

RRETHI I FERRIT - SHINASI A. RAMA

SHINASI A. RAMA

Përrallat e tranzicionit
shqiptar
- vëllimi 2 -

RRETHI I FERRIT

Instituti i Studimeve Kombëtare Shqiptare
Shkodër, 2015

Shtëpia botuese
Instituti i Studimeve Kombëtare Shqiptare,
New York, SHBA

Autor: **Shinasi A. Rama**

Titulli: “Përrallat e tranzicionit shqiptar”
- vëllimi 2 -
RRETHI I FERRIT

© Copyright Shinasi A. Rama

Të gjitha të drejtat janë të mbrojtura me ligj dhe të rezervuara prej autorit. Riprodhimi i librit, qoftë edhe në formë të pjesëshme, është i ndaluar. Nuk mund të kopjohet asnjë pjesë teksti, pa lejen dhe miratimin paraprak të autorit, i cili është mbajtës i vetëm i së drejtës së botimit, përveç rasteve kur kjo e drejtë lejohet qartazi nga ligji.

Redaktor letrar,
organizimi grafik:
Arben Bllaci

ISBN

Shkodër, 2015

Të mos merremi me Katovicën, Bërdicën, Kamenicën, Drashovicën, Reçicën, Nivicën etj., etj., por të reflektojmë mbi këtë hata që na ka rënë e mbi këta kërma politike që na sundojnë, na shfrytëzojnë, na shesin, na korruptojnë, na degjenerojnë. Këta duhet te ikin, sepse këta dhe platforma e tyre ishin dhe janë fatkeqësia jonë.

Unë e njoh shtetin, i njoh njerëzit, e njoh zanatin, e njoh politikën. Në momente kritike kam marrë vendime, kam sakrifikuar veten, familjen dhe të ardhmen për idetë e mia. Dallimi midis meje e të tjerëve është se unë dua një Shqipëri tjetër, nuk e pranoj shtetin e bandave e të hajnave. Prandaj ata thonë se nuk e njoh Shqipërinë.



PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	13
OLIGARKIA BËRTET PËR KOMB, BASHKIM, RILINDJE KOMBËTARE, POR PUNON KUNDËR KËTYRE OBJEKTIVAVE.....	19
ZGJEDHJET DHE E KEQJA MË E VOGËL.....	31
E GJITHË SHQIPËRIA SI LAZARATI: ZGJEDHJET DHE BUJQËSIA JONË INDUSTRIALE DIGJITALE E BIMËVE MEDICINALE.....	38
ZGJEDHJET DHE VOTUESIT: RINIA, E DREJTA E VOTËS DHE PËRGJEGJËSIA QYTETARE.....	48
ZGJEDHJET DHE VOTUESIT E DREJTA E VOTËS - II -	55
ZGJEDHJET DHE VOTUESIT: PËRSIATJE MBI KONCEPTIN E QYTETARIT - III.....	60
ZGJEDHJET DHE NDËRKOMBËTARËT: TRI ZGJIDHJET DHE LOJA ME KARIKE E PARISË.....	63
DITA PAS ZGJEDHJEVE: ËNDRRA E VETME DHE PESËMBËDHJETË ANKTHET E PARISË SË TIRANËS.....	68
PËRRALLA E 1 PRILLIT.....	74
PAKTI BERISHA - RAMA - META DHE NEVOJA E ALTERNATIVAVE POLITIKE.....	77
ZGJEDHJET, TURMA E UDHËHEQËSVE DHE MUNGESA E BURRAVE TË SHTETIT.....	83
PROBLEMI I LIGËSISË NË POLITIKËN SHQIPTARE.....	87

ZGJEDHJET DHE MANIPULIMI I NDASIVE TË RREME POLITIKE.....	93
PARIA E TIRANËS DHE PROBLEMI I AKTIVIZIMIT TË RINISË NË POLITIKË.....	102
ZGJEDHJET DHE PROBLEMI I BORXHEVE TË SHTETIT SHQIPTAR.....	110
ZGJEDHJET DHE PROBLEMI I PAZGJIDHSHËM I EKONOMISË NË KRIZË.....	119
NGA PROBLEMET POLITIKE TË PASZGJEDHJEVE: NË DORË TË KUJT DO TË MBESË PARTIA DEMOKRATIKE.....	130
PARIA E TIRANËS DHE VERBËRIA POLITIKE E POPULLIT.....	139
FENOMENI BEPPE GRILLO SI PROBLEM PËR PARINË E TIRANËS.....	143
KOMBËTARIZMI DHE ZGJEDHJET E PARISË SË TIRANËS.....	151
PAKTI I PARISË DHE ARIXHOFKAT E SHTYPIT.....	158
PAKTI I PARISË SË TIRANËS: PRIJATARËT, MILITANTËT DHE KATUNDARËT.....	164
PAKTI I PARISË SË TIRANËS DHE TAKSAT: FATI I KEQ I KATUNDARËVE SHQIPTARË.....	171
INISIATIVA “VOTA E BARDHË”, “BËJ BOJKOT”, “VOTA SHKON KOT”.....	180
EDHE NJËHERË MBI VOTËN E BARDHË, BOJKOTIN DHE PROTESTËN.....	187
PAKTI I PARISË SË TIRANËS, PRAGMATIK APO MORALIST.....	191
BLLOKMENË, BLLOKQENË, BLLOKZAGARË DHE KOKËPALARË, PAKTI I 1 PRILLIT DHE ZGJIDHJA QË NUK E KEMI	200
PRODHIMI I FERMERËVE PO ZVARRITEMI DREJT ZGJEDHJEVE.....	205
NE NA KA NGORDHUR GOMARI ME KOHË DHE.....	210
ZGJEDHJET DHE MAKTHET E BERISHËS.....	212

ANKTHET E EDI RAMËS.....	219
SE NE NA KA NGORDHUR GOMARI DHE.....	227
SI PO MUNDOHET PARIA E TIRANËS TË MBULOJË PAKTIN E 1 PRILLIT ME HI, ME ZHURME, E ME DHE.....	229
NËN PUSHTETIN E GJENDJES, PARIA E TIRANËS DHE EKSPERIMENTI I TRANZICIONIT SHQIPTAR.....	235
SE NE NA KA NGORDHUR GOMARI ME KOHË POR.....	240
INTERVISTË NË GAZETËN “SHEKULLI”	244
PËRSIATJE MBI PAKTIN E 1 PRILLIT DHE MARRËVESHJEN PS - LSI.....	251
PAZARI I ZGJEDHJEVE DHE KOALICIONET - BANDAT MË TË MËDHA TË HAJNAVE NË HISTORINË E SHQIPTARËVE	255
NË KAHE TË KUNDËRT, REALITETI VIRTUAL DHE REALITETI JETËSOR SHQIPTAR.....	262
NUK PO NDODH ASGJË, PROBLEMI I FSHEHUR I KRIZËS SË THELLË EKONOMIKE.....	271
NË ROLIN QENDROR TË SHTETIT, BOTËKUPTIMI REALIST DHE POLITIKA SHQIPTARE.....	277
MBI KANIBALIZMIN POLITIK, EKLEKTIZMI DHE BANDITIZMI NË POLIKËN E TIRANËS.....	283
CILA MENDËSI A BOTËKUPTIM DO TA SJELLË NDRYSHIMIN NDËR SHQIPTARËT.....	288
BOJA NË FYTYRËN E POLITIKËS SHQIPTARE.....	292
KOMENTATORËT DHE ZHURMUESIT - BRIGADA E PLEHUT NË INTERNET.....	297
OLIGARKIA, PARIA E TIRANËS DHE FAMILJET MAFIOZE LOKALE.....	302

KOMBËTARIZMI SI FAKTOR I PASHMANGSHËM NË POLITIKËN SHQIPTARE ËSHTË VETËM ÇËSHTJE KOHE.....	308
TRI FUSHATA ZGJEDHORE, PARIA, PARTIA DHE KLANET LOKALE.....	312
SHERRI I PASHMANGSHËM, LOJA E TENXHEREVE ME PRESION DHE ZJARRI I PASHUAR.....	317
MBI TË MIRËN DHE TË KEQEN NË POLITIKËN SHQIPTARE - I -.....	322
E MIRA DHE E KEQJA NË POLITIKËN SHQIPTARE - II -.....	325
E MIRA DHE E KEQJA NË POLITIKËN SHQIPTARE - III -.....	330
DEMOKRACIA NUK ËSHTË RROTACION DEMOKRACIA ËSHTË ZGJEDHJA MË E MIRË.....	336
BOJKTIMI I ZGJEDHJEVE - HAPI I PARË DREJT DEMOKRACISË SË VËRTETË.....	344
PËRPLASJA PËR MONUMENTIN NË KAVAJË.....	348
LËVIZJA STUDENTORE E VITEVE 1990 - 1991 VLERË APO KOHË KRITIKE.....	351
PSE MERREM ME POLITIKË, SHTET - KOMBI BESIMI DHE QËLLIMI IM.....	358
PROBLEMI I LEGJITIMITETIT TË SISTEMIT DHE BOJKOTI SI ARMË E DOMOSDOSHME POLITIKE.....	372
FUNDI DALTË PËR HAJËR - PËRSËRITJA E TRAGJEDISË KOMBËTARE TË 1997.....	388
THIRRJA PËR BOJKOTIM TË ZGJEDHJEVE - RIVLERËSIM I NJË NISME QYTETARE - II -.....	392
THIRRJA PËR BOJKOTIM TË ZGJEDHJEVE - RIVLERËSIM I NJË NISME QYTETARE - I -.....	398
KUSH DO TA BËJË OPOZITËN.....	404

ARTAN GJATAJ, SI LEXOHEM ME GOOGLE TRANSLATE NJË ARTIKULL.....	410
KOVA ME VRIMA, GJASHTË RRJEDHJET E FRIKSHME TË VJESHTËS 2013.....	416
SHTETI I PARISË APO SHTETI KOMBËTAR SHQIPTAR.....	422
E PAZËVËNDËSUESHME IDEOLOGJIA KOMBËTARISTE NË POLITIKËN SHQIPTARE.....	426
TEORIA E HIJES NË POLITIKËN SHQIPTARE, KUSH DO TA BËJË OPOZITËN.....	432
ARTAN GJATAJ, PARTIA E FORTË DHE PARTIA E SPORTEVE TË RËNDA.....	436
ARTAN GJATA: LUFTA KUNDËR KOMBËTARIZMIT DHE FATOS LUBONJA.....	440
MBI KONCEPTIN E BËRTHAMËS SË KOMBIT SHQIPTAR.....	448
MISIONI I PARTISË DEMOKRATIKE.....	452
MAJMNËT NA MBAJNË SKLLEVËR, REPLIKË ME KOLORETO CUKALIN.....	458
TË PAKTËN TË BËJNË SHTET, SE SHTETI I KUFIZON HAJNAT E CUBAT.....	464
PARIA I KA DUART ME GJAK, NË POLITIKË MBROJNË INTERESAT	468
MIZA NËN KËSULË, PARIA E TIRANËS DHE STRUKTURAT QË MBIJETUAN.....	475

PARATHËNIE

Në këtë vëllim të dytë të “Përrallat e Tranzicionit Shqiptar” janë përmbledhur shkrimet dhe analizat e mia të përgatitura gjatë tre muajve që i paraprinë fushatës zgjedhore të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013. Në më shumë se një mënyrë, libri është një analizë e një gjendjeje specifike mbështetur në konceptet e parashtruara në vëllimin e parë të “Përrallat e Tranzicionit Shqiptar”.

Analiza është e lidhur me një përpjekje për të kontribuar në debatet në shtetin shqiptar. Së bashku me kolegët Grid Rroji dhe Valbona Karanxha, në mars të vitit 2013, nisëm një blog, Rrethi i Ferrit. Synimi i ynë ishte që në rrëmujën e qëllim të mediatike, në shtetin shqiptar të kishte një pikëpamje alternative, por në të cilin të thuhej pa doreza e vërteta për gjendjen. Me një shpejtësi të habitshme Rrethi i Ferrit po lexohej me intensitet nga mijra vetë në ditë dhe u bë një pikë referimi në debatet e ditës dhe në politikën shqiptare në Tiranë.

Shumë shpejt blogu Rrethi i Ferrit tërhoqi vëmendjen e njerëzve të interesuar. Kontribuan me shkrime dhjetra analistë nga shumë shtete të huaja dhe nga trojet shqiptare. Për katër muaj botuam qindra shkrime shumë cilësore dhe të goditur, që u binin në shenjë problematikave të ndryshme në shtetin shqiptar. Natyrisht pjesa më e madhe e barrës i takoi këtij grupi të ngushtë kolegësh që me shkrime thuajse të përditshme e mbajti frymën alternative, që mungonte në poli-

tikën e Tiranës, të gjallë dhe të pranishme, pikërisht sepse mediumet ku botuam nuk kontrolloheshin nga paria e Tiranës. Shumë nga shkrimet u shumëfishuan dhe u përhapën në mediat shoqërore si dhe në faqet e tjera si Bleta Shqiptare, FSHAD.com apo albanianpolitics.com.

Duhet thënë se për interesat e tij, shumë nga shkrimet tona u botuan rregullisht nga shtypi në Tiranë dhe në emigracion si në gazetat “Sot”, “Telegraf”, “Illyria”, “Tema” dhe të tjera. Reagimi shoqëror ishte shumë i qenësishëm dhe i prekshëm. Blogu preku një nerv të shoqërisë shqiptare dhe nga një këndvështrim alternativ tha shumë të vërteta që deri atëherë as nuk cekeshin në fushatën zgjedhore. Kjo alternativë është ajo që duhet edhe në zgjedhjet e ardhshme kuvendore të vitit 2017. Por tashmë kjo alternativë interpretuese do të jetë në formën e disa librave përfshirë këtë libër, si dhe librat e kolegëve Grid Rroji dhe Valbona Karanxha.

Blogu Rrethi i Ferrit e arriti synimin e vet për të dhënë një përshkrim alternativ, si të gjendjes ashtu edhe të zgjidhjeve që duhen ndjekur. Kjo u arrit duke mbajtur një pikëpamje e qëndrim ideologjik konsekuent, me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme gjatë gjithë këtyre muajve të fushatës. Në thelb të këtij qëndrimi është bindja se paria e Tiranës ka ndërtuar një sistem oligarkik, me struktura të mbështetura në mendësinë katundare, me një shoqëri të kriminalizuar dhe me një shtet në shërbim të krimit, që do të na çojë ose në greminë, ose në skllavërim, ose drejt një përplasje të paevitueshme shoqërore. Në rastin e shkrimeve të mia, tej gjuhës së thjeshtë dhe të pakomplicuar qëndron një strukturë ideologjike e konsoliduar mirë, koherente dhe e qartë, që është parashtruar me gjerësi e sistematikisht në vëllimin e parë të “Përrallat e Tranzicionit Shqiptar”.

Influenca e blogut Rrethi i Ferrit u ndie qartë edhe në disa nivele të politikës dhe të shoqërisë në shtetin shqiptar. Ajo u ndie në kundërvënien e hapur të kalemshinjeve të Tiranës ndaj shkrimeve e pozicioneve politike të mbajtura në

blog. Ajo u ndie gjithashtu edhe në reagimin e drejtpërdrejtë të parisë që, ndër të tjera, e bëri Blogun fajtor për humbjen e votave. Ajo u ndie edhe në influencimin e mendësisë dhe të strukturave të brishta të shoqërisë civile që e mbështeti, por edhe që gjeti argumente dhe qartësinë e nevojshme në blog. Ajo u ndie veçanërisht në debatin mbi bojkotimin e sistemit dhe nevojën e ndarjes së njerëzve nga sistemi kriminal i parisë së Tiranës.

Po thuajse tre vite më vonë, mundem me thanë pa shumë modesti se kemi treguar të vërtetën e hidhur. Kemi qënë shumë, shumë të qartë dhe iu kemi rënë në kokë problemeve. Pa asnjë modesti më duhet me thënë se e kemi parashikuar me qartësi dhe kthjelltësi si do të ecnin proceset deri në data. Dhe në një kohë të tillë kur ndër shqiptarët rrena dhe mashtrimi shiten për realitet objektiv, kjo nuk është pak. Kemi qënë të saktë deri edhe në shifrat dytësore. Kjo u sprovua nga qeveritarët që heshtën për realitetin, por kur erdhën në pushtet nuk mundën të mos e pranonin gjendjen katastrofike ekonomike në të cilën ndodhej shteti. Prandaj shkrimet botohen ashtu siç kanë dalë në blog, me korigjimet e duhura gjuhësore, kuptohet. Por përtej të domosdoshmes, asgja nuk është ndërruar.

Përse duhet të dalin në një përmbledhje shkrimet për një zgjedhje që tashmë ka përfunduar?

Sepse në zgjedhjet e ardhshme do të kemi po të njëjtën problematikë, edhe më të përkeqësuar. Prandaj duhet t'i dalim përpara punës dhe të mos presim të na thuhet se “na duhet aleanca e qelbësirave,” se “nuk e dimë se si është gjendja” e se “nuk e menduam kështu,” sepse “zgjedhëm të keqen më të vogël” dhe se “nuk ka zgjidhje.” Tani e dimë se si është gjendja. Nuk duhet të zgjedhim të keqen më të vogël. Dhe mbi të gjitha, ka zgjidhje të tjera dhe nuk kemi pse të ndërrojmë një qelbësirë me një tjetër. Po për të arritur tek ajo zgjidhje që na shërben, duhet punuar fort e me durim.

Zgjedhjet e vitit 2017, do të jenë një skenar që e kemi

parë disa herë dhe që në blogun Rrethi i Ferrit e kemi përshkruar qartë e pa mëdyshje e në të njëjtën kohë pa pretenca akademike por me një gjuhë që e kupton gjithkush. Më shumë se analiza, këto shkrime e përsiatje janë dëshmi që i ka qëndruar dhe i qëndron kohës. Kështu i dalim para krimin të pritshëm të vitit 2017 kur do të blihen, do të shiten dhe do të viden zgjedhjet dhe do të dhunohet vullneti i kombit shqiptar.

Si me çdo libër, ka shumë njerëz që meritojnë falenderimet e respektin për kontributin e tyre. Familja e ime ka përballue shumë, sepse ka qenë familja ime. Vëllau im, Ilir Muja (Rama) ka përballue sulmet e shumta e të përditshme të tati-morëve dhe të strukturave të shtetit që mbas çdo shkrimi nga unë shkonin me librin e gjobave duke i shkaktuar shumë shqetësime jo vetëm financiare. Axha im i ndjerë Ymer Rama Muja, pas humbjes së 23 qershorit 2013, u nxor forcërisht nga shtëpia me urdhër të kryetarit të qeverisë, Sali Berisha, në një operacion të drejtuar nga një drejtor policie, pjesëtar i Trustit të Gështenjave të Tropojës. Sakrificat e familjes vazhdojnë me kenë një çmim që e kemi paguar rëndë, por që nuk më ka ndalë në rrugën me thanë të vërtetën dhe as familjarët e mi me më mbështetë. Vëllau tjetër Sokol Muja (Rama), edhe pse jo shumë dukshëm në sipërfaqe, ka ndihmuar në mënyrë të jashtëzakonshme në përmirësimin e shkrimeve, në rritjen e cilësisë dhe në përhapjen e tyre. Po ashtu edhe bashkëshortja e ime Nereida Rama Katrini ka dhënë një ndihmë të pazëvendësueshme e të çmuar si me leximin ashtu edhe me mbështetjen e palodhur.

Falenderime të veçanta meritojnë kolegët Grid Rroji dhe Valbona Karanxha. Pa përkushtimin dhe pa punën e tyre të palodhshme, blogu nuk do të ishte i mundur. Falenderimet iu shkojnë edhe kontribuesve të tjerë të blogut si Adem Gashi, Afrim Krasniqi, Arben Bllaci, Arben Kallamata, Arbenc Propoki, Arber Zaimi, Artjan Gjataj, Edlira Gushta, Ergys Mertiri, Fadil Lepaja, Gilmana Bushati, Ilir Demalia, Ilir Kulla, Leandrit Mehmeti, Ledjan Prifti, Majlinda Sinani, Man Pogaj, Mi-

moza Demiri, Murat Aliaj, Nail Draga, Nehat Sadiku, Nexhmedin Spahiu, Plarent Anamali, Ramiz Gjini, Xhafer Rakiplari, Ylber Lili, Ylli Babliku dhe të tjerëve, shkrimet e të cilëve i kemi vënë në blog. Nga ana e tij, redaktori gjuhësor i librit, gazetari dhe autori Arben Bllaci, ka bërë një punë shumë cilësore dhe të lavdërueshme. Të gjithë kanë mirënjohjen e paktësuar dhe falenderimet e mia për kontributin e tyre.

Në përfundim, gjithë të metat eventuale janë të miat dhe për to përgjegjës jam vetëm unë.

Nju Jork

Nëntor 2015

OLIGARKIA BËRTET PËR KOMB,
BASHKIM, RILINDJE KOMBËTARE,
POR PUNON KUNDËR
KËTYRE OBJEKTIVAVE

- Intervistë në revista "JAVA", 02.12.2013 -

- I nderuari z. Rama, faleminderit që pranuat të intervistoheni. Verdicti i gjykatës së shkallës së parë për çështjen e "21 janarit" ka treguar se drejtësia shqiptare e ka të pamundur t'i shkëputet ndikimit politik. Nëse e keni ndjekur ecurinë e procesit, a mendoni se gjykatat mund të gjenin kurajë t'i shkëputeshin disi tutelës dhe frikës nga politika e z. Berisha?

- Procesin e kam ndjekur me shumë vëmendje, kryesisht përmes shtypit të përditshëm që gjithësesi, është tejet i deformuar dhe në shërbim të pakushte të njërës apo të tjetrës palë të parisë së Tiranës. Megjithatë, në lidhje me sjelljen e gjyqtarëve për gjykimin e vrasjes së katër personave në rrugë e jo brenda institucioneve të shtetit, duhen theksuar këto gjëra.

Së pari, duhet kuptuar mirë se ligji gjithnjë është elastik. Ngaqë çdo sistem ligjor sanksionon atë që nuk duhet bërë, le gjithnjë shumë hapësirë interpretimi e justifikimi në lidhje me atë që duhet bërë. Shpesh, ajo që ka ndodhur është në nivelin e të diskutueshmes. Me pak ndihmesë nga institucionet e tjera dhe me mbylljen e syve nga prokuroria e gjykata, siç ndodhi në këtë rast me zhdukjen e videove, regjistrimeve, armëve, regjistrave, thirrjen e dëshimtarëve, etj., sjellja e gardi-

stëve bëhet disi e justifikueshme për ta. Por realiteti është se gjykatat shqiptare nuk kanë asnjë fije respekti për ligjin dhe sistematikisht demonstrojnë një besnikëri të frikshme karshi klaneve oligarkike dhe kriminale, që kontrollojnë çdo aspekt të jetës shqiptare.

Së dyti, gjykatat në shtetin shqiptar janë nga institucionet më të korruptuara dhe të vëna pa kushte në shërbim të parisë së Tiranës. Mjafton të kujtohen skandalet e panumërta që kulmuan me Gërdecin e me vrasjen e 26 të pafajshëmve, korrupsionin e rrugëve, të tenderave, të privatizimeve, të subvencioneve e me rradhë. Këta nuk e lëvizën gishtin, se i zbuloheshin petët lakrorit dhe tundeshin themelet e sistemit. Nuk është frika që ndjejnë nga Sali Berisha. Është bindja e tyre e vetëdijshme se kështu duhet vepruar, domethënë se edhe këta janë pjesë e vetëdijshme e krimit politik.

Më së fundi, gjykatësit do t'i bindeshin gjithkujt që kontrollon pushtetin e makinën shtetërore. Fajtori i vërtetë është ai që dha urdhërin e vrasjes. Këta ishin vegla të tij. Fajtori as nuk u gjykua, as nuk u thirr si dëshmitar, as nuk u dënua. Më në fund, duhet thënë se kjo sjellje është metodë pune në shtetin shqiptar. Të gjithë janë të kapur dhe po këta gjykatës do t'i shërbenin pa pikën e mëdyshtjes çdo pale, po të ishin në pushtet. Nëse vijnë në pushtet këta të palës tjetër, të njëjtët gjykatës, po të mos kenë pasaporta të shteteve të ndryshëm që të ikin nga sytë këmbët, do t'i nxjerrin të fajshëm e kriminalë po të njëjtët njerëz. Nuk mund të jetë një njeri në shërbim të parisë së Tiranës, të dënojë hajnat e vegjël, të punojë për të nxjerrë të pafajshëm kapobandat, të shkojë pastaj në shtëpi t'i thotë vetes i ndershëm dhe të rrisë familje të shëndetshme. Problemi është se bëhet me ndërgjegje të plotë, ndaj këta janë pjesë e strukturës kriminale - mafioze të parisë së Tiranës.

- Kemi disa privatizime të gabuara dhe së fundmi një privatizim të dështuar të "Albpetrolit", që gjithsesi është parathënë me kohë nga ekspertë të ndryshëm për mënyrën sesi është vepruar me procesin e transparencës së tende-rimit. Duke e parë

nga larg, si rasti juaj, a nuk duket se ka një tentativë për t'i shitur asetet e vendit pa asnjë logjikë ekonomike dhe më shumë se kaq, me pak logjikë kriminale?

- Në politikat ekonomike dhe në privatizime të këtij niveli, nuk ka gabime. Ka një llogaritje shumë të qartë e të bërë me kujdes; bëjnë ligjin ata që bëjnë ligjin dhe mandej bëjnë privatizimin. Pra, logjika e shitjes së pasurisë kombëtare kujtdo që hedh e pastron para në arkën e shteti shqiptar në shërbim të klanit sundues, nuk është pak kriminale, por është shumë kriminale, domethënë është një sjellje mafioze dhe kleptokrate e padyshueshme. Duhet kuptuar edhe logjika që ndjek Sali Berisha dhe administratorët e shtetit në shërbim të tij, në marrjen e këtyre vendimeve. Arka e shtetit është bosh e prandaj duhet mbushur disi. Privatizimi i jep mundësi klanit sundues të parisë së Tiranës të paguajë rrogat e të mbajë njerëzit në punë. Po ashtu privatizimi i këtij niveli dhe me këtë mënyrë i ndihmon të konsolidojnë interesat ekonomike të grupeve, familjeve e strukturave të dyshimta që i ndihmuan të rrinë në pushtet e që iu shërbyen me besnikëri. Privatizimi i bërë në këtë mënyrë i ngjan parimit të tokës së djegur. Kushdo që do të marrë pushtetin nesër, do të ketë çelësat e kashtës, do të gjejë thesarin bosh e shtetin me borxh gjer në fyt. Sa të merren vendimet e duhura, sa të përmbysen marrëveshjet, sa të verifikohen paratë, burimet e investimet, nëse do të merren vendimet e tilla, do të kalojë kohë. Dhe kur të qetësohet zallamahia në rrugë me protestat e pritshme e me rrëmujat e zakonshme, gjendja do të ketë shkuar në pikë kritike, populli do të harrojë çka ndodhur dhe me pafytyrësinë e zakonshme, kundërshtarët do të fillojnë të bëjnë fajtor njëri - tjetrin.

Por kjo pasuri ka qenë dhe është pasuria e të gjithë shqiptarëve. Privatizimi është bërë në mënyrën më të gabuar e më kriminale të mundshme. Është detyrë e gjithkujt që kërkon të bëjë politikë në shërbim të popullit, t'i thotë të bardhës e bardhë, të zezës e zezë dhe t'i rishohë të gjithë ligjet e kaluar dhe proceset si janë bërë. Këta njëzetë e dy vjet shqiptarët kanë

parë një proces privatizimi që ka qenë metoda e pasurimit të llumit shoqëror, e cubave, hajnave dhe lamashëve të rrugës, gjithnjë në shërbim të klaneve të konsoliduar të parisë së Tiranës. Gjithë kjo duhet riparë me kujdesin e duhur.

- Keni qenë vazhdimisht kritik ndaj qeverive shqiptare dhe nivelit të demokracisë të tyre. Ku e shikoni, në fazën e tranzicionit, pikën e parë të degradimit të qeverive të pas '90?

- Të gjitha qeveritë e pas vitit 1990, janë bërë me njerëz të situar mirë, të lëmuar e të deformuar me kujdes para vitit 1990. Këta ishin piketuar të merrnin pushtetin, pavarësisht se në atë ngut u ngatërruan këmbët e disa individë e gjetën veten të caktuar në opozitën kundër partisë që i shërbenin me shumë devotshmëri. Të gjitha forcat politike dhe të gjithë individët që dolën në lojë, ishin të kapur, të kontrolluar, të manipuluar, marioneta e kukulla pa vlera morale të qëndrueshme, pa ide realiste dhe pa ndjenjën e shëndoshë të shërbimit publik. Ashtu si ishin vetë, ashtu ishin edhe qeveritë që bënë; të degjeneruara, të zvetënuara, antikombëtare, antishtetërore, katundare dhe në shërbim të klaneve katundare të parisë. Qeveritë e dala nga zgjedhjet, nuk ua la trashëgim babai i teqesë, bajraktari i katundit apo këshilli i të urtëve, por këta i kanë trajtuar si të ishin të tilla. Qeveritë janë zgjedhur në mirëbesim të popullit shqiptar dhe detyra e tyre parësore ka qenë të mirëadministrojnë pasurinë kombëtare e të ruajnë nderin e dinjitetin e popullit. Ne jemi një popull i vogël, me një ekonomi të brishtë, nën trysni të jashtëzakonshme ekonomike, demografike dhe politike. Prandaj administrimi me kujdes i pasurisë kombëtare, përkujdesja për kultivimin e vlerave shoqërore, ruajtja e nderit dhe e dinjitetit të qytetarëve, shërbimi ndaj të pamundurëve, të sëmurëve dhe të brezit të tretë, rritja e fëmijëve siç duhet; me vlerat dhe me edukimin e duhur, ruajtja e ambientit dhe investimet afatgjata në edukim, në ekonomi, në kulturë kanë qenë objektiva kardinale për çdo qeveri. Këta shpërdoruan gjithçka. Në vend që me ato dhjetra e dhjetra miliardë dollarë që kanë hyrë si kanë hyrë në shtetin shqip-

tar, me burimet e me njerëzit që kishim të ndërtonin diçka të dobishme e me të ardhme, përfunduan duke e kthyer vendin në një shkretirë morale, me një shoqëri të kriminalizuar dhe pa të ardhme. Por kjo iu shërbente atyre, ndaj këtë shoqëri të degraduar vendosën ta ndërtonin dhe e ndërtuan të zvetënuar e të degjeneruar.

- A është një lloj dehje nga liria, kjo që po ndodh me fenomenin e demokracisë shqiptare?

- Liria është e drejta për të vepruar në mbrojtjen e mendimeve dhe të interesave të secilit, por pa shkelur interesin e përgjithshëm, interesin e shtetit, pa shkelur të drejtat e tjetrit. Kjo që ka ndodhur në shtetin shqiptar është keqkuptimi i lirisë. Kjo është anarki e qëllimtë, diçka që shqiptarëve iu shitet si liri, thjesht për t'ua bërë skllavërinë e ardhshme të pranueshme e të pashmangshme. E sa për demokracinë, në shtetin shqiptar mund të ketë individë që kanë qenë e janë demokratë, por nuk ka pasur ndonjëherë demokraci. E para dhe e vetmja herë kur u votua në mënyrë me të vërtetë demokratike, ka qenë në zgjedhjet e 31 marsit 1991. Pas tyre, zgjedhjet u bënë vetëm e vetëm përplasje strukturash të drejtuara nga katundarë, në bazë të parimeve katundare, me objektivat e mbrojtjes së interesave të katundeve respektivë, përmes manipulimit dhe vjedhjes së votave. Demokracia nuk është rrumpallë e një shprehje e individualizmit ekstrem në të cilin vota shitet për një thes miell apo për një gjel deti, për një vend pune apo përfitime të tjera. Demokracia është metoda për me zgjedhë udhëheqësit që matarojnë punët e kombit për një periudhë të caktuar. Pra, duhet të ketë një vetëdije paraprake se ka një grup, siç është edhe familja, në të cilin për të bërë një punë caktohet, zgjidhet kush është më i zoti ta kryej atë punë. Lumi bën dritë kur kanalizohet e drejtohet në rrugën e duhur. Edhe vullneti i popullit duhet kanalizuar e drejtuar në rrugën e duhur, që në këtë rast është interesi kombëtar - shtetëror që duhet të ishte i padiskutueshëm dhe në qendër të politikave të caktuara. Kur nuk kanalizohet si duhet, lumi

përmbyt e shkatërron gjithçka që gjen në rrugën e vet. Kjo që ka ndodhur gjatë këtyre njëzetë e dy vjetëve, është thjesht trimufi i katundarisë, i mendësisë katundare të manipuluar nga paria e Tiranës, nuk është demokracia e vërtetë. Një ditë, kur të na dalë dehja e të na mbysë zullumi i asaj që kemi bërë, do të pendohemi shumë. Unë shpresoj që të mos jetë vonë, të ketë ende shpresë. Po edhe po nuk pati më shpresë, përsëri duhet punuar kundër të keqes pa mëdyshje e pa kompromis.

- Të gjitha institucionet e vendit tashmë janë nën diktatin e z.Berisha, që e ka përmbysur strukturën e pavarësisë institucionale me anë të vendosjes së figurave që pothuaj nuk e respektojnë dhe më shumë akoma, as e përfaqësojnë pavarësinë e institucionit të tyre, duke filluar nga Presidenti e me radhë. A mendoni se kjo është logjikë personazhesh me të shkuar komuniste dhe me kompleksin e dosjeve, që me sa duket janë mbyllur përfare?

- Nuk ka kund institucione të pavarura; ka një autoritet më të lartë se të gjithë, është vullneti i popullit shqiptar. Shteti shqiptar është shtet sovran, sepse njihet nga shtetet e tjera. Shteti shqiptar duhet të respektojë sovranitetin e tij, sepse me kenë shtet, nuk është diçka që arrihet lehtë. Politikanët duhet të mbrojnë interesat e shtet - kombit dhe të respektojnë vullnetin e popullit. Popullin shqiptar as nuk e ka pyetur, as nuk e pyet njeri. Ndaj edhe shqiptarët shpërthejnë në çdo mënyrë që munden kundër shtetit e kundër pushtetarëve që kanë.

Në këtë shtet formalisht sovran, institucionet kanë pushtete të caktuara, por të gjitha pushtetet e ligjet duhet të burojnë prej këtij autoriteti që zgjidhet nga populli në zgjedhje dhe që në emër të popullit nxjerr ligjin bazë, ligjet dhe aktet mbi të të cilave funksionojnë këto institucione. Zgjedhjet e manipuluar, politikanët e korruptuar që dalin prej tyre, çojnë në ndrydhjen dhe në deformimin e vullnetit të popullit. Në shtetin shqiptar zyrtarët janë në pushtet jo pse i shërbejnë ligjit, por sepse i shërbejnë një klani të caktuar. Të gjithë janë pajtuar me mendimin se duhet të bëjnë atë që iu thotë shefi i klanit të caktuar. Është krijuar bindja se kur të jenë në pushtet

këta politikanë, do t'i vënë në një post që do ta shfrytëzojnë deri në maksimum. Kur të ikin nga pushteti, do të kenë vjedhur aq para, sa të jetojnë për shtatë breza edhe në opozitë. Kjo është sjellja logjike për parinë e Tiranës që ka ndërtuar një sistem qartësisht oligarkik e kriminal.

Në lidhje me të shkuarën... Duhet thënë se ka pasur njerëz që kanë qenë pjesë e strukturave të shtetit, por që i kanë shërbyer atij dhe janë munduar që edhe në ato kushte të mbesin njerëz. Shumë kanë qenë komunistë me bindje, por dhe teknokratë e shërbyes publikë të aftë, njerëz që 1990 - ta i gjeti dhe i la vetëm me një pension, pa shtëpi, të përbuzur pa të drejtë, pa asnjë fije respekti për kontributin që kishin dhënë, pa asnjë mundësi për me kontribue në shoqëri, përveçse me u kryqëzue e me u dënue moralisht për marrëzirat e një grushti udhëheqësish në Bllokun e Tiranës, të cilët donin të ruanin sundimin e tyre me çdo kusht e pa pikë mëshire për shqiptarët. Këta ishin përgjegjës për luftën e klasave, për mbylljen ekstreme, për ndrydhjen ekstreme, për ngurtësinë e politika-ve e me rradhë.

Në nivelin ideologjik, me qenë komunist domethënë me besue në barazinë e njerëzve, me iu dhanë mundësi edhe atyre që nuk kanë aftësi e kapacitete me jetue si njerëz. Këtë premton edhe socialdemokracia, këtë premton edhe nacionalizmi, këtë premton edhe çdo ideologji tjetër. Mund të jetë e pamundshme të zbatohet, por si ide nuk është diçka e dënueshme. Është thjesht pjesë e debatit publik dhe ideologjik në lidhje me rrugën që duhet të marrë shoqëria. Ideja e socializmit në shoqërinë shqiptare do të ketë gjithnjë mbështetje të ndjeshme politike. Sa më shumë të polarizohet ajo, aq më shumë do të rritet kundërshtia shoqërore dhe ide të tilla do të bëhen të pranueshme për brezat që vijnë. Prandaj duhen ndarë njerëzit që besonin e besojnë në shtet, në komb, në shërbim publik, në strukturën institucionale dhe në ligj, nga arrivistët, intrigantët, ekstremistët dhe shërbyesit e gjithkujt, që tashmë janë në pushtet.

Sa për dosjet, mund të them se shteti që kishim ishte një shtet i deformuar moralisht. Por në teknikën e administrimit, tëurvejimit, të kontrollit e të funksionimit, ishte një shtet shumë modern. Por ky sistem modern i njëanshëm u vendos mbi një shoqëri katundare. Sistemi u shemb, katundarët mbetën, dolën në krye dhe bënë një shtet katundar, me një kapitalizëm katundar, me parti katundare dhe me një sistem vlerash e propagande të denjë për katundarët. Tashti në një shoqëri katundare siç jemi ne, dosjet janë bomba bërthamore. Nderi, dinjiteti i familjes e gjithçka tjetër, varen nga ajo që ka ndodhur. Dhe ajo që ka ndodhur ka qenë tejet e frikshme, e llahtarshme në përmasa dhe e përcudnueme sa nuk merret me mend. Ajo është ana e errët dhe e zezë e shpirtit tonë, që duhet ta mbyllim e vulosim njëherë e përgjithmonë. Ta harrojmë si një andërr të keqe. Shqiptarët duhet të shohin përpara, duhet të mendojnë për të ardhmen e brezave dhe të gjithë shoqërisë, jo të merren me dosjet.

Por parisë dosjet i duhen si mjet kontrollimi i valvulës së tensioneve shoqërore. Dosjet janë mënyra më e mirë e përdorimit, frikësimit, kontrollimit, izolimit e zhvlerësimit të njerëzve. Kjo metodë kontrolli e parisë, siç e kam shpjeguar me detaje në librin tim të fundit "Përrallat e tranzicionit shqiptar" është një metodë e mbështetur në mendësinë katundare, por funksionoi mirë. Njerëz që do të ishin të dobishëm për shoqërinë, janë mënjanuar, injoruar, zhvlerësuar apo edhe shkatërruar familjarisht. Një parantezë; edhe pse unë nuk merrem e nuk dua të merrem më me politikë, do të thoja të hapet dosja ime. Unë kam aq ndershëmëri e ndërgjegje, sa me u përballë me veten time e me gjykue gjithçka të mirë a të keqe që kam bërë. Por ka shumë që nuk e kanë atë fuqi apo që kanë fëmijë me rritë, me mbajtë familje apo me ruajtë interesa të ngushta. Shkurt do të thoja se dosjet janë përdorur e do të përdoren nga katundarët në pushtet e në opozitë për arritjen e qëllimeve të klaneve respektive katundare dhe për shkatërrimin e mëtejshëm të shoqërisë shqiptare.

- Ka një ngritje të nacionalizmit në vendet ku flitet shqip dhe retorikë të madhe nacionaliste në Shqipëri. A mendoni se kjo është një mënyrë për t'u fshehur njerëzve paditurinë e liderve për të drejtuar dhe për të dhënë alternativa?

- Kombëtarizmi është ideologjia e vetme që mund të përqafojmë ne shqiptarët. Ne nuk na bashkon feja, sepse kemi tri fe; nuk na bashkon klasa e shtresa, sepse kemi e do të kemi shqiptarë të pasur e të varfër; nuk na bashkon idioma, sepse kemi ndarje në gegë e toskë; nuk na bashkon mendësia, sepse jemi të ndarë në malokë të jugut e të veriut, në fshatarë të jugut e të veriut, në qytetarë të jugut e të veriut; nuk na bashkon as interpretimi i historisë, sepse kemi qenë në pozicione të caktuara e të kundërta; si gjatë perandorisë osmane, gjatë kohës së luftës së ashpër të klasave, ashtu edhe deri në ditët e sotme kur ende flasim për persekutim, përndjekje apo për ndërtimin e një sistemi që i ndan njerëzit me thikë, siç është sistemi kapitalist. Nëse duam një shtet normal siç e kanë gjermanët, sllovenët të tjerët, ne duhet të përqafojmë idenë moderne të shtet - kombit. Shteti dhe kombi janë të pandashëm dhe, ose kombi do të kërkojë shtetin, ose shteti do të formojë kombin. Ne duhet të punojmë të gjithë për këtë punë. Edhe demokracia e vërtetë bëhet e mundshme kur shërben si metodë për të zgjedhur udhëheqësit dhe për të përcaktuar politikat që i shërbejnë një kombi të caktuar. Ndryshe edhe demokracia është shkatërrimtare e paralizuese për një shoqëri që nuk i ndan vlerat e një kombi etnik apo qytetar, siç është bie fjala SHBA, ku pavarësisht bindjeve, përkatësisë etj., të gjithë janë qytetarë të shtetit. Në rastin tonë është e pashmangshme që shteti do të identifikohet me shqiptarët, të cilët përbëjnë mbi 90 e ca përqind të popullsisë së shtetit. Gjuha e shtetit do të jetë gjuha shqipe, historia e shtetit është pazgjidhshmërisht e lidhur me historinë shqiptare dhe identiteti i shtetit ka qenë dhe do të jetë i lidhur pazgjidhshmërisht me identitetin kombëtar shqiptar. Përndryshe kombi shqiptar do t'i kundërvihet një shteti që nuk i promovon vlerat kombëtare, edhe pse pakicat

do të kenë gjithë të drejtat e detyrimet që duhet të mbrohen në një shoqëri moderne. Rritja e vetëdijes kombëtare shqiptare është normale, e pashmangshme dhe, në shumë e dobishme, anipse e vonuar dhe e abuzuar nga politikanët. Kombëtarizmi behët streha e fundit e horrave, si këta që kemi ne me shumicë në politikë, kur politikanët kërkojnë të përdorin interesin dhe mbështetjen ndaj idesë kombëtare për të manipuluar njerëzit, për të mbrojtur interesat e tyre dhe klaneve të tyre.

Flamuri është gjëja më e shenjtë kur mbulon trupin e një dëshmori të rënë për Atdhe. Flamuri bëhet leckë kur përdoret nga një politikan për me mbulue poshtërsitë e veta.

- Si e shikoni marrëdhënien e Kosovës me Shqipërinë?

- I shoh në një pikë kthese interesante. Shqipëria dhe Kosova janë protektorate, pa sovranitet të plotë e të mirëfilltë. Por paria e Tiranës e ka humbur sharmin dhe influencën që kishte dikur mbi shqiptarët e Kosovës. Edhe qendra e kombit shqiptar ka lëvizur nga Tirana drejt Prishtinës e Tetovës. Shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi janë patriotë, atdhetarë e kombëtarë. Tashmë ata kanë dijet, shtresën politike, një nivel qytetarie të lakmu-eshëm, besnikëri në strukturat lokale dhe pavarësisht kriminalizimit të disa segmenteve të politikës, masa e popullit është e shëndoshë, e vetëdijshme dhe sundimtarët që e kanë shfrytëzuar përtej maksimumit të mundshëm kontributin që kanë dhënë, janë kalimtarë. Brezi i ri i politikës është shumë më atdhetar, më i pastër, më i vetëdijshëm dhe kombëtar. Kosova është qendra e shqiptarisë dhe Tirana është vetëm një metropol ndër disa metropole të politikës shqiptare. Rrjedhat janë interesante dhe do të shohim sesi do të evoluojnë pas shpërthimit të plotë të krizës, të kthimit të emigrantëve, të përplasjes së pashmangshme shoqërore dhe të nevojës për dalje nga gjendja, situatë që do të precipitojë në tre - katër vitet e ardhshme.

- Në vëzhgimin tuaj, si është sot pozicioni ndërkombëtar i Shqipërisë, me mesazhet shumë ambigue që ne vetë japim vazhdimisht?

- Shteti shqiptar është një protektorat ndërkombëtar, klasa sunduese e të cilit merret seriozisht vetëm në aspektin sa mund të shkaktojë probleme rajonale. Po kjo kontrollohet lehtë me disa takime në Tiranë, sepse politikanët shqiptarë e përdorin nacionalizmin si strehën e fundit të horrave politike. Oligarkia shqiptare është një oligarki e krimit mafioz dhe kjo krijon shumë shqetësime për BE dhe SHBA. Nga ana e vet, politikanët janë të interesuar të mbajnë bashkë katundarët e tyre. Politikanë që kemi janë tërësisht të diskredituar e pa kurrfarë besueshmërie në popull dhe te të huajt. Ata që bërtasin më shumë për Komb, Bashkim e Rilindje Kombëtare, punojnë me shumë kundër këtyre objektivave. Kështu që BE, SHBA, shtetet fqinje dhe strukturat që ndikojnë në politikën shqiptare, e dinë se këta nuk e kanë aspak seriozisht atë që thonë.

- *A keni arritur në një gjykim tuajin për personazhet kryesorë që e kanë drejtuar Shqipërinë në këto njëzetë e dy vjet?*

- Po, gjykimin tim e kam dhënë në librat e mi dhe në intervistat që kam dhënë periodikisht. Mendoj se e dhashë edhe pak më lart. Ka dalë llumi mbi ujë dhe tash duhet të shpresojmë që rrjedha e historisë do ta shtyjë drejt vendmbledhjes së plehrave historike. Zhumilet rrinë mbi ujë, por dikur do të bien në fund..

- *Si pjesë e komunitetit shqiptaro - amerikan, a shqetësoheni për fatin e zgjedhjeve të 2013 dhe me parregullsitë që mund të ndodhin me to, parashikuar nga burime mediatike shqiptare?*

- Si unë ashtu edhe shumë miq e shokë të mi, shqetësohemi për gjendjen e vendit dhe për qorrsockakun moral ku e ka futur paria sunduese e Tiranës. Ne kemi ikur nga shteti shqiptar, por nuk ka ikë atdheu prej nesh. Atje kemi familjet, të afërmit, varret, të shkuarën, kujtimet, dhembjet e vuajtjet dhe normalisht shqetësohemi për çdo gjë që ndodh. Ne jemi shqiptarë dhe na dhemb shumë gjithçka e keqe që ndodh. Edhe këto zgjedhje janë të destinuara të jenë të kontestueshme qysh pa u zhvilluar. Me deformimet e listave dhe të numrave të deputetëve, me kodin zgjedhor, me caktimin e komisioneve, me mënjanimin

e emigrantëve, me shtrëngesën që iu bëhet partive të vogla që s'mund të marrin vota po nuk iu bashkëngjitën klaneve të parisë, qysh tani është dhunuar vullneti i popullit. Ky është një film që e kemi pare, e dimë se në fund do të triumfojë e keqja. Nuk mundet të ndodhë ndryshe; gjarpëri do të flerë gjith ditën, por kur ta marrë uria do të kafshojë. Paria e Tiranës do të sillet e përsillet dhe kur të vijë puna te votat e te zgjedhjet, nuk do t'i rezistojë tundimit të së keqes së pushtetit dhe do t'i vjedhë pa hezitimin më të vogël.

ZGJEDHJET DHE E KEQJA MË E VOGËL

Dilema kryesore në të cilën ndodhemi në këto zgjedhje, është zgjedhja e të keqes. Njerëzit thonë “të zgjedhim të keqen më të vogël”. Nga këndvështrimi im, të gjithë palët e parisë së Tiranës janë plehra politike e nuk ka “të keqe më të madhe” e “të keqe më të vogël”. Të gjithë këta që janë në politikë janë banditë, kriminelë, vrasës, të korrumpuar, zhatës, të degjeneruar, antishqiptarë, antikombëtarë, rrënues të shtetit dhe shkatërrimtarë të së shkuarës dhe të ardhmërisë sonë. Të gjitha palët e parisë janë të tillë/a, pa asnjë përjashtim. Nuk ka rëndësi a është Trusti i Gështenjave të Tropojës në PD, Orta e Jeniçerëve të Skraparit në LSI apo Mafia e Konviktorëve të mbledhur në PS, së bashku me të tjerët nga bashkësi të caktuara fetare - krahinore. Të gjithë këta janë pjesë e parisë së Tiranës, uzurpatorë të shtetit, cuba, hajna të cilët kanë mbledhur një bandë që figurativisht e respektivisht mund të quhet banda e Sali Bajraktarit, banda e Gramoz Lamashit dhe banda e Ilir Kusarit. Ka edhe disa banda më të vogla sekrete, por edhe ato janë pjesë e parisë së Tiranës. Problemi është se sistemi politik që kanë ndërtuar të gjithë bashkë, i ka lejuar të sillen në këtë mënyrë pa u ndëshkuar, por duke u paraqitur si të domosdoshëm e të paevitueshëm për shqiptarët.

Po ka disa konstatime dhe vëzhgime që duhen bërë, që nuk duhen nënvlerësuar.

Së pari, këto janë banda, janë krijesa thelbësisht krimi-

nale. Prandaj nuk e kanë vendin në politikë. Prandaj duhet të shkërmoqen, të zhduken nga skena politike e nga jeta shoqërore si banda.

Së dyti, sistemi politik që kanë ndërtuar këto banda duhet të shembet, sepse është në funksion e në shërbim të bandave, jo të shqiptarëve. Prandaj na duhet një fillim i ri. Ky ndryshim fillon duke thënë të vërtetën për bandat dhe rrugën që na duhet të ndjekim.

Së treti, nuk duhet t'i zgjedhim këta, si të zgjidhnim të keqen më të vogël. E keqja më e vogël të mbytet më ngadalë, por të mbytet njëlloj pa mëshirë si e keqja më e madhe.

Së katërti, na duhet një forcë e re politike që të punojë për shqiptarët, për të mirën e për ardhmërinë e tyre si komb. Kjo është zgjidhja që na duhet e për të duhet të punojmë të gjithë.

Pse partitë e parisë së Tiranës janë banda?

Po ja!

Së pari, le të fillojmë e të bëjmë një listë me përfundimet që kanë nxjerrë të huajt, por edhe këta vetë për sjelljen në krye të shtetit. Kanë vjedhur shtetin. Kanë shitur shtetin. Kanë shitur pasurinë kombëtare. Kanë shkatërruar vendin. Kanë mbjellë injorancën. Kanë dëbuar shqiptarët në mërgim. Na kanë vjedhur dinjitetin e nderin. Kanë trafikuar gra, vajza, fëmijë, burra, armë, drogë, plehra, ajrin dhe ambientin. Na kanë futur në borxh deri në fyt. Na kanë falimentuar. Na kanë vjedhur miliarda. Na kanë betonuar tokën e bukës. Na kanë vënë bombat e pallateve që mund t'i shpërthejë një tërmet e të na zënë brenda nesër. Na japin të pimë sit ë pijshëm ujra gjirizi. Na kanë degjeneruar shoqërinë në disa breza. Na kanë shkatërruar ekonominë. Na kanë bombarduar si në Gërdec. Lista është e gjatë, shumë e gjatë e dihet nga gjithkush...

Vetëm bandat e llojit më të keq sillen kështu. Gjithkund tjetër, kombet e shtetet i zhdukin bandat e tilla. Pse duhet ne shqiptarët t'i zgjedhim sërish dhe t'i vëmë në krye të shtetit?

Çfarë mendojmë ne, mendojmë se këta do të bëjnë ndryshe nga ajo që kanë bërë deri më tani? Asnjë gjë s'do bëjnë! Sepse këta vetë thonë që duan të ecin në rrugën ku kanë ecur deri tani. Prandaj parulla e tyre është “ne jemi ndryshimi,” domethënë këta janë ndryshimi.

Problemi është te sistemi, jo te njerëzit

Së dyti, problemi kryesor nuk janë thjesht njerëzit e parisë dhe bandat. Problemi është sistemi politik që kanë krijuar. Të gjithë janë dakord me atë që thashë më lart, edhe këta vetë. Kjo do të thotë që të gjithë e dinë se këta janë hajna e banditë. Të gjithë e dinë që këta janë kapur në video, me zë, pa zë, me sekserë, me ndërmjetës, me dashnore, në shërbim të të huajve, me llogari në banka në Qipro (a i bën dot publike SHIU, SHISH, Gjergj Lezhja, Visho Lika e të tjerët që merren me këto punë, telefonatat që u bënë këto ditë?), se janë spiunët e të gjitha markave, të gjithë shteteve e kështu me radhë.

Por të gjithë ndalen këtu, te konstatimi i sjelljes së individëve të veçantë. Mandej të gjithë fillojnë lojën e gishtave duke u marrë me individët e veçantë, jo me sistemin në të cilin ata janë pjesë. Jo “ai e bëri”, jo “ky e bëri” dhe, pas një rrahjeje e përleshjeje mediatike ku dalin dashnorët e vajzës, orgjitë, pislleqet, koburet, sekserët, dokumentet, fotot, regjistrimet e të tjera, e të tjera, njerëzit lodhen dhe harrojnë ku ishte e vërteta. Vjen skandali i radhës, çudia në Tiranë zgjat tri ditë, faji për krimin e mëparshëm bëhet qyrk e nuk e vesh njeri. Dhe kështu kalohet te krimi tjetër edhe më i përbindshëm.

Problemi i vërtetë është te sistemi që e krijon dhe e lejon mundësinë e krimin. Kur merresh me njerëzit, humbet gjithmonë, sepse njerëzit ndërrohen dhe krijohet përshtypja e gabuar se po ndodh ndryshimi. Megjithatë, sjellja e atyre që janë në lojë, e atyre që dalin nga loja dhe e atyre që presin të hyjnë në lojë, është e njëjtë. S'ka ndryshim.

Vetëm ndërrimi i sistemit e ndërron sjelljen e njerëzve

Unë them se problemi kryesor që kemi ne, është sistemi që këta kanë ndërtuar. Me të, do të vijë puna që t'iu hanë të gjallë me gjithë lecka e me gjithë pasurinë që e keni fshehur në mur, me gjithë pasurinë që e keni bërë mure, sepse këta dinë si të nxjerrin dhjamë nga pleshti. Këta ju kanë lënë të majmeni njëçikë me mjerimin tuaj e me sakrifica mërgimi, thjesht që të fërgoheni më mirë. Sepse kur të vijë dimri i mjerimit për ta e për ju, fëmijët e tyre duhet të hanë. Kë do të hanë? Ju do t'ju hanë! Këta i trajtojnë shqiptarët si në "Ferma e derrave" dhe ky është sistemi i tyre. Përse rriten derrat? Që të theren! Këtë duan të bëjnë këta. Kështu na shohin këta. Kjo është e vërteta lakuriq, anipse e thënë figurativisht. Kjo është e vërteta e dhembshme. Në daç mbyllni sytë, në daç mbajini hapur, kjo është e vërteta e nuk bëhet tjetër!

Parulla e ditës: Të zgjedhim të keqen më të vogël

Por,

Së treti, ky qëndrim realist i thënë kështu shqeto, popullorçe, iu bie ndesh të gjithë atyre që punojnë për këto banda, kryesisht në mullinjtë e propagandës. Komentatorët, opinionistët, analistët, shërbëtorët, veglat e tyre mediatike dhe të thashethemnajës, përpunuesit e opinionit, profesorët, ata që hanë e që presin të hanë prej tyre, nuk pajtohen me këtë qëndrim timin. Lufta e tyre kundër përshkrimit të realitetit që thotë se këta janë siç përshkruhen më lart, bëhet në katër plane të ndryshme, me objektiv të njëjtë. Të gjithë duan të ruajnë e të mbrojnë sistemin e krimit të parisë së Tiranës, sepse janë pjesë thelbësore e tij.

Së pari, ata janë të bindur se zallamahia e shtypit, e zërave në nivele të ndryshme dhe tamtami i legenëve mediatikë në televizionë, në shtyp e në radio, një pikëpamje e një këndvështrim të tillë e bën të duket surreal, irreal, jonormal për

shqiptarët. Kur njerëzit shohin tri orë në ditë në secilin kanal televiziv maskarenjtë që shesin dëngla e marrëzira mediatike duke u shitur si analistë apo si profesionistë, kur ngulen para “Big Brother” e shohin sesi babai lavdëron të bijën që thujse ka dale mendsh për një grusht lekë, nuk mund të pranojnë se ka një pikëpamje tjetër si kjo që paraqitet këtu.

Së dyti, kur dëgjon Çim Pekën, Henri Çilin, Blendi Fevziun, dreqin e të birin, nuk ke se si të mendosh ndryshe. Kur lexon të bekuarit apostolikë Fahri Balliu, Andrea Stefani, Mero Baze, Mustafa Nano, Arian Çani, Edmond Tupe, Edison Ypi, Artur Zheji, Preç Zogaj, Shpëtim Narzarko, Spartak Ngjela, Fatos Lubonja dhe sheh Kazanin e Plehrave që është televizioni e dëgjon edhe këta të tjerët, pikëpamja që shtroj unë është e papranueshme. Realiteti i përshkruar nga goja e tyre, është krejt tjetër, është realiteti iluzor dhe imagjinar që ata duan t’iu shesin.

Së treti, problemi është se të gjithë këta duan të bindin njerëzit se kështu sillet e gjithë bota. Si shembull gjithnjë marrin grekët e italianët. Por harrojnë se grekët dhe italianët kanë shtete të forte, kanë njerëz që punojnë për vendin e tyre. Ata kanë identitete dhe kombe të konsoliduara, jo vetëm parti hajnash e banda. Grekët mund të kenë një pari që vjedh Evropën, por vetë ata e nxorrën listën e hajnave që vjedhin shtetin e tyre dhe po i fusin në burg. Në Greqi doli një parti që mund të mos jetë demokratike dhe aspak e pranueshme si Agimi i Artë, por që iu jep strukturë ndjenjave të mospajtimit e të revoltës të popullit grek. Në Itali mund të jetë Berlusconi, por doli edhe Lëvizja me Pesë Yje e Beppe Grillo që e paralizoi gjendjen politike dhe trandi sundimin e partive tradicionale.

Së katërti, synimi i tyre kryesor është të zgjedhim të keqen më të vogël. Argumenti kryesor është se Edi Rama nuk është aq i keq sa Berisha, se PS nuk është si PD, se PS din të qeverisë e me radhë. PS është e keqja më e vogël. Por nuk zgjidhet e keqja më e vogël. Kanceri të zë si pive pesë cigare, si pive tri paketa duhan në ditë. Doktorin nuk të pyet “sa cigare pi”, por

“a pi duhan”. Dhe, siç iu përgjigja dikujt që më bëri të njëjtën pyetje, zgjidhja nuk është të mbështetet e keqja më e vogël. Këtë e do vetëm paria.

Zgjidhja reale është që të ndërrohet sistemi. Ja, ta sqaroj kësht! Një kancer të vret për një javë. Kanceri tjetër të le të jetosh dy javë. Por në javën që ke shtesë jete, do të bjerë tërmet, do të të digjet shtëpia, do të të vdesë nëna dhe do t’i shohësh fëmijët në rrugë të madhe. Në rastin tonë, kjo është e keqja më e vogël. Problemi pra, nuk është me Edin, Saliun, Ilirin, me këtë apo atë individ si individë. Problemi është me sistemin në të cilin këta funksionojnë dhe që e kanë ndërtuar t’iu shërbejë atyre e vetëm atyre. E keqja më e vogël don me thanë me vdekë një javë më vonë. Por vonimi i efektit, nuk është zgjidhja që duhet. Zgjidhja që na duhet është shmangia e shkakut që krijon atë efekt. Problemi është te sistemi që prodhon efekte të tilla.

Zgjidhja

Ashtu si doktori të thotë me një fjalë, “lëre duhanin”, zgjidhja jonë është “të ndërrojmë sistemin”. Prandaj duhet të mbështesim e të zgjedhim njerëz që nuk duan të shërbejnë si vegla e të sillen si derra të zgjedhur për t’u majmur sot e për t’u therur nesër. Shteti me të gjithë sistemet; politike, ekonomike, kulturore, shoqërore duhet të vihet në shërbim të qytetarëve. Po të shkoi ndërmend me pyetë se kush janë njerëzit që do të bëjnë ndryshimin, shih njëherë veten tënde e bëji pyetjen “a due unë me kenë njeri apo derr që të më hanë këta?”. Sepse po mendove që ua ke hedhur në lojën e tyre, e ke gabim. Janë mjeshtra. Disa i ka stërvitur uria e konvikteve. Disa mjerimi i një rinie të shkatërrueme. Disa jetesa në një izolim në Bllok nga populli i vet. Derrin, ngado që të sillet në thark, këta dinë ta mbërthejnë e ta rrjepin të gjallë.

Në mos paç mëshirë për veten, mendo për fëmijët, mendo për nënën, për vajzën, për gruan e për motrën! E në mos mundsh

të mendosh për kend tjetër, mendo për varret e prindërve që të kanë bërë kokën e që së shpejti do t'i mbulojnë plehrat e Italisë, do të t'i shkulin të huajt e s'do të të mbetet as nam, as nishan mbi këtë dhe! Në mos mundsh të mendosh as për këto, unë të kërkoj ndjesë që ta kam ngrënë kohën kot. Ata që do të të hanë, nuk do të ta thonë as lutjen që thuhet kur bëhet kurhani. Sepse nuk thuhet lutje për derrat, sepse derrat nuk i bën kush kurban.

E GJITHË SHQIPËRIA SI LAZARATI ZGJEDHJET DHE BUJQËSIA JONË INDUSTRIALE DIXHITALE E BIMËVE MEDICINALE

Në Gjirokastrë shkoi drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Gjenerali i policisë e kishte hallin te Lazarati. Me zë të plotë dhe të fuqishëm, deklaroi se nxjerrja e Lazaratit nga harta e zezë e prodhimit dhe importimit të drogës, është një ndër objektivat kryesore të Policisë së Shtetit. Aty ai shpalli se asnjë kilogram hashash nuk duhet të dalë jashtë kufirit të vendit tonë. “I kemi fotografuar fushat dhe nuk ka gjë”, tha i bindur gjenerali.

Por “hashishi është në kubik” dhe “policia i ka bërë fotot natën” thonë gojët e liga. Kryeministri e përmendi Lazaratin si bastion të PD - së, një arsye më shumë që nuk mund të këtë gjë të mbjellë aty. Të mos harrojmë se Lazarati është fshat me një të kaluar patriotike e të lavdërueshme; ka arritur të bëjë atë që nuk ka arritur të bëjë asnjë katund apo qytet në shtetin shqiptar. Lazarati është një fshat shumë i zhvilluar, me ekonomi model, i njohur si qendër e prodhimit dhe e përpunimit të bimëve medicinale e me marrëdhënie shoqërore shumë të mira brenda për brenda. Por edhe pse nuk përfillet fare në mediat e Tiranës, Lazarati është në qendër të vëmendjes së shqiptarëve, të politikës që bëhet dhe të interesave të parisë së Tiranës, sepse është një model suksesi ekonomik, politik e shoqëror, një El Dorado moderne shqiptare, një model që ndiqet me vemëndjen e duhur nga të gjithë.

Eldorado moderne shqiptare

Njëra nga qendrat më të rëndësishme industriale dhe të bujqësisë bashkëkohore shqiptare, Lazarati, ka një bujqësi të zhvilluar, me një teknologji moderne të avancuar. Komuna e Lazaratit gjendet në Malin e Gjerë, përbri, vetëm rreth tri kilometra larg qytetit të Gjirokastrës mbushur me të papunë. Lazarati ka një sipërfaqe prej 41 mijë hektarë, ka rreth 700 familje me rreth 6500 - 7000 banorë. Prodhimi i përgjithshëm lazaratas nuk dihet saktësisht. Por dihet se shteti shqiptar dhe shtetet fqinje, si Italia e sidomos Greqia, kapin në vit afërsisht një miliard euro vlerë mall kontrabandë që nuk zhdoganohet nga lazaratasit, të cilët për arsye politike, e konsiderojnë doganën një mjet vjedhje e pasurimi për shtetarët. Kjo shumë parash e mallit të kapur vjen vetëm nga hashishi, sepse heroina e përpunuar që kapet, nuk numërohet.

Si e dimë këtë? Po ja, në gjysmën e parë të vitit 2012, policia ka kapur drogë Lazarati (me famë botërore dhe e preferuar nga hollandezët e nga të tjerët) me peshën 5 000 kilogram, ose pesë ton drogë e destinuar për Itali e Greqi. Një ton hashish në rrugë kur shitet, kushton rreth 93 milionë euro. Pesë ton bëjnë 465 milionë euro vlerë shitjeje në rrugë. Po në një vit? Ja të themi se po kaq kapen edhe në gjysmën e dytë të vitit, edhe pse atëherë bëhet rritja e përpunimi. Pra, nuk është ekzagjerim të thuhet se vlera e hashishit të Lazaratit që kapet nga policia, gjithnjë në vlerën e shitjes rrugëve e Evropës, i kalon 930 milionë eurot në vit. Shto këtu edhe heroinën, sepse policia kapi edhe 50 kilogram heroinë me vlerë shitjeje në rrugë 3 - 4 milionë euro e shumë ngarkesa të tjera, dalim diku te një miliard dollarë mall i sekuestruar nga shteti, domethënë humbje për ekonominë e Lazaratit.

Pra, edhe sikur humbjet të jenë vetëm 50 %, prodhimi i përgjithshëm lazaratas i kalon të paktën dy miliard eurot në vit. Përafërsisht, çdo lazaratas kontribuon me rreth 200 000 euro në ekonominë shqiptare. Në terma formalë, edhe pse nuk

është i regjistruar kund, edhe pse është pjesë e ekonomisë informale, Lazarati kontribuon afërsisht 25 % të gjithë prodhimit kombëtar shqiptar të deklaruar.

Por duke e ditur sesa e korruptuar është policia shqiptare, druhen se përqindja e drogës që kalon kufirin është ku e ku më e lartë. Nga përvoja personale e di që policët shqiptarë të kërkojnë para në dorë edhe për një kundravajtje e nuk besoj se druhen shumë të kërkojnë para për ngarkesa që vlejnë shuma marramendëse. Duke e ditur se ka për të gjithë, duhet vlerësuar me keqardhje se sasia e drogës që kalon kufirin, mund të jetë nja dhjetë herë më shumë se ajo që kapet. Por kjo është një hipotezë që e hedhin dashakeqësit. Të vërtetën e di Lazarati. Ne vetëm po supozojmë se humbja është diku te 50 %.

Në shumë drejtime, prodhimi bujqësor në Lazarat është i nivelit të dëshiruar nga Kryeministri. Arsyeja është se Lazarati është shumë i modernizuar dhe përpunimi i produkteve bujqësore është i dixhitalizuar. Në Lazarat ka 23 laboratorë të përpunimit të bimëve medicinale. Nerëzit jetojnë me standartet më të larta të mundshme, kanë shtëpi e vila që nuk i gjen as në zonat e pushimit të miliardërëve të botës. Vilat e Lazaratit janë blu nga buletat e ujit dhe janë kështjella të vërteta me mure, tela dhe dyer të rënda metalike. Pasuria e familjeve në Lazarat është përrallore.

Por Lazarati është edhe model i liberalizmit dhe bashkëjetesës. Në Lazarat nuk ka nevojë për shtetin, sepse nuk ka krim brenda fshatit. Në Lazarat nuk ka polici. Në Lazarat nuk vjedh njeri. Të gjithë i kanë dyert hapur dhe kush bën faj, gjykohet “fshatçe”, sepse janë të gjithë të lidhur me martesë, krushqi, shoqëri e interesa ekonomike. Në Lazarat nuk ka uri. Në Lazarat nuk ka piramida financiare apo universitete private. Lazarati ka një besim të thellë fetar dhe në vlerat demokratike, sepse shenjti i Lazaratit është “Qytetar Nderi i Lazaratit”, Azem Hajdari. Këtij shenjti lokal lazaratasit i këndojnë një këngë që gjendet në Youtube. Ai ka edhe një shesh me emrin e tij dhe një memorial, që dikush u mundua ta hedhë

në erë, por që u rivendos me dinjitetin e duhur. Azem Hajdari ka shkuar në Lazarat si në shtëpinë e tij, ua ka hapur rrugën e kufirin dhe dashuria e lazaratasve për të është e hapur.

Të gjithë lazaratasit punojnë bashkë, ndajnë detyrat dhe të ardhurat me drejtësi dhe kontribuojnë në mbarëvajtjen e ekonomisë së katundit më të madh e më të pasur të shtetit shqiptar e të botës. Siç tha edhe kryetari i lomunës, Lazarati ka ndërtuar rrugët më të mira dhe ka bërë investime të dukshme, sepse ka ujësjellës, energji, rrugë të shtruara e siguri absolute. Por ka edhe një standard jetese të lakmueshëm. Për shembull, kur shkon te sheshi "Azem Hajdari" të merren mendtë nga markat e makinave. Lazaratasit nuk emigrojnë. Përkundrazi, atje shkojnë emigrantë nga e gjithë Shqipëria; për 2000 lekë të reja, nisen nga sheshi "Omonia" në Gjirokastrë me autobusë dhe punojnë gjithë ditën në fushën e hashishit, një bimë që nga Hollanda, një vend i Bashkimit Evropian, por edhe nga ne, tashmë konsiderohet si medicinale.

Lazarati vizitohet rregullisht nga politikanët e të gjitha niveleve, siç ishte, bie fjala, vizita e Lulzim Bashës, asokohe ministër i Brendshëm. Që nga Lazarati, Basha deklaroi më 24 maj 2010, se kishte shkuar atje së bashku me deputetin e zonës, Prof. Dr. Genc Ruli, për t'i dërguar një mesazh të fortë Evropës, sepse tani e tutje, tha ministri Basha, edhe Evropa do të dëgjojë vetëm gjëra të mira nga Lazarati. Fshati është modern, i dixhitalizuar, i kompletuar, kontribuon shumë në ekonominë kombëtare. Prandaj edhe kryeministri Sali Berisha e përmendi në programin e tij ekonomik si një sukses për vendin.

Por e vërteta është se Lazarati ia ka dhënë fjalën Partisë Demokratike, personalisht kryetarit të saj, Dr. Prof. Sali Berisha, që nuk do të rrisë më hashish, por vetëm sherbelë e çaj mali, deri në zgjedhjet e vitit 2013. Atëherë hashishi që është në kubik bëhet gati për t'u mbjellë dhe Lazarati nuk e shkel fjalën. Po fitoi PD, policia nuk shkel në Lazarat. Po fitoi PS, Lazarati merr armët dhe pushton të gjithë komisariatet e policisë.

Problemi i vogël i Lazaratit

Edhe pse ka 23 laboratorë e punishte të përpunimit të bimëve medicinale, Lazarati ka vetëm një problem të vogël. Aty kultivohen hapur bimë aromatike e mjekësore si qepa, hudhra, spinaqi, çaji i malit e sherbela, por më së shumti kultivohet hashish e kanabis. Problemi i vogël i Lazaratit është se të gjithë zogjtë e minjtë janë të droguar nga “bari”. Në Lazarat nuk ka shumë gjarpërinj e nepërka, sepse pasi hëngrën minjtë e dehur me hashish, ngordhën nëpër vrimat. Ndoshta me Lazaratin në mendje, në dhjetor të vitit të kaluar, kryeministri Sali Berisha foli shumë për bimët aromatike e mjekësore, theksoi rëndësinë e kultivimit e të përpunimit të këtyre bimëve për zonat malore, sepse për shembull, në zonat si Kukësi, 47 % e popullsisë jetojnë me ndihma nga shteti. Ku është dallimi midis Kukësit e Lazaratit? Nuk ka fare dallime, përveçse në pasurinë që kanë. Kukësi është i prapambetur, Lazarati është me bujqësi dixhitale. Pse të mos jetë dhe Kukësi si Lazarati?

Por nga një këndvështrim tjetër, duke qenë se rritja e bimëve aromatike si hashishi apo kanabisi nuk është problem e mund i madh, shqiptarët e tjerë nuk janë budallenj dhe nuk duan të mbesin të varfër. Pse të merren me çaj mali, kur mund të rrisin hashish të cilësisë së lartë? Disa nuk e dinin se ç’ishte hashishi dhe mbollën kërp, po tashti e dinë të gjithë edhe më mirë se agronomët. Kukësi dhe zonat e tjera duhet të marrin shembull nga Lazarati.

Nga ana e vet, edhe pse Sali Berisha premtoi se qeveria do t’i mbështesë “fermerët” me “laboratorët më modernë që iu duhen për të gjitha llojet e certifikatave, për vërtetimin e cilësisë së tyre”, prapë nuk tingëlloi bindës, sepse formalisht ai po fliste për luledetelet, për çajin e malit dhe për sherbelën. Modeli i vetëadministrimit demokratik të Lazaratit, është një shembull shumë tundues për shqiptarët e tjerë. Ky është modeli i zhvillimit nga poshtë. Të vijë një herë laboratory, pastaj shohim e bëjmë se çfarë kërkon ekonomia e tregut.

Jo vetëm kaq. Familjet e shquara e me traditë lazaratase, punojnë e kontribuojnë në shumë fusha; industria ushqimore, te transporti dhe kontrollojnë interesa të mëdha në fusha të caktuara, në zona të tjera të shtetit shqiptar si hotele, biznese e me radhë.

Më në fund, Lazarati ka një traditë kulturore shumë të shënuar, një grup poetësh cilësorë dhe një grup polifonik që është nga më të mirët në shtetin shqiptar. Natyrisht kënga më e famshme është ajo për Azem Hajdarin që e gjeni në Youtube. Influenca e Lazaratit është e thellë edhe në kulturë, sepse fshati ka hyrë edhe në mitologjinë popullore. Kaq sukses ka pasur, sa në dhjetë vjet kanë hyrë të paktën njëzetë fjalë të reja në gjuhën shqipe për të përshkruar hashishin dhe marijuanën. Për shembull, kur flitet për dikë që përsërit fjalët e politikanëve thuhet, “nga Lazarati e merr mallin që tymos ky njeri apo nga ndonjë vend tjetër?” Ka dhe ca shprehje të tjera që nuk po i përmend këtu.

Influenca e Lazaratit

Suksesi është sëmundje ngjitëse. E vërteta është se shembulli i Lazaratit po ndiqet me shpejtësi nga të gjithë katundet që kanë të njëjtën klimë dhe mundësi. Por thelbi i vërtetë i suksesit është që të kesh mbështetjen e shtetit. Dhe në rastin tonë, katunde të tëra që e kanë kuptuar si luhet loja, nuk e kanë pasur shtetin në qendër të vëmendjes, por tashmë e kanë vënë në qendër të vëmendjes. Nëse shteti nuk i mbështet në rritjen dhe legalizimin që duhej ta kishte bërë me kohë, se Tirana qelbet nga drogat, se nuk ka lokal, pub e mejhane ku nuk vjen era e qelbur e drogës, shteti duhet bërë që të mbyllë sytë.

Dhe shteti, që në fund të fundit funksionon sepse ka ca njerëz që punojnë si zyrtarë, bëhet i verbër kur atyre u tunden në sy shukat me para. Zyrtarët duan të çojnë fëmijët në shkolla jashtë shtetit, duan të shkojnë me pushime, duan të kenë dashnore, të blejnë makina e shtëpi dhe të mbajnë vjeh-

rrrën në azilin e pleqve. Me rrogën e shtetit do t'i bëjnë këto? Zyrtarët duan të kenë jetën e lazaratasve. Dhe zgjidhja që ne kemi gjetur është të bëjmë atë që nuk e ka bërë kush tjetër. Çdo katund ka në shtet përfaqësuesin e vet që mbron interesat e katundit në furumin përkatës. Ne kemi bërë edhe një gjë që nuk e bën njeri. I kemi marrë kultivuesit e drogës dhe trafikantët dhe ... iu kemi lënë në dorë shtetin. Arsyeya është se ky shtet është shteti i popullit dhe kush më mirë e njuh popullin, se ata që dalin nga shtresat që kanë provuar burgjet e vendit e burgjet e huaja? Askush! Kush më mirë e kap hajdutin, se ai që është vetë mjeshtër me vjedhë? Askush! Kush e gjen vrasësin më lehtë se krimineli? Askush! Kush më mirë e njuh kodoshin se vet kodoshi? Askush! Prandaj zgjidhje që kemi gjetur ne është ideale. Lisi çahet me pykën e vet dhe prandaj ne në krye të shtetit kemi vënë përfaqësuesit e bandave e trusteeve të krimit. Ajo që nuk parashikuam siç duhet, ishte se këta nuk kanë bërë kthesë, por po punojnë bashkë me shokët e rrugës, të semaforit, të burgut e të krimit.

Politikanët për Lazaratin

Nëse kemi para syve modelin e suksesshëm të bujqësisë dixhitale industriale shqiptare, pra Lazaratin, duhet të mos harrojmë edhe kontributin e politikës dhe të politikanëve. Heshtja e politikanëve nuk është e justifikueshme. Asnjëri prej tyre nuk e përmend Lazaratin. Por ne duhet të vlerësojmë këtë qendër zhvillimi, sepse sukseset meritojnë vëmendje dhe fenomeni i Lazaratit meriton më shumë vëmendje edhe në këto zgjedhje. Lazarati është modeli i suksesit dhe për shumë shqiptarë është edhe modeli i së ardhmes që po imitohet me shpejtësi. Lazarati është ndoshta i vetmi fshat që ka arritur të rrisë rendimentin 300 %. Para ca vitesh morën një farë që mbillet në klimën e Malit të Gjerë dhe tashti nuk rritet më kaçube. Bëhet pemë dhe në vend të një kilogrami, jep tre kilogram.

Lazarati ka edhe lidhje të tjera me politikën. Ka një shenjt të vetin, një politikan të shquar, “Qytetar Nderi i Lazaratit”, Azem Hajdarin. Ky Hajdari ka qenë njëri ndër ata që ia hapën rrugën e zhvillimit dhe të modernizimit këtij fshati, duke e bërë pjesë të ekonomisë botërore dhe Lazarati nuk ia harron kontributet. E sa për politikanët e tjerë, ata nuk flasin ngaqë janë modestë. Tashti që jemi ekonomia me rritjen e dytë në botë, siç tha Kryeministri, pas Brazilit e para Kinës, është turp me iu tregue gjermanëve e francezëve sukseset tona në rritjen 300 % të rendimentit të pemës së hashishit, sepse do të ndiehen të turpëruar. Lëre më po iu treguam gjermanëve që punojnë nga 10 orë në ditë e që mezi i paguajnë faturat e mua-jit, se ka një fshat si Lazarati ku vendasit nuk punojnë shumë. Atëherë nuk kemi më fytyrë të lypim ndihma e borxhe si shtet. Vetëm për këtë arsye nuk e përmendin, jo për tjetër. E natyrisht, Sali Berisha nuk shkon dot në Lazarat dhe në Tropojë, por dihet se ai i ka të dy zonat në zemër.

Nga modestia, paria e Tiranës po e rrethon Lazaratin me heshtje. Gjatë tetë viteve të shkuara, Sali Berisha nuk e preku fare Lazaratin, nuk e përmendi Lazaratin, nuk iu afrua Lazaratit. Më e shumta që bëri drejtori i përgjithshëm i policisë, ishte të deklaronte javën e kaluar se tashmë i kishin bërë fotografimet e zonës nga lart e me kujdesin e duhur. Për këtë politikan, parulla duhet të jetë: “E gjithë Shqipëria si Lazarati!”, për shembujt e mirë nuk duhet folur.

Nga ana e vet, Edi Rama nuk duhet të shkojë në Maqellarë, por në Lazarat dhe atje të parashtrojë programin e tij për Rilindjen. Sepse edhe Lazarati e don Rilindjen dhe PS - së i duhet një Rilindje për Lazaratin. E sa për Ilir Metën që e ndërroi kauzën e integritimit në të punësimit, Lazarati duhej të ishte modeli i zhvillimit edhe për Skraparin e për Mokrën, për Gorën e për Gramshin. Një fshat si Lazarati mban me bukë një qytet si Gjirokastra e jo vetëm lagjen “Zinxhira”. Se ata autobusët që sjellin mëditësit nga Gjirokastra për të punuar në Lazarat me 20 mijë lekë në ditë, janë për prodhuesit e për

kontribuesit e vërtetë të integritit tonë në Evropë. Lazarati është modeli i katundit të suksesshëm modern shqiptar që ka pushtuar qytetin. Modeli i Rilindjes do të përkryhet, po të silllemi të gjithë si lazaratasi.

Një krahasim mitesh

Më në fund, duhet bërë një krahasim. Mirëbërësi më i madh në Kolumbi ka qenë Pablo Escobar Gaviria. Në një vend, Los Chaunces, janë 500 shtëpitë që ai ndërtoi për të varfërit. Në atë zonë edhe sot ai njihet si “El Benefactor,” domethënë si “mirëbërësi”. Këta njerëz i janë besnikë Escobar Gavirias edhe shumë vjet pas vdekjes. Miti i tij është i paprekshëm dhe njerëzit i falen edhe sot, sepse ai iu dha strehë, iu dha një kafshatë bukë dhe mundësinë për të rritur fëmijët. Por këta janë të uriturit e të varfërit, ata që nuk e ngopin kurrë barkun, sado që të hanë, sepse uria e tyre s’ka fund e nuk ngopet mendja. Këta janë vëllezërit e motrat e mushkave të drogës, familjarët e vrasësve, e rritësve të drogës, e përpunuesve dhe të ushtarëve të krimit. Këta ishin fëmijë dhe që në atë kohë, në mendjen e tyre Escobar ishte heroi dhe modeli. Shteti i Kolumbisë e vrau Pablo Escobar, por nuk e fshiu dot nga mendja e këtyre fëmijëve modelin e tij të suksesit, të pasurimit, të arritjes në majë me drogë e krim. Sepse mund të djegësh fusha të tëra me *coca*, por a e djeg dot *coca* dhe paratë që ajo sjell, në mendjen e njerëzve? Prandaj edhe lufta e shtetit të Kolumbias është një luftë e pambyllur, sepse është e humbur, nuk mund të fitohet kurrë.

Ne si shqiptarë nuk kemi një Pablo Escobar që ta mitizojmë. Por Lazarati e ka Pablo Escobar Gavirian që e bëri këtë të mundshme. Lazarati e ka shenjtin e vet, Azem Hajdarin. Ky është qytetar nderi i katundit më të pasur në botë. Ky është heroi i Lazaratit, i cili nga memoriali i tij, po të kishte sy e mend e të mund të rrotullonte kokën, do të shihte me krenari përparimin dhe begatinë që ai ndihmoi t’u vinte lazaratasve.

Por edhe pse ai nuk i sheh dot lazaratasit, sepse tani po fle gjumin e thellë e të merituar, lazaratasit e shohin atë përditë në sheshin “Azem Hajdari”.

E kështu Lazarati është modeli ynë i së ardhmes, modeli ynë i zhvillimit të një bujqësie industriale, dixhitale... Sepse kjo është një fushë ku mund të bësh 100 000 euro në vit të ardhura, duke mbledhur gjethet e dushkut, të sherbelës, çajin e malit dhe luledelet. E natyrisht, duke mbjellë pemët e hashishit e kanabisin që e kanë rendimentin 300 %, si askund tjetër në botë.

ZGJEDHJET DHE VOTUESIT RINIA, E DREJTA E VOTËS DHE PËRGJEGJËSA QYTETARE

Fushata elektorale në shtetin shqiptar është në zhvillim të plotë. Dhe njëri ndër problemet kryesore që u ngritën këto ditë, është problemi i të drejtës së votimit për qytetarët. Si zakonisht kryeministri Sali Berisha hodhi një shashkë mediatike, domethënë hodhi tezën se e drejta e votës në shtetin shqiptar duhet të ulet nga mosha 18 vjeç, në moshën 16 vjeç. Por edhe pse u përkrah me zhurmë nga Ilir Meta që e përdori këtë rast për t'u treguar një pjesëtar besnik i koalicionit dhe kjo lloj mbështetjeje nuk i kushtonte asgjë, kjo inisiativë nuk ka shanse të shkojë kund. Nga ana e vet, opozita e kundërshtoi me vendosmërinë e pritshme.

E megjithatë, u bë një takim midis dy kryetarëve të grupit parlamentar. Shefi i dikurshëm, Gramoz Ruçi, e shihte ish - informatorin Astrit Patozi, që ka ecur përpara në jetë duke u bërë zv. kryetar i një instrumenti politik dhe kryetar i grupit të mbushur me kolegë, me një nënqeshje të kuptueshme. Por dihej që pa filluar të pinin shishet e ujit prodhuar nga një biznes grek, se nuk do të binin dakord. Kështu që pas një zhurme të madhe mediatike, u pa se kjo inisiativë nuk do të shkojë kund.

Megjithatë edhe pse u shtrydh për tri ditë nga politikanët, kjo temë vazhdon të tërheqë vëmendjen e shtypit dhe të mediave në përgjithësi. A duhet të votojnë 16 vjeçarët? Kjo është

një temë që politikanët do të vazhdojnë ta diskutojnë kur të mos kenë çfarë të thonë. Sepse ka vende ku edhe 16 vjeçarët votojnë. Në shumicën e këtyre vendeve, mosha e votës është zakonisht mosha kur lejohet martesë, punësimi, pirja e alkolit dhe kur fëmijët konsiderohen të pjekur e të përgjegjshëm për të marrë vendime si të rritur.

Në shtetin shqiptar këto kritere janë të gjitha problematike. Sepse kur vjen kriteri i punësimit, të rinjtë tanë janë masivisht të papunë. INSTAT deklaroi në rubrikën “a e dini se” që 44.3% e të rinjve deri në moshën 16 vjeç janë të punësuar, por kjo shifër është shumë e dyshimtë, sepse ka shumë më shumë. Sikur të jetë e vërtetë, do të jetë edhe më keq. Megjithatë shumë nga të rinjtë shqiptarë i përmbushin tre kriteret e tjera.

Problemi ynë kryesor nuk është votimi dhe e drejta e votës, por sjellja dhe morali i rinisë sonë. Morali i rinisë sonë le shumë për të dëshëruar. Sepse rinia jonë është në gjendje kritike dhe askush nuk po i kushton vëmendjen e duhur. Shumë të rinj i fillojnë hallet e qejfet e martesës në forma të tjera, shumë herët. Edhe pse ligji i dënon me shtatë vjet burg ata që kryejnë marrëdhënie seksuale me fëmijë deri në moshën 18 vjeç, ja si e përshkruan një artikull gazete gjendjen në gjimnazet e Tiranës:

“Një pjesë e tyre kryejnë marrëdhënie seksuale që në vitin e parë. Në maturë seksi nuk është tabu thuajse për të gjithë. Adolehentët nuk e kanë problem të tregojnë përvojat. Sipas Institutit të Shëndetit Publik, në gjashtë vitet e fundit sensibilizimi për përdorimin e metodave kontraceptive është rritur ndjeshëm. Megjithatë mbetet i lartë numri i gjimnazistëve që bëjnë seks të pambrojtur. Ka rezultuar se mbi 75 % e gjimnazistëve që kryejnë marrëdhënie seksuale përdorin prezervativë. Në studimin e vitit 2005 shifrat ishin rreth 61 %”. Në lidhje me përqindjet e gjimnazistëve që bëjnë seks, vlerësohet se 80 - 90 % e të rinjve deri në vitin e tretë janë të lidhur, kanë të dashur dhe kanë pasur më shumë se një përvojë”.¹

Droga, alkoli dhe cigaret iu shiten të gjithë fëmijëve që mund të hedhin tre hapa pa u rrëzuar dhe të gjithë adoleshentët janë ekspertë në këtë lëmi. Jo vetëm që lokalet shesin alkool, por në banjat e pubeve kanë vënë edhe kuti ku mund të marrësh prezervativë. Disa nga lokalet e Tiranës kanë edhe dhoma të posaçme ku bëhet seks e natyrisht të rinjtë filmohen, por kush pyet? Ja një përshkrim i marrë nga një artikull që nuk ngjalli asnjë diskutim në shtyp:

“Sipas tyre në disa pub-e, kanë krijuar ambiente të veçanta, një dhomë apo një kthinë që të rinjtë mund ta përdorin për të bërë seks. Mjafton të kesh muhabet me menaxherin dhe e zgjidh direkt, thotë një djalë në vit të tretë. Po të dish ta kërkosh pak me stil, në shumë pub-e gjen një cep për atë punë, tregon duke qeshur një tjetër. Përgjatë bisedave të rinjtë qeshin me habinë tonë dhe njëherësh habiten që ne nuk ditkemi akoma për këto vende. Për ta është normale dhe s’ka asgjë të keqe”.

Pyetja e parë që të vjen ndërmend është: ku është shteti? Ku janë politikanët? Ku është shoqëria civile? Askund!

Një nga dukuritë më të frikshme është edhe konsumi masiv i drogës. Në Tiranë ka rreth 60 000 konsumatorë të njohur e kushedi sesa konsumatorë të panjohur. Ja si bëhet shpërndarja e drogës në Tiranë, sipas një përshkrimi tronditës të bërë nga Arjola Tafaj në blogun e saj:

“Droga shpërndahet nga vetë ata që e konsumojnë. Mbahet në qese të vogla, mbështjellë me letra apo në paketa bosh cigaresh, bashkë me fletët që përdorin për ta dredhur. Një cigare hashash e gjen nëpër shkolla edhe me njëmijë lekë të vjetra, ndërsa një “treshkë” (siç e quajnë “mallistët” me gjuhën e tyre cigaren që del si kaush nga bashkimi i tri fletëve dhe që më pas mbushen me duhan të përzier me hashash, sipas dëshirës), kushton nga dy, deri në pesë mijë lekë, sipas cilësisë dhe miqësisë. Po kaq të përhapura dhe të preferuara kanë nisur të bëhen kokrrat e extasy-t (ekstazi) të cilat pas pirjes nga goja, të krijojnë një efekt të përngjashëm me të qënurit i dehur apo droguar, që mund të zgjasë disa orë, në varësi të dozës, llojit të saj dhe organizmit të konsumuesit. Ato kushtojnë tetë mijë lekë secila, shitësit i mbajnë brenda

disa tubetash dhe një tub i gjatë ka rreth 8 - 10 kokrra ekstazi. Kemi të dhëna që ekstazi po përhapet me shpejtësi, thuajse në të gjitha gjimnazet dhe ambientet e tjera të thuajse në të gjitha gjimnazet dhe ambientet e tjera të rinjve në Tiranë”.

Në lidhje me përgjegjësinë familjare, sipas INSTAT, shpesh fëmijët tanë, që në një moshë të njomë mbajnë me bukë prindërit e tyre. Shumica pra, janë të ndrydhur nga hallet e jetës, por ata e duan normalitetin e një jete sa më normale dhe i kthehen fesë. Ikja nga zvetënimi e zdërrhallja që i rrethon, po bëhet shumë e dukshme në shumë rrethe të shoqërisë.

E megjithatë, kultura që kanë fituar këta të rinj është kultura e rrugës. Një shembull shumë ilustrues është edhe marrëdhënia e tyre me shtetin e me mendësinë e rrugës. Ja si flitet për gjimnazistët dhe votuesit e ardhshëm që tashmë rriten si gangsterë e rrugaçë:

“Thika dhe armë të sajuara të ftohta, gjen me shumicë. Disa nga ata që i mbajnë, janë kthyer dhe në mjeshtra të thikave... Bëjnë numra cirku me to në klasë, ishte njëra nga dëshmitë. Më e përhapura është një tip thike, e quajtur “flutur” (quhet kështu, sepse ka dy bishta dhe në mes një teh të mprehtë). Në gjimnazet “Asim Vokshi”, “Besnik Sykja” e “Petro Nini Luarasi”, ka armë të tilla me shumicë brenda shkollës. Nuk mungojnë dëshmitë e reklamimit të thikave edhe në sy të mësuesve. Teksa interesohemi për vendin ku adoleshentët gjejnë thikat, ata tregojnë se ka plot, duke nisur që nga “Tregu çam”, ashtu dhe në tregun e madh te spitali. Çmimet për këto thika variojnë, nga 5 - 30 mijë lekë të vjetra”.

Megjithatë duhet mbajtur mend se vota është për të zgjedhur qeveritarët. Mendësia e të rinjve në lidhje me votën e tyre dhe se si do ta përdorin këtë të drejtë, shihet në lidhjen që kanë me shtetin. Në këtë moshë, kjo lidhje tek ata vjen përmes mësuesit dhe policit. Mësuesi merret më rininë në shkollë, polici është shteti për ta në rrugë. Për mësuesin fola me lart, por ja se si i trajtojnë ata policët dhe shtetin:

“Policët e rendit që rrinë pranë dyerve të shkollave të mesme, sipas nxënësve që kemi pyetur, tashmë e kanë marrë etiketën: janë dordolecë. Të paktën rojet bëjnë ndonjë punë, nuk lejojnë të huajt të hyjnë brenda në korridore, por policët rrinë kot më kot, është njëra nga dëshmitë”.

E drejta e votës nuk ka lidhje me pjekurinë e rinisë sonë. Por në këto kushte rrëmuje ideologjike, e kaq afër zgjedhjeve, kjo përpjekje për t’iu dhënë të rinjve të drejtën e votës, është një lëvizje e zgjuar e prijatarëve të parisë së Tiranës. Zhurma që e rrethon dhe që e mban gjallë këtë debat është një përpjekje e djallëzuar për të shmangur vëmendjen e rinisë dhe të shoqërisë nga interesat e vërteta politike, si dhe nga problematika e ngjeshur me të cilën po përballlet shoqëria dhe shteti shqiptar në këtë pikë tjetër kritike. Gama e problemeve ekonomike dhe shoqërore më të cilat përballemi është marramendëse dhe thellësia e krizës po bëhet më e dukshme përditë. Duke parë këto probleme, diskutimi i të drejtës së votës për gjashtëmbëdhjetë vjeçarët, është në fund të listës, është dhe shumë i rrezikshëm. A mund t’i jepet fëmijës një armë e mbushur në dorë? Vota vret më shumë se plumbi.

Nga ana tjetër, ky debat duhet zgjeruar e duhet zhvilluar siç duhet. Kjo është një temë me interes të jashtëzakonshëm për shoqërinë e për strukturat zgjedhore e demokratike të saj. Arsyeja është se kjo temë duhet të shërbejë si një fillim debati për natyrën e vet demokracisë në shtetin shqiptar. Me dështimin e përplotë të sistemit demokratik, të partive politike, me vjedhjen masive të votës e me fenomenin e shitjes së votës për një gjel deti apo për një thes mielli, nuk është më vetëm problemi i 16 - vjeçarëve nëse mund të votojnë apo jo.

Problemi kryesor me të cilin po përballemi të gjithë, është pikërisht një problem që nuk trajtohet si duhet. E drejta e votës nuk është vetëm e drejtë, por është edhe detyrim qytetar. Që e drejta e votës nuk është vetëm detyrim qytetar, por është edhe përgjegjësi kombëtare. Kush duhet të ketë të drejtën dhe përgjegjësinë e votës dhe si duhet ta përdorë atë votë? Cili

është konceptimi i qytetarit në shoqërinë shqiptare? Si duhet të sillet votuesi? Si duhet të jepet e drejta e votës? Këto nuk janë tema që debatohen siç duhet, por që duhen debatuar me seriozitetin e duhur. E mbi të gjitha, duhet debatuar sjellja dhe morali i rinisë së sotme, si baza për të formësuar qytetarin e ardhshëm në një shoqëri demokratike e kombëtare.

Prandaj nuk duhet të biem në vorbullën e lojës së parisë së Tiranës që kërkon vetëm të rekrutojë të rinjtë në marrëzinë e ligësinë e lojës së saj politike. Paria e Tiranës i ka fituar edhe këto zgjedhje, anipse do të fillojnë sherrin për kockat qysh pa mbaruar zgjedhjet. Por ne duhet të merremi me sistemin dhe me themelet e atij sistemi për dy arsye. Një, sepse jeta nuk mbaron me këto zgjedhje. Dhe dy, se demokracia nuk po funksionon. E drejta e votës në përgjithësi është një temë që ne duhet ta diskutojmë me qetësi dhe pa militantizmin e paanshmërinë e zakonshme që shfaqet në media e në jetën publike. Nëse rinia jonë është në këtë gjendje, për çfarë mund të votojnë këta të rinj? Cilin nga politikanët do të zgjedhin këta? Si do ta përdorin votën? Nga ky këndvështrim e me këto përvoja, e ardhmja jonë, e rinisë tonë dhe e demokracisë shqiptare, duket e pashpresë. Prandaj Edi Rama u bë shumë i suksesshëm me rininë kur tha se kur ishte 16 vjeç kalonte nga një orë në ditë në bunker. Të “turpshmit” e brezit të vjetër si Sali Berisha dhe Gramoz Ruçi nuk flasin. Kjo vlen edhe për më “modestët” si Arben Imami, Edmond Haxhinasto dhe Eduard Selami. I vetmi politikan që ka qenë model rinie, por që e prishi pak më vonë, sepse i dhanë shumë vodka e viski vendi në burg, ishte Fatos Nano. Me këto modele nuk ka të ardhme.

Por tashmë janë afruar zgjedhjet, kjo është rinia jonë dhe problemi i vërtetë nuk është e drejta e votës, por morali dhe sjellja e rinisë. Ne jemi në një krizë të thellë, sepse ka dalë djalli nga shishja dhe një zot e di a mund të bëhen njerëz të përgjegjshëm e qytetarë të rregullt këta të rinj që po rriten kështu, në “parajsën” e Tiranës ku këndohet “Mamica” dhe kënga më e preferuar është një qarje tallavaje, pasuar nga

kënga e papërsëritshme e anëtares së Këshillit Kombëtar të PD - së, Çiljeta Xhilaga, “O sa i kam... gungat e mira”. Çfarë rinie po rrisim, çfarë brezash do të vijnë dhe a do të shpëtojmë apo do të përfundojmë në humnerën e veseve e të horrlëkut moral, ky është debati i vërtetë.

<http://www.panorama.com.al/2012/01/09/reportazh-gjimmazet-e-nates-makina-luksi-e-prinder-pas-kangjellave/#ixzz2OMLÇhsq>

² <http://arjolatafaj.ëordpress.com/2012/02/22/droga/>

³ <http://arjolatafaj.ëordpress.com/2012/02/22/droga/>

ZGJEDHJET DHE VOTUESIT, E DREJTA E VOTËS - II

A ka të drejtë gjithkush të votojë? Në shtetin shqiptar kanë të drejtë vote të gjithë të rriturit mbi moshën 18 vjeç. Siç thotë edhe një vendim i Gjykatës Kushtetuese:

“Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në Nenin 45, parashikon “të drejtën e çdo individi mbi tetëmbëdhjetë vjeç të zgjedhë e të zgjidhet. Përjashtim bëjnë personat të cilëve iu është hequr kjo e drejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë për paaftësi mendore. Gjithashtu, paragrafi 3 i këtij neni parashikon se të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë, kanë vetëm të drejtën për të zgjedhur”.¹

Por argumenti që vijon e që thotë se:

“Ky parashikim kushtetues është brenda standarteve demokratike dhe bashkëkohore” nuk qëndron dhe duhet të rishikohet. Në shumë drejtime, ne jemi një rast i veçantë edhe në botë. Arsyeja më kryesore është se një nga parimet e zbatuara gjatë tranzicionit, ka qenë e drejta e votës për të gjithë shtetasit dhe te ne është abuzuar në mënyrë ekstreme me këtë të drejtë. Ky qëndrim i Gjykatës Kushtetuese ka mbështetje institucionale dhe është i bazuar mbi justifikime historike e ideologjike. Por e drejta e votës nuk është e drejtë, po edhe privilegj, edhe përgjegjësi qytetare, prandaj duhet rishikuar edhe nga ky këndvështrim. Kështu veprojnë shumë vende të botës,

përfshirë edhe SHBA. Numri i frikshëm i njerëzve me precedentë penalë në shtetin shqiptar e jashtë vendit që e gëzojnë këtë të drejtë dhe këtë përgjegjësi të madhe, e bën urgjent dhe imperativ rishikimin e të drejtës së votës.

Vështrimi në të shkuarën, do të ishte i dobishëm për t'i vënë proceset në kontest. Nuk është rastësi që një nga trashëgimitë e sistemit që lamë pas ishte edhe e drejta e njohur formalisht e votës për gjithkënd. Nuk kishte rëndësi a kishe vjedhur, vrarë, rrahur, apo në ishe pedofil, kulak, armik, i burgosur etj. Nëse nuk ishe në ndonjërin nga strukturat e "riedukimit" apo nëse e drejta e votës nuk të ishte hequr me ligj, duhej të votoje. Në sistemin e mëparshëm, votimi nuk ishte vetëm e drejtë, formalisht ishte edhe detyrë qytetare. Po të mos ishe i dënuar, konsideroheshe i "riedukuar" dhe me lirinë qytetare të ktheheshin edhe të drejtat qytetare, ndër to edhe e drejta e votimit. Nëse të hiqeshin të drejtat qytetare, të hiqej edhe e drejta e votimit. Në terma ligjore, sistemi ishte krejt modern.

Por motivi i sistemit të mëparshëm në mbledhjen e votave në mbështetje të vet ishte i mbrapshtë dhe demokracia popullore ishte një farsë. Sistemi kërkonte legjitimitet dhe prandaj të gjithë duhej të votonin kur iu thuhej dhe duhej të votonin ashtu si iu kërkohet. Kështu zgjedhjet mbaronin me 100% të votave të hedhura për kandidatët e Frontit Demokratik. Legjitimiteti i sistemit garantohej me "vullnetin e popullit". Vota ishte e rëndësishme, por ishte e dhunuar dhe e marrë me terror. Prandaj edhe sistemi i "demokracisë popullore" ishte thelbësisht i padrejtë, dhunues, pa legjitimitet dhe u shemb me goditjen më të parë. Forma dhe parimet e votimit ishin krejt moderne, por zbatimi ishte krejt terrorist. Më kujtohet një rast. Dikush që e merrte votën e vet seriozisht u fsheh në kanal deri në ora 18:00, vetëm e vetëm se nuk donte që sistemi t'i merrte votën me vullnetin e tij të lirë. Ky qytetar e mori votën kaq seriozisht dhe rrezikoi lirinë e jetën, edhe pse vota e tij nuk kishte asnjë vlerë për sistemin.

Pyetja është pse nuk duhet të diskutojmë për këtë çështje

tani kur jemi në një sistem demokratik, por krejtësisht të paqëndrueshëm dhe kur vota është më me peshë se kurrë?

Po ashtu e drejta e votës iu dha gjithkujt për motive ideologjike, pas vitit 1991. Gjithkush e gabimisht, konsiderohej si qytetar me të drejta të barabarta. Mund të mos zgjidheshe, por të drejtën e votës e kishe dhe e ushtroje. Ideja ishte se ideologjia liberaliste kishte triumfuar, edhe pse në shtetin shqiptar nuk dihej se çfarë ishte liberalizmi as ndër njerëzit e edukuar. Në shtetin shqiptar liberalizmi ngatërrohej me superstrukturën e kapitalizmit, ashtu siç kuptohej nga inteligjencia jonë në atë pikë të historisë. Kushtetuta e vitit 1998, e rishikuar më vonë, u bë më shumë nga të huajt që e trajtuan shtetin shqiptar si një kavie eksperimentale për ideologjitë e tyre.

Përgjithësisht me ndërrimin e sistemit, nuk u bë asnjëfarë diskriminimi pozitiv dhe gjithkush e fitoi të drejtën e votës. Kështu nga viti 1992 e pas, ka votuar gjithëkush, përfshirë këtu edhe hajnat e xhepave, rrugaçët, banditët, vrasësit, kriminelët, trafikantët e me radhë. Kjo ka vazhduar e vazhdon deri në ditët e sotme. Ka edhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2005, që iu njeht të drejtën e votës të gjithë të burgosurve. Një ndjenjë faji kolektiv për të shkuarën i paralizoi institucionet e shtetit. Zyrtarët që hoqën dorë nga zbatimi i ligjit, filluan të respektonin edhe hajnat e kriminelët, pikërisht njerëzit e jetës së nëndheshme, të cilët jo vetëm që votuan, por hynë dhe u bënë shumë aktivë e udhëheqës në jetën politike. Kjo u pa në momentet kritike të vitit 1997, kur banda me nga dhjetë vetë vendosnin se kush do bëhej deputet në qytete me njëqindmijë vetë si Vlora, Durrësi, Lushnja apo Elbasani.

Shembujt e këtyre të burgosurve të gjithfarlojshëm që u përfshinë aktivisht në politikë, shkojnë që nga Pjetër Arbnoori, kryetari i Kuvendit Popullor që kishte bërë njëzetë e tetë vjet burg dhe që sipas Dom Simon Jubanit kishte qenë “spion birucash”, te një numër i konsiderueshëm të përjashtuarish nga partia (PPSH) për vjedhje, për shpërdorim posti apo për kurvërim. Më kujtohet një ish - oficer sigurimi i përjashtuar

për kurvërim e shpërdorim detyre që dikur punonte me mua. Në vitin 1993, mora vesh se ishte bërë kolonel dhe ishte rehabilituar deri në atë pikë, sa që po luante një rol të madh në shërbimet e fshehta të shtetit shqiptar. Hajnat, pushtët dhe kodoshët mbushën sistemin. Të burgosurit ordinerë që nuk ia kishin idenë strukturës, përveçse si strukturë dhune, u veshën oficerë. Ishin aq injorantë, sa në fillim shumica donin të bëheshin kapitenë të parë e jo majorë, sepse kapiteni kishte katër yje e majori vetëm një yll në spaleta. Dhe të mendosh se e drejta e votës ishte emëruesi i përbashkët që qëndronte në themelet e shoqërisë së re!...

Por e drejta e gjithkujt për të votuar ka ngelur si një dregëz dhe është kthyer në parimin kryesor të funksionimit të sistemit në shtetin shqiptar, duke penguar e duke mos i lejuar funksionimin si duhet. Gjithkush që është në një moshë të caktuar, ka të drejtën të votojë. Problemi është se përmes së drejtës së votës, anipse jo vetëm përmes saj, sistemi është i kapur nga figurat e krimit. Njerëz të arrestuar, të dënuar, të kërkuar, të inkriminuar, trafikantë, drogaxhinj, kodoshë, hajna, cuba, pedofilë, nekrofilë, zoofilë, me dosje apo pa dosje, e kishin të drejtën e votës dhe e përdorën të drejtën e votës si deshën, më pasojat që dihen e që shihen.

E kjo gjendje vazhdon. Në burgjet tona aktualisht ka rreth 15 000 vetë. Sa kanë bërë burgje e jetojnë në shtetin shqiptar? Unë nuk i kam numrat, por mendoj se zakonisht numri duhet të jetë të paktën pesë - gjashtë fish më i lartë. Kjo përkthehet kështu: të burgosurit në burgjet e tanishme, kanë aq vota sa të zgjedhin dy deputetë, një me siguri të lartë si në Peqin, ku gjendet burgu i sigurisë së lartë dhe padyshim të influencojnë në zgjedhjen e deputetit në Zejmen. Në burgjet e huaja janë rreth 20 000 shqiptarë të tjerë që i kanë emrat në lista dhe dhjetramijë të tjerë që kanë kaluar në sistemet e drejtësisë së vendeve të ndryshme. Vetëm tri ditë më parë, Greqia dhe BE nisi një listë me 75 000 shqiptarë të padëshërueshëm për ta. Kur llogariten edhe të kthyerit nga shtetet e tjera që kanë

bërë burgje, që janë kapur në akte kriminale, që kanë dosje e precedentë penalë, që nga ushtrimi i prostitucionit, te shitja e drogës, vrasjet e therjet, që kërkohen nga policinë e shteteve të ndryshme të botës, na del se një përqindje shumë e madhe e llumit të shoqërisë, vendos se kush qeveris në shtetin shqiptar. Një fshat si Lazarati e zgjedh një deputet. Një bandë me dhjetë vetë në Lushnjë i zgjidhte dhe i kontrollonte të gjithë deputetët. Një bandë në Durrës kontrollonte listat. Të burgosurit në Peqin zgjedhin një deputet. Në Zejmen influencojnë zgjedhjet. E kështu me radhë.

Shteti duhet të vendosë dënime shumë të rënda për njerëzit që janë me precedentë penalë dhe synojnë të ndikojnë, në një formë a në një tjetër, mbi procesin zgjedhor. Por hapi i parë është heqja e të drejtës së votimit dregëzave të shoqërisë, mbajtja e tyre larg nga partitë politike e nga procesi zgjedhor, si dhe izolimi i tyre nga proceset vendimmarrëse. Demokracia nuk është sundim i turmës. Demokracia është një mënyrë e zgjedhjes së njerëzve që duhet të drejtojnë anijen e shtetit e të kombit për një periudhë të caktuar, duke zbatuar vullnetin e qytetarëve që e kuptojnë përgjegjësinë që kanë dhe sillen si qytetarë e bashkëkombas të përgjegjshëm.

Duke e parë gjendjen kritike ku jemi, si dhe kapjen e shtetit e përdorimin masiv të botës së nëndheshme për qëllime të tilla politike, ka ardhur koha për të rishikuar të drejtën e votimit. Njerëzit me precedentë penalë nuk duhet të kenë të drejtën e votës. Le të riedukohen, por jo të lejohen të zgjedhin drejtuesit e shtetit në çfarëdo niveli. Humbja e të drejtave qytetare për ata që kanë bërë krime, është një çmim që shoqëria duhet ta paguajë e ta institucionalizojë. E drejta e votës është shumë e rëndësishme. Por si thika me dy presa, edhe e drejta e votës është problematike. Arma që qytetarët kanë për të vrarë të keqen është vota. Te ne vota është arma e së keqes për të vrarë shtetin. Dhe shteti e ka detyrim ta konsiderojë njohjen e së drejtës së votës si detyrë, përgjegjësi qytetare e privilegj shumë të rëndësishëm.

ZGJEDHJET DHE VOTUESIT, PËRSIATJE MBI KONCEPTIN E QYTETARIT - III

Njëri ndër debatet e munguar në shtetin shqiptar është ai lidhur me qytetarinë. Kush është qytetar në shtetin shqiptar dhe si duhet të sillet ai? Cilat janë të drejtat dhe detyrat e tij? Cila është lidhja e qytetarit me shtetin, lidhja që ka qytetari me sistemet ekonomike, politike, shoqërore e kulturore? Cila është lidhja që ka qytetari me familjen? Më në fund, por jo më e fundit, cila është lidhja që ka qytetari me kombin? Të gjitha këto pyetje nuk janë të shkëputura nga njëra - tjetra. Ato janë vetëm këndvështrime të ndryshme të të njëjtit problem.

Problemi i konceptimit të qytetarit është një nga më kryesorët me të cilët përballen kombet e ndodhur në një pikë kritike, veçanërisht në shqiptarët. Megjithatë edhe në këto zgjedhje, ky është një nga problemet që po anashkalohen e që nuk trajtohen si duhet. Në “rrahjen” formale publike të prijatarëve oligarkë të parisë së Tiranës mungon substanca. Të kishte pak substancë, njëra ndër temat më kryesore duhej të ishte debati mbi qytetarinë. Por oligarkët e Tiranës e kanë mendjen të ruajtja e pasurisë së tyre dhe jo të ruajtja dhe kultivimi i vlerave të vërteta që iu shërbejnë shqiptarëve.

Në këtë pikë është e qartë se shteti shqiptar sundohet nga një grusht familjesh kriminale e klanesh të fuqizuara ekonomikisht e politikisht që i kanë ndërtuar marrëdhëniet shoqërore në mënyrën që iu shërben atyre më së miri. Parisë së Tiranës dhe klaneve sunduese mafioze iu duhet një shoqëri e cila është e fragmentarizuar, pa vetëdije kombëtare, pa kuptimin e duhur të shtetit, si dhe materialiste në ekstrem. E vetmja mënyrë që ata, një grusht klanesh, të mund të sundojnë

shoqërinë shqiptare është që të arrijnë këto objektiva. Siç edhe e kam argumentuar tjerakund, rrënjët e këtij projekti janë në mendësinë marksiste të parisë që është edukuar me bindjen e patundur se kapitalizmi dhe marrëdhëniet ekonomike janë qendrore e thelbësore në çdo shoqëri. Për të arritur këto katër objektiva që përmenda, paria oligarkike e Tiranës duhej të shkërmoqte shoqërinë shqiptare, ta riorganizonte sipas interesit dhe gjatë njëzetë e tre viteve, arritur ta bëjë këtë gjë.

Si ia arriti? Fragmentarizimi i shoqërisë u arrit përmes emigrimit masiv e getoizimit të zonave urbane që u bënë katunde gjigande me njerëz që banonin në apartamente e në toka të zëna me dhunë. Vetëdija kombëtare u zëvendësua nga mendësia e njeriut individualist, *homo economicus* materialist e të zvetënuar, që e bazon gjithçka në paranë dhe në anën më të keqe të mendësisë katundare. Shteti u transformua në armikun kryesor të shqiptarit dhe në instrumentin kryesor të sundimit të parisë së Tiranës. Në këtë proces, duke e veshur politikën e ndjekur me argumente ideologjike, si dhe duke e vënë individin e shkëputur nga vlerat e nga shoqëria në qendër të botës, paria e Tiranës ia arriti të fragmentarizonte shoqërinë, të ndryshonte konceptin e qytetarit dhe të shkëpuste lidhjen e tij jetike me shtetin. Rezultati ka qenë kapitalizmi katundar shqiptar, shkretëtira morale e njerëzve njëdimensionalë që e shohin gjithçka te vlera e lekut, kriza e thellë e vlerave kulturore dhe e shoqërisë së kriminalizuar, si dhe paralizimi i shtetit që ka hyrë në qorrsokakun e pritshëm të kolapsit.

Ngrehina që ka ngritur paria do të shembet, sepse nuk mund të vazhdohet në këtë mënyrë. Por paria e Tiranës i ka marrë masat që të ruajë pinjollët e vet. Kur të shembet ngrehina në krizën e pritshme, ajo do të zërë poshtë shqiptarët, jo parinë e pinjollët e saj.

Zgjidhja

Hapi i parë i daljes nga kriza është një rikonceptim i rolit të qytetarit në shoqërinë shqiptare dhe një rishikim i projektit të

tranzicionit. Projekti ka dështuar. Paria ka dështuar. Shoqëria shqiptare duhet të fillojë një debat të zgjeruar se si të ndryshojmë, sepse kështu nuk vazhdohet më.

Mendimi im është se ky rikonceptim duhet të bazohet në një numër parimesh që janë mbështetës të njëri - tjetrit dhe që zbatohen natyrshëm në rastet e shoqërive të tjera moderne.

Së pari, në qendër të identitetit të qytetarit, përcaktues është shteti.

Së dyti, lidhja e qytetarit me shtetin bëhet e natyrshme përmes përkatësisë në një grup identitar që është kombi.

Së treti, përmes lidhjes me shtetin, shoqëria kombëtare fiton elementët e qytetarisë dhe nga ana e tyre, individët fitojnë të drejtat që meritojnë, por marrin edhe detyrat e përgjegjësitë qytetare të domosdoshme.

Së katërti, vlerat morale që karakterizojnë një shoqëri të tillë, janë ato që i shërbejnë shtet - kombit si struktura qendrore legjitime e identitetit.

Së pesti, çdo sjellje që është e dëmshme për shtet - kombin është e dënueshme nga ligji dhe nga qytetarët.

Së gjashti, demokracia nuk është sundimi i turmave, por një metodë për të zgjedhur njerëzit që duhet të drejtojnë shtetin.

S'ka asnjë shoqëri normale që nuk është e ndërtuar mbi këto parime. Por në Tiranë u veprua krejt ndryshe. U eksperimentua me ne për të na bërë gjarpërinj. Prandaj paria e Tiranës e ndien thellë trandjen e sistemit oligarkik të kafazit ku i ka ndrye shqiptarët, si gjarpërinjtë në një laborator. Prandaj edhe në këto zgjedhje si prijatarët ashtu edhe instrumentat e tyre të shumta, janë duke luftuar për të ruajtur sistemin, sepse e kanë shumë frikë daljen e gjarpërinjve të uritur nga guva. Po kush vendos me i kthye njerëzit në gjarpërinj që t'i përdorë duke i rënë fyellit për me argëtue botën, duhet me e pasë shumë frikë ditën kur gjarpërinjtë janë të uritur, kanë dalë nga guva, kanë rrëshqitë e janë duke fjetë në të njëjtin shtrat me parinë që s'din çka me ba me pjellat e pamëshirshme të eksperimentit të saj.

ZGJEDHJET DHE NDËRKOMBËTARËT TRI ZGJIDHJET DHE LOJA ME KARIKE E PARISË

Vëmendja e jashtëzakonshme që iu kushtojnë këtyre zgjedhjeve nga të huajt, është shumë shqetësuese për shqiptarët që e duan demokracinë, të drejtën dhe vullnetin e popullit shqiptar. Të huajt janë tejet të shqetësuar dhe kjo duket nga niveli i personaliteteve që po merren me zgjedhjet. Ardhja e një personaliteti me peshë, si guvernatori H. Dean, i cili ka qenë edhe kandidat për president e kryetar i Partisë Demokratike në SHBA, tre muaj e ca para zgjedhjeve, nuk është fare shenjë e mirë. Edhe hutimi i tij pas takimeve me prijatarët e parisë që e shohin veten fitimtarë, është një shenjë shumë e keqe. Po ashtu deklaratat e personaliteteve evropiane, që nga e përherëshmjia Doris Pack, te komisioneri Stefan Fyle dhe raportuesi Kukan, janë shenja të qarta se jo vetëm SHBA, por edhe evropianët nuk janë fort të sigurtë me lojën dhe me loj-tarët në Tiranë.

E përbashkëta është se të gjithë këta ndërmjetës të huaj po e shohin me shumë pasiguri sjelljen e prijatarëve të parisë së Tiranës. Njëri thotë se të gjithë i kanë thënë se do të fitojnë. Tjetri vjen dhe nuk pranon as të takojë njeri, por takon pjesëtarë të shoqërisë civile dhe të biznesit dhe shkon ... direkt në Rinas. Në një shtet normal, për këtë punë duhej të kishte rënë qeveria. Tjetri nuk vjen fare dhe deklaron që politikanët e Tiranës duhet të merren vesh, sepse kanë të përbashkët kauzën e integritimit evropian, kur dihet që askush nuk beson më në këtë kauz dhe se parisë nuk i intereson fare kjo temë.

Por problemi është se zgjedhjet në Tiranë janë si ajo loja me karrike. Kur të pushojë muzika, njëri nga lojtarët nuk do të ketë vend të ulet, prandaj duhet të dalë nga loja. Në rastin tonë interesat jetike të lojtarëve më kryesorë politikë, janë të tilla që asnjëri nuk mundet me humbë, sepse ashtu del nga loja. Humbja është fillimi i kalvarit të pasigurisë që në xhunglën shqiptare përkthehet në shumë mënyra. Në një vend ku gjithçka është paraja, mund të përfundosh si Fatos Nano dhe të fillosh të paguash edhe për djathë të fërguar. Edhe pse mes fatit të Nanos, Charles Taylor dhe të Ghadafit, këta pjesëtarë të parisë do të zgjidhnin të Nanos, e vërteta është se asnjëri nuk është i sigurtë se nuk do të përfundojë në burg si Sanader apo edhe më keq. Në shtetin shqiptar çka sjell ora, nuk e sjell moti dhe këta që kanë bërë të 99 - tat gjatë motit, i druhen asaj orës kur mund të japin llogari për të 9999 - tat.

Por në këtë pikë, loja është në duart e të huajve. Ka tri mënyra që të huajt të zgjidhin nyjen e ngatërruar të zgjedhjeve.

Njëra është të vënë veton si bënë me Fatos Nanon në vitin 2005 e ta nisin atë që nuk gjen karrike në mërgim të praruar.

Tjetra është të mbyllin sytë e të pranojnë vjedhjen e orkestruar të zgjedhjeve e të votave nga dy palët e parisë, të shpresojnë se sherri nuk do të derdhet në rrugë dhe që bandat nuk do të lajnë hesapet me kë t'iu dalë përpara.

Më së fundi, zgjidhja është t'i bëjnë të gjithë bashkë në një qeveri, domethënë t'iu japin nga një karrike të gjithëve dhe ta mbyllin lojën në paqe për katër vjet të tjera. Por, problemi është se në Tiranë ka aq shumë mtues e fitues të deklaruar, sa qeveria duhet bërë me dyqind ministra. Edhe më keq, shteti nuk ka më para.

Shkurt, të tria këto rrugë janë ose të pamundshme, ose të padëshërueshme, ose tërësisht diskredituese. Interesat e parisë nuk janë të përputhëshme dhe të pajtueshme. Sherri është i pashmangshëm.

Së pari, nuk do të ketë largim të Sali Berishës. Ku do të mbytet Sali Berisha? Sali Berisha nuk ka ku shkon. Saliu ka

ende frikën e asaj kohe kur iu kundërvu botës dhe të gjithë e lanë në baltë e ngeli me 12 vetë në Presidencë. Aq më tepër që tani është në lojë edhe e ardhmja e familjes së tij. I biri është një lojtar i dobët dhe i kapur, me probleme familjare dhe i pazoti me përballue intrigat e komplikuara të Tiranës. E bija është shumë e zgjuar, por ka probleme personaliteti dhe që nga viti 1997, ka qenë dhe është në shënjestër. Dhëndri i tij është i pabesueshëm, peshë e lehtë edhe pse beson se është i zoti, pa qenë aq i zoti. Logjika e Saliut është se ai mbijeton vetëm me një opozitë bllokuese e shumë të fortë që duhet ta drejtojë vetë sa të ketë frymë. Prandaj nuk do të ndalet para asgjëje për të promovuar ata njëzetë e pesë vetët e familjes dhe këta rrotat që herë lart e herë poshtë, gjithnjë kanë shtyrë përpara makinën e Saliut e të gjithkujt që i ka përdorur, domethënë tipat si Arben Imamin, etj.

Saliu është mjeshtër i mbajtjes së njerëzve peng, mjeshtër i lojës me hijet në mur, një lojë që të huajt e kanë shumë frikë, sepse të çon lehtë në luftë civile. Por edhe pse e din se nuk e mban dot qeverinë kështu si janë punët, Saliu nuk ka ku shkon. Zgjidhja e vetme që ka është intensifikimi i përplasjes midis shqiptarëve. Përplasia herët a vonë, do të çojë jo vetëm në mbijetesën e Saliut, por edhe në luftë civile, obstrukcionizëm, rrebelim kundër shtetit.

Edi Rama nuk ka ku shkon. Ai mund të rrijë në Kuvend si deputet, por po nuk fitoi si kryeminister, është jashtë loje dhe shumë i pasigurtë për të ardhmen.

Illir Meta është në krye të një partie të punësuarish. Për të shteti është jetik gjithashtu, sepse të gjithë anëtarët e partisë ecin me etiketën e çmimit të varur te mënga.

Së dyti, për t'i mbajtur parinë nën kontroll, të huajt duhet të pranojnë marrëveshjen e qartë midis dy palëve kryesore dhe njëherësh, edhe diskreditimin e demokracisë e të përfaqësuesve të huaj që e mbështesin atë zgjidhje. Ata duhet të legjitimojnë në emër të stabilitetit, vjedhjen e hapur të votës dhe diskreditimin e sistemit demokratik, domethënë të pra-

nojnë pazarin midis dy palëve kryesore. Kjo do të thotë që formalisht do të ketë koalicione, por partitë e reja e të vogla që nuk kanë përfaqësues në komisionet zgjedhore, janë të destinuara të mbesin nën mëshirën e dy partive të mëdha.

Komisionerët do të mbushin kutitë, vjedhja do të jetë ashiqare, e hapur fare dhe në fund, arbitri do të jetë Ilir Meta që këtë herë do t'i mbrojë votat e tij dhe do të vendosë nga shkon balanca e fuqisë. Por nuk ka shenja se edhe në pranofshin prijatarët e këtyre partive të bëjnë pazar për një vend në Kuvend, do të pranojë baza e partisë. Ne jemi një vend oriental në të cilin mendësia katundare kërkon që "burri që është burrë" të dalë në fushë të mejdanit e të marrë hakun e vet. Dhe haku është vota e vjedhur. Edhe kjo rrugë çon në përplasje e në rrëmujë që pashmangshmërisht do të çojë në luftë civile, në përplasje e rebelim.

Së treti, të huajt kanë mundësinë të mbledhin të gjitha palët e parisë, të gjejnë një formulë që e ndan tortën e qeverisjes me përqindje dhe të mbyllin sherrin. Në këtë mënyrë do të ketë stabilitet. Formulatat që do të përdoren janë të lehta për t'u gjetur: të shmangim efektet e krizës (botërore, rajonale, ekonomike), të bëjmë një qeveri të shpëtimit kombëtar, të mbërrimë objektivat e integritit, të zhvillimit, etj. Por kjo zgjidhje që është edhe më e mundshme, është edhe më e rrezikshme. Të nesërmen që të bëhet një qeveri e tillë, maska e parisë bie. Shqiptarët do ta kuptojnë që më në fund ujku e shkundi miellin nga këmba dhe u tregua ai që ishte. Një qeveri e gjerë që tregon se paria e Tiranës nuk e ka pasur asnjëherë seriozisht. Në të njëjtën kohë, një zgjidhje e tillë do të tregojë se të gjithë kanë qenë kundër popullit. Atëherë do të jetë vetëm çështje kohe që edhe populli të kthehet kundër tyre.

Në përfundim duhet thënë se nuk ka gjasa që njëra palë e parisë të fitojë zgjedhjet e vetme. Saliu e ndjen dobësinë e Edi Ramës, di që ka shumë armiq të fuqishëm në partinë e tij. Edi Rama e di që Sali Berisha i mban bashkë rrotat e PD - së me karrot e pushtetit, sepse si leku edhe këta i shiten prurësit më

të parë. Vetëm Ilir Meta është më i sigurtë se të gjithë. Votat i ka blerë me lekë e me vende pune dhe i garanton me vende pune.

Të huajt duhet ta kuptojnë se këta individë nuk kanë asnjë skrupull, por kanë vetëm interesa qartësisht kriminale dhe mafioze. Për fat të keq, e ardhmja e shqiptarëve do të vendoset nga interesat e momentit të atyre ditëve që gjithsesi do të jenë të informuara nga këto interesa jetike të prijatarëve. Loja do të jetë lojë e karrikeve dhe e muzikës, por sa të ndalet muzika, të huajt duhet të shtojnë një karrike të re që asnjëri nga pjesëtarët e parisë të mos humbë, ose të pranojnë që njëri do të ulet në prehrin e dikujt, gjë që në Tiranë ndodh shumë herë e pa pasoja për karriken e radhës. Por mënyra se si do të zgjidhet ky problem, do të tregojë shumëçka për të ardhmen e demokracisë në shtetin shqiptar.

DITA PAS ZGJEDHJEVE: ËNDRRA E VETME
DHE PESËMBËDHJETË ANKTHET
E PARISË SË TIRANËS

Një përrallë popullore kallzon për një hoxhë të mençur që e kuptonte se çka mendonin njerëzit dhe që i gjente gjerat që ata fshihnin, ose i kishin humbur. Kaq i doli nami i madh këtij hoxhe, sa shkoi gjer në Stamboll. Sulltani e thirri e i tha të gjente se çka kishte fshehur në kutinë e duhanit. Hoxha u mendua e u mendua dhe kur e kuptoi se po i delte mashtrimi, psherëtiu me zë:

- Eci sa eci, këtu mbet karkaleci!

- Aferim, - i tha Sulltani, - karkalec kam!

E shpërbleu me para dhe e nisi në vendin e vet ku u trajtua si burrë i zoti për gjithë jetën. Ajo që e shpëtoi hoxhën ishte mbiemri që e kishte Karkaleci. Sulltani kishte fshehur në kutinë e duhanit një karkalec. Rastësia e shpëtoi hoxhën.

Tashti paria e Tiranës është si ky Hoxhë Karkaleci. Në dukje ajo e gjen të fshehtë e njerëzve, i mashtron dhe i rren gjithë kohën duke folur për liri, demokraci, pasurim, integrim e me radhë. Në dukje njerëzit besojnë se paria është e pashmangshme, e fuqishme, e pathyeshme dhe që i gjen të gjitha zgjidhjet. Ata e kanë frikë për vdekje dhe tmerrohen prej saj. Sepse këta të bëjnë atë që thuhet se e bëjnë. Të vrasin. Të zhdukin. Të çojnë në mjerim. Të trafikojnë familjarisht. Të bëjnë të pish helmin. Të nxjerrin namin e zi për shtatë breza. Të venë në kurriz ca banditë që kanë dalë direkt nga porta e Ferrit. Të shkatërrojnë me gjithçka dhe të bëjnë të bësh harakiri. Këta të bëjnë të mos e varësh veten, por të bëhesh mumje në derën e shtëpisë tënde.

Por problemi është se kjo është vetëm paraqitja. Dhe ngjan kështu, sepse ka shumë presion të papërbalueshëm nga ana e parisë, por edhe mungesë reagimi total nga ana e popullit. Gjërat janë më të komplikuar se duken. Paria jonë janë katundarë safi. Dhe ne të tjerët jemi katundarë safi gjithashtu. Dhe si katundarë të vërtetë, të gjithë ne ndryshe mendojmë, ndryshe flasim, ndryshe veprojmë. Origjina e ëndrrës dhe pesëmbëdhjetë makthet e parisë së Tiranës, janë të lidhura pikërisht me këtë mendësi katundare. Pasiguritë e saj janë të shumta dhe zënë fill pikërisht te paaftësia e leximit të saktë të mendjes së popullit katundar e fisnik. Se ne ndryshe mendojmë, ndryshe flasim, ndryshe veprojmë dhe tjerakund e kemi qëllimin. Ne jemi si uji. Dhe uji ka një problem, ai shkon aty ku gjen hapësira e të çara, jo ku don ti të shkojë.

Paria e Tiranës ka ngritur një digë gjigande me mashtrime, krime, vjedhje, manipulime, poshtërsi, ndyrësi, zvetënim e degjenerim. Paria e Tiranës ka një ëndërr të thjeshtë, shkurt ajo nuk don që në fund të zbulohet mashtrimi se ka bërë poshtërsinë më të madhe të mundshme, se na ka drejtuar në rrugën më të gabuar të mundshme, se na ka kriminalizuar, se na ka vjedhur, se na ka grabitur, se na ka degjeneruar, se na ka trafikuar, se na ka shitur e blerë, se na ka skllavëruar, se na ka droguar, etj. Paria ka frikë se po u ça dikund diga, të gjithë ngrehinën e krimit të tyre e merr rryma e zemërimit popullor me vete. Po doli që demokracia, liria, kapitalizmi pasurimi, integrimi etj., janë mashtrime dhe jo shpresa e vërtetë për shqiptarët, çka ndodh?

Deri në këtë pikë, paria beson se e ka hedhur lumin, sepse nuk ka ndodhur ende gjë. Në fund të fundit, nga pjesëtarët e vërtetë të parisë janë vrarë vetëm një grusht njerëzish. Hetuesit e të dënuarit rrinë bashkë e bëjnë biznese bashkë. Pronarët e ish-pronarët janë të lidhur me interesa e me martesat. Të gjithë familjet e komunistëve na kanë dalë edhe balliste. Ne i kemi marrë të gjithë kërmat e plehrat politike të historisë, i kemi larë e pastruar në faqet e gazetave e në biografitë e pa-

fund, i kemi vënë në piedestale dhe nuk është për t'u habitur që edhe pjesëtarët e parisë së Tiranës të presin radhën për piedestalin. Sepse kemi filluar t'iu vëmë emra bulevardesh të gjithë drogashitësve, hajnave të pulave e trafikantëve. Kurrkujt nuk i bëhet llogaria për maskarallëqet që thonë e që shkruajnë pa ndërprerë pa i vrarë as në thundra ndërgjegjia. Askujt nga këta nuk i është trafikuar djali apo vajza, motra, nëna apo gruaja, por edhe në ka ndodhur, nuk e kanë ditur, ose bajnë sikur nuk e dinë, sepse kur ban sikur nuk e din, nuk ka ndodhë. Këta vjedhin me të dy duart e askush nuk kundërshton, bile hajni më i madh brohoritet më shumë. Këta i kanë nxjerrë paratë jashtë vendit e askush nuk padit e nuk ankohet. Këta lllapin marrëzira e askush nuk kundërshton. Paria mendon se ia ka hedhur paq. Diga e mashtrimit është në mendjen e njerëzve dhe njerëzit nuk e shohin, sepse ata shohin me sytë e mendjes. Kjo është si puna e atyre që vazhdonin të besonin se dielli rrotullohet rreth tokës, edhe kur u vërtetua se toka rrotullohet rreth diellit. Për sa kohë këta besojnë në fjalët e parisë, paria ia ka hedhur.

Por çfarë ndodh, nëse njerëzit nuk besojnë më te paria? Duke e ditur se si mendojnë katundarët, paria ka shumë anthe dhe unë po përmend vetëm pesëmbëdhjetë prej tyre. Problemi i përbashkët i të pesëmbëdhjetë anktheve të parisë është se ajo nuk e din nëse shqiptarët ia besojnë prej së vërteti rrenat e mashtrimet, apo po luajnë lojëra edhe me të. Sepse në katundin tim kemi një lojë që quhet "dushk për gogla." Problemi i parisë është se po e morën vesh shqiptarët se e kanë një shans për të kryer punën që kanë ndërmend, ata nuk do të besojnë më parinë e Tiranës dhe në vend të karkalecit... do të venë një gjarpër. Dhe mandej do t'ia marrin parisë nderin, fytyrën, fëmijët, pasuritë dhe jetën. Sepse siç ka thënë Ekrem Bej Vlora, një plehurinë tjetër politike, tri gjëra nuk i ka kush të sigurta ndër shqiptarët: nderin, gruan e pasurinë. Problemi i parisë është se tashmë nuk i ka të sigurta as fëmijët dhe as jetën. Sepse ata që deri dje ishin popull, e katundarët tanë

që shkuan në shkollën e djallit, nuk kanë pse presin popullin katundar që të nënshtrohet e të rrijë si dele nën sundimin e tyre. Sepse malli i vjedhur iu përket të gjithëve dhe kur të vijë puna i përket më të fortit dhe më i forti ndër shqiptarët, është zemërimi popullor e shpërthimi popullor, si ai i vitit 1913. Ky është 100 vjetori i atij shpërthimi. Ku i dihet se çka ndodh në këtë 100 vjetor! Sepse e ka një arsye paria që festoi 100 vjetorin e shpalljes së një shteti gjysmak dhe nuk po feston 100 vjetorin e shpërthimit të marrëzisë kombëtare. Paria e din se nuk ka asnjë mundësi që shpërthimin popullor, edhe po erdhi në formën e qelbit, të mund ta ndalojë e ta përmbajë.

Po ashtu paria e din se oqeani është gjithnjë më i qetë para se të fillojë stuhia. Dhe populli trazohet zakonisht para zgjedhjeve. Prandaj paria e Tiranës po iu afrohet këtyre zgjedhjeve me një ndjenjë pasigurie të theksuar. Natyrisht që në takime, mitingje e në fushatat respektive, pasiguria e parisë as nuk shihet, as nuk ndjehet. Prijatarët janë të gjithë delirantë, e shohin veten si fitimtarë dhe militantët e tyre kanë nisur të sillen si mbështetës të fitimtarëve. Por poshtë kores së vetësigurisë dhe arrogancës së parisë, ka një numër faktorësh që e bëjnë lojën krejtësisht të paparashikueshme dhe të pakontrollueshme. Prandaj paria e Tiranës ka vetëm një ëndërr. Në atë ëndërr ka një numër të theksuar ankthesh që e shqetësojnë së tepërmi. Le të merremi me ëndrrën dhe me pesëmbëdhjetë ankthet e parisë së Tiranës që janë aktet e saj.

Ëndrra e parisë së Tiranës

Paria shpreson në një përplasjeje të furishme e të pandërprerë në shtyp, në të cilën do të përtypen e përmenden kurvëritë, poshtërsitë, hajnitë, dashnoret e dashnorët e familjeve, krimet e dorës së dytë, vjedhjet e tenderat, hidrocentralet e klanet e krimit, lidhjet e dyshimta, Tan Lepri e Rrahmoni, 10 e 20 përqindshat, në fund të ketë një përshkallëzim përtej fakteve që i din e gjithë Tirana, deri edhe Diaspo-

ra shqiptare e Timbuktusë. Analistët, komentatorët, opinionistët, mentarët e të gjithë ata që presin një kockë, do të hidhen në sulm për të degjeneruar e për të zvetënuar njerëzit e palës kundërshtare, sepse si katundarë të vërtetë që jemi, ose do të jesh me ne, ose kundër nesh. Fushata do të fillojë t'i ngjajë *Big Brother*, edhe pse këta nuk do t'i shohim të flenë bashkë. Ai që do të vjedhë votat më të shumta, do të ngrejë duart sipas parimit "që baba, dorën". Më në fund, votuesit e luajtur mendsh dhe të bombarduar me dizinformacion do të shkojnë të zgjedhin "të keqen më të vogël".

Por paria i ka marrë masat që votuesit të mos votojnë, të themi AKZ apo FRD. Si do t'i votojnë ata, kur votën e tyre e hedhin komisionerët e partive kryesore? Bamir Topi ndoshta e merr votën e vet, sepse shumica e ish-berishistëve që nuk kanë ku shkojnë e që nuk do të jenë më në lista ndoshta e mbështesin, ndoshta ku i dihet, me pak ndihmë nga dikush i interesuar, i bën vend vetes në Kuvend. Por AKZ nuk ka shans, sepse nuk e mbron njeri. Votat e saj vijnë shumica nga anti-berishistët. Po ashtu gjithsesi PBDNJ i ka tre vende të sigurta në parlament. Janë edhe nja gjashtë grekë në listat e partive të tjera dhe PS ka qenë gjithnjë partia e grekëve. Pyetja është pse duhet t'ia mbrojnë kush votat AKZ - së? Pala e pakënaqur do të bëjë nja dy mitingje të egra, takimet e KQZ do të jepen *live* dhe të gjithë shqiptarët do të rrinë pa punë duke parë televizor në kafene, duke pirë kafe dhe duke pritur që t'iu bjerë njëri nga tre iPhone për "ndonjë gjë të vogël" që pak a shumë përkthehet si "punë e pistë" diku tjetër.

Por në fund, pasi njerëzit të jenë të lodhur në maksimum, pasi të përmenden 1997 e 1998, e pasi të thuhet se kështu janë të gjithë, në skenë do të ndërhyjnë të huajt dhe do të caktojnë fitimtarin. Në këtë rast, kryetari i partisë humbëse do të shkojë te njerëzit e vet e do t'u thotë se nuk e mbajmë dot BE-në me bukë, se nuk kemi para, se duhet të kuptojmë situatat dhe ta mbyllim këtë punë. Shteti iu fal paratë partive të vogla, kutitë janë e mbesin transparente në KQZ, paria thotë se she-

rri ishte për fushatë dhe me një qeveri me bazë të gjerë mbyllet loja e zgjidhet halli. Të gjithë të inkriminuarit kanë marrë viza e kanë blerë restaurante jashtë shtetit, e kështu mund të fillojë vjedhja nga fillimi për ata që hypin në pushtet. Askush nuk humbet, shqiptarët denden me sapun duke kujtuar se është djathë dhe deri në zgjedhjet e tjera merren përnatë me Blendi Fevziun, Çim Pekën, Arian Çanin, Ilva Taren, Ruzhdijen, Big Brother, i fusin një "hajt ma, s'kena çka me ba..." dhe kthehen te jetesa e te poshtërsitë e vogla të përditshme.

Kjo është ëndrra e parisë së Tiranës. Me pesëmbëdhjetë ankthet e parisë që burojnë prej kësaj ëndrre, do të merrem në shkrimet që vijojnë.

PËRRALLA E 1 PRILLIT

Më në fund paria e Tiranës veproi ekzaktësisht ashtu si e pata parashikuar unë. Duke kërkuar të shmangnin përplasjen, që të përmbajnë urrejtjen popullore, zemërimin dhe indinjatën për krimet që kanë kryer, paria e bëri pazarin turrë nën hali dhe i mbuloj gjërat me hi, tre muaj para zgjedhjeve. Kjo ndodhi bash ditën e rrenave, ditën e gënjeshtreve, domethënë sot, me 1 prill 2013. Sali Berisha, Ilir Meta dhe Edi Rama u morën vesh. U bë pazari, u shit Shqipëria, u mashtrua populli për ta, i njohur si “gomari” dhe u krye puna.

Po që nuk më ikën mendja nga mençuria popullore e katundit tim! Budalla që jam edhe unë! Duke i pasur punët e mia në vijë, duke mos pasur fare problem, rri e merrem me gjëra që nuk më japin bukë, që vetem më prishin punë, siç janë politika e Tiranës dhe fati i shqiptarëve. Hajt ma, edhe unë si katundarët e tjerë jam! Edhe pse jetoj në Nju Jork, politikën e marr vesh vetëm me mesele popullore, domethënë me rrëfënja e me ngjarje të jetuara. Kam ikë unë prej katundit, por nuk ka ikë katundi prej meje, e për Zotën, gëzohem që ende i mbaj mend meselet e katundit, se më bajnë me kuptue mirë botën moderne shqiptare. Në fakt më ndihmojnë ma mirë se librat e shumë të studjuesve modernë shqiptarë dhe fjalimet e neveritshme të politikanëve vendore.

Duke dashur të kuptoj se çfarë ndodhi sot, m'u kujtua historia që tregonte plaku i urtë, Palokë Cuca. Singërisht që kjo puna e shqiptarëve me parinë sunduese që na ka rënë në hise

dhe marrëveshja e 1 Prillit, është dëshmi e shkëlqyeshme e unitetit dhe e dashurisë së shumëfishtë midis palëve të parisë, duket krejt si ajo historia e gomarit te shitur tri herë që kall-zohej në katundin tim. Me qe është dita e rrenave nuk mund të them krejt të vërtetën, sepse si mund ta them unë që jam jashtë loje, kur të vërtetën nuk e thonë as Sali Berisha, as Edi Rama e as Ilir Meta, por hajt ma, si katundar që jam po e gjej një mënyrë me e thanë.

Një bashkëkatundari ynë që e kishte emrin Votues kishte blerë një gomar te një xhambaz që e kishte emrin Socialist Blloku. Gomari që e kishte emrin Horllëk Pushtllëku, punonte mirë një kohë, luante edhe kumar, por u plak, nuk donte të punonte më fare dhe rrinte në grazhd/kafene gjithë ditën. Nejse, ky zotni katundari Votues shkoi e shiti gomarin Horllëk në pazar për shumë pak para dhe e bleu ortaku i atij xhambazi që e kishte emrin Demokrat Katundi. Pas disa orësh ky sheh ortakun tjetër të xhambazit, Integrim Skraparlliu duke shitur një gomar me leshra të prera, të kruar e të pastruar, me rruaza e zilka që tundej e që shkundej dhe që e kishte emrin Cub Lamashi. I pëlqeu dhe e bleu shumë shtrenjtë, se helbete, dukej si gomar i ri që i hante kurrizi për punë, sepse luante bishtin dhe ecte shpejt e tundte zilkat si në shfaqjen e tallavasë. Kur mori rrugën që të sjell në katundin tonë, gomari Cub eci më shpejt se vetë ky dhe i shkoi drejt e te shtëpia. Dhe ai i tha gruas së vet:

- A e sheh, moj grua, se çfarë gomari të zgjuar e demokratik kam blerë unë?

Po e shoqja që e njohu menjëherë gomarin, sepse gomari Horllëk Pushtllëku kishte një dosje me sjellje jo të këndshme, e një shikim të keq fort, iu kthye dhe i tha,

- Po ky është gomari jonë parazit, a të shplaftë mortja! Po si e humbe ditën e lume (domethënë tranzicionin) dhe paratë (kursimet e emigrantëve dhe ekonominë kombëtare) që të hajë ky që nuk punon fare? Që të mbajmë këtë do punojmë ne, more gomar?

Ky bashkëkatundari im që e kishte emrin Katundar Qytetar, i hyri në dru të shoqes dhe të bijës dhe i tha:

- Gomari është i ri, nuk është gomar i vjetër. Ty do të vë te semafori, se këtë gomar e kam blerë shtrenjtë dhe një burrë jeton pa gruan, por pa gomarin nuk jeton dot! Sepse çfarë burri është ai që nuk e ka një gomar si ky që edhe pse është i njëjti, tash duket njëzetë e tre vjet më i ri? Unë blej gomarë nga xhambazët më të zotë që ka bota. As doktori nuk të bën këtë që të bëjnë xhambazët e mi; e bëjnë gomarin plak të duket kaq i ri.

Dhe me i ra shkurt, prej aty u nis për te klubi i katundit ku i gjeti të tre xhambazët duke ngrënë ngjala (mos më kërkoni t'ua shpjegoj se si i hanin, ku i kapnin, nga i nxirrnin, kush ia jepte kujt, kush ia vinte në pjatë kujt, me paratë e tij, etj., etj., etj. Shkurt, me marrëveshjen e 1 Prillit dhe për këto zgjedhje, paria i ndau pazaret e shqiptarëve. A do të shkojnë shqiptarët te mejhana me pi një gotë qyl me paret e veta? Fund i hidhtë për një shtet që shitet kaq herë për kurrigjë e për një popull që mashtrohet e vetëmashtrohet pa fund.

PAKTI BERISHA - RAMA - META DHE NEVOJA E ALTERNATIVAVE POLITIKE

Gjëja më e hidhur për dikë që merret me analiza, është të thotë se ka të drejtë. Sepse nuk i thuhet atij që ka kancer në mushkëri se i ke thënë me kohë të lerë duhanin dhe se e ka pasur gabim kur të ka konsideruar si njeri që s'din dhe nuk kupton rëndësinë e duhanit. Nuk i thuhet atij që ka bërë një aksident, se i ke thënë më kohë se nuk din me vozitë makinën.

Ama shqiptarëve duhet me ua thanë të vërtetën pa ndërprerje. Sepse ndryshe nga këto raste, shqiptarët kanë në mendjen e tyre një gjarpër që po i shtërngon, po i mbyt haptazi e pa mëshirë dhe që do t'i përpijë me gjithë kocka, duke e përdorur shtetin shqiptar kundër vetë shqiptarëve. Më në fund edhe ata që mund të ngrenë dorën të luajnë bingo, të mbajnë gotën e rakisë e kanë sy të dallojnë nëse është ditë a natë, e kanë kuptuar se ky gjarpër vetëm po i shtërngon rrathët, po i sheh në sy dhe po rreket që t'i hipnotizojë. Koka e gjarpërit doli dje dhe në daç t'i mbajnë hapur sytë shqiptarët, në daç t'i mbajnë mbyllur, gjarpëri do t'i përpijë me gjithë pasuri, tulla e llaç, me shpresa e me ëndrra. Sepse shqiptarët janë lejuar të venë ca dhjamë që të mund të mbijetojë pikërisht ky gjarpëri që tashmë nuk ka kë kafshon dhe që duhet t'i përpijë ata një e nga e një e të gjithë pa dallim, për të mbijetuar. Sepse edhe po qe duke u mbytur anija e shtetit, gjarpëri do të vazhdojë të gjuajë minj deri në fund, sepse gjarpëri e din notin. Minjtë ose do të hahen, ose do të mbyten. Dhe në këtë pikë, dallimi midis shqiptarëve dhe minjve të krahasimit është i papërfillshëm.

Shqiptarët duhet të tregojnë a janë viktima, minj që gjarpëri do t'i hajë për zgjedhje apo janë burra e gra me dinjitet që duan të mbrojnë jetën e pasurinë, sepse nderin dhe fytyrën, ky gjarpër, paria e Tiranës, ua ka marrë me kohë. Shqiptarët do të kenë edhe shanse të tjera, por çdo ditë që kalon, zgjidhjet e tyre bëhen më të vështira e më të kushtueshme.

Çfarë ndodhi?

Më 1 prill 2013, u zyrtarizua marrëveshja për ndarjen e pushtetit midis palëve të parisë. Pakti ka qenë bërë me kohë, në fakt na e ka lënë gati Ramiz Alia, por më 1 Prill prijatarët e parisë, kokat e krimit shqiptar, krerët e famljeve mafioze, ranë dakord të ndajnë pushtetin. Sali Ram Berisha dhe Trusti i Gështenjave të Tropojës, do të ketë disa burime të forta financiare. Ai do të kontrollojë disa bashki të mëdha, disa komisione parlamentare, do të ketë mjaft deputetë e një “opozitë” relativisht të fortë. Po ashtu Sali Berisha do të ketë financim të siguar për të mbajtur funksionale një strukturë që do të ruajë familjen e interesat e veta. Orta e Jenicerëve ka interesa që Edvin Kristaq Rama të bëhet i pari i vendit. Ilir Rexhep Meta dhe banda e tij duhet të mbajë me punë elektoratin e vet. Këta do të vazhdojnë të hanë edhe atë që ka ngelur nga pasuria kombëtare e shqiptarëve, më pas do të vihen të hanë edhe vetë shqiptarët.

Tre klanet e fuqishme katundare të parisë së Tiranës, triumfuan dhe pakti katundar tregoi se këta kanë qenë gjithnjë bashkë. Edhe pse kanë venë në krye ca katundarë që kanë jetuar një kohë në qytete e kanë qenë të kamur, askush nuk harron se edhe këta katundarë të qytetarizuar vonë, pasurinë e kanë vënë duke pastruar nevojtoret e niveleve të ndryshme, në kohë të ndryshme dhe që nuk e kanë ndërruar fare mendësinë katundare, prapë sjellja e tyre është katundare safi. Ky pakt është siguria që i duhej parisë dhe dënimi me vdekje i shqiptarisë.

Si duhet interpretuar ky pakt?

Së pari, krerët e klaneve ranë dakord të ndajnë tortën e pushtetit. Ata ranë dakord të garantojnë Sali Berishën e familjen e tij. Nga ana e vet, shefi i Trustit të Gështenjave iu dha bekimin që Ilir Meta, Edvin Rama, Vangjel Dule dhe bandat më të vogla të vjedhin edhe atë që ka mbetur nga pasuria e shqiptarëve për tetë vitet e ardhshme, por me kushtet e renditura më lart. Plani është që pasi të mbarojnë kockat e shtetit, këta do të fillojnë të gjithë bashkë të hanë shqiptarët.

Së dyti, paria vendosi t'iu tregojë shqiptarëve se vota e tyre nuk ka vlerë. Zgjedhjet bëhen kot. Këta të tre i numërojnë votat si duan e sa duan. Këta ia numëruan votën edhe Bamir Topit. Këta do t'ia numërojnë votat edhe AKZ dhe të gjithë partive të tjera të vogla që e kuptuan se me këtë pakt djalli, loja me karrike ka mbaruar. Në karriken e fundit do të jenë Ilir Meta, Edi Rama dhe Sali Berisha. Se kush do të jetë ulur në prehër të tjetrit varet nga disa gjëra që nuk shpjegohen këtu. Por që do të rrinë të gjithë bashkë e njëri në prehër të tjetrit, kjo nuk ka dyshim. Megjithatë shqiptarët nuk do ta kuptojnë se janë ulur, sepse duke qenë me gjatësi të ndryshme, do të duket sikur janë njëri pas tjetrit. Teknikë e njohur, iluzion optik që e ngatërron dimensionin vertikal me atë horizontal. Por kur i sheh nga mënjanë, e kupton çka po ndodh dhe bëhesh i vetëdijshëm për të vërtetën.

Së treti, me këtë pakt paria e Tiranës iu tha të huajve që të mos përzihen. Në fakt paria ua zgjidhi problemin e stabilitetit. Nuk do të ketë rrëmujë në nivelin e parisë. Qentë që kanë një kockë në gojë, nuk iu gërmushen e nuk iu hakërrehen qenve të tjerë. Sepse kocka i bën të rrinë urtë. Dhe ndërkombëtarët nuk do të përzihen, sepse e dinë mirë me kë kanë të bëjnë. Sepse nuk mendon vetëm paria që ne jemi njerëz të paditur e katurdarë, edhe të huajt mendojnë po kështu. Ata duan stabilitet dhe këtë e garanton me lezet marrëveshja. Parimi ishte “më rove, të rrova, brisku i berberit”. Paria nuk ka nevojë për të

huajt. Të huajt nuk duan probleme. Kauza rrotacionale i zgjidh problemet dhe sistemi do të funksionojë përfekt.

Së katërti, marrëveshja tregoi se gjer ku janë të shitura mjetet e propagandës dhe të shtypit. Shumica e llapaqenërisë mediatike po bëjnë hapur lojën e parisë dhe janë të angazhuar në mbrojtje të paktit e interesave të tyre të ngushta. Nuk po përmend emra, se më vjen ndot, por të gjithë argumentet që lëshohen prej tyre, si bie fjala, “kështu iu thanë të huajt”, “ishte interesi kombëtar”, “është për të mirën tuaj”, “e bëri Stani-shevi, Papandreu dhe Internacionalja”, “e bënë për të bashkuar socialistët” etj., etj., janë thjesht profka, thjesht mashtrim i pastër. Këta kanë interesa dhe do të ulen të tre në një karrike për të mbrojtur interesat e tyre të ngushta. Se këta sillen sipas parimit të Haxhi Qamilit “kur kam Sharrën e Shijakun me vete, nuk pyes për Berlinin”. Kur i kanë katundarët e tyre pas vetes, nuk pyesin për Brukselin, Uashingtonin, apo Timbukunë. Nuk hyj në argumentet e shumta që po përdoren, por të gjithë këta pjesëtarë të llapaqenërisë mediatike do të ishte mirë ta qepnin gojën, se pusëtës së gjirizit politik në Tiranë i kanë vjedhur kapakun dhe llumi fekal ka vërshuar në gjithë mëhallën që qelbet.

Së pesti, ky pakt vjen në një moment kritik në të cilin do të sprovohet ideja kombëtariste shqiptare. AKZ ka lajmëruar për një miting gjigand me 7 prill. Pakti i parisë ia ka mbyllur lojën Kreshnik Spahiut dhe AKZ-së. Platforma e tij ka qenë e gabuar prej fillimit. Duke u bërë buldozeri anti Berishë, ai nuk e ka kuptuar se po përdorej prej parisë, sepse në çdo kohë, Edi Rama dhe Sali Berisha janë marrë vesh, edhe pse me pak vështirësi të kuptueshme. Tashmë AKZ dhe Kreshnik Spahiu në mitingun e 7 prillit duhet të heqin dorë nga demagogjia e populizmi dhe të parashtrojnë ide të qarta e mobilizuese, një platformë shtet - komb ndërtuese, një program të qartë politik. Ndryshe ky pakt që i mbyll dyert kombëtarizmit shqiptar edhe pse nuk e dëmton si frymë, do ta shfryjë AKZ-në si forcë politike. Përgjegjësia e AKZ është të gjejë forcën e të rrijë jashtë

paktit e jashtë sistemit, sepse Edi Rama e ka shitur pa nisur loja dhe paria është e gatshme që në mos arriftë ta përdorë si don, ta shkallmojë duke përdorur instrumentet e dhunës e të shtetit. AKZ duhet të jetë një parti jashtëkuvendore, të vendosë prioritetet e duhura, të shkojë te shqiptarët jo me dylbi e me demagogji, por me një program të qartë. Sido që të shkojë puna, paria e Tiranës me këtë pakt ia ka ngushtuar zgjidhjet dhe me 7 prill do të merret vesh ku e gjejnë veten AKZ dhe udhëheqja e asaj partie që në këtë pikë e sheh veten si bartëse të idesë kombëtariste. Por paria e din mirë se kombëtarizmi, me një parti apo pa parti, është një frymë e një ideologji, jo një strukturë interesash.

Së gjashti, ky pakt tregoi se nuk ka as të majtë, as të djathtë, as militantë, as ideologji, as vlera, as bindje politike. Kulti i parasë dhe i interesit ka triumfuar. Njerëzit që do të mbështesin njërën palë, ose tjetrën do të shohin qartë se po e dënojnë veten me vdekje, se kanë rënë viktimë e mashtrimit të një bande hajnash politikë. Nuk ka socialistë, demokratë apo liberalë që do të pranojnë një pakt të tillë të pajustificueshëm. Ky pakt tregoi qartë e thjeshtë se paria është kundër shqiptarëve. Të gjitha maskat e saj ideologjike ishin gjethja e fikut e radhës. Tashmë nuk kanë as platforma, as ideologji, as vlera, e as maska që i mbrojnë. Të gjitha sharjet janë pa vlerë, të gjitha etiketimet janë fshirë, të gjitha bërtitjet, kanosjet e kërcënimet janë harruar. Të gjitha dosjet janë fshehur e fshirë sikur asgjë nuk ka ndodhur.

Së shtati, ky pakt tregoi sesa e vetëdijshme është paria e Tiranës për gjendjen kritike të vendit, të ekonomisë, të shoqërisë, të dobësisë së shtetit, të nivelit të lartë të kriminalizimit e të korrupsionit, të shkallës së lartë të mosbesimit që kanë të huajt, etj. Por duke e zgjidhur problemin në këtë mënyrë, me këtë pakt, paria iu thotë të gjithë shqiptarëve; jeni të pashpresë! Ne jemi ata që ju sundojmë, ne do t'ju sundojmë prandaj dorëzohuni! Dallimi midis Rrethit të Ferrit dantesk dhe gjendjes në shtetin shqiptar është se shqiptarët po e pro-

vojnë me jetën e tyre se ç'të bën e keqja kur të kap për fyti. Ky pakt i ka vënë hapur në përballje parinë dhe popullin shqiptar. Paria ka llogaritur që në përplasjen e vezëve do të fitojë veza e tyre. Ata janë katundarë kopila, por edhe ne të tjerët jemi katundarë. Si të përplasen vezët, nuk dihet se cila vezë do të thyhet, sepse edhe ne bëjmë si ata: ndryshe flasim, ndryshe mendojmë e ndryshe veprojmë.

Përmbyllje

Shkurt, pakti Berisha - Rama - Meta është treguesi më i qartë i strukturës oligarkike të tri bandave që sundojnë shtetin shqiptar. Ky pakt tregon se paria është e lidhur me interesa shumë të forta që i bëjnë të gjithë të kontrollueshëm nga interesat e krimit. Por edhe pse koha është e pakët, njerëzit duhet të organizohen dhe të mos e pranojnë zgjidhjen që kanë vendosur prijatarët e krimit. Ata duhet të mbështesin alternativat, nëse këto bëhen alternativa bindëse e reale. Pyetja është a mund të bëhen bashkë 15 000 nënshkrime votuesish? A mund të ketë forca që dinë të luftojnë në këtë luftë me gjarpërin e parisë kriminale të Tiranës?

E vërteta është e qartë dhe është ajo që kam thënë unë me kohë. Këta janë një bandë, këta duan të na hanë të gjallë. Pakti e provon këtë, ndaj këta duhen luftuar pa mëshirë. Nëse nuk ka zgjidhje të shpejtë, atëherë duhet filluar një organizim i ri, jashtë strukturave të parisë, për një fillim të ri, për një shtet në shërbim të shqiptarëve, për një të ardhme të sigurtë e të qetë për të gjithë, për një shoqëri normale, të ndershme e me dinjitet, për një bashkësi ligjore - politike që të marrë vendin e duhur në shoqërinë e popujve normalë.

ZGJEDHJET, TURMA E UDHËHEQËSVE DHE MUNGESA E BURRAVE TË SHTETIT

Problemi kryesor që ka një popull, është zgjedhja e udhëheqësit të duhur. Roli i individit, veçanërisht në momente kritike e historike, është i pazëvendësueshëm. Udhëheqësi është ai që i jep drejtim popullit, masës, grupit dhe që e vë në rrugën e duhur. Udhëheqësi është ai që mbledh dhe i kanalizon energjitë e shoqërisë në një drejtim të caktuar, për një qëllim të caktuar dhe ndikon në zgjidhjen e problemeve me të cilat përballlet shoqëria.

Ka udhëheqës shpirtërorë që frymëzojnë njerëzit dhe i drejtojnë në rrugën e duhur përmes dhuntive që njihen nga njerëzit si hyjnore. Këtu hyjnë profetët; Moisiu, Krishti. Muhameti. Ka udhëheqës që përdorin vlerat kulturore të popullit të tyre dhe e ndihmojnë popullin e vet për me gjetë rrugën e duhur si Gandi në Indi. Ka udhëheqës që përdorin dhunën, inteligjencën, zgjuarësinë, dinakërinë, poshtërsinë, lidhjet familjare, të vërteta apo të rreme e të tjera, për të arritur qëllimet e tyre. Ka ca që u bënë perandorë, sepse ishin fizikisht gjigandë apo që humbën mbretërinë, sepse ishin të deformuar fizikisht. Ka të tjerë që i mbuluan cilësitë që kishin në ngjashmërinë fizike me profetët e imagjinuar. Ka të tjerë që përdorin dhunën e paskrupullt dhe bëjnë shtete që janë jetëgjata. Ka të tjerë që i drejtojnë popujt e tyre drejt shkatërrimit. Në fund të fundit, udhëheqës është ai që mbledh një grup njerëzish dhe i vë të punojnë për arritjen e një qëllimi që konsiderohet prej tyre legjitim apo që nuk vihet në dyshim.

Por në kohët moderne nuk mund të ketë më udhëheqës si të kohëve të vjetra. Dikur mblidhje një bandë, disa klane, disa fise dhe me forcën e keltëve, vandalëve, gotëve e hunëve, shkatërroje e plaçkisje një perandori. Dikur mblidhje një tufë fisesh e bëje një perandori si mongolët apo arabët, turqit apo edhe një shembull që e kemi nga historia jonë, merrje nja 8000 shqiptarë, pushtojë Egjiptin dhe e bëje pronë të familjesm siç bëri Mehmed Ali Pasha. Në kohët moderne nuk mjafton të kesh mbështetje nga populli, grupi, masa, apo banda. Veprimtarinë duhet ta zhvillosh në një shtet të caktuar. Shtetet janë struktura që kanë njohje në nivelin ndërkombëtar dhe kur je shtet i vogël, shumëçka varet nga fuqitë e mëdha. Çfarëdo që të bësh si udhëheqës do ta bësh brenda një shteti të caktuar. Mbështetja duhet të vijë nga shumica e popullit që jeton në një shtet. Dhe shumica e popullsisë së një shteti ka gjithnjë elementë të përbashkët që një lider mund t'i përdorë për të mobilizuar njerëzit. Prandaj udhëheqësit e popujve të vegjël klasifikohen ndryshe nga udhëheqësit e tjerë në histori.

Ajo që e bën dallimin, është objektivi i pandryshueshëm i një grupi të dhënë. Tani nuk është aq e lehtë për udhëheqësit të krijojnë grupe si duan ata. Lufta e tyre duhet të bëhet për të mbajtur bashkë një grup që kontrollon shtetin, që identifikohet me shtetin dhe që i shërben shtetit, sepse e konsideron shtetin si të vetin. Udhëheqësit janë ata që iu shërbejnë interesave të grupit, në këtë rast, të grupit që duhet të kontrollojë shtetin dhe që lufton për kontrollin e shtetit. Ky grup është i mpiksur, i krijuar me kohë, përpara se udhëheqësi të dalë në skenë. Ky grup ka një histori të vetën. Grupi ka vlera të dallueshme dhe të veçanta të tijat. Ky grup ka një gjuhë me të cilën komunikon e që është e ndryshme nga të tjerët. Ky grup ka një territor, një shtet me të cilin identifikohet dhe e quan të vetin. Ky grup e përzgjedh udhëheqësin dhe nuk e përzgjedh udhëheqësi grupin. Lidhja e njerëzve të tjerë me udhëheqësin është e natyrshme, i ka rrënjët në të shkuarën e përbashkët dhe grupi mpikset natyrshëm rreth këtij udhëheqësi. Shpesh

ai shpreh vullnetin e popullit në politikë e disa herë imponon vullnetin e tij mbi popullin e vet. Kjo ndodh herë për mirë, herë për keq.

Tash në kontekst të shtetit - komb, kur duhet të funksionosh si udhëheqës në një grup të caktuar, ka dy lloje udhëheqësish. Një palë janë burrat e shtetit, ata që shohin të mirën e përbashkët të të gjithë qytetarëve. Pala tjetër janë ata që shohin interesin e tyre dhe që duan të përdorin mbështetësit për të mbërritur qëllime që nuk janë qëllimet e kombit dhe të shtetit. Një palë shërbejnë, një palë përdorjnë. Një palë janë zare të dikujt dhe i përdorin popujt e tyre si zare. Një palë bëjnë atë që munden e mbeten në histori. Një palë i drejton interesi. Një palë i drejton ideologjia. Një palë janë të kapur nga të tjerët dhe përdorjnë popullin e tyre. Një palë bëjnë gjithçka për të mbrojtur ineteresat e popullit të tyre. Një palë vjedhin e një palë kërkojnë nderim e respekt. Një palë janë banditë e kriminelë, sepse e përdorjnë popullin e tyre me ndërgjegje. Një palë janë modele që kujtohen për shumë kohë. Një palë janë zagarë e një palë janë atdhetarë. Një palë janë hajna, cuba dhe kodoshë. Një palë janë shërbyes të dikujt e një palë dhurojnë kohën e mendjen e tyre për interesin e shtetit. Një palë vjedhin të ardhmen e një palë e krijojnë dhe e bëjnë atë më të mirë. Një palë e çmend popullin. Një palë tjetër e mbron dhe e shëron nga e keqja.

E kjo qasje që i vë udhëheqësit përballë burrave të shtetit, aplikohet shumë mirë në rastin shqiptar. Problemi ynë i madh është se kemi shumë shembuj hajnash, cubash, zarash, legësh politikë, bandash të Ali Babës me 400 000 hajdutë, udhëheqës partish e trustesh krimi, mafia katundesh e zonash si Tropoja, Salaria e me rradhë. Problemi është se kemi struktura që mbahen me lidhje familjare, të krimit, të interesave të ngushta që janë në përdorim të hapur të interesave antikom-bëtare e antishqiptare.

Për fatin tonë, ne kemi dy struktura që janë të domosdoshme për mbijetesë edhe në mungesë të udhëheqësve të tillë.

Ne kemi një komb që është kombi shqiptar. Ne kemi një shtet që është shteti shqiptar për shqiptarët dhe që duhet të ishte shteti i shqiptarëve. Këto dy pika duhet të ishin pikat e fillimit për çdo udhëheqës që do të bëhet burrë shteti ndër shqiptarët. Problemi është se nuk kemi udhëheqës që iu shërbejnë të gjithë shqiptarëve, interesit të tyre afatgjatë si komb e si shtet, ardhmërisë së fëmijëve e begatisë kombëtare, kultivimit të shpresës e të ndërtimit të një jete më të mirë për të gjithë.

Për fat të keq, edhe këto zgjedhje shqiptarët i kanë humbur pa u zhvilluar. Për fat të keq edhe në këto zgjedhje do të kemi shumë udhëheqës, një turmë udhëheqësish që bëjnë zhurmë si legenë. Asnjë burrë shteti.

PROBLEMI I LIGËSISË NË POLITIKËN SHQIPTARE

Çfarë është ligësia? Ligësia është diçka që bën dëm e bën keq, diçka që nuk është e pajtueshme me zhvillimin normal të genies dhe çon deri në shkatërrimin e saj. Jo më kot problemi i ligësisë është një problem që i ka munduar teologët e të gjithë feve, sepse dikush duhet me shpjegue nëse Zoti e ka krijuar vetë të keqen e ligësinë, apo se nuk ka qenë i aftë ta ndalojë zhvillimin e saj e prandaj fuqitë e tij janë të kufizuara dhe ka diçka mbi vetë Zotin. Në të njëjtën mënyrë, prania dhe efektet e ligësisë, kësaj here si problem politik, i kanë munduar të gjithë studjuesit e shoqërive njerëzore. Asnjë shoqëri nuk është e përsosur. Pritshmëria se do të ketë një nivel të lartë përsosmërie në shoqëri, edhe në projektet utopike, sigurohet shpesh me izolimin e një shoqërie të caktuar nga të tjerët.

Në rastin e një shoqërie normale, e mira dhe e virtytshmja mbisundojnë të keqen e ligësinë. Ato janë të dënueshme me ligje e me norma morale. Hajnat, vrasësit, të korruptuarit e të gjithë që sillen në mënyrë të ligësht e të keqe, dënohen, ostracizohen, izoloohen, burgosen, apo dëbohen nga shoqëria. Përmes ritualeve të veta, normave morale, sistemit të nderimit e të shpërblimit, të mirënjohjes e të seleksionimit, shoqëria përzgjedh atë që është e mirë, e dobishme, e vyeshme, e drejtë dhe e pranueshme për të gjithë e për të mirën e përbashkët. Kështu ndërtohen sistemet shoqërore ku njerëzit e pranojnë rendin shoqëror dhe i binden ligjit, sepse në mos tjetër, shprehimisht ligji është ndalesa e së keqes. Forca dhe dhuna përdoren për të ndaluar të keqen e ligësinë, për ta përjashtuar atë dhe manifestimin e saj nga jeta publike e shoqërore.

Problemi i ligësisë në shoqërinë shqiptare

Në rastin tonë, prania e ligësisë në procesin politik është masive dhe influenca e ligësisë është tejet komplekse.

Së pari, ligësia dhe e keqja është e gjithkundgjindshme në sistemin politik shqiptar.

Së dyti, ligësia ka përcaktuar moralin sundues dhe vlerat e shoqërisë shqiptare.

Së treti, kjo prani kaq hegjemonike dhe sunduese e ligësisë, si në vlera ashtu edhe në funksionimin e shoqërisë e ka vënë shoqërinë shqiptare në një hulli krejt tjetër nga shoqëritë e tjera normale.

Së katërti, natyrshëm duhet shtruar pyetja a duhet bërë gjë dhe nëse po, si duhet vepruar?

Normaliteti i ligësisë dhe i të keqes

Së pari, në rastin tonë gjatë tranzicionit drejt askundit dhe si askund tjetër, shoqëria shqiptare nuk ka çka me tregue si mbërritje e kultivim të së mirës e të virtytit. Ekonomia kombëtare është e shkatërruar dhe pasuria kombëtare është shpërdoruar. Një milion e gjysëm shqiptarë janë detyruar të emigrojnë. Këta ishin gjysma e popullsisë shqiptare. Tani po kthehen si njerëz me duar të arta, profesionistë, por që janë shpirtna të humbur, pa të ardhme, pa të shkuar e pa shpresë, sepse mërgimi i ka thyer dhe në shtetin shqiptar nuk gjejnë më asgjë. Shoqëria është e fragmentarizuar dhe nuk ka as elementët bazë të një morali të shëndoshë që ta mbajnë bashkë. Kriminalizimi është në rritje. Të gjithë janë përfshirë në rrjetën e sjelljes së pandershme, sepse nuk funksionohet ndryshe. Materializmi është bërë ekstrem. Paria sunduese janë monstra të nivelit më të ulët që mund të gjendet.

Kur e sheh nga jashtë, shoqëria shqiptare duket si një kamp përqëndrimi ku njerëzve iu është dhënë vetëm një mundësi; të hanë njëri - tjetrin dhe të shpresojnë se atë vetë do ta hanë

të fundit. As dreqi nuk do të kishte punuar me kaq kujdes për të ndërtuar këtë sistem që ka ndërtuar paria e Tiranës. Ligësia është bërë normale, ligësia është parimi mbi të cilin funksionohet, shteti dhe strukturat janë në shërbim të ligësisë. Më e shumta që mund të bëjë njeriu i ndershëm, i moralshëm dhe i drejtë, ai që don të mirën për veten dhe për të tjerët, është të ruajë veten e familjen e vet. Ata që besojnë drejtohen te feja. Ata që nuk besojnë, jetojnë në heshtje. Ata që s'durojnë gjejnë në një rrugë e sikterisen në mërgim. Dhe nga sipër e nga larg, duket sikur ligësia ka triumfuar në shtetin shqiptar.

Ligësia dhe morali shoqëror në shtetin shqiptar

Së dyti, ligësia ka përcaktuar moralin e pranueshëm shoqëror dhe normat në bazë të të cilave funksionon shoqëria shqiptare dhe shteti. Me vjedhë, me grabitë, me rrënue, me poshtërue, me degjenerue e me zvetënue, janë praktika të njohura. Shoqëria shqiptare është shoqëri e kriminalizuar deri në thelb. Në dukje me buzëqeshje me fjalë të ëmbla “respekte zotëri”, por me thikë pas shpine e me poshtërsi. Gjithçka e ka një çmim dhe gjithkush e din çmimin që ka njeriu dhe veprimi. Krimet që janë bërë nuk kanë fund e nuk kanë të numëruar.

Dhe më e keqja është se të gjithë kanë brohoritur e brohorasin kriminelët e banditët, veglat dhe cubat, hajnat e trafikantët. Askush nuk flet. Edhe kur krimi ndodh para syve. Të gjithë vjedhin. Vjedhin vota. Vjedhin prona. Vjedhin jetë. Vjedhin të ardhme. Vjedhin shpresë. Të gjithë vrasin. Vrasin me grurë kanceroz. Vrasin me qumësht të helmuar. Vrasin me ndotjen e ambientit. Vrasin me injorancën e mungesën e edukimit. Vrasin me dëbimin masiv të njerëzve. Vrasin edhe me shkëputjen me dhunë të njerëzve nga trualli e nga vendi i tyre. Dhe morali shoqëror që thotë se ligjin e bën i forti, ka legjitimuar poshtërsitë, krimet veset, ndyrësitë, veshjet, sjelljet, normat morale e modelet, se me që ra fjala, sonte është Zhigoloja te Big Brother, që do t'i mesojë shqiptarët se si të

bëhen lojë për seks në tokat e në vendet e huaja. Në sipërfaqe duket se ligësia ka triumfuar, se ka dalë llumi i parisë mbi ujë. Por tashmë shqiptarët nuk pajtohen më me këtë sjellje. Nuk përzihen uthulla me vajin dhe shqiptarët nuk e pranojnë këtë moral, veçse nga halli që i ka zënë.

A jemi një shoqëri normale?

Tashti që të kuptohet qartë, ligësia është si kanceri. Trupi funksionon në një mënyrë të caktuar. Por në një moment të caktuar dobësie, një nga qelizat shkon e zë vend në një vend ku ka qenë një plagë dhe aty fillon luftën kundër trupit të vet. Kjo qelizë bëhet armiku për vdekje dhe ajo lufton deri sa e shkatërron vetë organizmin. Ky është kanceri. Po ta përkthejmë këtë në nivelin e shoqërive, ne jemi një shoqëri që na ka zënë kanceri i Poshtërsisë dhe i Ligësisë. Plaga që gjeti qeliza jonë e keqe, paria e Tiranës, ishte dhembja që kishim përjetuar gjatë sistemit të kaluar, mjerimi material e zhveshja nga normat e moralit normal të një shoqërie normale. Ata panë një mënyrë për t'u pasuruar e për të shfrytëzuar një popull që ishte tërësisht i lodhur dhe i çoroditur. Dhe deri këtu duket se kanë triumfuar.

Problemi është se në shoqërinë e kombeve ne nuk dukemi një shtet normal. Askush nuk na trajton si normalë. Askush nuk na respekton. Askush nuk na nderon. Pasaporta jonë nuk ka vlerë. Na shohin kudo që shkojmë si prostituta e si kodoshë, si trafikantë e si njerëz që nuk e njohin ligjin, si vrasës e si hajna, si një plagë kanceroze në brinjë të Evropës.

Lufta kundër kancerit bëhet që të mbahet izoluar. Ne na kanë izoluar këtu. Sa e panë se vizat po shpërdoroheshin, na thanë do t'i heqin. Sa e ndjenë veten keq ekonomikisht, nisën të na dëbojnë nga Evropa. Sa e shohin se edhe ne jemi pajtuar me të keqen, nisin të na izolojnë edhe një herë që të hamë veten. Evropa e njeh mirë ligësinë dhe e din se asnjë trup njerëzor, asnjë qenie, asnjë shoqëri, asnjë shoqëri kombesh nuk do të

mund të jetojë pa të keqen. Po prej aty ku janë ata, ne jemi kanceri i tyre dhe ligësia. Jemi edhe e keqja e domodoshme, sepse nga diku duhet të vijnë drogat, femrat që kërkon Berluskoni dhe që ia premtton Sali Berisha, pushtët, kodoshët, mishi i bardhë, armët, vrasësit dhe i gjithë llumi i shoqërisë. Çdo shtëpi e ka një gjiriz dhe ligësia e parisë së Tiranës na ka shndërruar ne në gjirizin e Evropës.

Ligësia dhe e ardhmja e shqiptarëve

E keqja mendohet gjithnjë si diçka që është përjashta nesh. Imazhi që kemi për të keqen është sikur Djalli vjen të fusë njeriun e mirë në ngasje. Por e keqja është ndryshe. E keqja vjen në trajtën e njeriut më të afërt e më të dashtun. Lisi çahet me pykën e vet, trupi njerëzor sëmuret nga qeliza e vet dhe shoqëria bëhet e ligë kur një qelizë fillon luftën kundër saj. Qeliza që lufton kundër trupit të shëndoshë të shqiptarëve, janë paria e tyre sunduese.

Nëse nuk bëhemi një shtet - komb normal dhe nëse Evropa nuk do të mund të na izolojë, është vetëm çështje kohe para se të konsiderohemi si rrezik vdekjeprurës dhe të gjenden rrugë për të na minimizuar në numër, për të na bërë të pafuqishëm, për të na izoluar dhe për të na lenë të hamë njëri - tjetrin. Edhe kanceri vetë vdes, kur i vdes një pjesë e qelizës. Në rastin tonë, kjo pjesë e keqe që duhet hequr është paria e Tiranës. Njerëzit tanë janë të mirë dhe këtë e shohim kur iu jepet mundësia të jenë të mirë. Edhe ata që në shtetin shqiptar sillen si llumi i botës, kur dalin jashtë ulin kokën e sillen siç duhet, se ka ligje e rend, sepse ne e njohim ligjin dhe funksionojmë në shoqëritë që kanë moral dhe nuk pranohet të sundojë e keqja.

Këto zgjedhje i kemi të humbura, sepse paria e ka ndarë lojën dhe do të fitojë. Këta janë marrë vesh bashkë që të mos ndalen, deri sa trupi i kombit të kthehet në një kancer gjigand. Por është koha, gjithnjë është koha, me kthye rrugë, me pa nga e mira, nga normalja, nga e moralshmja, nga e dhura. Kurrë

nuk është vonë me ndërrue rrugë dhe me u ba një shoqëri si gjithë të tjerat, një komb si gjithë të tjerët, një shtet si gjithë të tjerët. Ligësia nuk duhet lejuar të triumfojë. Ajo nuk ka triumfuar plotësisht as në shtetin shqiptar, edhe pse duket sikur ka dalë mbi ujë, sepse masa e madhe e shqiptarëve dinë si të sillet me nder. Masa e madhe e shqiptarëve e dinë ç'është frika. Ne jemi një popull që është ngritur në këmbë me një ngritje gishti nga një polic në stadium. Ndoshta kjo që ka ndodhur e po ndodh është vetëm një reaksion ndaj asaj të keqeje që përjetuam e që na ka hequr trurin.

Por koha është për reflektim. Duhet të dalim nga mendësia e kampit të përqëndrimit. Ligësia që po shfaqim mund të jetë e kushtëzuar nga situata ku jemi. Në kampet e përqëndrimit edhe njerëzit më të mirë e më të moralshëm janë sjellë si bisha. Ndoshta po të bëjmë shtetin e duhur, po të vendosim moralin e rendin e duhur shoqëror, ligësia që po na sundon do të vdesë si kanceri që nuk e duron terapinë e fortë dhe tkurret e tkurret, deri sa vdes. Dhe atëherë njëriu kupton sesa e rëndësishme është mos me e lanë të keqen me triumfue dhe me na hangër së gjalli.

ZGJEDHJET DHE MANIPULIMI I NDASIVE TË RREME POLITIKE

Një ndër mësimet e mëdha që tregonin pleqtë e urtë, ishte një mesele, (parabolë biblike apo rrëfenjë popullore) që me fjalë të përmbledhura tregohej kështu!

Në një katund jetonte një familje që kishte ba veç mirë. Gjithë të tjerët ishin të dalë dore me të 99 - tat, pak a shumë si puna e 99-shave dhe e njëshave tanë sot. Perëndia kishte vendosë me i ndëshkue të këqinjët, por meqë plaku e familja tij kishte ba veç mirë, e paralajmëroi që uji i kronit të katundit do të mallkohej e ndaj të mos pinte në të. Kush pinte, bëhej budall. Duke qenë njeri i mirë, plaku i lajmëroi të gjithë bashkëfshatarët të pinin vetëm ujë nga pusi që ai e kishte hapur për familjen e vet. Nuk e dëgjuen, thanë “ky plak nuk po din çka flet”. Kur i mori etja, u turrën e pinë ujin e kronit të katundit dhe luejtën mendsh të gjithë. Plaku që pinte ujë më vete, në pusin e tij, e shikoi gjendjen. I gjithë katundi kishte rrok lodrën dhe kërcenin në marri... Atëherë i vuri në rresht të vetët, “robt e shtëpisë” dhe i çoi me pi ujë edhe ata se “nuk ban me u da shokësh”.

Morali i kësaj fabule rreh të thotë se njeriu duhet të bëjë si bëjnë të gjithë, sepse nuk jetohet vetëm. Po luajtën mendsh të gjithë, duhet të luash mendsh edhe ti, sepse në vetmi jeta bëhet e padurueshme. Por kur bëhen të gjithë budallenj nuk ka më të vërtetë dhe realitet. E vërteta dhe realiteti është marrëzia ku jetojnë të gjithë. Marrëzia ndjek logjikën e vet dhe

realiteti duket pikërisht ai që nuk është e që nuk duhet me kenë.

Përse nevojitet kjo mesele?

Sepse pikërisht këtë synon të arrijë para e Tiranës dhe për arritjen e këtij qëllimi po punon shumë ethshëm.

Problemi i përsëritjes së veprimit si marrëzi

Në çfarë gjendje jemi ne dhe si e shohim realitetin ku jetojmë? Ne na ka harrue fati me kohë, e një kohë e kemi pasë harrue edhe ne, por kur sheh çfarë marrëzish po bajmë si komb, nuk kuptohet si është e mundur të ndodhë kjo gjë. Sepse shenja e marrëzisë nuk është tjetër, pos përsëritja ma shumë se dy herë e një veprimi të gabuem e që të shkakton dam e dhembje. Dhe ne kemi shumë herë që përsërisim të njëjtën gjë.

Cilat janë shenjat e marrëzisë sonë? Një njeri që shkatërron pasurinë e tij, të gjithë e quajnë budalla, kurse ne e aprovojmë jo vetëm kur shkatërron pasurinë e tij, por edhe tonën, pasurinë kombëtare. Një njeri që shet motrën e tij, të gjithë e quajmë kriminel, e pra ka shumë shqiptarë që kanë shitur shqiptarët dhe ne iu bëjmë vend në tavolina. Këta që zgjedhim janë shefat e kriminelëve. Një njeri që vjedh miliona i themi “zotni” në vend që ta varim në shtyllën më të parë, por ne i kemi lënë këta banditë të vjedhin miliarda. Një njeri që shitet te gjithkush, ne e quajmë “të fortë”, i bëjmë temena edhe kur forcën që ka, ai e përdor me na zvetënue e me na degjenerue fëmijët e të ardhmen. Një njeriu që mbledh një bandë me cuba, ne i japim votën, ia shesim të ardhmen e fëmijëve tanë dhe e quajmë “trim”. Dikujt që vë një copë dërrasë te një ndërtesë, “Universiteti i Marrëzisë”, vë vjehrrën sekretare e ka vetëm një printer me ngjyra, ne i paguajmë paratë për një copë letër që ai thotë se është diplomë dhe ne e besojmë. Dikush që mbloshi paratë e njerëzve në një thes, e quajti atë bankë, e hodhi në sup e krisi iku, ne i besuam dhe ia lamë paratë në dorë. Emrin

këta figura e kishin jevga Maksude Kadëna, kapteri Vehbi Ali-muça apo “gjenerali i popullit” këpucari Rrapush Xhaferi.

Por ka edhe ma keq. Nuk ka rëndësi se çka themi me vete e në dhomën e gjumit. Në kafene, në rrugë, në miting, në punë, në takime e në dasma themi pikërisht atë që duan këta. Marrë-zia e një populli nuk ka brina. Marrëzia është me ba atë që të ban dam, me e përsëritë gabimin dhe mos me u mendue dy herë a është mirë a keq. A nuk po bëjmë ne kështu?

Meqë lista e çudirave tona është bukur e gjatë, po ndalem te një nga më të jashtëzakonshmet që kemi bërë. Çdo katër vjet ne zgjedhim të njëjtët kriminelë e banditë të parisë së Ti-ranës në krye të shtetit. Edhe kur na trafikojnë familjarët, ne i zgjedhim. Edhe kur na shtyjnë në krim, ne i zgjedhim. Edhe kur na vrasin e na vjedhin, ne i zgjedhim. Edhe kur na bëjnë me u sjellë si llumi i botës, ne i zgjedhim. Edhe kur na mashtrojnë, edhe kur na poshtërojnë, ne prapë i zgjedhim. Edhe kur na fusin në borxh, edhe kur e shesin pasurinë kombëtare, nderin e të ardhmen tonë, ne prapë i zgjedhim. Edhe kur e kanë kthyer vendin në një motel njëorësh gjigand, në prapë i zgjedhim. Edhe kur dalin si Sali Berisha e Ilir Meta pas zgjedhjeve e baj-në koalicion pikërisht ata që e quajtën njëri - tjetrin “spiu të serbëve”, “klani i Zemunit”, “të shitur”, ne prapë i zgjedhim. Bile i duartrokasim dhe i brohorasim. E sajta herë është që ne i zgjedhim këta? Ç’ka duhet të bëjnë këta banditë që shqiptarët të mos thonë në klub “osht mbret Sala, mbret,” apo “Edi, ti je njish”, “është flori Iliri, ua futi të gjithëve”? A nuk është ky veprim një budallallëk, pavarësisht nëse është i qëllimtë apo jo?

Përgjigjen duhet ta nxjerri vetë lexuesi. Për mua është budallallëk të shkosh më këmbët e tua dhe të votosh për krimi-nelin që të ka marrë jetën, nderin, të ardhmen, pasurinë, fy-tyrën, që ka si qëllim me të skllavnue për jetë. Shihe vetëm një aspekt të sjelljes së tyre. Këta na çmendën duke folë për integrim dhe duke na tundur para syve të ardhmen tonë në Evropë. Po kurrë nuk ka pasë Evropë për ne. Tash nga qeveri e integrimit thonë se duan të jenë qeveri e punësimi. Po çfarë

punësimi!? Në shtetin shqiptar ka një milion të papunë. E vërteta është se paria e Tiranës janë një tufë banditësh me mendjen te skllavërimi.

Objektivi i marrëzisë kolektive

Edhe marrja e poshtërsia e sjelljes së parisë e kanë një logjikë të vetën. Objektivi është skllavërimi i shqiptarëve përmes manipulimit. Për shembull, Sali Berisha shkoi në një forum ekonomik ku ishin shumë ekspertë të ekonomisë botërore dhe iu tha se do të mbillte 1 250 000 rrënjë arra. Ata panë njëri - tjetrin dhe tundën kokën. Mënjatë e privatisht e quajtën *baudet* domethënë “zog gomarit” që shqiptohet “bode”, si emri i ministrit që ka studjuar në Francë si edhe Sala. Sali Berisha thotë marrina, por nuk është krejt i marrë, anipse është krejt i pacipë. Saliu nuk po iu fliste të huajve, Saliu po iu fliste katundarëve të vet që nga Parisi. Dhe me mendjen katundare, të shkretët që e dëgjonin nga ekrani u bindën se ky që ua thotë edhe të huajve, e ka seriozisht që do të mbjellë 1 250 000 rrënjë arra. Tjetër muhabet se preu dy mijë rrënjë arrat që kishim dhe ministri që ka edhe sot në qeveri i shiti në vitin 1992. Sot po pritet të mbjellë 1 250 000 arra që duan njëzetë e pesë vjet me dhanë prodhim(!?) S’ka mbjellë asnjë rrënjë. Por ai thjesht mendon për manipulimin kolektiv, jo për arrat. Kjo sjellje është ilustrim i përsosur i sjelljes së parisë dhe kultivimit të marrëzisë kolektive ndër shqiptarët.

Edhe këta të tjerët thonë marrina, por ashtu si Saliu, nuk janë aspak të marrë. Edi Rama del e thotë se shkoja gjashtëmbëdhjetë vjeç e kaloja një orë në ditë te bunkeri. Ilir Meta e flet për zhvillim në një *call center*. Kujt i flasin? Në mendjen e tyre, këta iu flasin të marrëve, atyre që nuk kuptojnë, të dje-gurve për seks, atyre që nuk mendojnë, atyre që e hanë sapunin për djathë, katundarëve të pagdhendur, shpellarëve e malokëve të jugut e të veriut.

Djemve e vajzave të uritura të getove të katundeve gjigan-

de, këpurdhave ndërtimore në qytete që nuk kanë të ardhme tjetër veç epsheve të mishit. Në mendjen e tyre këta i flasin popullit “pis” shqiptar, sepse kështu i “don mushka drutë”, se “kështu e lypin këta” e me radhë.

Teknika e polarizimit dhe zgjedhjet

Por kur vjen puna te zgjedhjet, djallëzia e tyre mbërrin ekstremin e mundshëm. Këta i bëjnë njerëzit me votue për ta me entuziazëm. Askush më parë nuk e ka mbriritë këtë. Enver Hoxha të vinte në rresht, të fuste në burg dhe e kishe entuziazmin nga halli. Këta të bajnë me shkue me kambët tuja në qendrën e votimit. E duhet me ua shpjegue njerëzve mekanizmin qysh po ua hedhin trutë e marrisë këta jeniçerët e cubat e Enver Hoxhës. Teknika quhet polarizim. Me e përkthye me gjuhë popullore don me thanë “kur rrahen dy vetë, fiton i treti” e latinisht, *divide et impera*. Kur rrahen dy palët e shqiptarëve, fiton paria. Se kur fillojnë e rrahen dy vetë, nuk pyetet ma se kush e filloi sherrin, objektivi është me rrahë kundërshtarin.

Thelbi i lojës politike që luhet në Tiranë është ndarja e njerëzve në mbështetës e në kundërshtarë për vdekje të palës tjetër. Në këtë mënyrë, të dy palët e parisë, që vetë bien dakord për gjithçka, ia arrijnë t’i ndajnë njerëzit dhe t’i mobilizojnë mbështetësit në luftën me kundërshtarët në këtë lojë që shihet edhe diku tjetër. Por në rastin shqiptar manipulimi i ndasive dhe polarizimi është krejt i rremë dhe një lojë e parisë. Megjithatë, janë pesë paradokse që habisin gjithkënd që merret me shqiptarët, përveç vetë shqiptarëve që mendojnë se ky është normaliteti gjithkund tjetër.

Së pari, vet paria e Tiranës nuk beson në këto ndasi. Shembulli më i qartë jepet nga lufta e paskrupullt mediatike që Sali Berisha i ka bërë Bllokut dhe komunistëve. E megjithatë, kur mbaruan zgjedhjet ai u turr të bënte koalicion me Ilir Metën dhe u tha mbështetësve se “e gjithë ajo që kam thënë ishte për fushatë. Nuk e kuptuat ju?”. Këta mbetën gojëhapur, iu

hyri dhe iu doli miza nga goja, po as që e ndienë. Ishin krejt të topitur. Të gjithë e kuptuan që Saliu luajti e luan me ta dhe i konsideron budallenj, por e vetmja ankesë që kishin ishte se... “i dha ma shumë përqindje Metës”(!) Ajo që nuk duhet të harrohet është se me gojën e tyre edhe Edi, edhe Saliu e kanë pranuar se sundojnë me marrëveshje. Të gjithë palët e dinë si do të veprojnë edhe në këto zgjedhje. Kanë bërë marrëveshje dhe ka mbaruar ajo punë. Vetëm bëjnë cirk për të argëtuar shqiptarët edhe nëntëdhjetë e nëntë ditë të tjera, deri në ditën e votimit.

Së dyti, ky paradoks është thelbi i lojës. Baltosen në publik, po japin shfaqje, sepse merren vesh për bukuri. Kjo është një teknikë e njohur që nga koha e fletërrufeve. Shante vëllai - vëllanë e mandej shkonin në shtëpi e qanin bashkë. Këta shahen, rrahen, mbushin xhepat e mandej qeshin e tallen me në të tjerët. Si e dimë këtë? E thjeshtë fare. Të gjithë u morën vesh për kodin zgjedhor, për ligjet, për numrin e deputetëve në qarqe, për listat, si dhe... për të vjedhur votat e partive të tjera. Kush ka hyrë në burg në shtetin shqiptar për të tilla punë? Askush! Kush u verifikua dhe shkoi në burg? Askush! Kush do të shkojë në burg? Askush! Këta mbyllën Gërdecin, 21 janarin e lista është e pafund. Këta janë bashkë.

Së treti, këta kanë krijuar një atmosferë mbytëse që e ka çuar shoqërinë në një nivel marrëzie kolektive e injorance të frikshme. Masa e komentatorëve injorantë, të shtirë e të shitur, prashisin pa ndërprerë llomotitje në televizione e gazeta. Nuk kanë të numëruara gafat, marrëzirat, poshtërsitë e budallallëqet e tyre. Ja, për shembull, në vend që të merren me hallët e vërteta, me borxhet, me ekonominë, me dështimin e integritimit, me mungesën e shpresës për të ardhmen, me brezat e humbur, me papunësinë, me emigrantët, me shpërdorimet, korrupsionin e me rradhë, këta merren me... komentin e Zhejit, batutën e Batonit apo paragrafin e fundit të Shkullakut të “MAPO”. I sheh gjashtë burra, apo më mirë gjashtë vetë, që grinden tri orë, “ky fiton, jo ai fiton, e pe këtë, ky tha, jo po

se e tha”, e me radhë. Tri orë të tëra bombardojnë shqiptarët e shkretët me marrinë e tyre, me deklarata pompoze dhe i bindin se zgjedhja është ose njëri, ose tjetri. Nuk thotë njeri veç Fatos Lubonjës, që ndodh ta harrojë fillin e mendimit dhe ndaj me qëllim ia presin shpesh fjalën, se zgjedhja e vërtetë është kundër të gjithëve. Këta janë të gjithë në një tavë, por po thjesht mundohen të përçajnë shqiptarët.

Së katërti, provë është edhe kriminalizimi, korruptimi, sjellja e jashtëligjshme. Përmes pronave, investimeve, lidhjeve e punësimit, paria e Tiranës i polarizon njerëzit. Kjo është mënyra me të cilën katundari lidhet me shtetin. Do punë? Duhet të shkosh te sekseri i parisë? Do të legalizosh shtëpinë? Shko te filani. Do të të fitosh ndoj lek? Shko te filanja. E me radhë. Prandaj këta mbajnë gjallë e më këmbë një shoqëri të jashtëligjshme, me prona të vjedhura, të palegalizuara. Këta e dinë se për sa kohë nuk i ka letrat në xhep, katundarin nuk e zë gjumi. Ajo shprehja “qeveria e zë lepurin me qerre” i përmbledh të gjitha. Katundarët tanë mbahen për atë të shkretën pronë. Duke mos ua legalizuar (dhe nuk do t’ua legalizojnë se nuk janë aq budallenj), paria e Tiranës janë duke i ngrënë të gjallë katundarët dhe pronën e tyre. Paria e ka planin, por katundarët ende nuk e kanë kuptuar siç duhet. Si gjithnjë do ta kuptojnë kur të jetë shumë vonë.

Së pesti, ëshë paradoksi i kultivimit të mendësisë tribal - katundare. E vetmja mënyrë me zgjidhë punët dhe me mbijetue është me u mbështetë pa kushte e deri në fund te lidhjet që ke. Dhe lidhjet më të forta janë familja. Duke e mbajtur shoqërinë varur si vile rrushi, paria i ka detyruar të gjithë të futen në kallëpë që ua vjedhin dinjitetin dhe nuk i lënë të jenë njerëz. Të gjithë e kanë dikë që është ndërmjetës me parinë. Ai kryen punë për gjithë bashkësinë. Shpesh është njeriu më i ndytë i familjes apo i fisit. Prandaj ndodh që shkon Fatmir Mediu te “Shoqata dibrane” e flet për bashkim. Nuk pyet Fatmir Mediu as për shqiptarët, as për bashkimin e as për dashurinë midis shqiptarëve. Mediu ka ende një thes me kocka për të

ndarë dhe prandaj të gjithë u ngritën në këmbë dhe e duartrokitën. Fatmir Mediu është as më shumë e as më pak, një bandit e kriminel ordiner që duhet të përgjigjet për shumë krime që ka bërë, Gërdeci e me radhë, sepse ishte ministër kur ndodhi hataja.

Së gjashti, ndarja në komunistë - antikomunistë. Edhe dje gazeta e shplarë "RD", (*Rivdekja Demagogjike*) kishte një artikull për Marks. Po kush nga paria pyet për Marks? Këta e kanë harruar edhe Marks, edhe Enverin që i polli. Këta e shohin veten zotni, kapitalista. Këta besojnë te shfrytëzimi, kanë vënë miliarda, nuk kanë pyetur kur janë vlarë e prerë shqiptarët. Këta nuk e kanë këtë rrahje seriozisht. Sepse kur shqiptarët vazhdonin të thonin "ti je komunist", "jo, ti je komunist", "unë jam i persekutuar", jo, "ti s'je", këta ndërtonin pasurinë e tyre. Kjo ndarje nuk ka më vlerë. Se ka njëzetë e tre vjet që dikush që ka bërë burg se e kanë zënë duke vjedhur pula, tani na shitet si i persekutuar dhe ka njëzetë e tre vjet që unë e të tjerët nuk kemi vend në shtetin tonë. Por paria e përdor këtë lojë, sepse ka arritur të ndajë njerëzit dhe t'i mobilizojë në bazë të kësaj ndasie kaq paradoksale, sa i habit gjithë të huajt. Ndarja e vërtetë është në miliardet e parisë dhe në shqiptarët e shfrytëzuar, të papunë, pa të ardhme, pa shpresë. Ja edhe një shenjë tjetër e marrëzisë kolektive.

Pse ndodh kështu? Kjo i intereson parisë. Thelbi i teknikës së polarizimit apo i kultivimit të ndasisë politike, është të bindësh tjetrin të besojë në të kundërtën e asaj që është realisht e vërteta dhe interesi real i njeriut. Dhe ia kanë arritur. Tash paradoksi është se ne që e themi të vërtetën, jemi budallenj. Këta duan që ne të bëhemi si ai plaku i mençur që në fund u dorëzua e tha, "edhe ne me shokët". Por i kanë bërë llogaritë gabim. Ne që ikëm kur e dinim se do të ndahej torta e krimit, se do të përfitonim para e prona edhe vetëm po të rrinim urtë, as bëhet fjalë t'i bashkëngjitemi tani lojës së tyre kriminale. Nuk do t'i bashkëngjitemi, sepse ne nuk na duhen paratë e pronat e krimit.

Paria mendon t'ia hedhë edhe kësaj here duke besuar se shqiptarët e hanë sapunin për djathë, se i mban peng për pronat, për krimet, për poshtërsitë, për interesat e vogla dhe duke i shtyrë të luftojnë komunizmin. Atë që kërkon të jetojë me nder, nuk e bën dot budalla. Por në Tiranë, ata kanë gjithçka për të mbajtur njerëzit peng dhe për t'i bindur se realiteti është i pashmangshëm. Kontrollojnë shtetin, vlerat, paratë, mendësinë, median, pronat, punësimin, kafshatën e gojës, komentatorët, analistët, gazetatat, televizionet dhe thashethemnajën gjigande të kafeneve të njerëzve të papunë e pa të ardhme që nuk duan me kenë njerëz, por vdesin me kenë shërbëtorë. Ky është mendimi që ata kanë për ne, prandaj kërkojnë të na manipulojnë e të na përdorjnë edhe një herë tjetër. Më e keqja është se janë të bindur që do t'ia dalin, sepse deri tani kanë qenë shumë të suksesshëm.

Në vend të përfundimit

Në përfundim, unë jam edhe malok, edhe katundar, edhe shqiptar. Mue më dhemb në fund të shpirtit jo vetëm se jam katundar e malok, jo vetëm se jam shqiptar e jo vetëm se jam popull, por sepse e kam familjen time atje, sepse unë e dua popullin tim dhe due me e pa ma mirë se gjithkënd tjetër. Më dhemb edhe ma shumë, sepse unë nuk pranoj me e pi ujin e asaj marrëzie. Por logjika e tyre është se shqiptarët pranojnë çka t'iu thuash. Edhe të huajt kanë nisur të besojnë se këta kanë të drejtë. Kur sheh se ç'kanë thanë, çfarë marrëzish kanë sendërtuar e çfarë poshtërsish kanë zbatuar, kur sheh sesa me afsh i aprovojnë këto marrëzira njerëzit e tjerë, edhe pse si individ ti nuk i aprovon, e kupton logjikën e tyre. Për fat të keq, teknika e kultivimit të marrëzisë kolektive ka funksionue dhe po funksionon përditë.

PARIA E TIRANËS DHE PROBLEMI I AKTIVIZIMIT TË RINISË NË POLITIKË

Problemi i aktivizimit të rinisë në zgjedhjet kuvendore dhe kush do të jetë në mbështetje të njërës apo të tjetrës palë të parisë, është nga problemet që po konsumon shumë kohë dhe energji nga prijatarët e partive politike të parisë së Tiranës. Në çdo emision lajmesh televizive, ose në gazeta sheh prijatarët e rrethuar me të rinj e të reja. Të gjithë iu flasin më së shumti të rinjve, të gjithë sillen sikur fushatën e bëjnë me të rinjtë, për të rinjtë, për ardhmërinë e tyre. Emisione, biseda, aktivitete e festime janë të organizuara për të tërhequr të rinjtë. Kjo ndodh për një numër faktorësh që duhen kuptuar e shpjeguar me qetësi, se paria e Tiranës nuk i hedh as energjitë, as paratë e saj kot më kot. Ata e dinë mirë çka duan dhe sesi mund ta marrin. Fushata e drejtuar ndaj rinisë bëhet kryesisht për disa qëllime, asnjë prej tyre i ndershëm.

Objektivi i parisë së Tiranës

Sali Berisha, është njeriu që ka pasur rininë më të ndrydhur që mund të ketë pasur dikush, sepse ka kaluar nga një konvikt te tjetri si sekretar rinie që në moshën katërmëdhjetë vjeç. Ndërsa ishte në konvikt bëri lutje e hyri në parti në moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Ai e din se besnikëritë politike mpiksen në këtë moshë, ai vetë nuk ka ndryshuar tash pesëdhjetë e pesë vjet që është pranuar në organizatën e rinisë komuniste. Prandaj para tri ditësh doli propozoi të jepet e drejta e votimit edhe për gjashtëmbëdhjetë vjeçarët. Ilir Meta tha të votojnë

edhe ata, sepse e din se po u korruptuan tani, nuk kanë ku ikin më pas për gjithë jetën. Më në fund, sot u shfaq edhe Edi Rama. Tregoi se si dilte nga atelieja kur ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç, si lexonte libra që ngjallnin ndjesi të papërballueshme erotike dhe rrinte një orë jashtë te bunkeri...

Pyetja është pse këta prijatarë të parisë i drejtohen rinisë? Saliu i sheh si vegla elektorale, jo si rini që duhet zhvilluar. Ilir Meta i sheh si numra që duhen përdorur e blerë. Edi Rama i sheh si të rinj, por i sheh të zvetënuar.

Me e thënë shkurt e shqip, mendësia e parisë së Tiranës përmbledhet në këtë konceptim; njeriu zbuti edhe ujkun. Duke i dhënë bukë, ujku u bë qen. Ka ardhur puna që qeni dikur ujk, tash e han me shije edhe qepën, por të zotin e vet nuk e prek. Pse të mos bëjmë të njëjtën gjë me shqiptarët, pse duhet të jenë shqiptarët ndryshe nga qentë? Kështu mendon paria e Tiranës. Nuk e thotë hapur, por veprimet e saj të çojnë pikërisht në këtë përfundim. Po qe se diçka duket si gjarpër, zvarritet si gjarpër, të ngrin zemrën si gjarpër dhe të helmon si gjarpër, është gjarpër. Edhe kjo që po bën paria e Tiranës, nuk ka emër hapur si strategji, por është si puna e gjarpërit. Pa emër, por duket, zvarritet, helmon dhe vret si gjarpëri. Prandaj duhet ta quajmë taktika e gjarpërit. Askund nuk është kjo më e qartë se në lidhjen e parisë me rininë.

Tri jetë rinore paralele

Së pari, duhet thënë se ka tre rini në shtetin shqiptar. Paria vetë i ka nisur fëmijët jashtë shtetit, në universitete e shkolla të shtrenjta dhe i mban larg Tiranës. Shumë nga fëmijët e saj njihen si banditë e vrasës. Shumë të tjerë njihen si të fortët e lagjes, si hajna dhe si rrugaçë. Shumë të tjerë kanë vdekur nga drogat e nga horllëku në Tiranë, por edhe azileve të huaja ku mbahen me paratë e vjedhura shqiptarëve. Shumë nga pinjollët e parisë që kanë zbuluar qejfet e ndaluara, ecin rrugës duke u kruajtur nga sëmundjet veneriane të ndërgjegjshëm

që nuk do të bëjnë dot kurrë fëmijë. Depresioni mendor dhe neveria për nga vijnë, për atë që përfaqësojnë dhe për ku po shkojnë, është një shenjë e qartë se këta pjella të parisë janë konfuzë. Prapë se prapë, një pjesë e tyre jetojnë jashtë dhe kthehen në shtetin shqiptar ose për qejf e zdërhallje, ose për të bërë një grusht para e për të ikur në sikterin e vendit të huaj ku sillen si kukulla të përbuzura.

Por gjithsesi, këta pjella të parisë janë edukuar jashtë, kanë mësuar shumëçka dhe i rrinë larg rinisë së sotme shqiptare. Nuk do të hyjmë të diskutojmë sesi e sesa kanë vuajtur e çfarë përvojash kanë pasur, por të themi se e kanë ndarë veten me një mur nga të tjerët. Muri janë paratë, lidhjet familjare, përvojat që kanë dhe urrejtja që ndjejnë për shqiptarët.

Grupi i dytë i rinisë është masa qindramijra vetëshe e shqiptarëve që janë të dënuar të jetojnë nën sundimin kriminal të parisë së Tiranës. Këta janë ata që rriten nën presionin e frikshëm të mediave të degjeneruara dhe të zvetënuara, me modelet e një jete të shfrenuar, me mungesë të theksuar vlerash morale e ideologjike, materialistë në ekstrem; e çmojnë njëri - tjetrin nga makina, telefoni dhe marka e rrobave. Kjo është rinia shqiptare e atyre që janë diç më mirë, që shkon në universitete ku shiten diplomat dhe nuk merret dije. Shumica janë mësuar të jetojnë si parazitë. Lekët e fundit harxhohen për cigare, për pije a pak marijuanë. Vetë paria i ruan pinjollët e saj. Mundohet e shpesh nuk i lë të bien në kurthin që i kanë ngritur rinisë tjetër shqiptare. Edhe pse këta do të ndjekin modelin e prindërve e do të bëhen ndoshta edhe më keq, prapë se prapë nuk janë nën të njëjtat trysni si shqiptarët e tjerë.

Edhe ky grup është si të gjithë. Rinia shqiptare është e papunë, e paedukuar si duhet, e pashpresë, pa vlera morale, pa ideologji të qartë dhe pa aftësinë e duhur t'i kundërvihet sistemit të sofistikuar të parisë. Ajo nuk ka zgjidhje, nuk gjen zgjidhje tjetër veçse me ikë, ose me u konformue me moralin e me vlerat që ka shoqëria. Shteti, media, struktura e arsimit dhe e edukimit, por edhe mënyra si është ndërtuar kalimi i

kohës së lirë dhe shoqërizimi, janë të kontrolluara prej parisë që ushtron mbi këtë segment të pashpresë rinie, një trysni të frikshme.

Ka një grup të tretë që është numerikisht shumë i fuqishëm dhe ka pjesëtarë nga të gjithë shtresat e sotme shoqërore. Këta të rinj e të reja kërkojnë vlera, rriten në familje ku mësohen të përballen me të keqen dhe të ruajnë moralin e duhur. Këta vij-në nga grupimet ku familjet kanë përqaftuar një sistem vlerash morale, janë të mbështetura në fenë, në traditën popullore, në familjen, në idealizimin e të shkuarës, në ideologjitë moderne dhe në kombëtarizmin. Por ky grup masiv është i fragmentarizuar dhe në jetën publike i mënjanuar. Edhe pse numerikisht është substancial, paria i jep përparësi vetëm rinisë që nuk ka bosht. Kur shihet maskarada televizive, dëgjohe radioja dhe lexohet shtypi, duket sikur e gjithë rinia shqiptare sillet si grupi i jetëve të humbura endur derë më derë me diplomat pa asnjë vlerë të universiteteve të Tiranës. Ky është grupi i rinisë që na jep shpresë, por që është i paorganizuar, i ç'orientuar dhe i braktisur nga ata që duhej ta drejtonin në rrugën e duhur, edhe pse vetë modelet nuk i drejtojnë te shteti, por te bashkësia fetare apo familja. Një shtet - komb është zgjidhja. Modelet që këta emulojnë janë sisteme morale të qëndrueshme, por që nuk e shohin shtetin si strukturën qendrore, si thelbin e identitetit dhe kultivuesin e vlerave të vërteta morale e shoqërore. Deri atëherë, derisa shteti të vihet në qendër të identitetit të tyre, edhe konfuzioni i rinisë do të vazhdojë.

Rinia si problem për parinë e Tiranës

Për parinë e Tiranës rinia nuk është përgjegjësi. Për parinë sunduese të Tiranës rinia është problem politik. Për parinë e Tiranës, numrat janë të rëndësishëm dhe rinia është numra. Nga ana e saj, paria kërkon të tërheqë masën e madhe të të rinjve që votojnë për herë të parë në këto zgjedhje kuvendore. Secila palë kërkon t'i tërheqë në anën e saj.

Shumica e atyre që sot janë në moshën 18 - 22 vjeç, nuk kanë njohur realitete të tjera. Por realiteti shqiptar ku janë rritur këta të rinj e të reja është i frikshëm. Paria po përdor të gjithë ndjelljet e mundshme që nuk i kushtojnë gjë, përkundrazi i rrisin fitimin në biznes, sepse paria i ka pronë të vetën edhe mediat, edhe gazetat, edhe dyqanet ku do të blejnë veshjet e telefonat këta të rinj, edhe vendet ku bëjnë tatuazhet. Sistemi është ndërtuar për të përgatitur masën e skllëveve të ardhshëm e të vetëvullneshëm dhe për t'i bindur të rinjtë se ky realitet është i pashmangshëm.

Teknika që përdor paria e Tiranës është e njëjtë me atë të Hasan el-Sabah, lider i një sektit fetar mesjetar që i merrte të rinjtë, iu hapte botën e qejfit dhe të drogës duke iu thënë se ajo ishte parajsja dhe mandej i hidhte në rrugë. Ary duhej të vrisnin atë që donte ai, se në të kundërt parajsja ishte e mbyllur. Dhe këta bëheshin vrasës e skllëvër të vullnetit të tij, pikërisht sepse kërkonin kënaqësitë me të cilat ishin mësuar ndërkohë e që pa vrasjen e dikujt në emër të interesave të Hasan el-Sabah, nuk do ta gjenin kurrë më.

Paria e Tiranës përdor të njëjtën teknikë, por tashmë më të sofistikuar dhe në shkallë kombëtare. Drogat, kurvnimi, pija, horllëku, qejfi janë përvoja që rinia shqiptare i kalon në një moshë që s'ta merr mendja tjerakund. Kjo mendësi ushqehet nga gjendja tejet e kriminalizuar në të cilën gjindet shoqëria shqiptare, nga propaganda mbytëse dhe e shfrenuar, nga mungesa e një sistemi të moralshëm vlerash mbi të cilin mund të ndërtohet një shoqëri e shëndoshë, nga trysnitë e llahtarshme mbi familjen dhe strukturat e saj, nga presionet e shumta për të pasur standarte të caktuara jetese nga moshatarët, nga paraja e lehtë e emigrimit, nga krimi e droga, nga një konsumim qejfi e seksualiteti i pagjindshëm dhe i papranueshëm diku tjetër, nga një modë veshjeje e denjë për trotuaret dhe nga një inkurajim sistematik i veseve jonormale.

Së pari, realiteti surreal dhe eksperimental shqiptar është jashtë çdo imagjinate të mundshme. Luksi i çmendur i parisë

dhe varfëria ekstreme e shqiptarëve që kërkuan një jetë më të mirë në rrethinat e Tiranës, bashkëjetojnë edhe në Bllok e afër Bllokut. Normat morale, sundimi i parisë, propaganda, shembujt negativë, filmat, emisonet, këngët, veshja, moda etj., etj., e kanë bindur rininë se nuk ka rrugë të tjera. Kështu është vendi ku kanë lindur, ku janë rritur dhe ku jetojnë këta të rinj. Paria lufton t'i bindë se kështu janë e se kështu bëjnë të gjithë. Heqja e çdo kontrolli nga shteti dhe shoqëria, pamundësitë e prindërve me i drejtue në rrugën e duhur, sepse shpeshherë as vetë prindërit nuk janë në rrugën e duhur, legjitimimi i krimit dhe i poshtërsisë e kanë bindur rininë se nuk ka zgjidhje të tjera. Parisë së Tiranës i duhet pikërisht kjo rini që beson se "kanë lindur për qejf", që ndjek modele jetese të mbështëtura në llumet e shoqërive njerëzore. Paria e din se kur të mos kesh moral si njeri, nuk mund të kesh bindje politike për t'i dalë kundër.

Së dyti, paria e Tiranës e ka kuptuar teknikën e kultivimit të lidhjeve dhe dhënien e një kauze politike kot e të padëmshme rinisë shqiptare. Si të nisë të mbështesë një parti të parisë e një grup të caktuar, të bëhet pjesë e rretheve të caktuara, rinia do ta ketë të vështirë të ndërrojë rrugë, do të zhgënjehet, do të bëhet apatike dhe jopolitike. Kështu i duhet parisë. Paria ndjek me vëmendje atë grup të vogël që kanë prirje për militantë dhe për aktivistë politikë. Këta të rinj paria i helmatis mendërisht dhe i josh me punë e me premtime, i deformon duke i shtyrë të mbështesin çështje që i shërbejnë asaj dhe i përdoron pa mëshirë, i cyt për sherr, i korrupton dhe i zhvlerëson deri sa në fund të fundit, edhe këta e humbin shpresën dhe bëhen njerëz të vegjël e vegla të saj.

Së treti, parisë i intereson rinia, sepse ajo lufton të ndërtojë një strukturë ndër breza. Objektivi tjetër kryesor ka mpiksjen e besnikërive politike në këtë moshë kritike. Përplasja fiktive komunistë - antikomunistë, i shërben pikërisht kësaj loje. E shkuara e prindërve bëhet e ardhmja e fëmijëve, partitë e prindërve bëhen partitë e bijve. Paria e din këtë. Për hir të

dashurisë për prindin, të krenarisë që ndoshta është e rreme dhe false, fëmijët duhet të mbështesin partitë e prindërve. Prandaj i mëshohet përmendjes së gjyshërve, gjysheve e me rradhë. Edhe këta të rinj që nuk shohin me sytë e mendjes, por bien pre e ndjenjave familjare dhe dhëmbshurisë për prindin, përfundojnë si vegla të parisë që nuk ka asgjë për me iu afrue.

Së katërti, një arsye tjetër pse parisë i intereson përfshirja e rinisë në politikë dhe në përplasjen për sy e faqe, është se ajo kërkon të shmangë alternativat. Askush nuk mbështet dikë që nuk ka shumë shanse me fitue në politikë. Paria e ka ndërtuar sistemin në një mënyrë të tillë që po të jesh alternativë, je i pashpresë. Nuk gjen punë, nuk gjen mbështetje, nuk ke rreth shoqëror e nuk ke se ku të kapesh. Edhe të rinjtë që e dinë se diçka është gabim, nuk e konceptojnë mundësinë e zgjidhjes alternative. Kur e sheh botën nga Tirana apo nga çdo rreth tjetër, ajo duket shumë e vogël, e keqe, e ndyrë e pashpresë. Pikërisht këtë kërkon paria. Duke i shmangur, mënjanuar e izoluar, ajo po ia arrin të shmangë daljen e alternativave kundër. Alternativa ka, për ta kam folur diku tjetër, por paria ka arritur t'i izolojë e dobësojë ndjeshëm. Në këtë pikë asaj i duhen këta njëqind e pesëdhjetë mijë të rinj që votojnë për herë të parë. Asaj i duhet që këta të rinj ta shohin parinë e Tiranës si të pashmangshme, të pazëvendësueshme, të vetmen zgjidhje që kanë.

Rruga që kemi përpara

Rinia është e ardhmja e një kombi dhe paria e Tiranës edhe në këto zgjedhje, luftën e vet më interesante e ka me rininë shqiptare. Po e theu rininë, sidomos po e zvetënoi dhe po e zhveshi nga ndjenja e shërbimit publik, në një mënyrë a në një tjetër, paria e ka mbërritur objektivin e saj. Pas pak vitesh, këta të rinj nuk do të kenë entuziazmin të punojnë për kombin e atdheun e tyre, por do të mendojnë me mendjen e parisë që do të fusë në matricën e interesave të saj. Dhe si në ras-

tin e të rinjve që përdoreshin lehtësisht nga Hasan el-Sabah, edhe këta të rinj të rënë në kurthin e parisë, do të jenë peng i saj përgjithmonë. Ata nuk do të dinë të dalin asnjëherë nga ai kurth, përveçse si vrasës, trafikantë, banditë e kriminelë që duan të kthehen në parajsën e parisë me çdo kusht e me çdo mënyrë, sepse si thotë ajo kënga në Tiranë, “kena lindë për qef, o kena lindë për qef”.

Të nesërmen që shkrimi doli në *Rrethi i Ferrit* dhe në faqen time në Facebook, çuditërisht në Tiranë filloi debati lidhur me uljen e moshës së votuesve në 16 vjeç. Duke mos dashur të them se këta e kanë lexuar dhe mandej e kanë përsjellur në mendjen e tyre për të bërë më të keqen të mundshme, gjë që gjithnjë pritet nga mendja e djallëzuar e Sali Berishës, sjellja e tyre gjithsesi provon se këta mendojnë si të zvetënojnë, përdorjnë e shkatërrojnë rininë shqiptare. Prandaj për këta nuk mund të ketë mëshirë. Këta janë mishërimi i të keqes në kohën tonë. Për të keqen nuk mund të kesh mëshirë e nuk duhet të kesh mëshirë, sepse kanceri nuk din tjetër veçse me e mbytë trupin që e mban.

ZGJEDHJET DHE PROBLEMI I BORXHEVE TË SHTETIT SHQIPTAR

Shoqëria shqiptare po shkon në këto zgjedhje me një barrë problemesh të frikshme ekonomike, shoqërore, kulturore e politike. Po përleshja e radhës, si gjithnjë është midis prijatarëve partiakë. Megjithatë, kjo sjellje mbulon problemet e shumta e të pakapërcyeshme me të cilat përballet shoqëria shqiptare. Një syresh që prek ndjeshëm të gjithë fushat e jetës është edhe borxhi publik.

Një shoqëri e mbytur në borxhe

Fatkeqësia e vërtetë është se borxhi publik është vetëm njëri nga borxhet që kemi si shoqëri. E gjithë shoqëria shqiptare është e mbytur në borxh. Shteti është i mbytur në borxh. Familjet janë të zhytura në borxh. Bizneset janë në borxh. Shoqatat jofitimprurëse janë në borxh. Organizatat fetare kanë marrë borxhe, nuk ka rëndësi me interes apo pa interes. Shteti iu ka borxh bankave dhe individëve. Bizneset iu kanë borxhe bankave, individëve dhe bizneseve të tjera si në para, ashtu edhe me premtime dhe të huajve. Deri edhe bankat tona kanë borxh një miliardë dollarë te bankat e huaja.

Përtej dukjes sipërfaqësore, individët e familjet shqiptare kanë borxhe e kredi pa fund për shtëpi, për apartamente, për makina, për të paguar shkollat e fëmijëve, operacionet e doktorëve, për mobilime dhe çka nuk ndodh kund tjetër, edhe për të shkuar me pushime në Maqedoni e në Turqi. Shqiptarët marrin borxh për të rregulluar thonjtë, për të blerë një

çantë luksi, për të marrë bukën me lista, për ta shtyrë deri në marrjen e pensionit, në pritjen për ardhjen e ndihmës nga emigrantët e familjes, për dasma, për synete e për funerale. Ka shumë që marrin borxh për të rregulluar varret, gomat e makinës dhe për të blerë një *Iphone*.

Ka mjaft studime lidhur me borxhet. Po në këtë pikë nuk më intereson as aspekti ekonomik, as aspekti sociologjik apo antropologjik. Borxhi i bën njerëzit që të mbyllin gojën e të mos i dalin kundër sistemit. Borxhi i bën peng të parisë që iu hedh një kafshatë buke dhe i mban lidhur. Borxhi i bën familjet pengje të kimit e të bankave që mbajnë hipotekat e shtëpive e të pronave të tyre për 30 vjet. Borxhi është kulari në qafën e shoqërisë shqiptare. Borxhet e kanë paralizuar ekonominë; si ato që janë marrë nga bankat e nuk kthehen, si ato që janë bërë me marrëveshje e nuk respektohen, si ato që janë bërë në mall, por tash që malli nuk ka më të njëjtën vlerë po i fundosin afaristët, ndërtuesit, investuesit e të tjerët.

Në këto zgjedhje më intereson borxhi i shtetit si problem politik. Borxhi i shtetit është një fenomen ekonomik, por më shumë politik që ka efekte të ndjeshme në politikat e shtetit, në sjelljen e individëve dhe të gjithë shoqërisë. Prandaj, në këtë shkrim dua të ndalem vetëm te borxhi i shtetit shqiptar. Ky duhet të jetë problem kryesor politik që duhet debatuar, por që është zëvendësuar nga llapazanëria e komentatorëve injorantë e shërbyes të klaneve të parisë që prashisin në emisionet e përnatshme.

Në mos e dyta, pyetja e tretë që iu duhet bërë pushtetarëve të tashëm dhe të ardhshëm, (që mund të jenë të gjithë bashkë në një qeveri “me bazë të gjerë”), është pikërisht kjo:

Çfarë do të bësh ti me borxhin e shtetit?

Si do ta zgjidhësh ti këtë problem?

E di që nuk do thonë asgjë dhe do të thonë si Saliu “do rrisim rrogat 700 dollarë në muaj”. Kjo nuk e ul borxhin e shtetit, por e shton. Ulja e taksave e shton borxhin, se paratë duhet të dalin prej diku për ta paguar borxhin e shtetit. Zgjidhja që këta

japin është një mashtrim i pastër. Zgjidhja e vetme është të taksojnë furishëm e rëndshëm të gjithë shqiptarët, të mbysin ekonominë dhe të na kthejnë në kohën e sistemit kur punonim me bukë e djathë, me misërnike e dhallë për të ndërtuar bunkerët. Sot do të bëjmë të njëjtën gjë për të paguar borxhet që ka marrë paria e Tiranës në emër të të gjithë shqiptarëve.

Borxhi i shtetit

Shteti shqiptar ka marrë përsipër shtatë lloje borxhesh të ndryshme dhe ka detyrime karshi të gjithë atyre që e konsiderojnë legjitime këtë paketë borxhesh. Nuk ka shanse që shteti dhe qeveria e dalë nga zgjedhjet t'i përballojë e t'i paguajë këto borxhe. Duhet një vështtrim i përciptë mbi strukturën e borxhit shtetëror, që të jemi të qartë se në çfarë gjendje mjerrane jemi dhe sa urgjente është nevoja për zgjidhjen e duhur. Duhet me e thanë të vërtetën edhe pse nuk është e këndshme.

Së pari, shteti iu ka marrë borxh biznesmenëve dhe qytetarëve investitorë. Borxhi i brendshëm është rritur gjatë vitit 2012 me 513 milionë euro. Llogaritet që shteti shqiptar iu ka borxh bizneseve private që kanë ndërtuar e zbatuar projekte të ndryshme dikund rreth 200 milionë euro. Shumë nga këto biznese nuk kanë më shpresë se do t'i marrin ndonjë ditë borxhet që iu ka shteti. Më e bukura është se këta janë ata që kanë guxuar, kanë dalë e i kanë deklaruar/kërkuar paratë shtetit të shtyrë nga dëshpërimi i thellë. Këta kanë investuar shumë në makineri, edhe të shtrenjta, sepse të tilla ishin premtimet që iu bënë nga politikanët dhe tash nuk i përdorin dot. Tash janë të pazotë të lëvizin edhe gishtin. Ata që iu mbajnë paratë bizneseve të pastra, duhet të mbajnë përgjegjësi, por kryeministri i ardhshëm do të duhet të çojë avokatët e shtetit nga një gjyq në tjetrin.

Së dyti, shteti shqiptar iu ka borxh bankave të huaja e shteteve të huaj (rreth 25 shteteve, ndër të tjerë, edhe Serbisë) që i duan paratë me një inflacion të siguar, sepse borxhet

janë marrë në euro, ose në dollarë dhe leku ka marrë tatë-pjetën e po zhvlerësohet përditë. Vetëm 1/3 e borxhit është në euro e dollarë, po me lekun e zhvlerësuar, kjo po bëhet problem akut. Borxhi i jashtëm i ekonomisë arrin pesë miliardë e ca euro. Borxhi i shtetit, vetëm ai i shtetit jo borxhi i jashtëm i bizneseve e bankave, arrin në pak më pak se tri miliardë euro. Po ashtu vlerësimi i aftësisë borxhmarrëse të shtetit shqiptar, është në nivele të shteteve të falimentuara.

Nga ana tjetër, borxhi i jashtëm është rritur me nivele marrramendëse, edhe pse kjo u fsheh mirë e paq nën një rritje fiktive të ekonomisë, duke u mbuluar me gjethen e fikut të përqindjeve të rritjes fiktive që e bënë Kinën të duket si një ekonomi e prapambetur. Vetëm në vitet 2007 - 2009 borxhi i jashtëm është rritur me 25 %, sepse u bë Rruga e Kombit dhe me të njëjtat ritme vitin tjetër më pas, derisa u kuptua se nuk marrim dot më borxh me interesa të pranueshme! Tash niveli i borxhit është 300 % e borxhit të jashtëm që ishte në vitin 2005. Çdo zhvlerësim i lekut (inflacioni është i qartë, zyrtarisht te 5 %, po te mallrat e konsumit të gjerë është më i lartë) kur vjen bashkë me rënien e ekonomisë, që edhe kështu nuk prodhon gjë, e vështirëson jashtëzakonisht shumë pagesën e borxheve. Nëse shtohet që ne importojmë trefishin e asaj që eksportojmë dhe eksportojmë veç minerale, fasoneri e lëkurë, sepse kemi një ekonomi në të cilën zëri kryesor është tregtia me 48 % dhe ku industria jep vetëm 8 % të prodhimit kombëtar, kuptohet sesa e vështirë dhe e pakapërcyeshme është gjendja ku jemi.

Shumë borxhe të jashtme na janë dhënë me interesa të ulta, por po iu afrohem 20 - 25 vjetëve kur interesi i tyre fillon e kërcen dhe shuma që duhet paguar rritet ndjeshëm. Nuk duhet harruar se këto ishin borxhe të pastra që qeveritë shqiptare ia shitën popullit si "donacione" e "dhurata." Ata që i morën na i shitën si "donacione", edhe pse në rastin më të mirë ishin kredi të buta, duhet të mbajnë përgjegjësi. Po ashtu, kushdo që do të bëhet kryeministër, nuk mund të paguajë

borxhet e jashtme, pa i detyruar shqiptarët të paguajnë taksa disa herë më të larta e shumë më të egra se tani.

Por pyetja është e thjeshtë. A e kanë ditur prijatarët e parisë së Tiranës që këto janë borxhe gjaku dhe laku në fytyrë të popullit shqiptar? Natyrisht dhe pa pikë dyshimi që e kanë ditur. Kujt nuk i kujtohen fjalimet çapraze të qeveritarëve që pyeteshin frëngjisht e përgjigjeshin anglisht në forumet ndërkombëtare? Katundarët tanë nuk i kanë parë borxhet si problem, sepse për ta ky ishte problem i shtetit. Të huajt të japin paratë e presin t'i kthesh, ndryshe mos i lyp se s'të jep njeri gjë. Paria duhej të dinte se çdo të bëhej me borxhet, por ajo e fshehu të vërtetën. Tash shqiptarët duhet të paguajnë borxhet që mori paria në emër të shtetit.

Së treti, shteti shqiptar iu ka borxh pensionistëve, invalidëve, të persekutuarve, veteranëve dhe njerëzve në asistencë shoqërore. Secilit grup i detyrohet shuma marramendëse. Deri tani, borxhi i lidhur me sigurimet shoqërore është mbuluar me financime nga shteti dhe me paratë e mbledhura nga emigrantët për fushatën e sigurimeve shoqërore ku njerëzit blenin vitet e punës me një shumë të caktuar. Në këtë pikë nuk ka më kush të blejë. Shteti duhet të paguajë dhe nuk ka ku i merr lekët për të paguar këtë borxh që i rri si thes me gurë në qafë. Janë jo pak, por 560 000 pensionistë dhe 117 000 familje në asistencë. 46 % e Kukësit jetojnë me asistencë shoqërore. Gjithë këtyre njerëzve, shtresave e zonave, shteti iu detyrohet përjetë dhe shuma që duhet të paguajë për secilin, e kalon 5 - 6 mijë euro në vit.

Zgjidhjet që kanë gjetur në Tiranë janë hilera katundare të kuptueshme lehtë. E para zgjidhje është rritja e moshës së pensionit; kjo ka krijuar pakënaqësi të jashtëzakonshme shoqërore. E dyta, është zgjidhja tjetër për ta rritur pensionin më ngadalë se zhvlerësimi real i lekut, demethënë duke e kalkuluar pensionin e inflacionin në mënyrë që të bjerë fuqia blerëse e pensionistit. Këtë e shohin njerëzit te buka, mishi, orizi e vaji, por shteti luan me numrat si don. Çmimet janë

dyfishuar, demethënë leku është zhvlerësuar dhe pensionet janë rritur shumë pak. Kjo gjendje ka krijuar pakënaqësi të prekshme te masat e gjëra. Argumenti që shqiptarët jetojnë më gjatë është një mashtrim i paskrupullt, edhe pse ndër të tjera, kemi dhjetëfishin e shkallës së kancerit që ka Evropa. Por shteti dhe INSTAT luajnë me numrat dhe duan të bindin njerëzit se gjërat nuk janë krejt si duken.

Problemi pra, është se sot shteti mbulon rreth 50 % të fondit të pensioneve dhe barra mbi të do të vijë duke u rritur progresivisht në të ardhmen, sepse sigurimet nuk kanë paratë e nevojshme. Ky është një detyrim kontraktual me shtetasit që nuk shkelet lehtë, sepse shqiptarët e moshës së kaluar shpesh nuk kanë të ardhura të tjera. Me atë pension të shkretë mbajnë edhe fëmijët e nipërit e papunë që dredhin zinxhirin kafe-neve e pubeve të Tiranës.

Së katërti, shteti iu ka borxhe të mëdha zyrtarëve që nuk i ka paguar si duhet, atyre që i ka përzënë nga puna, profesionistëve, mësuesve, zjarrfikësve, ushtarëve komando, policëve e me rradhë që nuk i paguan me muaj të tërë. Skandali që u zbulua te “Fiks Fare” dhe doli edhe në gazeta, që as ushtarët e oficerët nuk i kishin marrë rrogat për disa muaj ishte shumë domethënëse. Por në muajt e ardhshëm, shteti nuk do të ketë para të paguajë rrogat e mësuesve, pastruesve, nëpunësve, të gjithë të punësuarve buxhetorë.

Së pesti, shteti shqiptar ka një borxh të jashtëzakonshëm për të mirëmbajtur strukturën dhe infrastrukturën, në atë që quhet shpenzime operative. Ky është një zë që nuk shihet si borxh, por shteti që ka mbledhur taksat, duhet të mbajë në këmbë infrastrukturën. Shteti duhet të mirëmbajë urat, rrugët, vendet e mbledhjes së plehrave, ndotjen, etj. Këto nuk bëhen me frymë të shenjtë, për çdo gjë duhet para. Dhe ndërtesat, rrugët, zyrat, e materialet e kohës së sistemit të kaluar, që kanë bartur barrën më të madhe të këtyre shpenzimeve, nuk punojnë e nuk funksionojnë më.

Së gjashti, shteti iu ka një borxh të madh qytetarëve shqip-

tarë të cilët vazhdojnë të blejnë letrat me vlerë që lëshon vetë. Ankandi si ai i gushtit të vitit të kaluar, apo ky që u bë muajin e kaluar, i ktheu shtetasit shqiptarë në borxhlinj të vetes. Sot 15 % e borxhit të shtetit është e blerë nga individët. Këta nuk janë të sigurtë se do të marrin shumë, por janë të bindur se do të mund të fitojnë edhe nga vetja.

Së shtati, ka nisur një fushatë për ta rritur buxhetin duke ia kaluar shtetit barrën e dështimit të sektorit privat dhe të bashkive të ndryshme. Për shembull bankat po i kërkojnë shtetit të paguajë kreditë me probleme që tashmë kanë shkuar në 22.7 % të kredive. Një vit më parë ishin vetëm 16.8 %. Flitet se përqindja është edhe më e lartë, por nuk don të prononcohet njeri, sepse i frigohen ikjes së kapitalit. Bashkitë që nuk mbledhin të ardhurat e duhura, janë në pikë të hallit dhe po kërkojnë subvencione nga shteti, i cili llogaritet se duhet t'u japë rreth 2 - 2.5 % të buxhetit të tij, që të mund të kryejnë funksionet bazë. Po ku do t'i marrë qeveria këto para? Nuk ka para as për qeverinë lokale.

Shkaku i gjendjes së një shoqërie të mbytur në borxhe

Pse e kemi këtë problem? E kemi ngaqë paria e ka bindur popullin se borxhi është i domosdoshëm për zhvillimin. Po ku i investuan paratë që kanë marrë borxh tash njëzetë e pesë vjet, këta që na sundojnë? Në rrugët që nuk të çojnë askund dhe kur të çojnë diku, bëhen autostrada vdekjesh, sepse i kanë bërë të ngushta si rrugë fshati, në ndërtesa që nuk vlejnë, sepse iu ka hyrë lagështia lart e poshtë, në projekte që i kanë vjedhur vetë, në tunele ku do të kalojnë lopët, në investime që janë përsëritur katër herë, në ura që janë bërë njëkalimshe, sepse kalimin tjetër e ka vjedhur ministri e me radhë.

Investimet ishin një mënyrë vjedhjeje e hapur, e paskrupullt që u pranua pa pikë përgjegjësie nga njerëzit e thjeshtë që e shihnin shtetin si armik. Tash që duhen paguar borxhet, njerëzit do ta kuptojnë se shteti bëhet armik kur nuk e traj-

ton si shtetin tënd. Problemi është se vetë paria e Tiranës janë pasuruar në mënyrë marramendëse me këtë vjedhje të pandalshme dhe tashti do të sillen me teknikën e njohur “qe baba, duart”. Do të fillojnë të grinden, “jo ti e bëre, jo e bëri ky që vdiq, jo kaq dimë e kaq na mësuan” e me radhë. Po nuk do të ketë përgjegjës, sepse faji do të bëhet qyrk. Në fund të gjithë shqiptarët do të jenë fajtorë.

Hajnat e parisë së Tiranës na kanë shitur si model zhvillimi një model skllavërimi. Këta na kanë futur në borxhe për t’u pasuruar vetë. Këta do të na lënë me borxhe dhe vetë do të ikin e do të zhduken dhe prej atje ku do të jenë, do të fillojnë këngën e gjinkallave, që ne ua thamë e nuk na dëgjuat, sepse si e thonë në tavolina, “këta jeni ju shqiptarët, një popull “pis” që nuk meriton më shumë”.

Përfundimi dhe prognoza

Shteti shqiptar është një shtet i falimentuar dhe këto zgjedhje janë një lojë me ua lanë dopiogjashtën në duar shqiptarëve. Shteti nuk ka ekonomi prodhuese, jep të dhëna fiktive dhe luan me numrat si iu intereson qeveritarëve. Ndërkohë qeveria e ardhshme e parisë së Tiranës do të përballet me një borxh që është sa 65 % e prodhimit të brendshëm bruto dhe do të shkojë në 68 % deri në qershor të 2013, sepse në kohë fushate, Sali Berishës i duhen para, shumë dhe me çdo mënyrë. Jo më kot ka llogaritur të marrë borxh edhe një miliardë deri në fund të vitit, por ka gjasa që të ngutet e t’i marrë borxhet deri në korrik 2013.

Me rënien e ekonomisë, me tkurrjen e saj dhe me zhvlerësimin e lekut, borxhi do të rritet. Me shpenzimet që duhet të përballohen, borxhi do të rritet. Me një ekonomi të pazonjën me përballue borxhet, taksat duhet të rriten. Ajo që dihet, është se taksat do të rriten nga paria, po do të paguhen nga populli. Ata të huaj që të dhanë paratë, e kanë nxjerrë mësimin nga përvoja jugosllave. Pasi u bë luftë njëzetë vjet, ata kanë

nisur të trokasin në dyert e shteteve të ish - Jugosllavisë për të kërkuar borxhet e tyre të papaguara. Kur paria iu thotë shqiptarëve se krimineli Tito ka thënë “merrni borxh, se borxhi nuk paguhet” ajo iu thotë gjysmën e së vërtetës. Gjysma e të vërtetës që nuk e thotë paria, është se mashtruesi Tito nuk pati më kohë të thoshte “merrni borxh, se borxhi nuk paguhet sa të jem gjallë unë. Kur unë të vdes, në djall vafshi të gjithë”! Edhe Kosova, tash që është bërë formalisht e pavarur, duhet të paguajë borxhet e ish-Jugosllavisë.

Paria e Tiranës e di këtë punë. Llogaria e saj është që të sikteriset atje ku ka fshehur paratë dhe ka bërë investimet. Ne do të na lërë me borxhin e papaguar. Vetëm në vitin 2013, llogaritet që borxhi për frymë të shkojë 315 000 lekë. Pra, jemi keq, sepse nuk kemi pak, por nga 3000 euro për frymë borxh shteti, 3000 euro për frymë premtime të papërbushura ende dhe 3000 euro për frymë interesa për të paguar. Shumëzoje me tre, sepse nuk punojnë gratë, fëmijët e pensionistët dhe kaq duhet të paguajë një taksapagues që punon. Me siguri ka ditur diçka Sali Berisha, kur tha se i kemi të ardhurat 9000 euro për frymë, sepse aktualisht po harxhojmë 9000 euro në vit për kokë. Sepse po i fitoi zgjedhjet, njëra palë e parisë do të duhet t'i taksojë shqiptarët sikur të kenë 9000 euro të ardhura mujore për frymë. Ndryshimi është se vetëm disa shtete evropiane e kanë borxhin e shtetit kaq të frikshëm sa ne, por ata kanë ekonomi dhe struktura.

Shkurt, kur të zëmë të lajmë borxhet, do të ndjehemi evropianë, sepse të paktën do të paguajmë borxhe si ata. Ky ka qenë një hap i madh përpara drejt integritimit nga qeveria e integritimit evropian. Qeveria që vjen duhet të fillojë të na taksojë si evropianë. Se ndryshe nuk lahen borxhet që kemi.

ZGJEDHJET DHE PROBLEMI I PAZGJIDHSHËM I EKONOMISË NË KRIZË

Problemi kryesor në këto zgjedhje për parinë e Tiranës është pikërisht ai për të cilin nuk po flet askush. Ekonomia. Si edhe e kam parashikuar vitin e kaluar, ekonomia do të bëhet shtjella, gjeratorja që do të përprijë këtë pari sunduese. Do të marrë edhe pak kohë, por nuk do të vonojë të shihet qartë se ekonomia do të jetë pika e tyre më e dobët. A do të jetë shtjellë uji që i merr dhe i nxjerr diku më poshtë lumit dhe ia dalin të mbijetojnë, apo do të jetë një gjeratore flakësh që i djeg si barin e thatë përmes një lufte civile? Varet nga disa faktorë, por s'ka dyshim se nuk do ta kenë të lehtë, edhe pse e kanë përgatitur zgjidhjen për ta shtyrë edhe ca kohë pa rrëmuja, sepse janë bërë të gjithë bashkë për të mashtruar popullin shqiptar.

Si është gjendja ekonomike?

Gjendja ekonomike është shumë e keqe, por jo aq e keqe sa do të bëhet së shpejti. Pas pak kohësh do të shohim se vilat, pishinat, hotelet, investimet, luksi, e moderniteti nuk do të na hyjnë më në punë. Sepse investimet e tilla nuk krijojnë pasuri kombëtare, nuk janë zhvillim, por janë para të hedhura në erë. Paria i ka shtyrë njerëzit të bënin investime të tilla që janë humbje parash. Paria nuk shkoi asnjëherë me një projekt të qartë investimesh te emigrantët, te shqiptarët që krijuan pak pasuri, duke kërkuar t'i tërhiqte në projekte që do të krijonin punë e stabilitet shoqëror. Ky është një krim i qëllimtë, që për-

puthet me planet e saj të zbatuara sistematikisht, metodikisht, pa kurrfarë konsiderate për interesat e kombit.

Deri tani është krijuar bindja se askush nuk do të ndëshkohet për këtë llahtarë kombëtare që ka ndodhur gjatë tranzicionit, sepse deri tani nuk i ka ndodhur gjë, nuk i ka hyrë gjemb në këmbë njeriu. Nuk janë vlarë politikanë, nuk kanë ndodhur kundërvënie, nuk ka pasur protesta, por ka një rezinjatë të dukshme që i ka inkurajuar prijatarët e parisë dhe të tjerët të bëjnë çka duan. Edhe kjo e ka një shpjegim. Askush nuk është ndëshkuar, sepse nuk ka përfituar vetëm paria. Gjithë njerëzit kanë qenë duke bërë diçka që iu ka krijuar mendësinë e përmirësimit relativ të gjendjes dhe besojnë se kanë përfituar për vete. Por paria e Tiranës kanë bërë miliarda, populli ka marrë thërmija. Kur ti dalë gjumi popullit, do të ndryshojë loja dhe mandej do të luhet me rregulla të tjera.

Në dukje Kryeministri dhe Guvernatori i Bankës sillen sikur gjendja ekonomike është jo krejt keq dhe se fajin e ka tjerakush, kryesisht politikanët e vendeve fqinjë si Greqia dhe Italia. Se ja, thonë këta të dy dhe analistët e ministrat, edhe pse e kemi ulur normën e interesit shtatë herë rresht, këtë herë nuk e ulëm, domethënë gjende, siç thonë nga jugu, kemi besim se do të përmirësohet gjendja shpejt. Ekonominë e kemi të dytën në botë, kemi rritje më të lartë se Kina. Bujqësinë do ta bëjmë dixhitale. Eksportojmë wiski në Francë dhe raki Skrapari në SHBA. Investimet e huaja janë rritur veçanërisht në përpunimin e plehërave. Vjet kanë hyrë tre milion e gjysëm turistë, edhe pse gjysma kanë ndenjtur më pak se njëzetë e katër orë. Po të mos ishte kriza greke dhe ajo italiane, do të ishim edhe (daha) më mirë, sepse do të kishte punë për fasonët (edhe pse vetëm në Tiranë kanë humbur punën nja 10 000 vetë) e për emigrantët. Kemi arritur të ulim importet e të rrisim eksportet, por nuk themi se ka rënë interesi e fuqia blerëse dhe se shtesat janë minerale e energji, si dhe lëkurë bagëtish që i çojmë jashtë. Kemi investuar në rrugë e në infrastrukturë, por nuk themi sesa qindra miliona dollarë janë vjedhur apo kanë rrjedhur rrugës. Bankat kanë besim te ne

se na dhanë borxh. Do t'i privatizojmë pronat e shtetit se kështu e ka kapitalizmi. Po i legalizojmë edhe apartamentet që të zhvillohet kapitalizmi. Dhe lista e përshkrimeve dhe slloganeve është shumë e gjatë.

Problemi është se këto justifikime që i shiten popullit për argumente, fshehin një realitet të frikshëm për shqiptarët, sepse janë një mashtrim i paskrupullt që tenton të fshehë realitetin e frikshëm. Por pakkush e cek faktin që ky nuk është realiteti ekonomik, por ajo që paria don që të besojnë shqiptarët se është realiteti. Për t'u ndalur në dy aspekte të vetme, ulja e normës së interesit, don me thanë që nuk ka kërkesë dhe që ekonomia është në rënie. Problemi është se nuk funksionon kjo teknikë në një vend ku paratë ende mbahen në qyp, siç ndodh në shtetin shqiptar. Guvernatori bëri një veprim politik për të mos u prishur me Berishën dhe Metën, se ndryshe bankat e nivelit të dytë nuk e blinin borxhin e shtetit. Kur shihet zhvlerësimi real i lekut, kuptohet qartë se njerëzit marrin atë që kanë dhënë e ndoshta më pak. Nga ana tjetër, rritja ekonomike është taksimi i një baze më të gjerë biznesesh. Kjo iu desh Berishës për të justifikuar rritjen e borxhit si përqindje e ekonomisë dhe për të rritur taksat, se ndryshe falimentonte shteti. Pra, thjesht u formalizua një pjesë e ekonomisë informale. Ja ku është rritja.

Por sërish kyçi i problemit është mendësia katundare dhe gjendja ku ishim. Kur nisesh nga buka e misrit me dhallë, nga rrobat e arnuara e shiltja e mbushur me pambuk të mykur në dyshemenë me lagështirë, shumë vetëve gjendja e sotme iu duket parajsë. Kjo ndodh sepse injoranca është ekstreme. Edhe pse hanë grurë të shplarë me pesticide, pinë qumësht me helm, flenë mbi materiale kancerogjene dhe hekuri i shtëpive vjen direkt nga zonat radioaktive, edhe pse po vdesim si minjtë nga kanceri, prapë dëgjojmë të thuhet "mirë jemi, desh Zoti, hamë e pimë e nuk kemi të ngopur". Theret lopa dhe në bark i gjenden tre kilogram qese plastike të patretura, shishe kimikatesh e me radhë dhe të gjithë, edhe doktorët, vdesin të

hanë paçe planci (plëndës) e koke shkrirë në dhajmë e uthull. Ky mentalitet që përmblihet bukur në shprehjen popullore “hajt ma, se një herë do të vdesim, po të paktën të mos vdesim të untë”, i ka qorruar njerëzit që nuk duan e nuk duan të shohin të vërtetën. Atje ku ka rërë, thonë struci e futi kokën në rërë, këtu te ne ku ka shkëmbenj, duhet gjetur një metaforë tjetër, ndoshta në baltovinën a llucën bregdetare.

Por po i afrohem fazës kur paria duhet të fillojë të hajë popullin dhe këto 23 vjet ne e kemi kuptuar vonë sesa e rëndësishme është kuleta për njerëzit. Ka shumë njerëz që të japin nderin e jetën, por jo kuletën. Paria e ka ditur këtë dhe i ka prekur njerëzit pa mëshirë në nder e në jetë, por jo aq në kuletë. Nuk i ka prekur deri tani, por tani këtej nuk ka rrugë tjetër.

Problemi kryesor pse do të ndodhë kjo është ekonomia, gjendja e krizës ekonomike, një temë që paria e Tiranës nuk e cek, nuk e përmend dhe prandaj duket sikur nuk ekziston. Por ekonomia është ajo që këta kanë më shumë frikë. Paria e ndien deri në fund të barkut ku ka fshehur frikën, që oligarkitë politike mbijetojnë sa kohë që janë në gjendje të mbajnë në këmbë një ekonomi që rritet. Oligarkitë shemben kur shembet ekonomia. Dhe janë shtatë procese që kanë konverguar për të krijuar këtë gjendje të pakëndshme për parinë e Tiranës, që pavarësisht se i trembet përsëritjes së një 1997-te, përplasja do të jetë e pashmangshme.

Shtatë aspekte të krizës ekonomike

Së pari, janë të ardhurat nga emigrantët. Emigrantët dërgojnë shumë më pak para se më përpara. Gjatë disa viteve të kaluara, emigrantët, sidomos ata që jetojnë në Evropë e në vendet postosmane, ku vjedhja nga shteti konsiderohet kapitalizëm, si Greqia, investuan gjithçka kishin në shtetin shqiptar. Por emigrantët po kthehen. Deri tani janë gati mbi gjysëm milioni që janë kthyer, rreth 300 000 mijë emigrant sezonalë (që shkonin verës) dhe rreth 228 000 emigrantë që

kanë ndenjtur më shumë se pesë vite në shtete të huaj. Rreth 9 000 fëmijë janë reregjistruar në sistemin shkollor në shtetin shqiptar duke krijuar një problem jo të vogël për ekonominë e për strukturat. Shumë nga këta do të kërkojnë të bëjnë diçka në profesionet e tyre, por tashmë kemi klube, bare, hotele, motele e restaurante sa të duash. Në ndërtim nuk punon dot njeri, se nuk shitet më asgjë. Ata po rrinë e hanë kursimet, po edhe sa kohë do të rrinë ashtu e sa kohë do të kenë kursime për të shpenzuar?

Edhe shumë të tjerë nga një milion e gjysëm emigrantë që janë rrugëve të botës, do të durojnë sa të mbarojnë shkollat fëmijët, që shpesh nuk dinë as shqip, e do të kthehen se nuk jetohet më bodrumeve, pa punë, e duke u përndjekur si shqiptarë. Rrethi është i mbyllur dhe koncepti “se i kemi fabrikat jashtë shtetit” po del gabim e mashtrim. Fabrikat i kanë pasur dhe i kanë të huajt e ne do të kemi krahun e punës, të pambrojtur, të pasiguruar e pa mundësi mbijetese në të ardhmen që e shitëm lirë e për asgjë.

Prandaj në përgjithësi, emigrantët që kanë sjellë mesatarisht rreth shtatë miliardë dollarë në vit (llogaritur në pesëfishin e parave që sillen me transferta bankare) përmes ndihmave, investimeve, fitimeve, pensioneve, shpenzimeve në sistem (dasma etj.) e kanë mbyllur rubinetin. Do rrinë ca kohë urtë ku të jenë dhe pastaj (meqë nuk ka kund shpresë që Italia, Greqia dhe Mbretëria e Bashkuar të bëhen më mirë) do të kërkojnë zgjidhje në shtetin shqiptar, sepse nuk kanë ku të shkojnë tjetër. Me një ekonomi evropiane në krizë, nuk kanë se si të gjejnë zgjidhje tjerakund. Dhe këta i kanë sytë e hapur se kanë parë se ç’është shteti, e dine se ç’është ekonomia dhe duhet të bëjnë zgjidhje të vështira për fëmijët e tyre.

Së dyti, fitimet nga bizneset e pista që numërohen në miliarda të tjera, kanë ardhur duke u pakësuar. Nga një anë bizneset e ngritura me paratë e krimit e të poshtërsisë janë konsoliduar dhe tashmë rritja, përpunimi dhe shitja e drogës është një pjesë e fuqishme e ekonomisë shqiptare. Por pjesë e

rëndësishme e ekonomisë së nëndheshme dhe kriminale janë edhe trafiqet. Kur flitet për trafiqet, shteti shqiptar njihet si një vend që prodhon, vend kalimi, transportimi dhe vend konsumimi. Ajo që ka ndodhur gjatë këtyre njëzetë e tre viteve është e frikshme dhe e llahtarshme. Ndoshta mallkimi “ua çoftë zoti atje ku iu dhemb më fort, te bijtë e te fara e keqe e tyre” që dëgjohet shpesh anë e mbanë shtetit shqiptar nuk do të funksionojë, sepse kobrën nuk e mbyt mallkimi i miut të dobët por kafshimi i mangustës dhe i rreqebullit.

Por paria e ndjen se ka një mallkim të një lloji tjetër. Tashmë hajnat, vrasësit, kodoshët e pushtët që sillnin para në Tiranë, ata që e majmën parinë dhe që mbajtën me bukë fise, katunde e lagje të tëra, e kanë ndërruar mendjen; kanë nisur të investojnë jashtë shtetit. Ajo që po ndodh është se shumë prej këtyre figurave të errta e të kërmosura të tranzicionit, janë duke i pastruar paratë në Tiranë dhe duke i nxjerrë jashtë pasi i kanë kaluar në shumë banka. Restaurant për restaurant, më mirë një restaurant në Itali se në Tiranë. Shkollë për shkollë, më mirë në Zvicër. Siguri për siguri, më mirë në Republikën Domenikane; aty ka edhe plazhe dhe muzikë përnatë. Ikja e kapitalit të kriminalizuar është një problem i madh dhe po bëhet një problem shumë shqetësues për parinë.

Së treti, shteti shqiptar nuk ka më ç’të shesë e privatizojë. Sali Berisha e mbylli ciklin e shitjes e të privatizimit. Natyrisht që pasi shitën edhe qentë, edhe shkollën e qenve (për arsye të kuptueshme, nuk e shesin dot partinë e zagarëve) do të shesin edhe ajrin, edhe malet, edhe shëndetin e fëmijëve. Do t’i sjellin plehërat nga ku të munden dhe do t’i hedhin ku të munden, në mes të fushës më pjellore do t’i vënë, si në Zadrimë, do të mbysin, do t’i vrasin me ngadalë shqiptarët, vetëm për hir të kuletës së tyre. Por shteti nuk ka më se ç’të shesë.

Së katërti, shteti shqiptar nuk ka ekonomi prodhuese nga mund t’i nxjerrë paratë. Bizneset vegjetojnë. Shitblerja ka rënë. Bizneset luftojnë të nxjerrin dhjamin e pleshtit nga blerësit. Një million shqiptarë janë të papunë. Po t’i lëmë më-

njanë statistikat që bëhen gjatë verës, kur edhe vjehrrat punësohen si shitëse e kamariere, vetëm një milion shqiptarë janë në punë nga mbi tre milionë vetë që tashmë jetojnë në shtetin shqiptar (përfshirë edhe të kthyerit pas regjistrimit të popullsisë). Këta të tjerët janë fëmijët dhe një masë e madhe në pension të hershëm, në asistencë, në punë fiktive, shtëpiake dhe ajo me qesharakja e të gjithë kategorive, puna në bujqësi. Po kujt i del jetesa me bujqësi në shtetin shqiptar? Vetëm një numri të papërfillshëm individësh. Kështu, po t'i bësh llogaritë me kujdes dhe të thuash se 90 % të njerëzve në bujqësi nuk iu del jetesa me punën tyre, edhe pse duket pak e tepërt, të dalin një milion të papunë. Paria nga ana e saj merr katër rroga secili. Janë zyrtarë, janë në borde shteti, kanë bizneset e tyre dhe thujse të gjithë janë profesorë të jashtëm që paguhen më mirë se profesorët jashtë vendit. Ky është një dallim që njerëzit nuk e kalojnë lehtë.

Ndryshimi është i thellë edhe te njerëzit që kanë mbetur me mall stok, sepse prisnin që shpërthimi ekonomik të mos ndalej ndonjëherë. Ikën "kohët e arta" kur emigrantët vinin e ndërtonin pallate në tre muaj, blenin dy - tre apartamente e mobilonin banjot me rubineta të argjendta e ulëse banjosh të lara me flori. Dhjetra e dhjetra miliarda dollarë që hynë në shtetin shqiptar, kanë shkuar për limuzina dasmash, për qejfet e syneteve e pagëzimeve, për apartamente që s'kanë ujë e as gropa ujrash të zeza, për pallate majë maleve ku nuk jeton askush, për makina të shtrenjta që nuk i duhen njeriu e që ndryshken në tako. Para të shkuara kot, por që kështu i interesonte parisë, sepse tregtitë me shumicë i kontrollonin njerëzit e saj dhe këto para kalonin në duart e saj.

Kush është fajtor?

Fajtoje për gjendjen është paria e Tiranës, pa asnjë dyshim apo diskutim. Paria e drejtoi procesin në rrugën më të shtrembër të mundshme. Gjermanët shtërguan rripin dhe për njëzetë

vjet hëngrën lakra e bënë një ekonomi të pakrahasueshme. E njëjta gjë edhe me japonezët apo koreanët. Paritë e këtyre vendeve punuan me plan dhe ndërtuan ekonomi që sot janë konkurruese në të gjithë botën. Paria e Tiranës i shtyri shqiptarët të luajnë horllëk për njëzetë e ca vite dhe tashti po i shtyn dalë ngadalë te fasulja, lakra e te bukë e djathë e mollatarta. A bënë ndonjë investim? A bënë ndonjë fabrikë? A hapën vende punë? Asgjë për të justifikuar sjelljen e qëndrimin e tyre në politikë. Sjellje e tyre sipas parimit “haja qenit, pija qenit, hajt t’i bijmë karadyzenit” modifikuar me parimin “çdo shqiptar, të luajë kumar” dhe kulmuar në kohën kur Fatos Nano ishte kryekumarmarxiu e kryeministri i vendit, nuk u ndryshua. Ne vazhduam të njëjtën gjë edhe në periudhën e rikthimit të Berishës që luan fall me të gjithë dhe e zgjeruam gamën e qejfeve duke e hapur lojën gjithkund. Ne nuk prodhojmë shumëçka, por importojmë gjithçka, përfshirë këtu ujë, qepë, grurë, e mollatarta. E vetmja gjë që na duhet e që nuk e importojmë dot, janë politikanët e burrat e shtetit që dinë, që kanë burrninë e duhur e që duan t’i thonë popullit të drejtën e të vërtetën, sepse këta që na sundojnë, luajnë lojra “hap e mbyll sytë” apo kukamçefthi.

Së pesti, paria e Tiranës e di se nuk mundet me marrë më borxhe. E para kush do t’i japë borxh? E dyta si do t’i lajë borxhet? Kështu si janë punët shteti shqiptar duhet të paguajë 500 milionë dollarë borxh interes në vit. Nga do të dalin këto para? Paria mendon se u ka hedhur shqiptarëve trutë e budallait, duke thënë se “Tito e ka lënë amanet merrni borxh se borxhi nuk lahet kurrë.” Argumenti tjetër është se Gjermania ka 300% të GDP-së borxh. Po a mendon ai njeriu që rri në klub gjithë ditën e lume se gjermani punon gjithë ditën e lume? Po ashtu paria i mëshon mendësisë katundare duke i shtyrë njerëzit të mendojnëse borxhi nuk është i tyre por i shtetit. Po shteti i kujt është? Nga do t’i marrë shteti paratë për t’i paguar borxhet? Shtetasit të vet do t’ia marrë. Të huajt nuk sjellin më ndihma, nuk japin më borxhe, nuk kanë kohë të merren me shqiptarët se kanë hallet e tyre. Do kullandrisemi me dhjamin

tonë. Po ky është fillimi i kanibalizmit ekonomik; do të fillojmë të hamë njëri - tjetrin dhe pasurinë e njëri - tjetrit.

Së gjashti, skemat piramidale po rishpërthejnë dhe paria nuk di si t'i kontrollojë. Po ndodhin në edukim e në ndërtim. Nuk është puna te Shemsie Kadria që u kthye dhe gjeti aq bu-dallenj sa t'u merrte 200 milionë lekë e të zhdukej. Problemi është te piramidat financiare si kjo e arsimit të lartë. Të gjithë janë studentë, të gjithë kanë dy - tri diploma, por punë nuk ka as për pastruese, veçse në të marrtë daja dorën në zemër. Paria është tallur sa ka mundur me të gjithë shqiptarët. Tashti ç'do të bëjë me këtë rini që nuk don të punojë tokën e gjyshit, sepse ka një copë letër dhe thotë se është e diplomuar univer-sitare? Edhe sa kohë do ta mbajë familja? A do të bëhet krah punë në mërgim diku? Parisë nuk i intereson. Ajo ndau copa letrash dhe njerëzit i blenë sa frëngu pulën; po frëngu sëpaku e hëngri pulën që bleu, ne nuk i hamë dot letrat e diplomat për të cilat kemi paguar aq shumë e aq shtrenjtë. E njëjta gjë edhe në ndërtim e në fusha të tjera.

Së shtati, sistemi ekonomik është i ndërtuar i gjithë mbi shkëmbimin e sendeve. Bankat nuk hyjnë shumë në mes, sepse punët bëhen me havale e me clearing. Shteti nuk i ka paguar investitorët privatë, por iu kërkon të paguajnë taksat paraprakisht. Shteti u ka borxh dikund rreth 200 milionë euro privatëve që tashti duhet të hapin qesen edhe njëherë për situatën e partinë. Problemi është që për të qenë në rregull, bizneset duhet t'iu japin të dy palëve, e aq sa duan të dy palët e parisë. Kush mund të investojë diku tjetër, kur nuk mund t'i shesë apartamentet qe numërohen me mijra e që janë të pahipoteuara e të palemalizuar? Kush don të investojë në një vend ku të gjithë duan të bëhen miliarderë brenda natës? Pak nga borxhet, pak nga pasiguria, pak nga parapritja se do të ketë sherr, biznesi është tërësisht i paralizuar. Ato degë që janë të suksesshme si mineralet e fasoneria, po e ndiejnë peshën e krizës dhe do të ndiejnë edhe më shumë.

Si do të bëhet kriza një problem i pazgjidhshëm

Këtu duhet theksuar se paria e Tiranës e ka të pamundur të ruajë qetësinë publike dhe t'i bindë shqiptarët se kriza është e përhershme, që do të bëhen gjërat keq e më keq dhe se nuk ka shpresë kund në të ardhmen. Shuma e shpenzimeve për të mbuluar borxhet që duhet të përballojë shteti është marramendëse dhe nuk ka asnjë mënyrë të arsyeshme të gjenden paratë, hiçmos ndonjë mrekulli ekonomike që nuk pritet që të ndodhë. Shteti shqiptar duhet të paguajë 107 000 buxhetorë, 560 000 pensionistë, 117 000 familje që marrin asistencë sociale, të ketë para për të mirëmbajtur infrastrukturën dhe për të gjithë shpenzimet e tjera dhe përmbi këto, i duhen edhe 600 milionë dollarë në vit për interesat e borxhit.

Nga do të dalin paratë? Një rrugë e shpejtë është legalizimi i pronave, ndërtesave, banesave, apartamenteve dhe përveç taksës së hipoteimit do të mblidhet edhe një taksë modeste vjetore mbi metër katrorin e mbi dyzetë e tetë metrave të një dhome e kuzhine për një familje me tre vetë e mbi gjashtëdhjetë metra katrore për një familje me katër veta. Taksa do të jetë e dyfishuar për shtëpitë e dyta, e trefishuar për shtëpitë e treta, nëse nuk janë të dhëna me qera. Përveç taksave mbi pronën, do të mblidhen taksa shtesë mbi bizneset, dyqanet, makinat, aparaturat e luksit, do të rritet taksa mbi telefonat, shteti do të vendosë tarifa mbi të gjithë shërbimet që ofron; që nga pulla në gjendjen civile e te pasaporta.

Paradoksi është se paria do të bëjë gjithçka për të dalë nga kriza, por nuk do të përfshijë veten. Ata do të paguajnë taksat që nuk janë kurrgjë krahasuar me pasuritë që kanë, do të sillen si qytetarët e tjerë, por nuk do tregojnë pasuritë e plota, do t'i fshehin, do t'i investojnë paratë tjerakund dhe kur të vijë puna te taksimi, të gjithë do të jenë më të varfër se shitësi i këpucëve te "gabi". Po ashtu, duke qenë se këta punojnë bashkë, por nuk ia kanë besën njëri - tjetrit, do të përpiqen të minojnë njëri - tjetrin dhe të ruajnë klanet e veta. Pavarësisht se nga vjen; nga

lart, nga poshtë, nga pakënaqësia e shtresës së mesme, e profesionistëve, e studentëve, e të papunëve, emigrantëve, e kujtdo tjetër, shtysa për ngatërresë është e pashmangshme. Dhe përpjekja e strukturave lokale të partive për t'i vjedhur votat, do të jetë një shkëndijë që nuk do të shuhet lehtë.

Në vend të përfundimit

Në përfundim, kjo është gjendja. Sipas mendimit tim, kjo gjendje do të bëhet më e dukshme sa më shumë që i afrohemi fushatës që do të jetë shumë e egër dhe e ndezur. Pavarësisht se paria e Tiranës po mundohet ta kalojë fushatën zgjedhore me sherre personale, me shashka mediatike, me sulme dytësore, duke mos prekur problemet e vërteta ekonomike, ajo nuk do të mundë të fshehë problemin e madh me të cilin do të duhet të përballlet pas 23 qershorit. Problemi kryesor i parisë së Tiranës është ekonomia. Shteti e ka arkën bosh. Emigrantët nuk sjellin më para. Nuk ka investime të huaja. Shteti nuk ka mundësi të marrë më borxh e të paguajë borxhet që ka. Shqiptarët nuk e kanë kuptuar se kur luan në kazino, fiton vetëm pronari i kazinosë. Dhe kur luan me jetën e fëmijëve të tu, fiton paria. Nuk të bën skllav vetëm buka e gojës, edhe qejfi yt të bën skllav të parisë, jo vetëm ty, por edhe fëmijët e tu. Ky është problemi i vërtetë i shqiptarëve.

Problemi urgent i parisë është se shqiptarët nuk merren vesh, nuk kuptohen se ç'duan të bëjnë. Ata rrinë e rrinë urtë, mandej e përmbysin tryezën. Dhe kur të fillojë sherri, do të jetë një përplasje e të gjithëve kundër të gjithëve. Problemi që tremb parinë nuk është më as problem politik, as problem ekonomik, është një problem automatik, AK - 47, si në vitin 1997. Prandaj i silllet rrotull, prandaj do të bëjë marrëveshje, prandaj do të mundohet t'i mbyllë sherret shpejt e shpejt, sepse po i u doli gjumi njerëzve, po e kuptuan se çfarë iu ka ndodhur, nuk dihet ç'ndodh. Urrejta është e verbër dhe ata dikë do ta venë në shënjestër të pamundësisë e të dështimit të tyre.

NGA PROBLEMET POLITIKE TË PASZGJEDHJEVE NË DORË TË KUJT DO TË MBETET PARTIA DEMOKRATIKE?

Para disa ditës një studjues i politikës m'u afrua me synimin që të bënim një studim të thelluar shkencor të PD-së. Me mirësjellje e refuzova duke i thënë se kisha në duar një projekt tjetër. E vërtetë ishte, por edhe se nuk desha të merrem me një projekt që nuk pasqyron të vërtetën, thjesht sepse jam i bindur që paraqitja e PD dhe realiteti brenda saj, janë dy gjëra të ndryshme. Më shumë se kaq, PD që është sot, nuk do të jetë e njëjtë me PD pas zgjedhjeve.

Prandaj i thashë se fenomeni që do të ndodhë pas një momenti kritik si zgjedhjet, don studjuar dhe analizuar me kujdes dhe nuk zgjidhet me një pyetësor e me përgjigje telefonike që do të jenë të përgjuara e me radhë. Arsyeja e vërtetë është se njerëzit tanë, sipas mendësisë klasike katundare, ndryshe mendojnë, ndryshe thonë, e ndryshe veprojnë. Me një pragmatizëm katundar klasik të mbështetur në dukje në sjelljen burrnore "kam ngrënë bukën e filanit", sjellja e të gjithëve në lojë motivohet nga tre parimet e sprovuara katundare, "kalova lumin, të vjedhi edhe kalin," "githkush për atë të vetën" dhe "qeni leh atje ku ha". Motivimi kryesor është ruajtja e intereseve të ngushta, mënyra e mbrojtjes së të cilave nuk kuptohet lehtë nga të huajt si për shembull, blerja e votave vetëm me një gjel deti, me një thes mielli, ose me një lopë për familje. Këtë nuk ta thotë kush në një pyetësor telefonik. Ajo që ndo-

dhi me skuthin intelektual Fatos Nano pas vitit 2005, mund të ndodhë edhe me kulimin politik Sali Berisha. PD do të ketë probleme të tjera nga gjendja e PS dhe ujrat do të sqarohen pas zgjedhjeve.

Ti marrim një nga një disa nga problemet kryesore që do të lindin pas zgjedhjeve.

Një hap i mirë është të fillohet me një vlerësim cila është paraqitja e jashtme e PD. Paraqitja e jashtme e PD është e një partie qeverisëse dhe e një reparti ushtarak të komanduar mirë ku shefi din se ç'bën. PD i ngjan një strukture që drejtohet nga një udhëheqës shumë i fortë në kryeministri. PD ka një grup deputetësh që kontrollojnë zona të caktuara në formën e pashallëqeve politike të konsoliduar me lidhje klienteliste dhe me një numër shumë të madh, dhjetra - mijra vetësh që kanë punuar në qeveri. PD është një parti me lidhje të shumëfishta në ekonomi dhe me pasunarët që e mbështesin pa mëdyshe. PD gëzon mbështetje masive në disa shtresa të popullit dhe në zona të caktuara. PD kontrollon dosjet që janë si thupra e mësuesit në shkollën e katundit. Po ashtu PD ka një influencë të ndjeshme në strukturat e bandave dh në botën e nëndheshme. PD është në kontroll të një perandorie televizive e shtypi që shpraz pa ndërprerje një propagandë çoroditëse. PD është një parti që po mbledh rreth vetes të gjithë ata individë që dikur ishin pjesë e saj (me përjashtim të Aleksandër Meksit dhe pa modesti, edhe timen, se duan s'duan ata, PD është partia që e kam nisur e themeluar edhe unë).

Në letër e si makinë elektorale PD është një parti impulsive. Është e sigurtë se Sali Berisha do të nxjerrë një listë tejet konkurruese në nivel kombëtar me kandidatë për deputetë, do të mbledhë 300 000 vetë në mitingun parazgjedhor, do të ketë në dispozicion para me thasë, televizione private, gazeta fletërrufe dhe do të zhvillojë një fushatë shumë të fortë, të egër dhe pa asnjë rezervë kundër gjithkujt që i duket pengesë në rrugën e tij. PD duket një parti shumë e fortë dhe me rrënjë në shoqërinë shqiptare. Në fund Sali Berisha do të ketë një

grup kuvendor numerikisht substancial të PD-së në Kuvend. Kjo pritet. Por kjo është vetëm paraqitja.

Saliu do të sillet si fitimtar, cilido që të jetë rezultati. Sjejlja e tij është e shpjgueshme. Sali Berisha nuk do të ndalet para asgjëje, sepse këto zgjedhje janë për jetë a për vdekje dhe janë thelbësore për mbijetesën e tij dhe të familjes së tij. Ai e di se pika e zgjedhjeve do të jetë një pikë kthese dhe vendimtare për vetë Sali Berishën. Para zgjedhjeve ai do ketë dhe e ka edhe gurin, edhe arrën në dorë. Pas zgjedhjeve do mbajë arrën dhe dikush tjetër do të ketë gurin. Krahasimi mbaron këtu, sepse pas zgjedhjeve ai do të jetë krejtësisht i pasigurtë, jo aq me prijatarët e partive të tjera, sesa me partinë e vet. Në varësi të marrëveshjeve që do të bëhen, ai ose do të jetë një partner i padëshërueshëm në një qeverisje të ashtuquajtur të shpëtimit kombëtar, ose do të jetë në opozitë së bashku me disa partnerë shqetësues e kërcënues. Por në të dy rastet, poshtë kupolës familjare, sjellja e bashkëpunëtorëve të Trustit të Gështenjave të Tropojës është një rebus i pashpjgueshëm, sepse gjithkush po mendon për të vetën.

Po ashtu duhet thënë se pavarësisht se si përfundojnë zgjedhjet, një gjë dihet e sigurtë. Sali Berisha do të jetë kryetar i përjetshëm i PD. Kjo përkthehet kështu. Ai është kryetari i përjetshëm i PD për sa kohë ai vetë do të ketë jetë, domethënë e ndoshta katër - pesë vjet të tjera, ja edhe dhjetë vjet, por pa dyshim jo tridhjetë e pesë, siç shpresoi në një moment deliri parlamentar vetë Saliu. Herët a vonë do të vdesë si gjithë të tjerët dhe askush më mirë se ai nuk e di sa delikate është gjendja e dikujt në moshën e tij dhe në gjendjen e tij. Në mos tjetër, veshja antiplumb të jep kruarje, shpesh të bezdisshme e të padurueshme.

Po edhe me Saliun kryetar të përjetshëm, domethënë edhe për ca vjet, në të dy skenaret e mundshme pas zgjedhjeve, pyetja që duhet të bëhet është çfarë do të ndodhë me PD? Kjo pyetje është legjitime, sepse pas zgjedhjeve ndryshon raporti i forcave dhe problemet me të cilat do të përballet Saliu janë jo të lehta.

Fatos Nano kishte një parti të strukturuar e të fortë dhe prapë të vetët, të drejtuar nga Gramoz Ruçi, me metoda katundare dhe me mendësi katundare ia futën, turrë nën hali. Të tre motivet e njohura pragmatike katundare do të vënë në lëvizje e do të ndryshojnë strukturën e PD që nuk është e konsoliduar deri në atë pikë sa të mos përjetojë një shkërmoqje ekstreme si në vitin 1997. Prandaj ai po bën gjithçka që mundet që të mos e lerë këtë të ndodhë. Nga ana tjetër njihet mirë fenomeni i partive oligarkike apo nën kontrollin e një familje, qoftë ajo edhe kriminale që, kur përballen me humbjen, shkërmoqen e treten si kripa në ujë. PD nuk është PS, edhe pse kanë lindur nga e njëra nënë, PPSH. Njëra parti mori kuadrot, tjetra mori të përdoruarit e të shfrytëzuarit. Askush më mirë se Sali Berisha nuk është i vetëdijshëm për këtë punë.

Në parantezë duhet thënë se Saliu e di që ka një problem të madh në faktin se PD është një parti qeverisëse e diskredituar në të gjithë drejtimet. PD po qeveris shtetin, por në thelb është një kartel mafioz që njihet si Trusti i Gështenjave të Tropojës dhe është në shërbim vetëm e vetëm të familjes Berisha. Në tetë vjet qeverisje ndodhën krime të panumërta, ekonomia u shkatërrua, borxhet u rritën me gjashtë miliardë dollarë, u shit deti shqiptar, u shitën pronat e fundit që kishte shteti shqiptar, korrupsioni ishte i llahtarshëm, niveli i kontrollit të bandave në shërbim të PD u rrit ndjeshëm. Gjatë këtyre viteve u shkatërrua më tej ushtria, arsimiti, shëndetësia, mbrojtja shoqërore dhe siguria. U shitën hidrocentralet e deri edhe qentë e policisë. U ndërtua Rruga e Kombit që do të mbahet mend dhe mijëra rrugë e rrugica që shërbyen për të pasuruar biznesmenët afër PD por që nuk të çojnë kund. Çmimi që u pagua, paratë që u vodhën, përdorimshmëria dhe mirëmbajtja e tyre, janë më shumë se një pikëpyetje. U sollën plehrat e Italisë, vjedhja e pronës publike u bë normë, u rritën numrat e përdoruesve të drogës, të vrasjeve, të trafikimit, të të burgosurve e me rradhë.

Pasurimi marramendës i disa individëve të lidhur me kla-

nin Berisha dhe me Trustin e Gështenjave të Tropojës, është një shenjë e qartë se qeverisja e PD ishte një qeverisje e korruptuar, kleptokrate, në shërbim të një strukture oligarkike në majë të së cilës qëndron Sali Berisha. PD është një parti që nuk ka asgjë me çka mund të krenohet në historinë shqiptare. PD është partia e dështimit, e krimit, e vjedhjes, e cubnisë, si në qeverisjen e parë, ashtu edhe në të dytën.

Saliu e di se deri tani ka mbajtur bashkë një shportë me karavidhe politike, që do të shprazet sa të bjerë në ujë. Mjafton të shihet figura e Arben Imamit, Genc Pollos, Tritan Shehut e me radhë. Këta janë si monedha, i falen prurësit më të parë. Këtyre nuk ua lë partinë, do t'i përdorjë, i ka paguar mirë, por nuk iu beson, sepse vetë i ka zvetënuar edhe më shumë se kanë qenë të përdorur e të zvetënuar. Këta nuk kanë asnjë lloj besnikërie politike dhe me gjuhën katundare, janë aty për "të rruar" para. PD është e detyruar të nxjerrë si deputetë një numër individësh që janë tërësisht të kriminalizuar, të kapur si nga Sali Berisha, ashtu edhe nga kundërshtarët e tij. Kandidatët e PD për deputetë, me përjashtim të disidentit të djathtë, dhëndrit të partisë, lenë për të dëshëruar. Edhe pse Fahri Balliu tashmë është i Bekuari Apostolik, prapë se prapë, si pisqollë mediatike ai është një rob i Saliut që nuk beson se do t'i gëzojë milionat, as vet, as e bija. Fahri Balliu mbahet peng edhe nga ata që ia kanë letrat në dorë, jo vetëm të tijat, por edhe të së bijës, sepse nuk i ka vetëm Saliu, i kanë disa palë. Po ashtu Fahriu mbahet peng nga ata që ia numërojnë ditët e presin rastin që t'ia kthejnë borxhet e palara. Shëtitjet në bulevard nuk do të jenë më aq të shkujdesura.

Gjithë të tjerët që i kanë shërbyer duke menduar se do të marrin partinë në dorë si Lulzim Basha, Jozefina Topalli, Ridvan Bode, apo Sokol Olldashi kanë interesa që e tejkalojnë Sali Berishën. Besnikëria e tyre nuk është ndaj Saliut, por ndaj klanit të mbështetësve të tyre. Të gjithë presin rradhën dhe asnjë nuk beson se Saliu e ka sinqerisht me të, sepse në mos tjetër, kur ka ardhur momenti, i ka përdorur si lecka dysHEMEJE. Po

ashtu, po të mos jetë PD në qeverisje, deputetët e Trustit do të detyrohen të bëjnë disa zgjidhje të pakëndshme për Saliun, sepse të gjithë i kanë dosjet e mbushura dhe kanë interesa të tilla që do t'i bëjnë të flasin me palën tjetër. Përpijekja e tij për t'i mbushur karriket e Kuvendit me zero politike apo me njerëz që kanë qenë shokë me të bijën gjatë hetimit të UÇK apo fëmijë apartamentesh me dhëndrin, miq fëmijërie nga lagja e shquar e Brrakës me të birin, do t'i japë një përqindje besnikësh. Por këta që e bënë gavetën duke qenë spiunë ministrish, kanë treguar se nuk kanë shtyllë kurrizore dhe nuk do të funksionojnë si liderë. Deputetët e PD kanë klanet e tyre lokale që janë më shumë klane krimi familjar e mafioz, sesa struktura ideologjike. Deputetët që kanë vrarë, ata që dalin me kobure në stadium e në takime me drogaxhinj, ata që kapen me prostituta e që vdesin duke bërë seks me sekretaret, ata që janë bërë milionerë në një mandat, nuk pyesin për Saliun. Këta nuk i kalon dot Saliu. Dhe do të jetë e vështirë të dorëzohen e të bëjnë çdo Saliu, kur ai ka arrën e dikush tjetër ka gurin në dorë.

Po ashtu mbështetësit e shumtë që duhet të humbin punën, nuk kanë më se ç'të humbasin. Klientët dhe mbështetësit, si dhe militantët, e kanë kuptuar se nuk rrihet më edhe tetë vjet në opozitë. Shumë ndjehen të mashtruar dhe do ta braktisin sa të hiqen prej punës, nëse nuk e kthejnë pllakën menjëherë. Arsyeja është se Saliu u soll krejt ndryshe nga i stërkorrupuari Fatos Nano që i la të gjithë të vetët të vjedhin sipas parimit "duan të hanë edhe këta, se nuk bëhet qameti, tanët janë". Saliu la të vjedhin vetëm disa dhe militantët morën dromcat, thërmijat e korrupsionit. Pakënaqësia është e madhe edhe te militantët që kanë besuar te PD qysh nga dita e parë. Saliu u tall me ta dhe i la në rrugë. Tashti që Saliu do të jetë në lumë duke notuar si kryetari Mao, edhe pse vetëm ecën se nuk din not, këta do ta braktisin, se ai nuk ka më ç't'u japë, ndaj duhet të mendojnë për hallin e vet dhe të mbështesin atë që iu jep një kafshatë.

Si të gjithë katundarët tanë heroikë, çdo familje i ka njerëzit në të dy partitë, kështu që loja luhet për familjen, jo për ideologjinë. Kjo sjellje “mbaje mirë me të gjithë dhe futja më të ligut” do të shihet në kthimin e pllakës së televizioneve si “Klan” dhe të gjithfarë llumkomentatorie që sot bën tërrtërre të pafund e përnatë për Sali Berishën në shtyp, në televizion, në radio e në internet. Saliu e din se i ka peng sa kohë ka pushtet, sepse ata kanë miq edhe palën tjetër, por më mik kanë kuletën e pushtetin. Këta që po vijnë në pushtet janë të uritur dhe e kanë oreksin e madh.

Biznesmenët që nuk i morën paratë dhe që duhet të derdhin “ndihmat” për PD, gjithsesi edhe në këto zgjedhje, do të shkojnë te partnerët e tyre, te shokët e vjetër të konviktit, te kushërinjtë dhe do të gjejnë gjuhën me ta. Janë në pikë të hallit, sepse nuk e kanë të sigurtë pasurinë që kanë vënë. Nga pastrues nevojtoresh janë bërë milionerë, nga kamerierë janë bërë miliarderë. Nga mushka droge e spaçiatori janë bërë “kinga Tirone”. Eh, këta që po vijnë tash edhe janë të uritur, edhe e kanë oreksin e madh.

Po ashtu edhe të gjithë llojet e banditëve që nuk lanë gjë pa bërë dhe që kanë “investuar” në “ekonominë” shqiptare, duhet të verifikojnë pasurinë e të gjejnë mbrojtje se këta që po vijnë tash edhe janë të uritur, edhe e kanë oreksin e madh. Kështu që Saliu nuk mbështetet dot as te këta, sepse këta duan të mbijetojnë për vete.

Zyrtarët që e kanë punën prej PD, pak prej frikës, pak prej dëshpërimit, do të dalin në mitingjet e saj dhe pak nga pak, varret nga fryn era, do të shkojnë edhe në mitingjet e PS. Partitë politike në shtetin shqiptar kanë nja gjashtë milionë anëtarë. Të gjithë e dinë se kolegu i tyre, që i kanë zënë vendin, po pret të kthehet. Fëmijët nuk ushqehen me taserën e PD, kështu që gjithkush duhet të mendojë për të vetën.

PS i mbajti mbështetësit edhe me Bashkinë e Tiranës dhe me mundësitë që ajo ofronte. Por shpresat kanë shterrur. Shpjegimi është se Bashkia e Tiranës nuk i ka më burimet që

të luajë atë lojë, sepse kryeministri i ardhshëm do t'ia mbyllë rubinetin. Më në fund, do të nisë edhe një herë eksodi drejt Kanadasë, SHBA e kudo tjetër ku zyrtarët berishianë, biznesmenët e PD, afaristët, doganierët, shefat, drejtorët e me rradhë i kanë fshehur paratë e pasuritë. Të gjithë këta që u kthyen në vitin 2005, do të rikthehen këtë herë “të rregulluar” me qesen plot dhe do të ulen të bëjnë politikë në kafenet e Nju Jorkut dhe të Torontos. Ata që ikën do të vijnë edhe më të uritur dhe me oreksin më të madh.

Saliu po bën një përpjekje gjigande dhe të zgjuar që të mbështetet te rinia, por rinia që i afrohet nuk ka bindje politike. Si mund të mbështesësh një parti që nuk ka ideologji? Çfarë bindjesh mund të kesh? Rinia që i afrohet, i afrohet jo prej Çiljetës e Greta Koçit, por për shkak se i ka nisur babai, se duan një vend pune, ose duan të zënë shoqëri me dikë që ua do zemra, e të marrin një rrugë jashtë shtetit. Rinia është bërë tejet pragmatike dhe përtej lustrës së mbështetjes dhe entuzazmit, mendon e sillet si katundarët më të sprovuar. Saliu po vepron si gjarpëri, sepse kërkon t'i helmatisë e t'u hedhë një lugë helm në çorbë, por ka shumë të rinj që e kanë kuptuar lojën dhe “luajnë me dy porta” si biznesmenët, si banditët, si zyrtarët dhe si mbështetësit e PD.

Por problemi më i madh janë katundarët që e mbështetën për tetë vjet dhe që Saliu, urtë e butë e thënë në gjuhën e tyre “ua ngjeshi paq”. Këta donin të legalizonin pasuritë e vjedhura, prandaj ia dhanë votat. Saliu tani nuk ka kohë t'i legalizojë, edhe pse iu ka shkelur syrin që “do ta bëj, po fitova këtë herë”; katundarët që duan të zgjidhin problemin e tyre e dinë se Saliu u soll sipas parimit “kalova lumin, ua vrava kalin”. Dhe tashmë e dinë se duhet të mendojnë gjithkush për të vetën. Sepse këta që po vijnë janë të uritur dhe e kanë oreksin e madh, duan para. Ndaj katundarët, qytetarë ilegalë në sytë e tyre, duhet të zgjidhin qesen e të paguajnë ryshfete edhe tetë vite të tjerë për pronat që i kanë vjedhur, zënë, grabitur e blerë. Po i paguajnë ato prona katërfish më shtrenjtë sesa t'ia kishin dhënë pro-

narit paratë në dorë. Pushkën nuk e marrin dot se të gjithë djemtë i kanë rrugëve të botës me veprimtari ndërtimtare, artistike e krijuese dhe gjithkush do të këqyrë atë të vetën. Kur të vijë ‘filani’ do t’i japin paratë e do të kujtojnë Saliun dhe as nuk do të munden të protestojnë. Nuk zgjidhen më punët me mitingje te ish-Pallati i ish-Kulturës. Lulzim Basha e ka bërë lulishte, tamam lulishte katundare, që funksionon vetëm kur nuk ka makina në lëvizje. Ky është një problem i madh për Saliun.

Ka shumë për të thënë, por shqetësimi i madh i Sali Berishës është ky: pas këtyre zgjedhjeve të gjithë këta elementë do të vihen në pikëpyetje. Pikëpyetja kryesore që mundon atë dhe Trustin e Gështenjave është se si do të sillen këto shtresa. Saliu e din se nuk e ka jetën e gjatë, trashëgimtarët që po lë në PD janë pesha të lehta, përkulen lehtë para dhe prapa, majtas dhe djathtas dhe se sjellja e të gjithëve në lojë, motivohet nga tre parimet e sprovuara katundare, “kalova lumin, të vjedhi kalin”, “gjithkush për atë të vetën” dhe “qeni leh atje ku ha”.

Në vitin 1992, PD e kreu misionin historik të mashtrimit të shqiptarëve. Saliu e ringriti me mjeshtëri të jashtëzakonshme në një parti politike qeverisëse pas vitit 1997, dhe tashmë e ardhmja e tij, e Trustit të Gështenjave dhe e Familjes, varet nga aftësia për t’i mashtruar edhe një herë shqiptarët. Por si edhe u prek përciptazi këtu, pas zgjedhjeve loja do të luhet me rregulla të tjera. Varet a do t’i hipë Saliu kalit të qeverisjes apo gomarit të opozitës, a do të jetë Don Kishoti apo Sanço Pança, edhe pse të dy rolet i njeh mirë. Por varet edhe nga sjellja e palës tjetër të parisë. Pas 2005, Saliu u soll si xhentëlmen me ta, nuk i preku fare, por vetë Edi Ramës i ka punuar qindin dhe kushedi çka i kalon nëpër mend Edit dhe atyre që po presin rradhën. Se këta janë ujq të uritur dhe e kanë oreksin e madh...

PARIA E TIRANËS DHE VERBËRIA POLITIKE E POPULLIT

Paria e Tiranës e ka gjetur zgjidhjen politike që iu shërben interesave të saj. Duke qenë se në indoktrinimin e mashtrimin gjigand që ka ndodhur tash disa dekada, shqiptarët e kanë humbur fillin e së vërtetës dhe nuk e kanë një ide të qartë të asaj çka duhet bërë, paria po i zgjidh me shpejtësi të gjithë problemet e saj. Nga ana e tyre, njerëzit tanë po sillen si qorrrat që prekën me duar elefantin. Njëri preku dhëmbin e madh dhe e quajti gur. Tjetri preku feçkën dhe e quajti gjarpër. Tjetri preku këmbën dhe e quajti pemë. Tjetri preku syrin dhe e quajti kandil deti. Mandej qorrrat nisën me u rrahë, sepse nuk pajtoheshin me njëri - tjetrin se çka ishte elefanti.

Kjo është edhe natyra e zgjedhjeve dhe bindjeve politike në shtetin shqiptar. Dallimi është se elefanti nuk kishte ndonjë interes në këtë punë, sepse problemi i identifikimit të problemit ishte vetëm problem i qorrave. Të kishin sy, qorrrat do të binin të gjithë dakord e do të thonin se ishte një elefant, një kafshë që ka pjesë të ndryshme të trupit dhe se ata kishin prekur pjesë të ndryshme të trupit të elefantit.

Rrahja jonë elektorale dhe politike, protestat e kacafytjet i ngjajnë kësaj ndodhie. Nga jashtë, në nivelin e popullit, politika shqiptare duket një rrahje e marrë midis qorrave politikë. Po të kishin sy, njerëzit do ta shihnin se palët e parisë janë pjesë e gjymtyrë e parisë së Tiranës që është problemi, elefanti për të cilin grindemi, sepse ne thjesht prekim një gjymtyrë a një tjetër dhe ato nuk janë njëlloj e nuk duken njëlloj.

Por lidhja e shumëfishtë që këta kanë me njëri - tjetrin, i ka bërë si një elefant. Të gjithë këta janë të lidhur me njëri - tjetrin, me martesë, me interesa, me shoqëri konviktesh, me bashkëfajësi krimesh, me dashnore, me bashkëpronësi biznesesh dhe mbi të gjitha, me origjina katundesh specifike që lindin me shumicë dhe pa ndërprerje udhëheqësa politike e afaristë, sikur ajri i malit afër teqesë dhe uji i kronit afër kullës të kenë diçka magjike.

Ja disa shembuj që e ilustrjnë këtë lidhje të pashkëputshme midis palëve të parisë.

Së pari, një hata e madhe që ia nxori petët lakrorit, ishte Gërdeci. Të gjithë ishin në tavë, të gjithë ishin e kishin pjesë, të gjithë politikanët e parisë ishin të lidhur me krimin që bëri hatanë dhe hodhi në erë një fshat të tërë e terrorizoi Tiranën. Ai që ka dyshim, të dëgjojë tabulatet telefonike dhe figurativisht do të gjejë në një dhomë të errët allishverishesh Sali Berishën, të bijën dhe vetë të Bekuarin Apostolik, pisqollën mediatike, Fahri Balliun, Edi Ramën, Fatmir Mediun, kunatin e kunatën e Sali Berishës dhe të gjithë të tjerët që “nuk dinin” e nuk folën, që nga presidenti Bamir Topi, te zëvendësi i tij Kreshnik Spahiu, që nga Ilir Meta tek ata që dinin e që ruajtën interesat e përbashkëta, që e qepën gojën e nuk folën.

Së dyti, le të shihet pak organizimi i zgjedhjeve. Këta i kanë bërë të gjitha gati që t'i vjedhin, që nga Kodi Zgjedhor, te listat e komisionerëve e te votuesit dhe i kanë gati edhe marrëveshjet se kush do të qeverisë nesër. Përditë shahen me libër shtëpie në televizionët e në gazetët paçavure, por marrëveshjet i bëjnë urtë e butë dhe pa asnjë problem.

Së treti, një fenomen interesant është edhe riciklimi. Vetëm në Tiranë politikanët i ndërrojnë partitë si ua ka qejfi dhe interesi. Lista është shumë e gjatë. Droga? Politikanët tanë kapen në aeroporte me drogë. Trafikimi? Politikanët tanë janë të lidhur me të gjithë bandat e mundshme. Korrupsioni? Politikanët tanë janë kapur me video, me zë, në banjo, në tavan, në dhomë, me mbërthecka, pa mbërthecka, duke marrë para,

duke u sjellë si kafshë dhe të gjithë e dinë e nuk flasin. Vajza e kujt u martua, me kë? Kush i bëri pushimet, ku me kë? Kur të verifikohet lista e pafund e pronave që kanë blerë jashtë, e llogarive që kanë, e pasurisë që kanë vënë, e me radhë, do të shihet se këta nuk e kanë seriozisht as rrahjen e as politikën. Këta rrihen si në cirk. Sa mbarojnë rrahjen në televizionin e rradhës, i fusin një paçe me kokë e me gjuhë lope, me pak uthull vendi, se të paktën atë e prodhojmë tani dhe fërkojnë duart që ia futën edhe kësaj here popullit shqiptar. Këta na urrejnë dhe në mendjen e tyre, ne jemi një popull kot, pis e budalla që mashtrohet për një kockë, e që këta kanë vendosur ta rrjepin të gjallë, deri sa të mos i mbesë as gjurma.

Që të kthehemi te fabula e fillimit; qorrat u rrahën, po një i mençur ua tha të vërtetën dhe ata i kërkuan falje njëri - tjetrit. Në rastin tonë, ne i kemi sytë në ballë dhe e shohim se si është elefanti. Elefanti është e vërteta e madhe që të gjithë e dinë, por që nuk kanë guxim ta thonë hapur: këta janë në tavë të gjithë bashkë, kjo është paria e Tiranës. Zhurma mediatike, rrahja e bisedat më emisionet e shpëlara e pa pikë vlere, bombardimi me emisione si Big Brother Albania e me rradhë, i shërbejnë shpëlarjes së trurit të shqiptarëve. Këta janë kundër shqiptarëve, këta duan të na hanë të gjallë, këta kanë punuar e vazhdojnë të punojnë pa pikë hezitimi kundër nesh. Këta janë të gjithë njëloj. Këta janë kriminelë, vrasës, trafikantë, banditë, gjakpirës, shkatërrues e zvetënues të së ardhmes së fëmijëve tanë. Këta punojnë ditë e natë për vete dhe kundër interesave tona. Shqiptarët duhet të zgjohen e të shohin të vërtetën. Ajo që ka ndodhur nën sundimin e tyre, është një krim i bërë kundër nesh. Ajo që do të ndodhë në të ardhmen, do të jetë një krim që do të shkatërrojë jetën e të ardhmen e fëmijëve tanë.

Në përfundim, kjo gjë duhet thënë e përsëritur kaq hapur e shqeto, sepse kur të na hapen sytë, këta do të kenë ikur në parajsat e republikave te bananeve ku kanë fshehur pasuritë e ndërtuara me gjakun tone, që i kanë vjedhur pa mëshirë e

pa u menduar dy herë. Atëherë ndoshta nuk do të jemi më qorra, por duke mos i pasur afër, do të vazhdojmë të rrihemi me njëri - tjetrin pse nuk bëme asgjë, kur po na e pinin gjakun të ngrohtë e pa pikë mëshire. Si thuhet diku, unë e thashë të vërtetën dhe e kam ndërgjegjen e qetë. Ti që po e lexon këtë shkrim dhe që ke arritur deri këtu, mendohu mirë para se të thuash mendimin tënd. Jo për tjetër, por skllavëria fillon me vetëmashttrimin dhe me vetëbindjen se e vërteta është ndryshe prej asaj që është. Mos u bëj qorr me sy në ballë! Thuaji “jo” parisë së Tiranës!

FENOMENI BEPPE GRILLO SI PROBLEM PËR PARINË E TIRANËS

Fenomeni Beppe Grillo, komediani që mori 19 % të votave në Itali dhe që ka futur në krizë të thellë sistemin politik tërësisht të korruptuar italian, është një dukuri e pritshme në çdo demokraci. Nëse njerëzit nuk besojnë më te sistemi politik e te partitë, nëse janë të zhgënjyer me udhëheqësit e tyre, nëse nuk kanë besim se udhëheqësit punojnë për ta, nëse janë të bindur se shtypi e media janë një mashtrim, nëse nuk kanë ku të mbështeten, sepse të gjithë mendojnë se si t'i përdorjnë e t'i poshtërojnë, atëherë ata mbështesin gjithkënd. Kandidati mund të jetë një gazetar populist në Izrael që mori nëntëmbëdhjetë vende në parlament. Mund të jetë Partia e Birrës në Poloni që mori gjashtëmijë vota, apo mundësi Jessie Ventura që u bë guvernator i shtetit Minnesota në SHBA dhe natyrisht pompuesi i shtangave Arnold Schwarzenegger që u bë dy herë guvernatori i Californisë.

Italia ka një traditë të shënuar që të zgjedhë në parlament figura të kulturës dhe të kundërkulturës. Para Beppe Grillos ka qenë Berlusconi. Para Beslusconit ka qenë Ciçiolina. Pas Beppe Grillos do të vijë prapë Berlusconi. Pas tij do të dalë ndonjë Ciçiolina tjetër. Prandaj fenomeni Grillo duhet kuptuar në kontestin italian edhe pse nuk ka kuptimin e duhur kund tjetër.

Italianët e shohin demokracinë si një formë argëtimi dhe nuk e marrin shumë seriozisht. Ama ata e marrin aq seriozisht, sa t'iu thonë të gjithë partive të tyre jeni hajdutë, të korruptuar e nuk i shërbeni popullit. Vota e tyre është votë e qartë proteste. Shteti italian është një shtet i fortë dhe i kon-

soliduar. Ekonomia mund të jetë në krizë dhe vendi i mbytur në borxhe, por Italia ka burime të shumta. Fenomeni Grillo, tregon mbi të gjitha, se Italia ka një shoqëri civile të gjallë që nuk i lejon politikanët të bëjnë si të duan. Grillo nuk e ka shembur partitokracinë italiane, por i ka dhënë një goditje të fortë. Ajo që nuk thuhet me zë të lartë, është se Grillo përfaqëson të pashpresët, njerëzit që nuk besojnë më në asgjë, që nuk kanë sisteme të qarta ideologjike dhe vlera dhe që janë në kundërshtim të plotë me atë që përfaqëson sistemi politik në Itali. Kjo është votë urrejtjeje e proteste.

Përse ka kaq shumë interes për fenomenin Grillo në shtetin shqiptar?

Për ne, njëri ndër aspektet më interesantë të fenomenit Grillo është interesi i jashtëzakonshëm që ka ngjallur në shtypin dhe mediat e Tiranës. Të gjithë komentatorët dhe analistët e shitur dhe të paguar mirë, po diskutojnë me passion atë që përfaqëson fenomenin Grillo në politikën italiane. Jo vetëm aq, kanë nisur të përkthejnë shkrime të autorëve italianë e të huaj që merren me Grillon. Megjithatë, ajo që të bie në sy është cektësia e analizës së tyre. Sa për të larë gojën, thonë se një Grillo është i mirëseardhur në politikën shqiptare dhe gjithë argumentet e mëpastajmë i ndërtojnë që të mbështesin tezën se Grillo është i pamundshëm në kontestin shqiptar.

Kush janë këta që flasin? Të gjithë këta njerëz që kanë ndikim në opinionin publik shqiptar, që në të ardhmen jo të largët duhet të shërbejnë si ilustrime jo vetëm të injorancës, por edhe të nivelit më të ulët të karakterit të njerëzve që shesin penën, mendjen e nderin, merren me Grillon në një mënyrë që vetëm katundarët e bëjnë. Para së gjithash, katundari praktik mendon për katundin e vet. Këta analistë që nuk kanë pikë dëshire të thonë të vërtetën, merren me Grillon si problem shqiptar.

Shqetësimet e tyre të përbashkëta janë disa. Mund të veço-

hen disa pyetje që duhen përkthyer në shqipen popullore. A do të ketë një Grillo shqiptar? Kjo përkthehet, a do të dalë kush kundër sistemit të parisë së Tiranës? Pyetja tjetër është çka mund të thotë ky Grillo shqiptar? Kjo përkthehet, a do të jetë ky Grillo shqiptar nën kontrollin e partive sunduese apo jo? Një pyetje kryesore është nëse sistemi është i ndryshëm nga ai italian, asnjë Grillo nuk mund të fitojë? Kjo përkthehet, paria e Tiranës e ka kapur vendin e sistemin demokratik për fyti dhe nuk ka më shpresë. Pyetja tjetër është me kë do të punojë ky Grillo shqiptar? Kjo përkthehet në këtë mënyrë, populli ynë është tërësisht i korruptuar, kështu që hiqeni shpresën se mund të ketë ndryshime nga poshtë. Ju që jetoni në këtë ferr që është shteti shqiptar të sunduar nga paria e Tiranës, ku mbretëron poshtërsia, krimi, droga, ndytësia njerëzore e zvetënimi, duhet të hiqni shpresat.

E kështu, këta komentatorë që me modesti ngrenë supet e shprehin keqardhjen hileqare të katundarit që të ka shitur lopën shterpë, japin mend se si të veprohet dhe rrejnë e mashtrojnë, sepse kështu iu kërkohet prej padronëve të parisë. Argumenti i tyre është: kjo gjendje është e pashmangshme dhe duhet të dorëzohemi, sepse nuk ka më shpresë.

Këta opinionistë karagjozë e të pandershëm nuk e shkojnë ndërmend se si dikush mund të flasë si Grillo në Tiranë. Këta nuk besojnë se shqiptarët mund të besojnë në ndryshimin e mundshëm. Këta besojnë se sistemi është i patundshëm, i pandryshueshëm sepse, si populli, si rregullat, ashtu edhe paria janë të korruptuar deri në ekstrem dhe jemi kaq keq, sa edhe duke parë majtas e djathtas, që nga Fresku deri në Kashar, nga Krraba në Laknas nuk gjendet askush që del kundër sistemit të parisë së Tiranës.

Morali është i thjeshtë: “këta jemi, mos kërkoni ndryshim. Bindjuni parisë sunduese. Ky është fati i juaj. Keni qenë skllevër e skllevër e meritoni të jeni. Ne po ua themi këtë, sepse dimë diçka, por ju mos shpresoni. Jeni një popull pis e ashtu do të ngordhni”. “Unë jam pjesë e parisë”, i thonë këta popullit

shqiptar, “jo si ju, që jeni rob kot, mish për top, e shpirtra të humbur”. Këta janë pjesë e parisë së Tiranës, vegla e saj, ata që i urrejnë shqiptarët dhe që ndoshta e mallkojnë fatin që kanë lindur shqiptarë.

A iu duhet shqiptarëve një Beppe Grillo?

Këta opinionistë e komentatorë bëjnë me shumë zell punën e parisë. Të gjithë kanë nga disa apartamente, kanë disa biznese, kanë shtëpi, kanë lidhje të forta e të ardhura gjithfarësh. Të gjitha vijnë nga paria. Ajo që këta thonë është një krim më vete, sepse po i bëjnë me bindje të plotë shërbimin për të cilin paria ka qaq shumë nevojë. Shqiptarët kanë nevojë për mend. Nëse këta nuk kanë të japin, më mirë të qepin gojën e të shkojnë të mbjellin fiqtë në arën e gjyshit në majë të maleve heroike. Ndoshta janë ma të mirë si katundarë, se si komentatorë.

Shqiptarët sot kanë nevojë më shumë se kurrë për një zgjidhje. A quhet ajo zgjidhje Beppe Grillo, lëvizje, parti, shoqatë, klube, rrethe, organizatë etj., nuk ka fare rëndësi. Ajo që ka rëndësi është se ka ardhur koha për një forcë të re, me një ideologji të qartë, me vlera të qarta, që iu beson shqiptarëve dhe që kërkon votën e tyre për ndryshimin e gjendjes në dukje të pashpresë. Shqiptarëve iu duhet një zgjidhje. Këta nuk janë zgjidhja, shkrimet e tyre janë si tymi i temjanit, hi syve popullit që edhe ashtu nuk din si me veprue.

Shqiptarëve iu duhet një Grillo, sepse gjendja ku jemi është e frikshme dhe do të përkeqësohet edhe më shumë. Shqiptarëve iu duhet një Grillo, sepse sistemi politik është oligarki e padyshimtë e parisë së Tiranës organizuar në klane kriminale. Shqiptarëve iu duhet një Grillo, sepse shoqëria është thellësisht e kriminalizuar dhe e karakterizuar nga një sistem sundues vlerash që nuk është moralisht i shëndoshë. Shqiptarëve iu duhet një Grillo, sepse paria sunduese është e korruptuar, plutokrate dhe kleptokrate. Shqiptarëve iu duhet një Grillo,

sepse shteti shqiptar është i kapur nga krimi. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse shoqëria civile që numëron me mijëra organizata, është krejtësisht e paralizuar. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse sistemi sundues i vlerave është imoral, materialist në ekstrem dhe i kapur nga krimi. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse partitë politike janë banda në shërbim të klaneve të caktuara. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse drejtues të shtetit zgjidhen pikërisht ata që kanë bërë më shumë krime, vjedhje, vrasje dhe që kanë përgjegjësi të padiskutueshme. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse nga shteti shqiptar janë trafikuar me qindra mijëra femra dhe fëmijë. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse ekonomia ka qenë dhe është një seri piramidash financiare. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse e vetmja industri që njeh rritje janë lojrat e kumarit. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse policia nuk lejohet të hyjë në shumë fshatra e zona që prodhojnë dhe eksportojnë drogë ditën për ditë siç është, bie fjala, Lazarati. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse jashtë unazës së Tiranës, varfëria është në nivele të papara. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse një ndër katër prej tyre ka probleme mendore. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse shkalla e shkatërrimit të familjes është e frikshme. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse gjendja e shërbimeve shoqërore, mjekësore dhe arsimit është katastrofike. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse paria sunduese jeton një jetë të paparë, zhytur në luks e në qejf dhe e urren popullin e vet. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse paria është haptazi jashtë ligjit, mbi ligjin dhe e paprekshme. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse ky është një vend prej të cilit edhe ata që e sundojnë dhe e shfrytëzojnë duan të ikin sa më shpejt të munden. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse ky është një vend ku të gjithë politikanët kërkojnë dikë nga të huajt që t'i sundojë dhe të mbajë përgjegjësinë për punët e shtetit. Shqiptarëve i duhet një Grillo, sepse sistemi që është vendosur është qartësisht plutokrat, kleptokrat dhe oligarkik, ku shqiptarët janë të sunduar me dorë të hekurt nga të njëjtët

sundimtarë që kishte në sistemin e mëparshëm, por tani të pasuruar në nivele marramendëse. Shqiptarëve iu duhet një Grillo, sepse tranzicioni që duhej të ofronte një jetë më të mirë për të gjithë shqiptarët, ka rezultuar në ndërtimin e një sistemi politik oligarkik, të një sistemi ekonomik monopolist dhe shitblerës, në polarizimin ekstrem të shoqërisë në plutokratë dhe në të varfër, si dhe në shkrirjen e plotë të shtetit dhe kapjen e tij dhe shoqërisë nga krimi i organizuar. Shqiptarëve iu duhet një Grillo, sepse kjo është gjendja në të cilën ndodhemi.

Një program i shkurtër politik për një Grillo shqiptar

Paria po punon në ethe të pengojë daljen e çdo force të re që iu kundërvihet interesave të saj. Parinë e Tiranës e dëmton një parti që punon për shqiptarët, që mban parasysh interesat e tyre dhe që provon se nuk është vegël e instrument i klaneve të parisë. Por edhe atëherë, të gjithë palët e parisë do të bëhen bashkë për të shmangur forcat që mund të marrin vota kundër tyre.

Koha ka ardhur për një fillim të ri. Nevoja për ndryshim është e pashmangshme. Forcat e reja politike që duan ndryshimin duhet të kuptojnë mirë se cilat janë rrugët e ndryshimit të vërtetë. Ndryshimi duhet mbështetur në vlerat e vërteta të një populli si shqiptarët dhe në një projekt të ri modernizues, të balancuar dhe të mbështetur në themelet e forta të elementëve të mëposhtëm:

Së pari, në identitetin e padiskutueshëm të shtetit - kombit.

Së dyti, në një sistem politik demokratik.

Së treti, në një administratë shtetërore të pakorrruptueshme e të mbështetur në ligj.

Së katërti, në një ekonomi tregu të institucionalizuar ku i jepet përparësi prodhimit kombëtar.

Së pesti, në një politikë të jashtme të bazuar në interesin kombëtar.

Së gjashti, në luftën e pakompromis kundër krimit e kundër

të keqes në çdo formë që të materializohet e keqja shoqërore.

Së shtati, në krijimin e në kultivimin e vlerave të vërteta të një shoqërie që krijon mundësi për të gjithë.

Së teti, në kultivimin e vlerave të një shoqërie civile efektive.

Së nënti, në ndërtimin dhe konsolidimin e strukturave të shërbimeve shoqërore si edukimi, shëndetësia, mbrojtja e fëmijëve dhe pensionistëve.

Së dhjeti, më në fund, por jo më e fundit, ndërtimi i një politike të jashtme e cila të avancojë interesat shqiptare.

Çdo përpjekje për ndryshim, qoftë në formën e një programi politik, qoftë në formën e një pakete ndryshimesh ligjore, çdo Grillo shqiptar që nuk mban parasysh këto parime themelore, është i/e destinuar të dështojë. Këta elementë janë pjesë e pandashme e çdo projekti për përmirësimin dhe shërimin e gjendjes. Por ata që marrin përsipër këtë detyrë, ata që duan të jenë Grillo shqiptarë, duhet të jenë të përgatitur të përplasen me një pari që do të përdorë çdo mjet në dispozicionin e saj, edhe në format ekstreme të dhunës e të terrorit shtetëror e mafioz, për të ruajtur pushtetin politik dhe kontrollin mbi ekonominë e mendësinë e popullit që sot e sundon në mënyrën më kriminale të mundshme.

A do të ketë mbështetje një Grillo shqiptar?

S'ka dyshim që shqiptarët janë të ngopur me zvetënimin e parisë, me sundimin kriminal, me përpjekjen për ta shkatërruar, zvetënuar, përbaltur e përjargur gjithçka. Shqiptarët janë gati të mbështesin alternativa të tjera. Shqiptarët duan të shohin nga e ardhmja. Ai që nuk ka frikë nga kërcënimet e parisë, ai që e sheh në sy vdekjen, ai që vendos të vrasë kriminelin, të ruajë nderin e shqiptarëve, të zgjidhë problemin e pronave, të ndërtojë ekonominë, të strukturojë si duhet sistemet e arsimit, të shëndetësisë, të pensioneve, ai që do të punojë për ruajtjen e kultivimin e vlerave njerëzore, ai që do të çojë

në trekëmbësh kriminelët, hajnat e cubat, ai që do të punojë për të drejtat e emigrantëve, ai që do të ndërtojë një strehë për të kthyerit, për të pambrojturit, të pazotët, të përbuzurit, në fund, ai që nuk do të shitet te paria e Tiranës, te klanet e saj, do të jetë një Grillo për shqiptarët.

Ne jemi një popull katundar, me anë të mira e të këqia, kemi katundarë të mirë e të këqij, por Grillo do të jetë njëri prej nesh. Gramoz Ruçi i përbuz katundarët. Sali Berisha i përdoron. Ilir Meta i korrupton. Fatos Nano i degjeneron. Edi Rama nuk i kupton. Bamir Topi i mënjanon. Ai Grilloja, po erdhi, duhet të jetë një katundar si ne, që të na ndryshojë. Për të mirën e të gjithëve, edhe unë do të jem ndjekësi e militanti i tij i bindur.

KOMBËTARIZMI DHE ZGJEDHJET E PARISË SË TIRANËS

Paria e Tiranës po ia arrin të kanalizojë debatin politik dhe zgjidhjen në lidhje me zgjedhjet e ardhshme kuvendore, në ofrimin e njërës pjesë të vetes si e keqja më e vogël. Por kjo është lojë me hijet në mur; djajtë janë veshur si engjëj e njerëzit shohin hijet e tyre në murin mediatik. Këta nuk kanë e nuk ofrojnë zgjidhje të mirëfillta politike e programe për të adresuar gjendjen kritike. Ka një kauzë rotacionale që parqitet si antiregjim, riciklim dhe ndryshim apo ecje përpara nga pala tjetër. Po përtej kauzave rotacionale, kësaj here secila zgjidhje e parisë është e veshur me terma, flamuj e koncepte kombëtariste. Kombëtarizmi është bërë më shumë se asnjëherë tjetër i pranueshëm dhe legjitim në politikën shqiptare. Si në përrallë, duke ndjekur interesat e veta të ngushta, këta e kanë nxjerrë xhindin nga shishja dhe xhindi nuk do të hyjë më në shishe. Kombëtarizmi është i papajtueshëm me interesat, me sjelljen, me qenien dhe me vlerat e parisë së Tiranës.

Papajtueshmëria e kombëtarizmit me parinë e Tiranës dhe varfëria e saj ideologjike, shihet te e shkuara e prijatarëve, te përbërja e partive, te përpjekjet për ndërtim koalicionesh dhe te programet politike. Duke mbledhur nën strehën e partisë respektive të gjithë mbeturinat e hedhurinat partiake, partitë e parisë së Tiranës duken si varreza makinash të dhëna me qera në shumë duar dhe të stërpërdorura në rrugën e Krujës. Nga ana e PD, pas përdorjes së gjithfarë individëve që politikisht duhen përcaktuar si qese plastike të stërpërdorura,

në këtë junkyard politik duhet të kthehet edhe një shitës i sprovuar makinash të përdorura si Eduard Selami. Nga ana e PS, këto mbeturina janë të ricikluara përmes shumë viteve në bizneset familjare, OJQ, në jetën civile dhe ndodh që bëhet lajm bombastik kthimi i dikujt që Fatos Nano në mbledhjen historike tragjikomike të KPD të PS e quajti "lavatriçe". Kush ka mbetur pa u kthyer, duhet të tregojë besnikërinë ndaj partisë e udhëheqësit pa kushte në shtypin e partisë, ose të bizneseve që presin të përfitojnë nga lidhjet politike, mbështetja që i japin partisë dhe shefit në këto zgjedhje.

Papajtueshmëria e sjelljes së partisë me kombëtarizmin shihet edhe në metodën e mobilizimit dhe në zgjidhjet që ofrohen. Pavarësisht përdorimit të simboleve e koncepteve kombëtariste, ajo që mungon në këtë mobilizim e përplasje të pandërprerë që do të kulmojë me mitingjet qindra e mijë-ravetëshe në sheshet e Tiranës, është ideologjia dhe sistemi i qartë i vlerave kombëtariste. Paria e ka gënjyer dhe mashtruar popullin shqiptar sistematikisht e pa kurrfarë brejtje të ndërgjegjes. Tashmë që miti i saj, integrimi evropian, është sprovuar të jetë një mashtrim i pashembullt, sepse shqiptarët nuk janë evropianë, BE nuk na don dhe integrimi nuk do të ndodhë, paria po i kthehet kombëtarizmit. Ajo mendon se njerëzit do ta harrojnë mashtrimin me integrimin evropian. Integrimi nuk bëhet, nuk arrihet, nuk do të ndodhë. Kombëtarizmi po përdoret për të mbuluar dështimin e parisë.

Në nivel të programeve, Sali Berisha dhe PD nuk kanë program dhe natyrisht as ndonjë ideologji të qartë. Sllogani i tij është "Përpara". Po përpara ai ka trishtimin e pleqërisë së thellë, dështimin e familjes, si dhe shkërmoqjen e Trustit të Gështenjave të Tropojës ndërsa ne kemi greminën morale dhe ekonomike buzë të cilës na kanë sjellë.

Edi Rama ka një farë programi, por programi që propozohet është një zhbërje e vendimeve të qeverisë së deritanishme, thënë me një shprehje kumarxhinjsh në modë në parinë e Tiranës, domethënë "don me i përzie letrat" e me nxjerrë diçka

për mbështetësit e deputetët e vet. Shkurt, pavarësisht si do ndodhë, rotacioni është vazhdimi i lojës së njohur katundare me variacionin e pritshëm, gjithnjë në kurriz të shqiptarëve sipas parimit “në ato maja rripa - rripa, herë ia hipe, herë ia hipa” të përtypjes së kockave që i kanë ngelur shtetit dhe ekonomisë shqiptare.

Cilido që të fitojë nga palët e parisë, do të dalin “jek e jek”, sepse çmimin do ta paguajë populli shqiptar që këta e trajtojnë si skllavin e tyre. Këta janë të bindur që populli nuk ka zgjidhje të tjera. Këta po punojnë me ethe të mos ketë zgjidhje të tjera. Edhe përdorimi i kombëtarizmit është në funksion të këtij qëllimi; shqiptarët të mos kenë zgjidhje të tjera. Duke e marrë vetë flamurin e kombëtarizmit këta nuk lënë të tjerët të hyjnë në lojë me besueshmërinë e duhur.

Por dihet pa filluar se slloganet kombëtariste që përdor me kaq bollëk, nuk do ta ndryshojnë fare sjelljen e parisë. Edhe gjatë këtyre zgjedhjeve, metodat kryesore të përdorura prej saj për të arritur objektivat do të jenë ato që kanë qenë gjatë gjithë tranzicionit. Personalizimi i sherrit, akuzat e shfrenuara dhe surreale, organizatat fantazmë që akuzojnë për gjithçka e gjithkënd, simbolizimi i nuancuar dhe i halabakëzuar, gricja e plagëve historike, shmangja e problemeve reale, propaganda e shfrenuar mediatike përmes dhjetra gazetave, radiove e televizionëve në shërbim të klaneve të parisë, terrori ekonomik me bukën e gojës, kriminalizimi i shpejtë dhe i mëtejshëm i shoqërisë, diskreditimi publik dhe sistematik i të gjithë kundërshtarëve, rekrutimi si instrumente të hapura e të paguara i analistëve dhe opinionistëve, tallja me investimet, loja me interesat jetike të një populli të çoroditur, manipulimi me listat, komisionet zgjedhore, me të huajt, me stabilitetin rajonal, loja e paskrupullt me mendësinë katundare, përzgjedhja e më të përlyerve si kandidatë, e kështu me radhë.

E vetmja pikë për të cilën nuk do të diskutohet, është ndershmëria. Kur duhet me vjedhë, hajnat bëjnë atë që janë mësuar të bëjnë instinktivisht dhe politikanët tanë do të sillen

njëlloj; ata do t'i vjedhin edhe këto zgjedhje. Shkurt, ky është një film që e kemi parë dhe që dihet si do të përfundojë.

Kombëtarizmi është mashtrimi i rradhës i përdorur nga paria. Po atëherë pse paria e Tiranës po i drejtohet përherë e më fort kombëtarizmit? Shpjegimi duhet kërkuar te interesat e saj të ngushta.

Së pari, paria e Tiranës janë një grusht klanesh oligarkike që mendojnë vetëm e vetëm për pushtetin e pasurimin e tyre, që i urrenjë shqiptarët dhe kanë punuar sistematikisht, pa ndërprerje dhe pa pikën e vrasjes së ndërgjegjes, kundër interesave të shqiptarëve. E megjithatë këta po i bien me shumë fuqi tupanit, daulles, lodrës nacionaliste. Sjellja e tyre nuk është e besueshme. Këta nuk janë kombëtaristë shqiptarë, nuk kanë qenë ndonjëherë, nuk kanë pasur si të jenë. Këta janë përfaqësues të klaneve të krimit në politikë. Një politikan kombëtarist punon jo për të vjedhur, vrarë, dëbuar, zhvatur, degjeneruar, kriminalizuar, shkatërruar, rrënuar e shitur kombin e vet. Një politikan kombëtarist punon për ta lulëzuar, ndërtuar, begatuar, mbrojtur, nderuar, vlerësuar, punon me dashuri për popullin e vet. Këta nuk janë kombëtaristë, por hajna. Arsyeya pse po sillen si kombëtaristë dhe e kthejnë pllakën sa iu flet një përfaqësues i huaj, nuk është vetëm se janë mësuar të hapen e të mbyllen pa shumë vështirësi dhe ta veshin e ta zhveshin petkun sipas parimit "ktheje nga të fryjë era". Këta po sillen si kombëtaristë, sepse populli shqiptar ka pësuar një ndryshim të thellë gjatë këtyre viteve tranzicion.

Së dyti, përtej interesave të ngushta të parisë së Tiranës, arsyeja e vërtetë pse këta po i drejtohen kombëtarizmit, është ndjenja kombëtare e zgjuar ndër shqiptarët. Kombëtarizmi, bindja se shtet - kombi është zgjidhja, edhe pse e pashtjelluar dhe kuptuar si duhet, ka zënë rrënjë. Shqiptarët, si ata që kanë qenë në mërgim dhe kanë parë shtete normale, si ata që janë zhgënjyer gjatë tranzicionit nën sundimin e parisë, si brezi i ri që nuk ka njohur sisteme të tjera dhe kërkon punë, nder e dinjitet, e ndiejnë se zgjidhja është një shtet - komb normal.

Është e habitshme, por ka edhe nga ata që kanë gabuar një kohë, e tash po duhet t'i përjetojnë në kurriz prej fëmijëve të tyre, atë që iu kanë bërë të tjerëve. Të gjithë pra, kanë filluar të kuptojnë se pa shtet e pa komb, nuk ka as përparim, as begati, as nder, as dinjitet, as zhvillim e progres. Pasi na shpërtheu qelbi që kishim në shpirt dhe pasi kemi provuar e sprovuar shumëçka, pasi iu lamë rrugë të lirë veseve e shtrembësisë njerëzore, tashti kemi filluar të duam, të jemi njerëz dhe e kemi kuptuar se duhet të jemi njerëz. Dhe njeriu është njeri në një shoqëri kombëtare, me një shtet të fortë që mbron interesat e njerëzve.

Prijatarët e parisë e ndiejnë se në mendësinë tonë po ngre kokën ai katundari i mençur pozitiv, ai që e don dinjitetin e nderin, ai që e kupton se duhet një shtet ta mbrojë nga e keqja, ai që e sheh se krimi është rruga e ferrit, ai që e kupton se kjo rrugë ku jemi nisur është rruga e pashpresë. Ky është xhindi që ka dalë nga shishja. Tashti këta duan të votojë për ta katundari fisnik shqiptar, ai dhe ajo që mendon për familjen, që kursen, që sakrifikon, që ndërton, që lufton me thonj e me dhëmbë me jetën. Këta duan që ai katundari fisnik të bëhet bashkëfajtor në krimin e tyre. Dhe për ta bërë bashkëfajtor, e ndjellin me dashurinë e katundarit për familjen, për nderin, për kombin. Dashuria e fëmijës për nanën është e verbër, dashuria e të pashpresit, atij që nuk ka më shpresë në të ardhmen e vetveten, për grupin që i jep mbrojtje, nder e dinjitet, është shumë e fuqishme. Duke përdorur flamuj e fjalë ndjellëse kombëtariste, këta duan që shqiptarët të mos merren me krimet që kanë bërë, as të shkuarat e as të prishmet. Si gjithnjë, paria i thotë popullit atë që populli dëshiron me dëgjue. Shqiptarët duan të jenë kombëtaristë dhe prijatarët po sillen sikur i kanë shpëtuar shqiptarët nga e keqja dhe janë gdhirë kombëtaristë.

Së treti, prijatarët e parisë së Tiranës po sillen si kombëtaristë, sepse në politikë kanë dalë forca që po gëzojnë mbështetje në popullin shqiptar. Nga një anë, duke u paraqitur si

kombëtaristë këto forca të reja duan të marrin vota dhe të dobësojnë partitë e vjetra politike. Njëherësh, forcat e reja si AKZ duan të paraqiten si aleatët e mundshëm të po këtyre forcave të konsumuara politike. Duke ndjekur me vëmendje sjelljen dhe sinjalet që po dërgohen në shtyp, shihet qartë se edhe këta që po paraqiten si kombëtaristë, kanë rënë në kurthin e klaneve të parisë. Vetë sjellja e parisë si kombëtariste ua justifikon aleancën zgjedhore që mund të bëjnë.

Por kjo lloj sjelljeje në dukje kombëtariste dhe në realitet pragmatiste, do të ishte shërbimi më i mirë që këto forca do t'i bënin vetë parisë. Kjo lloj sjellje është tejet e dëmshme për interesat e shqiptarëve. Ata që duan të punojnë për popullin e vet e bëjnë luftën politike si në Kuvend ashtu edhe jashtë tij. Nëse vërtet duan t'i shërbejnë popullit, këta nuk duhet të bëjnë kompromise me asnjërin palë. Pala e tyre duhet të jetë populli shqiptar. Këta nuk duhet as të guxojnë ta zhgënjëjnë popullin e kombin shqiptar. Por duket që paria e mendon me bindje dhe e di mirë që gjithkush në Tiranë e ka një çmim.

Po ashtu politikanët që paraqiten si kombëtaristë duhet ta dinë se kombëtarizmi nuk është pronë e tyre. Nuk e kanë shpikur ata. Nuk e kanë formuluar ata. Kombëtarizmi vazhdon edhe pa ata. Zgjidhja që kanë është ose t'i shërbejnë popullit, ose ta përdorin këtë ideologji për të marrë një karikë në kuvend. Por kjo nuk do ta ndalë kombëtarizmin si ideologji.

Së katërti, kombëtarizmi është një ideologji e pashmangshme në politikën shqiptare. Si në të gjithë rastet e kombeve në krizë, popujt nuk duhet të mbështeten te individët, por te një ideologji e caktuar dhe te zgjidhjet që ajo ofron. Duket se pas zhgënjimeve të shumta shqiptarët po kthehen te kombëtarizmi. Shprehjet e kësaj ideologjie në politikë e në hapësirën publike, tashmë janë legjitime. Prandaj sjellja e parisë ndaj kombëtarizmit, tregon qartë sesa kritike është gjendja e saj. Duke dashur të përdorë kombëtarizmin, paria ka ngjallur armikun e saj për vdekje. Duke u përpjekur të kooptojë, të lidhë në koalicione forcat që promovojnë ideologjinë kom-

bëtariste, paria po kërkon një mënyrë që të fusë xhindin në shishe.

Përdorimi i paskrupullt i kombëtarizmit nga ana e parisë dhe e veglave të saj, është jo vetëm një përpjekje e ulët dhe e pandershme për të thyer shqiptarët, por edhe një shenjë e qartë e varfërisë ideologjike që ka ngërthyer atë vetë. Përditë e më shumë, oligarkia e parisë së sotme shqiptare përdor mjete direkte ndikimi e influence, përplasje personale midis prijatarëve të parisë dhe gjithnjë e më pak argumenta ideologjikë. Varfëria ideologjike nuk mbulohet dot me këta tipa të skaduar, me këto parime dhe me këto sjellje. Varfëria ideologjike mbulohet më shumë se gjithçka nga mangësia e alternativave.

Në përfundim, kombëtarizmi është një alternativë reale, e prekshme dhe e mundshme. Edhe nëse paria ia arrin t'ia hedhë edhe kësaj here dhe t'i përdorë si zare individë të caktuar, ideologjia kombëtariste është bërë pjesë e debatit politik dhe influence e saj do të ndjehet shumë më fuqishëm në vitet e ardhshëm. Duke kërkuar ta përdorë për interesat e veta, paria e Tiranës e ka nxjerrë xhindin nga shishja. Mund t'ia hedhë edhe në këto zgjedhje, por në përplasjen me kombëtarizmin, ajo nuk mundet me fitue gjithmonë.

PAKTI I PARISË DHE ARIXHOFKAT E SHTYPIT

Llapaqenëria mediatike e parisë së Tiranës është vënë në punë shumë intensivisht, sidomos sot. Parulla që përsërisin të gjithë shkruesit, analistët e komentatorët është “çudia më e madhe zgjat tri ditë”. Bindja e tyre është se u bënë tri ditët dhe tashti njerëzit duhet ta pranojnë si diçka normale paktin e parisë së Tiranës, paktin e 1 prillit 2013. Por po shihet qartë se njerëzit nuk po e gëlltisnin dot. Prandaj të gjithë sot janë vërsulur ta paraqesin paktin e parisë së Tiranës nën dritën më të mirë. Por pakti i parisë së Tiranës është një akt kriminal me pasoja shumë të rënda që nuk mund të kapërdihet lehtë, që nuk duhet të kapërdihet lehtë e që nuk duhet të justifikohet. Sepse ky pakt është dënimi me vdekje i demokracisë shqiptare, shpallja hapur e sistemit oligarkik dhe zinxhiri politik që garanton skllavërimin e shqiptarëve. Kush thotë ndryshe, ose është vegël e parisë e duhet urreyer pa mëshirë, ose është injorant e duhet mëshiruar me keqardhje.

Në parantezë, dymbëshjetë vjet më parë kam dhënë këtu në SHBA, e për disa vite rresht rregullisht, një lëndë në nivelin universitar, Opinioni Publik në Amerikë. Pra, di se si mund të flas me profesionistët e zanatit, sepse në mos tjetër, për ca kohë kam bërë edhe unë shitësin e gatuesin e lajmeve. Por audienca që kam ndërmend janë shqiptarët e thjeshtë, jo studjuesit e profesionistët. Për ta hapi i parë është të kuptohet realiteti. Hapi tjetër është të interpretohet ai. Duke e ndjerë dhe parë zhurmën e mjegullën që po hidhet, është mirë të thuhet e vërteta. Interpretimet bëhen edhe më vonë.

Si duhet kuptuar pakti i parisë së Tiranës?

Pakti i parisë së Tiranës është një marrëveshje midis Sali Berishës, Ilir Metës dhe Edi Ramës dhe garanton interesat jetike të klaneve që këta përfaqësojnë. Edi Rama merr pushtet, edhe pse nuk dihet sesa fuqi do të ketë. Ilir Meta mban postet kyçe për punësimin se ndryshe nuk ka strukturë. Sali Berisha mbron familjen dhe ka veton politike që i duhet për mbijetesën e vet. Të tre deshën të marrin sigurinë për këto gjëra dhe sigurinë për këto gjëra e morën nga njëri - tjetri.

Nuk ka se si bëhet një marrëveshje më mafioze e më kriminale, më antidemokratike dhe më antishqiptare. Sali Berisha është kriminel mafioz, Ilir Meta është hajn mafioz, Edi Rama është i korruptuar mafioz dhe të tre janë shefat e mafiave të parisë. Pra, u mbledh kupola e krimit dhe bëri paktin oligarkik që e dënon demokracinë shqiptare me vdekje dhe që iu thotë shqiptarëve se nuk kanë më asnjë shpresë nën sundimin e këtyre. Prandaj ky vend, shteti shqiptar, është Rrethi i Ferrit dantesk në botën moderne. Ata që janë në Rreth nuk kanë më asnjë shpresë. Shqiptarët i ka braktisur Perëndia. Shqiptarët i kanë braktisur intelektualët e tyre. Duket se i kemi braktisur edhe ne, sepse jemi zemërplatur rrugëve të botës. Por po vjen dita të veshim opingat, të marrim malet edhe një herë e të shkojmë në gjurmët e paraardhësve. Pakti nuk do të harrohet, do të mbahet mend; si ajo që u vendos, ashtu edhe paturpësia e parisë në marrjen e këtij vendimi që ruan interesat, vetëm e vetëm interesat e saj. Këta janë gjarpëri që po na mbyt dhe me gjarpërin ka vetëm një gjuhë...

Shitja e paktit

Në Tiranë ka një fushatë shumë intensive për shitjen e paktit. Të gjithë palët e parisë janë vënë në punë në këtë funksion. Po ndonëse të gjithë ndajnë të njëjtat qëllime, nuk ndjekin të njëjtat metoda. Kjo ka të bëjë me tenikat e kontrollit e të ma-

nipulimit që i kanë ndjekur sistematikisht me mbështetësit e tyre dhe me masën jashtëzakonisht të madhe të shqiptarëve që nuk i duan hienat politike të parisë së Tiranës.

PD - së këtë punë ia bën Sali Berisha që formulon batutën e ditës dhe pastaj e përdorin të gjithë shkarrashkruesit e pavarureve të veta “RD”, “Koha Jonë” e “55”, përfshirë këtu edhe të Bekuarin e Vetëm Apostolik, Fahr-el-din Balliun, si dhe gjuhëtarët e pafund si amplifikatorë të muhabeteve të kafenesë së të papunëve e të komenteve të zgjedhura në faqet e internetit. Edhe pse duket se është një fushatë katundare, si kopil që është, Saliu e kontrollon mirë dhe pa pikë cipe brigadën e vullnetarëve të pandershëm, të pafytyrë e të kërmosur të shkarrashkruesve të vet. Siç thonë edhe korçarët, “nuk pyet PD për rrena e gënjeshtër”. Por mungesa e sofistikimit në cilësinë e kasnecëve, kompensohet me djallëzinë e mesazhit që lëshon Saliu, “ata le të hanë ngjallat, ne shohim përpara”.

Mesazhi i nënkuptuar është që ngalën ua ka dhënë Saliu dhe kështu e kuptojnë edhe të shkretët mbështetës të tij. Ajo që nuk thuhet është se po të numërohen ngjallat e llojeve të ndryshme që ka ngrënë pa dhembje Saliu, do të ushqehet një ditë të tërë e gjithë anëtarësia e Partisë Demokratike të Tiranës. Saliu po tallet me mbështetësit e tij, sepse ai nuk pyet për ta. Ai ka hallin e të birit e të bijës dhe është gati të durojë gjithçka që të sigurojë të ardhmen e tyre.

Nga pala tjetër e parisë, kryetari i opozitës po hesht dhe cicërin nganjëherë sa për të thënë se kështu e lypte aritmetika, se nuk duhet morali dhe etika, se si ato zonjat e semaforit është edhe politika, domethënë “jeta është aritmetikë, Olimbi”. Por ai ka një zogori shkarrashkruesish e komentatorësh që po e shesin me djallëzi paktin për të në media. Tani të gjithë ata që shiteshin si “mendimtarë të pavarur” e kanë hedhur maskën dhe bëjnë propagandë të hapur e pa kurrfarë skrupulli në shërbim të Paktit që në të vërtetë gjithçka është, por opozitë nuk është. Të gjithë palët e parisë janë palë të paktit dhe pa Sali Berishën e pa bekimin e tij, nuk do të kishte

pakt. Rëndësi ka se kujt i flasin dhe çfarë mesazhi japin këta. Sepse këmbanat bien për ata që duan të dëgjojnë. Kujt i flasin këta arixhofka? A duhet të merremi me ta dhe si? Përse gatujnë pandershmerira të tilla dhe mandej marrin poza sikur iu dhembën shqiptarët e sikur janë gjithologë të shumëditur?

Shembulli më i mirë janë gazetat si “Dita”, “Shqiptarja.com” dhe blogjet e tipit “Res Publica” dhe “Peshku pa Ujë”, vende të nivelit ku diskutohen dhe adhurohen grafomanë si Andrea Stefani, Mustafa Nano, Bledar Prifti e një seri shkarrashkruesish, të cilët mendojnë se duke përdorur ca fjalë të huaja do impresionojnë lexuesit. Këta janë disa individë të paditur e të papërgatitur profesionalisht, por që marrin poza sokratike dhe luajnë rolin e arixhofkës që të shtin fall duke lexuar rru-dhat e dorës e të tregon se çfarë mendon vjehrra për ty.

Argumentet e tyre janë krejtësisht të qarta.

Së pari, i detyruan të huajt.

Së dyti, e tillë ishte matematika e zgjedhjeve.

Së treti, jemi të majtë dhe e majta u bë më në fund bashkë.

Së katërti, të ndalim të keqen Berisha.

Së pesti, të bjerë regjimi, se ndoshta ka shpresë për demokracinë.

E kështu me radhë. Kjo është as më shumë e as më pak, por një përpjekje për të shitur paktin, sepse kështu iu intereson atyre që i kontrollojnë dhe i paguajnë.

Ja se si e paraqet zgjidhjen Andrea Stefani: “Tashmë shtrohet çështja jo e shpëtimit të një institucioni, por e shansit të demokracisë. Sepse edhe një mandat tjetër për Berishën, do të thotë që pushteti të shndërrohet në regjim autokratik, që do të thotë fund i demokracisë dhe e integritetit të Shqipërisë në Evropë. Pra, kemi dy alternativa: ose vdekje të demokracisë, ose rotacion të pushtetit dhe një demokraci të korruptuar sa të duash, por megjithatë ende me mundësinë për t’u pastruar në rrjedhën e kohës. Është si një zgjedhje mes vdekjes dhe jetës”.

Ja si thotë edhe i gjithëdituri Mustafa Nano: “Nuk është se më gënjen mendja lidhur me gjërat që vinë pas rrëzimit të

regjimit. As që më interesojnë në këtë moment. Për një gjë jam i sigurt: me rënien e regjimit, bie regjimi. Kjo nuk është pak”.

E vërteta lakuriq është se të gjithë këta janë në tavë bashkë dhe se janë kundër shqiptarëve. Le të dalin e të thonë Andrea Stefani e Mustafa Nano që duhet të ikin të gjithë, sepse edhe këta e dinë mirë se kush janë kriminelët. Por nuk e thonë, sepse siç thotë populli “qeni leh, aty ku ha” dhe ata nuk ndahen dot nga zogoria, sepse iu ikën kotherja. Po a mendojnë këta se krimi që po bëjnë kundër shqiptarëve do t’iu zerë frymën? Si rriten fëmijët e familja me mashtrim e duke mbrojtur krimin? Si mund të shohësh motrën e gruan në sy, kur e di se çfarë krimi i llahtarshëm po kryhet ndaj shqiptarëve?

Dr. Eduard Zaloshnja pyet te blogu “Respublica”, një te-neqe zhurmuese e PS që mbahet me paratë e “Credins”, një bankë në të cilën ka gisht edhe familja Berisha, se ç’mendojnë shqiptarët për faktin?

Zaloshnja thotë: “Nga një hulumtim i faqeve të internetit të gazetave shqiptare, ... rezulton se vetëm 1.1 % e atyre që i kanë lexuar ato kanë komentuar. Po 98.9 % e atyre që nuk kanë komentuar çfarë mendojnë?”.

Dhe një nga komentuesit anonimë, i përgjigjet: “Këtij muhabeti i thonë të zhdukemi të gjithë nga Shqipëria e të hanë këta morrat që e quajnë veten politikanë. S’kanë faj këta. Këta bëjnë ç’të duan, ne prapë i votojmë. Unë kam votuar gjithmonë PS, por nuk ia vlen më të votoj. Mjerë Shqipëria për shqiptarët!”. Në fakt duhej të ishte mjerë Shqipëria për ju kërmat e konvikteve, të uriturit e pangopur, ju që nuk keni dashuri për asgjë, veç parasë! Por ai komentatori e ka ditur se po të thonte të vërtetën, nuk i dilte komenti në blog.

Në përfundim

Në përfundim shqiptarët nuk duhet të harrojnë se ky është një moment shumë kritik për ta, për demokracinë shqiptare dhe për të ardhmen e tyre. Ajo që duhet kuptuar e që ka

rëndësi është se këta janë vegla mediatike, janë zhurmues. Detyra e tyre është të shesin mesazhin e parisë. Këta janë kriminelë, sepse e dinë çka po ndodh dhe sepse duan ta shesin e ta paraqesin si arritje, paktin e parisë së Tiranës që e dënoi demokracinë shqiptare me vdekje. Ata përdorin kulturën popullore, mendësinë katundare, argumentet e sofistikuara për të shitur këtë mesazh që duhet bërë bindës me çdo kusht.

Këta e dinë se pakti i parisë e mbylli lojën e zgjedhjeve, ia çorri maskën parisë, por edhe vetë këtyre. Gjendja është kaq e keqe, sa askush nuk don ta cekë këtë temë dhe loja nuk është më nën kontrollin e parisë. Sepse paria nuk do ta bënte këtë pakt kaq hapur e kaq brutalisht, po të ishte e sigurtë që i kishte gjërat nën kontrolli. Si bishat e plagosura, edhe paria e Tiranës, sillet brutalisht vetëm kur ndjehet e rrezikuar për vdekje. Vetëm atëherë e tregon fytyrën e vërtetë. Dhe fytyra e saj është fytyra e gjakpirësve që ua kanë vjedhur të ardhmen shqiptarëve. Paria është gjarpëri që po na ha të gjallë dhe këta shkarrashkrues janë as më shumë e as më pak, vërshtëllima e gjuhës së gjarpërit. Se miu ngrin jo vetëm kur e sheh gjarpërin, por edhe kur i dëgjon vërshtëllimën e rrëshqitjen. Misioni i këtyre fallxhorëve është të bëjnë anestezinë mendore të shqiptarëve, t'ua shpajnë trurin dhe t'i kthejnë në vegla të bindura të parisë. Këta do të kujtohen si arixhofkat e tranzicionit, si vërshtëllima e gjarpërit - pari e Tiranës, e cila kërkon të hipnotizojë shqiptarët e t'i hajë si minjtë, një e nga një, gjersa të mos mbesë as këmbë.

PAKTI I PARISË SË TIRANËS, PRIJATARËT, MILITANTËT DHE KATUNDARËT

Pakti i parisë së Tiranës tregoi qartë se rruga që ndjek paraia është ajo e shkatërrimit, e vetëvrasjes dhe e skllavërimit. Pakti i parisë i ka kthjelluar ujrat dhe zgjidhjet që kanë njerëzit janë krejtësisht të qarta. Ose me iu kundërvue parisë oligarkike, ose me pritë fundin e pashmangshëm të skllavërisë nën sundimin oligarkik të parisë së bashkuar të Tiranës që ka ndërtuar një sistem shumë më të dëmshëm e vdekjeprurës, se ai që përjetuam nën Partinë e Punës, pjella të së cilës janë edhe këta.

Dy fjalë mbi militantët

Militantët politikë janë pjesa më agresive, më e egër dhe më e pabindshme e çdo shoqërie. Ata besojnë te partia, te grupi, te vlerat dhe ideologjia e saj në formën më fetare të mundshme. Bota e tyre është bardh e zi dhe e ndarë me thikë në “të mirë” e në “të keq”. Në një sistem demokratik, militantët janë më shumë se tifozë skuadre, sepse kanë bindje dhe i zbatojnë ato në jetë. Por ata kanë shumë peshë, se kanë në dorë të ardhmen e vendit. Si pakicë ata janë shumë trazues. Si njerëz, e kanë votën e gatshme për dikë të cilit ata i besojnë verbërisht.

Por ka edhe një ekstrem të militantizmit që është fanatizmi. Fanatikët janë njerëz që kanë bindje qorre. Ata ndjekin rrugën edhe kur ajo nuk të çon askund. Nuk pyesin për argumente të kundërta, për ide e për mendime ndryshe. Fanatiku politik mendon se i din të gjitha. Për të, gjithçka është ose e vërtetë,

ose e rreme. Nuk ka asnjë hapësirë gri. Në ekstremin e llojit, kur prijatari i partisë i thotë të bardhës e zezë, edhe fanatiku i thotë ashtu. Dallimi midis fanatikëve fetarë dhe atyre politikë është thjesht se dikush beson te Zoti e dikush beson te dikush që i duket Zoti. Shpesh katalizatori që i bën fanatikët vegla politike, është injoranca e tyre dhe varfëria. Sa më të varfër e sa më të paditur, aq më të varur janë nga paria, aq më fanatikë paraqiten dhe bëhen shumë më të rrezikshëm.

Për fat të keq, militantët dhe fanatikët e parisë tonë janë të shumtë. Mjafton të shohësh mitingjet, të shkosh në kafene, të fillosh një bisedë. Gjithkush flet për politikë, të gjithë janë hipokritë shembullorë, por e ruajnë vijën e partisë të paprekur. Shqiptarët jetojnë me partinë e tyre, për partinë e tyre dhe në një farë mënyre ia kanë kushtuar veprimtarinë dhe e kanë lidhur jetën me partinë e udhëheqësin e saj.

E ne kemi shumë militantë e fanatikë të gjithkujt e të gjithfarëlloj partish. Megjithatë, pakti i parisë e ka vënë këtë lidhje në pikëpyetje, sepse nuk ka më dy a tri skuadra të parisë. Pakti tregoi se paria është e rreshtuar në një anë dhe populli është në anën tjetër. Tashmë ka dy skuadra. Dallimi është se kjo nuk është fushë futboll. Kjo është një fushë përqendrimi e internimi gjigande që quhet shteti shqiptar, në të cilin militantët e fanatikët përdoren nga paria për të dhunuar bashkëvuajtësit e tyre. E nesërmja do të jetë më keq se e sotmja. Por e sotmja është zi e me zi dhe një zot e merr me mend sesa më keq mundet me kenë e nesërmja.

A janë militantë e fanatikë shqiptarët?

Tashti duhet të bëjmë një rivlerësim të militantizmit, se ne shqiptarët jemi pak më ndryshe se të tjerët. Në shtetin shqiptar mendësia katundare është sunduese dhe është vështirë me kenë, me u shitë e me u pranue si fanatik shumë seriozisht. Me kenë militant i paguem është e pranueshme dhe kuptohet, e bile miratohet shoqërisht, sepse ashtu sigurohet jeta e shumë

familjeve dhe buka e gojës. Prandaj edhe pse mund të shiten si besnikë të dikujt, gjithkush nga shqiptarët ka tri tesera partie në xhep dhe gjithsecili vëlla e kunat, është në parti tjetër si sigurim familjar. Kur vjen darka e kur ndërrohet qeveria, të gjithë merren vesh dhe ai që del në krye si militant apo fanatik i partisë/prijatarit, mbron pjesën tjetër të fisit. Në shumë vende, në krye të fisit dalin më të mirët e më të zotët, më të urtët e më të ndershmit edhe punët atje shkojnë mirë. Kur në krye të fiseve e të familjeve dalin hajnat, cubat, mashtruesit e kriminelët, atëherë në atë familje plas sherri, hyn e keqja dhe e keqja kur hyn në një shtëpi, nuk del për njëqind vjet. Të dy palët sillen sipas parimeve katundare “larg vatrës sime”, “bjeri i forti të ligut” etj. Kur më i madhi i familjes është si puna ime, atëherë paria bën çka mundet me pjesëtarët e tjerë që përndiqen deri në shkatërrim. Por ka ditë, zbardh edhe për ne.

Në shtetin shqiptar ka një masë të konsiderueshme individësh që për arsye të ndryshme janë militantë të bindur të partive politike dhe deklarohen se besojnë në ideologji. Indoktrinimi i gjatë e ka bërë punën e vet. Militantët e PS, shumica ish-anëtarë partie e funksionarë të nomeklaturës, besojnë te partia socialiste. Ideologjia e kësaj partie formalisht është “e majtë” kolektiviste dhe strukturat e partisë deklarojnë se punojnë për të zbatuar një ideologji të tillë në të mirë të popullit. Në fakt, nuk kanë bërë asgjë për popullin. E vetmja kohë e sukseshme, është koha e Fatos Nanos që vodhi vetë dhe i la të gjithë të vidhnin. Kjo ka qenë e vetmja strategji kolektiviste e PS. Pra, edhe pse udhëheqja e PS është e përbërë nga milionerë që sinqerisht besojnë te globalizmi e tregu i lirë, siç beson i ashtuquajturi filozof i PS, Servet Pëllumbi, militantët e fanatikët e PS besojnë te partia dhe te kryetari i radhës. Pra, fanatizmi i këtyre skllëvërve modern, konsiston në mbështetjen pa kushte të milionerëve nga fukarenjtë. Si tha ajo gruaja e pamartuar nga Berati “pa drita rrimë, por aman ju të merreni vesh”. Ky është fanatizmi në këtë anë të fushës së kampit të përqëndrimit.

Nga ana e tyre, militantët dhe fanatikët e PD kanë një urrejtje patologjike kundër PS. I konsiderojnë militantët e PS komunistë, enveristë dhe mbeturina të së kaluarës. Këta besojnë se Sali Berisha solli demokracinë, lirinë e tregut, kapitalizmin e me radhë. Këta besojnë se Sali Berisha mendon për popullin, për kombin, për fëmijët e tyre dhe se, më e bukura, Sali Berisha është luftëtari më i egër kundër kastës së Bllokut dhe kundër komunizmit. Në shtetin shqiptar nuk ka komunistë, të gjithë janë bërë borgjezi, por hajt ma, këta janë skllëvërit e tjerë që do të përdoren si mish për top nga ana e parisë. Këta fanatikë të klasifikojnë “komunist” edhe kur e ke pasur gjyshin kryetar kooperative. Ky është fanatizmi i nivelit më të ulët e injorant.

Llojet e militantëve në politikën shqiptare

Pasi pamë dy llojet e militantëve skllëvër, të përdorur hapur e pa mëshirë, le të merremi pak me militantët tanë ekzotikë. Militantët dhe fanatikët më interesantë artistikisht, janë ata që mbështesin kauzën e integritit të Ilir Metës, që është thjesht një rrenë e pastër, e pambërritshme dhe e porealizueshme. Po ashtu objekt humori janë edhe militantët e fanatikët e Partisë Aleanca Demokratike që beson në aftësitë ushtarake të Arben Imamit e zotësinë diplomatike të Neritan Cekës, siç besonin dikur në aftësitë ekonomike të Gramoz Pashkos. Por më karagjozët e të gjithëve, janë militantët e Lefter Xhuvelit, që duan të mbrojnë ambientin, si dhe ata të Partisë Republikane të Fatmir Mediut që deklarohen të djathtë dhe mbrojtës të pronës, pa e luajtur gishtin një herë për atë punë. Militantët më simpatikë janë legalistët. Këta duan që shteti shqiptar të kthehet në vitin 1925, edhe pse pretendenti për fronin është këshilltar i presidentit republikan dhe nuk e lë dot punën se është ca si hollë nga gjendja.

Siç shihet edhe nga ky përshkrim i shkurtër, ka një dozë të dallueshme marrëzie kolektive në zgjedhjen e partive dhe të strukturave. Sepse këto parti nuk kanë ideologji. Këto parti

nuk kanë vlera. Këto parti nuk kanë nder. Këto parti nuk kanë asnjë interes t'iu shërbejnë shqiptarëve. Edhe kur kanë pretenca ideologjike, ato janë kokolepsje marrinash dhe ofrojnë një çorbë slloganesh që nuk janë as konsistente e as koherente. Këto parti duan skllëvër e shërbëtorë. Për kortezi i quajnë militantë, aktivistë, qëndrestarë e mbështetës dhe i përdorin si duan e pa mëshirë.

A janë militantët vërtetë militantë?

Që këta nuk janë militantë, kuptohet nga fakti se udhëheqësit e këtyre partive nuk dinë çka flasin dhe ia fusin kot, kodra pas bregut e bregu pas kodrës. Gjithkujt që studion militantët, i kujtohet Fatos Nano që fliste një gjysëm ore, gromësinde pa ndërprerje dhe i linte të gjithë me gojën hapur. Në fund njerëzve iu vinte turp që të thonin se nuk kuptuan gjë dhe prandaj duartrokisnin me fanatizëm. E vetmja herë kur e kanë kuptuar Nanon, ka qenë në atë mbledhjen e famshme të KPD. Por deri këtu po themi se këto gjëra janë të parëndësishme, sepse njerëzit duhet me besue diku dhe ata kanë zgjedhur të besojnë këtë.

Por unë e kam një fije dyshimi se më shumë se militantizëm, kjo është një lojë. Si edhe e thashë më lart, ndoshta edhe këta që shtiren si militantë, kanë të njëjtën agjendë si katundarët e zgjuar dhe po planifikojnë që të mbrojnë e ruajnë interesat. Ndoshta mbështetja e tyre është sipas parimit tjetër të sprovuar katundar, “kalova lumin, të vjedhi kalin”. Koha ka treguar se parimet katundare “qeveria e zë lepurin me qerre” dhe “më mirë një mik, se një çiflik” sidomos kur miku është në krye të shtetit, funksionojnë. Duket sikur kjo është edhe loja e militantëve.

Ajo që të bind për këtë, është sjellja e militantëve dhe fanatikëve socialistë me Fatos Nanon. Sa ishte në krye të shtetit, jo vetëm që i bënin temena, por edhe i lëpinin të gjithë muskujt e lëvizshëm. Sa iku nga pushteti, jo vetëm që nuk i hapin as

telefonin, por nuk lënë gjë pa thënë për të. Dhe për kë? Për atë që ua la amanet udhëheqësi i shquar dhe shoqja Nexhmije. Po me këta që nuk kanë lënë gjë pa bërë dhe që janë vegla të përdorura nga të gjithë regjimet, si do të sillen? Eh, kam dyshim se militantët do t'ia fusin një teke raki dhe pas të parës, zoti e din se çka ndodh...

Militantët dhe problemi i paktit të parisë së Tiranës

Që të kthehemi në realitetin e këtushëm. Pas paktit të parisë së Tiranës, dilema e të gjithë qytetarëve, por edhe e militantëve dhe e fanatikëve është e qartë. Ose shqiptarët duhet të dorëzohen para së keqes e të nënshtrohen përfundimisht duke e humbur nderin, familjen, fëmijët, të ardhmen e sigurinë për bukën e gojës në një shtet modern skllavopronar të parisë së Tiranës, ose duhet të hapin sytë e të rebelohen. Dhe zgjedhja nuk është aspak e lehtë, sidomos për militantët e partive respective, që deri më 1 prill 2013, kishin bindjen se këta që i drejtojnë kanë vlera, ose kanë në mend mbrojtjen e interesave të tyre. Pas paktit të parisë së Tiranës, është parë qartë se këta që i drejtojnë, janë koka e Gjarpërit të Ferrit që po matet t'i kapërdijë si minjtë, një e nga një, derisa të mos mbesë këmbë.

Pakti tregoi se në shtetin shqiptar ka një diktaturë oligarkike. Pakti i parisë së Tiranës tregoi qartë; ka një parti të vetme, që është partia e zhvatjes dhe e vjedhjes. Pakti tregoi se partitë dhe prijatarët nuk kanë asnjë vlerë ideologjike. Pakti i parisë së Tiranës tregoi se këta janë një parti, Partia e Lekut dhe e Interesit. Pakti tregoi se këta janë mafiozë të gjithë bashkë. Për dikë që të jetë tifoz duhet të paktën të ketë një kampionat futbollit. Partia e Tiranës lot në një skuadër dhe njerëzit, të gjithë të tjerët, shqiptarët, militantët, fanatikët dhe injorantët janë në skuadrën kundërshtare. Sepse loja nuk është midis dy gjarpërinjve dhe, pas tyre, minjtë fanatikë të cilët presin që njëri të hajë tjetrin. Pakti tregoi se kjo është loja e gjarpërit

me minjtë dhe të gjithë këta militantë e fanatikë janë dreka e darka e dreqit, domethënë e gjarpërit të parisë së Tiranës. E shqiptarët janë një popull i vështirë.

Përfundimi

Nuk ka përfundim në këtë analizë, sepse përfundimi do të merret vesh pas qershorit të vitit 2017. Askush nuk e di se çka po bluajnë katundarët e shumë të që nuk kanë lënë gjë pa bërë për të siguruar një kafshatë buke, një pronë në tokën e vjedhur, e me trafik njerëzish, droge e armësh, për të ushqyer fëmijët e tyre dhe për t'u dukur se kanë pushtet. Militantët e hershëm ruanin letrat prej mbretit dhe të gjithë i vinin në krye të vendit. Militantët e dikurshëm të sistemit, vishnin një xhakë të oficeri dhe kryetari i kooperativës i kishte frikë. Këta të sotmit kanë vënë prona e pasuri dhe po presin. Kështu duket sikur sillen mirë, por kur të fillojë paria t'i taksojë, dhunojë e përdorojë, atëherë do ta shohim sesa militantë e sa fanatikë janë. Sepse si katundarë fisnikë që jemi, i durojmë të gjitha, por kur vjen puna te prona, të fusim një plumb, bëhemi kaçakë e cuba, nuk pyesim më për parti e militantizëm dhe atëherë, edhe ky dikushi që mendoi se u bë Zot, bëhet një copë katundari si ne të tjerët.

Atëherë fillohet edhe loja prej fillimit.

PAKTI I PARISË SË TIRANËS DHE TAKSAT, FATI I KEQ I KATUNDARËVE SHQIPTARË

Deri më tani gjarpëri ka ngrënë gjithçka ka gjetur në fushë, tani i ka ardhur radha katundarit fisnik shqiptar. Ky gjarpëri i parisë së Tiranës, që është rritur konvikteve, din sesi të nxjerrë proteina e dhjamë edhe nga vezët e pleshtit, jo më nga katundarët tanë, që i kanë bërë paratë tulla e llaç, makina e kafene, dyqane e mall që shihet e taksohet lirshëm. Tash katundarët duhet të kthehen të punojnë tokën e të mbajnë parinë e shtetin. Përndryshe le të ikin në mërgim e të sjellin para që andej. Se njëlloj është kjo punë, mjafton që paratë të vijnë në shtetin shqiptar dhe paria gjithsesi e merr pjesën e vet. Pakti garanton që paria është e bashkuar e katundarët janë të izoluar, të vjedhur, të plaçkitur, të rrjepur e të përdoruar.

Fati i keq i katundarëve

Fati i keq i katundarëve është se ata janë të vetmit që mund të paguajnë. Ja të shpjegohe! Tashti në shtetin shqiptar ka nja tre milionë banorë. Në shtetin shqiptar ka 560 000 pensionistë e nuk iu merr dot asgjë se nuk kanë, por edhe ato para që i kanë ruajtur e fshehur, nuk i tregojnë, meazallah. Këta duan të hanë, duan pensione, duan spitale e jo më t'iu marrësh paratë. Në shtetin shqiptar ka rreth 750 000 kalamaj, të rinj e adoleshentë që nuk punojnë dhe që shkojnë në shkolla deri në moshën 30 vjeçare e që nuk i takson dot, sepse nuk bëjnë asgjë deri sa bëhen doktorë profesorë dhe mandej dalin në pension. Dredhin zinxhirin e shohin Big Brother, harxhojnë

500 lekë për një pishinë, calcetto, e ca lekë për telefon dhe kaq. Në shtetin shqiptar ka edhe 114 000 familje që jetojnë me ndihma dhe paria duhet t'iu japë ndihmat, se ndryshe nuk i merr votat. Se nuk mjafton 50 mijë lekëshi që jepet për votën ditën e zgjedhjeve. Ata duan të hanë katër vjet rresht. Ja, Kukësi ka 47 % të popullsisë që jeton me asistencë. Kush pret që banorët e Kukësit të paguajnë taksa?

Biznesit të madh qeveria nuk u vë dot taksa, se të gjitha bankat tona janë borxh te bankat mëmë jashtë vendit dhe bizneset e mëdha janë të mbrojtura mirë e mirë. Në fakt edhe pse nxjerrin një fitim të pastër diku te 350 milionë dollarët në vit, borxhi i bankave tona i kalon një miliard eurot dhe këto para kalohen sipas një skeme interesante; si pagesa për interesa te bankat mëmë dhe shteti mbyll sytë. Kompanive të huaja të cilave qeveritë iu kanë dhënë koncesione për njëzetë e pesë vjet, nuk u mbledhin dot taksa, sepse atë shumë që duhej ta merrnin si taksë, e kanë marrë si ryshfet zyrtarët qysh në fillim dhe e kanë harxhuar për dhjamë qeni, domethënë për pushime, për dashnoret dhe dashnorët e familjes, për orët e arta dhe për apartamentet e paratë që kanë fshehur në bankat e huaja. Pastaj, po t'i taksosh, të huajt ikin dhe na prishin kauzën e integritimit evropian.

Po ashtu ka një numër të konsiderueshëm republikash katundare të tipit San Marino, sepse ne e imitojmë Evropën jo vetëm në gjërat e këqia, por edhe në pluralitetin e formave të vetëqeverisjes. Këto republika katundare kanë vetqeverisje sovrane, organe të dhunës, gjyqësor etj., dhe nuk kanë nevojë për shtetin. Është e qartë që shumica e tyre merren me aktivitete ekologjike dhe me rritjen e bimëve medicinale. Për këtë paria e Tiranës dhe shteti nuk pranon të hyjë e t'i taksojë, sepse nuk mund të dalë e të thotë kryeministri i radhës se po takson prodhimin e hashishit, të drogës, të marijuanës, të trafikut të fëmijëve, të femrave, të nderit, sidomos kur ajo që pritet e digjet në fushë nuk ishte kannabis, por kërp. Pse, të marrë janë policët të presin hashishin e të bien në gjak

me kultivuesit ekologjikë? Mandej, si ia vë taksën trafikut të nderit? Paria e ka kuptuar këtë dhe nuk pranon të flasë për punë të fëlliqta. As paria e as shteti i parisë nuk pranon para të fëlliqta. Dhuratat që jepen me gjithë zemër i pranon edhe mbreti e jo më këta të uriturit e pangopshëm, koka e gjarpërit të kimit. Por duhet të jenë dhurata e jo taksa ama. Sepse kur e mbledh shteti, parasë i ikën lezeti.

Ka edhe një grup biznesmenësh, afaristë të fuqishëm, pjesëtarë të klaneve të kimit, që tashmë nuk kanë se ç'të japin, sepse po presin të marrin paratë që shteti ua ka borxh. Këta i kanë paguar dy herë taksat, edhe mbi paratë që nuk i kanë marrë ende dhe tani shohin se si po iu ndryshken në rrugë buldozerët e ekskavatorët që i blenë sa frëngu pulën e që nuk i vënë dot në punë. Këta janë të deklaruar në krizë likuiditeti, siç është, bie fjala, ndërtimi, që nga 2400 kompani është katandisur në nja 1400, që nuk arrijnë të shesin dot ato dhjetëra mijëra apartamente që kanë ndërtuar e që janë bosh.

Më në fund, janë edhe afro një million të papunë që vijnë e ikin, shkojnë e vijnë, rropaten e mundohen, punojnë në të zezë e në jeshile, por që nuk i takson dot, sepse nuk kanë lekë në xhep. Ka mbaruar koha e horllëkut kur paraja bëhej me telefon. Tani as telefoni nuk bën më para, sepse e gjen të vjedhur me kurrigjë hiç. Nuk e ndalon tjetrin që të shkojë në kafe dhe ta pyesësh sa para ka në xhep, apo si i ka blerë cigaret, sepse nuk e bën një shtet serioz këtë punë. Po ashtu shteti nuk shkon të pyesë te dyqani sa para borxh ka njëri e tjetri e si t'i taksojë, sepse nuk është e ndershme të vesh taksa mbi listat e dyqanxhinjve që shesin veresie te komshinjtë e kushërinjtë. Po ashtu nuk i thua dot njerëzve ku i gjejnë paratë për motelet, sepse mund të shkaktosh divorce shumëpalëshe. Në fund të fundit, dihet që ekonomia informale është zhvillim, edhe kur është prostitucioni, droga, horllëku, kumari e trafikimi.

Po ashtu, shteti ka 107 000 buxhetorë që mbajnë me bukë 25 % të popullsisë, sepse këta harxhojnë e blejnë, shpenzojnë e vjedhin dhe dinë si të nxjerrin paranë edhe nga guri e jo më

nga shqiptarët e tjerë. Këta vërtetë i takson 10 % e vende - vende iu ka ulur rrogat me 25 %, por po i uli rrogat fare dhe po ua mbylli rubinetin e korrupsionit e të krimit, nuk del më njeri në punë të shtetit as me biçikletë. Atëherë bie shteti. Askush më mirë se zyrtarët nuk e kupton atë shprehjen “fukarallëk = maskarallëk, pushtllëk e kodoshllëk”. Sepse nuk punohet badihava, rroga nuk del për një javë dhe zyrtarët më mirë dalin e mbledhin luleshtrydhe e manaferra, sesa të punojnë falas. Shteti nuk mbahet me punë vullnetare. Këta buxhetorët duan para, jo të japin para.

Nevojat e shtetit për para

Cilat janë nevojat e shtetit shqiptar për para? Po ja, duhen paguar 600 milionë dollarë në vit për interesin e borxhit. Duhet paguar edhe 400 milionë për pensionet. Unë i hodha një sy sa për të qenë brenda, fjalimit të ministrit të Financave, Bode dhe gjeta vetëm përqindje e asnjë shifër të saktë.¹[1] Ras-tësisht i pashë edhe zërat e buxhetit, pashë se si ishin fshirë subvencionet etj. Por thashë të ndalem te një shifër rrum-bullake dhe e përgjithshme që kuptohet nga të gjithë sa para duhen në vit. Dhe kështu Berisha e deklaroi shifrën e buxhetit kur tha: “Sot diskutohet buxheti i 100 - vjetorit të themelimit të shtetit shqiptar. Më i madhi në historinë e Shqipërisë, arrin 410 miliardë lekë, buxhet i cili ka si synim madhor rritjen e mirëqenies suaj, të dashur qytetarët dhe qytetare shqiptare”.² Edhe pse shteti shqiptar nuk pati para të paguante rrogat në fund të vitit, kjo nuk ka rëndësi. Ajo që ka rëndësi është se nga do të dalin këto 410 000 000 000 00 lekë për vitin 2013 dhe për katër vitet e ardhshëm. Sepse nuk janë pak, po rreth katër miliardë dollarë në vit. Edhe po të shkurtohet buxheti me 25 %, prapë nga diku do të dalin këto miliarda dollarët që duhen. Edhe pse shteti është i falimentuar, nuk mund të themi hapur fare se është i falimentuar, sepse po nuk gënjem edhe për këtë në zgjedhje, ç’u pa puna! Atë duhet ta thotë kryemin-

istri i ardhshëm, po kam frikë se ai nuk do ta hapë gojën fare për këtë punë. Doganat duhet të japin të paktën gjysmën e buxhetit, por vitin që kaloi dhanë vetëm 129 miliardë lekë. Unë iu hodha një sy të ardhurave nga dogana dhe vura re se nuk kanë mbledhur sa ishte planifikuar, po më pak. Iu hodha një sy importeve dhe vura re se kishin rënë pingulthi. Mallrat që taksohen rëndshëm nuk importohen më, sepse edhe kështu janë magazinat dëng me mall që nuk shitet. Taksat e shitjes janë të larta, janë paguar e harxhuar paradhënie dhe biznesi duhet të operojë me humbje. Dyqanet e vogla nuk i takson dot rëndshëm, se shumica janë si ai katundari që shiste dhjetë vezë gjithë ditën; vajin që shesin e përdorin për gatim shtëpie dhe miellin për bukën. Fabrika s'ka. Shteti shqiptar ka nevojë për para, të paktën katër miliardë dollarë çdo vit dhe pas hyrjeve prej doganave i duhen pak a shumë edhe tre miliardë dollarë të tjerë.

Nga do t'i nxjerrë?
Nga katundarët.

Si hyn në lojë katundari shqiptar

Ja pra, si hyn në lojë katundari shqiptar! Pavarësisht pallavrave të politikës e lojës së zgjedhjeve, shteti, domethënë zyrtarët në shërbim të parisë, nuk janë aq budallenj sa të taksojnë parinë.

E para, nuk do të taksojnë monopolet e mëdha, sepse janë të tyret, janë prona të familjeve kriminale të parisë. Se nuk janë budallenj këta që shkojnë me pushime në Sharm - el Sheik të paguajnë taksa. Këta duan që edhe kur mbesin atje, se i ka gënjyer agjensia turistike, shteti t'u paguajë paratë e rrugës, hotelin për një javë dhe ushqimin. Edhe pse vetëm paria ka para, një budalla mund të shpresojë se do taksojnë veten e tyre. Këta mezi i kanë vënë paratë jo të taksojnë veten. E kujr t'ja japin? Në mendjen e tyre ne jemi një popull pis që nuk meriton më shumë.

E dyta, zyrtarët kanë frikë, se këta janë banditë, kanë ca banda pas vetes që të vrasin ditën për diell e të vënë lëkurën të thahet për të zënë djathin e gjizën. Për këtë janë mjeshttra.

Ku do të drejtohet paria për gjithë këto para që duhen? Ata do të drejtohen në tre burimet nga ku mund të dalë dhjami i pleshtit: te biznesi i vogël, te pasuria e patundshme dhe te katundarët. Ja si funksionon skema sekrete e parisë!

Së pari, shitblerësve të vegjël dhe prodhuesve me pakicë iu bëjmë qejfin dhe i quajmë nja tri javë afaristë, tregtarë gro-sistë e kapitalistë.

Së dyti, pronarët e gjithë apartamenteve të këtyre ndërtesave si të kullave të termiteve, i quajmë zotërinj qytetarë pronarë të legalizuar e të hipotekuar, iu bëjmë ca premtime dhe si ta hanë grepin, i fusim në rresht dhe i mjelim nga pak.

Së treti, katundarët që janë në qytet i quajmë qytetarë dhe katundarët që kanë mbetur në katunde i quajmë fermerë. Këtyre dy kategorive të fundit ua fusim me pak lezet. Nuk është budalla Sali Berisha që thotë se kemi 350 000 ferma e fermerë. E ka një qëllim ky zotni katundari, se po të donte t'iu bënte qejfin njerëzve, do thoshte janë kalorës. Pse thotë fermerë? Sepse fermerët punojnë e taksohen dhe mbajnë një shtet me taksat që paguajnë. E gjithë Amerika me 300 milionë banorë ka vetëm dy milionë ferma. Ne kemi tre milionë banorë e 350 000 ferma. Unë jam katundar praktik dhe e di se kur dikush të thotë se je "burrë i mirë e i zoti", "se ty ta hek dera" etj., etj., e ka ndërmend me ta ba ndoj hile a ndoj poshtërsi të vogël.

Mandej, skema sekrete e parisë është që të na taksojnë të gjithëve sipas kriterëve ligjore e perëndimore. Me këta të tjerët nuk dinë se ç'të bëjnë, sepse këta i kanë fshehur paratë nën dyshek. I kanë dalë punës para, gjithkush ankohet "skamllëk, fukarallëk, s'ka pare, po hekim keq". Kaq shumë bërtasin, sa kanë nisë me i besue rrenat e veta. Por paria e din sa para kanë e se ku i kanë fshehur. Ne kishim një shtet që kishte një sigurim që e dinte se kush kishte lakra në kokë, e jo më tani që diskutohen paratë. Se qentë që ka ky system, e nuhasin erën e

parasë së fshehur deri në varrin e vjehrrës. Po e panë punën keq, prodhuesit e vegjël e shitësit ulin qepenat dhe hanë dhjamine e tyre. Pronarët e pasurive nuk pranojnë të legalizojnë e hipotekojnë pasurinë. Jo vetëm që nuk duan të paguajë 10 %, por nuk duan të paguajnë as taksën që vjen më pas e që është e paevitueshme. Po tokën nuk ke si e fsheh dhe prandaj do paguash.

Kush mbetet? Mbesin “fermerët” domethënë ne, katundarët që nuk kemi ku ikim. Qeveria ka kaluar ligjin që të merr tokën po nuk e punove dhe që të takson gjithsesi, në daç punoje, në daç jo. Argumenti i katundarëve “ne s’paguajmë drita e ujë e nuk pjerdhim për shtetin” nuk funksionon, sepse si të mbarojnë zgjedhjet, fillojnë të shtërngohen vidhat dhe, si hap i parë, fillon mbyllja e dritave dhe e ujit. Kur të vijë dimri e të qajë fëmija do të ulësh kokën e do të paguash, se nuk jetohet në atë të ftohtë. Në daç rri ti në të ftohtë, në daç shko te mullari i barit, paria nuk e ka fare problem. Po pagove, do marrësh dritën e ujin.

Por si do të na mjelin? Shteti nuk ua merr dot tokën e ndërtime moderne katundarëve. Edhe pse këta e shesin votën për një thes miell, toka e prona formalisht nuk preket. Por shteti do të gjejë mënyrën t’i bindë katundarët të kthehen e ta punojnë tokën e të parëve për një kafshatë buke, sepse u përpoqën, por nuk u bënë dot sheherli. Dhe do t’ua masë pasurinë e patundshme që mandej don taksuar. Se këta nuk janë budallenj. E mbani mend si e bënë punën e makinave të vjetra? Të sigurimeve? Po nuk funksionoi një herë e bëjmë herën tjetër, më mirë e më bukur. Ka ardhë puna që i sheh shkodranët me biçikleta kineze. Tash po vjen edhe radha e Tiranës.

Por taksat duhet t’i paguajnë katundarët. Në sytë e parisë edhe ata që u turrën të zenë tokë në qytete e në rrethina, katundarë ishin e katundarë mbetën. Këta duhet të kthehen e të punojnë tokën. Sepse edhe vetë katundarët e kanë kuptuar se nuk rrihet me matrapik e me mistri në dorë tërë ditën në qoshe të rrugës, duke mos fituar asnjë lek. Fëmijët duan të

hanë, nuk mbahen fëmijët në katin e katërt të një pallati që nuk sheh dritë, me ëndrrën se janë bërë qytetarë, kur duhet të shesin misra në rrugë e të mësojnë të gjithë poshtërsitë që të mëson fukarallëku. Në fshat jeta është më e mire, se do kenë pula e një lopë që bën qumësht. Do të kenë qepë e hudhra. Shtëpinë e babës e të gjyshit. Po nuk u sollën si duhet, kërcet huri. Pra, paria e ka ndërtuar punën që dalengadalë katundarët të drejtohen edhe një herë nga nga punimi i tokës, por këtë punë duhet ta bëjnë vetë, me vullnetin e tyre të lirë. Se po vendosën të vrasin, të vjedhin e të grabisin, atëherë e ka rritur policinë e shtetit në 17 000 vetë dhe i fut në burgjet që janë bërë si kampe pushimi me dy herë e gjysëm më shumë të burgosur, se në vitin 2005.

Pikërisht ky është edhe aplikimi i parimit të dhjavit të pleshtit. Pleshti ka dhjamë vetëm kur rritet pak. Kështu edhe në këto zgjedhje, paria po iu vjen rrotull katundarëve shqiptarë duke iu bërë hipnozë e terapi, duke iu thënë se nuk do t'i taksojë, se do t'i mbështesë, etj. Është mëse e qartë se ndoshta tokën nuk ua merr dot, por ama së shpejti i bën ta punojnë si më të mirët. Është vetëm çështje kohe.

Nga ana e tyre bashkëkatundarët e mi dalin në mitingje, shiten si trima, sillen si militantë të thekur, sepse mendojnë që duke u shitur si besnikë të njëjës palë do ta hedhin lumin. Por paria është si gjarpëri, i han minjtë një e nga e një dhe i han pikërisht kur ata struken në vrimën e tyre, tamam kur ndjehen të sigurtë, të rrethuar me pasuri e katandi. Sepse lisi çahet me pykën e vet dhe paria me mbërritë objektivat e saj, do të përdorë bash ata katundarë që sillen si trima. Paria e ka shpikur vetë këtë lojë. Katundarët e kanë me të mësuar, këta e kanë me të trashëguar.

Përfundim

Pakti e provon se paria është e bashkuar, ndërsa shqiptarët janë të përçarë. E kam thënë diku që ata duan ta përdorjnë e

poshtërojnë katundarin shqiptar, ndërsa unë e të tjerët duam ta mbrojmë e shpëtojmë, sepse ne jemi katundarët e vërtetë shqiptarë. Por dilema është e të gjithëve: a do të bëhen katundarët fisnikë shqiptarë dreka e darka e dreqit, domethënë e parisë së Tiranës? A do të dinë të bëjnë zgjidhjet e duhura? Sepse këta janë mjeshtra. Një kohë na kanë vënë të punojmë duke ngrënë bukë misri e ujë e sheqer. Tash mund të hamë bukë të bardhë si sfungjer, anipse me grurë të shplamë me klor e kancerogjen, por prapë duhet të punojmë për parinë. Se nuk ka rrugë tjetër, nëse nuk i ikim kontrollit të saj e nëse nuk bëjmë zgjidhjet e duhura në politikë. Shteti lyp katër miliardë dollarë në vit dhe këta që po vinë janë të uritur, duan ca euro edhe për vete dhe e kanë oreksin e madh. Gjarpëri po na sheh në sy, e ka marrë uria dhe ne katundarët jemi dreka e darka e dreqit.

http://www.minfin.gov.al/minfin/Prezantimi_i_buxhetit_te_shtetit_te_vitet_2013_nga_Ministri_i_Financave_z_Ridvan_Bode_ne_Komision_2363_1.ph

<http://gazeta-shqip.com/lajme/2012/12/08/maratona-e-buxhetit-berisha-historik-opozita-me-borxhe-rrezik-si-greqia/>

INISIATIVA “VOTA E BARDHË” - “BËJ BOJKOT” - “VOTA SHKON KOT”

Legjitimiteti i çdo sistemi politik qëndron para së gjithash në marrjen e mbështetjes popullore. Populli hedh votën dhe iu jep votëbesimin politikanëve që mandej qeverisin shtetin. Nga ana e tyre, politikanët bëjnë të pamundurën që të mbledhin sa më shumë vota. Përprjekja e politikanëve kudo, edhe tek ne, për të mbledhur votat është e jashtëzakonshme. Në mbarim të votimit, ata që fitojnë më shumë vota formojnë qeverinë. Por pyetja që shtrohet tani nuk është “për kë duhet të votohet”, është “a duhet të votohet” në zgjedhjet kuvendore të vitit 2013? Përgjigja e shkurtër është që votuesit shqiptarë duhet të votojnë, por ata nuk duhet të votojnë për partitë në këto zgjedhje. Zgjedhjet duhen bojkotuar. Edhe sikur votat e bardha, vota “en blanco”, të përcaktojnë se cila palë e parisë do të fitojë, prapë zgjedhjet duhet të bojkotohen, sepse nuk ka dallim mes palëve. Këta janë tri koka të së njëjtit gjarpër. Vota e bardhë nuk është një votë në mbështetje të sistemit, por kundër tij. Vota e bardhë nuk është zgjidhja më e mirë e mundshme, sepse zgjidhja më e mirë e mundshme do të ishte të votohej për dikë që zgjidh problemet e shumta dhe të pakapërcyeshme me të cilat përballemi.

Por mosdhënia e legjitimitetit, është një arritje e jashtëzakonshme në gjendjen kur kemi një diktaturë fashiste që maskohet si demokraci liberale. Paria e Tiranës ka një nevojë të jashtëzakonshme për legjitimitet. I druhet tërheqjes së

mbështetjes popullore. Dhe e ka shumë frikë “votën e bardhë”. Aq shumë, sa në shtetin shqiptar është rritur çmimi i votës dhe paria është pa ndërprerje në fushatë. Mjetet financiare që janë hedhur, makina politike që është vënë në lëvizje dhe përkushtimi i politikanëve të Tiranës, është i jashtëzakonshëm. “Vota e bardhë” i bën të gjitha këto të pavlefshme dhe e bën parinë të ndjehet krejt e pasigurtë.

Por në pamundësinë e ndërrimit të sistemit, të vendosjes së njerëzve të duhur, të vendosjes së rregullave të duhura e të drejta, të ligjit e të njerëzve që do të zgjidhen, të gjithë shqiptarët duhet ta bojkotojnë sistemin. Shtysa për këtë shkrim erdhi nga inisiativa e një grupi djemsh e vajzash të reja në Tiranë, si Alban Nelaj, Alida Karakushi, Gjergj Erebara, Adela Halo, Ervin Kaciu, e të tjerë. Këta janë të rinj me kurajo qytetare që e marrin seriozisht detyrën e qytetarit, si dhe të drejtat që kanë. Janë organizuar në një grup në facebook: <https://www.facebook.com/votobardhe>. Këta të rinj, të cilët unë nuk i njoh, por i mbështes me shumë entuziazëm në këtë inisiativë, po japin një shembull shumë frymëzues. Unë nuk i njoh të tjerët, por inisiativa e tyre për të bojkotuar sistemin dhe zgjedhjet, është ajo që duhet. Ja edhe disa nga arsyet pse unë mendoj se kjo inisiativë është shumë e dobishme dhe vjen në kohën e duhur.

Pse duhet bojkotuar sistemi?

Së pari, sistemet politike, ekonomike, morale, shoqërore e kulturore janë të përçudnuara dhe nuk janë në shërbim të qytetarëve shqiptarë. Këto sisteme iu kanë shërbyer vetëm palëve të parisë për pasurimin e tyre dhe ndërtimit të një sistemi të pastër oligarkik, kriminal, kleptokrat, të zvetënuar, amoral, të sunduar, të kontrolluar e në pronësi të një grushti klanesh. Nga ana e tyre, këto klane punojnë shumë ngushtë bashkë, si pjesë e parisë së Tiranës për të mbajtur gjendjen e pandryshuar. Këta janë nisur të punojnë bashkë, do të vjedhin bashkë, do të mbajnë bashkë qeveritë, nuk do të ketë

asnjëherë adresim si duhet të problemeve të qytetarëve dhe vjedhja do të vazhdojë pa ndërprerje.

Me një fjalë, si ilustrim, kjo punë është si e furgonit të prishur në rrugën Durrës - Tiranë. Shoferi dhe fatorinoja janë kunetër. Ata grinden se kush i mbledh paratë dhe kush i jep makinës. Tarifën e kanë caktuar që në fillim. Fitimet do t'i ndajnë bashkë në darkë. Por në rrugë e sipër prishet makina, te shtëpia e Rrahmonit, apo Tanit, Gimit e Gonit. Zgjedhjet janë sikur t'u thuash udhëtarëve pasi t'ua kesh marrë paratë në Vorë dhe makina të jetë e prishur, e të mos dish ta rregullosh, "Hë, vendosni ju kush do të jetë shoferi, se kemi vetëm pesë minuta kohë dhe mandej vihuni në rresht të shtyni makinën tonë deri në Durrës, se ndryshe vjen Rrahmoni e Tani, Xeni, Goni e Gimi e iu marrin paratë".

Çfarë rëndësie ka se cili shofer i jep makinës që nuk punon, që për më tepër nuk është as mekanik e nuk din tjetër veç me luejtë timonin majtas - djathtas si karrocën e Dylit? Makina është e tyre, makina është e prishur, ajo nuk po i çon udhëtarët në destinacionin e duhur dhe udhëtarët duhet ta mbajnë gjallë iluzionin e funksionimit të sistemit të parisë. Edhe Rrahmani e Tani, Goni e Gimi janë të tyrët. Prandaj një votë e bardhë, që nuk është në mbështetje të parisë, që nuk numërohet për parinë, është sikur të bësh sikur shtyn makinën, por të mos mundohesh fare.

Zgjedhësit pra, janë si pasagjerët në këtë situatë. Ata duhet të përdorin çdo mundësi për të dalë nga situata ku i mban paria. Nga situata i nxjerr ose riparimi i këtij furgoni nga një pasagjer që është mekanik, ose një furgon i ri që punon, që i çon në destinacion, edhe pse paratë e biletës së furgonit të parë nuk do t'i marrin ndonjëherë. Ose kështu, ose në fund, le ta shtyjnë sa të duan furgonin, prapë do të vijë Rrahmoni, Tani, Zeni e Gimi dhe do t'iu mbledhin paratë. Kush e jep votën, është si ai udhëtar që e shtyn furgonin në këtë gjendje deri në Durrës, sepse këta janë bashkë, duan të vjedhin paratë, të kryejnë punët e tyre dhe të përdorin shqiptarët e votuesit.

Së dyti, vota në sistemin shqiptar nuk ka vlerë. Këta e kanë ndërtuar një sistem që garanton partitë e tyre të fitojnë votat sido që të shkojnë punët. Këta i kontrollojnë të gjithë komisionet si duan vetë. Këta e kanë bërë ligjin zgjedhor si kanë dashur vetë, bashkë e në mbrojtje të interesave të tyre. Këta të bëjnë të hedhësh votën për njërin, ose tjetrin, sepse forcat politike që nuk janë të mëdha, ose në koalicion me ta, janë të humbura. Këta i kanë fshirë emigrantët nga listat. Po votove për ta, të hipin në aeroplan dhe të sjellin në Tiranë të votosh, të shohësh mamin e babin dhe të kthehesh prapë në Greqi, Itali e Hollandë. Po votove e dole kundër tyre, je i humbur. Këta kontrollojnë edhe bandat që rrinë te qendrat e votimit dhe vendosin se kush voton, për kë. Këta i kanë listat gati dhe preson që për 50 mijë lekëshin t'ua nisësh foton e votës me Iphone. Këta të japin Iphone të fotografosh vjedhjen dhe deformimin e votës tënde. Këta e bëjnë si ai shoferi i furgonit që e thërret Rrahmonin, Gimin e Tanin dhe iu thotë, “shihe pak a e shtynjë si duhet furgonin, këta miqtë tanë qytetarë” që jetojnë te kënetat? Në Laprakë do ju japim një kafe edhe këtyre, edhe ju. Por furgoni është i privatizuar prej Rrahmonit që ka edhe një pjesë tjetër në fitim.

Së treti, paria e ka organizuar punën që të mos ketë alternativa të tjera. Çdo politikan që del kundër tyre është i poshtër, bandit i shitur te të huajt, injorant, spiun i sigurimit, bllokmen apo bllokqen, etj. Këta, me një fjalë, nuk duan që të dalë loja nga dora e tyre. Sikur të ndalet ndonjë furgon që i çon njerëzit në vend, këta i thonë “ik, zhduku se të futa një plumb, pis!”. Për parinë e Tiranës, me një fjalë, çdo njeri që del e thotë se furgoni nuk punon, se këta janë hajna, se janë bashkë me Rrahmonin, është mashtrues, kriminel e bandit. Çdo furgon që ndalet për të marrë këta udhëtarë, edhe për një çmim të arsyeshëm, duhet të ikë sa më shpejt që të jetë e mundur, sepse Rrahmoni, Tani, Goni, Gimi ka një koburë të vockël në brez. Prandaj edhe nuk duhet votuar për këta, sepse këta janë sistemi dhe sistemi nuk ndërron nga brenda. Duhet ndërruar me themel rregullat

e lojës. Me këto rregulla loje që janë, këta fitojnë gjithmonë.

Së katërti, cilado palë e parisë të fitojë, shqiptarët do të humbin, se ata janë të gjithë bashkë. Pakti i 1 Prillit 2013, provoi në mënyrë përfekte që janë të gjithë bashkë. Halli i tyre është se si të ndajnë lekët. Saliu, Edi, Iliri, Vangjeli, Skënderi, Paskali, Spartaku, Fatmiri, dreqi dhe i biri, janë të gjithë bashkë, e kanë hallin të ruajnë familjen e tyre, të mbledhin miliardat, të ruajnë kokën, të shmangin urrejtjen popullore, të vjedhin shtetin, të shesin territorin, të degjenerojnë kombin, të shkatërrojnë rininë, të bëjnë të 99 - tat. Halli i tyre është që torta e pushtetit të ndahet pa sherr. Kësaj here u morën vesh shpejt. Saliu ruan familjen, Iliri ruan kuletën, Edi merr pushtetin. Çfarë iu duhet këtyre vota e njerëzve, përveçse për të bërë të pranueshme gjendjen e poshtërsitë që kanë bërë?

Së pesti, për kë do të votojnë shqiptarët? Të gjithë këta që janë e do të jenë në lista, janë kokat e kimit lokal, kombëtar e deri në familjen e tyre. Po dëgjoni çfarë ka thënë Saliu për Ilirin dhe Edin, Iliri për Edin dhe Saliun, Edi për Saliun dhe Ilirin. A ia vlen t'u numërosh epitetet, dëshmitë, poshtërsitë? Janë të pandershëm, të pafytyrë, të zvetënuar, të degjeneruar, të zhveshur nga çdo fije morali e sillen si gangsterët që kanë mbrapa. Kandidatët janë marioneta në duart e parisë. Kush i pa dhe kush i dëgjoi në Kuvend? Çfarë thonë e çfarë flasin? Po kush do të jenë deputetë? A do të jenë Spartak Braho, Ilir Meta, Gramoz Ruçi, Arben Imami, Dashnor Sula, Fahri Balliu, Nard Ndoka, Ferdinand Pone, e të tjerë e të tjerë? Për këta duhet të votojmë? Jo! Këta janë e shkuara jonë fatkeqe, që do ta bëjnë edhe të ardhmen tonë akoma më fatkeqe.

Së gjashti, bojkoti duhet bërë për të mos rënë në kurthin e parisë së Tiranës që e bëri paktin më 1 prill dhe tashti është nisur të zgjedhë shërbëtorët që duhet të shkojnë në Kuvend. Kushdo që do të fitojë zgjedhjet si deputet, do të punojë për parinë, për klanet e saj pa kushte e pa pikë dyshimi. Prandaj njerëzit nuk duhet të dëgjojnë fallxhorët e shtypit që si arihofkat në rrugë, të ndalin, të heqin një qime nga palltoja dhe

të fusin në hall kur të thonë “e paske një hall, po ta them unë hallin për njëqind leka”. Këta ndjekin të njëjtën teknikë. “Ja, ta them unë se çfarë halli ke ti, po mos bëj kështu, se revolucion nuk do bëjmë, e provuam më 1997”. Parulla e ditës është “evolucion dhe rotacion”. Por ka ngelur gomari në baltë dhe shkarrrashkruesit si Mustafa Nano e të tjerët e kuptojnë këtë lojë, sepse e njohin mendësinë e gomarit shumë mirë e qysh herët, nga kohë që nuk mbahen mend. Zhurmuesit e parisë Mustafa Nano, Andrea Stefani, Henri Çili, Ndiriçim Peka, Blendi Fevziu e me rradhë, janë thjesht klientë të paguar që të duartrokasin zgjedhjet e parisë. Si me thanë ndryshe, këta janë kushërinjtë e Rrahmonit, të Gimit e të Tanit që bërtasin nga klubi, “A bën burri kështu? Shtyje more ti, derr pis, pak ma fort! Këtu do të rrini sonte! O burra, edhe njëherë, se s’bo burri kshu!”. Ja, kjo është mendësia e këtyre zhurmuesve të parisë.

Së shtati, duhet vepruar kështu, sepse ky fisi në këtë katund i ka ndarë punët, jetojnë me këtë punë, e kanë biznes të familjes. E dinë se katundarët që kanë hall, do ta shtyjnë furgonin nja një kilometër dhe as nuk do të kërkojnë paratë e do të turren të gjejnë strehë në katundin afër, ose do të shkojnë në këmbë deri në Tiranë, domethënë në mërgim. Ata që kanë ca para do të ndalen te “Stela” apo te “Dream City” e do të thonë sesa “kopila”, domethënë sa të mençur ishin Sala, Iliri dhe Edi, që ua futën ashtu. E Saliu, Edi dhe Iliri do të kthehen në Durrës me marrë pasagjerë të rinj, katundarë që kanë hall me zgjidhë në Tiranë. Rrahmoni do të shkojë me Tanin, Gimin, Gonin, me “bo noj sen”. Nga ana e tyre, Muçi Puçi, te themi Rrushit Rrapatushi (ky është pseudonim, por megjithatë unë nuk e ve dorën në zjarr, sepse nuk i di këto pseudonimet e reja) dhe llapaqenëria mediatike do të shkojnë te emisioni i Blendi Fevziut e në vende te tjera. Do diskutojnë me zjarr se çfarë duhej të bënin katundarët dhe sa pare do të marrë Saliu, Edi, Iliri e kush ishte burri më i mirë që nuk ua futi dorën në xhep katundarëve pasagjerë, që ishin kaq budallenj, po “hajt ma, popull budallë, rob kot që jena!”.

Në përfundim

Për këto arsye duhet mbështetur inisiativa “vota e bardhë”. Kjo është një shprehje e qytetarisë shqiptare, është një mënyrë për me i ikë kontrollit të parisë, për me pasë një fillim të ri, për me kuptue vetveten e zgjidhjet që kemi. Ndoshta për ata ne jemi pasagjerë katundarë, po këtë furgonin tonë, këtë shtetin tonë, na e kanë vjedhur këta pjesëtarë të parisë së Tiranës dhe ne duhet t’ua marrim. Ne do të gjejmë rrugën tonë dhe, në fakt, fillimi është po ky: shteti është i joni. Shtetin do ta bëjmë tonin vetëm kur të votojmë si duhet, për njerëzit që duhet, për problemet që duhet dhe me seriozitetin e duhur. Prandaj edhe këtë herë, edhe në këto zgjedhje, duhet bërë thirrje për bojkot, sepse kjo votë shkon dam. Në mos mundsh të votosh, e në mos qofsh i/e bindur për cilën parti mund të votosh, atëherë bëji një “like” e “share” kësaj inisiative në Facebook. Sepse, kur blen “miq” në Facebook edhe nga Egjipti vetë Saliu, Edi dhe mbështetësja e PD, Bleona Qerreti, ne të tjerët të paktën mund të themi se nuk duam të jemi pjesë e krimit të tyre dhe do të jemi të saktë në bindjen tonë.

EDHE NJËHERË MBI VOTËN E BARDHË BOJKOTIN DHE PROTESTËN

Paria e Tiranës me paktin e 1 prillit e ka shpallur qartë strategjinë e saj. Ata do t'ia ruajnë shpatullat njëri - tjetrit dhe do të na bëjnë ne të gjithë të vuajmë edhe më shumë. Sistemi është i ndërtuar në mënyrë të tillë që këta të na i vjedhin votat. Si votuam 50 %, si votuam 110 % këta e kanë ndarë mendjen të na e vjedhin votën, me të edhe shpirtin dhe të ardhmen. Prandaj duhet “vota e bardhë”, “bojkoti” dhe “vota e protestës”.

Paralajmërim për ata që votojnë

Po votove, vota jote shkon kot gjithsesi, sepse këta do ta vjedhin e deformatojnë votën tënde. Vota shkon me i dhanë jetë e frymë, garanci e legjitimitet, pikërisht atyre që e kanë shkatërruar të ardhmen e shqiptarëve. Po iu dhe votën, iu ke dhënë të drejtën që të bëjnë çka të duan me ty, me familjen, me pasurinë e me të ardhmen tënde.

Vota jote nuk ka rëndësi, sepse këta e dinë sa duhet të vjedhin e si dhe do të bëjnë pikërisht atë gjë. Nuk ka rëndësi nëse del në krye Sali Berisha, Ilir Meta, Edi Rama, apo dreqi dhe i biri. Të gjithë këta janë njëloj, djall rozë, dreq blu, shejtan integrues. Të gjithë këta janë në lojë për kuletën e vet. Këta e kanë mendjen me vjedhë, me u pasurue, me ruejtë familjet e tyre, me mbrojtë interesat e klaneve dhe nuk pyesin për shqiptarët e tjerë. Me ua dhanë votën këtyre është me dënuë veten me dorën tande, me mendjen tande.

Vota jote është arma që ke me luftue të keqen. Dhe e keqja është gjithkund. Demokracia në shtetin shqiptar është më keq se e dështuar, është oligarki. Ekonomia është më keq se në krizë, sepse është tërësisht e varur nga sektorët joproduhues. Shoqëria është e varur nga kriminaliteti. Administrata është e korruptuar. Këta janë hajna dhe partitë e tyre janë banda. Vota jote duhet hedhur kundër këtyre. Prandaj voto kundër, bojkoto, hidh një votë proteste, një “votë të bardhë”.

Pse duhet ta hedhësh votën e bardhë të protestës?

Se këta që na sundojnë duhet të qërohen, duhet të zhduken nga faqja e shtetit shqiptar e jo të kenë fytyrë të dalin e të kërkojnë votën tonë. A ia jep votën atij që të ka trafikuar fëmijën? A ia jep votën atij që të ka djegur shtëpinë? A ia jep votën atij që të ka lënë pasurinë në kumar? A ia jep votën atij që të rreh përditë në qoshe të rrugës? A ia jep votën atij që bën dasëm deri në mesnatë me paratë e tua, në shtëpinë tënde e të ka marrë gruan e fëmijët peng? Ja, me ua dhanë votën këtyre është me veprue në këtë mënyrë.

Vota është e shenjtë, është dinjiteti e nderi jot. Ruaje atë nder se nuk jepet lehtë! Kur ia jep votën dikujt është njëlloj si me ia lanë në dorë fëmijën tënd, sepse po iu lë edhe më shumë. Po iu lë këtyre në dorë të ardhmen tënde, shtetin, ligjet, forcën, ekonominë, shëndetësinë, arsimin. Të gjitha. E këta e kanë mendjen me vjedhë, vëlla, janë hajna. Prandaj nuk duhet me ua dhanë votën këtyre, asnjërit, sepse këta nuk e meritojnë.

Si duhet vepruar?

Po munde të organizohesh, organizohu! Po gjete forca politike që mbrojnë interesat e të gjithëve, bashkohu me to! Lufto kundër të keqes me të gjitha mënyrat e mundshme! Por mos e rrej veten; kjo nuk duhet bërë, sepse e keqja fillon pikërisht me vetëmashtrimin.

Po nuk pati forca që luftojnë kundër të keqes, bëji bojkot sistemit. Kjo nuk është demokraci. Ky është fashizëm demokratik, oligarki, sundim i klaneve të krimit. Mos voto, shko me pushime po pate para, rri në shtëpi po nuk pate para, shtiru i sëmurë, bëj çka të duesh, por mos e dëgjo atë sekserin e parisë që të vjen te dera e të numëron si bagëtinë se i duhesh vetëm për një moment, për votën. Mos dil, mos shko kund, mos voto!

Po nuk pate rrugë tjetër se je i dobët, je i varur, por e kupton të keqen, atëherë shko në qendrën e votimit e hidhe votën e pavlefshme. Hidhe “votën e bardhë”, por jo që me e përdorue ata. Hidhe votën, por duke iu rënë vizë të gjithëve. Vizato një qen, një mace, një gjarpër, një kukudh, një shejtan, djall me brirë, se kështu janë këta. Shaji me listë. Shkruaj “bandë hajnash” shkruaj, “kriminelë”. Shkruaj “ju zëntë mallkimi i naneve shqiptare!”. Mandej hidhe votën.

Do ta nxjerrin të pavlefshme, por mandej do të paguajë dikush një avokat që të gjykojë vlefshmërinë e votave dhe do të dalë edhe vota jote e protestës e të bëhet publike. Bëji një foto votës e nise me email e në Facebook. Atë të sharën që ke bërë ti, do ta përcjellim në të gjithë Shqipërinë, në internet e në rrugë të tjera. Dhe do të jetë fshikullimi më i madh për këta që duan të shiten të larë para popullit. Prandaj duhet “vota e bardhë”, sepse nuk është votë e bardhë që ta mbushin këta, por votë e bardhë që të shprehesh ti, që të protestosh ti për padrejtësinë, që të ngresh zërin ti për pafuqinë, që të kërkosh ti atë që është e jotja; ardhmërinë e sigurtë, me nder e me dinjitet, si gjithkush tjetër në një shtet normal.

Përfundim

Në fund, mos voto për krimin! Në fund, po pate kurajo, merre atë letrën e votimit, fute ne xhep dhe shko në darkën e 23 qershorit te Gropa e Politikanëve pas Pallatit të Kulturës. Atje do të gjesh shumë të tjerë që do t'i hedhin në një kosh të

zjarrtë ku do të tregohet se këta nuk meritojnë të na sundojnë. Ruaje edhe për katër vjet dhe kur të vijë dita tregojua fëmijëve e thuaju “këta duan të na vjedhin të ardhmen, por nuk do t’i lejojmë”! Dhe mendo për një fillim të ri, për njerëz të rinj, për të ardhme të re, për një shpresë të re, sepse ka Shqipëri edhe për ne të tjerët! Bojkoto zgjedhjet, protesto! “Voto bardh” duke iu vënë vizë këtyre plehrave e kërmave të historisë sonë të dhembshme. Mallkoji në atë votë! E mos harro se këta duhen marrë në dorë me libër e pa dhembje!...

PAKTI I PARISË SË TIRANËS, PRAGMATIK APO MORALIST

Pakti i parisë së Tiranës që u formalizua me 1 prilli 2013, është shumë domethënës, edhe nga një këndvështrim tjetër prej atij të kafenesë. Në kafenetë, mejhanet, pubet, baret, restorantet e pijetoret, pakti i parisë së Tiranës shihet sipas standartit “kush e hëngri atë ngjalën” e “kush ia futi, kujt ngjalën në gojë”, domethënë sipas problemit të ngjalës, gatimit dhe mënyrë se si u fshi nga pjatat dhe ku përfundoi në rrëshqitjen e saj të dallueshme nëpër kolltukë meshini, e jo në minderë tradicionale, pa përdorur vajin e ullirit apo dhjamin e vet.

Po për mua, pakti i parisë së Tiranës dhe shkalla e rezinjatës shoqërore që e pasoi, janë shumë domethënëse për gjendjen e debatit politik, për mendësinë mbizotëruese të shoqërisë, për nivelin e ultë të gjykimit nga ana e masave, për shitjen e pacipë e të pafytyrë të llapaqenërisë mediatike si dhe mbi të gjitha, për nivelin e ulët të përgjegjësisë shoqërore të parisë së Tiranës. Me këtë pakt, paria provoi se nuk ka vlera morale, se pragmatizmi i saj është individualist në ekstrem dhe se motivimi i sjelljes së saj është frika nga urrejtja popullore dhe përplasia e mundshme pas zgjedhjeve.

Shkaku për këtë shkrim, një Shkrim i Dr. Eduard Zaloshnjës

Një nga shkrimet ku u reflektua shumë qartë e me profesionalizëm analitik, ndonëse jo me seriozitetin minimal e të pritshëm moral mbi këtë dilemë shoqërore, ishte shkrimi

i sotshëm i Dr. Eduard Zoloshnjës “Miti i votës morale dhe realiteti i koalicioneve elektorale”. Duke e ndjekur shtratin e premisave argumentative, më shumë se vetë logjikën dhe argumentet e Zoloshnjës, pyetja kryesore, çeshtja e vërtetë, dilema e madhe, del se është kjo: a ishte pakti i parisë së Tiranës i 1 prillit 2013, një pakt pragmatik apo një pakt moral?

Përgjigja e Zoloshnjës është se ky pakt ishte jo vetëm një pakt pragmatik, por realist dhe i domosdoshëm e bile edhe moral. Për të, Saliu nuk hiqet ndryshe, përveçse nga bashkimi i forcave të “majta”. Ky koncept i “të majtës” është një deformim i plotë, sepse partitë politike të ashtuquajtura “të majta” në shtetin shqiptar janë thjesht banda elektorale. Janë grumbullime fisesh e katundesh që nuk kanë asnjë bindje kolektiviste dhe liderët e tyre mbrojnë vetëm interesat e klaneve respektive. Por me finesën profesionale që i mungon z. katundarit Muçi Puçit, Zoloshnja argumenton që përçarja e këtyre bandave, mbeturina të strukturës së PPSH, mundësoi fitoren e Sali Berishës me një pakicë votash në vitin 2005. Për më tepër, bashkëngjitja e njëres palë, LSI mundësoi fitoren e Sali Berishës edhe në vitin 2011. Argumentimi i tij është këtu nuk ka vend për moral, por për realizëm elektoral të mbështetur në pragmatizëm të pastër. E majta që përkthehet si bandat e farefisit, duhet të bashkohet “që të heqim qafe Saliun”.

Ajo që bën Zoloshnja me këtë shkrim, nuk është tjetër veçse një përpjekje që të përforcojë bindjen që ekziston në një masë të madhe të elektoratit dhe të segmenteve të parisë së Tiranës. Argumenti sundues në këto rrethe është; duhet të përdorim “të keqen më të vogël”, për të hequr “të keqen më të madhe”. Të mbajmë hundët e të heqim një herë Saliun, se ndoshta bëhet mirë pas zgjedhjeve. Të mos bëjmë më një 1992 apo një 1997 të re. Se në fund të fundit, kështu bëjnë të gjithë dhe me argumentin që Muçi Puçi e kupton si duhet, sjellja e pritur është “ush - ush si gjithkush,” të zgjedhim Edin dhe Ilin, se këtë nuk e durojmë dot më! Eh, katundi prej ku vjen me origjinë z. Zoloshnja, është një kilometër e gjysëm vertikalisht

mbi nivelin e lumit më të afërt. Kësaj i thonë, “Për inat të sime vjehrrë, shkoj e fle me mullixhinë!” Asokohe nuk kishte motele e parti, sepse tashti duhej ndryshuar kjo fjalë e përshtatur me modernitetin katundar që sundon në Tiranë.

Zgjidhje pragmatike apo morale?

Dilema pra, është e thjeshtë: zgjidhja duhet pragmatike apo morale? Përgjigja në rrethet politike - mediatike të Tiranës është e ditur dhe e konsideruar edhe më pak se mençuri popullore. Në Tiranë të thonë të gjithë, edhe ai që të shet një misër të përzhitur në rrugë, se politika nuk ka moral. Politika në Tiranë e ka vendin te Gropa e Hajdin Sejdisë, edhe pse e mbushur, në rrethe të caktuara e njohur si Gropa e Politikaneëve. Si mund të ketë politika moral?! E di si i themi ne politikës në Tiranë? Po nuk iu dhe përgjigjen që presin, domethënë që politika është një dikush që shet një rrugëdalje te Gropa e Politikanëve që kujtohet si Gropa e Hajdin Sejdisë, ku do të bëjë opozita e radhës mitingjet pas 23 qershorit, të gjithë të thonë “ti nuk jeton në Shqipëri!”.

A e njoh unë gjendjen? Po, more, e njoh mirë shumë! Në parantezë, unë jetoj në Shqipëri më me intensitet se shumë të tjerë, unë jetoj me Shqipërinë, e kam më shumë dije për ecuritë e proceset se shumë të tjerë që fitojnë bukën duke bërë politikë në shtetin shqiptar. Kaloj dy - tre muaj në vit në shtetin shqiptar. Për shembull, vitin e kaluar kam qenë atje disa herë. Por po mendova që politika duhet të jetë në shërbim të shqiptarëve, të gjithë mund të më thonë “ti nuk jeton në Shqipëri!”. Pra, unë e njoh shtetin, i njoh njerëzit, e njoh zanatin, e njoh politikën, se jo për modesti, por ata që më njohin e dinë se në disa momente kritike kam marrë vendime, kam pasur peshë, kam sakrifikuar veten, familjen dhe të ardhmen time për idetë e mia. Dallimi midis meje e tyre është se unë dua një Shqipëri tjetër dhe nuk e pranoj shtetin e bandave e të hajnave. Prandaj këta thonë se unë nuk e njoh Shqipërinë...

Që të kthehemi te debati në fjalë, sipas kësaj mendësie sunduese, zgjidhjet politike duhet të jenë krejtësisht pragmatike. Ergo, veprimi i parisë që mbërriti këtë marrëveshje është qartësisht i drejtë. Ajo që i jep shteg këtij interpretimi dhe justifikimi të shtrydhur deri në pikën e fundit, është bindja e përhapur në shoqërinë shqiptare se politika është vetëm pragmatike, e mbështetur në konjuktura e në interesa të momentit. Sipas këtij argumenti, politika nuk mundet me kenë morale, sepse është gjithnjë rreth zgjedhjes të së keqes më të vogël.

Por ana tjetër e medaljes, përjashta politikës, është që të gjithë duhet të sillemi moralisht. Jemi qytetarë, familjarë, njerëz dhe është e pamundur të pranosh të keqen në jetën tënde. Përjashta politikës gjithkush duhet të synojë të mirën më të mundshme. Për ata, po deshe të sillesh me moral, mos u merr me politikë. Sepse morali e përjashton politikën dhe anasjelltas.

A duhet të jetë kështu? Në këtë shkrim, unë pajtohem me Zaloshnjën vetëm në një pikë. Edhe unë do të argumentoj se sjellja e politikanëve ishte thellësisht pragmatike. Po nuk pajtohem me argumentin e tij se kjo u bë për dobinë e të "majtës". Sipas meje, nuk ka "të majtë," ka vetëm banda politike e kriminale që vënë kollare e rruajnë kokat, hanë ngjala dhe shesin dokrra ideologjike. Pra, Zaloshnja po bën zhurmuesin e parisë dhe po rreket që t'iu hedhë hi syve njerëzve. Argumenti i studjuar mbulon qëllimet jo të pastra të tij.

Si duhet kuptuar pragmatizmi i parisë?

Si duhet kuptuar pragmatizmi i parisë me paktin e 1 prillit 2013? Kjo logjikë sjelljeje, parë nga këndvështrimi i interesave individuale të prijatarëve të palëve të parisë, të bind që pakti ishte një veprim qartësisht pragmatik, racional dhe kalkulatativ individualist. Ama nga këndvështrimi i interesave të popullit dhe i të një pjese të parisë së mënjanuar e politi-

kisht të izoluar, ky pakt ishte një pakt thellësisht amoral. Ku qëndron problemi?

Problemi me këtë dilemë që errësohet qëllimisht e që paraqitet në terma absolute në Tiranë, qëndron në keqkuptimin e fushës së veprimit të politikanëve. Do të thoja se ka një kufi ku lejohet që politikani të sillet në mënyrë amonale. Varet se ku e si vihet ky kufi. Si edhe ka thënë një burrë shteti, "Po të kisha bërë për vete atë që kam bërë për popullin tim, e meritoja të varesha nja dhjetë herë". Kufiri, pra, i legjitimitit të sjelljes pragmatike, varet nga objektivi moral që politikani i ka vënë vetes. Në këtë rast, pyetja për të justifikuar një veprim pragmatik duhet parë nga justifikimi moral që ofrohet. Për të mirën e kujt bëhet një veprim i caktuar? Sepse marrja e jetës së dikujt nuk është një veprim moral, por vrasja dhe dënimi me gjyq i një kriminel, marrja e jetës së tij, është një veprim shumë moral.

Ana pragmatike e paktit të parisë së Tiranës

Teoria e zgjidhjes racionale, në veçanti teoria e selektoratit, e shpjegon shumë mirë sjelljen e parisë së Tiranës. Teoria e zgjidhjes racionale thotë se udhëheqësit kanë vetëm e vetëm një preferencë; të fitojnë zgjedhjet dhe të mbesin në pushtet. Ata llogarisin përfitimin dhe humbjen që kanë, sipas preferencave të tyre personale që nuk janë gjithnjë pastërtisht materialiste dhe ekonomike, që i motivojnë të sillen në një mënyrë të caktuar. Pra, nga këndvështrimi i kësaj teorie, pakti i parisë së Tiranës dhe sjellja e tre politikanëve të tranzicionit, Sali Berishës, Ilir Metës dhe Edi Ramës duket tejet pragmatike, utilitare, e justifikueshme dhe racionale.

Sepse që të tre prijatarët e parisë u sollën si individë pragmatikë, racionale, të ftohtë dhe shumë llogaritës. Ata peshuan interesat e tyre individuale dhe llogaritën se çfarë iu duhej mbështetësve të tyre për të mos u rebeluar. Kalkulimi politik i secilit ishte tejet racional, i ftohtë dhe bindës. Por ishte kështu

vetëm po të shihet nga këndvështrimi i tyre si persona. Nga pikëpamja morale, ata u sollën si banditi që të vret, sepse i duhet kuleta jote për të blerë drogën që i duhet. Nga këndvështrimi moral, ata nuk morën parasysh interesat e popullit shqiptar. Sepse në këtë rast, populli e ka thikën e tyre në fyt e dorën e tyre në xhep. Prandaj pakti nuk është moral, nuk është as për popullin, as për mbështetësit.

Cilat ishin qëllimet dhe preferencat e tyre? Duke përdorur rregullat e lojës politike, duke i ndenjur besnik paktit të 1 prillit, Saliu humb zgjedhjet. Ai qëndron në një opozitë të fortë shumë, siguron vendet e punës për mbështetësit dhe kontrollon PD. Mban kontrollin e posteve kyçe si Prokurori i Përgjithshëm, Presidenti, policia, etj., etj., dhe në dukje vazhdon luftën politike me një grup biznesi që e mban peng deri në fitoren e ardhshme. Këtë herë, meqë sheshin "Skënderbej" e ka bërë dikush livadh, Saliu do të shkojë mbrapa Pallatit të Kulturës, aty te Gropa e Politikanëve dhe do të bëjë mitingjet opozitare. Por humbja don të thotë largim nga puna për shumë mbështetës, heqje e kotheres së bukës për shumë të tjerë, humbje e tenderave dhe kontratave dhe zhgënjim i thellë i atyre që duan të luftojnë komunizmin dhe mullinjtë e erës në paçavuret e tij.

Pra në fakt, zgjedhjet i humbin militantët e PD që nuk e dinë a do t'u dalë dhjami jo i paktë që vunë gjatë këtyre tetë viteve duke vjedhur pa mëshirë shtetin e shoqërinë. Objektivi racional i Saliut nuk është fitorja e zgjedhjeve për militantët, që i duhen si mish për top, por mbrojtja e familjes së tij të ngushtë dhe sigurimi i vetes që e fiton përmes një opozite të fortë. Saliu ka një objektiv minimalist, individualist and utilitarist. Ai e din se shumë të pakënaqur brenda radhëve të PD do të duhet të ikin, shumë të tjerë duhet të hidhen në rrugë. Por atij i duhet një masë kritike sa për të garantuar të birin, të bijën dhe interesat e familjes.

Si vallë Edi Rama e pranoi bekimin e Saliut e marrëveshjen me Ilir Metën që i kanë punuar qindin njëri - tjetrit? Me këtë pakt, Edi Rama garanton në mendjen e tij mundësinë që të

bëhet kryeministër. Me pushtetin vjen edhe mundësia që të ndajë të mira publike dhe të çimentojë kontrollin e vet mbi partinë e strukturat që janë shumë të bezdisura nga ndenja tetë vjet në opozitë, sepse në vitin 2009, i humbën zgjedhjet për shkak të mungesës së qartësisë në lojë të vetë Edi Ramës. Kuadrot dhe mbështetësit e partisë së tij, janë njerëz të mësuar të hanë nga thesari i shtetit. Ndenja në opozitë cënon rolin e tij si udhëheqës i kësaj pale të parisë, sepse këta i shiten prurësit më të parë dhe po vazhdoi puna kështu, ata kalojnë me Ilir Metën. Edi Rama ndaj kaloi mbi ndjenjat e veta, mbi gjithë frikën që ka se Ilir Meta e Sali Berisha do ta manovrojnë fill pas zgjedhjeve dhe shpreson e beson që marrja e pushtetit do të mbajë atë në krye të PS. Marrja e pushtetit i garanton atij mundësinë të shqyëjë thelat e fundit që i kanë ngelur ekonomisë shqiptare. Për të kjo është luftë për jetë a vdekje në politikë dhe kjo zgjidhje e pakti i garanton mbijetesën.

Ilir Meta po ashtu del i fituar, sepse ai e din se kontrollimi i shtetit dhe shpërndarja e të mirave publike, është mënyra më e mirë me mbajtë mbështetësit e tij bashkë, sepse anëtarët e partisë janë rrogëtarë të punësuar. Në një shoqëri materialiste, ky ka partinë më materialiste. Në këtë shoqëri, njerëzit i shiten atij që paguan më shumë, e shpesh çmimi që kërkohet është një vend pune në shtet. Kjo logjikë funksionon në mënyrën perfekte. Ilir Meta i largon për dy muaj njerëzit e tij nga administrata shtetërore, por i kthen me cilëndo qeveri që do të vijë. Si edhe e kam thënë shumë herë, nuk bëhet qeveri pa Ilir Metën.

Në përfundim? Të tre duan të fitojnë brenda partive të tyre, të mbajnë bashkë koalicionin fitues respektiv në masën e zgjedhësve. Dhe marrëveshja që bënë e garanton këtë. Pra, teoria e zgjidhjes racionale, që e shpjegon sjelljen politike nga këndvështrimi i interesave të ngushta, tregon qartë se këta nuk kanë ndërmend të punojnë për interesin e popullit. Këta iu kërkojnë njerëzve që të shkojnë të votojnë, po për kë do të votojnë shqiptarët? Këta kanë ndërtuar një sistem që iu shër-

ben atyre, që është kriminal, oligarkik, kleptokrat, klanor dhe i zvetënuar në ekstrem. Ky sistem nuk iu shërben shqiptarëve, nuk iu shërben interesave të tyre, është moralisht i dënueshëm dhe kriminal. Në çdo shtet tjetër të botës këta duhej të shkonin para gjyqit. Sepse lista e krimeve të tyre është e gjatë dhe e pambyllur. Vjedhje, degjenerim, betonim, ndotje, emigrim i detyruar, trafikim i pamëshirshëm, shitje e territorit, shitje e nderit, humbje e sovranitetit, përdhosje e familjes dhe e vlerave, drogim masiv i rinisë, zvetënim i pashembullt, veçse verja emrin.

Shteti shqiptar është më keq se Sodoma e Gomorra. Në emër të mbijetesës së mundimshme në politikë të klaneve të tilla kriminale, është sakrifikuar e ardhmja e të gjithë shqiptarëve. Prandaj ky pakt nuk është moral, nuk mundet me kenë, ose me u pranue si moral. Ky është pakti i banditëve që e kanë kapur një popull për fyti, që e mbajnë peng, që i kanë marrë nderin e kuletën e tash duan t'i marrin edhe jetën.

Morali në politikë

Kjo temë mund të përmbliidhet shumë shkurt. Në politikë sjellja që i shërben grupit të cilit i përket e bën sjelljen e moralshme. Po besove në veten e në interesin e ngushtë personal, çdo veprim që bën do ta bësh i nisur nga interesat e ngushta. Ti je i moralshëm për veten, por aspak i moralshëm për shoqërinë. Pra, je si gjarpëri që sillet në mes të minjve. Kur mendon për klanin, bandën, grupin, rrethin etj., je si 40 hajdutët e Ali Babës. Je thjesht një bandë dhe morali i bandës nuk është ai i shoqërisë. Kur mendon si burrë shteti, atëherë sillesh me moralin e duhur me popullin tënd. Ama në politikën e jashtme duhet të sillesh me pragmatizën e me vetëdijen e duhur, se nuk ka rrugë të lehta, zgjidhje të shpejta.

Morali në politikë, don të thotë që shtetari punon gjithmonë me këtë qëllim në mend. Mund të mos mbërrish më të mirën që duhet, por mbërrin më të mirën e mundshme. Pra,

një burrë shteti vepron me moralin e duhur, kur mbron interesat e shtet - kombit, shpeshherë edhe kundër vetë popullit të vet. Njëlloj si doktori që të bën me e lanë duhanin, të ushtrohesh, të mbash dietë etj. Është kaq e thjeshtë. Ky është vendi i moralit në politikë. Këtë nuk e thotë Zaloshnja, Muçi Puçi, Rrushi Rrapatushi dhe zhurmuesit e parisë, që thellë - thellë janë të njëjtët malokë të edukuar konvikteve që zbritën nga mali dhe kur e panë se nga kanë ardhur, nuk shkojnë më pas për qamet se çdo të gjejnë? Gurë e dhe.

Përfundimi

Askush nuk e di ku e ka vendin Ali Baba dhe 40 hajdutët. Sepse banda që vodhi e vrau Ali Baba, nuk ka pasur ndonjëherë atdhe dhe prandaj nuk ka as varr. Këta tanët, Sali Babën dhe këta 400 000 hajnat vullnetarë e mbështetës të tyre, si dhe zhurmuesit e parisë do t'i nxjerrim edhe nga varret, sepse edhe po të ishin krijesa të djallit, nuk do të sillëshin si janë sjellë. Sepse edhe atëherë duhet të bindemi përfundimisht që këta gjarpërinj nuk janë në gjumin e dimrit, por kanë ngrdhur një herë e mirë. Këta që nuk na dhanë paqe, nuk meritojnë paqe. Pragmatizmi i tyre është mendësia e gjarpërit. Morali është për ata që e duan popullin e vet me shumë se jetën dhe që duan asgjë më shumë se dy metra dhe që të prehen në paqe një ditë. Edhe politika na duhet e moralshme dhe në shërbim të shqiptarëve.

BLLOKMENË, BLOKQENË, BLOKZAGARË
DHE KOKËPALARË:
PAKTI 1 PRILLIT DHE ZGJIDHJA QË NUK E KEMI

Pyetja që vërvitet në mendjen e gjithkujt dhe që paraqitet si nëntekst në shkrimet e ndryshme është kjo: a do të ketë përplasje pas 23 qershorit? Nga jashtë lojës politike, gjendja në Tiranë duket shumë dramatike dhe e tensionuar. Dyqanxhinjtë janë të shqetësuar, nuk e dinë çka mund të ndodhë me pasurinë e me tregtinë, sepse ka shkuar biznesi në fund e listat janë mbushur me njerëz që blejnë veresie. Zyrtarët janë të shqetësuar, sepse nuk e dinë a kanë punë apo jo pas 23 qershorit dhe të gjithë kanë kredi, fëmijë e mënyra jetese që nuk përballohen ndryshe, përveçse duke vjedhur nga puna e shtetit. Afaristët janë të shqetësuar sepse të gjithë duan të dinë çdo të bëhet me tenderat e shtetit që është i falimentuar. Zejtarët nuk dinë çka të shesin, sepse nuk ka treg dhe taksat të mbysin. Masat e gjëra janë të shqetësuara, sepse i druhen kthimit të bandave e të marrëzisë kolektive të vitit 1997. Dhe njerëzit e shohin thikën që e kanë në kockë, sepse gjysma e popullsisë e gatuan bukën në shtëpi, por nuk duan të shohin sherr, sepse kanë parë llahtarë në vitin 1997. Të huajt janë tejet të shqetësuar, sepse nuk dinë se ku t'i kapin këta gjarpërinjtë tanë që të rrëshqasin duarsh edhe po t'i kapësh me gjethe fiku e hi.

Kush nuk po e prish terezinë?

Kush nuk po shqetësohet për këtë gjendje? Në sipërfaqe,

të vetmit që nuk e prishin terezinë janë prijatarët e parisë. E pra kjo sjellje e tyre duket paradoksale. Këta duhej të ishin më shumë të shqetësuar se të gjithë ne të tjerët, sepse në dukje rrezikojnë të humbin shumëçka. Duke i parë e gjykuar nga sipërfaqja, të duket sikur janë gati të vrasin njëri - tjetrin, sa ta shohin në Sheraton apo në Dhërmi. Sepse nuk kanë lënë gjë pa thënë e pa bërë ndaj njëri - tjetrit. Janë sharë, i kanë nxjerrë pisllëqet, vrasjet, krimet, grabitjet, korrupsionin e gjithçka tjetër.

Por shërri vazhdon në publik me nga një shashkë media-tike hedhur nga Sali Berisha, Edi Rama apo Ilir Meta në mënyrë shumë të llogaritur. Tri shashkat e fundit që të bëjnë të qeshësh e të qash ishin këto. Edi tha “21 janari kalon nga 23 qershori”. Kush e kuptoi këtë? Unë mendoj se as Edi nuk e kupton çka tha, sepse kjo nuk ka kuptim. Ilir Meta tha se “sheh nga e ardhmja dhe jo nga e shkuara”. Normal, kur fut 700 000 euro në xhep për shtatë minuta, si do të shohësh nga e shkuara? Nga ana e vet, Saliu ka nisur të merret me lulishtet e Tiranës dhe dërgoi ngushëllimet e tij për vdekjen e Thatcher, ndër të tjerëve edhe punonjësve të ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, shumica shqiptarë e me lidhje të forta me palën tjetër. Hajde e merre vesh maskaradën që luhet në Tiranë.

Edhe më shumë se kaq, sjellja ndaj njëri - tjetrit është e mbuluar me një heshtje e vetësiguri që nuk është e shpjegueshme, sepse as nuk po lodhen me u marrë me paktin që e nxori në publik pisllekun e tyre, marrëveshjen për vjedhjen paraprake të zgjedhjeve. Si të shpjegohet kjo sjellje? Ajo bëhet e shpjegueshme vetëm kur fushata që bëjnë konsiderohet si asgjë më shumë se një lojë, teatër për konsum publik, si një çudi që nuk do të zgjasë më shumë se tri ditë. Dhe fushata konsiderohet si teatër ku këta e kanë bërë marrëveshjen me kohë e tani duan ta shesin si diçka normale.

Çfarë tregoi pakti?

Pakti i 1 prillit tregoi hapur se trinomi Sali Berisha, Ilir Me-

ta dhe Edi Rama nuk kanë skrupuj, por vetëm interesa. Ata duan të punojnë bashkë, do të punojnë bashkë dhe do të bien po bashkë. Bashkë e bënë Gërdecin, bashkë e bënë Kodin Elektorale, bashkë i vodhën zgjedhjet, bashkë e mashtrojnë popullin, bashkë i kanë mbuluar të gjithë poshtërsitë e mundshme që ka bërë secili. Grindja e tyre është vetëm për sy e faqe. Këta nuk punojnë për shqiptarët, këta nuk punojnë për të mirën e kurrkujt, as për të mirën e tyre. Sepse dikur edhe hajni e mafiozi më i madh lodhet duke vjedhë e don me u ba zotni. Këta duan me mbetë hajna e cuba të rëndomtë. E vetmja gjë që dinë është të vjedhin nga thesari i shtetit, nga pasuria e shqiptarëve dhe e ardhmja e tyre.

Më e keqja është se pakti tregoi që këta janë bashkë, por janë bashkë kundër gjithë shqiptarëve të tjerë. Sepse këta nuk e dinë çka po bluajnë në mendje shqiptarët e tjerë. Bashkimi i tyre kaq hapur, kaq në unitet dhe kaq i lehtë, tregon se kanë një frikë të thellë se të nesërmen e 23 qershorit do të plasë sherrri, pikërisht ai sherr që duan ta kontrollojnë e ta shmangin.

Bashkimi i tyre i hapur dhe i paskrupullt, moralisht i çimentuar me paktin e 1 prillit, tregon se këta i druhen popullit. Bashkimi i tyre i hapur tregon se këta i druhen aq shumë popullit, sa bënë pikërisht maksimumin e asaj që duhej të bënin e që mund të bënin, në mbrojtje të interesit të tyre. Gjëja më kryesore ishte të mos lejonin të kishte sherr me tyre. Por ky bashkim iu tregoi shqiptarëve, të gjithëve; qorrave, memecëve dhe shurdhëve politikë, edhe militantëve, klientëve e gjithë të tjerëve një gjë: këta i konsiderojnë si armiq dhe iu kanë frikën. Pakti tregoi se këta janë pjella të së njëjtës mëmë, ndajnë të njëjtën mendësi e vlera. Militantët bërtasin “kjo është partia ime”, por pakti tregoi se partitë janë njëlloj, banda hajnash, të drejtuar nga cuba, që kanë si objektiv vjedhjen e të ardhmes së shqiptarëve. Militantët e PS mund të votojnë lirshëm Sali Berishën, militantët e PD, Edi Ramën dhe ata të Ilir Metës mund të gjejnë punë me të dy palët.

Pakti si problem

A është pakti problem? Pakti është një problem i jashtëzakonshëm, sepse tregoi lidhjen e fortë të parisë. Në një anë janë rreshtuar bllokmenët, bllokzagarët dhe bllokqenët. Në anën tjetër janë zejtarët, tregtarët, kokëpalarët dhe katundarët, shqiptarët e tjerë si puna ime. Tashti në shtetin shqiptar, vetëm dy muaj e ca para zgjedhjeve, është kristalizuar një ndarje e frikshme shoqërore, një hendek që shihet krejt qartë midis parisë e shqiptarisë. Në një anë tjetër është paria e Tiranës, bandat e shumta të saj, krimi politik dhe ekonomik, zhurmuesit dhe mjetet e dizinformimit, njerëzit e vegjël dhe të frikësuar dhe vemjet e përjetshme që duan vetëm të hanë një kafshatë bukë e të vdesin të harruar. Këta kanë një objektiv, të hanë nga shteti dhe pasi të mbarojnë zgjedhjet, të hanë të gjallë shqiptarët dhe pasurinë e tyre. Masat që po marrin për t'u dukur se po mbështesin shtresa e grupe të caktuara, janë shumë të kalkuluara. Njerëzit nuk i besojnë dhe e dinë se menjëherë sa të mbarojnë zgjedhjet, këta do të thonë se kaq ishte loja, tani "paguani" dhe do të rrjepin të gjallë tregtarin e vogël, prodhuesin e vogël, biznesin, katundarin e shkretë që s'ka ku ikën, pronarët e apartamenteve, mbajtësit e llogarive financiare e me radhë. Këta po rrinë urtë se nuk duan sherr para zgjedhjeve, por sa të mbarojnë zgjedhjet e të formojnë qeverinë në shtator, do t'i turren popullit, sepse arka e shtetit është bosh, shteti është i falimentuar, nuk merr dot borxhe e nuk ka çka shet. Shteti duhet të hajë qytetarët e vet. Qytetarët e vet janë tregtarët, kokëpalarët dhe katundarët.

A është kjo qetësia para stuhisë?

Ka shumë që e dinë dhe e shprehin se kjo është vetëm qetësia para stuhisë. Asgjë nuk është më e qetë dhe më e paqetë, se syri i ciklonit. Ata që mendojnë se shqiptarët nuk e kuptojnë këtë gjë, e kanë gabim. Të gjithë e dinë çka po pritet të ndodhë.

Të gjithë e dinë se kjo është loja e parisë. Të gjithë e dinë se pas fushatës do të vijë dita që t'i rrjepin të gjallë. E prandaj zërat që janë përhapur se dyqanxhinjtë po vendosin t'i mbyllin dyqanet e të shkojnë në grevë të heshtur, se bizenset janë të paralizuara, se emigrantët e hidhëruar nuk do të bëjnë asgjë për të lehtësuar mundimin e familjeve të tyre, janë duke e shqetësuar shumë parinë. Ajo e ka frikë për vdekje këtë protestë të heshtur që bëhet me mbylljen e dyqaneve, me protestat e rinisë, me refuzimin e legalizmit të pronës, me kuptimine drejtë të asaj që po vjen.

Në përfundim

Përplasja po vjen, edhe pse tamtami i zhurmuesve të llapaqenërisë mediatike nuk po e lë të shihet. Ajo është përplasja e hapur midis parisë së Tiranës të bashkuar me paktin e 1 prillit 2013 dhe e gjithë shqiptarëve në anën tjetër të hendekut. Në njërën anë janë bllokmenët dhe bllokqenët të rresh-tuar në partitë politike, në anën tjetër janë zyrtarët, zejtarët, kokëpalarët dhe katundarët. Përplasja është bërë e pashman-gshme me humbjen e legjitimitetit të parisë së Tiranës dhe me rritjen e padurimit qytetar. Dikur loja me bllokmenë, bllokqenë, e bllokzagarë pranohej. Tashti të gjithë e dinë se paria janë thjesht bllokusarë që duan të jetojnë me dorën rrasur në xhepin e shqiptarëve, duke iu vënë thikën në fytyrë duke iu mbajtur gratë, motrat e fëmijët peng. Askush më shumë se zejtarët, kokëpalarët dhe katundarët nuk e ndien dhembjen që këta u kanë shkaktuar.

A do të ketë përplasje si gjithkund tjetër në të tilla raste? Këtë do ta shohim pas 23 qershorit. Edhe pse njerëzit nuk lëvizin, askush nuk po e din çka po bluajnë në mendje. Sepse si sundimtarët e bajraktarët, ashtu edhe zejtarët, kokëpalarët dhe katundarët, ndryshe flasin, ndryshe veprojnë e ndryshe mendojnë.

PRODHIMI I FERMERËVE

- Dy mendime mesnate -

1.

Ja, po shoh se shkoi Sali Berisha në Konventën e Fermerëve dhe tha shakanë e radhës. Po e sjell citimin nga fjalimi i tij të plotë.

“Përulem me nderimin më të madh para të gjithë fermerëve të Shqipërisë. Këtu u fol për punën e bërë gjatë këtyre viteve për zhvillimin rural. Ne jemi krenarë, vlerësojmë dhe frymëzohemi nga dashuria e pakufishme të fermerëve. Te fermerët puna nuk mbaron kurrë dhe ne u detyrohemi atyre shumë më tepër, se kaq sa kemi bërë. Fermeri është kujdestari i Zotit për tokën, rrudhat e tyre janë vulat e Zotit për punën e tyre të mrekullueshme dhe ne do të bëjmë gjithçka, për t’ua shpërblyer atë që ata bëjnë për shoqërinë. Do të bëjmë gjithçka që çdo fshat i Shqipërisë të ketë infrastrukturën më të nevojshme dhe të përshtatshme. Ne garantuam furnizimin me energji elektrike. Mandati i ardhshëm është mandati i përfundimit të infrastrukturës më moderne. Vrapi ynë nuk do të ndalet, derisa t’i garantojmë fshatit shkollë të njëjta me qytetin, ujë të rrjedhshëm dhe energji. I garantoj fermerët se përparësia e parë për Partinë Demokratike do të jetë kullimi në tokat me sera. Ju inkurajoj që të ecni sa më shumë drejt prodhimeve bio, që ato të bëhen të njohura në të gjithë Evropën. Ne qëndrojmë të vendosur që në katër vitet që vijnë të shumëfishojmë prodhimin e fermerëve shqiptarë”.

Kështu u shpreh Berisha.

Mendova që të përqendrohem në disa prej argumenteve kryesore të fjalimit, sepse po iu fliste pikërisht atyre që do të mbajnë shtetin nesër me taksa e me paga. Më tërhoqi shumë vëmendjen fjalia “Ne jemi krenarë, vlerësojmë dhe frymëzohemi nga dashuria e pakufishme e fermerëve”. Si ta kuptojmë këtë? Nga frymëzohet z. Berisha? Nga dashuria e fermerëve për z. Berisha? Nga dashuria e fermerëve për lirinë e demokracinë? Nga dashuria e fermerëve për njëri - tjetrin? Po ku është kjo dashuri? Ku me e ditë! Fermerët shqiptarë po vriten e priten, ka plasë vrasja divorci e therja, na mbyti krimi, e ky flet për dashuri.

Megjithatë, duke e njohur stilin pak abstrakt të zotnisë në fjalë, e lashë këtë punën e dashnisë së fermerëve. E dita se do të dalë me një shashkë mediatike që do t'i trulllosë studjuesit. Dhe nuk u zhgënjeva, kur me një frymë tha shumë gjëra që nuk i beson njeri, tri më mbetën në mendje prej tyre: inkurajimi i eksportit të prodhimeve bio në Evropë, se ky mandat do të ishte mandati i përfundimit të infrastrukturës moderne dhe e treta, ... “se përparësia e parë për Partinë Demokratike, do të jetë kullimi në tokat me sera”. Hajt ma, thashë, me kaq e mbylli këtë herë. Kur ja dha më e forta e të fortave ... “Ne qëndrojmë të vendosur që në katër vitet që vijnë të shumëfishojmë prodhimin e fermerëve shqiptarë”.

Pashë zotin, si shtohet prodhimi i fermerëve? Se ta kishte për prodhimin bujqësor do të thonte ose “prodhimin bujqësor”, ose “prodhimin që japin feramat”. Por ky po fliste për prodhimin e fermerëve si produkt. Eh, thashë me vete, ky po ka ndërmend me i kthye të gjithë qytetarët, që çka hoqën me u ba qytetarë të pasaportizuar, në fermerë. Sepse meqë shteti nuk prodhon gjë, ndoshta ka vendosur të prodhojë fermerë. Po sa shumëfish? Se tani kemi ende një million shqiptarë që jetojnë në fshat... Sa është kjo shumëfish? Trefish? Katërfish? Pesëfish? Domethënë paska vendosur me i nisë gjithë shqiptarët në fshatra me punue tokën. Lëre, thashë me vete, ia ka fu-

tur kot si e ka zakon. Po ndoshta e ka pasë në mend të shumëfishojmë brenda katër vjetëve atë që prodhojnë fermerët! Po si do ta bëjë këtë punë? Edhe pse ekonominë e kemi të dytën në botë, prodhimi bujqësor duhet të rritet me ritme mararamendëse. Duhet me marrë tokë e njerëz borxh në Azerbajxhan.

Më në fund e kuptova sa i cekët jam unë! Medet, që jetoj në Nju Jork e nuk i kuptoj shqiptarët! I vetmi shpjegim që mund të jepet e që të bind, është më poshtë.

Në katër vitet e ardhshme, ky po mendon me e ba të gjithë shtetin shqiptar si Lazaratin. Me farën e re të hashashit holandez, prodhimi rritet 270 %. Po të mbjellim edhe 10 % të tokës me hashash, po të marrim edhe këtë farën e re, me të vërtetë prodhimi do të rritet shumëfish. Atëherë do ia kalojmë Afganistanit në shkallën e ekonomisë botërore dhe nuk do të shkojmë me lypë para në Azerbajxhan. Aty ishte edhe fjala për prodhime bio, se a ka gjë më bio te ne, se hashashi? Jo. Eh, sa vonë e kuptova! Duhet me u mendue thellë, se ndryshe të duken fjalët e kryministrit të vendit marrina e mashtrime. Po me që ky nuk mundet me i thanë tanë gjanat si duhet, len shumë me nënkuptue. E këtë aftësi me e kuptue e kanë vetëm ata që jetojnë atje, se në fund, të gjithë të pranishmit, edhe ministri i Bujqësisë, edhe ai tjetri e duartrokitën me emocion të dallueshëm.

Sa gabim asht me folë për gjana që nuk i kupton!

PO ZVARRITEMI DREJT ZGJEDHJEVE

2.

Nuk duhet me u marrë me shuplakën që hengri Edi Rama në Prishtinë nga Albin Kurti, apo me lëvizjen e pritur e të parashikueshme të Sali Berishës që e hoqi anëtarin e KQZ të Metës, i cili për vete nuk foli fare e nuk i nxori bedelët e tij. Njëra kup-tohet se ishte një goditje shumë e rëndë për parinë e Tiranës, që tashmë nuk e ka më monopolin e ideve, të pushtetit e të

influcencës ndër shqiptarët. Por tjetra ishte një lëvizje e pritur dhe e kalkuluar mirë brenda lojës së vetë parisë. Reagimi i të huajve ishte i gabuar, sepse edhe për këtë punë ka menduar Ilir Rusmajli, që me nenin aq e kaq dhe me ligjin numër këtë e atë, e justifikon veprimin. Qeveritarët takohen me të huajt, pinë një kafe me të gjithë, i pyesin si i kanë punët, i japin një shpjegim, “shiko, kupto, garantoj, e kemi bisedue, aprovue, jemi pajtue, liria, demokracia, etj., or mik i dashur, etj., etj.”. Mandej iu tregojmë se edhe Meta e Rama janë dakord, po nuk mund të thonë gjë se del sheshit pazari. Mbështetësve iu themi ne “nuk pyesim për këta”. Në fund, nuk ua themi shqiptarëve të vërtetën. Edhe Vollfarth që ia ka ënda shumë birrën, nuk e thotë kurrë të vërtetën dhe e ruan sekretin. Kështu punojmë të gjithë për demokracinë shqiptare dhe “më rrove të rrova, brisku i berberit”, kalojmë te kriza e radhës, kur nuk ndodh vetë e shpikim, sepse prandaj e paguajmë kaq mirë Fevzon.

E megjithatë skenari duket i përgatitur me kohë dhe po zbatohet me qetësinë e pritshme. Pak zhurmë nga deputetë të dorës së dytë si Bizhga e të tjerë, sharje për ish - deputetët e PS që votuan heqjen e tij si Kaçi, Asllani dhe Gjovalini, si dhe nga dhuruesi i gjelave të detit katundarëve të uritur të Myzeqese, Dritan Prifti dhe një zëvendësim i qetë me një nga të kapurit e Saliut nga strajca e Mediut. Edi Rama nuk do të bëjë as gëk, as mëk, as Ilir Meta nuk do të bëjë gërr e as vërr. Ndoshta do të na vënë Skënder Gjinushin të thotë se u vodhën zgjedhjet...

Por kjo sjellje është guri i provës për paktin e parisë së Tiranës. Sepse po nuk pati demonstratë nesër, jo te Top Channel, por në Sheshin e Burrave, ose te Gropa e Politikanëve pas ish-Pallatit të Antikulturës, atëherë edhe më budallenjtë, pavarësisht se çka thotë Muçi Puçi dhe Fahri Balliu e dinë se “kjo ishte lojë”. Po nuk pati sherr publik, po dolën në luftë gjelat e parisë, kjo asht hile. Po u tërhoqën Edi Rama me Ilir Metën dhe po u morën me gjëra të tjera, atëherë është e qartë se ky është pazar. Kjo tregon se këta e dinë si do t'i zgjidhin punët e tyre. Po pati sherr dhe më e pakta, tashti që ka pu-

shuar shiu dhe mund të ngrihen çadrat, një grevë urie me paçe plendësi a këmbësh e me ujë Selite, atëherë do të shihet se opozita e ka seriozitetin.

Ama po na vuri Edi ndonjë nga batallët e tij para ekranit, nuk numërohet si protestë. E vetmja gjë që bën punë është ajo çanta e Spartak Brahos. Të gjithë mandej do të tkurren, sepse kanë frikë se diku e kanë emrin, zërin apo atë pisllekun e vogël. Por Spartaku është ulur te klubi poshtë pallatit, pi kafe, flet për futbollin e nuk merret më me politikë, sepse i është neveritur politika. Pra, nuk do të ketë çantë të Spartakut. E shumta ndonjë llapaqen mediatik do të hedhë dy shashka dhe një deputet me zë të prerë do të bëjë një deklaratë e kështu mbyllet loja.

Shkurt, më thotë mendja se këta janë mjeshtra, specialistë, siç thoshte ai i mjeri që u përdor nga të gjithë, Pjetër Arbnori. E vetmja gjë gabim ishte se Pjetri shihte çka kishte përpara. Kur kuptoi që Sala ishte mjeshtri, tamam kur nuk e bëri ambasador, vdiq për një ditë. Sala nuk ka kenë krejt i marrë, gjithkund e vinte Pjetrin përpara.

Por jam krejtësisht e plotësisht i bindun se nuk ka më sherr, sepse pakti i parisë po funksionon si duhet. Me ngadalë e me qetësi po zvarritemi drejt zgjedhjeve. Nuk ka rëndësi kush humb, sepse shqiptarët i humbin gjithmonë zgjedhjet, edhe kur e rrahin njëri - tjetrin. Por paria e Tiranës i ka fituar edhe një herë tjetër, sepse këta janë pak, por ia ruajnë shpinën njëri - tjetrit... Dhe mjerë ne kush na sundon!

NE NA KA NGORDHUR GOMARI ME KOHË DHE ...

Ambasadori i BE në Tiranë, Etoire Sekui, e cilësoi të paprueshëm faktin që në Shqipëri personat me aftësi të kufizuara nuk kanë mundësi punësimi dhe arsimimi. “Shqipëria duhet të miratojë ligje dhe akte nënligjore për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Në Shqipëri vazhdon të jetë problem arsimimi dhe respektimi i kuotave të punësimit, gjithashtu ligji për antidiskriminimin duhet të jetë më i fortë. Ne besojmë se e drejta nuk është ajo që jepet, por atë askush nuk duhet të ta marrë. Të gjitha vendet që aspirojnë BE duhet të respektojnë këto të drejta, përfshi këtu dhe Shqipërinë që duhet t’i respektojë këto standard.”, tha Sekui.

Një mendim jashtëzakonisht me vlerë, në kohën e duhur që i drejtohet një audience receptive ndaj këtyre mendimeve shumë bashkëkohore, lidhur me gjendjen e punësimit e të diskriminimeve në shoqërinë shqiptare. Në fakt ka vetëm një gabim. Duke qenë se kemi nja një million të papunë, do të ishte mirë të thuhet se duhet të respektohen kuotat e papunësim-it. Në lidhje me arsimimin e kemi fare të lehtë. Me një grant, donacion apo kredi të butë fare, të gjithë mund të bëhen doktorë profesorë në fushën që dëshërojnë. Sa për aktet ligjore e nënligjore, ato i përkthejmë nga rumanishtja dhe i botojmë në gazetën zyrtare. Po kush i lexon? Kryeministri mban fjalime e inaugurime, opozita shkruan kopjet te dora, ministrat kanë dhembje koke e gishtash nga telefonat, zyrtarët e niveleve më të ulta, dhembje koke nga vera e rakia që rrallë bëhet nga rrushi, njerëzit e tjerë nuk dinë as ku e kanë kokën nga hallet.

Ajo që z. Sekui ose nuk e sheh, ose nuk don ta thotë është

se në këtë drejtim ia kalojmë botës e jemi ku e ku më mirë e më lart se ata. Ne e kemi mbushur administratën me njerëz me aftësi të kufizuara, bile edhe me kaq; shumë të paaftë sa nuk ta merr mendja. Ja, kryeministër kemi Sali Berishën, që i shkojnë sytë si sahat muri, ministër Mbrojtjeje kemi Arben Imamin, ministër të Jashtëm Aldo Bumçin dhe ministre të Integriteteve të Gjithanshme, Majlinda Bregun. Tash kemi marrë me kuota edhe Greta Koçin që e kemi bërë drejtoreshë në Ministrinë e Brendshme. Nga opozita nuk janë gjërat më mirë, por mangësitë e këtyre janë të një natyre pak më specifike.

Nëse duhet të matemi me këtë punë, në lidhje me personat me aftësi të kufizuara, të pakufizuara apo krejt të paaftë, ne duhej të kishim marrë një miliardë euro në vit! Sepse ajo Spanja juaj e ka papunësinë 23 %, Greqia juaj e ka 40 %, etj. Kurse ne, me këta gjysma njerëzish hamë e pimë gjithë ditën, nuk punon njeri dhe i kemi lënë të gjithë të paaftët, të pakualifikuarit, injorantët, e hajnat të na sundojnë. A shkon te Stela? A ke qenë te TEG? Ç'ka bëjmë gjithë ditën ne? Kujton se punojmë? Po ne jemi parajsë e njerëzve me aftësi të kufizuara fizike, mendore dhe emocionale. Shqipëria një euro për të tjerët e ju po ju lutemi të na merrni falas e nuk doni. Prandaj, duke qenë se i përmbushim standartet, na futni në Evropë dhe të jeni të bindur që do ju bëjmë superfuqi energjitike, do të shumëfishojmë prodhimin bujqësor, do të keni bujqësi dixhitale, internet në motele, ekspozita pikturë në pube, e me radhë, se edhe opozita ka një program me 1000 faqe.

Mandej sa shqiptarë me aftësi të kufizuara ke marrë në punë në ambasadë? Ku me e ditë.

Hajt ma, një mendim ishte ky, sa me kalue kohën. Sepse ne na ka ngordhur gomari me kohë e nuk dihet nga na vijnë këto mizat. Ndoshta vijnë nga gomari që iu ka ngordhur edhe të tjerëve, grekëve, italianëve, spanjollëve e me radhë...

ZGJEDHJET DHE MAKTHET E SALI BERISHËS

Në këtë pikë duket se pakti i parisë së Tiranës i ka dhënë Sali Berishës dhe prijatarëve të tjerë sigurinë për të cilën ata kanë qaq shumë nevojë. Ëndrra e parisë duket sikur po realizohet, por secili nga prijatarët ka ankthet e makthet e veta. Në një shkrim tjetër i kam trajtuar disa nga këto ankthe, por tashti duhet të ndalemi pak më seriozisht e më në thellësi te shtatë makthet e Sali Berishës. Sali Berisha përballet me një rebus delikat dhe kompleks të mbushur me të panjohura. Ai është mjeshër i lojës politike, por loja ka shumë lojtarë, më shumë të panjohura dhe mbi të gjitha, në këtë pikë ai nuk ka asnjë kartë të fshehtë që ta nxjerrë nga mënga. Karta më e fortë që ka Saliu është të bëjë opozitën besnike të pjesës tjetër të parisë. Përpjekja e parë është të mos shkelë në dërrasa të tjera të kalbura me ndërkombëtarët. Të tjerat janë dytësore. Sepse të gjitha motivojnë sjelljen e tij tani dhe do ta motivojnë më shumë në të ardhmen. Ankthet e tij për të ardhmen janë të lidhur me faktorët e mëposhtëm..

Makthi i ndërkombëtarëve

Si edhe pjesëtarët e tjerë të parisë, Sali Berisha është stërvitur të bëjë luanin me të dobëtit, konen apo këlyshin me të fortët. Këtë teknikë ka ndjekur sistematikisht me ndërkombëtarët. Ka qenë shërbëtor i bindur në vitin 1990 - 1994, mandej bajraktar deri në vitin 1997, mandej shërbëtor i bindur deri në përkujtimin e 100 vjetorit të shtetit. Tash po silllet si katundar i pafytyrë duke ndjekur parimin, “kalova lumin, të vjedhi kalin,” domethënë po iu thotë ndërkombëtarëve me-rrni çka doni, por unë nuk pyes shumë për ju.

Nga një anë ndërkombëtarët janë lodhur me Saliun që ka krijuar problem të rënda. Edhe pse tha se nuk është nacionalist, festimet e 100 vjetorit të pavarësisë i dolën nga dora dhe nuk ishte problem i “tortës me legena”, por problem i shpërthimit të një ndjenje kombëtarizmi që mendohej se nuk ekzistonte kund, sepse kaq mirë e kishte fshehur paria e Tiranës. Nga ana tjetër, edhe lojës ideologjike të Saliut e të parisë i ka ardhur fundi, ngaqë dihet se nuk do të ketë integrim në Evropë dhe po ashtu dihet që Evropa nuk e don as Saliun, as shqiptarët. Mandej, të huajt dinë shumë gjëra. Dinë për të, për të bijën, për të birin, për pislleqet, për shërbimet e vyeshme që ai i ka bërë. Por varet si paraqiten në publik, se edhe këto gjëra janë thika me dy presa dhe askush nuk e di këtë punë më mirë se Sali Berisha që në një anë është deklaruar “i bekuar nga Papa”, “vëlla me turqit”, “vëlla me Izraelin”, “armik për vdekje me Iranin”, “mik i madh i grekëve”, “vëlla me kinezët” etj.

Prapë loja është e gjatë, ai ka shumë të panjohura parasysh dhe më shumë të panjohura që nuk din si me i interpretue. Atij nuk i interesojnë më të huajt, sepse e din që për sa kohë e mbështesin të vetët, të huajt nuk do ta ngasin. Por thellë - thellë e bren dyshimi se të huajt kanë edhe ca karta që mund t’i luajnë në një mënyrë që ai nuk e kontrollon dot. Ata që dinë nuk po lëvizin, ata që munden po lëvizin me kujdes dhe Saliu e din se në këtë botë ka edhe zjarr pa tym ku digjesh pa ndjerë e pa kuptuar. Se këta janë mjeshtra për të zgjidhur problemet e shteteve edhe më të komplikuar e jo më të shtetit të Saliut.

Makthi i Trustit të Gështenjave

Sali Berisha është 99 - sh dhe më i zgjuari i politikanëve shqiptarë. Po a i kontrollon dot Trustin e Gështenjave të Tro-pojës dhe klanet lokale mafioze? Është e vërtetë që ka nisur t’iu japë vizat e t’i mbledhë paratë, një metodë që do të thotë “ikni sa më shpejt” që këtu. Saliu ka vënë re se shumë nuk po shkulen nga vendi, sepse nuk ikin dot, edhe sikur t’iu japë nga

dy a tre pasaporta të reja biometrike. Problemi nuk është se kanë frikë palën tjetër. Problemi është se nuk kanë frikë as Saliun, as kënd, se duan të fitojnë dhe se kanë qenë aleatë të Saliut, por jo vegla të tij. Por këta afaristë kanë qenë me Saliun, sa kohë Saliu ka qenë me ta. Këta presin të marrin paratë që të japin diçka për fushatë. Ndryshe të gjithë kanë nisur të bërtasin “s’kam!”. Dhe jo më kot shumica i kanë vëllezërit, kunetët, partnerët e lidhjet e shuëfishta edhe me palën tjetër të parisë. Sepse në fund të fundit, “tanët jemi”. Saliu e di se ata klientë që shiten si militantë, shpesh janë thjesht diversantë. E vetmja rrugë që kanë për të marrë paratë që ua ka borxh shteti, ose për të shmangur taksat, ose për të mbrojtur veten nga punët e pista, është të bëjnë marrëveshje me palën tjetër. Shembulli më i mirë është i Bekuari Apostolik, Fahri Balliu që ka disa kompani në partneritet me socialistët, deri me Edi Ramën. Sepse paria e Tiranës janë të kapur e të ngatërruar keq me njëri - tjetrin dhe i shiten lirshëm prurësit më të parë, të gjithë japin në të gjitha palët dhe Saliu e din, por s’ka ç’ka me ba.

Makthi i militantëve

Militantët e PD janë ajo masë njerëzish që besonin në një shans të ri në vitin 1990. Një turmë shumë komplekse, ku ka nga të gjithë llojet e njerëzve. Tashmë shumica e tyre e kanë lidhur jetën me PD e me Sali Berishën. Dhe Sali Berisha i ka lidhur fort pas vetes, aq sa i përdor si vegla të tij. I ka përdorur kulturalisht, sepse këta shkojnë pas parimit “kam ngrënë bukën e Saliut” edhe pse kanë qenë të punësuar në shtet. I ka manipuluar në ndjenja, sepse këta e urrejnë PS dhe nuk durojnë asgjë që vjen erë nga sistemi i mëparshëm. Iu ka krijuar një realitet fantazëm përmes tv “Klan”, gazetës “55” dhe “RD”. I ushqen shoqërisht me thashetheme kafenesh, me batuta, barcoleta. Shpesh ua thotë të vërtetën, por ata e marrin si kopi-llek të Saliut, “njish është, ua futi keq fare”.

Militantët janë të punësuar në shtet, ose kanë bërë ndonjë

biznes të vogël me licenca të përkohshme. Po kanë familje, fëmijë dhe këta që po vijnë janë të uritur. E provuan e ndenjën tetë vjet në opozitë një herë militantët e Saliut dhe o donin të shkonin aty ku kishin qenë në punë, o s'ka. Ngordhën për bukë. Tani vodhën ca dhe mendojnë se kanë vënë dhjamë, por këta që po vijnë dinë të nxjerrin dhjamë edhe nga pleshti. Këta nuk duan të rrinë më në opozitë. Saliu nuk të jep më bukë. Sepse militantët janë besnikë, po deri në një pikë ama. Saliu nuk i mban dot me premtime, sepse e panë që nuk doli gjë nga ai. Tani nuk janë më aq militantë edhe ata që janë mjaft injorantë. Stomaku don bukë, jo premtime.

Makthi i të përndjekurve

Kjo është një shtresë që u keqpërdor me vullnetin e saj të lirë nga Saliu. Deri tani e ka pas fatin politik të lidhur me të. Tani do të kërkojë të ndahet, sipas teknikës “ne e dinim kush ishte, por na duhej e na mashtroi”. Saliu i mbajti me thërrime, por i përdoroi deri në atë nivel sa këta nuk kanë fytyrë të dalin më në publik. Për çfarë përndjekje mund të flasin këta? Për çfarë vlerash? Kush pyet për burgun dhe internimin e tyre, kur ne kemi nga njëzetë e ca vite në mërgim, na janë shuar familjet e këta nuk kanë lëvizur as gishtin të mbrojnë vlerat për të cilat ishin deklaruar të persekutuar? Kush prej tyre e mbrojti lirinë e demokracinë, të drejtat e shqiptarëve e kombin?

Shumica e ish të persekutuarve ranë në kurthin e mjeshtrave kontrollues dhe janë të diskredituar, sepse e treguan qartë që nuk kishin as vlera as mendësi, por ishin thjesht vegla politike. Saliu ka kuptuar se këta nuk i duhen më si shtresë, prandaj i ka futur ne sherr dhe kontrollon vetëm ata që kanë pak influencë. Ndarja me Saliun do të jetë një përpjekje për të gjetur dinjitetin. Sepse bijtë e bijat e tyre e kanë një ide idjote kush ka qenë familja e tyre dhe do të kërkojnë nderim e respekt. E këtë do ta kërkojnë duke u ndarë nga Saliu.

Makthi i katundarëve fisnikë

Saliu i ka mbajtur katundarët me shpresë. E ka shfrytëzuar me kujdes mendësinë e tyre. I ka lidhur me fjalë, me interesa si legalizimi, me bukën e gojës si punësimi, me manipulim si kundërvënie nga të tjerë dhe me njëmijë fije të menduara mirë. Por ka dy gjëra për të cilat katundari shqiptar, dhe unë jam katundar i vjetër, nuk të fal. Këto janë nderi e prona. Saliu ka kërkuar t'ua marrë nderin njerëzve. Ka pasur shumë që kanë heshtur, por nuk e kanë falur. Te prona i ka mashtruar haptazi, sepse iu ka dhënë ca legalizime gjysmake që mund të kthehen kundra me një hetim të shpejtë. Katundarët e dinë mirë se i ka mbajtur varur dhe ua ka hedhur keq. Më në fund, katundarët janë praktikë; po nuk pati çka me ofrue Saliu, kush po pyet për të? Pse duhet me dalë në miting për të? Në fund të fundit, shteti dhe pushteti është në dorën e tjerakujt dhe katundari fisnik e ka frikë shumë shtetin, sidomos kur është në duar të atyre që dinë si ta përdorin makinën e shtetit në interes ë tyre.

Makthi i PD

Saliu e din se PD është e mbushur me Haxhi Qamilë, sepse për atë detyrë i ka zgjedhur, përdoruar, manipuluar dhe degjeneruar. Se mos pyet ai deputeti me kobure "plastike" për Saliun! Për Saliun, kur të vijë puna nuk pyet Sokol Olldashi, sepse duhet të japë llogari atje ku duhet, tek ata që e kanë vënë e që i haxhojnë paratën e fushatën e tij. Dhe nuk i harxhojnë që të humbë Olldashi, sepse sa për i persekutuar, po të mos kishte hyrë gjyshi në burg, do të ishte akoma me partinë e Bllokut e në ballë të saj, se shumë kushërinj i ka nga ajo anë qysh nga viti 1942. Nëse Saliu nuk i vë deputetë sërish ata që janë shumë si këta e zgjedhin veten, ia japin votat dikujt tjetër dhe me këto banda që kanë, kush guxon t'iu dalë përpara! Saliu don të humbë, por me dinjitet, domethënë të ketë një opozitë

të fortë, të mbajë një tufë njerëzish me rrogë, të ketë veton e pushtetit. Se kështu ishte marrëveshja në 2005 dhe ai e respekttoi. Punë tjetër se u ngatërrua Ilir Meta me Fatos Nanon dhe Edi Ramën në një ménage a triosocialiste të spikatur ku ia futën të gjithë njëri - tjetrit dhe fitimtar doli vetëm Saliu. Këta zotërinjtë gangsterë ia fitojnë zgjedhjet me zori si në vitin 1996, se nuk janë zare, por “koca”. Janë burra që kanë mbrapa edhe ca vrasës që flenë me sy hapur e me gishtin në këmbëz, e që edhe makaronat i hanë me thikë pa i prerë (këtë e kanë mësuar në burg në Itali e në Greqi, po nejshe).

Saliu nuk e don këtë, por nuk ka zgjidhje. Kë do të verë kandidat në Tropojë? Po në Peqin? Po në Vlorë? Në Laç? Në Lazarat? Lista është e gjatë. Aty nuk vë dot Aldo Bumçin e Keltis Krujën, Edit Harxhin dhe Elvana Hanën. Aty të vjen një “koqe plumbi” nga s’e pret. Dhe pastaj ka Arben Imamin, Ed Selamin, Genc Pollon, Tritan Shehun, etj. Këta janë përdorur si lecka, por edhe lecka shkyhet duke u fërkuar për dyshemeje. Pragmatizmi i tepruar I ka vënë këta te semafori i Saliut, por po u fikën dritat, nuk dihet se çka ndodh, sepse të gjithë kanë shumë ustallarë dhe shumë urrejtje për çka janë detyruar të bëjnë.

Nga ana tjetër janë vendorët dhe këtu përfshihen të gjithë kategoritë e njerëzve; që nga pjesëtarët e klanit të Trustit të Gështenjave, te berishistët e flaktë, te ata që ai i ka bërë të lyejnë duart me gjak, te ata që i ka bërë të vjedhin për të, të poshtërojnë të tjerët për të, te kriminelët e lindur, te militantët PD - istë që nuk njohin tjetër veç Saliut, te klientët e biznesit, të frikësuarit e deri te masa e madhe e atyre që ende duan të luftojnë komunizmin. Shkërmoqja e PD është një ankth tjetër shumë shqetësues.

Ankthi i Familjes

Ankthi kryesor është familja. Me standartet katundare, familja e Saliut dhe farefisi janë ndër dyert e para të vendit. Por djali është karabush, vajza është e zgjuar, por jo për lojtare kryesore. Rrethi i kushërinjve janë të djallëzuar, por pa klasin

e nevojshëm politik, disa edhe të pakënaqur, krushqitë jo të besueshme. Ky është edhe ankthi kryesor i Saliut. Ai e din se peri këputet ku është më i hollë dhe kur të vijë dita, që ai e din se do të vijë, asgja që ka ndodhë nuk do të ketë më vlerë. Nuk dua t'i diskutoj këto gjëra më gjatë, por nuk don shumë mend me kuptue se armiqtë e tij janë duke pritur rastin. Paria është një tufë hienash, që kur i kap uria hanë edhe njerëzit e vet.

Në vend të përfundimit

Sali Berisha ka qenë njeriu i duhur në vitin 1990, as kam pasur ndonjëherë e as kam ndonjë dyshim për këtë gjë. Atëherë ai duhej për të shpëtuar shqiptarët nga vetvetja dhe nga lufta civile dhe ne të tjerët duheshim sakrifikuar. Por taktika e tij është të mbështetet në të vetët dhe të bëhet problem që nuk duhet trazuar. Si thoshte Haxhi Qamili, "Sa të kem Sharrën e Shijakun, nuk pyes për Berlinin". Problemi është se Saliu duhet të mbajë bashkë një turmë që shkon në drejtime krejt të kundërta me njëri - tjetrin. Kjo kërkon shumë zotësi dhe kohë.

Tashmë ai nuk ka rrugë tjetër, veçse të mbajë shqiptarët në luftë civile e t'i verë të përplasen me njëri - tjetrin. Dhe në politikë njerëzit nuk motivohen aq nga dashuria për të tjerët, sesa nga frika për gjërat që i kanë të dashura e të shtrenjta. Të gjithë makthet e tjera të Saliut janë të lidhur me familjen. Por ai e din mirë se tashmë edhe vetë është një makth për shumë prej shqiptarëve. Si një pjesë e parisë, si një nga udhëheqësit e saj, anipse i përdorur dhe i abuzuar keq nga pala tjetër, Saliu do të mundohet të hedhë vallen e tij deri në fund, e si ka thanë Gjergj Mullaga, "fundi daltë hajër," për shqiptarët.

ANKTHET E EDI RAMËS

Pakti i parisë së Tiranës i garanton Edi Ramës mundësinë të bëhet kryeministër, por vetëm mundësinë ama. Shumëka do të varet nga konjunkturaturat dhe nga numrat që do të dalin ditën e zgjedhjeve. Por zgjedhjet janë shumë afër e politika është e gjatë, me hile të shumta dhe zullum të hatashëm. Tirana është një kënetë gjigande dhe kushdo që del mbi nivelin e llumit e din se mund të zhytet shumë shpejt.

Pra, pavarësisht dukjeve dhe sigurisë sipërfaqësore, Edi Rama ka shumë probleme të cilat nuk mundet me i zgjidhë edhe po të dojë, edhe po të mundohet gjithë jetën. Ai është i detyruar të jetojë me këto makthe dhe herët ose vonë, do të përjetojë krizën e tij të thellë, pikërisht prej kombinimit të këtyre problemeve që vetëm do të vijnë duke u përkeqësuar. Sepse natyra e lojës është e tillë që këto probleme do ta ndjekin si gjatë këtij procesi zgjedhor, ashtu edhe më pas. Ndaj ia vlen të analizojmë makthet politike të Edi Ramës. Natyrisht prova është koha, por si e thashë më lart, koha nuk punon për Edi Ramën. Koha në shtetin shqiptar nuk punon as për vete.

PS - partia e bandave dhe klaneve

Partia Socialiste është partia e shumë grupimeve, klaneve e bandave që e bëjnë të duket si një kartel gjigand mafioz e kriminal. Dikur PS ka qenë një ushtri cilësore ideologjike, me udhëheqësi, me partishmëri, e me bindje ndaj strukturave hierarkike dhe të centralizuara. Sot, është një hordhi bandash kriminale, prapë cilësore si banda kriminale mafioze, por

pa ideologji, pa partishmëri, e mbytur nga arrivizmi dhe me struktura hierarkike të dyshimta.

Por nëse ideologjia dhe udhëheqësia mund të konsolidohen e të qartësohen me kohë e me punë, ajo që është thyer e nuk ngjitet më, është autoriteti dhe hierarkia e brendshme e nivelit të një reparti ushtarak. Në PS ka klane transversale të kasketave të vjetra, struktura solide të sigurimit e të shërbi-meve të tjera dhe nyjzime më të lirshme të të rinjve, rrjedhur nga shtresa të nivelit të mesëm dhe intelektual të sistemit të mëparshëm, të edukuar mjaft mirë, që shpresojnë të bëhen diskutuesi si në parti, ashtu edhe në shoqëri.

E megjithatë, në zemër të kësaj strukture qëndron bërthama e strukturave klanore e familjare, me një kulturë jeniçere - katundare që u konsoliduan në sistemin e mëparshëm, u ruajtën dhe u kultivuan edhe më shumë në sistemin që u vendos në vitin 1990. Armiqësia e hapur dhe e shtuar e shtresave të tjera dhe e masave të gjëra të popullit, i detyroi këto klane që të zhdërvjelltësohen, të hedhin lëkurën e ujkut e të përdorin të gjitha teknikat e hienës e të gjarpërit për të mbijetuar, për të arritur objektivat e tyre të pasurimit në tranzicion.

Këta ndenjen 45 vjet në pushtet dhe e bënë popullin të hajë bar. Kush mund të besojë se kanë ndryshuar dhe se i ka kapur ndonjë dashuri e madhe për shqiptarët? Sepse motivimi për hyrjen në politikë të shumë prej tyre, nuk është as shërbimi publik, as dashuria për kombin, por për emrin e familjes. Këta jetojnë ende me hierarkitë e vitit 1990, por këtë herë brenda klaneve e strukturave lokaliste e me baza të tjera. Komplekse, siç janë ato hierarki, vazhdojnë të sillen sikur shqiptarët e kanë me borxh sundimin e shfrytëzimin prej tyre.

Makthi i Edi Ramës është se me kë nga këta do ta bëjë qeverinë, kë do të verë deputet, kush do të mbajë, kë dhe kujt do t'i detyrohet shumë? Sepse këta janë ujq dhe e ndiejnë erën e gjakut nga larg. Janë të uritur dhe e ndiejnë nga shumë larg që Edi Rama nuk është fort i sinqertë me ta. Edi Rama ka dhënë prova se nuk ka besnikëri politike, ai nuk ka ruajtur

miqësi politike me karakter. Po ashtu, në sytë e asaj shtrese, Edi Rama nuk është njeriu i tyre, nuk është ai që duhet edhe për shkak të së shkuarës së tij. Ata mund ta përdorjnë, mund ta tolerojnë, por nuk mund ta pranojnë edhe pse është nga një klan me peshë. Për shumë vetë, Edi Rama mbetet një piktor jokonformist, djalë i shkathët e çapraz, kokëshkretë e nevrrik, por ai nuk ka mendjen e policit e të zyrtarit të shtetit që e lexon shefin e vet nga mënyra se si rrin në karrike dhe që i del përpara lojës politike si paraardhësi i tij.

Këta që janë stërvitur të funksionojnë në sisteme të tilla paralele e me baza të ndryshme, nuk e pranojnë lehtë Edi Ramën. Prandaj brenda partisë janë vënë në rresht një grup aspirantësh si Ben Blushi, por ka edhe të tjerë që presin radhën dhe dështimin e tij, anipse me modesti e në heshtje. Për-pjekjet e tij për të rekrutuar ca zero politike qysh nga koha kur ishte kryetar Bashkie i Tiranës dhe për t'i vënë pas vetes si "1-sh", kanë krijuar shumë shqetësime të thella si për strukturën, ashtu edhe për atë vetë. Kasketat po dobësohen, struktura është gradualisht e kriminalizuar, klanet janë konsoliduar dhe tashmë janë në lojë për interesat e tyre. Të gjithë e shohin veten si më të zotin se Edi Rama dhe të gjithë luajnë lojën e tyre. Me kristalizimin e listave, të fushatës, të kontributeve, të premtive etj., Edi Rama përballet me mundësinë e humbjes së mbështetjes së ndjeshme në këto struktura. Atë e mban gjallë vetëm sukcesi, po një dështim e rrëzon, sepse këta janë gati duke pritur radhën. Morën frymë kur vdiq Enver Hoxha, u çliruan kur iku Ramiz Alia, morën forcë kur iku Fatos Nano dhe Edin nuk e numërojnë as si të barabartë. Dhe si copat e mozaikut, klanet e tyre dinë të lidhin e të zgjidhin aleancat me stilin e njohur katundar të Tepelenës e të Lunxhërisë që Edi Rama e kupton, por nuk e kontrollon dot si duhet.

Një element tjetër i ndjeshëm është mungesa e ideologjisë. PS është parti e parasë dhe jo parti e vlerave. Vlerat e PS duhej të ishin kolektivistë, të mbrojtje të të varfërve, të mjerëve, të pazotëve, të atyre që nuk kanë, nuk dinë e nuk munden, por

kanë të drejtën të jetojnë si gjith të tjerët. PS është parti e milionerëve dhe tashti nën shembullin e një karagjozi intelektual si Servet Pellumbi mbrojnë globalizmin dhe kapitalizmin. Por brezi i ri i edukuar jashtë e brenda, e kupton se ka një dallueshmëri të madhe ndërmjet ideologjisë që duhej të kishte PS e të lllomotitjeve të udhëheqësve të saj, përfshirë këtu edhe anarkistin Edi Rama. Sot PS është një parti hajnash që nuk e luan rolin e saj në sistem. Në një drejtim Saliu ka të drejtë që është partia e bijve, sepse ka vazhduar struktura, por jo ideologjia. E pra, nuk ka asgjë të keqe për të qenë mbështetës i një ideologjie kolektivist. Edi Rama nuk është as kolektivist, as kombëtarist, as marksist, por thjesht nihilist e anarkist. Ky është një problem i madh, sepse shteti funksionon në bazë të disa parimeve të caktuara dhe roli e detyra e tij, po qe se bëhet kryeministër, është që t'i japë këtë drejtim shtetit dhe ekonomisë dhe të përçojë këto vlera në shoqëri. Ky është një makth jo i vogël, sepse shteti nuk është Bashkia e Tiranës dhe nuk bëhen punët duke marrë kazmën e duke shembur ndërtesat buzë Lanës. Kryeministri është në një nivel tjetër dhe ky është një shqetësim jo i vogël për të.

Mafia e Tiranës dhe Mafia e Partisë

Edi Rama ka një problem të madh të trashëguar një nga Tirana dhe një nga partia që drejton. Ky problem është lidhja në kërthizë e strukturës ekonomike të klaneve të PS me krimin e organizuar. Edi mund të dijë, por nuk ka se si të kënaqë mafian e Tiranës dhe mafiet e partisë. Këtu ka karteles kriminale sa të duash e nga të gjithë llojet. Por të gjithë janë të lidhur me monopole, me paratë, me tenderat etj. Të gjithë duan të kontrollojnë një pjesë të ekonomisë. Tirana është qendra e monopoleve, dora e parë e fitimit dhe e shpërndarjes e përpunimit. Këtu janë përqëndruar si mendjet e klaneve të parisë, ashtu edhe qendrat e tyre nevralgjike. Këtu janë sekserët e të gjithë llojeve e markave.

Dhe lidhjet e Edi Ramës me të gjithë këto klane shkojnë shumë thellë. Ja për shembull, lidhjen e tij me Gërdëcin, me Mihal Delijorgjin e të tjerët! Të gjithë këta janë në tavë dhe të gjithë presin diçka. Bile, duke u bazuar në dokumentet e botuara, del se Rama dhe Fahri Balliu, Mediu dhe i biri i Saliut kanë qenë duke ngrënë në një tavë. Mjafton të shihen pallatet, si të “15 katëshi”, apo shitblerja dorë më dorë e “Tajvanit”. Premtimet që janë dhënë në telefona, në tavolina e me sekserë duhen mbajtur, sepse mafia jonë është shumë e kualifikuar profesionalisht. Këta të vrasin ditën për diell, pasi t’i kesh paguash benzinën e motorit dhe kafënë vrasësit. Nëse e shkuara është një tregues i së ardhshmes, lista e premtimeve të tilla duhet të jetë shumë, shumë e gjatë.

Ilir Meta

Ky ka hyrë në lojë për vete jo për Edi Ramën. Ky e mbajti dhe e përdori një kohë. Ky ka interesa të vetat. Tashti po e bën të heqë dorë nga një anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nesër do t’i marrë një të tretën e vendeve të punës në shtet. Ilir Meta është njeri që din të marrë vendime dhe që nuk e respekton Edi Ramën. PS u nda midis tij dhe Fatos Nanos, por do ta ketë të lehtë të mbështillet rrotull tij, më lehtë se rrotull Edi Ramës. Për Edi Ramën, Ilir Meta është edhe zgjidhja afatshkurtër, edhe problemi afatgjatë. Ka shumë të panjohura, por Ilir Meta është treguar mjeshtër në të shkuarën.

Militantët dhe loja në nivelin lokal

Ka ende ca njerëz që e nderojnë dhe e besojnë strukturën. Militantizmi vjen ose nga injoranca, ose nga bindja e thellë. PS nuk ka vlera ideologjike, është thjesht një strukturë për pushtetin. Këtu hyjnë strukturat e organizuara klanore e familjare që janë konsoliduar shumë gjatë këtyre viteve. Kështu si u pa edhe me lëvizjet e fundit, klanet lokale nuk janë të përgatitura

t'i shërbejnë Tiranës. Ka qenë më e lehtë për Edi Ramën të hiqte Asllan Dogjanin e Gjovalin Kadelin. Por a do të mundë të heqë edhe Erion Braçen, edhe Pandeli Majkon? Për të mos shkuar te banditët e rrugës si Taulant Balla dhe Gazmir Bizhga. Klanet lokale janë shumë të konsoliduara dhe Edi Rama e din se nuk mund të luajë lojën e Nanos që iku, por mendoi se e kishte grupin parlamentar në dorë. Grupi e shiti dhe nuk i hapi as telefonin dy vjet rresh. U deshën 500 000 euro për një votë që të zgjidhej presidenti. Edi Rama nuk don të bjerë në atë situatë, por ka pak gjasa që listat të jenë ashtu si i don ai. Sepse këtu po flasim për banda, për horra konviktorë e për hetues drogaxhinj. Këta të numërojnë paratë që ke në xhep, jo më të të lejojnë të tallesh me ta.

Një element kryesor në lojën me qytetarët e me fshatin është edhe lidhja e tij me katundarët fisnikë. Këta e shohin Edi Ramën si pjesën e tyre të huaj. Nuk identifikohen me të dhe ai nuk identifikohet me ta. Nuk i ka dashur kurrë katundarët, nuk i njeh. Dhe katundari e ndjen me erë kur dikush don me ia futë dhe këtij nuk ia kanë besën. Katundarët nuk shohin asnjë të mirë nga ky koalicion. Ata e dinë se do t'i mbysë me taksa e detyrime dhe ky është një makth tjetër për Ramën.

Ndërkombëtarët

Këta janë tejet të shqetësuar me këtë aleancë. Në dukje sjell qetësimin e stabilizimin e gjendjes, sepse këta janë mjeshtër e specialistë, po me kë do të merren vesh? Me Gramoz Ruçin që nuk i dhanë vizën për në SHBA? Me Fidelin apo me dikë tjetër që bredh me kobure e Uzi në "Jeep"? Edi Rama nuk duket bindës për të huajt. Akuzat e deridokohëshme nuk janë harruar. Ashtu si nuk është harruar 21 janari, Gërdeci e shumë gjëra të tjera që të huajt i dinë dhe paraqitjet për konsum publik nuk i mbulojnë dot. Po ashtu edhe në politikën e jashtme, influenca greke dhe jo shqiptare janë shumë faktorë përkeqësues në këtë qëndrim. Klanet brenda PS janë shumë të lidhura me

grekët. Edhe pse Orta e Jeniçerëve nuk do të pranojë rritjen e ndikimit grek, këta të tjerët janë shumë afër. Edi Rama vetë iu detyrohet shumë dhe grekët e kanë kujtesën e gjatë, dinë të kërkojnë haraçin në kohën e duhur.

Influenca ndër shqiptarët

Edi Rama është tërësisht i papranueshëm si lider i shqiptarëve të trojeve kombëtare. Ai nuk mund të luajë të njëjtin rol që luajti Berisha, i cili megjithëse ishte krejtësisht i diskredituar, prapë e shiste veten për ndërmjetës. Në shumë raste dhe në momente kritike, Edvin Rama ka treguar mungesë respekti për ndjenjat kombëtare të shqiptarëve. Në këtë konteskt, disa kohë më parë pata thënë se qendra e kombit shqiptar është në Kosovë. Ajo që ndodhi në Prishtinë gjatë vizitës së fundit të zotërisë në fjalë, tregoi se unë kisha të drejtë. Albin Kurti, jo vetëm refuzoi të takohej me Edi Ramën, por filloi t'i jepte mend dhe t'i tregonte se ku është gabim Edi Rama. Duke ia rreshtuar me kujdes, një e nga një pikat kryesore, Albin Kurti i tha Edi Ramës të kthejë majat nga thembrat. Por mënyra si u adresuan problemet, tregojnë se fenomeni është më kompleks e më i thellë. E njëjta situatë pritet të përsëritet në Maqedoni.

Në lidhje me influencën e tij ndër shqiptarët, ia vlen të thuhet se një rol të veçantë do të luajë aleanca e tij me grekët e PASOK apo me të tjerë, sido që të jetë e ndërtuar, e hapur ose e fshehur. Për këtë kam folur më lart.

Më në fund, por jo më e fundit, deklaratat e hapura kundër nacionalizmit që ai mendon se e ndihmojnë që të fitojë pikë me ndërkombëtarët, ia kanë hequr petët lakrorit. Rama mund të bëhet kryeministër, por askush në trojet shqiptare nuk do të turret për të ndjekur atë si udhëheqës politik apo shpirtëror të shqiptarëve, një rol kyç për çdo kryeministër që ka pasur shteti shqiptar pas vitit 1912.

Shteti i falimentuar

Më në fund makthi kryesor i Edi Ramës është shteti i falimentuar. Ai mund të vijë në krye të shtetit, por shteti është thjesht e qartë, pa asnjë pikë dyshimi, i korruptuar, i degjeneruar, me një administratë të kriminalizuar dhe i falimentuar. Mbështetësit e tij e të Metës duan të hanë, se kanë ndenjur kaq gjatë në opozitë dhe kanë pritur me durim. E prandaj do të plasë sherri, sepse këta nuk ngopen me thërmija si doganierë. Të gjithë këta duan të bëhen milionerë në gjashtë muaj. Dhe ky që po ikën e ka lënë shtetin në pikë të hallit. Ky është një makth që e shqetëson shumë Edi Ramën. Në mos e shqetësoftë sot, do të fillojë të bëhet shumë i prekshëm nesër.

Përfundimi

Në përfundim, do të thosha se duket që Edi Rama po e mbërrin qëllimin e vet të bëhet kryeministër, por çmimi që do të paguajë do të jetë i frikshëm. Këto probleme do t'ia bëjnë jetën të zezë dhe të vështirë, në mos të pamundur. Sepse peshqit në kenetën siç është politika e Tiranës, nuk shohin më larg se dita e nesërme. Mendimi se po hanë një peshk tjetër, i çon direkt në gojën e peshkaqenit. Si edhe e përshkrova më lart, kënetat politike e Tiranës është e mbushur me rreziqe dhe egërsira të të gjitha llojeve dhe Edi Rama e din se nuk e ha peshku i madh të voglin, por peshku më i shpejtë e më i zgjuar, ai peshk që mban gojën hapur e pret të vijë preja e radhës...

SE NE NA KA NGORDHUR GOMARI DHE...

Kryetarja e Kuvendit me gradën “Doktor në fushën qytetare të drejtësisë” iu tha deputetëve të Partisë Socialiste, një parti që nuk ka as ideologji e as vlera socialiste, përveç që janë një grup kompakt ujqish të vjetër socialistë që duan të vjedhin shtetin: “Ju do shkoni për lesh!” Puna e leshit shkaktoi krizën politike të ditës. Dhe mos ma keq, plasi sherri në Kuvend! Ata zotni deputetët që u informuan se do të shkonin për lesh, filluan të mërzhiten fort e të shajnë kryetaren e nderuar me gradën “Doktor në fushën qytetare të drejtësisë” për përdorimin e një shprehjeje të tillë blegtorale.

Po si nuk u çua kush me pyetë se për çfarë leshi bahej fjalë? Si nuk pyet kush se si e dinte këtë punën e leshit kjo zonja e nderuar? A ishte lesh a peliçe, postiqe dhie, dele rudë apo qime derri? Se ndoshta duhet të pyesim Muçi Puçin si e ka leshin dhia e Skraparit dhe për çfarë bëhet fjalë në këtë rast. Ndoshta ia ka nisë këtë argumentin e leshit me SMS, ai zotni Burri - Shefi që e mban mend nga koha e rinisë së parë si rruheshin bagëtitë e si shkohej për lesh në Viçidol.

More, mos e kishte me vetë deputetët? Po a u foli edhe këtyre që iu kanë ra flokët? Këtyre që e rruajnë kokën? A mos e kishte me Profesor Doktor, Kastriot Islamin që në sytë e opozitës u bë më i zi e më me lesh që ditën që u lidh me Salën? Sepse kishte shumë vetë që nuk e vunë re, por Profesor Doktor Kastriot Islami ishte i parruar atë ditë që votoi me Saliun. Dhe deputeti Bizhga nuk i ra atij, por i ra tavolinës, sepse pati frikë se po e gërvishte dorën në faqen me gjemba të zezë të Profesor Doktor Kastriot Islamit. Për me i ra Gjovalinit e Asllanit, nuk bëhej fjalë se këta të nisin në botën tjetër. Nejse.

Se me e ditë punën e leshit nuk është pak. Në shtetin shqiptar të bëjnë doktor profesor ba me e ditë punën e leshit, në

botën e huaj edhe më shumë se aq. Leshi është shumë i rëndësishëm. Jeton një shtet me lesh, Zelanda e Re. Kjo është kryetarja e Kuvendit e duhet njohje e thellë profesionale me folë për leshin e si shkohet për lesh në foltoren e kombit. Sepse ne jemi kombi që prodhon shumë lekurë (zëri me rritjen më të lartë në eksportet e vitit) dhe shumë pak lesh. Sepse ne leshin që përdorim e marrim nga jashtë shtetit.

Por duke gjykuar nga klithmat e platesë dhe revoltimi i zotni deputetëve, jam i bindur që të dy palët mendojnë se kryetarja e Kuvendit iu tha një mesazh sekret që iu djeg fort.

Pas shumë hamendjeve, fillova të mendoj se si do t'ua përkthejnë të huajve këtë shprehje... Ja në anglisht me Google translator.. (you will go for fur). Pffff... Nuk shkon.

Në fund thashë, po bëj si Prof. Dr. Edmond Tupja. Hapa Fjalorin e Gjuhës Shqipe të vitit 1981. Shprehja “shkoi për lesh” kishte edhe një pjesë të dytë... “dhe u kthye i qethur”. Aha! Me një fjalë, kjo u tha me gjuhën e saj dhe të tyre, edhe të atij zotni Burri - Shefit, sepse këta duhet të flasin një gjuhë që të kuptojnë njëri - tjetrin, që deshët më shumë se iu takon dhe nuk do ta merrni, sepse kështu e kishim marrëveshjen dhe ju e shkelët.

Ky mërgimi të ban me folë me vete. Pra, kryetarja e Kuvendit po përdorte një shprehje katundare që e kupton mirë, që ia kishte thënë ai zotni katundari tjetër fisnik, me ua thanë këtyre zotni katundarëve të tjerë që e dinë se si shkohet për lesh. Sepse pakti i 1 prillit duhet të respektohet, jo të hidhen vickla, sepse ashtu mandej shkohet për lesh. Këtë mesazh e thotë kjo, sepse vjen nga kumbari i paktit. Çuna, mos u bëni arrivistë, kështu e patëm pazarin, më rrove të rrova brisku i berberit, ndryshe do të shkoni për lesh.

Prandaj edhe plasi sherri, sepse të gjithë e dinin kuptimin. Mua të shkretit m'u desh me hapë fjalorin. Mirë që ne na ka ngordhur gomari e këta grinden për punën leshi, po si nuk flet kush për çmimin! Eh, çmimin do ta paguajmë ne shqiptarët, sepse këta rrahen e shahen, por për lesh duket se na kanë nisur ne.

SI PO MUND OHET PARI A E TIRANËS TA MBULOJË PAKTIN E 1 PRILLIT? ME HI, ME ZHURMË E ME DHE...

Sot ka qenë njëra nga ditët më të vështira për parinë e Tiranës. Problemi që nuk ikën e nuk ikën për qamet nga mendja e njerëzve, është pakti i 1 prillit. Të gjithë skalionet e parisë ishin hedhur në sulm për të mbuluar pazarin e 1 prillit me ca hi mediatik, me ca sherre në Kuvend dhe me lëvizje që duken të frikshme... Por era kutërbuese e paktit po i mban njerëzit larg. Teknikat e shitjes nuk po funksionojnë. Njerëzit janë zgjuar nga gjumi i rëndë hipnotik, edhe militantët po kanë dyshime e çfarë dyshimesh. Iu duket LSI si jashtëqitje miu. Problemi është se pakti i 1 prillit ka treguar fytyrën e vërtetë të parisë. Por duhet kohë që ta kuptojnë të gjithë.

Në fakt është krejt e thjeshtë. Si e kam thënë në shumë intervista, në artikuj e libra, këta janë të gjithë bashkë në tavë, por thjesht shtyhen me bërryla se duan të kruajnë kusinë nga ana e të tjerëve. Dhe i marrin inat, sepse lëngu në tenxhere shkon gjithnjë nga ana e tyre. Më kujtohet koha e kazanit. Kur derdhej grosha nga garuzhdja, një shoku ynë bërtiste nga inati se i dukej se merrte gjithnjë racionin më të vogël.

Po sot u pa shumë qartë se pakti nuk po shitet e nuk po e blen njeri. Dhe shqetësimi ndjehet gjithkund në shtresat e parisë. Por janë të paktën gjashtë shenja që pakti i 1 prillit ka ardhur me një kosto të lartë, shumë të lartë, për parinë e Tiranës, sepse këtyre fundërrinave politike iu ka dalë fare boja. Dhe të gjitha u panë sot në llapaqenërinë mediatike e në strip-tizën politike të Tiranës.

Interpretimi i pozicioneve të të huajve

Pakti u pranua nga të gjithë të huajt. Vollfarth, apasadori që ka pirë me shumë kenaqësi aq birrë Korçe sa nuk mban mend e nuk i nxjerr sekretet, “unter keinen Umständen” tha se ajo që ndodhi ishte njëloj sikur të nxirrej lojtari nga fusha e të hynte një lojtar tjetër. Maartens, kryetari i një partie internacionale, dikur demokristiane, sot popullore evropiane, doli hapur me Saliun. Këtu me siguri që ka bërë ndërhyrjen e vet i Bekuari Apostolik, Fahr - el - Din Balliu me “Institutin De Gasperi” që e ka qendrën në fermën e Belshit. Mandej doli ambasadori Withers që u keqinterpretua qëllimisht në shtyp, sepse pati rezerva ndaj paktit. Edhe pse e ndjen se Rama do të bëhet diçka, por se çka, ende nuk dihet, Withers e tha me më shumë diplomaci se kjo që ndodhi nuk është e pranueshme, por kjo është loja në Tiranë dhe është e pranueshme në Tiranë. Edhe z. Moore tha se këta janë të njëjtët njerëz që ka takuar katër muaj e ca më pare, por që tani flasin krejt ndryshe dhe që shpreson se do të respektohet procesi.

Kjo çudi është e kuptueshme, sepse në Tiranë, sy më sy “të bardhës” t’i thonë “e zezë” dhe “të zezës” t’i thonë “e bardhë”. Këta nuk dallojnë partitë, jo të dallojnë ngjyrat. Lëre më kur duhet të përkthesh nga anglishtja në shqipen bashkëkohore. Por parimi është, “hajt ma, këta jemi, kështu i do drutë ky popull”. Rrejnë hapur edhe pse anglishtja është gjuhë e huaj e dytë në shtetin shqiptar. Por shumë vetë e kuptuan se arsyeja pse Saliu propozoi kinezçen si gjuhë të dytë dhe këta të tjerët nuk e kundërshtuan, është thjesht sepse paria don që shqiptarët të harrojnë anglishten, sepse anglisht flasin të gjithë këta që merren me ne. Po të mesojnë shqiptarët kinezçe, nuk do të dinë çka tha ky e ai zyrtar i huaj dhe kështu shpëton paria.

Sigurimi si garanci fitimi

Më në fund u pa se pakti ka pasur pasoja të rënda mendore në bazën socialiste, ku militantët e urrejnë Ilir Metën, mafian

e Skraparit, oficerët e gardistët e kompanisë automatikase të xha Sulo Gradecit dhe nuk ia falin Ilirit ditën e 21 janarit. Ata nuk i besojnë më as Edit, as Ilirit, as Gramozit, as dreqit e të birit. Tronditja në bazë ishte ndjerë keq shumë dhe nuk duket se është shuar shija e keqe. Kjo u pa, sepse sot doli në një nga paçavuret e PS, pikërisht në fletushkën “DITA” një nga kuadrot me perspektivë të kohës që lamë pas. Një i projektuar për pozicion kyç në moshën e mesme, “zbuluesi me përvojë e me perspektivë në lëmin ndërkombëtar” Luan Pobrat. Kam dyshime që ky i di ca takime të miat me të huajt dhe uroj që të mos t’i ketë raportuar, por hajt më. Asokohe të huajt ky i kishte armiq, tani i ka miq kështu që jemi përkohësisht në të njëjtën barrikadë. Shkrimi ishte i pjekur, e lexova dhe e nënvizova, por ka shumë gjera brenda që duhen kuptuar si duhet.

Gjithësesi, ky i lavdëroi në maksimumin e mundshëm Edi Ramën dhe Ilir Metën, u dha bekimin e vet individual, por edhe të ca të tjerëve, sepse dihet që në luftë duhet të sillemi “si një trup i vetëm”. Për ata që kanë harruar kohët e vjetra, anëtarët e partisë, militantët, oficerët, nënoficerët, kuadrot dhe bashkëpunëtorët, mendonin si bleta. Dhe z. Pobrat flet në emër të një grupi që hoqi keq, por nuk e ka tradhëtuar partinë dhe shefin e vet që sot është kryetar i Asamblesë së PS. Ja edhe garancia e fitores për bazën e partisë nga një qytetar modest dhe i thjeshtë, që ka për zemër vetëm interesat e partisë dhe të bazës socialiste.

“Do të mendoja dhe doja që Ilir Meta dhe Edi Rama të kenë nxjerrë mësim nga e kaluara dhe eksperiencia negative e marrëdhënieve midis tyre, të mos përsëritej. Nga gabimet e së shkuarës, vetëm histori të pakëndshme mund të priten. Në qoftë se lidhësitë e të dy partive, ditën të tejkalojnë me maturi çështjet midis tyre, të tolerojnë njëri - tjetrin dhe të tregojnë se dinë të bashkëpunojnë e shikojnë përpara, problemet do të tejkalojnë dhe efektet do të duken qartësisht, përmes progresit ekonomik dhe institucional të vendit. Është kjo e dyta, çka unë uroj të ndo-

dhe më shpejtë dhe jam i bindur se për sa them, nuk është vetëm dëshira ime, por e një elektorati të gjerë, të majtë progresistë e socialistë, fuqi që gjeneron energji, dëshirë e mijëra njerëzve të thjeshtë”.

Më e bukura është që ky flet me gjuhën e Fatos Nanos dhe iu tërheq vërejtjen atyre që e lexojnë gazetën, ose ngulen të shohin Bashkim Hoxhën para se të pinë kafënë e mëngjezit. Jam i bindur se gazeta “DITA” është gazeta më e shitur sot. Kush kishte dyshime, e vë në tavolinë dhe i thonë tjetrit:

- E pe?

Dhe përgjigja do të jetë:

- Po, po e pashë.

- Ça do marrësh sot, se mora pensionin dje?

- Një kafe të dytë, akoma s’më ka sjellë gjë djali nga Italia.

- Jo jo, sot do ta jap unë kafënë, se tani e dimë që u bashkuam edhe një herë.

Gramozi është qafa e partisë, por partia e vërtetë është Sigurimi. Dhe kur flet Luan Pobrat, e dëgjon i gjithë fshati. Ose ndoshta duket ashtu, sepse loja luhet me rregulla dhe rregullat janë bërë për t’u thyer. Por është thyer buka dhe këta nuk ia kanë më besën as këtij e as atij. Kështu që kjo dalje kaq e hapur, tregon se pakti nuk po shitet në bazën socialiste.

Pushtllëk, maskarallëk, deputetllëk...

Sherri duhet të bëhej i besueshëm, prandaj u ngrit ai deputeti i kobures plastike nga Peqini, e shau nga motra atë deputetin tjetër këngëtar të papushuar nga Librazhdi dhe i tha “hajde të dalim jashtë”. Doli ai deputeti tjetër që i ka do kobure joplastike me vete e në farefis dhe i tha “hajde, mor ti, del jashtë me mue”. Asnjëri nuk doli jashtë, por të gjithë e kryen detyrën e ngarkuar. Ashtu iu thanë të bënin shefat dhe tani është mbushur i gjithë shtypi e televizioni me këtë përplasje që tregon se PS e PD janë në luftë e gati në gjak. Eh, sonte ndoshta nuk hanë darkë bashkë, por deri muajin tjetër, me siguri do të

gjendet ndonjë sekser që t'i pajtojë, sepse "lëre, o burrë, se nuk u bë qameti, hajt ta blej një verë spanjolle, e mos çaj trapin se tanët jemi". Detyra u krye, nderi i partisë dhe i shefit respektiv u ruajt. Por kjo ishte loja! Se të dielën humbet Peqini apo fiton Peqini, dihet se tre burra me emër ka qitë, Mustafa Gjinishin politikan, Hekrin babaxhan dhe Dashin bambam, po burrë si ky që të vret me kobure plastike, nuk ka nxjerrë as Pekini.

Llapaqenëria mediatike: zagarë dhe gazetarë

Nga ana tjetër, gazetarët në Tiranë i ka zënë halli. Muçi Puçi nuk ka thënë gjë sot, ndaj nuk do ia zë në gojë emrin. Por kanë dalë ca të tjerë si Henry Tchili dhe Skender Minxhozi, që lajnë borxhet e vjetra e thonë se këta i bashkoi Berisha, se kështu ikën e keqja, se fajin e pati Fatos Nano që i futi në sherr dy vëllezërit, pardon, tre vëllezërit, përfshi këtu edhe Salën dhe njerëzve u është bërë mendja çorbë. Shyqyr që u bënë bashkë, se edhe pa drita, pa bukë e pa ujë rrijmë.

Problemi i leshit në Kuvend

Këtë problem e kam shpjeguar më lart. Po për Jozefinën si njeri gjithnjë kam pasur e kam respekt maksimal edhe pse si politikane lë shumë për të dëshëruar. Nuk do të merrem me pallatin, me tokat në Rrjoll, me hidrocentralet, me këtë e me atë, por më vjen keq që ai Burri - Shefi e ka vënë përballë këtyre hienave. Me keqardhje them se nuk i takon Jozefinës me u marrë me leshin e me opozitën, sepse ajo batutë që tha, nuk mundet kurrë me dalë nga goja e saj. Ka dalë nga telefoni e SMS, por hajt ma, janë rreziqet e zanatit.

Heshtja e prijatarëve

Prijatarët mendojnë se ia hodhën edhe këtë herë. Njëri vuri Gramoz Ruçin të dalë e të flasë me autoritet si u vodh ligsh-

mëria dhe si humbi besimi i institucionit të zgjedhjeve. Aman, o Zot, o Perëndi, kush po flet! Del mandej informatori i tij Alfons Ballshi, pardon, Astrit Pajtoni dhe i thotë ish shefit të madh, sill emrat, more burrë, se merremi vesh. Po nuk thotë tamam kështu. Ai thotë me zë bubullues e kavajas: “keni dyzetë e tetë orë të sillni emrat, ne jemi gati dhe i miratojmë!”. Edi qan hallin e ligjshmërisë. Po çka dinë Saliu dhe Edi çka është ligjshmëria, more aman! Hajt ma, të dy palët luajnë teatër, komedi.

Përfundim

Shkurt e përmbledhtas, këta vëlla, janë nisur të na e fusin keq. Po rrahen keq në publik, po shahen, bëjnë shenja se do ta presin njëri - tjetrin në fyt, merren me poezi për leshin, edhe pse me e bukura është se i shkruajnë ata që nuk kanë asnjë xhufkë a qime në kokë si Ilir Bejtja, që në u kujtoftë do të kujtohet se ka ngelur pa u fejuar, sepse i ka kërkuar të puthurat ku nuk duhet, dhe në fund duan t’ia arrijnë qëllimit të polari-zojnë shqiptarët.

Por duket se kësaj here njerëzit e kanë kuptuar se kopilat e mençur të politikës nuk e kanë seriozisht. Prandaj nesër e pasnesër pritet zbritja në fushë e prijatarëve dhe po nuk funksionoi ajo zgjidhje, atëherë vjen vala e katundarëve. Në mos funksionoftë gjë tjetër, kemi Fevzon. E shpik një skandal ai brenda natës dhe harron ky popull që nuk mban mend çka ka hangër dje e jo se kush ia ka me hile. Sepse pakti është shpëtimi i parisë dhe nuk mund të prishet e të shkelet. Pakti është shumë i hekurt, e lere kush hedh vickla, janë kot. Pazari është i qartë; këta dojnë pushtetin të vjedhin nga thesari në shtet, ai don të mbrojë familjen dhe djalin e vet.

Por ja që ky pakti nuk po gëlltitet nga askush, edhe sikur ta shtyjë Luan Pobratit me shpatën e partisë, siç mund të thotë edhe Muçi Puçi, shpata ende pret koka, por nuk e justifikon paktin e 1 prillit të parisë.

NËN PUSHTETIN E GJENDJES: PARIA E TIRANËS DHE EKSPERIMENTI I TRANZICIONIT SHQIPTAR

Pushteti i gjendjes në të cilën ndodhet është i jashtëzakonshëm mbi gjendjen mendore të individit dhe të gjithë shoqërisë. Literatura është e mbushur me raste kur njerëz sidokudo janë vënë në pozicione kyçe dhe janë sjellë sikur të ishin të lindur për to. Vishe hajnin polic dhe bëhet më i ligjshëm dhe më i ndershëm se të tjerët. Fute tjetrin në burg dhe si që është njëriu më normal e humbet krejt dinjitetin.

Pushteti i gjendjes ku ndodhet mbi sjelljen e individëve të ndryshëm është i frikshëm. Individët tjetërsohen, e humbin nderin e dinjitetin dhe shfaqin sjellje që në shoqëritë normale janë patologjike. Në shoqëri që janë të izoluara, siç kemi qenë ne gjatë kohës së sundimit të Enver Hoxhës dhe krejtësisht të mashtruar e të manipuluar, siç jemi tani nën sundimin e jeniçerëve, bashibozukëve dhe martallozëve të Enver Hoxhës, këto patologji bëhen karakteristikat themelore që përcaktojnë fatin e gjithë shoqërisë.

Për ta kuptuar më mirë gjendjen dhe pushtetin e gjendjes mbi psikikën e mendësinë e individëve dhe të shoqërisë, do të krahasoj Eksperimentin e Burgut të Stanfordit me eksperimentin e marrëzisë kolektive që është luajtur e që luhet pa ndërprerje mbi shqiptarët, qysh nga viti 1944, veçanërisht gjatë tranzicionit. Sepse, në mos tjetër, tani jemi në një pikë kritike dhe nuk duhet të bëjmë të njëjtat gabime.

Eksperimenti i Burgut të Stanfordit

Eksperimenti u zhvillua nga profesorë të Universitetit të Stanford drejtuar nga profesor Zimbardo. Njihet në literaturë si “Eksperimenti i Burgut të Stanfordit”. Për kë do ta ndjekë si u zhvillua, lidhja është këtu: <http://www.prisonexp.org/>.

Duke i marrë studentët dhe duke i lënë të zgjidhnin vullnetarisht ose rolin e të burgosurit, ose të gardianit dhe duke u bërë vetë drejtori i burgut, profesor Zimbardo dhe të tjerët shpresonin që të studionin ndryshimin e sjelljes në varësi të roleve që merr individit. Pyetja që i bënë vetes profesorët ishte çka ndodh kur i merr njerëzit e mirë e normalë dhe i vë në një gjendje të keqe dhe anormale?

Nuk kishte më asnjë autoritet. Gjithkush ishte më vete. Fillimisht u mendua që studentët të rrinin në atë gjendje për nja dy javë. Dhe rezultati, edhe vetëm pas tre ditësh, e tmerroi profesorin që po bënte eksperimentin. Ai vërejti se studentët i morën seriozisht rolet dhe duke i luajtur filluan të shfaqnin patologji sjelljesh që e llahtarisen. Dy prej studentëve që nuk duronin dot më, e lanë eksperimentin në ditën e dytë. Të tjerët filluan të silleshin në menyrë iracionale, të kishin ankthe e shqetësime mendore dhe, ata që ishin të burgosur e të pafuqishëm filluan të tjetërsohen komplet. Në burgun imagjinar ndodhën rebelime dhe kundërvënia e gardianëve ishte e furishme. Ata që u bënë gardianë u bënë sadistë e të pamëshirshëm, të dhunshëm dhe abuzivë. Disa të burgosur u bënë hafije dhe të tjerët filluan të kishin ankthe. Ata që ishin të burgosur filluan të humbnin mendjen, të demonstironin shenja shtresi të jashtëzakonshëm. Pas gjashtë ditësh eksperimenti u ndërpre. Por mësimi që u nxor ishte shumë i thjeshtë. Gjendja në të cilën vendoset personi, përcakton edhe mënyrën e sjelljes së tij. Natyra njerëzore është shumë e formësueshme, lehtësisht e formësueshme dhe prandaj duhet bërë shumë kujdes të mos krijohen gjendje që me lehtësi i deformojnë njerëzit dhe i bëjnë të sillen si të marrë, ose si kriminelë.

Ekspërimenti i marrëzisë kolektive

Nga viti 1944, deri në vitin 1990, të gjithë ne ishim në burg. Edhe unë edhe shumë të tjerë që tani janë në politikë, kemi lindur në një burg të tillë. Nuk kemi njohur tjetër, ai burg ka kenë shteti jonë, shoqëria jonë. Në izolimin dhe në marrëzinë e një të çmenduri diabetik e diabolik si Enver Hoxha, të gjithë jemi tjetërsuar e deformuar. Të gjithë e kemi humbur të paktën një shkallë normaliteti. Nuk ka rëndësi si e fshehim, por e kemi një plagë që nuk do të mbyllet asnjëherë, sepse kemi qenë të përdoruar, të deformuar, të shformuar. Gardianët; Partia, Sigurimi, Blloku, së bashku me disa të burgosur; intelektualët, profesorët e doktorët, na abuzonin si donin. Këta na bindën se bota nuk funksiononte pa ne, se ishim fanari i socializmit, se bar do të hanim e parimet nuk do t'i shkelnim, se patatja ishte edhe bukë, edhe gjellë. Këta na kontrollonin ditë e natë. Këta na mbajtën skllëvër, edhe kur vetë dilnin nga burgu e shkonin në Francë e ktheheshin, na tregonin sa mirë ishim në burgun e marrëzisë kolektive. Katundari pinte ujë me sheqer e hapte kanal. Punëtori hante bukë me djathë e hidhte betonin për bunker. Këta shkonin jashtë shtetit. Mësonin. Morën diploma. U bënë njerëz. Ne skllëvër se skllëvër. Ne e hëngrëm njëri - tjetrin e tash këta gardianët e të burgosurit që iu shërbenin atyre, na thonë se ishim plehra që spiunuam e dënuam njëri - tjetrin. Se këta, bijtë e zagarët e Bllokut, i kanë duart e lara. Se ne e hëngrëm njëri - tjetrin për një kafshatë bukë e këta u tallën kaq keq me ne. Po çka kemi ditë ne, çka din njeriu që është në burg se ka jashtë diell e dritë?

Ekspërimenti i tranzicionit shqiptar

Problemi është se në vitin 1990, kur burgu duhej të shpërthej dhe kur njerëzit u rebeluan, se vjen një kohë që thika të shkon në palcë, këta intelektualët e shquar, që në fund të fundit ishin vegla të gardianëve të Bllokut, të jeniçerëve të En-

ver Hoxhës që vinin e rrinin “gju më gju” me ne dhe formalisht ishin të burgosur si ne, na ndrynë me marifet edhe një herë në burgun ku ishim dhe na thanë: “Ne nuk jemi si ata. E ardhmja juaj do të jetë e ndritur, por hyni edhe një herë këtu e do ju nxjerrim ne, sa të bëhen punët mirë!”.

Eh, unë e kam ditur dhe e kam thënë... Unë dhe shokët e mi u kemi thënë se këta do ju skllavërojnë. Por shumë iu besuan dhe si ata dy studentët në “Eksperimentin e Stanfordit”, ne ikëm vetë. Ende na dhembin plagët nga gurët që na kanë plasur kokës njerëzit që na urryen edhe pse i deshëm më shumë se jetën. Iu thanë se burgun do ta bëjnë parajsë. Dhe njerëzit besuan. Iu thanë njerëzve se do të kishte shpëtim e lumturi edhe për ata. Dhe ata besuan. Iu thanë njerëzve se do të hyjmë në Evropë, se do të jenë të lumtur, se do t’ju ruajnë nderin, pasurinë e jetën. E njerëzit besuan. Iu thanë njerëzve se do të shkojë haka te i zoti. Se do të kishte edhe për të varfërit e të mjerët. Dhe njerëzit besuan. Edhe kur i zhdukën paratë e jetën e njerëzve si me piramidat, me pronat, me mërgimin, me 1997 - ën, me Gërdecin, me shitjen e pasurisë kombëtare, me vjedhjen, njerëzit prapë besuan. Edhe kur i lëshuan bandat e tyre mbi kurriz, njerëzit besuan.

Deri kur ma?

Sepse dallimi midis “Eksperimentit të Stanfordit” dhe Eksperimentit të Tranzicionit Shqiptar është te gjendja. Atje ishin pak njerëz. Ne jemi një komb. Atje ishin vullnetarë. Këta kriminelët e gjarpërinjtë tanë na kanë kapur për fyti. Atje e ndali dikush eksperimentin e këtu nuk ka kush ta ndalë. Edhe pse jemi vetëm një grusht njerëzish që e themi të vërtetën, ata që janë ndry në Burg, në Rrethin e Ferrit Shqiptar, nuk duen me besue, nuk duen me dëgjue. Realiteti absurd ku jetojnë e ku i ka ndry ajo paria e vjetër, gardianët e burgut, së bashku me veglat e saj të dikurshme, tash pjesë e saj, i bind që ne flasim kot e nuk dimë se çfarë jemi duke thënë. Nga realiteti i marrëzisë kolektive dhe anormale shqiptare, ne jemi absurdi dhe marrëzia. Dhe këtë mesazh përcjellin ditë e natë të gjithë

veglat e parisë sunduese të Tiranës, komentatorët, mendimtarët, spiunët e vjetër e të rinj, profesorët që shesin gjithçka... Këta kanë përdorur gjendjen që po vetë e kanë krijuar, për të na tjetërsuar, për të nxjerrë më të keqen nga fundi i shpirtit tonë dhe për të na bërë skllëvërit modernë, të kohëve moderne të shpirtit të tyre prej gjarpërinjsh e të zi si bloza.

Në vend të përfundimit

Për ata që kanë sy me pa e veshë me dëgjue, pakti i 1 prillit e ka tranguar qartë edhe tash, njëzetë e tre vjet më vonë, se shqiptarët janë në një burg gjigand. Gardianët e djeshëm janë pronarët e sotshëm. Siç edhe e tregoi pakti i 1 prillit, këta ishin shërbëtorët e gardianëve të djeshëm dhe sot janë gardianët e rinj. Këta duan të na mbajnë skllëvër e të burgosur. Nuk ka më asnjë iluzion. Paria e Tiranës ia ka arritur të paralizojë shoqërinë deri në atë pikë, sa reagimi popullor duket krejtësisht i pamundshëm. Nga çdo nivel që ta shohësh, shoqëria shqiptare duket sikur është pajtuar me gjendjen dhe se ne që flasim që gjendja nuk është normale, jemi një pakicë e papërfillshme dhe një zë në shkretinë. Por ne jemi ata që dimë, sepse për ata që kanë shumë kuriozitet, edhe ne e kemi bërë shkolllën e djallit, por e kemi bërë për t'iu shërbyer njerëzve tanë, jo drejt e të birit, gardianëve të djeshëm e të sotëm të Burgut të Marrëzisë Kolektive shqiptare, tranzicionit shqiptar.

SE NE NA KA NGORDHUR GOMARI ME KOHE POR...

... Këta duan që duan të shesin pazarin e 1 prillit. Por pazari i 1 prillit nuk po shitet që nuk po shitet... Petullat në ujë të Andrea Stefanit, të Muçi Puçit, të të Bekuarit të Vetëm Apostolik Fahr - el - Din Balliut, të Hamit Takeve dhe të të gjithë teneqeve e raketakeve të parisë, nuk po i bindin njerëzit. Shqiptarët janë djegur kaq herë nga lojërat e parisë dhe këtë herë e kanë ndjesinë e atij që është djegur nja nëntëdhjetë herë me ujë të nxehtë. Dhembja ma e madhe fillon kur e din se duhet me pritë e me durue, sa të fryhet, të mbushet e mandej të shfryhet flluska.

Paria vetë e din se nuk ik dhembja po nuk u fry, po nuk u mbush me ujë dhe po nuk u shfry flluska e djegies. Si edhe pata parashikuar ekzaktësisht në shkrimet e mia, pas paktit, me një shkelje syri këta nisën sherrin mes vetes. Tashti flluska është duke u fryrë me shpejtësi. Nga ana e vet, sherrin e nisën në Kuvend deputetët njëpërdorimsha e kryetarja shumëpërdorimshme. E vazhduan këta teneqexhinjtë dhe raketaket e shtypit dhe, një shenjë e qartë e krizës ku janë, thirrën Rexhep Qosen që mendon vetëm për lavdinë e vet, dhe e bënë qytetar nderi të Gjirokastrës. Nderimin ia bëri Rexhep Mejdani, që zot e din se çka lypte atje, se as gruan nuk e ka gjirokastrite dhe ia filloi të kallzojë përralla si duhet të ikë Saliu. U mbushën gazetat dhe llapaqenëria mediatike u hodh në një sulm të paparë duke e nxjerrë Qosen e shkretë të rrethuar me libra, duke thënë “nuk e di çka ka ndodhë, por Saliu duhet me ikë!” Dhe

natyrisht, doli edhe Gramoz Ruçi dhe Arta Dade, që çuditërisht është gjallëruar shumë pas paktit me LSI, kjo për arsye të kuptueshme; kthimi i plangprishësve krijon mundësi pajtimi në parti dhe të gjithë të tjerëve që duan të bëhen deputetë.

Por ashtu si u prit dhe si u parashikua me shumë modesti nga unë, beteja po nis “e ashpër” midis prijatarëve. Këta do ta shpëtojnë situatën, sepse pazari i 1 prillit nuk po shitet. Edi hypi në pemë e nisi të cicërinte me mesazhe 140 fjalëshe, me një lëvizje mjeshtërore shkoi në Dibër dhe iu tregoi dibranëve se kur shkon lopa teposhtë e kur përpjetë. Por dibranët të japin ujë në bisht të lugës, se janë njerëz të mençur dhe kushe-di çka kanë menduar për atë shembullin e marrë nga libri i veterinarisë, që Edi nuk e ka lexuar asnjëherë. Nga ana e vet, Saliu mori në krahë atë foltoren e bardhë ku thuhet se folësja është ndryshimi, rruga përpara dhe nisi sulmin imagjinar kundër bashkëfajtorëve Edi Rama dhe Ilir Meta.

Ilir Meten e ka ruajtur për në fund. Tani duhet t'i bjerë Edit tri ditë rresht. Iliri i tha drejt, me delikatësinë e një katundari që të fut një dru pas koket “mos u merr me mua” dhe Saliu nuk merret me Ilirin, se kur u pat marrë me guroren desh e hëngri. Po u mor me zotërinë e nderuar Leonard Kokën që doli i pajshëm dhe që ia mbylli shpejt gojën. Si zakonisht e filloi me një goditje nga poshtë. Dikur shante klanet e Zemunit, tash ka vendosur të merret me Nar Kokën. Po Nar Koka i tha “je bërë si Ver Llapa, hajde merru me mua”. Të gjithë gazetatat e vunë në faqe të parë, se dihet që Nar Koka e mban fjalën. Po kjo i nxori punë Sokol Olldashit dhe ca të tjerëve, të cilët duhet të bindin këta që mërzhiten shpejt se të medhenjtë nuk e kanë seriozisht.

Dhe Saliu e mbylli shpejt. Nejse, nuk ka çajre pa filluar sherrin edhe me Ilirin, por kjo do të jetë nga fundi, kur të mos ketë zgjidhje të tjera.

Dhe sharjet ndaj Edi Ramës dihen, ashtu si dihet edhe përshkallëzimi i sherrit. Dhe meqë Edi nuk do të flasë, sepse si kryeministër i ardhshëm nuk mund të lerë gjurmë sharjesh e fyerjesh që i ulin figurën në publik, Saliu e din se mund të

thotë çka i rrjedh në tru. Si gjithnjë, një kunj të madh e ka me burrërinë e përdhosur, sipas tij, të Edi Ramës, por këtë e bën se e din që shitet ndër katundarët fisnikë. Shqiptarët nuk e durojnë mungesën e humbjen e burrërisë, edhe pse ajo shfaqet në mënyra të ndryshme, disa prej të cilave vetë Saliu i ka profesion. Por po të jetë e paguar mirë, edhe falet gabimi, “se, hajt mor burrë, njerëz jemi, ta hajë dreqi, edhe gabojmë”.

Nejse, Saliu e nisi me burrërinë e Edi Ramës, do të shkojë te Blloku, te mister 20 % - shi, do të merret me librin e shtëpisë, me Saimir Tahirin, me pallatin dhe në fund do ta mbyllë me gazetën “55” dhe me ndonjë shpikje të të Bekuarit Apostolik, që me siguri do të na vërë ca foto me rërë.

Ja si u shpreh z. Berisha:

“Burrat janë për fushëbetëjë, nuk janë për të kapitulluar. Beteja elektorale duhet të shkojë deri në fund. Nuk ua mban! Tërhoqën komisionerët nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kurrë mos i ktheni, po të doni! Zgjedhjet shqiptarët do t’i bëjnë të lira dhe të ndershme. Je i pashpresë, zoti Rama! U bashkuan, e panë që u zvogëluan dhe tani shohin karriken e amshuar me dylibi. U largohet çdo ditë e më shumë. I tërhoqi komisionerët dhe po bëhej gati. A mund ta imagjinoni ju, të kërkonte shtyrjen e zgjedhjeve?! I çova fjalë: asnjë sekondë! Po të duash që tani deklaro se nuk do të marrësh pjesë, se në mënyrë absolute qoftë edhe një sekondë nuk shtyhen zgjedhjet. Ai është një njeri që do të prishë çdo proces normal të këtij vendi. Por edhe ky vend, kam bindjen më të madhe, siç besoj te Zoti, siç besoj te Shqipëria, do t’i japë atij atë që meriton më 23 qershor”.

Që kjo është rrenë e pastër shihet te ajo fjala që ka thënë se beson te Zoti dhe te Shqipëria. Por për ta thënë me një shprehje popullore tiranase, që është shumë në modë tani në Sheraton, “ku i rruhet” Saliut për Zotin e për Shqipërinë! Nejse, në mes të llapaqenërisë mediatike, të rrahjes së teneqeve zhurmuese e të rrotullimit të rraketakeve, të gjithë palët vazhdojnë të sigurojnë njëri - tjetrin se nuk e kanë seriozisht. Pakti i 1

prillit do të respektohet. Nuk ka rëndësi a e mbushin Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më 1 maj apo më 1 qershor. Mjaf-ton që njerëzit të shohin fluskën që fryhet. Dhe të fillojnë e të luten, “aman, kur do të plasë”. Por as Saliu, as Edi, as të tjerët nuk kanë ndërmend ta bëjnë këtë punë qetë e shpejt. Se me çka do të merren njerëzit e papunë që rrinë kafeneve duke bërë politikë, pastaj shkojnë në shtëpi të hanë bukën që pjekin gratë në stufat elektrike me miell të marrë veresie? Kjo është fushata zgjedhore, sepse për të zgjidhur problemin, duhet ta krijojmë njëherë. Sepse ne na ka ngordhur gomari, por që ta kuptojmë, duhet të vijmë mizat. Shumë miza, kaq shumë miza, sa nuk po na lënë as të vdesin ne vetë rehat.

INTERVISTË ME GAZETËN “SHEKULLI”

- Dhënë gazetarit Plarent Shehu, 04.17.2013 -

- Si i gjykoni deklaratat e fundit të përfaqësuesve amerikanë në Tiranë për zgjedhjet në Shqipëri?

- Deklaratat e përfaqësuesve të SHBA janë një shprehje e qartë e shqetësimit për stabilitetin dhe demokracinë në një shtet aleat në pozicion strategjik, aq sa mund të konsiderohet shteti shqiptar aleat dhe strategjik.

- Me ndërhyrjen në KQZ nga kryeministri Berisha dhe shkakimin e një anëtarit të saj me justifikimin se ishte propozuar nga LSI, rrezikon Shqipëria marrëdhënjet me SHBA?

- Shteti shqiptar nuk i rrezikon marrëdhëniet me SHBA, sepse ndodhin këto pislleqe të vogla në Tiranë. Ka një linjë shtetërore që rregullohet me marrëveshje e me dokumente të tjera e mbikqyrje, që nuk influencohen dhe aq shumë nga politika e ditës. Ka institucione që kanë linjë direkte me partnerët e tyre jashtë shtetit shqiptar. Paria ka shumë influencë, por nuk është vendimtare në këto punë.

Por janë këto problemet tona politike të brendshme që bëhen shumë shqetësuese për stabilitetin e vendit dhe që shqetësojnë edhe SHBA. Klanet e parisë së Tiranës, nuk kanë çfarë të humbin, janë krejt të pafytyrë, nuk e respektojnë as shtetin, as popullin. Të gjithë e dinë mirë se kush janë ata. Të gjithë i njohin si persona të pabesë, si politikanë të nivelit të ulët, si njerëz të lidhur me krimin dhe si mafiozë të paskrupull. Përpjekja e SHBA duket se është që të minimizojë efek-

tet e sjelljes së tyre negative, në mënyrë që të mos jenë edhe më të dëmshme se ç'mund të jenë. Sepse këta sillen kështu vetëm kur iu rrezikohet posti. Kur janë në poste, janë shërbëtorë shumë të bindur; luajnë një lojë të dyfishtë; edhe shërbejnë, edhe vjedhin për vete.

Mendoj se ju dhe të tjerët duhet ta keni parë nga Wikileaks se nuk ushqen kush ndonjë iluzion as edhe për njërin në politikën e Tiranës. Fatkeqësisht, bindja është se këta që janë në politikë, nuk do të veprojnë me ndershmëri apo në interes të shtetit e të shqiptarëve. Keta politikanë kanë një të shkuar dhe ajo është e zezë si bloza. Keta kanë një të tashme dhe ajo është e zezë si bloza. Si do të jetë e ardhmja? E zezë si bloza.

- A mendoni se qeveria dhe Berisha do të bëjnë zgjedhje të lira e të ndershme më 23 qershor?

- Po nuk është Berisha që i bën zgjedhjet. Këta janë të gjithë bashkë dhe zgjedhjet i bëjnë bashkë Edi Rama, Sali Berisha dhe Ilir Meta. Këta bënë një pakt më 1 prill, kanë harxhuar një vit duke i kopsitur punët... Tashti kanë vendosur ta zbatojnë e ta shpallin. Po u gjetën tërësisht të papërgatitur nga reaksioni popullor dhe iu duhet të justifikojnë sjelljen para shqiptarëve. Këtyre iu intereson të duket se e kanë sherrin mediatik me të vërtetë. Por ky është thjesht teatër politik. Këta janë të gjithë në tavë bashkë dhe do të bëjnë gjithçka që të zbatojnë marrëveshjen që kanë bërë Edi Rama dhe Ilir Meta. Këtu ka dorë edhe Sali Berisha që ishte kumbari, sepse asgjë nuk u bë pa miratimin e tij. Problemi është se do iu ikë loja nga duart. Në një vend ku nuk ka ekonomi e vlera, shteti është ekonomia. Një palë mbështetës e klientë janë të uritur, një palë të tjerë u mbajtën me thërrime dhe janë edhe më të uritur. Kështu që sherri varet nga faktorë që nuk janë tërësisht nën kontrollin e tyre.

- Ish ambasadori John L. Withers II, jo më larg se dje, në një të përditshme shqiptare iu ka bërë thirrje shqiptarëve haptazi që të votojnë kundër Berishës, shprehimisht, "Më 23 qershor votoni kundër Berishës, kundër rikthimit në komunizëm". A jemi

ne komunizëm vërtet? Është etike deklarata e tij, apo ky është një mesazh dhe i SHBA?

- Ambasadori Withers është në pension, besoj se flet si individ, por ai i njeh mirë të gjithë këta persona. Do të thoja se deklarata e tij duhet interpretuar pak me ndryshe. Pakti i parisë i 1 prillit 2013 dhe sjellja e të gjithë palëve, tregojnë se tashmë jemi në një sistem fashist që shitet si demokraci. Jemi në një fashizëm demokratik, sepse paria i ka vjedhur zgjedhjet pa filluar. Këta e kanë bërë ligjin si iu ka shërbyer më mirë, i kanë mbushur listat si kanë pasur dëshirë, kanë caktuar kë kanë dashur vetë dhe tani i lënë njerëzit të bëjnë zgjedhjet. Mandej do t'i mbushin kutitë dhe i ndajnë punët si iu intereson atyre. Deklarata e tij është shumë e saktë. Por me komunizëm duhet kuptuar një diktaturë fashiste e parisë sunduese, që është paria e sistemit të vjetër, e veshur si demokraci. Mesazhet e SHBA i përcjell ambasadori Arvizu, zv. ambasadori dhe zyrtarët e tjerë. Por nuk ka dyshim se ambasadori Withers e din se cila është e mira e SHBA dhe çka pret e dëshiron SHBA që të ndodhë në shtetin shqiptar.

- Si e gjykoni kthimin e Eduard Selamit në PD, pas vitesh në Amerikë dhe një kundërshtar i Sali Berishës?

- Me vjen keq për të. Në politikë, sidomos kur je pjesë e një populli që është në një pikë kritike e në udhëkryq, siç janë shqiptarët, njeriu duhet të ketë vlera, bindje e parime dhe marrjen me politikë duhet ta shohë si sakrificë që bën, sepse politikanët e vendeve të vogla janë humbës pa filluar lojën. Politika në rastin tonë, nuk bëhet për të fituar bukën e gojës, po për të fituar respektin e njerëzve. Politikani që mendon me fitue bukën me politikë, mbaron i urryer, sepse ecën me një faturë në kurriz dhe është për shitje dhe lehtësisht i përdorueshëm. Një politikan që mendon se do të vdesë, që dikush duhet të vijë ta respektojë a ta përmendë për mirë, nuk ke se çka i bën. Unë mund të ngordh për bukë, por nderin tim në jetën publike, nuk kam pse e shes. Të gjithë jemi të vuajtur në mërgim, unë kam larë dyshemetë e restauranteve, por të

vërtetën nuk kemi pse ta tjetërsojmë për një kafshatë buke, a një post në shërbim të një bande kriminale. Ky e shiti veten e nderin dhe tani do të bëjë hyzmeqarin e gjirizit të PD. Si ky edhe të tjerët nuk dalin dot nga lëkura e tyre dhe do të vdesin në shërbim të gjithkujt, përveçse të popullit të vet.

- *Z. Rama përse nuk vini në Shqipëri të kontribuoni për demokratizimin e vendit, si në politikë dhe në jetën akademike?*

- E para, kush tha që nuk vij në shtetin shqiptar? Unë kaloj dy - tre muaj në vit në shtetin shqiptar me gjithë familjen dhe vij të paktën dy herë në vit. E dyta, unë kam punuar e punoj sa mundem për të bërë detyrën time qytetare. Kam botuar të parën reviste anglisht për shqiptarët në SHBA në vitet kritike 1996 - 1997. Kam botuar artikuj e intervista rregullisht. Kam botuar dy libra me analiza e studime për shqiptarët, më 2006 dhe më 2012 dhe po botoj një të tretë sëshpejti. Unë i kam ruajtur të njëjta bindjet që kam pasur në kohët kritike të vitit 1990. Mendoj se do të hap një gazetë online shqiptare me disa kolegë të mi nga 1 maji 2013. Kam ofruar ndihmën për të hapur një katedër të shkencave politike në Shkodër, në universitetin "Luigj Gurakuqi", me shpenzimet e mia, me njohjet e mia, jam ofruar të jap mësim falas atje. Më e bukura është se jam refuzuar nga nga të dy rektorët e atij universiteti dy herë për këtë ofertë timen. Jam ofruar të jap mësim në Universitetin e Tiranës pa shpërblim gjatë verës dhe jam refuzuar. Koha ime është shumë e shtrenjtë dhe në një vend ku nuk të duan, nuk ke si jep kontribute. Por libri ka shkuar në botimin e tretë, gjë që tregon se ka shumë interes.

Sa i përket jetës politike, unë kam një vend në historinë e këtij shteti. Nuk ma zë dot njeri, edhe pse për shumë vite kam qenë i censuruar haptazi e pa pikë turpi. Nga ana ime, kam qenë shumë i vetëdijshëm për çka kam kontribuar dhe jam munduar, me aq sa kam mundur, të mos e përlyej emrin dhe kontributin tim, me ndyrësitë e politikës shqiptare. Unë kam mbajtur të njëjtin qëndrim qysh në vitin 1990, gjithnjë kam thënë të vërtetën. Me e thanë të vërtetën është kontributi

më i madh që mund të japësh në këto kohë të mashtrimit. Po u desh ndonjë kontribut tjetër, unë jam nga ata që nuk i druhen asgjëje e askujt. Ata që më njohin e dinë se i kam dashur librat, por e kam njohur edhe rrugën e vështirë të përplasjes së pamëshirshme në të gjithë nivelet dhe me të gjitha mënyrat. Por unë nuk kam dëshirë të merrem me politikë në shtetin shqiptar. Unë i njoh kufizimet e mia si aktivist, nuk kam ambicie, politika nuk më jep kënaqësi, dua vetëm të them të vërtetën. Këtë më duket se e bëj mirë. Dua ta bëj sa më mirë që mundem, sepse me thanë të vërtetën, është shërbimi më i madh publik që mund të ofrojë një qytetar me kurajo civile.

- A duhet që shqiptarët e diasporës të kthehen të ndihmojnë vendin për t'u demokratizuar?

- Po. E para, ne nuk jemi diaspora. Ne jemi të mërguar politike dhe të tjerët janë të mërguar ekonomike. Ne kemi ikur për bindjet tona dhe po të na kapnin këta, do të na nisin në botën tjetër... E jo se nuk janë përpjekur ta bëjnë. Ai që ka lindur në SHBA është diasporë, ne jemi të dëbuar, jemi mërgimtarë të detyruar. E dyta, unë e shumë të tjerë si unë, jemi në lojën politike e jemi aktivë, por jemi shumë të censuruar. Se nuk bëhet lufta vetëm duke u rreshtuar pas njërit e tjetrit, por edhe me argumente e dije. Në Tiranë përhapet shumë mashtrim e pak e vërtetë. Kaq keq është gjendja, sa lufta bëhet me mbrritë njerëzit e ndershëm, ata që e dinë se i ka mbërthyer e keqja, por nuk dinë çka me ba. Vetëm kur njerëzit ta kuptojnë të vërtetën dhe të sillen ashtu si duhet, si atdhetarë e patriotë, të vendosin se do ta luftojnë të keqen, atëherë do të fillojë të ndryshojë gjendja. Atëherë do të mund të kontribuojmë edhe ne, ashtu si duhet e si i kemi mundësitë.

E treta, demokracia ka rregulla dhe mërgimtarët i njohin ligjet, i respektojnë. Por shteti shqiptar është kamp përqendrimit, është një sistem më fashist se ai i Hitlerit, në të cilin sundojnë klanet katundare që respektojnë vetëm lekun e fitimin. Kush dëshiron të kthehet në një kënetë ku ka vetëm hi-ena, gjarpërinj, krim e poshtërsi? Ata që kanë dështuar do të

kthehen dhe do të adaptohen, sepse nuk kanë ku ikin tjetër. Ata iu bashkohen strukturave shoqërore të parisë. Por pse duhet të kthehen e të bëhen pjesë e lojës, ata që kanë arritur të bëhen dikushi në vendet ku jetojnë? Pse duhet të kthehen e të merren me këtë llum që as nuk krahasohet me ndyrësitat e me llumin e shoqërisë në vendet ku jetojnë?

E sa për mërgimtarët e vërtetë politikë, ne po flasim e do të flasim. Por kur nuk na dëgjon njeri, atëherë pse duhet te vijmë? Që të shkojmë për dhjamë qeni dhe të humbim familjet, pasurinë dhe nderin? Kur të çohen në protestë njerëzit e ndershëm, sado pak që të jenë, të gjithë ne, por edhe diaspora, do të jetë me ta. Në këtë mizerje terri informativ e propagande të shfrenuar mashtrimi e manipulimi, nuk ka shans të mbërrish njerëzit e ndershëm. E ndryshimin duhet ta bëjnë ata, ne dhe diaspora duhet të ndihmojmë dhe do të bëjmë të pamundurën. Po e keqja është këtu, midis jush. Doktorit të ndihmon të luftosh kancerin. Po nëse ti vendos të pish duhan, nuk ka mjek që të ndihmon të shërohesh. Gjithkush duhet të luftojë të keqen dhe ne të gjithë kemi qenë e jemi me ju. Se njeriut i vdes nëna, por nuk i vdes Atdheu. E ky është Atdheu jonë, jo vetëm i këtyre maskarenjve.

- *Kush mendoni se do të fitojë zgjedhjet më 23 qershor?*

- Humbësi i madh është populli shqiptar. Fituese do të jetë paria e Tiranës dhe bota kriminale. Këta do të sundojnë edhe pak kohë. Por kriza e këtij sistemi është e pashmangshme. Këto zgjedhje janë si qetësia para furtunës e ciklonit. Në këtë vend ka dy zgjidhje e nuk ka rrugë të tjera. Ose do të triumfojnë banditët, hajnat e kriminelët dhe ky shtet do të bëhet Sodoma e Gomorra moderne, ose do të triumfojnë njerëzit e mirë që do të luftojnë të keqen dhe do të ndërtojnë një shoqëri normale. Por armiku i të gjithëve, paradoksalisht edhe armiku i vetvetes, është paria e Tiranës. Sepse këta janë të uritur dhe po hanë aq shumë, sa do të plasën. Fitorja e parisë në këto zgjedhje, është edhe fillimi i fundit të vërtetë për të, sepse nuk ka më as burime financiare, as mbështetje morale, as shpresë

në popull, as aleanca të huaja. Është vetëm kundër të gjithëve. Këta kanë dalë më fytyrën e tyre të vërtetë dhe ajo është e frikshme.

- Nëse Sali Berisha do të humbasë zgjedhjet, do të përçahet PD, apo do të marrë frymë? A duhet të largohet Berisha, nëse humbet?

- Ku do të shkojë ky zotni qyqari dhe ata qyqarët e banditët e tjerë në PD, PS, e në të gjithë partitë e tjera? Sali Berisha dhe gjithë të tjerët, që nuk marrin dot viza, bashkë me 400 000 hajdutët e Ali Babait të rreshtuar në partitë e parisë së Tiranës, nuk kanë ku ikin, sepse e dinë se herët a vonë do të vijë dita e gjykimit. Do të vijë se s'bën. E vetmja mënyrë që të mbijetojnë është të pinë gjakun e shqiptarëve dhe t'i mbajnë të skllavëruar në një kamp përqendrimi bashkëkohor, siç është shteti shqiptar. Këta janë ushunjëza dhe gjarpërinj, dihet se çfarë iu duhet bërë ushunjëzave dhe gjarpërinjve... Prandaj, në mungesë të alternativave, duhet të hidhet vota e protestës, "vota e bardhë". Qytetarët duhet t'iu bien vizë këtyre dhe të mendojnë për një organizim të ri, për një fillim të ri dhe ndryshe. Njerëzit nuk duhet të bien në kurthin e parisë. Arma e vetme që kanë, është vota dhe të gjithë duhet të respektojnë votën e tyre, sepse është e shtrenjtë. Por si humbën, si fituan, këta këtu do t'i kemi. Edhe kur të ikin këta do të kemi bandat e tyre, kartelet e trustet kriminale që kanë ndërtuar dhe i mbajnë gjallë. Këta nuk ikin ndryshe, përveçse me sherr dhe përplasja është në prag të derës. Është vetëm çështje kohe, por është e pashmangshme.

PËRSIATJE MBI PAKTIN E 1 PRILLIT DHE MARRËVESHJEN PS - LSI

Një ndër mësimet e para të politikës është se një politikan mund të ketë në mendje, (si pati, si s'pati mend) dy ide që e përjashtojnë njëra - tjetrën dhe të bindë veten se të dyja këto ide janë të pajtueshme e të zbatueshme njëkohësisht. Teknokrati del e thotë atë që duhet bërë dhe nuk ka dilema të tilla. Zyrtari duhet të zbatojë ligjin. Ndryshe nga këta, politikani del në publik dhe mundohet të bindë njerëzit se ka një rrugë të mesme. Dhe në proces e sipër, mundohet të shesë idenë që i shërben më mirë interesave që mbron.

Por në rastin shqiptar, nuk mjafton që politikanët të kenë dy ide të kundërta, nga të cilat njëra të jetë e pranueshme dhe tjetra më pak e pranueshme, por me pak finesë gjendet një zonë e hirtë ku pajtohen. Nuk mjafton që ato dy ide të jetë përjashtuese të njëra - tjetrës si vaji dhe uthulla. Nuk mjafton që këto ide as të mos ekzistojnë si mundësi për të ndërtuar politika shoqërore, ekonomike apo të jashtme. Në rastin shqiptar, këto ide duhet të shkojnë deri në marrëzi e në budallallëk të hapur. Sepse politikanët tanë shkojnë me mendësinë e njohur, shprehur qartë e saktë nga Artan Hoxha, si njëri prej tyre, "Këtyre katundarëve që na votojnë, kaq u duhet dhe e kuptojnë vetë kush është i forti e kush i dobëti. Ndërrojnë votën. Disa dhjetëra mijëra mjaftojnë".^[1]

Për t'u pranuar idetë e tilla, duhet jo vetëm politikanët të besojnë marrëzinë që thonë, por edhe të besojnë se në mendjen e tyre ne katundarët, jemi aq të trashë, sa ta besojmë me gojë hapur rrenën e mashtrimin e radhës. Në rastin shqiptar,

nga politikanët thuhet dy rrena të pakundërshtueshme dhe pritët që shqiptarët t'i besojnë pa hezitimin më të vogël.

Një shembull ideal

Pakti i 1 prillit u finalizua me një marrëveshje të nënshkruar në qytetin e Shkodrës. Por me gjithë fanfarën dhe përpjekjen për ta paraqitur si një përpjekje të internacionales socialiste dhe prania e shumë personaliteteve si Boris Tadiç, Maria Fanjon etj., që dukeshin gjigandë prapa figurës imcake të Taulant Ballës, shërbeu për ta përforcuar këtë përshtypje. Në thelb kjo ishte një marrëveshje për ndarjen e tortës së pushtetit. Jam i bindur se nuk e ka përkthyer kush në serbisht apo në sllovenisht, por në greqisht nuk ka nevojë sepse Vangjeli e ka gjuhën e mëparshme të babait, e kupton mirë se ka shkuar në shkollën shqipe dhe ka shumë gjasa të jetë përkthyer nga greqishtja në shqip. Ajo që u nënshkrua ishte një dokument që tregonte se këta nuk kanë asnjë vlerësim, asnjë respekt për njerëzit, asnjë dëshirë për shërbim publik. Kjo ishte një marrëveshje për numrat e përqindjet, por që duhej vetëm për të justifikuar llogarinë e ftohtë. Ka një numër idesh e bindjesh idiosinkratike që përjashtojnë njëra - tjetrën dhe vërehen në këtë dokument të rëndësishëm, deri në momentin që u nënshkrua. Sepse pasi u nënshkrua u pa që nuk ishte as dokument, as program, por një hallvë ballkanike e gatuar me shpejtësi marramendëse.

Idetë qesharake nuk kanë të numëruar, por këtu do të ndalemi te më kryesorja, te boshti i marrëveshjes. Çfarë duan këta? Këta duan që të na evropianizojnë. Me një vizion evropian, të bëjnë Shqipërinë evropiane dhe më evropianët që qen kemi ne. Por meqë ne nuk jemi evropianë, një nga idetë më idiosinkratike në këtë pakt të alambikuar, është ky koncepti i "Shqipërisë evropiane". Gjeografikisht mund të numërohem si pjesë e kontinentit evropian, por në nivel të qytetërimeve e të vlerave, nuk kemi asgjë evropiane, nuk jemi pjesë e BE,

përveçse si territor limitrof që shkakton probleme. Çfarë lidhje ka Skrapari me Evropën, more aman? E vetmja gjë që të shkon ndërmend është Mustafa Nanaj. E dyta dhe deri te e tridhjetë e shtata, sepse aq janë edhe kapitujt e marrëveshjes së Stabilitizimit Asocimit, përveç faktit që jemi shtet i njohur ndërkombëtarisht dhe që e përmbushim si kusht, ne nuk përmbushim as edhe një kusht tjetër. Ne nuk kemi shtet funksional e ligjor. Ne nuk kemi shtet - komb me identitet e vlera. Ne nuk kemi administratë ligjore. Ne nuk kemi qytetari e shoqëri civile. Ne nuk kemi industri që eksporton e prodhon. Ne nuk kemi bujqësi që ushqen vendin. Ne nuk kemi asgjë që të në bëjë evropianë. Edhe më keq. Kemi droga. Kemi krim. Kemi poshtërsi. Kemi zvetënim. Kemi plehra. Kemi borxhe. Kemi trafikë. Kemi mafia. Kemi papunësi. Kemi një ambient të shkatërruar. Kemi universitete dhe studentë. Kemi doktorë e profesorë për kariaturë, për gazetë muri dhe për fletërrufe. Shkurt e seriozisht, ne nuk përmbushim asnjë kusht, more asnjë për be!

Për më tepër, Evropa na ka thënë se nuk na pranon edhe 15 vjet. Tash që zoti Meta ishte në Qeverinë e Integritimit Evropian, për katër vjet të gjatë, kur vendit iu lëpinë edhe kockat dhe nuk ka ngelur asgjë për të vjedhur lirshëm, BE e hodhën poshtë kërkesën për asociim. Ne nuk përmbushim asnjë nga kushtet për të qenë evropianë. Po çfarë janë këto përralla për Shqipëri evropiane? Megjithatë, këta e kanë futur kokën në rërë dhe hedhim shashka të tilla që nuk i blen njeri. Ne nuk jemi as Napoli, jo të duam të hyjmë në Evropë. Megjithatë, ne do të hyjmë në Evropë kur të hyjë Turqia, se grekët po dalin vetë. Por komedia është se për të mbajtur grekët në koalicion, flasin për Shqipëri evropiane.

Në vend të përfundimit

Pakti i 1 prillit, i formalizuar në qytetin e lashtë të Shkodrës, tregoi qartë e hapur se këta na marrin për të marrë e për katundarë. Marrëveshja tregoi se këta as nuk mërzhiten

se çka mendojmë ne. Si tha Artan Hoxha për mbështetësit e PS duke i krahasuar me të PD, “Edhe këta si katundarët tanë qenkan, shkojnë me erën”. [2] Se ne na ka ngordhur gomari me kohë, e s’po mund të bëhemi as si Greqia, e këta kallzojnë përralla me bashkim kombëtar, integrim evropian dhe shërbim kombëtar duke punuar për interesat e vetvetes. Ndoshta këta kanë shpresë se do marrim gomarin e ngordhur dhe ta bëjmë sallam për eksport. I fusim pak groshë, pak miell të bardhë e pak hashish Lazarati dhe ia vëmë emrin “Sallam evropian”.

[1] Artan Hoxha, “Fajet e Saliut”, “Panorama”, 20 prill 2013.

[2] Hoxha, *Ibid.*

PAZARI I ZGJEDHJEVE DHE KOALICIONET, BANDAT MË TË MËDHA TË HAJNAVE NË HISTORINË E SHQIPTARËVE

Ndërtimi i pazareve zgjedhore nga ana e parisë së Tiranës ishte një proces që ka treguar përfundimisht katër gjëra.

Së pari, paria e Tiranës, të gjithë pa përjashtim, janë në politikë jo për të shërbyer, jo për të ndihmuar, jo për të drejtuar, po për të vjedhur shtetin, për të vjedhur e për të grabitur.

Së dyti, të gjithë nuk kanë as ideologji, as vlera morale, sepse nuk shihet asgjë në këtë lojë që të bind, se këta e bëjnë këtë punë për vlera e për moral, përveçse materializmit ekstrem.

Së treti këta mendojnë të gjithë njëloj e janë hapur në lojë për të shitur nderin e shqiptarëve, se vetë nuk kanë ç'të shesin më dhe nuk do të ndalen deri në fund. Fundi është kur të mos kemi më as trup, as pasuri e as shpirt.

Së katërti, alternativa e vetme është kundërvënia, me të gjithë mënyrat e mjetet sa më demokratike, që nga bojkoti, te rezistenca paqësore e me rradhë. Për të ilustruar argumentin e mësipërm do të ndalem pak te përbërja e koalicioneve, qëllimet e tyre, prijatarët, në veçanti te paradokset më të spikatura të formimit e të funksionimit të tyre në nivelin ideologjik.

Përse ndërtohen koalicionet partiake?

Çfarë janë koalicionet? Koalicionet partiake janë marrëveshje ndërmjet partive për të arritur qëllimet e përbashkëta, duke synuar marrjen e pushtetit dhe influencimin e politikave shtetërore përmes fitores në zgjedhje dhe qeverisjes. Por ko-

alicionet midis partive nuk janë si koalicionet midis shteteve. Shtetet duan të mundin një shtet tjetër dhe sa zgjidhet problemi, mandej ndjekin politikat e tyre. Partitë nuk mund të shkojnë në rrugën e tyre, sepse zgjedhjet i kanë fituar bashkë dhe po u ndanë në objektiva e në drejtime, bjen qeveria. Pra, qëllimi për ndërtimin e koalicioneve ndërmjet shteteve është që t'iu kundërvihen dikujt, e qëllimi ndërmjet partive për ndërtimin e koalicioneve është punojnë bashkë për një qëllim, deri në zgjedhjet e tjera.

Për të pasur një koalicion të tillë partiak, partitë duhet të bien dakord për arritjen e një objektivit politik të përbashkët.

Së dyti, partitë duhet të kenë besim se edhe të tjerët janë të përkushtuar të arrijnë të njëjtat objektiva.

Së treti, koalicioni duhet të ketë mekanizma për të zbutur e pajtuar dallimet që mund të ekzistojnë në gjuhë, tradita, taktika e në kulturën e partive të ndryshme. Më në fund, partitë duhet të kenë drejtues të besueshëm që të ofrojnë garancinë për suksesin e koalicionit. Koalicionet partiake pra, janë disi afatgjata, më e pakta jetëgjatësia e tyre shkon deri në zgjedhjet e tjera. Cilatdo që janë arsyet, prapë nuk ka kontradikta kaq përjashtuese e kaq paradoksale, sa në rastin tonë.

Paradokset programatike

Së pari, këta nuk kanë vlera, ideologji apo botëkuptime të qarta që të na drejtojnë në rrugën e duhur. Shihet qartë, shumë qartë nga paçavuret e paraqitura si dokumente që rregulluan marrëveshjet e tyre. Konceptet e përdorura janë kontradiktore, përjashtuese të njëra - tjetrës e me radhë. Sepse në këto materiale flitet për integrim evropian, bashkim kombëtar dhe mbrojtje të interesave rajonale. Flitet për lulëzim ekonomik dhe përmenden globalizmi dhe integrimi. Flitet për mbrojtjen e qytetarëve dhe ekonominë, por gjithçka është e mbështetur te tregu i lirë dhë kështu me radhë. Meqë këtë problem e kam trajtuar më parë, nuk po përqëndrohem këtu. Aq më shumë

që këto kontradikta e mospajtimit do të bëhen shumë më të dukshme në të ardhmen e afërt. Të gjithë flasin për integrimin evropian, por ja një deklaratë qesharake nga Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim: “Ne jemi të angazhuar për të siguruar mirëqenien e të gjithë shqiptarëve pa dallim, kudo ku jetojnë, nëpërmjet thellimit të aleancave të NATO, inkurajimin e vlerave euro - atlantike dhe ndërtimin e një marrëdhënieje të veçantë me Kosovën, që shkon përtej miqësisë”. Pra, të thellohen aleancat e NATO...

Paradokset në aleanca

Së dyti, këta nuk kanë vlera ideologjike. Po hiç fare! Kjo shihet nga fakti se boshti i pazarit është shitblerja e posteve ne shtet. Ja për shembull, të marrim marrëveshjen e PS me partinë e grekëve, që është strumbullari i gjithë koalicionit të ndërtuar prej tyre. Grekët kanë një qëllim të vetëm, nga i cili nuk kanë hequr dorë asnjëherë. Nuk është përparimi i kombit shqiptar apo mbrojtja e interesave të shqiptarëve. Grekët nuk e njohin Çamërinë, kërkojnë Vorio Epirin, regjistrimin e bërë nga shteti shqiptar e quajnë mashtrim, bëjnë diversione të çdo lloji që minojnë sovranitetin e shtetit shqiptar e me radhë. Kjo është e drejta e tyre dhe ligji ua njeh këtë të drejtë. Është e drejtë e PS dhe e Edi Ramës që të bëjë koalicion me grekët.

Por pyetja është çfarë duan në aleancën e PS këta individë dhe parti që janë betuar e që na lehin përnatë në televizione e gazeta se duan të mbrojnë interesa që iu bien ndesh grekëve dhe programit të tyre? Çfarë duan në aleancë me grekët njerëz e parti si ky kryetari i “Partisë për Unitet Kombëtar”, Idajet Beqiri që na flet për unitet e për bashkim kombëtar?! Çfarë don “Partia Aleanca Popullore” e kryesuar nga Artur Dojaka që me demok do të mbrojë çështjen çame, në një koalicion me grekët?! Po ky zotëria Bujar Shurdhi, që është në krye të partisë së “Çështjeve Shqiptare”! Mirë këta, por çfarë duan në këtë koalicion këto partitë e tjera si “Partia Aleanca Arbnore

Kombëtare”, “Partia e Pajtimit Kombëtar Shqiptar”, mbi të gjitha, “Partia Shqiptare Atdheu Kreshnik”?! Pyetja është se çfarë duan parti të tilla, që kanë një ideologji nacionaliste ekstreme, në një aleancë me PS?

Ja edhe një shembull tjetër që këta nuk kanë fare vlera ideologjike. Marrëveshja PS - LSi flet për mbështetje biznesit të madh, globalizmin, kapitalizmin dhe është një marrëveshje kot, që nuk ka asgjë proletare në të. Nuk e ka një fjalë për të drejtat e punëtorëve. Çfarë duan në këtë koalicion “Partia Komuniste Shqiptare”, “Partia e Punës Shqiptare e Reformuar”, “Partia Social Punëtore e Shqipërise” apo “Partia Komuniste Shqiptare 8 Nentori”? Këto parti janë të gjitha enveriste. Për çfarë janë në politikë këto parti, për një vend këshilltari në Ministrinë e Ekonomisë? Edi Rama është për mbrojtjen e biznesit, jo të fukarait.

Lëre më kur sheh një listë me parti kristiane apo demokristiane që mbështesin këtë aleancë, që në thelb duhej të ishte e majtë dhe socialiste, por që nuk është as njëra, as tjetra.

E vetmja parti e pranueshme është “Partia e Personave me Aftësi të Kufizuara”. Këtyre mund t’iu falet zgjidhja, sepse kanë hallin të zgjidhin problemet e atyre që nuk shohin, nuk janë në gjendje apo që janë të diskriminuar.

E njëjta gjë është edhe nga pala tjetër. Çfarë do në një koalicion politik të ashtuquajtur republikan “Lëvizja e Legalitetit”, një parti që kërkon të vendosë në fron mbretin, në bazë të një ndodhie të vitit 1925, aq më shumë kur pretendenti për fronin është këshilltar i presidentit republikan?! Mandej, për çfarë vlerash kombëtare e shqiptare flet edhe ky koalicion, në veçanti parti si partia e Shpëtim Idrizit që mbron çështjen çame apo shtatë partitë e tjera, me demek nacionaliste? Se edhe këta i kanë grekët në koalicion. Këta kanë jo një, por dy parti pakicash, një parti greke e një parti që nuk gjindet kund në botë, “Aleanca e Maqedonasve për Integrim Evropian”. Nuk ka problem që është ndërtuar një koalicion i tillë. Problemi është se marrëveshje të tilla, me parti që kanë

një bazë dhe një agjendë etnike të papranueshme nga partitë e tjera, tregojnë se pika e pajtueshmërisë së koalicionit nuk është ideologjia apo vlerat, por interesat e ngushta të njerëzve që nuk janë aspak të sinqerta.

Paradokset e përplasjeve mes prijatarëve

Problem tjetër jashtëzakonisht i rëndësishëm është mungesa e kredibilitetit të prijatarëve. E shkuara e tyre është e mbushur me probleme që gjithkund tjetër do ta nxirrnin dikë nga politika. Sepse të gjithë këta kanë një të shkuar që nuk ka filluar në vitin 1990, por shumë e shumë kohë më parë. Por pas vitit 1990, dolën në pah të gjitha mangësitë dhe krimet e tyre. Këta nuk kanë lënë gjë pa thënë për njëri - tjetrin, brenda koalicioneve gjen dyshe që e kanë sulmuar njëri - tjetrin deri në pikën e fundit. Se po të mendohet sesa egër e kanë luftuar njëri - tjetrin Edi Rama dhe Ilir Meta, Skënder Gjinushi dhe Paskal Milo, Nard Ndoka dhe Nikollë Lesi, Sali Berisha dhe Shpëtim Idrizi, këto koalicione nuk kanë fare kuptim.

Problemi tjetër është se të gjithë këta, kanë në kurriz një barrë krimesh që nuk ka det t'i lajë. Këta e kanë çuar vendin e shtetin deri në këtë pikë, kanë humbur shansin historik të tranzicionit. Dhe më e keqja është se po ndeshemi në fundin e frikshëm të tranzicionit dhe atëherë do ta kuptojmë se çfarë rasti historik kemi keqpërdorur e abuzuar.

Si shpjegohen paradokset e koalicioneve

Koalicionet e ndërtuara nga paria e Tiranës janë krejt paradoksalë. Në këto koalicione janë përfshirë parti e grupe që ndjekin agjenda të papajtueshme, gjë që tregon se këto nuk janë koalicione normale. Kjo tregon se këta kanë diçka tjetër që i bashkon dhe ajo që i bashkon nuk është ideologjia apo vlerat, por interesi i ngushtë. Dhe ky nuk është interesi i elektoratit, por interesi i tyre material, marrja e një rroge,

shfrytëzimi i një posti dhe vjedhja e shtetit. Ky është një interes që do të përmbushet vetëm e vetëm nga kontrolli i makinës shtetërore. Shembullin më të bukur e dha Nikollë Lesi. Në mengjez shkoi në Spitën dhe iu tha votuesve që i delte llogaria të shkonte me Ramën. Kur u kthye ne Tiranë nënshkroi marrëveshjen me Berishën! Paradokset e koalicioneve janë të dukshme dhe shqetësuese. Por lufta e parisë është pikërisht që të mos lejojë askënd të gjykojë me qetësi e me vëmendjen e duhur atë që po ndodh.

Sepse si pakti PS - LSI, i arritur pas pakteve të bëra me partitë e vogla e të tjera, ashtu edhe pakti i PD me të "vetët" tregon se këtu është bërë thjesht pazar për vende pune. Po more 500 vota, ke një këshilltar lokal. Po morë 10000 vota ke një ministër. Por të tjerët? Të tjerët, me këto emra bombastikë, nuk kanë asnjë ideologji të qartë, as vlera të qarta, as bindje politike. Pazarit është 50 vota 5000 euro, 500 vota një vend pune si këshilltar apo drejtor e ashtu vidh 500 000 euro dhe 10 000 vota një ministër të kesh mundësinë të vjedhësh si Ilir Meta (që doli i pafajshëm) 700 000 euro për shtatë minuta. Pra, nuk është një marrëveshje për të shërbyer, por për të marrë e për te vjedhur. E njëjta nga ana e PD. Aleancat e koalicionet janë shitja e votave për mundësinë e vjedhjes së shtetit shqiptar. Rrahjet e sharjet në publik maskojnë keq marrëveshjen që është bërë. Këta janë bashkë. Këta e kanë ndarë tortën. Kjo që po ndodh është një përpjekje me u hedhë njerëzve trutë e gomarit. Si tha Artan Hoxha, "Këtyre katundarëve që na votojnë kaq u duhet dhe e kuptojnë vetë se kush është i forti e kush i dobëti".

Zgjidhja?

Zgjidhja është bojkotimi, "vota e bardhë", vota kundër, ndërtimi i një koalicioni qytetar për liri e demokraci. Këtu duhen bërë bashkë këto grimcat e shoqërisë civile që synojnë ikjen nga kontrolli i parisë. Ose duhen mbështetur alternati-

vat që janë jashtë strukturave të këtyre, si dy partitë që do iu krijojnë probleme të dy koalicioneve FRD e AKZ, ose duhet ndërtuar një strukturë civile me inisiativat “Bjeri vizë”, “Vota e bardhë,” lëvizja “Vota e protestës”, “Hiq kryq,” blogun “Demokracia direkte” dhe me mua e të tjerët që kemi thënë tash sa vite “Bojkot: vota shkon kot”. Sepse nuk ka më zgjidhje të tjera. Po nuk u veprua kështu, këta prijatarë të parisë së Tiranës do të dalin e do thonë ju na e dhatë të drejtën të bëjmë të keqen që bëmë, sepse ne kaq ditëm, nuk kishte të tjerë dhe ju na zgjodhët, nuk iu detyruam ne. Se ja shih, edhe koalicionet që kemi ndërtuar, ju i zgjodhët!

NË KAHE TË KUNDËRTA REALITETI VIRTUAL DHE REALITETI JETËSOR SHQIPTAR

A po ecin në kahe të kundërta shqiptarët dhe paria që i sundon? Pakti i 1 prillit, ndërtimi i bandave të Ali Babait, të ashtuquajtura koalicionet e partive politike dhe mbajtja ndezur e zjarrit të sherrit ndër shqiptarët, në thelb kanë një synim të vetëm. Të detyrojnë qytetarët shqiptarë të dorëzohen e të pranojnë gjendjen si të pandryshueshme. Vetëm atëherë këta do të mund të sundojnë si duan vetë.

Por duket qartë se hendeku ndërmjet qytetarëve dhe sundimtarëve të parisë së Tiranës është i pakapërcyeshëm. Nga pamjet e deklaratat e politikanëve ofrohet një realitet virtual ku gjithkush jeton i lumtur, ka një të ardhme dhe situata është e “shkëlqyer” dhe “do të bëhet edhe më mire”. Nga ana tjetër, njëri nga institucionet e parisë së Tiranës, Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare, sapo botoi një pyetësor, “Demokracia shqiptare në prag të zgjedhjeve të përgjithshme”. Duke gjykuar nga çka është përzgjedhur e botuar në shtyp dhe duke i marrë të dhënat e paraqitura në gazetatat e ndryshme si të mirëqena, mund të thuhet se në mos tjetër, ky pyetësor provon pikërisht ekzistencën e një realiteti tjetër jetësor. Për të kuptuar ku jemi duhet ndalur sadopak në analizimin e kësaj gjendjeje papajtueshmërie midis realitetit virtual të parisë dhe realitetit jetësor të shqiptarëve.

Një vështrim i shpejtë

Pyetësori pyeti 1200 vetë në 12 qytete. Kjo është e rëndësishme, sepse në fshatra gjendja është shumë më keq në të gjithë

drejtimet. Ky pyetësor nxori në pah gjendjen reale të shqiptarëve në disa drejtime kryesore në të cilat po ndalem, sepse dua të bëj interpretimin tim, qoftë edhe me këto të dhëna të pjesëshme. Sa për iltutrim të argumentit, do të ndalem te ekonomia, ndjenja kombëtare, emigracioni dhe votimi. Edhe sikur të mos merret parasysh shkalla e lartë e mosbesimit shoqëror dhe të besohet se të gjithë kanë thënë të vërtetën, edhe sikur të mos mbahet parasysh se ky pyetësor është shpërndarë në qytete jo në fshatra e në zonat e thella, edhe sikur të kihen rezerva lidhur me pyetjet që mund të ishin formuluar ndryshe, prapë pyetësi ka vlera të padiskutueshme.

Ekonomia

Në fushën ekonomike, 25 % e njerëzve thanë se shqetësimi kryesor i tyre është papunësia. Pse do të shqetësohen njerëzit, nëse nuk janë pa punë apo nëse nuk e kanë dikë në familje që është pa punë, siç është bie fjala, djali apo vajza, nusja apo dhëndri? Si i bëhet që mund të kenë dy të papunë? Vetëm 5 % thanë se jetojnë mirë. Kjo është shenjë e qartë që në shtetin shqiptar ka oligarki ekonomike. Se ka shumë të dhëna të tjera, jo nga ky pyetësor, që e konfirmojnë këtë. Për shembull, gjysmën e depozitave bankare, 4 miliardë euro, i kanë 4 % e popullatës. Po të qëmtosh të dhënat, del gjithkund ky 5 % si mesatare e atyre që jetojnë mirë. Dhe këta janë oligarkët politikë, ekonomikë, sipërmarrësit, pronarët e bizneseve të mëdha dhe të mesme. Kjo është edhe mjaft relative, sepse shumë njerëz e konceptojnë të jetuarit mirë ndryshe nga jashtë vendit e në krahasim edhe me të shkuarën.

Rreth 40 % e njerëzve thanë se bëjnë një jetë mesatare. Koncepti i jetës mesatare nuk është fort i qartë. Megjithatë, mund të thuhet se këta njerëz nuk mendojnë se e kanë jetesën të mirë. Me sa e kuptoj unë gjendjen, jetesë mesatare do të thotë të kesh një punë, një makinë, apartament, ca kursime dhe të mund të shkosh me pushime diku. Këta janë mësuesit,

profesorët, zyrtarët, nëpunësit, të punësuarit në firma të ndryshme, profesionistët e rinj e me radhë. Këtu hyjnë edhe dyqanxhinjtë e mesëm e të vegjël etj. Ajo që nuk ceket është vetëperceptimi se jeta e tyre është mesatare, nuk është më e mira, por nuk është as ëndrra e tyre. Modestia e tyre shkon deri diku, sepse në fakt këtu ka një element vetëcensurimi që është krejtësisht i prekshëm. Ndryshe nuk ka arsye që numri i atyre që duan të emigrojnë po iu dha mundësia, të jetë 66 % e shqiptarëve. Jetesa e këtyre njerëzve është shumë e paqëndrueshme dhe këta ndjehen të pasigurtë.

Kësaj i shtohet edhe fakti që 28 % e njerëzve deklaruan se mungesa e të ardhurave është problem kryesor për ta. Kjo përkon edhe më numrin e 33 % e njerëzve të pyetur që thonë se jetojnë në kushte të këqia. Zyrtarisht në shtetin shqiptar papunësia urbane është rreth 13.4 % dhe rreth 7.4 % e popullsisë jetojnë nën nivelin e varfërisë, domethënë me një dollar e gjysmë në ditë për familje. Pra, shifrat e dhëna nga shteti, fshehin një realitet tjetër shumë tronditës, sepse një ndër tre shqiptarë të rritur, jeton keq. Dhe në mendësinë shqiptare, me jetue keq, don me thanë mos me pasë bukë me iu dhanë fëmijëve. Standarti i nivelit të jetesës është i ulët dhe pritja që kanë njerëzit për një jetë normale është po ashtu e paktë. Kjo fsheh masën e madhe të të varfërve. Ata që janë mësuar të jetojnë me bukë të gatuar në shtëpi, e të hanë groshë e djathë, nuk ankohen kaq lehtë. por edhe ankimi i tyre ka vlerë.

Prandaj ai numri që përkon dhe që duket më i sakti, është përqindja e shqiptarëve që mendojnë se gjendja ekonomike është e keqe. 66 % e njerëzve mendojnë se gjendja ekonomike është e keqe. Këtu hyjnë jo vetëm të papunët, jo vetëm ata që jetojnë keq, por edhe një pjesë shumë e ndjeshme e atyre që deklarohen se e kanë "jetesën mesatare". Sepse po 61 % kërkojnë që të emigrojnë, në iu dhëntë mundësia. Po si është gjendja në fshat? Kjo as guxohet të marret me mend. Kjo pamje e gjendjes në zonat urbane është më shumë se shqetësuese. Në katundet shqiptare, gjendja është për faqe të zezë.

Ndjenja kombëtariste

Paria sunduese e Tiranës është hedhur në një fushatë të egër kundër kombëtarizmit ndër shqiptarët. Koalicioni i drejtuar nga PS ka vendosur të zhvillojë një fushatë të egër ndaj “nacionalizmit primitiv” dhe të punojë për afrimin me Greqinë e me Serbinë, gjithnjë duke propaganduar kauzën e dështuar të integrimit evropian. Po ashtu edhe koalicioni i drejtuar nga PD ka premtuar “më shumë se miqësi me Kosovën”, po kjo është më pak se të jesh vëlla me turqit dhe me italianët, siç është deklaruar kryeministri. Të dy palët flasin për integrimin evropian si mantra e zgjidhjes së probemeve shqiptare, por ky është një objektivi i paarritshëm. BE e ka bërë të qartë se ka lodhje nga integrimi dhe nuk do të ketë zgjerim deri pas vitit 2025. Këta flasin ende për integrim.

Pamja që del nga ky pyetësor është e kundërta e propagandës së parisë, gjë që ka shumë rëndësi. Një ndër tre të anketuar, 32 % e tyre, deklaroi se shteti shqiptar përballet me rrezikun e jashtëm imediat e jetik që mund të vijë nga një shtet tjetër, që në këtë rast është ose Greqia, ose Serbia. Numri i vogël i njerëzve që mendon se rreziku vjen nga këto vende fqinje, shpjegohet me shkallën e lartë të besueshmërisë që kanë shqiptarët te NATO dhe te SHBA. SHBA dhe përmes tyre NATO, shihen si garancia e ekzistencës së shtetit shqiptar. Po ashtu, duke qenë se këto dy shtete janë në krizë të thellë, shqiptarët nuk besojnë se përbëjnë rrezik imediat për shtetin shqiptar.

Në vitin 1992, vetëm 19 % e shqiptarëve në shtetin shqiptar besonin se bashkimi me Kosovën ishte një gjë e mirë, ose pozitive. Në vitin 2013, 49 % e shqiptarëve në shtetin shqiptar, mendojnë se bashkimi i Shqipërisë me Kosovën është gjë pozitive. Kurse 29 % nuk kanë ndonjë opinion të fortë as pro, as kundër. Kjo do të thotë se 80 % e shtetasve në shtetin shqiptar ose e mbështesin, ose e pranojnë bashkimin midis

Kosovës e Shqipërisë si diçka normale. Për më tepër, 55 % e të pyeturve u deklaruan se në rast të një referendumi, do të votonin pro bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Ishte interesante se 14 % e të pyeturve deklaruan se do të votonin kundër bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, por vetëm 10 % e shohin bashkimin e Kosovës me Shqipërinë si zhvillim negativ.

Këto të dhëna tregojnë qartë e pa shumë mëdyshje se bindjet politike të parisë dhe bindjet politike të shqiptarëve, nuk përputhen. Shqiptarët po shfaqin një ndjenjë kombëtariste shumë të fortë. Dhe kjo do duhet të reflektohet edhe në agjendat politike, sepse identiteti është thelbi i sjelljes së individit në politikë. Por agjendat politike të parisë nuk janë prioritetet e shqiptarëve. Ky pyetësor tregoi qartë se përpjekja e parisë për të shtyrë e për të shitur agjendën e integritit evropian, kur Evropa nuk na don, nuk i kemi përmbushur kushtet dhe kur jemi në një krizë të thellë, nuk është prioriteti i shqiptarëve. Ka një laithitje këtu. Nuk po them se është një agjendë kombëtariste, por ama bindjet kombëtariste janë të dallueshme, në rritje dhe që nuk mund të injorohen lehtë.

Emigrimi

Barometri i lumturisë kombëtare, i pranimit të gjendjes si të kënaqëshme për çdo popull, është qëndrimi i njerëzve ndaj emigrimit. Kur një shoqëri është mirë, kur njerëzit kanë shpresë, kur jeta është normale, atëherë askush nuk kërkon të emigrojë. Aq më pak ne, një popull që jemi gjendur gjithnjë në fundin e shoqërive të avancuara ku kemi përjetuar të 1001 të këqijat. Emigrimi për ne shqiptarët është një nga gjërat më të fundit që duhet të na shkojnë ndërmend. Sepse ku do të shkojnë njerëzit? Kështu si janë punët, deri tani na janë kthyer rreth 225 000 emigrantë. Këtë verë priten edhe 300 000 - 400 000 të tjerë të kthehen.

E megjithatë, ajo që të pikon në shpirt, është se ky pyetësor tregoi se në ç'gjendje të keqe jemi si popull e si shtet. Kur u py-

etën “po të kishit mundësi të largoheshit nga Shqipëria, a do ta kishit bërë një gjë të tillë?”, anketa tregoi sa keq është gjendja; 61 % e të pyeturve thanë se do të ishin larguar nga Shqipëria. 28 % thanë se nuk do të ishin larguar dhe të tjerët thanë se nuk dinin çdo të bënin. Pra, vetëm një ndër katër qytetarë dëshëron të jetojë në shtetin shqiptar. Dhe kur shihet përbërja e popullsisë, mund të thuhet me siguri se në këtë 28% hyjnë oligarkët, sipërmarrësit, tregtarët, zyrtarët që janë në gjendje dhe profesionistët, ata që jetojnë mirë. Por kjo është një gjendje e mjerë. Sepse qëllimi i politikës është të mund të sigurojë një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët, jo të krijojë mundësinë që ata të degdisen e të ikin nga shtëpitë këmbët në mërgim.

Votimi dhe besimi në sistemin politik

Ky pyetësor tregoi se shqiptarët kanë besim në procesin zgjedhor, edhe pse nuk kanë besim te partitë politike. 40 % thanë se zgjedhjet nuk ndryshojnë gjë dhe po kaq përqind thanë se zgjedhjet nuk do të jenë të lira dhe të ndershme. Një shenjë e qartë se kjo masë e votuesve i sheh palët e parisë politike si të padallueshme nga njëra - tjetra dhe nuk ka fare besim në sistemin politik. 18 % e njerëzve thanë se do ta bojkotojnë sistemin, shenjë e qartë kjo, se tashmë paria ka një masë të madhe të qytetarëve që nuk i pranojnë zgjidhjet e ofruara prej saj dhe nuk kanë besim në sistemin politik. Megjithatë, shqiptarët janë të gatshëm jo për të votuar siç është interpretuar, po për të votuar nëse me votën e tyre arrijnë të ndërrojnë diçka. Është me të vërtetë shpresëdhënëse për një popull, në të cilin 71 % e qytetarëve janë të gatshëm të përdorin votën si armën për të përmirësuar gjendjen. Ndjenja e përgjegjësisë qytetare është me të vërtetë e lartë. Edhe pse ky përfundim i bjen krejt ndesh praktikës së njohur të shitjes së votës për një thes mielli, të gjithë ne duhet të lexojmë më thellë. Po iu dha mundësia shqiptarëve për të votuar, ata do të votojnë.

Nëse duhet me zgjedhë vetëm e vetëm midis palëve të parisë, hëpërhë, ata do të zgjedhin thesin e miellit, gjelin e detit dhe zgjidhjen e problemeve të vogla e jetike.

Realiteti virtual

Në sipërfaqe duket sikur shoqëria shqiptare është e pajtuar me gjendjen ekzistuese. Kur sheh televizionet, kur lexon gazetat, kur dëgjon politikanët, por edhe kur flet në kafene, të gjithë përsërisin në forma të ndryshme refrenin: “Mirë jemi, desh Zoti, s’kemi kenë ndonjë herë ma mirë, ma mirë bane, por mos e prish”.

Por ky pyetësor flet ndryshe.

Ky është realiteti virtual, sepse sa i gërmon apo ngacmon pak, njerëzit nisin të hapin thesin e halleve dhe çka nuk të thonë. Po nuk patën besim të thonë “Mirë, mirë, çka, jo keq”. Dhe të gjithë janë ekspertë për futbollin e për motin, për makinat e për çmimet. Po ky pyetësor flet ndryshe; njerëzit e duan ndryshimin, por kanë frikë. Paria këmbëngul se arrijtet e sistemit janë në nivele të larta ndërkombëtare, se jemi i vetmi vend që nuk njeh krizën dhe pasojat e saj, se... etj., etj.

Por ky pyetësor flet ndryshe.

Njerëzit e thjeshtë të nisin fotot e dasmave, të makinave, të pushimeve, të zifafeteve dhe kuriozitetet nga ndeshjet e futbollit. Hyrë në të gjithë emisionet dhe gjithkush është e duket i lumtur, që nga velinat, deri te Ardit Gjebrea. Gëzimi televiziv shqiptar ia kalon edhe atyre që fitojnë telebingon italiane. Hareja nuk ka të sosur dhe gjendja duket “s’kemi qenë ndonjëherë më mirë”.

Por ky pyetësor flet ndryshe.

Në botë zemë shumë vende të para; Të gjithë kafenetë janë të mbushura deng me klientë, jemi njëjsh/njësh në mumërin e shtretërve për frymë të moteleve njëorëshe, karriket e restoranteve, kafeneve, kamerierët, studentët dhe profesorët, të burgosurit jashtë shtetit, emigrimin, trafikimin e femrave dhe

të fëmijëve, sallat e kumarit, e shumë e shumë tregues të tjerë të lumturisë kombëtare në tranzicion.

Ky pyetësor flet ndryshe.

Në nivelin ideologjik na thuhet se e gjithë bota është kështu, se ky është normaliteti dhe se kjo është e tashmja dhe e ardhmja. Ky është realiteti virtual i Rrethit të Ferrit, një realitet që shihet vetëm brenda unazës së Tiranës. Dhe në sipërfaqe të gjithë duken të pajtuar me gjendjen.

Por ky pyetësor flet ndryshe.

Realiteti jetësor

Ky pyetësor flet ndryshe dhe gjen mbështetje edhe në media, por edhe nga pervoja e raportet anekdotike. Duke dashur të përlyejnë palën tjetër, paria rregullisht mbush faqet e shtypit me një anë të frikshme të shoqërisë shqiptare. Në shtetin shqiptar vidhen fshatrat e shtëpitë, grabiten e trafikohen fëmijët, theren njerëzit si berrat, grabiten varëset dhe unazat nga qafat dhe nga gishtat, ka plasur prostitucioni dhe horllëku, kumari dhe kurvnimi politik dhe jetët e njerëzve janë të shkatërruara. Por përtej degjenerimit masiv, duhet cekur shpejt e shpejt se ekonomia ëshë e kapur, monopoliste, struktura e shoqërisë është thellësisht klanore - katundare, sistemi politik është oligarkik, prijatarët e parisë janë hajna e cuba, administra shtetërore është e zvetënuar dhe e korrup-tuar deri në palcë. Ba mos me kenë droga e trafiket, shqiptarët duhet të fillojnë të hanë byrek me hithra. Kush punon mezi jeton, kush nuk punon, por trafikon, jeton si mbret.

Në vend të përfundimit

Prandaj edhe ky pyetësor duhet marrë seriozisht. Sepse ky pyetësor flet ndryshe, tregon se shoqëria shqiptare ka ndryshuar thellësisht. Në shoqërinë shqiptare ka shtresëzime të frikshme, ka ndarje të thella e të papranushme klasore. Ka

humbje të besimit në parinë e Tiranës, në sistemin politik e në demokracinë. Ekonomia është në krizë të thellë dhe më shumë se gjysma e njerëzve presin që gjendja të bëhet edhe më keq. Më në fund, ky pyetësor tregon se shqiptarët janë patriotë. Gjatë këtyre njëzetë vjetëve të fundit ka ndodhur një ndryshim i thellë në mendësi e në ideologji. Njerëzit janë bërë kombëtaristë e atdhetarë. Edhe pse paria sunduese e Tiranës ka vendosur të luftojë kundër nacionalizmit dhe një shteti të integruar, një politikë kjo që i ngjan luftës me mullinj të erës, së shpejti duket se do t'i duhet të luftojë edhe kundër popullit të vet. Sepse paritë luftojnë me hile e me poshtërsi, duke i blerë e duke i zvetënuar njerëzit, duke i përdorur ata dhe makinën e shtetit, e njerëzit luftojnë me bindje e me shpresë. Dikur shqiptarët kanë pasur shpresë, por nuk kanë pasur bindje të qarta politike. Tani duket se bindjet po ndërrojnë dhe me ndrrimin e bindjeve, ka me ardhë edhe shpresa. E përfundimi nuk don mend: paria dhe populli janë duke ecur në kahe të kundërta dhe përplasja është e paevitueshme, është vetëm çështje kohe.

NUK PO NDODH ASGJË, PROBLEMI I FSHEHUR I KRIZËS SË THELLË EKONOMIKE

Problemi kryesor i kësaj fushate zgjedhore është terri në të cilin po mbahet elektorati shqiptar në lidhje me gjendjen ekonomike të vendit. Si edhe e kam analizuar në disa shkrime të Rrethit të Ferrit, ky është një problem kardinal. Por në këtë terr informative duket se po kontribuojnë të gjithë; politikanët, specialistët, gazetarët, publiku i gjerë dhe institucionet e shtetit. Kjo po krijon një gjendje të frikshme, sepse kur të zgjo-het shoqëria do të jetë me të vërtetë vonë.

Institucionet dhe ekonomia

A flasin politikanët? Politikanët tanë nuk flasin për këtë temë. E para sepse nuk dinë; për shumicën ekonomia është vjedhje, shitblerje dhe ryshfet. E dyta, sepse nuk iu intereson. Çka do të thonë? Që jemi keq? Po këtë e dinë të gjithë. E treta, sepse numrat e të dhënave shpeshherë janë të fabrikuara në zyrat e ministrive dhe nuk dihet se ku fillon rrena e ku mbaron e vërteta. Ja për shembull, një pyetje e thjeshtë: sa ishte rritja ekonomike në shtetin shqiptar? Kryeministri nuk e tregon, po thotë se ia kaluam Gjermanisë e Brazilit dhe jemi pas Kinës. Por Turqia e Kina e kanë rritjen mesatarisht 9 % në vit dhe këtë vit rritja e Kinës ra në 7.8 %. Sa ishte rritja e ekonomisë? Askush nuk din të thotë gjë. Këtu të jepet shifra 3.0 % nga qeveria, 2.7 % nga Banka Shqiptare, 1.7 % nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, 0.5 % nga CIA dhe në fund negative nga një agjensi tjetër zbulimi që informon vendimmarrësit dhe që emrin po ia mbajmë sekret... More, po sa ishte rritja ekonomike? Hajde e merre vesh! Nga ana tjetër, këtu të thonë se e kemi rri-

tur prodhimin e përgjithshëm kombëtar 11 herë, apo se do ta rrisim prodhimin bujqësor katërfish në katër vjet. Edhe shefi i opozitës nuk flet me numra, por thotë “i themi Saliut, ik me nder”. Po çfarë nderi ka ky kryeministër, e çfarë nderi do të marrë me vete?!

Të kthehemi te ekonomia. Numra e përqindje nuk ka. A flet shtypi për ekonominë? Në lidhje me shtypin e shkruar pashë me keqardhje se lajmet ekonomike shpesh nuk e zënë as gjysmë faqe gazete. Ka gazeta të tëra që në versionet online, ose edhe në shtyp nuk kanë asgjë për ekonominë. Në gazeta ka më shumë lajme për seksin në Big Brother, se për ekonominë. Faqet e para hapen me komentet e analistëve e komentatorëve që janë të paguar dhe që shpifin, rrejnë, mashtrojnë, manipulojnë, përgojnë, vrasin njerëz e karaktere, por që nuk merren fare me ekonominë. E gjithë kjo mbulohet me argumentin se publiku nuk don debate të kësaj natyre, se nuk ka interes për çështjet ekonomike dhe në fund, me një shkelje syri lihet të nënkuptohet se populli shqiptar nuk i kupton këto tema. Shkulja e veshit dhe e flokëve të Egin Cekës, një skandal i paparë që u bë edhe më skandal nga letra e prindit, që do të bëhet edhe objekt, por edhe subjekt shërr, që nga Kuvendi, deri te kafeneja më e humbur, meriton vëmendje. Po edhe më shumë vëmendje meriton ekonomia.

A flasin institucionet e tjera? Jo! Të gjithë e dimë se si gatuajnë informacionet e të dhënat institucionet tona. Asgjë e re. Sepse INSTAT varet nga kryeministri dhe Guvernatori i Bankës Shqiptare është duke luajtur me tri porta. Deri pas zgjedhjeve nuk do ta ulin normën e interesit të lekut. Po pse? Raporti që u ofrua të mërkurën e nxirrte ekonominë blözë. Po ja, banka nuk do të ndërhyjë në politikë. Dhe për të justifikuar zgjedhjen që bëjnë të japin ca shifra kot e ca arsyetime që nuk të bindin. Nejse, me shumë mbi këtë temë në fund të shkrimit.

Shqiptarët dhe gjendja ekonomike

A e dinë shqiptarët si është gjendja ekonomike? Përgjigja e shkurtër është “po”. Populli e kupton mirë se gjendja ekonomike është e keqe dhe se do të përkeqësohet edhe më shumë në të ardhmen e afërt. Pyetësi i Institutit Shqiptar për Studime Ndërkombëtare tregoi se 66 % besojnë se gjendja ekonomike është e keqe dhe se 50 % e shqiptarëve besojnë se gjendja ekonomike do të bëhet edhe më e keqe pas zgjedhjeve. Sa për shashkat që hidhen andej - këtej sikur politikanëve që do të vijnë në pushtet iu janë premtuar miliarda, me to nuk ia vlen të merresh seriozisht. Populli e kupton këtë dhe ndjehet qartë rezistenca ndaj këtij dizinformimi.

Politikanët dhe ekonomistët mund ta vlerësojnë ekonominë duke u marrë me të dhënat makro. Njerëzit e thjeshtë e vlerësojnë gjendjen ekonomike duke u mbështetur në shpenzimet të jetesës së tyre, fuqinë blerëse dhe mundësinë e përballimit të nevojave që kanë. Shkurt, problemet ekonomike nuk marrin vëmendjen e duhur. Por politika dhe ekonomia janë të pandara.

Ku është e vërteta

Mëgjithatë e vërteta del. E pjesëshme, e paplotë, por gjithësesi del. Shkretëtira dallohet që është shkretëtirë, jo pse nuk ka gjelbërim, por pse ka një oaz a një tufë pemësh që të tregojnë se si është gjendja. Përtej kësaj dyanshmërie e moskuptimi dypalësh, (mua më interesojnë të dhënat, jo bindjet e përkatësitë politike të individëve), këto ditë në shtyp ka pasur disa shkrime ngacmuese, të shkurtër dhe të dobishëm, por që nuk kanë tërhequr vëmendjen e duhur.

Një shkrim i pjekur dhe i informuar lidhur me borxhet nga Genc Kondi te “Shqiptarja.com” duhej të kishte ngjallur debat serioz, por çuditërisht kaloi në heshtje.^[1] Ashtu kaloi

edhe alarmi i profesore Ermelinda Meksi, një nga njerezit që e njohin më mirë se shumë të tjerë ekonominë e vendit, lidhur me borxhin e shtetit në “Shqip” dhe shkrimet e Ilir Beqajt.^[2] Në rast se prononcimi i prof. Ermelinda Meksit, apo shkrimet e Ilir Beqajt kalojnë disi në heshtje, sepse të dy janë figura politike dhe pritet të jenë në nivele të caktuara të qeverisjes, kalimi në heshtje i disa shkrimeve dhe analizave të tjera nga gazetarët që mbulojnë ekonominë, është plotësisht i pajustificuar. Një seri shkrimesh të informuara mirë ka bërë edhe Ervin Kaduku në “Standard”.^[3] Njëri nga problemet kryesore ekonomike për popullin e thjeshtë është shtrenjtimi i jetesës, domethënë inflacioni i fshehur. Në një shkrim hetimor, cilësor e të pjekur, gazetarja Alba Xhambazi në “Shekulli” e ngriti këtë problem i cili kaloi në heshtje dhe pa vëmendjen e duhur.^[4] Po kush i diskuton? Askush! Njerëzit merren me shkuljen e veshit të një diplomati, jo me ekonominë. Në veçanti, artikulli i Alba Xhambazit më tërhoqi vëmendjen, sepse tregonte qartë sesa e vështirë është gjendja sidomos në tregtimin e prodhimeve bujqësore ku shtrenjtimi i jetesës është i dukshëm.

“Krahasuar me të njëjtën kohë të një viti më parë, çmimet janë shumë të larta edhe pse javën e fundit është vënë re një ulje e lehtë për produktet e stinës. Sipas tregtarëve, në tregun ushqimor të kryeqytetit, te ish - uzina “Dinamo” sallata kishte shkuar nga 50 lek/kg një vit më parë, në 120 lek/ kg këtë vit. Po ashtu edhe patatja, e cila një vit më parë ishte 30 lek/kg, dje tregtohej me çmimin 80 lek/kg. Rritje gjën edhe te trengulli, spinaqi, qepa dhe lulëlakra, e cila sipas tregtarëve ka pësuar një rritje 4 - 5 fish, krahasuar me një vit më parë”.^[5]

Pra, një vështrim i shpejtë i çmimeve të produkteve ushqimore, veçanërisht në tregun më të madh të vendit, në Tiranë, si edhe u tha më lart, tregon një histori tjetër. Inflacioni i fshehtë është rampant, i kudogjindshëm dhe përbën një problem shumë të madh për qytetarët që jetojnë me rroga apo që kanë të ardhura fikse. Kjo shihet si në prodhimet e importuara, ashtu edhe në prodhimet e vendit.

Inflacioni zyrtar, shifra që jepet nga Ministria e Financave, nga Banka e Shqipërisë dhe mandej përhapet gjithandej, është më pak se 4 %. Por në realitet, shtrenjtimi i produkteve ushqimore dhe bujqësore në treg, tregon diçka tjetër. Edhe nga një vështrim i shpejtë i rritjes së këtyre çmimeve, duket se inflacioni është i pranishëm dhe se njerëzit blejnë më pak me më shumë para. Natyrisht që ka spekulim e lojë me krizën, prodhimin etj., por rritja e çmimeve deri në këtë nivel, (gjasat janë që nuk do të bien në dysheme), sugjeron se shqiptarët do të blejnë më pak mall me të njëjtat para. Vërja emrin si të duash, por kjo është, më e pakta, shtrenjtim jetese. Duke shkuar pak më përtej të dhënave, mora raportin e Ministrisë së Bujqësisë për javën e fundit të marsit lidhur me çmimet e prodhimeve bujqësore dhe pashë se nuk janë aspak inkurajuese. Shumë gjëra më habitën në atë raport, por njëra ishte çmimi i limonëve (të vendit kushtonin 190 lekë kilogrami e të importuarit 159 lekë) e me radhë. Por kjo është temë tjetër.

Në vend të përfundimit

Në fund të fundit, ekonomia duhet të kthehet në vëmendjen e njerëzve. Njerëzit do të votojnë dhe ekonomia do të jetë një nga influencat kryesore në vendimmarrjen e tyre. Jo më kot shqëtësimet më kryesore ishin mungesa e të ardhurave (për 28 % të njerëzve), papunësia (për 25 % të njerëzve). Jo më kot 66 % e njerëzve thonë se gjendja ekonomike është keq apo shumë keq. 22 % mendojnë se është mesatare/normale dhe vetëm 2 % thonë se gjendja e ekonomisë është e mirë. Sido që të jetë, politika dhe të gjithë institucionet heshtin.

Tani e ka radhën Banka e Shqipërisë. Siç thashë më lart, më datën 30 prill do të mblidhet Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë që ndërmjet të tjerash, do të vendosë edhe për normën e interesit mbi lekun. Por ka gjasa që Guvernatori Fullani të marrë një vendim politik që nuk do të ndikohet nga arsye ekonomike, por nga marrëveshja që do të bëjë guvernatori

me palët respektive të parisë. Por cilido që të jetë vendimi, e prekin s'e prekin e ulin apo e mbajnë aty ku është, ekonomia shqiptare është në krizë të thellë e nuk ka asnjë shans që ta kalojmë tani shpejt, lehtë e për disa vite të vështira.

[1] Genc Kondi, "Çfarë trashëgon qeveria e ardhshme?" "Shqiptarja.com", 24 prill. 2013

[2] Ermelinda Mexsi, "Shqip", 24 prill 2013.

[3] Ervin Kaduku, "Bankat: Ja çfarë do të bëjmë për kreditë e këqija", gazeta "Standard" (pa datë) <http://www.standard.al/bankat-ja-çfarë-do-të-bëjmë-për-kreditë-e-këqija/>

[4] Alba Xhambazi, "Shtrenjtohen çmimet, perimet 110% më të shtrenjta nga vjet". "Shekulli", 21 prill. 2013.

[5] Xhambazi, Ibidem.

MBI ROLIN QENDROR TË SHTETIT, BOTËKUPTIMI REALIST DHE POLITIKA SHQIPTARE

Botëkuptimi, apo ideologjia, luan një rol qendror në formësimin dhe sjelljen e individit. Por roli qendror i botëkuptimeve në jetën shoqërore, në formësimet e grupeve, kulturën, besimet dhe vlerat e tyre, natyrisht edhe në politikë, është aksiomatik. Vetëdija shoqërore, qëllimet e synimet që ka një grup i caktuar, veprimi politik dhe strukturat politike e shoqërore që ndërtohen, janë të mbështetura në botëkuptimin e një grupi të caktuar. Të gjithë botëkuptimet, në një mënyrë ose në një tjetër, të orientojnë drejt një jete më të mirë, prandaj pritshmëritë janë të njëjta edhe pse rrugët mund të jenë të ndryshme. Kështu shoqëritë ngrihen mbi botëkuptime të tilla si dhe bien, shuhen e zhduken, kur mospajtueshmëritë midis botëkuptimit dhe realitetit, bëhen të papërballueshme e të pashpjegueshme.

Në kulturë e në besimet fetare është normale që botëkuptimi do të mbështetet në të pashpjegueshmen. Prandaj kur flasim për familjet, katundet, bashkësitë e trevat, flasim edhe për bestytini e përralla, legjenda e perëndi si pjesë e botëkuptimit të tyre.

Por në politikë, botëkuptimet nuk mund të jenë të bazuar në utopi, bestytini apo në përralla. Botëkuptimet e tilla rezistojnë për një kohë dhe në fund shkërmoqen, e humbin vlerën e tyre, sepse parimet dhe logjika e sjelljes politike dhe shoqërore, janë të papajtueshme me parimet fetare apo kulturore, që fare mirë mund të vazhdojnë të ekzistojnë si besime e vlera në nivel të familjes, të bashkësisë e të trevës.

Por shoqëria, si një shkallë më e lartë e organizmi, është ndryshe, sepse është në thelb një marrëdhënie politike. Botëkuptimi, për të qenë mirëfilli i dobishëm dhe i vyeshëm për një shoqëri, duhet të jetë i mbështetur në një logjikë të hekurt politike, mbështetur edhe në përvojat e në natyrën njerëzore. Sepse në mos tjetër, njerëzit janë ata që janë dhe ndërrimi i botëkuptimit nuk i ndërron ekzigjencat tona, të cilat me kohë gjejnë edhe strukturat politike që iu përshtaten më mirë e që ndihmojnë shoqërinë të arrijë të njëjtin qëllim përmes rrugëve të ndryshme. Në qendër të botëkuptimit politik është shtet - kombi.

Problemi me botëkuptimet sunduese

Kështu, në një kohë, ose në një tjetër, ne kemi pasur botëkuptimet tona, edhe të grupeve të caktuara brenda nesh, që kanë qenë ose utopike, ose thjesht përralla. Problemi është se në politikën e ditës ne na mungon botëkuptimi realist, botëkuptimi që do të ndihmonte të mbërrinim atë objektivin e pandryshueshëm të të gjithë shoqërive njerëzore; sigurinë e jetës, të pronës, të nderit, të mirëqënies dhe të harmonisë shoqërore. Ky botëkuptim mbështetet e ndërtohet mbi shtetin.

Cili është problemi ynë? Problemi ynë është se na mungon ajo lidhja e fortë, qendrore, e pashkëputshme me shtet - kombin që është në qendër të identitetit individual dhe kolektiv dhe pa të cilën njeriu nuk e kupton dot veten. Ky duhet të jetë qëllimi kryesor i politikës, domethënë ruajtja dhe kultivimi i këtij botëkuptimi, mbrojtja e interesit të shtet - kombit dhe përmes vetëdijes shtetërore etj., edhe i interesit të gjithë shoqërisë dhe individëve që e përbëjnë atë.

U zgjata pak me teorizime, por desha të hedh pak dritë mbi problemin qendror të kohës sonë. Botëkuptimet sundues në shoqërinë shqiptare janë të gjithë të mbështetur mbi një premisë themelore dhe ekzistenciale; të gjithë botëkuptimet që po lulëzojnë në kohën tonë, kërkojnë dobësimin e shtetit

kombëtar. Për të gjithë botëkuptimet sunduese, një shtet - komb normal, realist dhe relativisht i fortë është i papranueshëm. Arsyeja është se shteti - komb vë si kusht parësor besnikërinë e pakushte të qytetarit e të shtetasit ndaj shtet - kombit. Të gjithë botëkuptimet e tjera vënë si kusht besnikërinë ndaj një qytetërimi të caktuar apo të strukturave shoqërore e në nivel të bashkësisë si katundi.

Sa për ilustrim, cilat janë këto botëkuptime? Në rastin tonë, dalja e dhunëshme që bëme ne si shtet më vete, solli përplasjen e botëkuptimeve të grupeve të ndryshme brenda shoqërisë shqiptare. Ne patëm shumë sundimtarë e pak shtetarë, sepse mendësitë e botëkuptimet tona sunduese e kanë kushtëzuar fort hapësirën e veprimit të shtetarëve të vërtetë dhe shpesh kanë dalë përcaktuese. Ekstremi ka qenë kjo periudha e tranzicionit kur paria e Tiranës, masat e gjëra të popullit dhe ata që duhej të ishin shtetarë, punuan sistematikisht për të minuar këtë botëkuptim e për t'iu kundërvënë shtet - kombit.

Përse ndodhi kjo?

Nga një anë ne vijmë nga miletet e perandorisë osmane. Gjurmët e këtyre botëkuptimeve fetare kanë qenë të rrënjosura thellë dhe janë ringjallur e kanë lulëzuar edhe gjatë tranzicionit. Këto janë shtrati kulturor dhe i sjelljes së shumë bashkësive që po kristalizohen me një shpejtësi të frikshme, që nuk e kanë kombin në qendër të identitetit dhe që do t'i çojnë shqiptarët drejt përplases së pashmangshme, sepse nuk ka çka i bashkon tjetër. Po ashtu, si edhe shihet nga debatet e fundit, problem themelor është se lidhja e këtyre botëkuptimeve me shqiptarët si komb e si grup etnik, është e deformuar, e shtrembëruar dhe nuk lidhet me të vërtetën historike. Me kenë shqiptar ka qenë diçka krejtësisht e ndryshueshme dhe që ka evoluar gjatë historisë sonë. Ama, me kenë shqiptar, në shtetin shqiptar, është diçka krejt tjetër dhe përpjekja e tyre për të lidhur shqiptarinë me një botëkuptim të caktuar, nuk ka qenë asnjëherë e sukseshme.

Po ashtu një nga botëkuptimet që ka përcaktuar edhe sje-

lljen politike të parisë dhe të shoqërisë gjatë tranzicionit, ka qenë mendësia katundare, një fenomen specifik shqiptar. Duke vënë familjen dhe interesat e klaneve mbi gjithçka, si dhe duke e parë katundin e trevën si një univers të mbyllur, shoqëria shqiptare e përbërë nga një numër katundesh që ekzistojnë realisht dhe në mendjen e njerëzve, ka luftuar me shumë vendosmëri kundër shtetit e kundër gjithçkaje që e bën një shtet të sukseshëm.

Meqë këtë mendësinë katundare e kam trajtuar gjerë e gjatë në shkrimet e mia, nuk do të ndalem këtu. Por mjafton të them se kjo mendësi doli si parësore e sunduese në katundet e fshatrat e shumtë, në getot urbane të katundarizuara me rrënjë, por edhe në emigracionin tonë masiv. Gjithkund kjo ideologji iu kundërvu shtetit normal e realist që për arsye të ndryshme ishte armiku për vdekje.

Po ashtu një botëkuptim e mendësi tjetër sunduese, sidomos në rrethet e parisë së Tiranës është mendësia që e sheh shoqërinë si sistem kontraktual marrëdhëniesh ekonomike midis individëve, jo më shumë. Kjo është mendësia e shtresave të edukuara mbrapsht gjatë sistemit enverist kur bota pasqyrohej vetëm në terma bardhezi, në një interpretim të ngushtë, dogmatik të botëkuptimit marksist. Ky botëkuptim e bëri të mundshëm shfrytëzimin ekstrem, materializmin e paskrupullt, spekulimin, shkatërrimin e shtetit dhe të shoqërisë gjatë tranzicionit. Tani këta kanë shkuar në ekstremin tjetër.

Duke e ndierë nevojën e shtetit, shumë shqiptarë kanë përqafuar botëkuptime që qëndrojnë në themel të shteteve të tjera. Ata ndiehen gjithçka, perveçse shqiptarë. Edhe për këta armiku kryesor është shteti shqiptar. Po ashtu ka një masë të madhe njerëzish që e ndiejnë, por në mënyrë konfuze, se botëkuptimi që iu duhet është ai që mbështetet në shtet - komb, po për mungesë udhëheqje e qartësie, bien pre e slloganeve dhe e populizmit injorant të tipit si ai i "tortës së pavarësisë".

Më në fund ka një botëkuptim përrallor që thotë se të gjithë

problemet tona do të zgjidhen kur ne të hyjmë në Evropë. Por integrimi evropian është i pamundshëm, Evropa nuk na don, ne nuk kemi çka t'i ofrojmë. Evropa është në krizë të thellë dhe koncesionet që kërkohen në këtë pikë, çojnë në shkatërrimin e shtet - kombit me kulm e themel. E vetmja rrugë për t'u integruar kund, është kur të kemi shtet - kombin tonë, me ekonomi, me vlera, me struktura e me shërbime të përafërta me ato që ofrojnë edhe shtetet e falimentuara evropiane për qytetarët e tyre.

Kjo gjendje konfuzioni mendor e botëkuptimor, i shërbente dhe i shërben vetëm e vetëm parisë sunduese. Duke qenë se njerëzit e thjeshtë nuk dinin më mirë, duke qenë se edhe ata që po përqafojnë botëkuptime jo realiste vepruan kështu vetëm se donin t'i iknin të keqes dhe nuk dinin më mirë. Fajin për këtë punë e ka paria sunduese.

Shkurt, politika shqiptare nuk ka një botëkuptim të qartë, realist, normal, të mbështetur në përvojat e vendeve të tjera. Duke gjykuar nga materialet dhe dokumentet që janë botuar e botohen, shihet qartë se ngulmimi i tyre po i afrohet budallallëkut e idiotësisë politike. Por kjo idiotësi e injorancë, verbëri e refuzim, është e qëllimtë. Paria e din se cila është e mira e shqiptarëve, por kjo gjendje iu shërben dhe këtë do të luftojnë të promovojnë.

Ajo që e ka bërë gjendjen tonë katastrofike, është ky kombinim eksploziv i mendësisë katundare me botëkuptimin materialist ekstrem dhe me këtë përrallën e integritit evropian. Ky shtresëzim injorance dhe shfytyrimi mendor, ka çuar në një krizë të thellë vlerash, kriminalizim e mafiozitet, sundim oligarkik të mbështetur në klanet katundare, një polarizim ekstrem, mungesë përgjegjësie qytetare, shkatërrim të vlerave dhe të moralit, në zvetënim, në degjenerim dhe në krijimin e një shoqërie të fragmentarizuar e të shkërmoqur, që si rëra shkon andej e këtej, nga të fryjë era. E gjithë kjo ndodh, sepse ne na mungon botëkuptimi i duhur realist që mbështetet në shtet - kombin normal e funksional.

Në vend të mbylljes

Shtet - kombi është struktura më e fuqishme, më efikase, më e dobishme për grupin dhe luan një rol qendror në botëkuptimin e njerëzve në kohën tonë. Shtet - kombet janë zgjidhja strukturore politike që njerëzit iu kanë dhënë problemeve të tyre ekzistenciale. Për t'i rënë shkurt, mundimet tona dhe tranzicioni nuk do të kenë fund, derisa të mos vendosim në qendër të vëmendjes e të politikës shtet - kombin dhe interesat e tij. E gjithë demagogjia elektorale në Tiranë bëhet për të shmangur diskutimin rreth shtet - kombit dhe ndërtimit të një shteti normal e funksional. Meqë këtë temë e kam trajtuar gjerësisht në librat e mi, por edhe në blogun Rrethi i Ferrit, nuk do të ndalem këtu. Por ky është problemi kryesor i kohës dhe i politikës sonë. Vendosja e shtet - kombit në qendër të debateve dhe diskutimi politik i mbështetur në atë botëkuptim, është pika nga ku duhet filluar. Sepse shtet - kombi dhe botëkuptimi që lind prej vetëdijes shtet - kombëtare, është edhe leva e Arkimedit për të dalë nga kriza e thellë ku e mban vendin paria e Tiranës që i shërben gjithkujt tjetër, përveç shqiptarëve.

MBI KANIBALIZMIN POLITIK: EKLEKTIZMI DHE BANDITIZMI NË POLITIKËN E TIRANËS

Edhe në këto zgjedhje po shihet se politika shqiptare nuk del dot nga klisjetë e njohura të politikëbërjes, praktikuar rregullisht prej saj në të shkuarën. Siç tha edhe Sali Berisha, “Sot spektri ynë politik është i bashkuar në parimësinë më të madhe në historinë e Shqipërisë...” ^[1] Se si i ka dalë, ndoshta në mënyrë subkoshiente, në mes të fushatës një pohim i tillë shumë domethënës në lidhje me unitetin e parisë, është tjetër gjë. Por kjo është e vërteta. Paria janë bashkë dhe sillen me të njëjtën mendësi.

Po cili është parimi kryesor i sjelljes së parisë për të cilën flet Sali Berisha? Parimi kryesor i sjelljes së parisë është arrizmi i paskrupullt dhe pasurimi me çdo kusht e me çdo mjet. Por në mes është sistemi demokratik dhe parisë i duhet legjitimiteti. Ajo duhet të tregojë se populli e mbështet dhe e pranon gjendjen kështu siç është. Si vrasësit, asaj i duhet që viktima t’i kërkojë ndjesë dhe ta shohë në sy. Ndaj kur vjen periudha e zgjedhjeve, paria bën gjithçka mundet për të fituar këtë legjitimitet, për të mobilizuar elektoratin e votuesit e për t’i rresh-tuar në një rën nga anët e saj.

Dy metodat kryesore të mobilizimit nga ana e parisë së Tiranës, janë populizmi dhe banditizmi. Të dyja janë të mbështetura në një eklektizëm banal ideologjik. Ajo që mungon është ideologjia e duhur shtetformuese, kombëtarizmi dhe struktura partiake që ta bartë këtë ideologji. Me përdorë një shembull ilustrativ, ajo që po ndodh me demokracinë shqiptare mund të krahasohet me një dasmë tradicionale që ka shkuar keq. Ama, kjo është një dasmë, në të cilën orkestra dhe kuzhinieri

nuk e njohin muzikën dhe kuzhinën, janë të dehur dhe duan të mbledhin paratë e të ftuarve. Por për shqiptarët, të zotët e shtëpisë duhet të kërcehet e të vallëzohet, sepse kështu e don zakoni, duhet të ruhet fytyra ndaj miqve dhe bëhet dasmë, se duhet të bëjmë dasmë. Edhe ne bëjmë zgjedhje, sepse nuk kemi orkestër tjetër, po kur të vijë momenti që të thuhet e vërteta, një zot e di se ku do të përfundojnë pjesëtarët e parisë.

Eklektizmi ideologjik

Eklektizmi ideologjik është një mënyrë të gjykuari që mbështetet në përvojën dhe në kuptimin e ngushtë e pragmatik që individi ka për botën që e rrethon. Sa i lind një problem, duhet me e zgjidhë. Pra, njerëzit nuk kanë një bosht të qartë ideologjik dhe marrin koncepte, zgjidhje e mënyra të funksionuari që iu duken më të përshtatshme dhe që funksionojnë në planin afatshkurtër. Nëse ke uri e nuk ke tjetër, han edhe derrin, edhe bretkocën, edhe lepurin, edhe qenin. Parimet si “mos ha bretkosa” nuk të mbajnë gjallë kur je në batak. Ajo që të mban gjallë, është mendja e hapur dhe kthjelltësia se duhet mbijetuar. E prandaj bretkosa bëhet e pranueshme.

Por në politikë nuk është vetëm problemi të mbijetesa e individit, sepse eklektizmi është më shumë i lidhur me përdorimin e shtetit, të burimeve njerëzore e materiale.

Prandaj nga ky këndvështrim që e vë shtetin në qendër, në politikë ka dy lloje kryesore eklektizmi. Njëri është eklektizmi që të shtyn t'i bësh të gjithë zgjidhjet nga këndvështrimi i yt i ngushtë e personal, si individ, cilido që të jetë ai interes në një moment të dhënë. Pra ajo që të shërben më së miri si individ në kohën e duhur e në gjendjen e duhur, ajo është edhe praktika e duhur që duhet ndjekur dhe politika që duhet zbatuar. Nëse duhet të prishësh shtetin, atëherë e prish dhe shikon vetëm e vetëm punën tendë.

Së dyti ka një eklektizëm në zgjidhjet që gjen si udhëheqës e si parti politike për të zbatuar idetë dhe parimet që ke si

grup në politikë. Interesi nuk ndryshon, por udhëheqësi gjen mënyrën më të mirë për të mbrojtur e avancuar interesat e grupit të vet. Në këtë rast, shteti përdoret për të plotësuar nevojat dhe interesat e këtij grupi të ngushtë që është armiqësor ndaj shtetit dhe shtetasve të tjerë.

Pra, ka eklektizëm në interes në qëllimet që i vë vetes para dhe eklektizëm në mjete që arrijnë qëllimet e interesat që nuk ndryshojnë që janë shtetarët. Format e tjera janë të ndërmjetime, ose forma të shfytëruara të këtyre dy mënyrave të mobilizimit të popullit në mbështetje të politikave që të interesojnë. Meqë në nuk kemi shtetarë në politikë, gjendja jonë është me të vërtetë tragjike dhe jemi në fazën e kanibalizmit politik.

Fenomeni i kanibalizmit politik

Si shfaqet kanibalizmi politik?

Së pari të kuptojmë një herë kanibalizmin si anomali sjelljeje. Në jetën normale ndodh që individë të luajnë mendsh dhe t'i humbin të gjithë parimet e kriteret edhe kur e kanë mundësinë t'i respektojnë dhe bëhen kanibalë. Edhe pse ka mish sa të duash, këta duan të hanë mish njeriu e të pinë gjak. Këta duan të hanë njerëzit. Morali i tyre nuk mbështetet në respektin për tjetrin, për jetën njerëzore, për specien e llojin, por në urinë e tyre për mish njeriu.

Po kanibalizmi politik? Kur je në politikë dhe mendon vetëm e vetëm të hash popullin tënd, të shkatërrosh popullin tënd, të varfërosh popullin tënd, të degjenerosh popullin tënd, të zvetënosh popullin tënd, të shesësh e të skllavërosh popullin tënd, je kanibal politik. Kanibal politik je edhe kur duartroket sjelljen e kanibalëve të tjerë dhe nuk bën gjë për t'iu kundërvënë krimin.

Paria e Tiranës janë shprehja më e qartë e kanibalizmit politik. Po ashtu ka edhe grupe kanibalësh politikë që formësohen mbi parime që janë e kundërta e normales dhe i bëjnë festat e tyre kur gjejnë të hanë dikë. Forma normale e organizimit

është familja e rregullt e me moral. Në nivel të shoqërisë, normale e organizmit shoqëror e politik, është shteti e kombi.

Kur strukturat politike formësohen si banda, hordhi e mafia kriminale të cilat duan të thithin gjakun e popullit e të luftojnë kundër shoqërisë si parazitë në trupin njerëzor, e këta në trupin e shtetit, atëherë këta janë shprehje e kanibalizmit politik. Sepse gjithçka që ata marrin, e marrin nga jeta, e ardhmja dhe nga mundësitë e popullit të tyre. Partitë politike në Tiranë janë banda në shërbim të parisë që hanë të gjallë shtetin shqiptar, burimet e shtetit dhe vjedhin sistematikisht të ardhmen e popullit.

Paradoksi shqiptar i kanibalizmit politik

Paradoksi shqiptar i kanibalizmit politik është pikërisht ky. Paria ka qëllime të vetat, ndryshuar me kohën e me pozicionin e saj dhe tashmë janë kthyer në kanibalë politikë. Si individë, ata nuk ndalen më përpara asgjëje. Edhe pse i kanë të gjitha, untia e tyre i ka shtyrë udhëheqësit në ekstremin e mundshëm të kanibalizmit politik. Fytyra që merr ky kanibalizëm politik; pasurimi me çdo kusht e me çdo mjet, korruptimi e vjedhja e shtetit, zvetënimi dhe degjenerimi i shoqërisë, shkatërrimi i ekonomisë kombëtare dhe kriminalizimi i pashembullt i njerëzve, familjes dhe vlerave, janë ana tjetër. Njerëzit nuk ha-hen të gjallë vetëm kur vriten e kur kanibalët iu ziejnë organet dhe mishin. Njerëzit piqen të gjallë, kur e shohin të keqen e janë të pazotët të veprojnë kundër saj. Sepse ne kemi arsye e jemi njerëz dhe prandaj kjo është e papranueshme. Kjo është forma më e ndyrë e kanibalizmit politik dhe kjo po praktikohet e zbatohet me vetëdije të plotë nga paria e Tiranës.

Po pjesëtarët e parisë së Tiranës nuk e kanë bërë këtë punë vetëm. Në këtë ndërmarrje kaq kriminale e vrastare, këta janë të organizuar në banda që i quajnë parti, klane, struktura e familje. Forma e preferuar e organizimit të tyre, ka qenë banda mafioze bazuar mbi parimet e klanit katundar që nuk

njuh tjetër përveç materializmit ekstrem. Logjika e sjelljes së bandës me popullin është logjika e sjelljes së udhëheqësve me pjesëtarët e bandës. Është e njëjta logjikë që pjesëtarët e bandës përdorin me udhëheqësit e tyre dhe anasjelltas. Bandat dhe pjesëtarët e tyre, deputetët dhe zyrtarët e ardhshëm, edhe pse i kanë të gjitha, duan të kenë atë që kanë më të pasurit në mes tyre. Untia i ka shtyrë në ekstremin e mundshëm të kanibalizmit politik; pasurimi me çdo kusht e me çdo mjet, korruptimi e vjedhja e shtetit, zvetënimi dhe degjenerimi i shoqërisë, shkatërrimi i ekonomisë kombëtare dhe kriminalizimi i pashembullt i njerëzve, familjes dhe vlerave. Të gjitha këto, i çojnë bandat edhe në kundërvënie të hapur ndaj prijatarëve, nëse këta iu bien ndesh interesave të tyre. Partitë politike të parisë dhe strukturat ndërpartiake, të ashtuquajturat koalicionet, janë thjesht banda të sofistikuar hierarkike në shërbim të klaneve sunduese të parisë së Tiranës.

Në vend të përfundimit

Paria e Tiranës ia ka arritur që edhe në këto zgjedhje ta mbyllë lojën dhe me koalicionet e saj të paraqesë bandat e diskredituara të hajnave si alternativat e vetme të mundshme. Kundërshtarët e tyre janë të diskredituar, edhe pse u rrekën që të merren vesh me parinë, të bëhen pjesë e saj. Nga ana e tyre, pjesëtarët e bandave po presin copën, llokmën që vjen me korrupsionin e vjedhjen e të ardhmes së shqiptarëve. Tashmë ata janë si hienat që po grinden mbi prenë që rrin ulur si buall i lodhur, që e sheh veten si po shqyhet i gjallë dhe që nuk ka fuqi të lëvizë as bishtin. Sot është dita e hienave. Nesër hienat do të hanë njëra - tjetrën, sepse hiena është hienë. Kur e merr uria, ajo ha edhe pjellën e vet. Deri në zgjedhjet e ardhshme, do të na kenë ngrënë edhe kockat e fundit që na kanë mbetur. Atëherë do të nisin të hanë veten.

[1] "Shqiptarja sot", 3 maj 2013.

CILA MENDËSI A BOTËKUPTIM DO TA SJELLË NDRYSHIMIN NDËR SHQIPTARËT?

Gjatë tranzicionit struktura e shoqërisë shqiptare ka pësuar ndryshime të thella dhe vazhdon të jetë duke ndryshuar me shpejtësi marramendëse. Si edhe në drejtime të tjera, edhe në drejtim të strukturës shoqërore, ne jemi një rast mjaft paradoksal. Paradoksi kryesor qëndron te lidhjet shumë të forta personale, klanore dhe të interesave që nuk i lejojnë shtresat e ndryshme të formësohen ashtu siç ka ndodhur në të gjithë rastet e tjera. Ngjithësja më e fortë është mendësia katundare, sunduese në të gjithë shtresat e shoqërisë. Përmes lidhjeve farefisnore, traditës, origjinës, martesave, kulturës, vlerave që vijnë natyrshëm në shoqëri, ne trashëgojmë një mendësi katundare të theksuar. Edhe ata që kanë kaluar në përvoja pasurimi, edukimi, formësimi institucional e burokratik, e gjejnë mënyrën të tradhëtojnë shtratin e mendësisë katundare.

Sa për me shmangë keqkuptimet, edhe pse familja ime është njëra nga ato katër familjet që e ka themeluar Podgoricën në fillimin e shekullit të 16 - të dhe që ka një histori të njohur edhe para asaj periudhe, unë e numëroj veten me krenari e me nderim si katundar shqiptar e malësor. Unë nuk due me kenë tjetër. Jam krenar për fisin tim, për kombin tim, për njerëzit e mi. E megjithatë, unë mendoj se duhet me ndryshue rrugë. Unë mendoj e besoj se shpëtimi që na duhet, ashtu si edhe e keqja që na ka rënë mbi kokë, vjen nga i njëjti burim mendësie.

Pse e them këtë? Sepse e mira dhe e keqja jetojnë bashkë. Tash e kemi harrue disi e ndoshta ma shumë se duhet, por ne shqiptarët jemi i vetmi popull në botë që rrënjët tona historike i kemi pikërisht në këtë sistem besimi që i sheh të mirën dhe të keqen si të ngërthyera në një lidhje të pazgjidhshme. E megjithatë sistemi ynë i lashtë i besimit dhe ajo përkrenarja e trashëguar prej Skënderbeut, në familjen e Skënderbeut shitur për një copë bukë një arkiduke austriak, ka ma shumë vlerë se ia japim ne sot, e ka vënë njeriun në qendër të vendimmarrjes dhe ia ka dhënë atij vetëm e vetëm atij, mundësinë e zgjidhjes. Dhe zgjidhja kësaj here duhet ba me mend, sepse si themi ne malësorët, edhe ujë ba me pi ma shumë se duhet, plas njeriu, njëlloj si bagëtia që han bar ma shumë se mundet me blue. Por puna jonë është të ndajmë të mirën nga e keqja, të gjejmë masën e duhur dhe kufirin ku e mira dhe e keqja e lejojnë qenien me ekzistue. Pak kush e din se mikrobet e bakteriet që kemi në trup, që na ndihmojnë me tretë ushqimin, na bëjnë me vdekë dhe na hanë të gjallë, por edhe të vdekun. Me një shembull tjetër; ne duhet të përdorim helmin e gjarpërit për me shërue plagën. Sepse shpëtimi jonë është pikërisht aty, nga na vjen e keqja, te mendësia jonë katundare shqiptare.

Ana e keqe e mendësisë katundare

Për të keqen e mendësisë katundare kam folë gjerësisht në blogun tim “Rrethi i Ferrit” si dhe në librat e mi. Materializmi ekstrem, frika ndaj shtetit, përlulja ndaj parisë sunduese, lidhja deri në skllavërim me pronën, izolimi, mendjengushtësia dhe nevoja e zgjidhjeve për mbijetesë në një kontekst të caktuar, e të tjera mënyra sjelljeje e vlera të dallueshme unike, janë pjesë e kësaj mendësie. Kjo është ana jonë e zezë që ka dalë mbi ujë, ajo që po na vret e po na shuen. Ma ka çue në këtë gjendje untia e katundarëve dhe e malokëve tanë, se malokë e katundarë që na dallojnë një kilometër larg jemi jug e veri, toskë e gegë, muslimanë e të krishterë, të majtë e të djathtë,

hudhra dhe qepë. Po ashtu mendësia e sheherliut, e atij që jeton në qytet, e borgjezit/dyqanxhiut të vogël që kënaqet me një dyqan/kioskë e me një të ardhur të vogël, është po ashtu e përafërt dhe e ngjashme me mendësimë katundare. Në mos tjetër, të dy nuk i shohin proceset më larg se mëhalla/lagja/katundi i tyre. Prandaj nuk due me folë ma për të keqen. Atë e dinë të gjithë, e jetojnë të gjithë dhe prej saj janë të lodhun të gjithë.

Ana e mirë e mendësisë katundare

Ana e mirë e mendësisë katundare është ruajtja e dinjitetit, e nderit, e fytyrës, e respektit për veten dhe për familjen. Sepse kur vjen puna te nderi e te fytyra, katundari të zhdruk nga faqja e dheut. Kur e prek në fytyrë e në nder katundarin tonë, nuk ke vend ku mund të fshihesh. Të gjën edhe në birë të miut. Çuditërisht edhe në një kohë që shitet si moderne, këto parime e sjellje që e shohin njeriun si të patjetërsueshëm dhe e vënë nderin e dinjitetin e tij në qendër të vëmendjes e të sjelljes politike, janë pikërisht ajo që ne duhet të kultivojmë, të provojmë dhe mbi të cilën duhet të mbështesim të ardhmen tonë. Sepse tashmë ne shqiptarët e kemi një shans që nuk e ka kurrkush tjetër. Ne jemi një turmë katundarësh që mund të mendojmë si fisnikë dhe si banditë. Zgjedhja është e jona. Paria na drejtoi për njëzetë e tre vjet të mendojmë si banditë. A mund të mendojmë ndryshe? A mund të ndërtojmë një shoqëri që të na lejojë të jemi njerëz normalë, me nder, me dinjitet ndërmjet vetes, pa dallimet që të tjerët na shtyjme që t'i kultivojmë?

Në vend të përfundimit

Shkurt, bota e huaj është një xhungël në të cilën ne nuk kemi arritur të çajmë. Bota ka pasur perandori e koloni, zotërime e sundime pa numër e pa farë dhe ne iu dukemi si miza.

Por pyetja që duhet t'ia bëjmë vetes, është se si kanë arritur të jetojnë edhe mizat? Sepse ne nuk bëhemi dot anglezë që janë bërë të gjithë me mendësi zotërie njëlloj për arsye të caktuara. Nuk bëhemi dot rusë, që janë bërë njëlloj për arsye të caktara. Ne jemi këta që jemi. Ne jemi katundarë shqiptarë. Ne çmojmë nderin, fytyrën e pasurinë. Për fat, kemi edhe një shtet. A mund të bëjmë këtë shtet të na ruajë fytyrën, nderin e pasurinën, të na garantojë jetën e nderin? A mund të bëhemi normalë e të mbijetojmë në këtë botë të vështirë? Sepse ne jemi lloji më i veçantë i popujve që mund të bëhet në fytyrë të dheut. Ne jemi ata që bëhemi krimba. Ne jemi krimbat që bëhemi flutura. Pyetja është ç'ka duam të jemi? Zgjidhja është në kuptimin e duhur e të drejtë të mendësisë sonë katundare dhe në vlerat që na bëjnë të veçantë, ndryshe, që na kanë lejuar të mbijetojmë tash mijëra vjet dhe që ne i manifestojmë në mënyrë të pavetëdijshme në sjelljen tonë kudo që jemi. Me një fjalë e shkurt, e ardhmja jonë kalon nga kuptimi i saktë i vetvetes, i asaj që na bën të veçantë dhe i përdorimit të atyre cilësive që na kanë lejuar të mbijetojmë e që do të na mundosojnë mbijetesën në të ardhmen. Kësaj here duhet të dimë të zgjedhim.

BOJA NË FYTYRËN E POLITIKËS SHQIPTARE

Me mbylljen e listave të kandidatëve për deputetë, po shihet qartë niveli i pafytyrësisë dhe i poshtërsisë së parisë së Tiranës. Me një shprehje popullore parisë së Tiranës “i ka dalë boja”. Tashmë paria e Tiranës nuk ka pretendimin më të vogël për t’i shitur sherret falso si ndarje ideologjike. Paria e Tiranës nuk ka fytyrë për t’i mobilizuar njerëzit as në bazë të ndarjeve të vjetra e të stërpërdorura si komunistë/antikomunistë. Paria e Tiranës ka treguar se ka vetëm interesa materiale. Klanet e tyre përplasen vetëm për të fituar kontrollin e shtetit dhe për ta vënë në shërbim të tyre.

Ata që e kanë kuptuar këtë sjellje kanë gjetur vërtetimin e asaj që kanë ditur. Ata që nuk e kanë pasë pranuar, nuk kanë më justifikime. Vetëm të poshtërit dhe budallenjtë nuk duan ta pranojnë këtë të vërtetë të pamohueshme. Këta janë banda katundarësh që duan të vjedhin shtetin dhe që nuk lodhen fare ta fshehin, bile e shesin si arritje këtë sjellje të tyre. Një shprehje popullore thotë “iu plasi cipa”. Por cipa të plas kur ke fytyrë. Shprehja më e saktë është “këtyre iu ka dalë boja,” domethënë boja është leskëruar dhe këta e kanë treguar fytyrën e tyre të vërtetë, kanë shkuar në origjinë. Huri i gardhit mbetet hu gardhi, edhe po ta pikturojë Vangjush Mio apo Kolë Idromeno.

Dalja e bojës dhe vazhdimi i lojës

Dalja e bojës është një fenomen i rrezikshëm për vetë parinë. Edhe pse praktika e ndjekur nga paria e Tiranës për të mobilizuar njerëzit, për t’u zhvilluar atë që quhet politikë sim-

bolike, duket sikur po funksionon mirë edhe në këto zgjedhje. Megjithatë poshtë lustrës së vetësigurisë dhe të përpjekjes së bashkërenduar për të shitur rezultatin, cilido që të jetë, për të zhdukur alternativat dhe për të vazhduar me teknikën e dezinformimit e të ç'orientimit të votuesve, shihet diçka tjetër.

Dalja e bojës po e bën të tendosur shumë vazhdimin e lojës së sherrit fals e artificial ndërmjet palëve. Nga një anë paria i ka llogaritur mirë e bukur votat. Ata i kanë numëruar njerëzit si delet dhe e dine se kush do të votojë, për kë me një qartësi të madhe. Kjo punë është bërë shtëpi më shtëpi, derë më derë, me sekserë, me lista të punësuarish, me shantazhe të hapura e të fshehta, me terror politik, me terror mendor, me terror hafijesh që janë shtuar në kufinj të shtetit policor dhe me propagandën e frikshme të kafeneve katundare që janë emisionet si Opinioni, Top Show, apo ai gjirizi mediatik, që është emisioni i Arian Çanos. Përpjekja e tyre për vazhdimin e lojës, po duket shumë e suksesshme dhe luftohet ditë për ditë. Nga këndvështrimi i tyre, loja po vazhdohet, po pranohet nga populli dhe po fitohet ditë për ditë.

Por nga ana tjetër, paria është tërësisht e pasigurtë se çka mund të ndodhë me popullin e se si do të sillen shqiptarët me 23 qershor, e më mbrapa.

Sepse loja kishte kuptim sa kohë ata ishin të organizuar në dy skuadra kundërshtarë për vdekje. Tani po del se ata janë një skuadër që po bën stërvitje dhe e shet si ndeshje.

Vazhdimi i lojës dhe pranimi i saj, rrezikohet edhe sepse në këtë pikë e më pas, paria i mban njerëzit haptazi të lidhur vetëm e vetëm për interesa materiale. Por edhe qeni më besnik don të hajë tri herë në ditë. Kështu paria është në krizë dhe vazhdimi i lojës bëhet problematik. Paria përballet me shterrjen e burimeve materiale të shtetit, me mbylljen e rubinetës së punësimit, me mbriritjen e tavanit të marrjes së borxheve dhe të pagimit të tyre, me pamundësinë e dhënies së favoreve që nga doganat te licenca, me shtimin e daljen jashtë kontrollit të strukturave kriminale, me fuqizimin e vetëdijes në shtresa të caktuara se kjo gjendje nuk mund të vazhdojë më tej, me kthimin e emigrantëve, me humbjen e qartë të legjitimitetit

e të besnikërisë së masave dhe me përballjen e mundësisë së dështimit të marrëveshjes midis palëve, në nivele poshtë prijatarëve, në nivelin lokal. Këto janë disa nga aspektet e procesit që paria nuk i kontrollon dot më. Shqiptarët e pranuan lojën sepse vidhte paria, vidhnin dhe ata. Zinte toka paria, zinin toka edhe ata. E rripte shtetin paria, kocka mblidhnin dhe ata. Paria bënte pakte me krimin, shisnin droga, bënë trafikë e pislleqe edhe ata. Me një fjalë, ndërtonte plazhin e Gjirit të Lalzit paria dhe të gjithë katundarët u bënë me vila në Golem, Dhërmi e Divjakë. Edi Rama dhe Saliu bënë pallate, njerëzit shtonin kate. Paria vidhte ne shtet, njerëzit merrnin rryshfet. E kështu me radhë.

Dalja e bojës dhe fundi i lojës

Kjo është edhe pika ku vazhdimi i lojës rrezikohet. Oligarkia funksionon sa kohë që njerëzit përfitojnë. Sepse në momentin që njerëzit e mësuar me kalkulimin e ftohtë e racional të tramit të votës për favore që shkojnë nga thesi i miellit e gjeli i detit, te tenderi shumëmilionësh, nuk presin gjë, atëherë ndryshon loja. Njerëzit kthehen kundër parisë oligarkike dhe fillojnë t'i kundërvihen.

Është e qartë se me mendjen e vet paria e ka mbyllur rrethin edhe në këto zgjedhje. Diskreditimi i saj, frika se po vjen edhe fundi i lojës e se mund të fillojë një lojë e re, shihen qartë te listat e deputetëve. Çka nuk gjen! Trusti i Gështenjave, Orta e Jeniçerëve, Klani i Zemunit, Çeta e Lavatriçeve, hajde vërja emrin se ka dalë llumi mbi ujë e po bëhen deputetë. I gjithë pislleku kombëtar është duke u kandiduar për deputet. Këta janë paria. Sido që të shkojnë zgjedhjet, le të fitojë kush të dojë, Kuvendit do t'ia ndërrojme emrin e do t'ia bëjmë Kupola. Sepse të gjithë këta janë banditë.

Por edhe pse paria e Tiranës i ka fituar zgjedhjet, sepse kushdo që të fitojë do të bëjë të pamundurën të respektojë marrëveshjen, ka shumë të panjohura në këtë lojë. Arsyeja është se ka shumë palë të përfshira dhe gjithkush po luan për

vete. Sindikatat e krimit funksionojnë sa kohë që ka për të gjithë. Po edhe paria vetë e din se nuk ka më për të gjithë, se do të bjerë miu në thesarin e shtetit e do të thyejë turinjtë.

Edi Rama nuk do ta prekë Sali Berishën dhe Ilir Metën, për arsye të kuptueshme. Njërin e ka në koalicion e tjetrin nuk don ta bëjë “Martir të Demokracisë”. Prandaj thotë “Saliu duhet të ikë me nder”. Po çfarë nderi ka ky? Edhe mafia e ka “kodin e nderit” që në Tiranë pak a shumë përkthehet kështu: “vodhe sa vodhe ti me të tutë, tani e kam radhën unë me të mitë. Ik me të mire, se ndryshe do të bëjmë sherr dhe nga sherri humbim të dy. Ik me nder, o Sali, se nuk të bëj martir! Si nuk e bëre ti Fatos Nanon, si nuk të bënë Fatos Nano dhe Ilir Meta ty. Sepse shahemi nga nëna e nga motra, por jemi tanët, bre. Ti nuk më preke, unë nuk të prek. Më rrove, të rrova brisku i berberit”.

Por këtu janë në lojë shumë vetë me kobure plastike, me mushka droge, me trafiqe armësh, prostitucioni e organesh. Se ne jemi parajsja e krimit dhe e llumit dhe nëse Saliu, Edi, Iliri, apo edhe dreqi dhe i biri, mendojnë se këta iu janë besnikë, e kanë shumë gabim. Këta që nuk kanë lenë gjë pa bërë në faqe të dheut nuk i besojnë as kanatjeres që veshin e jo më shefave që janë treguar të pabesë gjithë kohën.

Vazhdimi i lojës

Ajo që është shqetësuese edhe për parinë, është pikërisht ajo çka do të ndodhë pas 23 qershorit kur dalja e bojës të bëhet e qartë edhe për budallenjtë. Sepse po shihet qartë se Sali Berisha e ka një shans për të qenë pjesë e qeverisjes. Se miq jemi, por kuleta kuletë e numrat numra. Po qe se Saliu i mbledh edhe ca vetë rrugës si Agron Duka, edhe po të dojë t’ia lërë Edit, nuk ka ç’u bën shefave të mafiave lokale, deputetëve me kobure plastike apo Lefterit që ia futi me lezet dhe e mori vendin e deputetit me një katundarllëk të paparë; mblodhi kushërinjtë, farefisnin dhe vuri Kozmain të këndonte: “o Sali t’u bëfsha ferrë/ merr pushtetin dhe njëherë/ krah për krah, o me Lefterë”. Hajde gjetje Lefteriane, hajdeeee! Nuk dinte ku t’i

çonte sytë Saliu... ama funksionoi manovra, e siguroi vendin në listë Lefteri. E sa ka PD e PS si Lefteri, aq të mira qofshin! Po ne jse, do ta shohim se kush është ferrë e kush është trëndafil.

Për shkak të shefave të mafiave lokale, të gjithë policë e doganierë, shikas e trafikantë, ka ndryshuar ekuacioni në të dy anët. Se ikja e Asllanit nuk e ndryshon lojën në Kukës, por e ndryshon në Bathore, ashtu si ikja e Kastriot Islamit sjell ca vetë që do të bëjnë ndryshimin për para në Tiranë. Por këto janë shenja se parisë i ka dalë boja dhe është krejt e pasigurtë për atë që vjen pas.

Në vend të përfundimit

Shkurt, parisë i ka dalë boja, tashmë ka ndërruar edhe loja. Marrëveshja do të ruhet, por torta do të ndahet pak më ndryshe. Saliu po sheh se ka më shumë shanse të ketë një copë të pushtetit. Edhe pse torta do të jetë e zvogëluar, këta që janë mësuar të hanë tortën me legenë dhe nga legenët e shtetit, do të ndjekin taktikën e njohur katundare të vjedhjes së votave si me vjedhjen e ujit nga vada natën. Te vada e ujit hiqet lesa e mbushet kutia.

Mënyra të ndryshme, por mendësi e njëjtë.

Prandaj edhe paria nuk është e sigurtë, nuk mundet me kenë e sigurtë a është kjo dalje e bojës diçka thjesht kalimtare apo është fundi i lojës dhe fillimi i një loje të re. Këtë do ta marrim vesh kur të formohet qeveria në shtator. Deri atëherë, edhe pse nuk e kemi krejt për herë të parë dhe jemi mësuar, na duhet me durue edhe marrëzitë, edhe poshtërsitë, edhe pafytyrësitë e parisë së Tiranës. Se ne na ka ngordhur gomari ka kohë dhe nuk na prish punë se vjen Edi dhe i shkull veshët, vjen Sala bën komision për veshët, vjen dreqi dhe i biri e merrren me veshët e jo me gomarin tonë që ka ngordhur e nuk ngjallet më duke i shkullur veshin.

KOMENTATORË DHE ZHURMUES, BRIGADA E PLEHUT NË INTERNET

Rreziku më i madh me të cilin përballlet një njeri që don të ofrojë ndonjë ndihmesë në debatin publik, ose thjesht të thotë mendimet e veta në një blog, siç bëj unë te Rrethi i Ferrit, është ndeshja me lukuninë e njerëzve anonimë që e kanë lirinë e pakufizuar të thonë çka duan, si duan pa e vrarë mendjen.

Por këta që komentojnë pa ndërprerje në faqet shqiptare në internet, nuk janë as njerëz, as anonimë, as të lirë. Si gjithherë, gjëja më e lehtë për t'u mësuar janë mbrapshtitë. Dhe në shtetin shqiptar, së bashku me Call Center që hapi italianit që ia dogjën BMW - në te Blloku, ky është profesion që të paguan mirë. Kjo është një ndër mbrapshtitë moderne të komunikimit që e kemi mësuar shpejt e shpejt e jemi bërë mjeshtra.

Natyrisht nuk e kemi shpikur ne profesionin e komentatorit profesionist. Por paria e Tiranës ka nevojë të jashtëzakonshme që mesazhi lidhur me të vërtetën që thuhet kryesisht në internet, të cilin ajo nuk e kontrollon, të mos mbërrijë kund. Edhe po mbërriti, ai duhet të zhvlerësohet. Nëse nuk zhvlerësohet mesazhi, atëherë duhet të zhvlerësohet njeriu. Në fund, njerëzit që jetojnë në shtetin shqiptar duhet të jenë e të mbesin tërësisht të çoroditur, sepse të vërtetat nuk bien nga qielli. Të vërtetat do t'i thonë njerëzit dhe puna e këtyre është t'i bëjnë të papranueshme. Dhe po e mbytëm një gjarpër të burimi i ujit, askush nuk do të pijë më aty. Po e diskredituam njeriun, atëherë mesazhi i tij nuk ka vlerë. Kjo është detyra e Brigadës së Plehut në Internet.

Në Tiranë kemi një zogori llapaqenërie mediatike që përmes televizioneve, gazetave, radiove, revistave dhe të gjithë

mënyrave të tjera të komunikimit që ka mision të përdredhë të vërtetën. Por internetin nuk e kontrollojnë dot. Dhe njerëzit shkojnë në internet, atje u ngatërrohet mendja dhe e gjejnë të vërtetën që paria lodhet kaq shumë t'ua fshehë. Sepse ja, shih gazetat! Në kioska shesin dyqind copë dhe këto i blejnë institucionet, por në internet lexohen nga dhjetramijë vetë në ditë.

Paria e di rrezikun e internetit në nxjerrjen e së vërtetës. Se mua e disave si unë, nuk na mbyllet goja dhe do të themi të vërtetën sa të kemi forcë të flasim e të shkruajmë.

Pikërisht për të përmbushur misionin e ngatërimit të mendjes, të fshehjes së të vërtetës, paria e Tiranës ka marrë në punë Brigadën e Plehut të Internetit. Këta janë një tufë rrogëtarësh që rrinë në zyra e në kafene dhe hamullisin pa ndërprerje në çdo shkrim që iu bie ndesh palëve respektive të parisë. Mund të jesh te një lokal simpantik dhe ai djali që sheh me laptop e që qesh gjithë kohën, që nuk punon e pi kafe e lexon në kompjuter, nuk është student. Ai është pjesëtar i Brigadës së Plehut të Internetit. Edhe ky konsulli që e vë emrin në komentet e tij, është pjesëtar i Brigadës së Plehut në Internet. Edhe ky ambasadori i lodhur, ky analisti i roitur, profesori me mani seksuale, ky... vërja emrin, që vetëquhet aristokrat, ky drejtuesi i emisionit që llap e llap dhe vetë nuk e di çka thotë, edhe këta që shkojnë në punë në katin e tretë të PD dhe që drejtohen nga "disidenti i djathit", apo ata të tjerët në zyrën në qoshe të PS, janë pikërisht të punësuarit në Brigadën e Plehut në Internet. Miratojnë, kundërshtojnë, shahen me njëri - tjetrin dhe krijojnë konfuzionin për të cilin edhe paguhen.

Ka mjaft fakirë që nuk dinë çka thonë, apo njerëz të edukuar që thonë gjëra të sakta në internet, por këta janë profesionistë dhe të zanatit. Këta dinë se si funksionon mendja e njerëzve dhe i gjen gjithkund, në gazeta, blogje, Facebook, forume. Këta janë Brigada e Plehut të Internetit. Aty ku ka një të vërtetë, këta i hedhin pak pleh përsipër. Aty ku nuk ka shumë pleh, këta e plotësojnë me aq sa duhet.

Profesioni i ri i zhurmuesit

Dikur kishte një njeri që e kishte detyrë të kthente antenën këndeje e andej dhe të ndizte e fikte me urdhër zhurmuesin. Tash këta pjesëtarët e parisë së Tiranës e kanë kuptuar se zhurmuesi i vërtetë është në mendjen e njerëzve. Sepse po ua bëre të bardhën të zezë dhe të zezën të bardhë, e ke zgjidhur problemin. Këta janë pjesëtarë të Brigadës së Plehut në Internet. Detyra e tyre është të merren me gjithkënd e me çdo argument. Dhe po panë se ke një mendim që nuk iu shërben kryetarëve të partisë, hedhin një dorë pleh. Po panë se ke hedhur mjaft pleh, siç ndodh rëndom me komentatorë që janë në shërbim të palëve të parisë si pjesëtarë të Brigadës Mediatike të Plehut, këta ta shtojnë edhe pak dozën dhe i fusin një të sharë të shkretit kundërshtar. Objektivi është i njëjti: të dobësohet apo të përforcohet mesazhi, sipas interesit të shefit të Brigadës së Plehut.

A funksionon Brigada e Plehut?

Brigada e Plehut funksionon dhe funksionon mirë. Ne jemi një popull që vdesim për thashetheme, që nuk i besojmë të vërtetës edhe kur e kemi para syve. Sepse duhet medoemos të ketë diçka të fshehur dhe këtë e marrim vesh vetëm te mulliri pa kokrra që është kafeneja ku nga mengjesi, deri në darkë, diskutohen pikëpamjet dhe vizioni i burrave shqiptarë për botën. Kryemerhumi e quante gazeta arabe, unë e kam quajtur gazeta katundare, po nuk ka ndonjë dallim të madh, se edhe arabët katundarë kanë qenë kur i kemi njohur ne. Nejse.

Thashethemet shpërndahen nga Brigada e Plehut pa kurrfarë kursimi e dhembje dhe funksionojnë. Ja të sjell ca shembuj që më kanë ndodhur mua vetë.

Njëri më pyeste: “po të kujtoj kush ka qenë babai jot!” Çka me i thanë? Me i thane se unë jam ndër të paktët që e di të sigurtë se kush ka qenë im’atë... Shko more vëlla e gjej se

kush është babai jot, sepse kështu si kanë ardhur punët, është mbushë bota me njerëz që nuk e dinë! Po ky tjetri që një e dy nuk ka lanë rrugicë të Gjuhadolit pa më përmendë! “A e din se kur ke kalue te kjo rrugica?...”. Kah kam pasë me shkue? Te ajo rrugica asht dashtë me kalue! Asht njëri që duket e ka detyrë me thanë se kam qenë kapterr... Një e dy e “Shenazia ka kenë kapterr”. Më e bukura është akuza që më bën njëri që një e dy më thotë se kam qenë spiun i sigurimit. Unë nuk kam kenë kurrëgjia hiç, as spiun, as oficer, por me thanë të vërtetën, ba me më pasë ba oficer të sigurimit, isha sjellë ndryshe... Por këta sa më shumë kam shkruar, aq më shumë më kanë rritur gradën. Njëri bile me bëri DS Nasi, shefi i sigurimit të qytetit “Studenti”! Një tjetër me shkruante: “A e din kur spiunoje ata që takoheshin fshehtas me të huajt?”. More vëlla, fshehtas e hapur jam takue unë me shumë të huaj, bile ka dalë një revistë jashtë shtetit në qershor të vitit 1990, e thotë se takuam një Shenasi Rama në Shkodër e na tregoi se ku i kishin hedhur eshtrat e Fishtës. Me sa duket këta kanë marrë dosjen time dhe po e kthejnë çdo gjë mbrapsht. Lexoje, more dosjen, apo ia keni lanë në kujdestari një kopje Gjergj Lezhjes e një kopje Fahr-el-din Balliut, të Bekuarit të Vetëm Apostolik?

Shkurt, si rregull unë i lexoj komentet që bëhen në shkrimet e mia. I lexoj në Facebook, i lexoj në blogun tim Rrethi i Ferrit dhe në komentet e gazetave që botojnë shkrimet e mia. E ndjej detyrë me dëgjue njerëzit dhe me i kuptue si duhet. Shpesh marr mendime të vyeshme, ide për shkrimet dhe argumente që vërtetojnë atë çka mendoj e di unë. I respektoj shumë miqtë e mi që harxhojnë kohën e komentojnë, më korigjojnë, me venë në dukje gabime etj. E ndjej shumë përgjegjësinë për atë që them, sepse nuk dua të them mendime të gabuara dhe t’i zhgënjej. Nuk përtoj të komunikoj me njerëz që i njoh, me njerëz që nuk i njoh, me pseudonime, me njerëz që kanë personalitete të shumëfishta dhe me ata që janë krejtësisht të turbullt. Është detyra ime. Përderisa shkruaj e përderisa më lexojnë, duhet të përgjigjem. Nuk do të shkoj deri në nivelin

e Mustafa Nanajt që hapi një rubrikë “ju pyesni, Muçi përgjigjet”, por ama lexuesin e respektoj dhe do t’i përgjigjem. Ja një shembull:

“O miq, mua më duket se ky i shkreti nuk është mirë nga mëhalla e sipërme. Jeton në një botë virtuale që e ka krijuar brenda një nate dhe i duket vetja perëndi. Fut në një epruvetë terma, fjalë, ngjarje, insinuata, hamendësime, këshilla, sentenca e pasazhe teorike dhe pasi i tund fort, na i hedh ne si bar çudibërës. E kam thënë edhe një herë tjetër; ky Shinasiu punon në avancë që pas zgjedhjeve të vijë në Shqipëri, të krijojë një parti të tijën me synimin që të dalë me shpatë si shpëtimtar kundër asaj që ai e quan “paria e Shqipërisë”. Mua më duket një eklektik klasik që merr poza profeti, sepse kujton se ka të bëjë me budallenj e me katundarë, siç shprehet shumë shpesh. Don Kishot tipik i kohëve moderne”.

Çka t’i përgjigjem këtij njeriu? Por edhe kur nuk di çka me iu përgjigjë, këta të Brigadës së Plehut në Internet i lexoj ma me andje se gjithçka tjetër. Këta më argëtojnë! Tashti po sjell një koment të tyre që më ka shkri gazit:

“Sa për dijeni, ky Shemja ka si idol Zhozefinën, Dizenjatoren e Pallavrave të Leshit të patjerrun. Kshtu osht dhe kjo puna e ktij intelektualit prej Hamerike, tjerr e tjerr... e bone golfin gati me e vesh në dimën, o Naçoooo”.

Ama... këtij nuk i përgjigjem! Se ky shihet nga katër “o” radhaz që ka marrë sëmundjen e shefit të vet! Po kushedi për cilin e ka, se unë nuk e njoh veten këtu. Hajt ma, duhet me pasë mëshirë edhe për këta, sepse edhe këta duhet me fitue rrogën. Dikur vinte një makinë që pastronte gjirizin. Tash kemi laptopin dhe Brigadën e Plehut në Internet që qelb të gjithë dynjanë. Por duhet me vazhdu e me thanë të vërtetën. Ne na ka ngordhur gomari me kohë, por vetëm e vërteta ka me na shpëtue, një nga e një e të gjithëve bashkë.

OLIGARKIA, PARIA E TIRANËS DHE FAMILJET MAFIOZE LOKALE

Në listat e kandidatëve për deputetë kishte kushërinj, krushq, kunetër, spiunë, sampistë, policë, doganierë, hetues, ndërtues, bodigardë, trafikantë... Mbi të gjitha, kishte lista të konsoliduara të familjeve mafioze të politikës shqiptare, si të Ortës së Jeniçerëve, Trustit të Gështenjave të Tropojës, Klanit të Zemunit dhe të Çetës së Lavatriçeve. Më i pastri në këto lista kandidatësh, është Ilir Meta. Sepse ky ta thotë në sy dhe kur e bën e bën si burrat. Edhe kur i merr 700 000 euro për shtatë minuta (dhe del i pafajshëm) të thotë në sy se nuk i ka marrë. Kush është ai burrë që thotë se ky të fut një plumb? Përse nuk i ndodh ende gjë Dritan Priftit?

Kishte ca emra të rinj që nuk i njihja fare. E kështu hapu edhe ato kartelat me biografinë e secilit që i mbaj në një vend, sepse në listë më dolën edhe disa emra që nuk i njoh, ose që i njoh pak, sepse duket sikur sa dolën nga sirtarët. Por pasi e vrava trurin, gërmova pak më shumë, pashë për kë kishin punuar, kush ishin daja, burri, krushqia, xhaxhai e babai dhe i gjeta edhe të dhënat e këtyre në kartelat e të tjerëve. Sepse ca i njoh mirë, e për dreq, edhe më mirë nga sa dua t'i njoh; gjithkush e ka një shqisë që e bën të jetë më i vëmendshëm kur e ndjen gjarpërin rrotull dhe unë nuk bëj përjashtim. Por shumë nga këta që nuk i njihja mirë apo hiç fare, kishin qenë ata që ishin përdorur për punët e pista, që nga institucionet e shtetit, ministritë, zyrat, partitë e deri te strukturat e shoqërisë civile. Kanë mbaruar shkollat jashtë, rrinë në hije, lënë baseta dhe

i fryjnë flokët, por njëloj janë, gjarpërinj si mjeshtrit e ustallarët e tyre.

Gjithsesi, duke e ditur që të gjithë do të flasin për listat e do të merren me kandidatët, me krimet që kanë bërë, me të përjashtuarit etj., etj., dhe në Rrethin e Ferrit ka pasur disa shkrime shumë cilësorë, vendosa të përqëndrohem në një paradoks kyç. Paradoksi është zgjerimi i rrethit nga paria dhe njohja zyrtare e familjeve mafioze lokale si forca politike të mirëorganizuara. Nuk është gjë e re po të them se në shtetin shqiptar sundon krimi i organizuar. Nuk është as e panjohur që shqiptarët po detyrohen të zgjedhin midis dy karteleve të familjeve kriminale. Këta që pajtohen për të grabitur, vvarë, rrënuar e shkatërruar shqiptarët, luftojnë si familjet mafioze për territor. Paradoksi është se në këto lista, shihet që familjet e mëdha mafioze iu kanë bërë vend edhe familjeve lokale. Kuvendi është bërë Kupola.

Listat e deputeteve të sigurtë dhe të atyre që do të luftojnë me njëri - tjetrin, treguan qartë se sistemi është një oligarki e pastër mafioze me klane katundare kriminale. Një grusht familjesh kriminale që kontrollojnë ekonominë, propagandën dhe vlerat, kontrollojnë edhe politikën. Organizatat e parisë kanë, si çdo ndërtesë, një fasadë që është moderne e që quhet parti. Këto struktura janë shumë të bukura nga jashtë, por brenda janë si kampe përqendrimi që sundohen me dorë të hekurt nga kryetari respektiv dhe që na shesin ushtarët e tyre si politikanë. Brenda këtyre partive ka klane të pastra mafioze e kriminale, njerëz që kanë bërë të pabërën dhe që nuk ndalen para asgjëje. Këta janë ata që njihen si Orta e Jeniçerëve, Trusti i Gështenjave të Tropojës, Mister Ndërtuesit, Çeta e Lavatriçeve, Klani i Zemunit dhe disa struktura të tjera të këtij niveli, emrat e të cilave dihen, por nuk thuhën, sepse njerëzit kanë frikë.

Por listat ishin të balancuara. Familjet e njohura mafioze kishin një përqindje të sigurtë të deputetëve. Ama të tjerët që ishin në lista, ishin disi panatyrshëm në ato vende, sepse nuk

janë pjesë e oligarkisë së Tiranës, po janë pjesëtarë e përfaqësues të klaneve mafioze e kriminale lokale katundare.

Prandaj fenomeni më i spikatur i këtyre listave, është tërheqja e familjeve mafioze të parisë së Tiranës të drejtuara nga Sali Berisha, Edi Rama, Gramoz Ruçi, Ilir Meta dhe ata kapitenët e familjes si Fatmir Mediu dhe të klaneve që janë duke ndenjtur me vetëdije jashtë politikës, për të hyrë, ose më mirë për t'u kthyer më 24 qershor si shpëtimtarë, si ministra apo si luftëtarë. Listat tregojnë se paria pranoi që edhe familjet mafioze lokale të vendosin deputetët e përfaqësuesit e tyre në vendet më të sigurta, më të shkëlqyera e më të garantuara në lista. Kompromisi i arritur midis parisë sunduese të Tiranës, klaneve të familjeve mafioze, vëllazërive cubnore katundare krahinore nga një anë dhe mafiave të vogla lokale të drejtuara nga kandidatët për deputetë në këto lista (ose nga vëllezërit, vjehrrët, kushërinjtë, vëllamët etj.), nga ana tjetër, është tregues për shumëçka.

Çka tregon kjo? Kjo tregon se paria e Tiranës i ka frikë dhe është e pazonja t'i kontrollojë familjet mafioze lokale. Me një fjalë, paria e Tiranës në thelb është dorëzuar para këtyre strukturave mafioze lokale. Sali Berisha mund t'ia presë krahët Jozefina Topallit e Ridvan Bodes, por nuk ka ç'i bën as Dashnor Sulës e as Iglj Carës, pardon, Sokol Olldashit, Lefterit e Sherefedit. Edi Rama mund të luajë me Erjon Braçen, por Xhemal Qefalisë nuk ka ç'i bën se ikën e gjithë komuna e Dajtit. Ilir Meta nuk e prek Lefter Kokën për të mos folur për të tjerët. Saliu e hodhi poshtë autobusit Nikollë Lesin pa u kthyer nga Spiteni në Tiranë, sepse ka një bandë tjetër që ofron 1218 vota të numëruara kokë më kokë. Kështu, duke parë listën sheh banda, kriminelë, mafiozë, vrasës që kanë vënë përpara nusen e vëllait dhe e bëjnë deputete në parlament.

Do të ishte e pranueshme, po të ishin fytyra të pastra. Por këta as nuk lodhen për të mashtruar. Ajo që bie në sy është numri i individëve në lista që janë njerëz të arrestuar, dënuar, hetuar, burgosur etj., etj., që shkurt kanë pasur marrëdhënie

jo të këndshme me drejtësinë edhe brenda, edhe jashtë vendit. Me qetësi numërova individët që nuk kanë marrë vizë nga ambasadat e vendeve të huaja, se këtë e mbaj në kartelë. Dhe më dolën një grusht i mirë. Gramoz Ruçi nuk mori vizë për në SHBA. Lefter Maliqi u refuzua nga Mbretëria e Bashkuar. Agron Duka nuk mori vizë kur ishte Ministër i Bujqësisë. Një kandidat e zunë duke ikur me tren te dashnorja dhe e kthyen me vrap. Një kandidate e zunë duke vjedhur fustan në supermerkato. Një tjetër e ndalën në aeroport. Një tjetri i kanë vënë videon me atë zonjushën që nuk donte të bëhej zonjë... E kështu me radhë. Të gjithë kanë nga një histori që të ngre qimet e kokës përplotë.

Më një fjalë, listat quhen “të fitores”, por i ngjajnë radhës së nevojtores në burgun përjetë që nuk e kemi! Ky burg duhej të ishte për kriminelët, hajnat, cubat, banditët, të zvetënuarit, spiunët, dyfytirëshat, trefytirëshat, asnjëfytirëshat, fytyrëmunguarit, fytyrëharxhuarit, fytyrërreckamanët dhe fytyrëdhjeramanët. Sepse kur këta që duhet të jenë në burg si pjesëtarë e ushtarë cuba e hajna, banditë e vrasës të klaneve mafioze, duan të jenë deputetë, a ka burrë nëne që të mendojë të fusë në burg trafikantët, vrasësit e vegjël, mashat e këtyre, ustallarët e gomoneve, pushtët e kodoshët, masakarenjtë dhe llumin që bën poshtërsi të vogla përditë e gjithkund në shtetin shqiptar?! E vetmja gjë e mirë që kanë bërë, është që nuk e kanë çuar listën te Interpoli, sepse kushedi sesa vetë do të hiqeshin apo do të dorëhiqeshin menjëherë.

Këta janë në krye, ajo pjesa që nuk duhej të ishte as në fund. Por këta janë përfaqësues të fuqishëm të mafiave lokale. Nëse bandat që kanë përfaqësuesit e tyre në politikë arritën të mbrijnë deri këtu, si iu bëhet gjatë e pas zgjedhjeve? Kuvendin do ta bëjmë Kupolë. Dhe kjo do të jetë kupola e oligarkisë më kriminale në botë, sepse këtu i gjen të gjithë mostrat; të kriminit e të jetës së nëndheshme. Ky Kuvend nuk do të jetë një ndërtesë me ngjyrë e me dritë të kuqe, sepse partitë i kemi me të gjithë ngjyrat e ylberit, por është një paradhomë gjykate a

burgu. Këta duhej të ishin në burg. Këta kanë qenë në burg, edhe kur kanë qenë hetues e gardianë, spiunë e informatorë, quadro kursesh në Pukë e konviktorë të uritur pa bukë, doganierë, policë e oficerë.

Megjithatë, me këtë akt balancimi vetë familjet mafioze u konsoliduan. Listat janë të mbushura me njerëz shërbëtorë pa kushte të kryetarit të partisë respektive. Nuk kisha pritur të kandidoheshin shefat e ata që kanë bërë shërbime të pa-fund në nivelin kriminal, por këtu na dolën shegertët e rinj që e kanë mësuar zanatin qysh kalamaj e duket edhe në familje, shokët e Xenit e të Argitës, të Nar Kokës, të Edi Ramës e të gjithfarë bande të parisë. Njerëzit i njohin mirë. Sepse shumë nga këta që i njoh kaq pak unë, më falet se jam në mërgim, e kanë bërë të gjithë shkollën e djallit. Ka shumë të rinj që vijnë nga nuk ta merr mendja, por që kanë bërë 99 poshtërsitë e mundshme dhe këtë e di mirë. Këta janë të rinj, por të regjur në poshtërsi të vjetra. Sepse familjet vunë në lojë fytyrat e pas-tra të tyre dhe ata ishin të gjithë të stërvitur. Këta janë djem e vajza të reja që nuk kanë njollë nga e shkuara e sistemit të mëparshëm, por kanë kaluar në shumë duar që i kanë mësuar e stërvitur derisa janë bërë mjeshtra gjatë tranzicionit. Paria po riciklon veten.

Në vend të përfundimit

Ngado që ta sjellësh, Kuvendi që do të caktohet me 23 qershor, se këtu nuk bëhet më fjalë për zgjedhje, do të për-bëhet nga tre lloje njerëzish dhe të gjithë do jenë në shërbim të krimit të organizuar. Do të ketë bedelë, kriminelë dhe te-veqelë. Ka njerëz që i kanë të gjithë cilësitë, por shumica jo. Disa janë beadle, sepse i shërbejnë qorrazi dikujt, bëjnë qokën

me votën dhe e kryejnë punën. Shumica janë kriminelë, sepse nuk kanë lënë gjë pa bërë në të shkuarën dhe nuk ka as edhe një pikë dyshimi se nuk do të lënë gjë pa bërë edhe në të ardhmen. Një grusht janë teveqelë, domethënë janë njerëz kot, por duhen si bedelë e si fasadë për kriminelët. Të gjithë janë të pandashëm dhe lidhen në një sistem që është oligarkia politike e kriminale e parisë së Tiranës dhe klanet e saj. Prandaj duhet bërë kujdes, sepse këta janë ata që janë. Këta të gjithë e kanë burgun në kokën e tyre. Dhe prandaj do të punojnë që ta bëjnë shtetin shqiptar një burg gjigand për të gjithë ne.

KOMBËTARIZMI SI FAKTOR I PASHMANGSHËM NË POLITIKËN SHQIPTARE ËSHTË VETËM ÇËSHTJE KOHE

Në shkrimin e një miku dhe kolegu që doli dje në blogun Rrethi i Ferrit, vura re shumë nota trishtimi dhe pesimizmi lidhur me rrugën që po merret nga shqiptarët dhe lidhja me fatin e nacionalizmit në politikën shqiptare. Për të, si dhe për shumë të tjerë, mënjanimi i shpejtë politik, shkrirja e strukturave të AKZ, është një moment krize e thellë morale, identiteti dhe vlerash. Dukshëm AKZ dhe nacionalizmi politik shqiptar ndodhet nën një sulm të fortë nga ana e parisë së Tiranës. Braktisja sistematike dhe e organizuar e strukturës nga njerëzit dhe drejtues qendrorë e locale, synonte thyerjen e plotë të kauzës kombëtariste.

Duhet thënë se pragmatizmi dhe përdorimi afatshkurtër i një ideologjie që ofron vetëm zgjidhje të mundimshme dhe afatgjata nga ana e vetë drejtuesve të AKZ, përbën një problem të madh politik. Kësaj nuk i ka ndihmuar karikaturizimi i ideologjisë dhe i strukturave në media. Ashtu si nuk i ka ndihmuar populizmi dhe përçafimi i sjelljeve që në politikë sjellin vetëm shqetësime që nuk i shërbejnë askujt. Kombëtarizmi është një ideologji serioze dhe duhet marrë seriozisht.

Për kolegun në fjalë, në mos tjetër, kjo që ndodhi me AKZ është edhe rënia e nacionalizmit politik shqiptar.

Mendoj se një pozicion i tillë është i gabuar. Për ta thënë në mënyrë figurative, paria e Tiranës ia arriti të shmangte efektet e nacionalizmit politik, ashtu si ai që ka ndërtuar një kështjellë rëre dhe shpëton duke u shtrirë midis saj dhe detit. Por edhe

nëse e shpëton gjithë ditën, kur të vijë zbatika, nuk e mbron dot krijesën e vet. Pra, kjo shmangie e nacionalizmit politik, që gjithsesi përbën një sukses të madh për parinë, është e përkohëshme. Krijimi i një gjendjeje të re, do ta rrezikojë e do ta prishë kështjellën e rërës. Në këtë pikë, thirrja e kolegut për të vazhduar punën është e lavdërueshme, logjike dhe zgjidhja më e drejtë.

Nuk është koha me analizue sjelljen politike të individëve dhe të strukturave që janë bartës formalë të çështjes së nacionalizmit politik në politikën shqiptare edhe në këto zgjedhje. Gabimi themelor që bën kolegu, mendoj se është lidhja e fatit me të ardhmen së ideologjisë kombëtariste, me një parti politike dhe me individët që janë në krye të strukturave. Rënia e individëve dhe e strukturave të tilla, nuk përkethehet në rënie apo dështim të ideologjisë dhe të zgjidhjeve që ajo ofron, sepse në realitet janë beteja në një luftë që vazhdon e që nuk ka mbaruar. Individët vijnë e shkojnë, por interesat, vlerat dhe identiteti mbeten.

Ideologjitë politike janë shumë më të mëdha se individët që i bartin ato në politikë. Ka pasur shumë parti nacionaliste, politikanë që kanë qenë e janë nacionalistë edhe në Tiranë. Por fati i tyre politik, ka qenë i hidhur. Ose janë thyer nga paria, ose janë sulmuar deri në fund e janë diskredituar, ose janë detyruar të mërgojnë. Ka nga ata që nuk janë pranuar nga shqiptarët për arsye të ndryshme, ndër të cilat edhe paraqitja e nacionalizmit politik si një aventurë apo si një mjet politik i përdorur nga horrat, të cilët ne i kemi me shumicë. Por shpesh, arsyeja më kryesore ka qenë paqartësia e duhur ideologjike, aftësia për me ofrue zgjidhje realiste në interes të grupit dhe të individëve, në kushtet ku jemi gjendur. Edhe këtë herë, problemi ka qenë pak a shumë i ngjashëm. Ajo që ka ndryshuar është gjendja dhe mbi të gjitha, mendësia e brezit të ri.

Duke e parë me sy të ftohtë atë që ka ndodhur e që ndodh në lidhje me AKZ, mund të thuhet me qetësi se nuk u ndërtuan struktura politike që funksiononin në bazë të një ideologjie

të qartë. Një strukturë politike është e suksesshme, edhe kur ndjek një individ karizmatik, por që nuk ka asnjë ideologji përveç interesit personal dhe të klaneve që përfaqëson, si në PD. Së dyti, një strukturë është e suksesshme në politikë, kur njerëzit iu janë besnikë strukturave, siç ndodh me PS. Nuk ka rëndësi kush është në krye të PS, sepse njerëzit do të votojnë në strukturën. Por një parti ideologjike nuk mund të identifikohet me individë të veçantë, sepse ideologjia nuk i përket një njeriu. Prandaj gabimi kryesor që ndodhi është se duke ndjekur metodën e "rrotës së qerres" një individ nuk mund të jetë boshti ku mbahet struktura. Ideologjia duhet të jetë boshti. Rënia dhe ngritja e një njeriu, mund ta influencojë, por nuk mund ta ndërrojë themelin ideologjik të strukturës.

Ideologjia kombëtariste buron në mënyrë të pashmangshme nga katër ekzigjenca të çdo shoqërie normale e të çdo shteti normal. Këta faktorë, jo vetëm e stimulojnë lindjen e kombëtarizmit. Ata e bëjnë të pashmangshëm, të nevojshëm dhe shumë të dobishëm për jetën shoqërore.

Nevoja e parë është ajo e jetesës në një shoqëri të moralshme. Njerëzit dhe shoqëritë duan të jetojnë në një shoqëri që mbron të mirën e që lufton të keqen.

Nevoja e dytë është pashmangshmëria e nevojës që individit të ketë identitet të qartë, të jetë vetvetja. Një identitet i tillë fitohet vetëm në një grup që edhe të shtërngon, edhe të mundëson jetesën me dinjitet, me siguri, si i barabartë me të gjithë pjesëtarët e grupit.

Nevoja e tretë vjen nga shteti. Shteti ka nevojë për besnikërinë e pakushte të qytetarëve ndaj tij. Për të arritur këtë, duhet jo vetëm shteti, por edhe qytetarët ta shohin kombin si formën e natyrshme të organizimit shoqëror. Pra, shteti e sheh kombin si formën më të mirë shoqërore dhe kombi e sheh shtet - kombin si strukturën me efikase politike për të arritur të mirën shoqërore.

Së katërti, nevoja e kombëtarizmit lind nga politika e madhe që i sheh njerëzit dhe shoqëritë të organizuara në grupe.

Sa më të forta e sa më kohezive të jenë grupet, aq më e mundshme është mbijetesa e tyre dhe mundësia për të pasur siguri, mirëqenie, begatim, paqe shoqërore dhe shmangie të luftës e të përplasjes midis individëve brenda grupit, por edhe me grupet e tjera në nivelin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Në vend të përfundimit

Duhet thënë se pavarësisht dallimeve, pajtohem me bindjen e kolegut që po i referohem, se masa e madhe e të rinjve ndarë tashmë me sistemin e parisë, që duan një shtet - komb normal e modern, nuk duhet të zhgënjehet, nuk duhet të braktiset dhe nuk duhet lënë të manipulohet nga segmentet e parisë. Nacionalizmi shqiptar do të mbijetojë krizën e AKZ dhe të strukturave të saj. Nuk ka asnjë dyshim për këtë. Sepse thënë figurativisht, edhe anija, edhe trapi bëhen me dru. Por mënyra se si ndërtohen, e për çka shërbejnë, përcakton edhe mundësitë që kanë, si dhe sa larg munden me shkue. Prandaj, ndryshe nga kolegu, mendoj se është vetëm çështje kohe, para se kombëtarizmi të rikthehet fuqishëm në politikën shqiptare, si zgjidhja e vetme dhe logjike e daljes nga kriza ku na mban paria e Tiranës.

TRI FUSHATAT ZGJEDHORE, PARIA, PARTIA DHE KLANET LOKALE

Ajo që nuk po theksohet si duhet, është se në shtetin shqiptar nuk po zhvillohet një fushatë në tre nivele, por po zhvillohen tri fushata elektorale në nivele të ndryshme. Si duhet kuptuar kjo?

Në shtetin shqiptar janë krijuar e konsoliduar struktura politike që janë jashtë kontrollit të qendrës. Si thotë Grid Rroji, ka ndodhur grimcimi dhe fragmentarizimi i strukturave dhe fushata po e nxjerr haptazi në shesh këtë fenomen problematik për parinë.

Nuk është e vështirë për të parashikuar origjinën dhe pasojat e një fenomeni të tillë. Origjina është në vetë strukturat e parisë dhe në ligjin elektorale. Pasojat janë të prekshme që tani në dobësimin e kontrollit të qendrës mbi strukturat lokale të partive respektive. Në fakt, strukturat lokale po dalin shumë më të forta e më rezistente seç ishte llogaritur nga qendrat. Zgjedhjet e pritshme lokale do të jenë vendimtare për këtë shkërmoqje, por shenjat po jepen edhe në këto fushata.

Cilat janë tri fushatat?

Fushata e parë është ajo që po shohim në media e në rrëmujën e qëllimshme të dizinformacionit e të llapaqenërisë mediatike, duke e mbajtur një sy nga të huajt e një tjetër nga shkelja e rregullave.

Fushata e dytë është fushata e prijatarëve që duan të konsolidojnë mbështetjen e tyre.

Fushata e tretë është fushata e bandave lokale që kanë in-

teresat e tyre në lojë. Ethet e fushatës janë shtrirë në të gjithë shoqërinë që muajin e ardhshëm duket se do të jetë krejt e paralizuar.

Përse po ndodh kështu?

Sistemi elektoral që po përdoret nga paria e Tiranës, ka mundësuar shkërmoqjen e partive politike dhe fuqizimin e bandave lokale. Këto nuk janë mirëfilli makina politike, por janë struktura kriminale që kanë një dimension të hapur politik. Tashmë edhe në nivelin lokal.

Fushata e prijatarëve dhe zhurma mediatike

Në këtë fushatë dallohen qartë përpjekjet e parisë, të medias, të komentatorëve dhe të shtypit, për të paraqitur një pamje të normalitetit politik. Por ajo që thuhet, që analizohet apo që komentohet është shumë larg realitetit. Mungesa e objektivitetit është e prekshme. Synimi është që të cyten njerëzit për t'i dalë kundër palës tjetër. Prandaj këta merren me xhingla - mingla dhe duan ta shtyjnë me sot e me nesër. A behet Ilir Meta kryeministër? Ti je betonues! Ti je pengues! Unë jam serioz!

Saliu merret me batuta, gjen nga një në ditë. Merr atë folësen ku shkruhet se ai është ndryshimi dhe shkon nga një mbledhje katundi te tjetra, ku bie në sy rruga bosh pas shpine. Duke gjykuar nga sjellja e tij, që nuk ka ndryshuar fare, influenca e Podesta qenka zero dhe paratë kanë shkuar kot, sepse Saliu po bën të njëjtën fushatë katundare që ka bërë gjithmonë dhe që i ka funksionuar. Shpifje, mashtrime, hile, kunja, batuta e përdredhje argumentesh gjithnjë me katundarin e shkretë në mendje dhe me qëllimin e pandryshuar që ta përdorojë. Nuk ka rëndësi e quan fermer apo qytetar, Saliu iu flet katundarëve sipas teknikës që thotë se “kur je çekan, gjithkush të duket gozhdë”.

Edvin Rama iu flet qytetarëve, por në fakt shumica janë katundarë që e shohin Edvinin si të largët e të huaj, sepse nuk po

i përshtatet kulturës dhe mendësisë së tyre, por po kërkon t'i ndryshojë. Kurrë më shumë se sot, nuk ka vlerë ajo shprehja popullore, "si të jetë vendi, bëhet kuvendi" dhe "gju me gju me popullin", sepse shihet se pikërisht kjo i mungon fushatës së PS, që duket se kërkon të ndryshojë mendësinë e popullit në mes të fushatës.

Por sherri personal dhe mediatik midis tyre, është thelbi i fushatës së parë e cila ushqen edhe median që duket sikur nuk sheh tjetër. Kjo përplasje po bëhet strumbullari i një fushate tjetër të dështuar politike në nivelin e prijtarëve dhe të medias që iu shkon mbrapa, në fletushkat e traktet që nxjerrin të dy palët dhe natyrisht, në emisionet televizive ku mblidhen si në kafene, opinionistët që iu bëjnë lavazhin e trurit shqiptarëve.

Fushata politike brenda strukturave partiake

Megjithatë, përtej këtij niveli, tensionet janë shumë të forta dhe këta i kanë sherret brenda partive. Partitë e tyre po shkërmoqen, sepse Saliu don ta kthejë partinë në kala të familjes, Edi të prishë kalanë që kanë kontrolluar të vjetrit dhe Ilir Meta duhet me doemos të gjejë punë për partinë, sepse në fakt partia e tij është partia e punës, domethënë partia e vendit të punës. Por askush nuk është i sigurtë se çfarë niveli kontrolli do të kenë mbi ekipet e tyre nesër. Të vetmit lojtarë politikë që vijnë të sigurtë në këto zgjedhje me struktura të qarta e me plan të qartë pune, janë Ilir Meta dhe Blloku i Grekëve.

Ilir Meta do të jetë faktori që do të përcaktojë balancën dhe do të jetë, ashtu si e kam parathënë tash dy vjet, boshti i qeverisjes së bashku me grekët. Sepse ngado që të sillen, grekët do të marrin të paktën shtatë vende.

Nga ana e tij Sali Berisha po lufton fort që të fitojë mbështetjen e njerëzve për Trustin e Gështenjave. Gjithkund ka gjetur një grupim sado të vogël, por me influencë lokale që t'ua vërë përballë klaneve lokale. Me këtë synim po punon që të dobësojë Jozefinën, Ridvanin, që nuk ndjehet dhe Sokol Oll-

dashin. Ylli në ngjitje në PD, është beniamini i familjes, Lulzim Basha. S'ka rëndësi sa të madhe e ka dosjen Basha, shpejt do të vijë koha që kostumi që po i jep Berisha do t'i duket shumë i ngushtë e shtrëngues. Tensionet për të mbledhur votat dhe për të mbajtur radhët e shtërnguara janë të dukshme. Edhe këtë herë njerëzit do të votojnë për partinë, strukturën dhe siglën, por shenjat e krisjes janë qartësisht të dukshme dhe të pariparueshme.

Fushata kriminale lokale

Ashtu si edhe është ngritur si problem në blogun Rrethi i Ferrit, shumë nga kandidatët për deputetë duhej të ishin në burg, sepse janë me dosje kriminale, të kapur me gjithfarë mallrash, të regjistruar nga gjithkush dhe jo rrallë, edhe me dosjen gati. Në fakt kemi kandidatë që janë edhe në paraburgim si Arben Frroku. Kandidatët që iu janë imponuar qendrave të partive për shkak të mbështetjes lokale që kanë fushatat e tyre. Edhe kur strukturat lokale janë mënjeluar, prapë roli i tyre sa vjen e bëhet më qendror. Personalitetet lokalë të njohur e të rinj si Qazim Sejдини, Stefan Çipa, Elvis Rroshi, Lefter Maliqi, Dashnor Sula, Lefter Koka, Ilir Bele, Xhelal Mziu, e me radhë tani janë në fushatë për veten e tyre. Mbijetesa është e garantuar jo më nga lidhja me parinë e Tiranës, por nga aftësia e tyre për të mbajtur bashkë klanet lokale. Nuk ka rëndësi kë vendos në krye të listës që vjen nga Tirana, llogaritë do t'i bësh me "të fortët e qarkut". Duke qenë se në traditën tonë katundare, një pjesëtar i familjes shkon nga një anë dhe një pjesëtar i familjes shkon nga ana tjetër, ka ardhur puna që në krye të klaneve kundërshtarë në nivel qarku kemi kushërinj të parë e të dytë, kunetër e krushqi, bile dy vëllezër në një listë partie. Nuk ka rëndësi se kush e zgjedh Agron Dukën, Lefteri thotë se ai do të jetë me socialistët. Agron Duka thotë se ka moral politik dhe do të jetë republikan deri në fund. Nuk ka rëndësi kush fiton nga klani i Elezëve, familja Elezaj fiton në

Kukës. Dhe më tepër se kaq, në PS rezistenca kundër qendrës po bëhet e dukshme, flitet për fenomenin Arben Malaj dhe Agron Duka, por nuk flitet sa duhet për Ilir Gjonin dhe familjen e Enver Hoxhës.

Edhe në PD ka plasur sherri që nga Shkodra në Burrel, nga Kavaja deri në Gjirokastër. Në Shkodër ka shumë pakënaqësi që nuk do të vonojnë të dalin në sipërfaqe. Në Burrel u desh të ndërhynte policia në takimin e deputetëve me strukturat lokale. Sali Berisha e ka caktur Lulzim Bashën në Kavajë, por Kavaja tashmë është lidhur pas interesave që kanë krijuar një strukturë të fortë lokale në krye të së cilës është Elvis Rroshi. E kështu me radhë.

Një shenjë tjetër e qartë e tensioneve është mobilizimi i parakohëshëm dhe mitingash i masave të gjera që do të arrijë nivele histerie në javët e ardhshme. Paria mendon se mund t'i kontrollojë dhe do të mundohet fort të gjejë mënyrën për të mbyllur sherrin. Por ka dalë djalli nga shishja. Klanet lokale nuk e luajnë më lojën për partitë e Tiranës, por për interesat e tyre në politikë. Me të njëjtat metoda që u bënë biznesmenë e afaristë, tani duan të bëhen politikanë e deputetë, në mos në këto zgjedhje, doemos në zgjedhjet e ardhshme. Prandaj duhet t'i kushtojmë vëmendje tri fushatave që po zhvillohen paralelisht në këto zgjedhje.

SHERRI I PASHMANGSHËM, LOJA E TENXHEREVE ME PRESION DHE ZJARRI I PASHUAR

Frikën më të madhe paria e Tiranës nuk e ka se është e diskredituar, se vendi është në krizë, se ekonomia është e falimentuar, se rinia nuk ka shpresë dhe se vendi është i sunduar nga krimi e nga paligjshmëria, se kauza e integritetit është e një rrenë e pastër, se mungojnë programet e duhura, se kandidatët janë njerëz që e meritojnë të jenë në burg, se fushatat po bëhen me para që s’dihet nga vijnë, etj., etj. Frika më e madhe e parisë së Tiranës, është frika nga përplasja që do të ndodhë me 22 qershor, ditën e zgjedhjeve e pas zgjedhjeve.

Prandaj sot në një takim të zgjeruar me rrogëtarët e shtypit, ata që paguhen shumë dhe ata që nuk paguhen me muaj, doli Presidenti i shtetit Bujar Nishani dhe tekstualisht me aq fuqi sa ka për të folur, tha: “Çështja e parë dhe më kryesorja do doja bashkëpunimin tuaj, të jeni pjesë frenuese për parandalimin e çdo lloj dramaciteti që nuk ka bazë dhe kthehet në kosto sociale dhe emocionale për vendin. U ndala në këtë pikë, se gjatë fushatës paraelektorale ka pasur shpeshherë opinione të hedhura nga kënde të ndryshme, jo nga njerëzit e medias, për dyshim të procesit zgjedhor, rrezik të përplasjes shoqërore dhe sociale të aktorëve të ndryshëm ditën e zgjedhjeve apo para dhe pas”.

Kjo ishte një deklaratë serioze, nervoze dhe që shprehte një tension të madh në radhët e parisë. Sepse zotëria punon për zotin Sali Berisha, po i ka ustallarët e vjetër edhe nga ana tjetër, e si të gjithë pra, punon për interesat e parisë së Tiranës. Paria duket se është e shqetësuar nga përplasja. Edhe sikur

se Sali Berisha të jetë duke i dalë para vjedhjes së zgjedhjeve, fakti që po i mëshon kaq fort e përmes një figurine, është do-methënës.

A do të ketë përplasje?

Duke u nisur nga një vlerësim i përvojave të shkuara, nga ajo që po shihet në terren, nga synimet e prijatarëve dhe nga sjellja e pritshme e katundarëve, fshatarëve dhe qytetarëve, pasiguria e saj duket e justifikueshme. Ngado që kthehet, mendimi im është se paria sheh shkaqe e mundësi të shumëfishta për sherr, rrëmujë e përplasje, prandaj doli edhe Presidenti i shtetit dhe bëri një paralajmërim kaq serioz.

Megjithatë, ndryshe nga të tjerët që e panë si pjesë të fu-shatës elektorale, unë e pashë si shqetësim serioz të parisë se gjendja mund të dalë nga duart shumë shpejt dhe paria mund të gjejë veten në një pozicion kritik. Media e shtypi duhet të funksionojnë si një valvulë që nuk flet për përplasjet, sherret, poshtërsitë, krimet, vrasjet, kërcënimet, djegjet, e dhunimet. Paria e din se ashtu si një gjuhë flake e djeg mullarin e barit të thatë, ashtu edhe shqiptarët janë gati të shpërthejnë kundër saj.

Paria sunduese po mundohet të kontrollojë atë që mund të kontrollojë. Nën këtë shqetësim dallohet edhe vetëdija e saj se gjendja është kritike. E pra, përplasia është e pashmangshme, pavarësisht se nuk dihet se nga do të vijë sherri.

Përse e them këtë?

Së pari, institucionet zgjedhore janë dëmtuar në mënyrë të pariparueshme, si në strukturë, ashtu edhe në drejtim të legjitimitetit e të besueshmërisë. Le t'i rindërtojë sa herë që t'ia ketë qefi parisë së Tiranës, tani në kulm të fushatës, çdo rikonstruksion do të ndodhë me një çmim të kripur; humbjen e legjitimitetit. KQZ është e diskredituar, le të çojë kë të dojë opozita, me 1 qershor, ose me 15 qershor. Po ashtu, KZAZ do të jenë edhe më të diskredituara, ashtu si edhe komisionet dhe e gjithë struktura zgjedhore. Sa më e madhe frika e parisë për humbjen e zgjedhjeve, aq më e madhe do të jetë edhe ndërhy-

rja politike. Nuk duhet shumë për ta ndalur motorrin, vetëm ca kokrra rërë e pak ujë. Pasoja do të jetë përplasja e pashmangshme në njërin nga tre nivelet institucionalë. Kolegji zgjedhor nuk pi ujë. Rëra do të hidhet në qendrat e votimit.

Së dyti, paria ka zbuluar me shqetësim se klanet lokale që përfaqësojnë familje politike e banda kriminale, tashmë janë të pakontrollueshme. Sepse zgjedhjet, klanet e bandat lokale do t'i vjedhin jo vetëm për partitë e Tiranës, që dukshëm nuk i honepsin, por edhe për veten e tyre. Marrëveshjet për të mbushur kutitë, për të vjedhur votat, për të bërë gjithë ato gjëra për të cilat ne jemi mjeshtra, do të mundësohen edhe nga fuqizimi i jashtëzakonshëm i klaneve lokale që e kanë humbur dallimin partiak, por kanë ruajtur e shtërguar rradhët e familjes, qoftë ajo në bazë të lidhjes së gjakut, qoftë në bazë të lidhjes së krimit. Sepse këtu nuk ndodh vetëm vjedhja, ndodh edhe marrëveshja e hapur që i sheh votat e një partie, të shkojnë te partia tjetër.

Së treti, histeria e militantëve dhe klientëve do të arrijë majat në ditën e zgjedhjeve. Kur të vijë momenti e të shohin se kanë një zgjidhje midis mbushjes së kutisë e ndenjes katër vjetë në opozitë, “militantët” dhe klientët nga të dy palët do të mundohen të bëjnë zgjedhjen e duhur dhe nga këndvështrimi i tyre, edhe moralisht të lejueshme: do të mbushin kutitë.

Së katërti, frika e madhe e biznesit të pambrojtur që përveç humbjes së mundësisë së përfitimit nga shteti, do t'i duhet të përballet edhe me nevojën e pasurimit të shpejtë, qoftë edhe modest nga pala tjetër, do ta shtyjë në rrugën e influencimit të zgjedhjeve. Këtu flitet për kocka tani. Biznesi e ndjen se paria do të fillojë të kërkojë të hajë prej tij. Dhe kjo ndalohet vetëm me politikë.

Së pesti, tundimit të manipulimit të zgjedhjeve, nuk mund t'i shpëtojnë as prijatarët, as kandidatët vetë. Për një grusht votash nuk mund të rrezikohet mundësia e ndenjes në opozitë. Si thonë bashkëfshatarët e mi, “shkon dora vetë”. Demokracia është e mirë, por kur je kandidat dhe kur ke marrë borxhe e

ke dhënë premtime, nuk mund të ndalesh para një sherri të vogël. Se gjithçka nis me sherrin e vogël e pa dëm. Si themi ne malsorët, “loja e fmijve shuen fiset”. E në terma modernë, nevoja e vjedhjes së votave do të fillojë sherrin.

Së gjashti, shoqëria jonë është e fragmentarizuar, e grimcuar, e kontrolluar nga struktura që duhej të ishin shoqërore, por që janë bërë autonome dhe pa rrugët e duhura të komunikimit e të zgjidhjes së konflikteve ndërmjet tyre. Gjendja është kaq keq, sa çdo konflikt që mbështetet në fe, në etni, në ide dhe bile edhe në kundërvënie individuale për pazare të pista, sjellje kriminale, sherre banale etj., do të interpretohet politikisht. Në fund të gjithë e kemi një lidhje politike. Ndaj dhuna, grabitja, ndëshkimi, krimi, do të paraqiten si krime politike. E që këtu është vetëm një hap përplasja e organizuar nga paria, apo segmentet e interesuara sipas parimit “qe baba, duart”.

Së shtati, kriza është e përgjithshme dhe pasojat që po ç’orientojnë njerëzit dhe po i frigojnë, do të ndikojnë edhe në zgjedhje, edhe në sherrin e pritshëm. Shteti është i falimentuar, i mbytur në borxhe që nuk i paguan dot, pa aftësi me pague rrogat, pa mundësi privatizimi, pa mundësi marrje borxhi, pa mundësi taksimi, pa prodhimtari të mirëfilltë, pa mundësi me krijue punë. Bizneset janë duke punuar sa me mbijetue, ritmi i shitblerjes ka rënë, ritmi i investimeve është përtokë, ritmi i turizmit është dobësuar, të ardhurat nga remitancat janë në pikiatë, kapitali është duke ikur me shpejtësi. Banka shqiptare është pa mundësi me përdorë mekanizmat financiarë që diku tjetër do të bënin dobi e me radhë. Gjendja ekonomike është shumë e keqe. Kushdo që të dalë në krye të shtetit, do të trashëgojë një gjendje të pashpresë.

Së teti, shoqëria jonë është e pjekur për sherr. Të rinjtë që sillen vërdallë me makina, që përdredhin kutitë e cigareve dhe rrinë në klub gjithë ditën e lume, kanë nisur të mprehen për sherr. Nuk kanë të ardhme, diplomat nuk iu hyjnë në punë, nuk kanë mundësi emigrimi dhe politika bëhet më shumë se simbolike, një mënyrë për të shpërthyer.

Së nënti, sjellja e parisë tregon panik të qartë. Njerëzit nuk kanë besim. Askush nuk po gënjehet nga falja e taksave, nga uljet e taksave, nga legalizimet gjysmake që mund të kthehen mbrapsht me një vendim ligjor, nga inaugurimet, ceremonitë, mitingjet e me radhë. Kjo është gjendja dhe shoqëria është shumë mosbesuese ndaj parisë së Tiranës. Një segment tjetër që fillon të luajë rol në këto zgjedhje, janë emigrantët e kthyer që ende nuk po lexohen si duhet nga paria. Emigrantët po kthehen, por nuk kanë mundësi investimi, as përkrahje, gjenden të izoluar në një shoqëri të deformuar e të kriminalizuar deri në palcë dhe me traumat e emigrimit.

Pra, mundësia e përplasjes është qartësisht e prekshme. Përpyekja e pandalshme e parisë së Tiranës për të kontrolluar gjendjen, i ngjan përpyekjes së kuzhinierit që ngre valvulën e shkarkimit të avullimit dhe i jep kohë gjellës të gatuhet në njëzet tenxhere me presion në të njëjtën kohë. Por kuzhinieri i mirë ul zjarrin. Këtë paria jonë nuk e ka në dorë, sepse zjarri është kriza e thellë dhe e gjithanshme. Ajo mund të luajë vetëm me valvulat dhe këtë duhet ta bëjnë të gjithë palët bashkë e në harmoni të plotë. Por këtu na kanë dalë ca dinamika që e bëjnë të pamundur lojën politike me tenxheret. Ngado që të shkojë puna, valvula e njëres nga tenxheret do të plasë dhe mandej përplasia do të ndodhë. Sepse paria hap e mbyll valvulat e tenxhereve me presion, por zjarrin nuk e shuan dot. Dhe për shkaqet që u përmendën më lart, valvulat do të shpërthejnë e kështu, herët, ose pak më vonë, përplasia është e pashmangshme.

MBI TË MIRËN DHE TË KEQEN NË POLITIKËN SHQIPTARE - I -

Çdo njeri, por edhe çdo shoqëri, ka dy anë në vetvete, të mirën dhe të keqen. Shpesh ne i përcaktojmë ngushtësisht e moralisht duke i parë nga interesi jonë i ngushtë dhe imediat, domethënë ajo që më bën dëm mua është e keqja. Parimi i famshëm katundar “larg vatrës sime” e ilustron më së miri këtë qëndrim e mendësi. Ka grupe njerëzish që për të arritur objektivat e tyre të sigurisë, mirëqënies dhe të një jete të dinjitetshme sipas mendësisë së tyre, marrin rrugën e gabuar. Por struktura të tilla nuk e kanë të gjatë. Njerëzit nuk mund të jetojnë vetëm me të keqen dhe vetëm nga e keqja. Në marrëdhëniet midis tyre duhet doemos të ketë sjellje të moralshme, mirëbesim, qëllime të përbashkëta dhe ndëshkime që e bëjnë të keqen të papranueshme dhe të dënueshme.

Kjo ndodh, sepse në një nivel tjetër shoqëror e politik, e keqja nuk është vetëm pasive. E keqja është kur nuk njeh kufinj në sjellje dhe bën gjithçka vetëm e vetëm për interesin tënd të ngushtë, pa dhembje e pa respekt për tjetrin. Kur je zyrtar kjo shprehet me mendësinë “kështu e don ky popull pis”. E keqja që shkakton njeriu që është në krye të një shoqërie të caktuar, është e pamatë, sepse ajo prek thellë, për shumë kohë dhe gjithsecilin njeri në shoqëri. Prandaj kombet që kanë udhëheqës të këqinj i vuajnë pasojat për shumë e shumë kohë. Sjellja e këtyre udhëheqësve përcakton deri ku ndalet e keqja dhe sa kultivohet e mira. Sepse e mira e shoqërive vjen nga njerëzit që punojnë për shoqëritë e kombet e tyre si kombëtaristë e si burra shteti dhe shembulli i tyre i mirë kultivohet si model sjelljeje për të gjithë shoqërinë.

Nga ana tjetër, në nivelin shoqëror, e mira është kur heq nga vetja dhe iu jep të tjerëve mirësi me vetëdije. E mira është edhe kur nuk vepron me keqdashje, sepse mendon se e njëjta gjë mundet me të ndodhë edhe ty. Duket moralizuese, por është kaq e thjeshtë. Unë do të ruaj ty, sepse duke vepruar ashtu ruaj edhe veten. Ky parim reciprociteti është thelbësor, sepse “njëra dorë lan tjetrën, të dyja lajnë fytyrën,” për të mos përmendur atë shprehjen e njohur që është në themel të fuqisë politike, “bashkimi bën fuqinë”.

Duke e zgjeruar këtë shprehje do të kisha thënë se bashkimi në nivelin politik, jep edhe fuqinë, edhe sigurinë, edhe mirësinë, edhe begatinë. Me e përkthye ndryshe, e keqja ndalet kur dënim i me vdekje është ajo që të pret. E keqja ndalet kur njerëzit organizohen. E keqja ndalet kur njerëzit kanë një ideologji e sistem të qartë vlerash në qendër të të cilave është shtet - kombi. E keqja ndalet kur njerëzit e shohin se rruga ku po ecet nuk funksionon, sepse po na çon në greminë. E keqja ndalet kur e din se e mira do ta luftojë sy për sy e dhëmb për dhëmb. E keqja ndalet kur njerëzve iu shpjegohet pse janë në këtë rrugë e ku të çon ajo. Sepse në fund të fundit, kaq mund të bëhet, nëse njerëzit e dinë të vërtetën, por nuk kanë mbështetjen e të tjerëve. Ka njerëz që bëjnë vetëvrasje. Mund t’ia shpjegosh të mirën tjetrit, por nuk mund ta bësh të dojë veten.

E njëjta gjë është edhe kombet. Mund t’ua shpjegosh ku është e mira e tyre, por nuk mund t’i bësh ta duan veten. E megjithatë, duhet përpjekur për ta bërë këtë pa ndërpreje. Prandaj të gjithë shoqëritë luftojnë që të bëhen shtet - kombe. Më shumë tani në modernitet, se në të gjithë kohët e mëparshme.

Duke e arritur ose me mençuri, ose me dhembje këtë përfundim, të gjitha shoqëritë kanë zhvilluar një mekanizëm që kultivon ruajtjen nga e keqja dhe shpërblimin për sjelljen e mirë. Të gjitha ideologjitë shtet e komb formuese, në një nivel thelbësor, janë të mbështëtura mbi një konceptim të së mirës e të së keqes që i shërben shumicës në një shoqëri të caktuar.

Kjo është një pikë që ne duhet ta mbajmë mend e ta zhvillojmë si duhet. Sepse politika është në plan të parë dhe shteti është struktura përcaktuese e identitetit dhe elementi qendror i vetëdijes së individit shoqëror e politik.

Prandaj në nivelin shoqëror, edhe për shkak të mekanizmeve që shpërblejnë një sjellje të caktuar e që dënojnë një tjetër, të dyja shumëfishohen si buka dhe si peshku në parabolën e njohur. Mirësia që bën individin në shoqëri kthehet në të mirën tënde nesër. Si thotë populli ynë me atë mençurinë e tij të pamatë “çka hedh ne det e gjen në kripë”. Por realisht ne kemi shumë kohë që kemi hedhur e po hedhim në det të gjithë jashtëqitjet tona. Kripa që po i hedhim të ardhmes sonë është e helmatisur nga e keqja e madhe që po bëjmë sot. Atëherë, pyetja shtrohet: Ku janë njerëzit e mirë? Pse nuk e ndalojnë këtë krim?

Në këtë shkrim do të thoja edhe diçka që e dinë të gjithë. E keqja nuk ndalet me vetëdije nga askush tjetër, përveç se nga njerëzit e mirë, por jo vetëm nga njerëzit e mirë. E keqja ndalet edhe nga njerëzit mendjengushtë që kanë frikë ligjin e shtetit, që duan të ruajnë interesat e tyre imediate, që funksionojnë brenda strukturës ligjore. Ndalet edhe kur përballet me njerëzit që e shohin të keqen dhe padrejtësinë të papranueshme, të patolerueshme dhe të dënueshme, sepse si njerëz, shpesh ne nuk e shohim sjelljen tonë si të dënueshme, por çdo veprim të tjetrit e shohim me lupë zmadhuese.

E keqja pra, ndalet nga vetëdija e shërbimit publik, nga frika e ndëshkimit që të pret dhe nga nevoja për të ruajtur vetveten. Për të parën duhen njerëz që prijnë e shërbejnë. Për të dytën duhen institucione. Për të tretën duhen qytetarë të vetëdijshëm. Struktura e vetme që i mundëson këto është shtet - kombi.

Sepse nuk ka rrugë tjetër për t'i ikur të keqes.

E MIRA DHE E KEQJA NË POLITIKËN SHQIPTARE - II -

- E keqja në jetën publike -

Nuk them ndonjë gjë të re, po të përsëris se e keqja helmon dhe vret jetën shoqërore dhe e mira shëron dhe e lulëzon jetën shoqërore. Sepse e keqja mund të jetë në interes të një njeriu të vetëm, por jo të gjithë të tjerëve në një shoqëri. Edhe atij që për pak kohë i bën mirë, e keqja e gjen mënyrën për me ia shkatërrue jetën, sepse një herë që zbulohesh, e nuk dilet lehtë nga lëkura, do të vazhdosh të sillesh ashtu si je në të vërtetë.

Prandaj ka grupe e kombe që mund të bëhen xhelatët e vullnetshëm të dikujt apo sklevër të një ideje absurde dhe në emër të asaj ideje, të bëjnë atë që nuk mund të merret me mend. Këtë e kam shpjeguar në një shkrim tjetër. Këto grupe sillen kështu me grupet e tjera, por brenda grupit edhe këta kanë rregulla e norma sjelljeje që i ruajnë dhe i mbrojnë pjesëtarët e grupit nga të tjerët.

Edhe brenda këtyre grupeve e keqja e nxjerr kokën, por është e dënueshme, sepse e mira e grupit vjen përpara gjithçkaje tjetër. E keqja, në çdo grup, si në familje ashtu edhe në komb, vjen kur njeriu punon vetëm për interesin e vet të ngushtë. E keqja vjen kur në rrugën e vet, për të siguruar mbijetesën e pasurimin, individi nuk njih asnjë shtërngesë apo pengesë dhe për ma tepër e kthen këtë sjellje në thelb kani-balesk. Në botën shtazore ka shumë shembuj të tillë kanibalizmi, më i qarti mbetet krokodili. Krokodili kujdeset për vezët etj., por e han pjellën e vet sapo hidhet në ujë. Ama, kur o vogli rritet mjaftueshëm, krokodilët nuk e prekin më njëri - tjetrin.

Në nivelin e shoqërive njerëzore, nga këndvështrimi i të dënuemit me u përpi, e keqja është gjendja kur njeriu në

një shoqëri është i pashpresë, pa dinjitet, pa mundësi me jetue normalisht dhe me iu gëzue vetes dhe të tjerëve, i përdorur, i skllavënuar, me ndjenjën e të kenunit gjithherë i pamoralshëm dhe i ndytë. Ajo që e bën të keqen të frikshme, është normalizimi i saj, momenti kur gjithkush në një shoqëri e sheh të keqen si diçka normale, të natyrshme, si të vetmen gjendje e mënyrë sjelljeje të moralshme, që bëhet e moralshme, sepse kështu sillen gjithkush. Me një fjalë, ashtu si në Rrethin e Ferrit e keqja triumfon kur gjithkush që ka zbritë aty me sjelljet e veta, transformohet në gjarpër dhe nis të hajë të sapozbriturit në Ferr.

Popujt dhe kombet e tjerë e kanë gjetë mënyrën me analizue të keqen duke iu kthye shembujve të historisë së tyre, duke e parë si kategori filozofike duke e ritualizue e normalizue ideologjikisht për me i shërbye interesave të një grupi të vogël sundues. Por ne shqiptarët kemi një natyrë specifike, histori e gjendje të veçanta që kërkojnë reflektim të thellë, se vijmë nga rrugë paralele, me përvoja të ndryshme, pa një shtet - komb të mirëfilltë dhe mbi të gjitha, me sundues që kanë ardhur njëri pas tjetrit dhe që interesin e kombit nuk e kanë pasur gjithnjë parësor. Kjo që ndodhi pas rënies së sistemit parti - shtet, është shumë ilustruese në lidhje me sjelljen e parisë.

Prandaj ia vlen me e cek pak se si shfaqen e mira dhe e keqja në jetën tonë publike e politike. Por më parë ia vlen që duke e shkëputur idenë e mendësinë e të keqes nga feja, të shohim se nga vjen e si manifestohet ajo në jetën shoqërore.

Nga vjen e keqja?

Njeriu është një gjallesë që kërkon me mbijetue dhe në procesin e mbijetesës, morali dhe vlerat që ka, janë të kush-tëzuara nga rrethanat, nga zgjidhjet që gjen dhe nga vlerat kulturore të grupit të cilit i përket. Po e keqja nuk ekziston pa të mirën, sepse terri i natës kuptohet kur ka dritë. Si njerëz e si qenie shoqërore, edhe ky dyzim na shtyn me reflektue mbi sjelljen tonë. Si grupe, ky dyzim përcakton rrugën që marrim, moralin e kohës në të cilën jetojmë dhe vlerat sunduese në një shoqëri. Përtej përrallave të zakonshme, ne shqiptarët kemi

harxhue disa qindra vjet të ekzistencës sonë si komb në mesjetë, duke mbrotjur një pikëpamje të tillë. Në fakt, edhe origjinat si komb i kemi pikërisht te lufrat që kemi zhvillue duke mbrotjur pikërisht këtë pikëpamje filozofike. Ajo përkrenare e trashëguar në familjen e Skënderbeut, i ka rrënjët thellë në histori dhe është një objekt që flet shumë për ne si komb, sesa legjendat e krijuara nga historianët e poetët tanë.

Thelbi i besimit tonë të hershëm, është se e keqja është e pashmangshme, aspak banale, por pjesë e natyrës njerëzore dhe e gjithësisë të cilën duhet me e kontrollue e me e njohë, por që nuk mundesh me e shmangë. Varet si e përdoron edhe këtë anë tënde të keqe. Sepse prandaj edhe kemi vullnetin si qënie njerëzore me ba zgjidhjet e duhura, me dallue të mirën nga e keqja. Kemi mundësi me ndryshue, me e minimizue, shmangë, kontrollue, por jo me e zhdukë. Sepse edhe më i miri ndër ne, bahet më i keqi, kur detyrohet nga rrethanat.

E keqja vjen nga jashtë dhe nga brenda grupit. E keqja vjen në formën e katastrofës së natyrës që nuk ke ç'i bën, sepse vjen nga nuk e pret. Po diçka mund të bëhet. Shtatë vjetë thatësi në Egjipt, u përballuan sepse njerëz të mençur ruajtën ushqimet shtatë vjet më parë në kohët e mira kur kishte prodhim. Pra, udhëheqja e mirë i del përpara të keqes. E keqja tjetër nga jashtë grupit, që shpesh është e pashmangshme edhe nga ata që sundojnë, vjen nga pushtimi i huaj. Kështu, 150 000 ilirë u nisën për në Romë nga Luc Emil Pauli, ku përfunduan si skllëvër. Ndoshta ajo lidhja e fortë që së fundi deklarohet se e kemi gjenetike me Evropën, vjen nga këta skllëvër e nga valë të tjera skllëvërish ilirë, që më vonë me emra të tjerë si arbanë, arbëreshë, shqiptarë, epirotë, etj., u degdisën rrugëve të botës. Prandaj duhet shteti dhe udhëheqja që i del përpara të keqes.

E keqja tjetër vjen nga brenda grupit, nga natyra specifike e rrethanave, nga kultura nga sëmundjet, epidemitë, ndryshimet e panjohura dhe degjenerimi. Popuj të tërë shuhen nga faqja e dheut, kur bien në kontakt me sëmundje e me prodhime që janë të panjohura, të dëmshme, pa ilaç për ta.

Por ka një të keqe që e ka origjinën jo te të huajt, jo në përbërjen e predispozicionin gjenetik, jo te natyra specifike dhe kultura e grupit, por është në origjinë; një e keqe politike dhe shoqërore. Kjo e keqe lidhet me sundimin e një grupi apo shtrese që e sheh të gjithë shoqërinë si masë për t'u përdoruar, shfrytëzuar e sunduar. Kjo shtresë është paria. Ajo lufton me të gjithë mënyrat të mbjellë një mendësi që e legjitimon dhe e justifikon sundimin e saj. E keqja bëhet dhe duket e pashmangshme. Jeta në Rrethin e Ferrit është normaliteti dhe e gjithë bota jeton në Ferr.

E keqja shoqërore e këtij lloji pra, është e një natyre tjetër. Kjo e keqe vjen nga degjenerimi moral, humbja e vlerave dhe e besimit që e mban një shoqëri bashkë. Kështu Sodoma e Gomorra u dhanë pas qejfeve dhe u zhdukën nga faqja e dheut. Spartanët u dhanë pas qejfeve, verës, intrigës dhe horllëkut dhe e humbën shtetin e tyre në një brezni. E keqja vjen kur dobësia njerëzore përcakton marrëdhëniet njerëzore. Atëherë shoqëria fillon e degradon. Njerëzit e mirë duan të ikin e të shkëputen. Si një plagë, shoqëria fillon mbledh qelbin, derisa gangrenizohet, ose shërohet. Sepse nuk mund të ketë shoqëri njerëzore pa virtyt dhe nuk mund të ketë virtyt pa të mirën, të paktën në mes të një shtrese që e drejton atë.

Në këtë pikë, rasti ynë shërben si ilustrim. Sepse ne jemi një popull i shfityruar në ekstrem dhe e keqja më e madhe është e keqja që del nga vetë shpirti i popullit të shfityruar në ekstrem. E keqja shoqërore tashmë nuk është si qeliza e shëndoshë që kthehet në vrasësen e trupit. E keqja e një populli të tillë është si kanceri që e ha të gjallë njeriun. Kjo e keqe lufton kundër shoqërisë, e helmatis dhe e vret trupin, sepse me kohë ajo e ka ndryshuar mendësinë e popullit. Çdo njeri lufton për vete dhe paria, udhëheqja politike e morale e shoqërisë, lufton kundër trupit të vet, kundër kombit të vet. Sepse idetë dhe mendësia lindin e kultivohen, bëhen të pranueshme e legjitimohen nga paria, jo thjesht nga njerëzit e mençur, të izoluar e jashtë shoqërisë. Kur paria është qeliza e tillë vdekjeprurëse e

kancerit, një popull është në krizë të thellë, pa besim në zgjidhjen e mundshme e shpesh fare pa zgjidhje. Një popull që nuk sheh asgjë të përbashkët me tjetrin, është një popull që është i destinuar të bëhet komb skllëvërisht për të tjerët. Ka skllëvër që paguhen më mirë se të tjerët, por në Rrethin e Ferrit askush nuk mundet me shpëtue pa u ba gjarpën në fund.

Ku jemi ne?

Ne jemi në një pikë kur na ka kapluar e keqja më e thellë shoqërore. Qeliza kanceroze që po na han është grushti i njerëzve që na sundojnë e që na shohin si pronë të tyre. Duke e ditur se si funksionon organizmi shoqëror, pra shoqëria, këta bëjnë çdo gjë për interesat e tyre dhe e bëjnë këtë duke na futur në kokë mendësitë e gabuara. Pasoja? Shoqëria jonë po vdes. Këta hanë e pinë e ne po shuhemi. Po shuhemi e po deformohemi në Shqipëri. Po shuhemi e po asimilohemi në mërgim. Deri këtu duket sikur paria e Tiranës ia ka dalë. Këta janë kanceri dhe e keqja që nuk do të ndalet deri në fund. E megjithatë, shqiptarët që i shohin si njerëzit e tyre, nuk po e kuptojnë natyrën e problemit me të cilin përballlemi. Edhe qelizat e shendosha nuk e njohin qelizën kanceroze derisa ajo bëhet e fuqishme dhe fillon i vret apo transformon ashtu si don ajo. Tani ka ardhur koha që të fillojmë të ndryshojmë rrugën dhe të drejtohem nga e mira. Kushdo që ka një fije dëshire mos me i pa fëmijët e vet të transformuar në skllëvër, duhet të mendohet edhe një here, para se të japë veten e lirinë e vet dhe t'ia lerë në duar parisë së Tiranës.

Dy gjërat që dihen janë këto: Njëra që të gjithë do të përfundojnë si gjarpërinj në këtë Rreth Ferri. Dhe e dyta, se nëse duhet mbijetuar si njerëz e si shoqëri normale, të gjithë duhet t'i kundërvihen të keqes dhe parisë.

Po ashtu ka dy gjëra që nuk dihen: Njëra se çka duan të bëjnë njerëzit e mirë. Dhe e dyta gjë që dihet, rruga është e vështirë dhe nuk i dihet fundi. Por kush punon për të mirën, do të shpërblehet me të mirë dhe kush punon për të keqen, do të shpërblehet me të keqen.

E MIRA DHE E KEQJA NË POLITIKËN SHQIPTARE - III -

- Zgjedhja midis të mirës e të keqes -

Të gjithë popujt në historitë e tyre kalojnë nga sundimi i të mirës, te sundimi i të keqes dhe anasjelltas. E mira dhe e keqja mbizotërojnë për disa kohë dhe mandej lavjerrësi kalon nga ana e kundërt. Lufta e përplasja midis të mirës e të keqes, nuk mbaron asnjëherë në asnjë shoqëri. Thjesht e keqja triumfon për pak kohë dhe njerëzit e kuptojnë se nuk jetohet ashtu. E mira nga ana e vet bëhet tepër e rëndë, sepse e shtërngon anën njerëzore e pasionet ma shumë se duhet dhe njerëzit që bien në fund në shoqërisë, nuk kanë respekt për moralin e vlerat. Morali i tyre, morali i të shtypurve e skllëvërve, bëhet morali i kohës që vjen. E kështu me radhë.

E pra, lufta e të gjithë popujve është që e keqja të mos dalë përsipër e të mos mbizotërojë për shumë kohë. E mira duhet të mbizotërojë, sepse ndryshe njerëzit nuk do të ishin këta që janë. Ka popuj si gjermanët që kaluan nga nazizmi te shtet - kombi modern, e hoqën të keqen që kishin dhe ja ku janë sot, një nga kombet më të forta e më të begata të botës. Ka kombe që ishin të kontrolluar për shekuj si sllovenët, ka të tjerë që ishin të shtypur e të getoizuar si izraelitët që ditën të bëjnë më të mirën për veten e tyre dhe ja ku janë.

Po ne? Ne jemi të mbuluar nga e keqja. Dhe e keqja ka nisur të hyjë thellë në vlerat tona, në mendësinë, në sjelljet, në kulturën dhe në përparësitë që kemi si komb. Një kohë bukur të gjatë kemi qenë të çoroditur, të indoktrinuar e pa vetëdijen e duhur politike. E ka një kohë bukur të gjatë që kemi nisur të kultivojmë qëllimisht të keqen brenda vetes. Kjo nuk është nor-

male, sepse edhe ata popuj që e njohin të keqen e tyre dhe që e dinë se është e pashmangshme, apo që përkohësisht i ndihmon me jetue, e gjejnë mënyrën që ta kontrollojnë e ta përdorin në të mirë të tyre. Historia është e mbushur me raste popujsh që kanë qenë në anë të shoqërive normale dhe të diskriminuar që e kanë përdorur të keqen, kanë zhvilluar mekanizmat moralë e justifikimet ideologjike për ta neutralizuar efektin e saj mbi veten. E megjithatë, brenda grupit të tyre, brenda kombit të tyre nuk kanë lejuar të mbizotërojë e keqja. Ka pasur njerëz që kanë qenë hedhur jashtë kombeve normale dhe janë bërë grabitës e piratë. Edhe këta kanë krijuar bashkësi, struktura, shtete e republika ku kishte drejtësi brenda llojit si në Tortuga. Por këto nuk mund të ishin afatgjata, sepse e keqja vazhdimisht e nxirrte kokën dhe e shkatërronte fabrikën e tyre të brishtë shoqërore. Kombet e vërteta janë ato që nuk e lejojnë të keqen të bëhet e pranueshme dhe sunduese në sjelljen publike.

Edhe kur e dinë se njerëzit janë të këqinj, edhe kur e dinë se nuk kanë mundësi t'i ikin të keqes, prapë në jetën publike këta kultivojnë të mirën. I ngrënë tempuj, luten, sillen si duhet, ruajnë parametrat e një qytetarie normale, respektojnë norma e rregulla shoqërore dhe kanë mekanizma shoqërorë që e mbajnë të gjithë shoqërinë bashkë. Po edhe pse bëjnë keq dhe e dinë që bëjnë keq, nuk lejojnë të keqen që të bëhet sunduese në shoqëri e në marrëdhëniet që mbahen si të moralshme.

Pse ndodh që popujt e tjerë nuk e lejojnë të keqen të mbisundojë?

Ndodh sepse të gjithë këta grupe e popuj, kombe e etni e dinë mirë se ata popuj e grupe që e lenë të keqen të mbizotërojë brenda vetes, që nuk kanë mekanizma për vendosjen e drejtësisë ligjore, të mbrojtjes parësore të jetës e të nderit të pjesëtarëve të grupit, të pasurisë e të kohezionit shoqëror, do të shuhen. Njerëzit e mirë nuk mund të pranojnë të jetojnë për shumë kohë nën sundimin e të keqes. Ata do të gjejnë mënyrën të ikin. Të mençurit e të edukuarit kanë mendjen e tyre si strehën e fundit, të ndershmit kanë fytyrën e traditën

në të cilën janë rritur dhe mbahen pas vlerave tradicionale, ata më të zotët kanë profesionin. Askush nuk don me jetue nën sundimin e të keqes. E kështu shoqëria bëhet si sita, ku mielli i bluar më imët, ai më i miri dhe i dobishmi, ikën e bie në fund dhe në majë mbesin krundet. Në atë pikë, shoqëria nuk ka më shpresë dhe do të shpërbëhet e do të hidhet në koshin e plehërave të histories, së bashku me parinë që e sjell popullin e vet në atë gjendje.

Prandaj shoqëritë e ndajnë të mirën, atë që është në shërbim të tyre, e vlerësojnë, e kultivojnë. Shoqëritë e drejtuara nga njerëz të mençur e përdorin politikën për të zgjidhur problemet e brendshme me drejtësi, me vëmendjen e duhur dhe me sa më shumë paanësi. Sepse themeli i dinjitetit është drejtësia, ligji. Mbi këtë themel ndërtohen shoqëritë e shëndosha.

Në veçanti, shoqëritë vendosin kontrolle të forta mbi paritë, të cilat janë gjithnjë të gatshme të tkurren në rrethin e tyre dhe të fillojnë ta shohin si prene e tyre, vetë shoqërinë që i ka bërë të lulëzojnë. Ky është edhe funksioni shtërngues i shtetit dhe i kombit, i ligjit dhe i vendosjes së rendit, i vendosjes së shtërngesave mbi parinë dhe i dallimit midis grupit dhe të tjerëve. Paritë që punojnë për popujt e tyre, mbijetojnë dhe e gjejnë vendin. Por edhe më shumë se kaq, historia e popujve është e mbushur me pari që janë zhdukur e shuar, sepse në një pikë a në një tjetër, nisën të hanin popullin e vet.

Po në rastin tonë?

Në rastin tonë, si edhe e kam thënë më përpara, këta që na sundojnë, janë shkak i të keqes. Njerëzit tanë më të mençur kanë ikur, ata më të zotët punojnë në botën e huaj, ata që duan të shërbejnë nuk gjejnë vend dhe në krye kanë dalë krundet e shoqërisë shqiptare. Këta janë si gjarpërinjtë e zgjuar nga gjumi, të uritur, të zvetënuar, barkthatë e të pangopshëm që hanë llojin e vet. Diku rrugës së historisë, këta njerëz janë përçudnuar keq e në mënyrë të pandreqshme. Ata që na shesin, na trafikojnë, na vjedhin, na përdhunojnë, na mundojnë, na skllavërojnë, na përbuzin, na zvetënojnë, na shtyfyrojnë e na

çnjërezojnë. Ne i ndihmojmë dhe jemi kthyer në bashkëfajtorë në krim, sepse deri aty mund të shohim e të kuptojmë. Dhe kështu ka ardhur puna që nuk kemi më as identitet, as vlera, as moral të pranueshëm publik, as shtërngesa normale ligjore, na sundojnë të huajt e ka triumfuar e keqja.

Ky është Rrethi i Ferrit, sepse në Rrethin e Ferrit të gjithë mendojnë si gjarpërinjtë, vetëm e vetëm që të shpëtojnë jetën e vet. Ky është Rrethi i Ferrit, sepse nga kjo darë e kontrollit të kësaj mase gjarpërinjsh që është para sunduese, duket sikur nuk ka shpëtim. Ky është Rrethi i Ferrit, sepse shpëtimi i vetëm që ke, është të bëhesh si gjarpërinjtë dhe t'ua hedhësh edhe fëmijët e tu gjarpërinjve. Sepse këta gjarpërinj janë të parët tanë, udhëheqësit, para sunduese, sepse në Ferr ku nuk rritet gjë, ka vetëm një rregull; do të mbijetosh duke ngrënë llojin tënd, njerëzit e tu brez pas brezi. Prandaj pyetja kryesore e kohës sonë për ne shqiptarët është:

Ku e kemi të mirën tonë? Ku janë njerëzit e mirë?

A ka zgjidhje?

E mira jonë

Në parim e mira jonë si popull qëndron në ndërtimin e kujdesshëm e në kultivimin e asaj që na lidh sa më ngushtë të jetë e mundur. Ajo që na lidh bashkë ne si shqiptarë është vetëdija e natyrshme dhe individuale se jemi të tillë. Nuk ka rëndësi nga ka ardhur dikush pesëqind vjet më parë. Të gjithë popujt kanë njohur flukse të tilla. Ajo që ka rëndësi është kjo; në këtë pikë kur i ke të gjitha mundësitë me i thanë vetes çka të duesh, me zgjedhë kombin që don ti, fenë që të pëlqen, veshjen që të duket më e përshtatshme, ushqimet që t'i ka ënda, gjuhët e letërsinë që don me lexue, a i thue vetes shqiptar? A mundesh me i ikë vetëdijes se je shqiptar? Në fund të fundit, kjo ka rëndësi. Po e more një pasqyrë mendore dhe e vune para ndërgjegjes tënde dhe e pyet veten se çka je, e po të erdhi ndërmend se je shqiptar, se mund të jesh diçka tjetër, por ti e din dhe don me kenë

shqiptar, atëherë ke ti shpresë, por ka shpresë edhe për ne të tjerët. Sepse nëse deri tani nuk je thye e nuk je ba kombmohues, bukëshkelës, braktisës i varreve të të parëve, atëherë ka shpresë për ty, ka edhe për ne të tjerët.

Guri i themelit të një kombi, shtylla e jetesës dhe e mbi-jetesës, fuqia e shtetit dhe vlera më e madhe e një shoqërie, është një qytetar që nuk mundet me kenë tjetër. Sepse ata që nuk munden me kenë tjetër, do të kërkojnë të njëjtët, do të kërkojnë të tjerë si veten. Kështu, si hardhuca që e rrit shtatin e vet, shpirti i një kombi lind e rilind vetveten. Sepse ata që nuk dinë me kenë tjetër, përpos shqiptarë, kanë me dashtë me kenë jo kombmohues, por afër shqiptarëve të tjerë, me shqiptarët e tjerë dhe me punue për kombin e për shtetin e tyne. Ata që kanë ikë, ata që luftojnë me iu bashkëngjitë kombeve të tjera, qytetërimeve e popujve të tjerë, janë shpirtna të humbur për shqiptarët. Shumë kanë me u kthye kur të ikë e keqja, e do të jenë të mirëseardhur, por luftën do ta bëjnë ata që nuk dinë me kenë tjetër, që nuk duan me kenë tjetër dhe që dëshërojnë me kenë shqiptarë.

E mira jonë, pra, është në vetëdijësimin e njerëzve dhe në mbështetjen pa kushte të këtij grupi që e sheh ndërtimin e shtetit dhe rilindjen e vërtetë të kombit si detyrën e tij të vetme, kardinale dhe të jashtëzakonshme. Ne e dimë çka është e mira dhe çka është e keqja dhe nuk duhet të dëgjojmë më Sirenat që na thërrasin në rrugët e mbrapshtisë, të krimit, të llumit, të zvetënimit e të degjenerimit. Ne duhet të fillojmë të punojmë për vete e për shtetin tonë. Në themel të shoqërisë ne duhet të vemë atë lidhje të shenjtë të gjakut, që sado e brishtë që mund të jetë në raste të caktuara, prapë është aty dhe mund të gjallërohet. Duke mos pasur një shtet të fortë, ne duhet ta nisim duke e bërë kombin e fortë. Sepse edhe nën kushtet e një trysnie kaq të fuqishme siç ishte tranzicioni, nën sundimin e një parie kaq perverse e kriminale, me një masë kaq të madhe njerëzish të zvetënuar e të degjeneruar, ndjenja kombëtare është e fortë dhe lulëzon.

Shumica e shqiptarëve e numërojnë veten si shqiptarë. Shumica e shqiptarëve duan të jetojnë me nder. Psikoza e krijuar nga sundimi i burgaxhinjve e banditëve me shkollë që duhej të ishin në burg, është bërë një gangrenë dhe njerëzit kanë filluar të kuptojnë se kanë qenë nën një narkozë të qëllim të ideologjike e krimi nga ana e parisë sunduese.

Por ne nuk duam as më shumë, as më pak se atë që duan kombet e tjera. Shkurt, shqiptarët duan të jetojnë me nder. Shqiptarët duan mbrojtje. Shqiptarët duan shërbime, edukim, vlerësim. Ka ardhur një kohë që e kemi kuptuar se mund të jemi të varfër, por do të jemi të qetë në vendin tonë. Ka ardhur koha që ai që ka ndërmend me jetue me nder, duhet të triumfojë. Duhet të triumfojë e mira, jo e keqja. Sepse në jetën tonë tashmë sundon e keqja publike. Ka ardhë koha që lavjerrësi të shkojë nga ana tjetër. Sepse njerëzit që dikur nuk e ngopnin barkun me bukë, kanë hangër sa po plasin. Tani kanë filluar të mësojnë se duhet të jetojnë edhe me vlëra. E kur shohin rreth e rrotull, nuk shohin asgjë, sepse ka triumfuar e keqja. Po e keqja triumfon vetëm përkohësisht. Njerëzit e mirë, të zotë e të përkushtuar që ne i kemi të shumtë, por të shpërndarë, do të fillojnë të shtynë lavjerrësin nga ana tjetër. Kjo është përpjekja e mundimshme politike për ne shqiptarët, sepse ka ardhur koha që e mira të triumfojë. Edhe në mos qoftë plotësisht e realzueshme, të paktën duhet të përpiqemi të gjithë ata që e numërojnë veten shqiptarë, sepse nuk ka shpëtim tjetër për ne, veçse të kapemi pas idesë së kombit, pas idesë së shtet - kombit dhe pas vetëdijes se nuk mundemi me kenë tjetër. Nga ky pus ku kemi rënë, do të mund të dalim vetëm duke hipur mbi shpatullat e njëri - tjetrit dhe mandej duke hedhur litarin për të nxjerrë të tjerët.

Forcën do ta gjejmë në vetvete dhe litari që na nxjerr nga pusi i historisë, do të jetë puna për shtet - kombin, për njëri - tjetrin dhe për atë vetëdije që nuk mund të tjetërsohet. Se jemi shqiptarë e nuk bëhemi dot diçka tjetër, popull tjetër e njerëz të tjerë. Kjo është edhe rruga e të mirës sonë.

DEMOKRACIA NUK ËSHTË RROTACION, DEMOKRACIA ËSHTË ZGJEDHJA MË E MIRË

- Intervistë me z. Jakup Gjoca për gazetën “
Telegraf”, 05.28.2013 -

- Zoti Rama, si do ta vlerësonit aktualitetin politik në Shqipëri, në këtë pragzgjedhjeje?

- Kur shihet me objektivitet, gjendja është katastrofike. Shteti shqiptar sundohet me dorë të hekurt nga paria e Tiranës, një grup familjesh mafioze që tashmë e kanë treguar fytyrën e tyre të vërtetë. Kjo pari politike është edhe paria ekonomike e kulturore, sepse shumë nga prijatarët e këtyre familjeve e përdorën dijen që kishin fituar brenda e jashtë vendit, për t’u afirmuar si figura qendrore të tranzicionit. Po ashtu edhe profesionistët e rinj që dolën nga radhët e tyre u bënë biznesmenë, politikanë dhe mafiozë duke u integruar në strukturat e parisë. Shtoi këtyre edhe botën e pasuruar marramendshëm të krimit. Fuzioni i këtyre tre lloj segmenteve, çoi në transformimin e parisë shqiptare që tani është:

Thelbësisht një pari politike oligarkike, sepse janë shumë pak familje që kontrollojnë shtetin, politikën.

Plutokrate, sepse 80 % e pasurisë kombëtare është përqendruar në duart e 4 % të shoqërisë shqiptare.

Kleptokrate, sepse shteti është i kapur.

Mafioze sepse aleanca e parisë politike me klanet mafioze është konsoliduar deri në atë pikë, sa politikanët janë thjesht instrumente të klaneve mafioze dhe tani mafiozët kandidojnë për deputetë.

Në drejtimet kryesore, shteti është i falimentuar, eko-

nomia është përtokë, shteti dhe njerëzit janë të mbytur në borxhe, rinia është pa shpresë, mosha e tretë janë pa mbrojtje, shteti e ka humbur sovranitetin, zvetënimi moral ka arritur nivele katastrofike, trafiqet e drogës, të fëmijëve, të armëve e të njerëzve po lulëzojnë e kështu me radhë.

Por gjendja është bërë edhe më e frikshme nga sulmi që paria i bën shtetit. E vetmja rrugë pasurimi që këta kanë gjetur është të kapin shtetin. Prandaj edhe politika është në plan të parë. Hidhen miliona euro në fushatë për të maskuar realitetin dhe për të fituar legjitimitetin. Megjithatë, këto miliona nuk e fshehin dot gjendjen e krizës së thellë.

- *Nëse nuk rikompozohet KQZ, a mund të shkojmë në zgjedhje me një KQZ me katër anëtarë?*

- Në zgjedhje mund të shkohet gjithsesi, por besoj se KQZ do të plotësohet në minutën kur s'mban më, ose me pak presion e me një shitje alla tv "Klan" publikut, sikur diçka ndodhi, domethënë do të paraqitet loja sikur do të ketë presione formale nga jashtë, ose sikur, me një shkëlqje syri, "është në interesin tonë". Por po nuk qenë krejt të sigurtë për numrat dhe duket se nuk janë, sepse numrat janë në kufinj të 71 - 69, do të bëjnë gjithçka që të minojnë legjitimitetin e zgjedhjeve, që edhe kështu janë të kompromentuara. Shkurt, në zgjedhje mund të shkohet edhe me katër anëtarë. Do të luhet loja e lënies së fajit kundërshtarit dhe do të vazhdohet sikur kjo gjë nuk ka rëndësi.

- *Mosgjetja e kompromisit, mund të jetë i tëri faj i mazhorancës?*

- Këta i bëjnë të gjitha pislleqet bashkë. Përqindja e fajit nuk ka rëndësi.

- *Opozita a ka kontribuar sa duhet në gjetjen e konsensusit për të kapërcyer konfliktualitetin e KQZ?*

- Edhe pse sundojnë bashkë, këta nuk i besojnë njëri - tjetrit dhe e vetmja mënyrë që mund të mbijetojnë, është duke krijuar sherr. Sepse nuk është vetëm sherri për KQZ, tani po shohim se sherri po përhapet si zjarri në të gjitha nivelet. Sa

më shumë afron data e zgjedhjeve, aq më shumë rritet mundësia e përplasjes. Mënyra si është ndërtuar sistemi politik dhe vetë sistemi zgjedhor, krijojnë mundësi për përplasje të vazhdueshme.

- Mund ta perceptojmë si sfidë politike nga politika (mazhorancë e opozita, veçmas apo bashkarisht) mosmarrjen parasysh të apeleve të ndërkombëtarëve për një KQZ të pavarur, apo qëllimi i marrjes së pushtetit me çdo çmim, ngrihet mbi çdo parim dhe ligj nga forcat politike?

- Institucionet zgjedhore janë dëmtuar në mënyrë të pariparueshme, si në strukturë, ashtu edhe në drejtim të legjitimitetit e të besueshmërisë. Le t'i rindërtojë sa herë që t'ia ketë qejfi parisë së Tiranës. Tani në kulm të fushatës, çdo rikonstituim do të ndodhë me një çmim të kripur të humbjes së legjitimitetit. KQZ është e diskredituar, le të çojë kë të dojë opozita, me 1 qershor ose me 15 qershor. Po ashtu, KZAZ - të do të jenë edhe më të diskredituara, ashtu si edhe komisionet dhe e gjithë struktura zgjedhore. Sa më e madhe frika e parisë për humbjen e zgjedhjeve, aq më e madhe do të jetë edhe ndërhyrja politike. Nuk duhet shumë për ta ndalur motorrin, vetëm ca kokrra rërë e pak ujë. Pasoja do të jetë përplasje e pashmangshme në njërin nga tre nivelet institucionale. Kolegji zgjedhor nuk pi ujë. Rëra do të hidhet në qendrat e votimit.

Në parim ndërkombëtarët nuk duhet të ndërhyjnë. Por këta ndërhyjnë, sepse kanë interes për të ruajtur stabilitetin. Por stabiliteti që duan të huajt është formal. Nga ana e tyre, politikanët tanë e duan pushtetin me çdo çmim. Në rethanat kur duket se numrat do të jenë aty - aty, tundimi është shumë i fortë për me i vjedhë votat dhe me e shty fitoren nga ana e vet.

Me një fjalë, kjo është thjesht llogari. Nuk e di për çfarë sfide politike flisni ju, këtu politika bëhet me stërkëmbsha. KQZ është institucioni më i varur politikisht në shtetin shqiptar. Atje dergohen njerëzit më të besuar politikisht. Ja, dy ish - kryetarët e KQZ në momentet kritike, Ilirjan Celibashin dhe Arben Ristanin i ke në lista të sigurta. Nuk e kanë ndërruar

mendjen në një ditë këta, vegla kanë qenë, si vegla po sillen. Beson njeri që Lefteri Lleshi, Jani Jani apo Ilirjan Muho ishin të paanëshëm?

- *Nëse një pjesë e opinionit asnjë, shprehet se mazhoranca e sotme është lodhur, është konsumuar në tetëvjeçarin qeverisës, ju si e shpjegoni që opozita, sidomos PS, nuk ka marrë atë përqindje besimi të elektoratit, të paktën atë që tregojnë sondazhet, por është e barabartë me PD?*

- Po për çfarë besimi flisni? Këta janë të gjithë hajna e masakrenj, këtë e dinë të gjithë, edhe këta vetë. Këta e kanë mendjen me vjedhë nga thesari i shtetit. Populli ka nisur ta kuptojë më në fund se kjo është loja e tyre. Kur dikush del e vjedh si bandë i ndajnë punët; njëri të vjedh, tjetri të merr me të mirë. Njëri bën si i mirë "hajde ti se e zgjidhim këtë punë, më kallzo çfarë të ndodhi", tjetri të vjedh paratë, ikën dhe në darkë i ndajnë bashkë. PS dhe PD janë dy duar të një trupi. Njerëzit e kanë kuptuar me kohë dhe tani e kuptojnë më qartë. Këta janë të diskredituar, jo të lodhur. Se kur vjen puna me vjedhë, këta punojnë 24 orë, shtatë ditë në javë.

- Çfarë duhet të shpresojnë shqiptarët nga rezultari i 23 qershorit?

- Asgjë. Do të jetë e njëjta gjendje. Të njëjta zare janë hedhur edhe një herë, me përdorë gjuhën e Tiranës, hep - jek, shesh - besh. Në rastin më interesant, do të ndërrojë hajnat në krye të shtetit. Kaq.

- *Sa vlerë reale ka miratimi i tre ligjeve, ndërkohë që po këta ligjbërës, kanë shkëlur Kodi Zgjedhor për KQZ, duke hedhur në erë mirëbesimin dhe legjitimitetin e procesit zgjedhor?*

- Po, asnjë farë vlere nuk ka. Kjo është thjesht demagogji e propagandë për budallenjtë që duan të besojnë diku, te diçka që do t'ua zgjidhë të gjithë hallet. Këta kanë gjetur përrallën e integritimit. Shqiptarët duhet ta ngulin mirë në kokë: nuk ka integritim për ta. Integritimi duhet të ndodhë midis shqiptarëve vetë. BE është në krizë, ka thënë se nuk ka zgjerim deri në vitin 2027 dhe ne flasim për integritim, kemi parti integritimi, qeveri

integrimi dhe tani duam të heqim edhe vizat për në SHBA! Pastaj, kush ka besuar ndonjëherë në procesin zgjedhor? Po kush beson? Mulliri i tyre i propagandës bluan fare pa kokrra, por kjo tregon nivelin e përbuzjes që këta kanë për shqiptarët.

- *A ka interes që ky sistem politik të ndryshojë për të mirë?*

- Paria nuk ka interes. Populli ka. Të huajt duan stabilitet. Se çfarë bëjmë ne me veten, është problem jonë. Por duhet punuar fort dhe i duhet treguar popullit se cila është rruga. Koha ka ardhur për një fillim të ri dhe fillimi nuk vjen dot nga paria. Çdo ditë e më tepër kjo bëhet e qartë si drita e die-llit. Nevoja për ndryshim është e pashmangshme. Ndryshimi duhet mbështetur në vlerat e vërteta të një populli si shqiptarët dhe në një projekt të ri modernizues, të balancuar dhe të mbështetur në themelet e forta të elementëve të mëposhtëm.

Së pari, në identitetin e padiskutueshëm të shtetit - komb.

Së dyti, në një sistem politik demokratik.

Së treti, në një administratë shtetërore të pakorruptueshme e të mbështetur në ligj.

Së katërti, në një ekonomi tregu të institucionalizuar ku i jepet përparësi prodhimit kombëtar.

Së pesti, në një politikë të jashtme të bazuar në interesin kombëtar.

Së gjashti, në luftën e pakompromis kundër krimit e kundër të keqes, në çdo formë që të materializohet e keqja shoqërore.

Së shtati, në krijimin e në kultivimin e vlerave të vërteta të një shoqërie që krijon mundësi për të gjithë.

Së teti, në kultivimin e vlerave të shoqërisë civile efektive.

Së nënti, në ndërtimin dhe konsolidimin e strukturave të shërbimeve shoqërore si edukimi, shëndetësia, mbrojtja e fëmijëve dhe e pensionistëve.

Më në fund, por jo më e fundit, ndërtimi i strukturave funksionale të një sistemi të partive politike, që të avancojë e të mbrojë interesat e bashkësisë ligjore - politike me mjete legjitime demokratike.

Çdo përpjekje për ndryshim, qoftë në formën e një pro-

grami politik, qoftë në formën e një pakete ndryshimesh ligjore që nuk mban parasysh këto parime themelore, është e destinuar të dështojë. Këto elemente janë pjesë e pandashme e çdo projekti për shërimin e përmirësimin e gjendjes. Por ata që marrin përsipër këtë detyrë, duhet të jenë të përgatitur të përplasen me një pari që do të përdorë çdo mjet në dispozicionin e saj, edhe në format ekstreme të dhunës e të terrorizmit shtetëror. Rruga është e qartë.

- *A mund të reformohet së brendshmi ky sistem politik, ekonomik, shoqëror dhe kjo kastë (klasë) politike njëzetë e dy vjeçare, e cila është ndërtuesja e interpretuesja e këtij sistemi?*

- Po nuk priten pushtues që të na bëjnë njerëz. Sepse pushtimet bëjnë skllëvër, jo njerëz. Dhe ne i kemi pasur rreth e rrotull të huajt tash njëzetë e dy vjet dhe nuk janë të zotët të na bëjnë përsëmbari. Ne kemi shtetin tonë, le të ndërtojmë strukturat që na ndihmojnë me arritë objektivat e shoqërive normale, domethënë sigurimin e jetës, të nderit, të dinjitetit, të begatimit e të mbrojtjes për popullin tonë. Sistemi mund të reformohet nga brenda dhe ai do të ndryshohet e përmirësohet me përfshirjen e popullit, të rinisë, të emigrantëve të edukuar jashtë, të profesionistëve, qoftë edhe në moshë, në politikë.

Edhe pse do të jetë një ndeshje sy për sy e dhëmb për dhëmb, do të ketë vend edhe për parinë. Gjithkush duhet të funksionojë në një shtet normal që ka shtërngesa ligjore të forta. Ata që kanë bërë krime të dënohen, por të gjithë duhet të kenë mundësinë të ndryshojnë për mirë.

- *Duke qenë se koalicioni i së majtës, ka LSI e cila bashkëqeverisi për katër vjet me PD, besoni se do të kemi rotacion politik, nëse fiton apo do të kemi ndryshimin e progresit të kërkuar e të dëshiruar?*

- Po çfarë rrotacioni, more aman? Këta e kanë mendjen të rradha e pirjes së gjakut. Politika shqiptare është si politika e çimkave. Ato rrinë gjashtë vjet pa pirë gjak, por kur fillojnë kanë etje për të pirë sa për gjashtë vjet. Këta duan të jenë si çimkat. Të pinë gjakun tonë, domethënë të vjedhin sa

të munden, në gjashtë muaj të pasurohen për gjashtë breza dhe mandej flasin për rrotacion. Nuk e kam parë një politikan të dalë e të lypë për bukën e gojës, të ecë në këmbë, të çojë fëmijët në shkollë publike, të bëjë punë vullnetare. Asgjë e re. Po përziejmë kazanin e plehrave politikë. Këta ishin në qeveri dolën tre muaj në opozitë. Demokracia nuk është rrotacion, demokracia është që të bëhet zgjedhja më e mirë. Zgjedhjet që kemi ne, janë mizerje dhe të dyja të këqia e prandaj duhen refuzuar. Gjarpëri blu e gjarpëri rozë. Ku është dallimi?

- A duhet të jetë kushtëzimi i këtij ndryshimi demokratik, që shtrohet domosdoshmëri nga zgjedhjet e 23 qershorit, rishikimi i Kushtetutës për të korrigjuar ato ndryshime që u bënë në 2008, pasoja e së cilave është përqendrimi i të gjitha pushteteve në një dorë?

- Kushtetuta duhet rishikuar e ndryshuar, sepse nuk funksionon. Po kush do ta bëjë? Këta punojnë për vete. Si thonë myzeqarët, gjeti buallica baltën dhe ra rehat. Edhe ndryshimet do t'i bëjnë kur iu intereson dhe si iu intereson. Dhe do të rrinë po aty ku janë tani. Këtu duhet ndërruar Kushtetuta, duhet bërë funksionale e duhet vënë në shërbim të mirëfilltë publik struktura e shtetit. Kush do ta bëjë? Hajnin kur e bën polic e ka mendjen prapë me vjedhë. Këta kanë të njëjtën mendësi. Duhet një forcë e re, me njerëz të rinj dhe me mendësi tjetër.

- Të paktën këtë premtim nuk e kemi dëgjuar nga opozita. Mendoni se nuk është ky prioriteti i saj strategjik?

- Opozita don me çdo kush të kapë kontrollin e shtetit. I ka marrë uria keqas dhe nuk shohin gjë veç parave. Këta duan marrëveshjen me Saliun dhe i thonë "ik me nder". Aty është e gjithë puna, na e lësho karriken ne. Si e thashë më lart, këta nuk kanë ndërmend me ndrrue gjë.

- A është Edi Rama lideri i cili mund të realizojë ato transformime demokratike që nuk janë realizuar njëzetë e dy vjet deri tani dhe ta çojë Shqipërinë në BE, apo është udhëheqësi i forcës politike më të madhe opozitare?

- Po çfarë demokracie? Në çfarë bote jetoni ju? Këtu është

oligarki, këta janë hajna, këta vjedhin bashkë. Edi Rama, Sali Berisha Ilir Meta, Fatmir Mediu e me radhë. Këta do të sillen katër vjet rreth mullarit të barit të thesarit dhe aty mbaron puna. Nuk ka BE për ne, ta heqin nga mendja shqiptarët.

- Integrimi deri tani është mbajtur peng i mosgjetyes së konsensusit pozitiv - opozitë. Përse duhet të jemi optimistë, se çdo rezultat zgjedhor, mund të ndihmojë, që pozita - opozita do të kenë vullnetin politik kësaj here për të bashkëpunuar për integrimin?

- Po çfarë pengu? BE nuk don që shteti shqiptar të jetë pjesë e BE. Duhet të jemi optimistë? Po asgja nuk ka me ndodhë. Nuk janë tre ligjet problem. Këta janë bashkë, por nuk është integrimi që nuk ka me ndodhë zgjidhja. Sepse ashtu i thuhet që të ngopesh me lugë të zbratur. Zgjidhja është bojkotimi, vota e bardhë, vota kundër, ndërtimi i një koalicioni qytetar për liri e demokraci. Këtu duhen bërë bashkë këto grimcat e shoqërisë civile që synojnë ikjen nga kontrolli i parisë. Ose duhen mbështetur alternativat që janë jashtë strukturave të këtyre, dy partitë që do t'iu krijojnë probleme të dy koalicioneve, FRD e AKZ, ose duhet ndërtuar një strukturë civile me iniciativat "Bjeri vizë", "Vota e bardhë", lëvizja "Vota e protestës", "Hiq kryq", blogun "Demokracia direkte" dhe ata të tjerët që kanë thënë tash sa vite, Bojkot: "Vota shkon kot". Sepse nuk ka më zgjidhje të tjera. Po nuk u veprua kështu, këta prijatarë të parisë së Tiranës do të dalin e të thonë; ju na e dhatë të drejtën të bëjmë të keqen që bëmë, sepse ne kaq ditëm, nuk kishte të tjerë dhe ju na zgjodhët, nuk ju detyruam ne! Se ja shih, edhe koalicionet që kemi ndërtuar, ju i zgjodhët! E sa për integrimin, ajo është një përrallë e parealizueshme...

BOJKOTIMI I ZGJEDHJEVE - HAPI I PARË DREJT DEMOKRACISË SË VËRTETË

Në shtetin shqiptar do të ketë zgjedhje, por nuk ka zgjedhje. Të gjithë këta janë pjesë organike e parisë së Tiranës. Ata përfaqësojnë interesat e një grushti oligarkësh ekonomikë e politikë të klaneve kriminale të drejtuara nga Sali Berisha, Edi Rama, Ilir Meta dhe të tjerët.

Ja disa nga arsyet pse duhen bojkotuar zgjedhjet!

Të gjithë këta nuk kanë pikë dashurie për popullin shqiptar, nuk kanë pikë dhembshurie për të varfërin, nuk kanë mirëkuptim për të pamundurin, nuk kanë mëshirë për të mjerin, nuk kanë vetëdije shoqërore e mendësi shtetari. Ti mund të shkosh të votosh për cilin të duesh nga këta, por asgjë nuk do të ndërrojë. Prapë do të jesh pjesë e një populli që këta e quajnë “këta pisa”. Prandaj duke mos ua dhënë votën këtyre që të urrejnë e të përbuzin, që duan të të rrjepin e të të shfrytëzojnë, nuk bëhesh me vetëdije pjesë e krimit që po luhet e që do të luhet edhe më me dhembje mbi ty e mbi familjen tënde pas këtyre zgjedhjeve.

Këta nuk punojnë për ta vënë shtetin në shërbim të gjithë shqiptarëve, por vetëm për ta vjedhur për veten e tyre. A nuk të mjafton ajo që sheh e përjeton përditë? A nuk i sheh se si i vodhën të mirat që u prodhuan me aq mund e gjak e që u përkisnin të gjithëve, i ropën shqiptarët nga e mira publike, i shitën pasuritë e vlerat, i shfrytëzuan si deshën burimet e shtetit? A nuk e sheh se si na kanë zhytur në borxh publik, na kanë mashtruar, rrejtur dhe grabitur? Nëse ua jep votën këtyre, cilitdo prej tyre, do të bëhesh pjesë e krimit të pashembullt që u bë kundër shqiptarëve. Prapë do të jesh pjesë e një populli që këta e urrejnë, e neverisin dhe e përbuzin. Por do të jesh si ai që e lë pasurinë në dorën e hajnave. Prandaj duke mos ua

dhënë votën këtyre që të urrejnë e të përbuzin, që duan të të rrjepin e të të shfrytëzojnë, nuk bëhesh me vetëdije pjesë e krimit që po bëhet e që do të bëhet edhe më me dhembje mbi ty e mbi familjen tënde pas këtyre zgjedhjeve.

Këta do të bëjnë gjithçka munden që të vazhdojnë degjenerimin e zvetënimin e shoqërisë shqiptare. Këta që nuk lëvizën as gishtin kur kriminelët e banditët më të fëlliqtë trafikuan çdo gjë të shenjtë që ne kishim, kur shoqëria shqiptare jetonte nën terrorin e bandave që punojnë për ta, nuk kanë ndryshuar. Këta që nuk kanë pasur mëshirë për asgjë, nuk do të kenë mëshirë për ty nesër. Këta që kanë trafikuar fëmijë, vajza, armë, drogë e gjithçka tjetër, nuk do të kenë mëshirë për ty e për familjen tënde nesër. Duke mos ua dhënë votën këtyre që të urrejnë e të përbuzin, që duan të të rrjepin e të të shfrytëzojnë, nuk bëhesh me vetëdije pjesë e krimit që po bëhet e që do të bëhet edhe më me dhembje mbi ty e mbi familjen tënde pas këtyre zgjedhjeve.

Këta kanë vetëm një Zot; paranë. Për para këta kanë shitur shpirtin, do të bëjnë gjithçka që u thotë shpirti i uritur e meskin, sepse skllëverit e zvetënuar e të ndërgjegjshëm të një sistemi, nuk bëhen dot bukëdhënës e frymëzues për brezat e ardhshëm. Këta duan të pasurohen me çdo kusht. Tani që nuk kanë ku marrin, ku të vjedhin, ku të privatizojnë, ku të korruptohen, do drejtohen të të hanë ty me gjithë kocka, me gjithë atë pak mall që ke, gurë e tulla që i quan pasuri, me atë apartament ku fut kokën, me atë grusht parash që i ke ruajtur për ditën e zezë. Sepse këta nuk njohin gjë tjetër veç erës së parasë. Duke mos ua dhënë votën këtyre që të urrejnë e të përbuzin, që duan të të rrjepin e të të shfrytëzojnë, nuk bëhesh pjesë e krimit që po bëhet e që do të bëhet edhe më me dhembje mbi ty e mbi familjen tënde pas këtyre zgjedhjeve.

Këta duan të na skllavërojnë e të na bëjnë të punojmë për bukën e gojës e për bukën e gojës njerëzit të shesin nderin. Ata që sot shesin nderin, nesër do të shesin jetën e fëmijët e tyre. Sepse këta e dinë shtegun se si të skllavërojnë njeriun. Sot të bëjnë të dalësh në miting, të kërcënojnë me vendin e punës, të mbajnë varur, të korruptojnë, të degjenerojnë si duan vetë.

E mendon se do të ndryshojnë nesër? Duke mos ua dhënë votën këtyre që të urrejnë e të përbuzin, që duan të të rrjepin e të të shfrytëzojnë, nuk bëhesh me vetëdije pjesë e krimit që po bëhet e që do të bëhet edhe më me dhembje mbi ty e mbi familjen tënde pas këtyre zgjedhjeve.

Duke mos ua dhënë votën këtyre, je duke treguar karakter dhe virtyt qytetar. Këta duan të të kthejnë në kafshë me të drejtë vote. Këta duan të të kthejnë në injorant me diplomë. Këta duan të të kthejnë në pronar në tokën e paligjshme, por nën kontrollin e tyre. Këta duan të të kthejnë në njeri që shet nderin për paranë. Këta duan të të kthejnë në njeri që për jetën e vet shet fëmijët e vet. Këta duan të të kthejnë në njeri që kurvninë e konsideron virtyt, që poshtërsinë e konsideron zgjuarësi, që maskarallëkun e sheh si sjelljen burrënore. Këta duan të të kthejnë në qorrshurdhmemec politik që pranon vjedhjen masive e krimin që kanë bërë, vetëm për të siguruar mbijetesën e ditës e bukën e gojës. Duke mos ua dhënë votën këtyre që të urrejnë e të përbuzin, që duan të të rrjepin e të të shfrytëzojnë, nuk bëhesh me vetëdije pjesë e krimit që po bëhet e që do të bëhet edhe më me dhembje mbi ty e mbi familjen tënde pas këtyre zgjedhjeve.

Duke mos ua dhënë votën këtyre horrave e maskarenjve, ti po tregon se ende ka shpresë për shqiptarët. Sepse bojkoti nuk është qëllim në vetvete. Bojkoti është hapi i parë në rrugën e vështirë të ndryshimit, të fillimit të ri, të një rruge që do të bëjë një shoqëri normale. Bojkoti i këtyre zgjedhjeve ua heq lustrën shfaqjeve publike që kushtojnë miliona euro e që nuk bëjnë asgjë për ty. Bojkoti është hapi i parë me pa rrotull e me kuptue se ka të tjerë që nuk e duan këtë gjendje. Bojkoti është hapi i parë me u nda me të keqen. Bojkoti është momenti kur ti shkëputesh nga kontrolli i ujkut që të ka kapur për fyti. Sepse ti mund të bësh ç'të duash, këta duan vetëm të pinë gjak. Po ta kuptosh se vota është plumb, atëherë nuk do të bësh vetëvrasje, duke ua dhënë votën këtyre, por do ta drejtosh votën - plumb aty ku duhet. Kombi shqiptar ka shumë shembuj që duhen ndjekur, ka djem e vajza që duan të japin gjithçka. Kërkoji në rrugën tënde. Aty janë. Ata janë ti, motra,

vëllai, djali e vajza, mbesa e nipi, shoku e shoqja, ata që ty nuk ta merr mendja, sepse janë edhe në kalimtarët e rrugës dhe në ata që ti nuk i njeh, sepse nuk të le llapaqenëria mediatike. Ata që nuk ta mbushin mendjen, por që duan të punojnë për të mirën e shqiptarëve, për një shtet - komb normal, për një ekonomi kombëtare, për një shoqëri që e mbron nderin e dinjitetin e qytetarëve të vet, për një sistem shoqëror që mbron të pamundurin, të varfërin, fëmijët, gruan shqiptare, janë aty me ty. Ata njerëz janë e nesërmja jote. Duke mos ua dhënë votën këtyre që të urrejnë e të përbuzin, që duan të të rrjepin e të të shfrytëzojnë, nuk bëhesh me vetëdije pjesë e krimit që po bëhet e që do të bëhet edhe më me dhembje mbi ty e mbi familjen tënde pas këtyre zgjedhjeve. Por bëhesh pjesë e zgjidhjes që fillon me dështimin e me çjerrjen e maskës së kësaj partie kriminale.

Edhe po nuk pate besim se diçka ka me ndodhë, mos u bëj pjesë e të keqes. Bojkoti është të mos shkosh fare të votosh. Ama, nese shkon e voton, voto ndërgjegjen tënde. Vëru një vizë të gjithëve. Kur të dalësh nga salla, do të shohësh ata komisionerët e shitur që rrinë aty gati për të vjedhur të ardhmen tënde, por do të jesh i ndërgjegjshëm se ata do të të vjedhin votën, por nuk mund të të vjedhin nderin e ndërgjegjen. Mos voto për sot, mendo për nesër! Sepse vota jote vendos të ardhmen tënde dhe të fëmijëve të tu. Sepse vota që hedh është plumb dhe mos ia drejto atë plumb fëmijëve të tu. Drejtoja atyre që të urrejnë e të përbuzin, që duan të të shfrytëzojnë, të të grabisin, të të rrjepin e të të skllavërojnë. Sepse jemi një hap në buzë të greminës dhe çdo votë kundër parisë, çdo votë për bojkot, e mbush të ardhmen me shpresë. Vuri një vizë të shkuarës! Duhet një fillim i ri dhe çdo fillim i ri, fillon me ndarjen nga e shkuara, sidomos kur ajo është kaq e zezë dhe e vuajtur, sa e shkuara e ne shqiptarëve.

PËRPLASJA PËR MONUMENTIN NË KAVAJË

Paria e Tiranës e ndien shumë thellë se niveli i mosbesimit popullor në të e në sjelljen e saj politike, ka arritur një shkallë edhe më të ulët sesa besohej. Po pa besimin e njerëzve në rrugën e saj e në individët prijatarë, paria nuk mund të shpresojë të ketë zgjedhje të sigurta.

Ajo që i ka munguar fushatës zgjedhore deri më tani, ka qenë përplasia e hapur në nivelin më të thellë të identifikimit të grupeve, domethënë në atë ndarje fiktive ideologjike që paria e ka manipuluar kaq intensivisht gjatë këtyre njëzetë e tre viteve.

Kjo është ndarja në komunistë - antikomunistë. Ka disa kohë që paria ka kërkuar shkaqe për të filluar këtë sherr. Edhe pse i ka rënë rreth e rrotull, e ka kuptuar se tashmë ka një mur të madh ndarës midis të rinjve që janë shumica e votuesve, pjesës tjetër të shoqërisë e vetë parisë. Gati 60 % e popullatës në shtetin shqiptar nuk ia kanë idenëse çka ka qenë sistemi i mëparshëm. Ata që kanë jetuar në sistemin e mëparshëm e kanë kuptuar se e gjithë përplasia ishte një lojë.

Prandaj edhe kjo që po ndodh në Kavajë është shumë domethënëse. Gjatë këtyre njëzetë viteve, Kavaja ka qenë një bastion i Partisë Demokratike dhe i Sali Berishës. Aty kanë vënë kandidaturat rregullisht figurat më të spikatura të PD, Sali Berisha apo Azem Hajdari. Kavaja e numëronte veten si “demokratike” dhe një kohë nuk guxonte të dilte kush si kundërshtar i PD apo Sali Berishës.

Por në Kavajë ka dalë si figurë qendrore politike, Elvis

Rroshi. Njeri inteligjent, që nuk dihet se si i ka bërë paratë në Zvicër e tjerakund e që ka qenë në vëmendje të shumë strukturave policore brenda e jashtë. Ai ia ka arritur të lidhë me njëmijë fije masën e tregtarëve, të sipërmarrësve dhe të parisë lokale. Jo vetëm që z. Rroshi ia arriti të bëhej kryetari i bashkisë, por duke përdorur të ardhurat e veta të ndjeshme dhe duke krijuar mundësi për pjesëtarët kryesorë të parisë lokale, ai tashmë e ka transformuar Kavajën në një bastion të PS. Jo vetëm që ia ka arritur të kthejë në mbështetës të vet shtresën e biznesit, por ia ka arritur të kthejë në mbështetës të vet edhe një masë të qytetarëve të Kavajës.

Dalja e tij në këto zgjedhje dhe deklarimi se do ta zhgulë "me paratë e veta" monumentin e ndërtuar nga PD dhe do ta sjellë me helikopter në Tiranë, ngjalli një reagim jo të vogël. Eduard Selami dhe Arben Imami që të gjithë i paraqesin si drejtues të Lëvizjes Studentore, por që studentët nuk i njohin si të tillë, u ngritën kundër heqjes së monumentit. Tashti ka hyrë në lojë edhe Sali Berisha që i fryu flakës së përçarjes duke dalë e duke thënë se kush e prek monumentin, do t'ia këpusin gishtat, sepse ky është monumenti i demokracisë, etj, etj. Tashmë ky problem u politizua dhe si Berisha, ashtu edhe kundërshtarët e tij në nivelin lokal, kanë nxjerrë maksimumin e përfitimit që kanë mundur të nxjerrin nga kjo përplasje.

Kjo gjithashtu tregon se fushata do të bëhet në nivelin lokal. Elvis Rroshi dhe ata që e mbështesin ndiehen aq të fortë dhe kanë bindjen se zhgënjimi në Kavajë është aq i thellë, sa të mund të shkojnë gjer në këtë pikë. Po ashtu, shpejtësia me të cilin u turrën për të kundërshtuar sjelljen e tij, tregoi se ndjeshmëria është e madhe. Arsyeja është se "Dy gishtat" nuk janë thjesht një simbol i demokracisë. Ato janë kthyer në pronë private të Sali Berishës. Prandaj edhe qëndrimi domethënës i Lulzim Bashës, njeriut që është caktuar të drejtojë fushatën e PD në Kavajë nuk duhet të kalohet lehtë. Se ja, lidhur me rrëzimin e monumentit në Kavajë, Basha u shpreh se: "Rilindja" e Ramës është rievokim i sistemit komunist. Rama,

kur erdhi këtu ju tregoi atë që ai është në të vërtetë, se do të thyejë dy gishtat e demokracisë, të cilat shkërmoqën murin famëkeq të Berlinit në Shqipëri, duke treguar se “Rilindja”, sipas Ramës është rievokimi i bllokmenëve, pra sistemit komunist”. Me një fjalë edhe Basha po tenton të përdorë ndarjen komunistë - antikomunistë.

Po në një nivel tjetër, kjo gjendje e kjo përplasje tregon se Kavaja është e humbur për PD. Zhgënjimi i thellë i kavajasve me tranzicionin dhe me mashtrimin sistematik që kanë pësuar gjatë këtyre njëzetë e tre viteve, do të shpërthente diku dhe po shpërthen te çështja e monumentit. Kavaja dikur e bëri të dërguarin e Ramiz Alisë të ecte mbi veprat e Enver Hoxhës. Tani, përmes njeriut që e drejton, po e bën Sali Berishën të pozicionohet edhe kundër vetë Kavajës.

Megjithatë, përtej përplasjes për monumentin duhet thënë se këtë herë Kavaja nuk është më qyteti i shpresës për vegjëlinë. Kavaja është një qytet që e ka humbur shpresën dhe që po mbështetet përditë e më shumë në forcat e errëta të shoqërisë dhe në ata që duan ta përdorin sentimentin popullor për interesat e tyre personale, klanore, materiale, ekonomike dhe politike. Prandaj edhe përplasja për monumentin është një simptomë më e thellë e gjendjes, jo vetë gjendja, siç e paraqesin palët e interesuara.

LËVIZJA STUDENTORE E VITEVE 1990 - 1991 VLERË PËR KOHËT KRITIKE

Lëvizja Studentore e viteve 1990 - 1991, është një moment shumë kritik në historinë moderne shqiptare. Diku tjetër i kam zbërthyer me qetësi arritjet e saj historike. Po në këtë moment delikat në të cilin po shihet qartë se paria e Tiranës nuk na ka çuar kund, se tranzicioni ka dështuar, se shoqëria është e kriminalizuar, sistemi politik është oligarkik, ekonomia është në grushtin e disa monopolistëve, kur administrata është e korruptuar, vendi nuk ka sovranitet dhe pyetja shtrohet se cili do të jetë niveli i përplasjes shoqërore të nesërmen e zgjedhjeve, është e dobishme të reflektohet mbi momente e lëvizje të tilla shoqërore. Më shumë se kurrë, kemi nevojë t'i drejtohem të shkuarës për të gjetur shembuj të mirë. Ne kemi shumë shembuj të lartë shërbimi publik, por gjatë këtij tranzicioni nuk ka shembull më të pastër shërbimi publik se Lëvizja Studentore e viteve 1990 - 1991.

Mbi arritjet e Lëvizjes Studentore të viteve 1990 - 1991

Duke lënë mënjanë shumë individë, elementë e kontribute, do të thoja se shtatë arritjet e mëposhtme të Lëvizjes Studentore e meritojnë vëmendjen e analistëve dhe të historianëve.

Së pari, ishte mobilizimi e strukturimi i studentëve në masën kritike që e gjeti dhe e fitoi zgjidhjen e duhur politike në një moment historik, kur paria e Tiranës dhe intelektualët ishin krejtësisht të paralizuar e të pazotët të vepronin si duhet.

Së dyti ishte fitimi i pluralizmit nga vetë studentët, dhënia

e shembullit të sjelljes së vërtetë demokratike e kombëtare.

Së treti, ishte themelimi, drejtimi dhe mbështetja që iu dha partisë së parë opozitare, si një formë moderne kundërvënije ndaj një sistemi ende shumë të fortë.

Së katërti, ishte mobilizimi popullor në mbështetje të ndryshimeve politike, ekonomike e shoqërore që do të mund të ndërtonin një të ardhme më të mirë për të gjithë shqiptarët.

Së pesti, ishte ruajtja e dallueshmërisë së Lëvizjes Studentore nga partitë politike. Shumë nga studentët u përfshinë në politikë, po karakteri, individualiteti dhe besimi politik i Lëvizjes u ruajt i patjetërsueshëm përmes organizatave dhe individëve të veçantë.

Së gjashti dhe e lidhur pazgjidhshmërisht me kontributin e mësipërm, ishte planifikimi, organizimi, drejtimi dhe mbyllja në sukses e Grevës historike të Urisë që e detyroi sistemin të hiqte statujën dhe emrin e themeluesit të vet, Enver Hoxhës dhe të pranonte humbjen e legjitimitetit. Kjo edhe çliroi masat e gjëra të popullit dhe të gjitha shtresat nga kontrolli, frika, detyrimi dhe dyshimi.

Së shtati, e para të gjithave, vlera themelore e Lëvizjes Studentore ishte mesazhi thellësisht patriotik e kombëtarist që i dha frymën gjithë veprimtarisë së saj dhe në veçanti, arritjeve që përmenda më lart. Edhe pse kishte ideologji e besime të tjera, fryma kombëtariste ishte përcaktuese në momentet më kritike dhe në vendimet që u morën. Kjo e bëri Lëvizjen një kontribut të veçantë e të dallueshëm në atë periudhë kritike dhe pikërisht për këtë arsye, ai kontribut është themeli i respektit dhe vlerësimit që shprehet nga të gjithë shqiptarët për Lëvizjen dhe pjesëmarrësit e saj.

Përpyekja për të manipuluar me Lëvizjen Studentore

Politika nuk na lë ta harrojmë Lëvizjen Studentore. Sepse gazetata na i portretizojnë aktorët kryesorë të krimit, si liderë e udhëheqës të Lëvizjes Studentore, duke na futur të gjithëve në

atë kazan plehrash ku gëlojnë këta vemje të parisë së Tiranës. Del Arben Imami, e flet si lider i Dhjetorit. Del Eduart Selami e paraqitet si lider i Dhjetorit. Hidhet Sali Berisha e shitet si frymëzues i Dhjetorit. Edhe Tritan Shehu na ka dalë si figurë e Dhjetorit. Janë edhe disa të korrumpuar e të degjeneruar nga të gjithë krahët që na shiten si liderë të Dhjetorit. Duke e parë këtë manipulim të pashembullt, duke e vlerësuar si duhet momentin kritik në të cilin gjendemi, mendoj se duhet të ndahemi me këta matrapazë e manipulues të së vërtetës. Ashtu si edhe është vënë në dukje nga shumë miq, duhet të sqarohen si motivet, ashtu edhe e vërteta lidhur me Lëvizjen Studentore. Duhet të sqarohet se këta individë e mistrecë politikë, nuk kanë të bëjnë asgjë me Lëvizjen e kontributet e saj. Megjithatë këta janë shkaku pse ajo Lëvizje u mbyt, u shua, u shpërnda dhe u persekutua pa mëshirë.

Lëvizja Studentore nuk ka të bëjë asgjë me individë të tillë. Këta kanë qenë mishi i huaj, të futurit e sistemit, veglat e tij që përdorën mashat e injorantët, naivët e të paditurit për të arritur qëllimet e tyre. Këta ishin e keqja që fitoi. Por nuk ishin e nuk janë Lëvizja Studentore dhe kontributi i saj. Prandaj qëndrimi ambivalent i pjesëmarrësve më lë shumë keq. Në këtë periudhë të tendosur zgjedhore, e kam ndierë qëndrimin ambivalent të shumë pjesëmarrësve, të shprehur në shumë mënyra; mbështetje për individë që nuk kanë bërë gjë me vlerë, për vlera që nuk janë vlera, nevojën e tyre për t'i lidhur këto me Lëvizjen Studentore e për t'iu dhënë legjitimitet, përvetësimin e kontributeve të një personi dhe njëherësh hedhjen poshtë të atij personi, që në një përkujtim e pashë të ulur në radhën e dytë, sepse në radhën e parë ishte ulur dikush që ka kontribute të një natyre tjetër. Sepse njëri ndër elementët më të pranishëm të kësaj fushate elektorale, është edhe Lëvizja Studentore dhe trashëgimia e saj politike. Nuk duhet lejuar të ketë qëndrime ambivalente. Lëvizja nuk ka pasur të bëjë me këta që janë në politikë. Të paktën ajo pjesë e Lëvizjes me të cilën jam identifikuar unë dhe miqtë e mi, nuk ka pasur të bëjë

me këta që janë në politikë. Këta kanë qenë e janë njolla e zezë e tranzicionit, kolona e pestë, veglat e sistemit, instrumenti i krimit të pashembullt dhe fytyra e mashtrimit politik.

Pse e them këtë? E them se Lëvizja Studentore është burimi kryesor i legjitimitetit të Sali Berishës, të shumë prej figurave tashmë të diskredituara që ende duan të shiten si “dhjetoristë” dhe e shumë militantëve të PD që janë në gjendje të tregojnë se çfarë bënë në atë Dhjetor me një saktësi të habitshme.

Por kjo është më e ngarkuar politikisht se kaq. Historia e Saliut dhe e të gjithë disidentëve të sistemit të mëparshëm, fillon në Dhjetor 1990. Problemi nuk është se ajo fillon në Dhjetor 1990, problem ishte se mendërisht, me të njëjta teknika, si makina të përdorura që dalin nga parkimi, në vend të marshit para, këta i futën një marsh mbrapa dhe nuk u ndalën e nuk po ndalen as tani. Po makinat moderne partiake nuk janë gomarë e kuaj që shtyhen me “ush - ush” dhe problemi ishte se frenat i kishte në duar tjetërkush.

Prandaj edhe nuk më bën përshtypje që njëra ndër lëvizjet interesante të Sali Berishës gjatë vitit të kaluar, ka qenë në drejtim të konsolidimit të lidhjes së tij e të familjes së tij me Lëvizjen Studentore. Kjo Lëvizje është parë dhe është përdorur në të gjithë nivelet e mundshme nga ai dhe nga PD. Publikisht, Saliu shitet si frymëzuesi i Lëvizjes dhe themeluesi i vetëm i PD . Dhe pjesëmarrësit në Lëvizje kanë heshtur. Ai përkujton lindjen e PD në qytetin “Studenti” kur i teket dhe e ndërron datën thjesht sepse ka një udhëtim jashtë shtetit. Dhe pjesëmarrësit në Lëvizje kanë heshtur. Qan e përlohet në përvjetorin e lindjes së Azem Hajdarit edhe pse i din shumë mirë prapaskenat e ngjarjes që çuan në vrasjen e tij. Dhe pjesëmarrësit në Lëvizje kanë heshtur. Ai ndan medalje e dekorata për njerëz që kanë pasur fatin të jenë njëzetë vjeçarë në atë kohë. Dhe pjesëmarrësit në Lëvizje kanë heshtur.

Por Sali Berisha nuk ka problem Azem Hajdarin. E si ta ketë problem? Saliut i duhet identifikimi i tij me Lëvizjen përmes Azem Hajdarit. Azemi është blindi pas të cilit mbrohen të

gjithë këta padesybardhët, spiunët, veglat, të futurit, plehrat e sistemit. Saliu nuk është budalla. Ai e di se kush e bëri punën dhe kush i mori meritat dhe në këtë pikë. Azemi ishte hero i që i duhej sistemit dhe Saliu ishte paterica e sistemit. Prandaj në mes të dy seancave, Presidenti Mëkëmbës, ai që me automatik në dorë donte të vendoste statujën e Enver Hoxhës në shesh, i jep “Urdhëri i Flamurit”, të ashtuquajturit “lider të Lëvizjes” duke i shtuar edhe një njollë tjetër flamurit kombëtar dhe duke e zhvlerësuar edhe më këtë urdhër. Saliu e përkujton Azemin si frymëzues dhe si drejtues të Grevës së Urisë, kur dihet që e kemi vënë të rrinte te dera e banjos dhe që ka qenë kundër e që është munduar ta sabotojë grevën së bashku me Saliun. Po ashtu Saliu mbledh rreth vetes tufën e të dërguarve nga strukturat dhe sjell me vete në qytetin “Studenti” shitësin e suksesshëm të makinave të përdorura Ed Selamin dhe Arben Imamin, shitësin e ministrisë dhe të ushtrisë, Genc Rulin, shitësin e ekonomisë dhe të gjithë hajnat që ka në qeveri. Një kohë na ka nxjerrë edhe dhëndrin e Trustit të Gështenjave, “disidentin e djathit”, shkaktarin që në Grevën e Urisë vinte erë këmbësh të palara, sepse mbante kambale zbori, që të provonte versionin e tij. Tani e shpall Azemin dëshmor të kombit dhe e nderoi edhe në 5 Maj. Unë Azemin nuk e kam pasur mik, por armik. Mund të them pa mëdyshje, e kam pasur armik për vdekje. Megjithatë, Azem ka meritat e veta që askush nuk mundet me ia mohue. Ai ka edhe krimet që askush nuk mundet me ia mbulue. Por Azemi nuk ka luejtë ndonjë rol qendror në arritjet e Lëvizjes Studentore për të cilat fola më lart, sepse ka qenë dora e zgjatur e strukturave dhe njeriu që për hir të interesave të veta, shiti të gjithë shokët e shoqet e tij.

Arma e Sali Berishës: grupimi “Dhjetor ‘90”

Arma kryesore e Sali Berishës në këtë lojë të ndyrë me Lëvizjen Studentore është grupimi “Dhjetori ‘90”. Ky grupim i drejtuar nga Bislim Ahmetaj, një dikush që nuk ka qenë udhë-

heqës apo me ndonjë kontribut në Lëvizjen Studentore, është bërë struktura që ka mbledhur rreth vetes e rreth PD shumë studentë, pjesëmarrës aktivë në Lëvizje, por edhe vajza e djem të mrekullueshëm që u përdorën e po përdoren edhe sot. Duke e ndërtuar si strukturën e vet, ta përdorte si mbështetje për t'u bërë deputet i PD, gjë në të cilën dështoi, Bislim Ahmetaj ka ndjekur me konsistencë e gjithë kohën politikën e Sali Berishës. Si pasojë, grupimi 'Dhjetori '90' është kthyer në instrumentin kryesor të shitjes së variantit salist të zhvillimit të Lëvizjes Studentore. Në shkrimet dhe në veprimtaritë e grupimit "Dhjetori '90" të bien në sy shumë gjëra që janë gabim, shtrembërime të së vërtetës, mashtrime e hile të nivelit më të ulët. Përpyekja titanike e grupimit është me identifikue Azem Hajdarin si figurë qendrore të Lëvizjes Studentore. Përpyekja e grupimit është me paraqitë një histori të Lëvizjes, në të cilën shihet se çfarë niveli kanë pasur e kanë pjesëmarrësit. Përpyekja e grupimit është me e paraqitë Lëvizjen si një Lëvizje Tropojane. Prandaj unë nuk dua të kem të bëj me këtë grupim, as nuk më ka interesue, as nuk më intereson. Lëvizja është idealet e saj dhe kontributet. Ato janë dhënë për t'i shërbyer kombit e jo dikujt që nuk ka as komb e as nder.

Në vend të përfundimit

Njerëzit vdesin, por nëse janë të dobishme, idealet duhet të barten e të vazhdohen nga brezat e tjerë. Ata që mendojnë se kanë bërë diçka dhe kanë pritur të marrin një kockë që nuk e kanë marrë asnjëherë, nuk mund të kenë bërë diçka me ndërgjegje. Sepse veprimi politik që është një kontribut i pastër në shërbim të shtetit e të kombit, të fisnikëron, të mençuron, të bën më të përgjegjshëm e të paprekshëm nga kockat e pushtetit. Për fat të keq, numërohen me gishtat e dorës ata që dolën nga Lëvizja Studentore të fisnikëruar, sepse i shërbyen shtetit e kombit, ata që dolën me të mençur, sepse iu dhanë dritë brezave të ardhshëm dhe ata që u treguan të

përgjegjshëm e të paprekshëm. Koha ka treguar se kush e ka pasur me sinqeritet e seriozisht, se kush e ka ditur se çka po bën, e pse po e bën atë veprim politik. Po koha ka treguar gjithashtu se rrjedha e historisë mund të ndërrohet, e duhet të ndërrohet nga lëvizje të tilla të fuqishme, që lënë gjurmë në histori e që shërbejnë si model për brezat e tjerë.

Prandaj edhe detyrimi qytetar që kanë para shoqërisë pjesëmarrësit në këtë Lëvizje, ndër ta edhe unë si individ, janë detyrime që nuk mund të kalohen lehtë. Sepse kush i ndërrohet rrjedhën historisë së një vendi, duhet me kenë gjithnjë një hap para valës së parë dhe nuk mundet e nuk duhet me e lanë valën ta marrë me vete. Sepse valës së rrëmbyeshme e shkatërruese, duhet me i ndërrue drejtim e me i vu një digë me gjoksin tand. E rrjedhën e dobishme e të qetë duhet me e drejtue në fushë për me dhanë jetë e begati. Kjo është edhe detyra aktuale e pjesëmarrësve në Lëvizjen Studentore të viteve 1990 - 1991. Gjithkush duhet me tregue se kush është. Edhe ata që u përdorën pa mëshirë nga paria e Tiranës, duhet të kthehen te vlerat e Lëvizjes dhe të kërkojnë një fillim të ri për veten e për të gjithë shqiptarët e tjerë.

PSE MERREM ME POLITIKË? SHTET - KOMBI, BESIMI DHE QËLLIMI IM

- Në vend të një replike -

Dje dikush kishte postuar një koment shumë të gjatë dhe kërkonte përgjigje prej meje me shumë nerv. Vërejta që në komentin e tij kishte shumë dyshime dhe shumë paqartësi në lidhje me mua e me qëndrimin tim politik. Nga një anë më bëri me qeshë.

E para, si shtetas shqiptar unë jam një askushi në politikën e përditshme shqiptare. Më e shumta, jam një njeri si gjithkush tjetër.

E dyta, në nivelin ideologjik në Tiranë, unë jam si delja e zezë, sepse them ato të vërteta që nuk iu pelqejnë shumë vetëve. Unë nuk jam politikan, nuk due me kenë në politikë, nuk due me kenë në “tavë”, nuk më intereson fare politika, përveçse si objekt studimi.

E treta, si shqiptar në mërgim, politika më intereson vetëm si kombëtarist e si patriot që kërkon nderim e respekt duke u krenuar me kombin e vendin e vet, diçka që e kërkojmë e nuk e gjejmë tash një jetë. Arsyeja pra, është se unë jam emigrant, njeri që nuk ka më rrënjë në jetën e përditshme shqiptare, përveç dashurisë për të afërmit e për kombin. Unë jam nga ata që nuk ka me u tretë kurrë në paqe, sepse patetikusht me e thanë, jam i dënuem me u shue në toka të hueja, pa mbriritë me jetue atë shoqëri që do të kisha dëshirue. Por dhembjen e

ndarjes prej vendit tim e ndiej në fund të shpirtit sa zgjohem e nuk më ndahet asnjëherë.

E pra, problem është se unë nuk due me u marrë me politikë, por siç ka thanë një njeri i mençur, po nuk u more ti me politikë, atëherë do të merret politika me ty. Politika të ndjek edhe në mërgim, edhe larg, edhe kur e urren e nuk don me u përzie në të. Sepse ajo që po ndodh në shtetin shqiptar, ndikon shumë në mendësinë e gjendjen time shpirtërore. Ajo që ndodh përditë me kombin tim, më shkakton shumë dhembje. Pikërisht kjo dhembje nuk të lë të qetë, sepse i njeh njerëzit, e njeh gjendjen dhe e di se cila është rruga e greminës ku po shtyhen shqiptarët. Unë nuk mundem me mbyllë një kapitull të jetës time e me thanë se atje ku nuk të duen mos rri e atje ku nuk të dëgjojnë mos fol. Kështu kanë bërë shumë miq të mi dhe janë në paqe si njerëz, por mue më duken krejt bosh. Duke dashtë me u ba si dikush tjetër, janë ba një askush në shoqërinë ku jetojnë, njerëz pa identitet e pa vlera.

Po unë kështu jam pre, kështu do ta mbyll jetën time. Shqiptar kam lindë e shqiptar kam me vdekë dhe nëse nuk mundem e nuk due me ndryshue, të paktën t'i shërbej me aq sa mundem identitetit e kombit tem. Dikush duhet me thanë se jeni e se po shkon në Rrethin e Ferrit dhe unë e miqtë e mi, po e themi përditë këtë. Edhe ba mos me na dëgjue kush, ne po e themi të vërtetën njeherë, e për fat të keq, koha ka me na dhanë të drejtë.

Një arsye më tepër pse po hezitoj me iu përgjigjë, është se nuk e njoh fare as njeriun, as të shkuarën e tij, as përgatitjen politike e as përkatësinë. Por argumentet e tij janë njerëzore dhe meritojnë respekt, ashtu si edhe kjo dhembja ime që s'më len të qetë. Si parim, nëse duhet të sillemi si shqiptarë e si njerëz, nëse duam të ecim në rrugë të mbarë, duhet të respektojmë njëri - tjetrin, duke ia respektue mendimin. Ky zotnia ngren disa çështje delikate si rëndësia politike e të shkuarës në politikë, hedh dyshime mbi qëllimet e mia si individ, mbi besimin tim dhe mbi platformën që na duhet për të ardh-

men. Duke mos qenë politikan, mendova mos me u përgjigjë. Por duke e besue të sinqertë e jo njërin nga ata zhurmuesit e shumtë të parisë, po i përgjigjem shkurt, me sa di, e me sa mundem në lidhje me pikëpyetjet dhe argumentet që ngre në komentin e tij.

Rëndësia e të shkuarës në politikën shqiptare

Së pari, në lidhje me të shkuarën. E shkuara nuk duhet me na mbajtë peng dhe e shkuara jonë nuk është e tillë që na sjell gëzim, asnjërit e askujt ndër shqiptarët. Askujt nuk i sjell gëzim e shkuara, sepse ajo që ka kenë nuk mundet me kenë më përcaktuese e të ardhmes. Ajo bahet përcaktuese vetëm nëse ne e lejojmë të na sundojë. E vetmja e shkuar që nuk ke çka i ban, se nuk tjetërsohet dot, është identiteti që ke. Atë nuk e ndryshon dot.

Por ajo që ne si popull e kemi përjetue, ka kenë e hidhun dhe e deformueme gjatë gjithë këtyre dy shekujve të trazuem. Populli ynë është i vogël, por është një popull që ka shumë histori, sepse ka kalue në shumë travaja e mundime gjatë shekujve të kaluar dhe ma shpesh se duhet, të keqen ia kemi ba vetes e njëri - tjetrit. Prandaj gjithkush që ka mend, ose kërkon me e shmangë të shkuarën, ose me mësue prej saj. Po përsëritëm të njëjtat gabime, do të gjendemi gjithnjë në të njëjtin qorrsokak. Do të sillemi rrotull. Asgja nuk ka me ndryshue, vetëm dhembja ka me u shtue. A duhet me ua lanë këtë barrë brezave që po vijnë?

Prandaj ndarja me të shkuarën, është fillimi i ri. Vazhdimi i mendësisë sunduese të së shkuarës, nevoja me gjetë shkaktarë për fatkeqësitë e kaluara është e dobishme, sa kohë njeriu si individ e një komb si shoqëri, mëson nga pësimet dhe iu ruhet kurtheve. Ama, nëse ndjekja e qëllimeve të tilla bëhet qëllim në vetvete, atëherë ai komb është i destinuar të dështojë. Kjo është rruga e të mirës dhe e të drejtës. E shkuara duhet të jetë burim mësimi për të ardhmen. Njeriu dështon edhe më keq. Ai

individ që e mbërrin qëllimin që i ka vënë vetes përmes urrejtjes, pasi e mbërrin atë qëllim, është bosh. Vetëm e mira të jep arsyes me pasë shpresë e me ndërtue të ardhmen.

Nga ana tjetër, politikanët kanë rrugën e qëllimet e tyre. Kur janë njerëz me mend e me ndjenja kombëtare ata i ikin ndasive që sjell e shkuara. Është e paevitueshme, gjithkush që kërkon shkaqe për sherr e ndasi do t'i gjejë në të shkuarën e vet. Prandaj edhe është ligji dhe shteti që në mënyrë arbitrare të vendosë se çka është e drejtë, e ligjshme dhe e pranueshme në një kohë të caktuar. Por në mendjen e njerëzve, e drejta e tjetrit është padrejtësi që të bahet. Prandaj dashuria për tjetrin, elementët e domosdoshëm të qytetërimit, e zbusin këtë ndjesi dhe rrisin mirëkuptimin për të drejtën e tjetrit.

Politikanët e parisë së Tiranës kanë dashur e duan që e shkuara e dhembshme me iu shërbye vetëm atyre, pa mbajtur parasysh dhembjen që iu shkaktonte njerëzve ngacmimi i plagëve shpirtnore. Sepse gjithkush e kemi një histori të dhembshme. Ata e dinë këtë prandaj i mobilizojnë njerëzit në emër të së shkuarës. Prandaj edhe po veprojnë ashtu edhe në këtë fushatë, duke iu fryrë ndasive ideologjike, fetare, krahnore, kulturore e gjendjes ekonomike. Ja, edhe në këtë fushatë merren me gjyshër, simbole, monumente, etj. Asgja që iu flet njerëzve dhe halleve të tyre. Asgja që ka të bëjë me të ardhmen e tyre. Asgja me iu dhanë shpresë. Asgja që i bashkon dhe i bën të mendojnë si pjesëtarë të një bashkësie politike - ligjore, apo si shqiptarë, pjesëtarë të një kombi. Politikanët përdorin çdo gja për t'i ndarë njerëzit. Ata përdorin pa fund rrena, mashtrime e manipulime.

Unë kërkoj me mësue prej të shkuarës, mos me përsëritë gabimet dhe me ndihmue me ndërtue një të ardhme tjetër për këtë zotninë e për të gjithë të tjerët. Sepse unë nuk kam ndërmend me jetue prej politikës. Nuk kam ndërmend me u marrë me politikë. Nuk kam ndërmend me dalë e me ia kërkuë kujt votën e besimin. Unë jam njeri i lirë, them atë që mendoj, e kam edukue veten me iu shërbye njerëzve, mendoj më të

mirën që mundem për kombin tim dhe nuk due askurrgjë prej askërkujt.

Qëllimi im si individ

Së dyti, ky zotnia ngren dyshime te qëllimi im. Si edhe sapo e thashë, unë nuk kam ndërmend me u marrë me politikë në shtetin shqiptar. Nuk më intereson politika. Nuk jam i prerë për atë punë e për atë profesion. Politika nuk më ka dhënë asnjë kënaqësi në këtë jetë, përveç dhembjeve të pashlyeshme e fatkeqësive që ua kam shkaktue njerëzve të mi e që shpesh nuk kam guxim as me ia thanë vetvetes, sepse menjëherë më kujtohet fytyra e nanës teme të ndjerë.

Për ma tepër jam në një moshë kur dua të mbyll jetën me nder, nëse kam mundësi e nëse ia arrij me ruejtë veten e vlerat e mia në mërgim. Ne mos tjetër, çdo ditë që jetoj, e shoh si një mundësi me u përmirësue, sepse sa ma shumë kërkon me kenë i pastër, aq ma shumë të bahen të dukshme gabimet e të metat që ke. Unë ndoshta nuk mund të mbërrij të ndërroj gja në këtë jetën time, por përditë mund të bëhem njeri më i mirë, më i ndershëm, më i pastër, më me respekt për të tjerët, një prind i mirë, një i afërm i mirë, një shqiptar i mirë. Nëse sillem kështu, mua më mjafton ndjenja e të kenunit shqiptar, nuk më duhet as feja, as ideologjia e tjerakujt. Më mjafton respekti i njerëzve sepse, në fund të fundit për këtë jetohe.

Megjithatë, pa mendjemadhësi, por me shumë modesti, më duhet me thanë se unë ndiej një obligim moral ndaj popullit tim. Si njëri ndër ata që na u dha mundësia me kenë instrumenta në momente historike, edhe unë duhet me e gjykue veten përditë për sjelljet e veprimet e mia në jetën publike. E në këto kushte, shërbimi më i madh që mund të bëjë një njeri si unë, është me thanë të vërtetën. E vërteta është ajo që na duhet më së shumti. Dhe në mos mundsha me ba tjetër, do të them të vërtetën ashtu si e di dhe e kuptoj unë. Ndoshta nuk jam i zoti me e vra gjarpnin, por të paktën mundem me të

tregue që ai po fshihet pas ferrës. Ky është edhe funksioni i së vërtetës.

Pse duhet me veprue kështu? Thënia e të vërtetës është një gjë jo e lehtë, sepse iu bie ndesh njerëzve e interesave të shumta. Nganjëherë është më lehtë me jetue në mashtrim, se me kenë njeri i lirë. Edhe unë pres që fjala ime të ketë një efekt për mirë dhe ajo e ka një qëllim të qartë. Qëllimi im është me mbështetë daljen e një grupi të ri të rinjsh që të jenë të motivuar nga ndjenja e shërbimit kombëtar e të punojnë për shtet - kombin e shqiptarëve. Qëllimi im është që gjithçka kam, dijen, kohën, mundësitë, t'i vë në shërbim të këtij grupi e së bashku me të tjerë, të ndihmojmë me e ça rrugën në politikë, t'iu japim mbështetje e besueshmëri. T'i ndihmojmë që të rriten, t'i shmangen të keqes, të bëjnë më të mirën që munden për popullin e tyre. Sepse një popull vdes, kur rinia nuk mundet me u mbështetë te brezi para saj. Sepse një grup i tillë do të jetë shpresa për të gjithë shqiptarët.

Besimi im

Ky qëllim imi do të ishte diçka donkishoteske, një marrëzi, një budallallëk i pashembullt, nëse unë nuk do të kisha një besim të patundur te populli shqiptar dhe te mundësitë e tij me u ba një popull normal, i begatë, i sukseshëm, që jeton në harmoni shoqërore e në siguri si gjithë popujt e tjerë. Janë disa arsye që më shtyjnë me besue fuqimisht se ka shpresë për shqiptarët.

Së pari, ne kemi shtetin tonë.

Së dyti, ne kemi kombin tonë.

Së treti, ne kemi gjuhën, vlerat dhe traditat tona familjare, të katundit e të kombit tonë, të veçanta, pozitive, të papërsëritshme dhe tejet të dobishme për modernitetin.

Së katërti, ne kemi fuqinë t'i ikim së keqes ngado që të vijë.

Së pesti, tashmë ne kemi dijen e funksionimit të shoqërive moderne.

Së gjashti, ne kemi një brez të ri që po kërkon me forcë të gjejë vetveten në shtet - kombin modern.

Së shtati, megjithë rezistencat e forta, krijimi, konsolidimi dhe lulëzimi i shtet - kombit të shqiptarëve, edhe sikur ai shtet të jetë i rrudhun sa më s'bahet, është një fakt i pashmangshëm i politikës ndërkombëtare.

Ky është besimi im si njeri e si shqiptar. Gjatë jetës time jo aq të gjatë, nuk kam parë e gjetur asnjë arsye me më ba me ndrrue mendjen. Prandaj do të vazhdoj të punoj për këtë qëllim e me këtë besim sa të kem frymë.

Çka duhet bërë?

Këtë përgjigje e kam thënë disa herë dhe po e përsëris. Ka ardhur koha për një fillim të ri. Nevoja për ndryshim është e pashmangshme dhe forcat e reja politike që do lindin, duhet të kuptojnë mirë se cilat janë rrugët e ndryshimit të vërtetë. Ndryshimi duhet mbështetur në vlerat e vërteta të një populli si shqiptarët dhe në një projekt të ri modernizues, të balancuar dhe të mbështetur në themelet e forta. Këtë mund ta bëjmë vetëm duke ndërtuar një shoqëri që do të mbështetet në parimet e mëposhtme.

Së pari, në identitetin e padiskutueshëm të shtetit - komb.

Së dyti, në një sistem politik demokratik, me një sistem zgjedhor proporcional, por me shtërngesa të forta ligjore që nuk lejojnë tepritë në sjelljen e politikanëve dhe nuk pengojnë qeverisjen e mirë.

Së treti, në një administratë shtetërore të pakorruptueshme e të mbështetur në ligj me shtërngesa shembullore e drastike.

Së katërti, në një ekonomi tregu të institucionalizuar, ku i jepet përparësi prodhimit kombëtar dhe ku sukseset dhe arritjet e njerëzve më të zotë, ndihmojnë në rritjen e zhvillimin e njerëzve të mirë.

Së pesti, në një politikë të jashtme të bazuar në interesin shtetëror - kombëtar.

Së gjashti, në luftën e pakompromis kundër krimit e kundër të keqes në çdo formë që të materializohet e keqja shoqërore brenda llojit.

Së shtati, në krijimin e në kultivimin e vlerave të vërteta të një shoqërie që krijon mundësi për të gjithë shqiptarët e qytetarët me aq sa i kemi mundësitë e kushtet.

Së teti, në kultivimin e vlerave të një shoqërie civile efektive që është baza dhe shtërngesa kryesore mbi të keqen, shoqërinë dhe strukturat institucionale.

Së nënti, në ndërtimin dhe konsolidimin e strukturave të shërbimeve shoqërore si edukimi, shëndetësia, mbrojtja e fëmijëve dhe pensionistëve.

Së dhjeti, ndërtimi i një sistemi përfaqësues politik që të funksionojë për zgjedhjen e udhëheqësive që do të mbahen në kontroll të fortë nga shoqëria e nga strukturat administrative institucionale.

Çdo përpjekje për ndryshim, qoftë në formën e një programi politik, qoftë në formën e një pakete ndryshimesh ligjore, që nuk mban parasysh këto parime themelore, është e destinuar të dështojë. Këto elemente janë pjesë e pandashme e çdo projekti për shërimin e përmirësimin e gjendjes. Këto janë edhe parimet që duhet të frymëzojnë një forcë politike të re. Kjo duhet të jetë një parti që punon për ndryshimin e sistemit dhe për zbatimin e një projekti i cili mban parasysh dhe punon për një rindërtim të menduar mirë të strukturave e të institucioneve shtetërore, për një afirmim të vlerave e të identitetit, për një përparësi të interesit shtetëror e kombëtar dhe të vënies së interesave të bashkësisë mbi interesat personale të parisë. Kjo rrugë është rruga e ndërtimit të shtetit kombëtar, e stabilizimit të sistemit demokratik dhe e strukturave partiake. Kjo është rruga e vendosjes së një ekonomie tregu të institucionalizuar, e një administrate që zbaton ligjin dhe e kultivimit të një shoqërie civile shekulare që kontribuon aktivisht në jetën publike. Kjo është rruga e zhvillimit dhe e lulëzimit të vlerave morale që duhen për

të kultivuar një shoqëri të shëndoshë, të begatë dhe bashkëkohore. Më në fund, por më e rëndësishmja, baza e suksesit për një tranzicion është njësimi kombëtar, formësimi i ndërgjegjes kombëtare, domethënë një identitet i përbashkët i shtetasve. Në rastin shqiptar, për shkak të natyrës specifike të problemit, tranzicioni nuk mund të shihet i shkëputur nga çështja kombëtare shqiptare. Zgjidhja e çështjes kombëtare shqiptare është parakushti për suksesin e çdo reforme dhe zbatimin e çdo projekti që do t'i vendosë proceset në hullitë e duhura.

Një parti që i përmbush këto kushte dhe që ofron këtë program, do të ishte një parti shpresëdhënëse dhe që meriton mbështetjen e të gjithë shqiptarëve, natyrisht edhe timen. Por ata që marrin përsipër këtë detyrë, duhet të jenë të përgatitur të përplasen me një pari që do të përdorë çdo mjet në dispozicionin e saj, edhe në format ekstreme të dhunës e të terrorizmit shtetëror e mafioz, për të ruajtur pushtetin politik dhe kontrollin mbi ekonominë e mendësinë e popullit që sot e sundon.

A është e mundur të realizohet ky projekt?

Edhe pse duket se ka dalë e keqja mbi ujë, realiteti është shumë kompleks dhe shoqëria shqiptare nuk është as uniforme, as e pajtuar me gjendjen. Mitingjet tregojnë një pamje të retushuar të sistemit. Kjo është pjesa e terrorizuar dhe pjesa që i është shplarë truri, pjesa që dridhet për bukën e gojës e për ndëshkimin që vjen nga paria. Përtej kesaj hipokrizie të pashoqe mitingashe që lundron si plehnat në det mbi shoqërinë shqiptare, duke shkuar nga njëri shesh te tjetri, gjendja është e ndryshme. Njerëzit e mirë janë aty.

Po cilat janë grupimet e shtresat shoqërore që janë të interesuara për këtë ndryshim? Duke folur kështu përgjithësisht, në shoqërinë shqiptare ka tre grupime të mëdha që tashmë janë konsoliduar e kristalizuar bukur qartë. Të tre

këto grupe jetojnë jetë paralele dhe shpesh janë të izoluar nga njëri - tjetri. Këto shtresa janë paria e Tiranës, shtresa e mesme e profesionale dhe vegjelia urbane dhe katundare.

Mbështetja për sistemin është në nivele të ndryshme. Paria, një pjesë shumë e vogël e shoqërisë, që bëhen a s'bëhen tre mijë vetë, e sheh këtë gjendje si të natyrshme dhe si botën më të mirë të mundshme. Ka mjaft nga pjesëtarët e parisë që sinqerisht besojnë se kjo shoqëri është shoqëria ideale, pikërisht ajo shoqëri që shpresohet se do të ndërtohet në vitin 1990 e pas. Këta janë paria, pinjollët e tyre dhe shtresa e zyrtarëve të lartë, e spekulatorëve monopolistë dhe e klientëve të spikatur të familjeve mafioze të parisë që u pasuruan shumë shpejt e me lehtësi duke bërë të 99 - tat. Këta të flasin me sinqeritet mbi virtytet e kohës dhe mbi vlerat që ka kjo shoqëri. Por këta flasin nga maja e mullarit të tyre. Sepse gjithçka që kanë, e kanë marrë me një krim të pashembullt, me një mungesë skrupujsh që të frikëson dhe me një urrejtje të thellë për popullin e vet. Vetëm një ligj i forte, e sjell në fije këtë pari. Por në këtë pikë ligjin e bëjnë vetë. Prandaj duhet ndryshimi.

Nën shtresën e ngushtë të parisë që kontrollon ekonominë, politikën, shtetin, kulturën, mjetet e komunikimit e vlerat, janë dy shtresat numerikisht masive, të ndara në grupe me bindje të papajtueshme dhe të paqartësuar si duhet. Me këta duhet punuar. Një numër i madh shqiptarësh e kanë pranuar gjendjen si normale dhe si të pashmangshme. Në këtë grup çdo njeri e jeton jetën sipas rregullave të xhunglës së parisë, sepse nuk din tjetër dhe se ka rënë në grackën e parisë. Këtu hyjnë mjaft nga katundarët, të shpërngulurit, shtresat e vegjëlisë urbane si dhe ata që i janë bashkëngjitur sistemit për arsye pasurimi e arrivizmi si profesorët, mjekët, profesionistët, etj. Pra, këtu hyjnë edhe pjesëtarët e shtresës së mesme, kryesisht të inteligjencës dhe me influencë direkte mbi popullin, pikërisht grupi nga ku duhet të fillojë ndryshimi i mendësisë sunduese. Këtu hyjnë edhe të mërguarit që mbetën në fund të shoqërive ku kishin emigruar, sepse këtë nivel ndyrësie e poshtërimi

përjetuan për vite të tëra dhe tani këtë e shohin si normalitet e si gjendje të pashmangshme. Këtu hyjnë edhe një masë e madhe e të rinjve që nuk kanë njohur shoqëri të tjera dhe që ndjekin modelet e parisë, kanë rënë pre e propagandës së saj dhe e jetojnë jetën në këtë realitet absurd. Ky është grupimi më tragjik, sepse këta e dinë se ky është një realitet kriminal dhe absurd, por janë shumë të frikësuar e të terrorizuar që të veprojnë. Këta bëhen veglat e parisë për një kafshatë bukë, edhe pse ajo bukë është e ngjyer në krimin e jetës së përditshme. Me këta duhet punuar fort e me kujdes, sepse duke u mbajtur pas pronës së vogël, këta do të jenë të paralizuar. Po ajo pronë e mjerë pas të cilës mbahen, është një fije kashte që i mban peng të parisë më fort se zinxhiri i prangave.

Po ashtu ka një pjesë shumë më të madhe që e sheh këtë shoqëri dhe rregullat e saj të sjelljes si të papranueshme dhe si jo normale. Këta janë shumica e katundarëve shqiptarë, të urbanizuar ose jo, shumica e profesionistëve, e qytetarëve dhe e të rinjve të edukuar, apo të vetëedukuar dhe masa e madhe cilësore e emigrantëve shqiptarë. Në shoqërinë shqiptare kjo shtresë po rritet me shpejtësi numerikisht dhe cilësisht. Kjo shtresë e kupton jo vetëm se ky realitet është absurd, por edhe se ky realitet është kriminal, i qëllimtë dhe i stisur në atë mënyrë nga paria e Tiranës që të mos lejojë të rebelohet kush. Ka shumë në mërgim që flasin. Ka shumë nga këta që jetojnë në shtetin shqiptar e nuk flasin. Por këta që nuk e hapin gojën, sepse kanë frikë, duhet që shpejt të bëjnë zgjidhjen se me kë do të jenë. Niveli i terrorizimit të shoqërisë shqiptare ka arrihur në nivele të tilla, sa që njerëzit nuk guxojnë as të mendojnë, jo më të flasin. Frika është me e prekshme në këtë këtë grup, se në cilindo grup tjetër.

Për këdo që hyn në politikë, ky është grupi i shtresës dhe i individëve me influencë lokale që mund e që duhet të bëjë ndryshimin. Këta janë ata që sot gjenden ndërmjet parisë sunduese dhe popullit. Këta e përçojnë ideologjinë, sjelljet, normat dhe vlerat e parisë në popull. Këta e ndiejnë dhembjen e

shtypjen njëlloj si populli. E në të njëjtën kohë, këta janë grupi më i madh dhe më i ndjeshëm që mund të bëjë ndryshimin.

Çfarë mungon? Mungon ndërgjegjësimi i tyre si shtresë. Mungon ndërgjegjësimi lidhur me rrugën që duhet të ndiqet. Mungon organizmi dhe udhëheqja e duhur. Edhe këta kanë rënë pre e propagandës së parisë që gjithçka e lidh me njerëzit, me individët e jo me ideologjinë. Por njerëzit janë gjithmonë të gabueshëm e me të meta. E megjithatë nga këto shtresa të gjëra do të vijë ndryshimi që na duhet.

Katër janë problemet kryesore.

Së pari është qartësimi ideologjik, domethënë shpjegimi me qetësi e me kujdes i të këqijave që na ka sjellë kjo gjendje dhe të mirat që do të vijnë nga një shtet - komb modern i ndërtuar mbi parimet e shprehura më lart.

Së dyti, është ndërtimi i një udhëheqësie të përbërë nga të rinj të panjollusur që duan të jetojnë me nder, që duan të bëjnë mirë e që ndjehen shqiptarë. Kushdo që din, duhet të vihet pas djemve e vajzave të tilla dhe t'i mbështesë e t'i mbrojë, sepse këta do të jenë e ardhmja e do të bëjnë ndryshimin.

Së treti, është ndërtimi i strukturave nga qendra, deri në familje. Me kujdes e me shumë vëmendje, duhet ndërtuar një strukturë shoqërore e re. Ashtu si një pemë e kalbur nxjerr filiza të rinj dhe e rilind veten, edhe ne si komb duhet të mbështetemi te të rinjtë e të rejtat për të gjetur e për të rilindur vetveten.

Së katërti, problemi kryesor është se si me ia nxjerrë frikën këtyre njerëzve, që pavarësisht se ku jetojnë, në fshat apo në qytet, kanë edukimin, ndjeshmërinë dhe receptivitetin për të kërkuar ndryshimin.

Kush janë njerëzit që mund e që duhet të bëjnë diçka të dobishme për të ardhmen e për veten e tyre? Këta janë zyrtarët e ish-zyrtarët e niveleve të ulta në atë e në këtë sistem, njerëzit që vijnë nga familje me tradita e me vlera, tregtarët e reshperët që duan të jetojnë me nder, mësuesit dhe mjekët e ndershëm, oficerët dhe policët e edukuar, njerëzit që e kanë

ngritur jetën mbi bindje morale të qëndrueshme, atdhetarët dhe patriotët, pasardhësit e familjeve patriote dhe të gjithë ata që duan të ketë një shtet - komb të shqiptarëve.

Cilat janë rrugët?

Zotëria kërkon me ditë cilat janë rrugët e daljes nga kjo gjendje. Hapi i parë është që të ndahesh moralisht e me ndërgjegje nga paria, nga struktura e sistemi që ajo ka krijuar e që e mban gjithë shoqërinë peng të mendësisë së Ferrit. Hapi i dytë është që të qartësosh mendjen, e të kuptosh se cila është rruga e zgjidhjes, që natyrshëm kalon nga parimet e numëruara më lart. Hapi i tretë është organizimi dhe kundërvënja ndaj parisë me të gjithë mjetet e mundshme në demokraci. Kështu do të ndërrojnë gjërat. Por hapi i parë është të bësh bojkot, të ndahesh me sistemin. Hidh "votën e bardhë". Futi një vizë. Futi një - XXXX - të gjithëve. Kur të dalësh nga qendra e votimit do të ndjehesh njeri. Do të ndjehesh i lirë dhe me dinjitet. Dhe me lirinë tande fillon edhe liria dhe e ardhmja e të gjithëve ne.

Në vend të përmbylljes

Në përfundim do t'i thoja këtij zotnisë se për me arritë diçka, duhet me besue në diçka. Qëllimet duhet të jenë të mbështetura në bindje më të forta se shkëmbi. Rruga kalon nga ndarja me sistemin. Kështu si është ndërtuar, ky sistem i shërben parisë së Tiranës e vetëm parisë së Tiranës. Kush është në një ishull në mes të tallazeve, duhet me mbijetue vetëm duke besue se është në një shkëmb. Unë besoj se populli shqiptar është një popull me vlera të jashtëzakonshme. Unë besoj se shqiptarët janë një popull me shpirt të lirë, krenarë, me respekt për ata që iu japin nder e dinjitet. Unë besoj se shqiptarët janë një popull që e meriton të ketë qeveri të pakkorruptueshme, politikanë të ndershëm dhe një shtet - komb që të jetë i dobishëm për të gjithë e të garantojë begatinë, si-

gurinë, mbrojtjen shoqërore e vlerat normale njerëzore. Prandaj e shkuara më ndihmon mos me ba gabimet e të shkuarës, jo me luftue betejat e të ardhmes, për me zgjidhë gabimet e të shkuarës. Qëllimi është gjithnjë të mos përsëritet e keqja. E që të mos përsëritet e keqja, duhet të mendojmë me dashuri për tjetrin e për veten, të kemi besim te vetja e te shqiptari tjetër dhe të mendojmë e të sillemi si duhet, si shtetas e qytetarë të një shtet - kombi modern. Njeriu mund të zhgënjehet në gjithçka, por nuk mund të zhgënjehet te nëna e vet. E pra, Nëna të vdes e të len jetim, Atdheu nuk të vdes edhe kur ta marrin, ta pushtojnë, ta dhunojnë e ta grabisin, siç po ndodh me parinë e Tiranës. Kur vdes Atdheu, atëherë njeriu vdes përditë e përditë nga pak e me shumë dhembje.

Sepse Atdheu jemi të gjithë bashkë e gjithësecili në vetminë e vet.

PROBLEMI I LEGJITIMIT TË SISTEMIT DHE BOJKOTI SI ARMË E DOMOSDOSHME POLITIKE

- Makthi i parisë së Tiranës e ka emrin bojkot -

Marrë nga libri "Përrallat e tranzicionit shqiptar"

2012, botuar së pari në maj 2009 -

Zgjedhjet kuvendore janë një moment shumë i rëndësishëm politik për parinë e Tiranës. Për një ditë, fati i sundimit të tyre është në duart e popullit. Është në dorën e popullit të tregojë nëse pajtohet apo nëse nuk pajtohet me sundimin e parisë, me rrugën që po ndiqet prej saj, si dhe me parinë vetë. Në këtë moment politik, qytetarët përzgjedhin me vullnetin tyre, ata që do të drejtojnë shtetin deri në zgjedhjet e ardhshme. Sundimi i ligjit, depersonalizimi i pushtetit, efektiviteti i strukturave partiake, një shoqëri e gjallë qytetare, janë elementë të rëndësishëm të demokracisë. Por një vend është demokratik, vetëm e vetëm kur mbahen zgjedhje të ndershme, të lira, të fshehta e të drejtpërdrejta, duke ndjekur procedurat e një sistemi demokratik. Atëherë sistemi është legjitim dhe paria ka mandatin e duhur për të drejtuar shtetin.

Por në një sistem demokratik nuk mjafton që paria politike e merr mandatin e drejtimit të shtetit në bazë procedurash. Në një sistem demokratik duhet që populli ta aprovojë sistemin politik. Këtë transferim autoriteti populli duhet ta bëjë me vullnetin e tij të lirë. Në një farë mënyre, zgjedhjet e përgjithshme janë thuajse referendare. Shkaku është se një pari e re mund të marrë shumicën dhe mund të zgjidhet me vota të lira.

Kësisoj, në parim, edhe me një zgjedhje e ndryshon edhe ligjin themeltar të shtetit, pra vetë formulën politike. Natyrisht sistemi nuk është më demokratik, por kjo është një mundësi. Veçimi i parimit bazë të sistemit, formulës politike, nga ajo çka qytetarët mendojnë për atë parim themelor dhe për parinë, është artificial dhe në praktikë i pamundshëm.

Pra, thelbi i legjitimitetit është aprovimi moral i qytetarëve për rendin shoqëror ku jetojnë si më i përshtatshmi, më i drejti dhe më i miri sistem i mundshëm. Po rendi shoqëror në një sistem shoqëror ku ka zhvatje kaq flagrante dhe ku pushteti ekonomik, politik dhe i influencës është katërcipërisht në duart e parisë si në shtetin shqiptar, me këtë nivel kriminalizimi, mungese vlerash morale e korrupsioni të gjithkundgjindshëm, nuk mund të shihet si rendi i duhur shoqëror. Prandaj edhe paria u kushton rëndësi zgjedhjeve kuvendore, thjesht sepse u druhet fort. Edhe në këto zgjedhje, objektivi kryesor i parisë sunduese është i njëjti. Ajo synon të bindë të huajt, veten dhe popullin se ata dhe vetëm ata, duhet ta sundojnë shtetin shqiptar. Pa e krijuar këtë bindje në të tre grupimet e lartpërmendura (dhe më parë te pjesëtarët e vet, natyrisht) paria nuk mund të sundojë kurrë e qetë dhe e sigurtë në zotërimin e saj, në shtetin shqiptar. Nuk ka gjalle se rezultati që del prej këtyre zgjedhjeve është i manipuluar, i ndryshuar apo se vetë zgjedhjet janë një farsë politike, sa kohë ruhet fasada e legjitimitetit, domethënë që shumica e votojnë parinë. Për parinë zgjedhjet janë prova më e qartë që ajo mund të ofrojë si dëshmi të mbështetjes që kinse vetë, por edhe sistemi që ka krijuar dhe është totalisht në shërbim të saj, ka nga qytetarët e nga shqiptarët në veçanti. Kjo ditë është njëlloj si një ditë referendumi, kur paria e merr legjitimitetin që i duhet për të sunduar edhe për katër vitet e ardhshme.

Si e siguron legjitimitetin paria e Tiranës?

Duke e ditur mirë rëndësinë e legjitimitetit të sistemit të

saj, paria ka përdorur sistematikisht e me shumë kujdes të gjithë arsenalin e armëve që ka. Natyrisht, instrumenti kryesor e parësor i saj është vendosja e ruajtja e kontrollit të hekurit mbi shtetin, institucionet qeverisëse dhe mbi strukturat e pushtetit lokal. Përdorimi i burimeve të shumta materiale dhe njerëzore të shtetit si dhe manipulimi i ligjit nga ana e saj, kanë qenë e mbeten instrumente të preferuara të parisë së Tiranës për fitimin e legjitimitetit e vijimisht, për arritjen dhe ruajtjen e kontrollit të tyre mbi fatin e të gjithë shqiptarëve.

Po ashtu, përpjekja e parisë për të fituar legjitimitet dallohet qartë veçanërisht në nivelin e shfrenuar të propagandës, manipulimit të shtypit e të informacionit. Paria ia njeh vlerën ideologjisë. Edhe përkundër përpjekjes që bën sistematikisht për ta shmangur debatin ideologjik në përplasjet midis segmenteve të saj, argumentet që përdor për të bindur votuesit, në veçanti militantët respektivë, janë qartësisht ideologjike.

Për shembull, parisë i intereson që shqiptarët të binden se nuk ka zgjidhje të tjera. Për të justifikuar këtë, përdor si mungesën e alternativave, dështimet e palës tjetër, dështimet e shteteve të ngjashme, dështimet e alternativave ideologjike e me radhë. Këtu duhet të përmenden para së gjithash, argumentet e tyre ideologjike që e paraqesin të gjithë botën e qytetëruar si një botë kriminale, ku paraja blen e shet gjithkënd. Ky është argumenti që shitet lehtë në shtetin shqiptar. Shumica e atyre që kanë qenë jashtë, të punësuar, ose kanë jetuar në perëndim, kanë qenë në fund, ose afër fundit të strukturës shoqërore, pikërisht në ato nivele ku sjellja kriminale apo strukturat e bashkësisë janë kushti themeltar për të siguruar ekzistencën. Nga këndvështrimi i jetës së mërgimtarit të paligjshëm apo edhe i mërgimtarit që ecën përpara në nivelin lokal, në shoqëri thellësisht të korruptuara dhe të politizuara si Greqia dhe Italia, bota nuk mund të funksionojë ndryshe.

Paria përdor çdo metodë tjetër që ndihmon në konsolidimin e hegjemonisë së saj mbi shoqërinë. Në arsenalin e teknikave të

saj dallohen manipulimi sistematik dhe organizimi korruptiv i strukturave mbarëshoqërore dhe i aktiviteteve partiake në bazë klanesh e me karakter të dallueshëm mafioz. Në fushën e propagandës, dallohet përdorimi e glorifikimi i analistëve injorantë dhe manipulimi i opinionit publik, përmes komentatorëve me përgatitje profesionale shumë të dyshimtë. Po ashtu hapja e mbyllja e debateve mediatike, pa pikë vlere e mbi tema shterpë, që shërbejnë thjesht për të deformuar mendjet e vlerat e njerëzve me një ritëm marramendës, është një pjesë e rëndësishme e këtij arsenali metodash që përdoret për të çoroditur shqiptarët. Qëllimi i pandryshuar i parisë është stabilizimi i hegjemonisë ideologjike të saj. Krijimi i përshtypjes se rruga ku po ecim, është rruga e vetme ku duhet shkuar e se nuk ka zgjidhje tjetër, është një hap i madh përpara në vendosjen e kësaj hegjemonie.

Qëllimit të vendosjes së hegjemonisë dhe legjitimiteti i sistemit, i shërben mbi të gjitha zhveshja e përditshme dhe e pandalshme e shoqërisë nga vlerat e vërteta dhe nga morali njerëzor. Në Tiranë çdo gjë e ka një çmim në vlerë monetare; edhe nderi, edhe fytyra, edhe vlerat, edhe historia. Paria jeton e vdes për pasurinë e vet. Prandaj, me këtë qëllim të qartë në mendje, ajo po lufton ta shndërrojë shoqërinë shqiptare në shembëlltyrën e saj kriminale. Vetëm ashtu i duket se garantohet pasuria dhe sundimi i saj.

Nuk ka pikë dyshimi se mjete të preferuara të parisë së Tiranës janë edhe patologjitë e njohura të sistemeve politike; korrupsioni, klientelizmi, shitja e shtetit dhe e interesave të qytetarëve të tjerë, si dhe blerja e njerëzve me çmimin që i kanë vënë vetes. Këtu hyn edhe paraliza e plotë e sistemit ligjor, sepse në fund të fundit, kë do të arrestojnë? Këtu hyn edhe mbyllja e gojës së gjithkujt tjetër që është kundërshtar. Cubat duan me dhanë e me marrë me cubat, hajnat japin e marrin me hajnat. Paria ndjek të njëjtën metodë, si cubat e hajnat. Shtetin i duhet ta përdorë vetëm si instrument shpërblimi për mbështetësit dhe si mjet ndëshkimi për kundërshtarët.

Po ashtu, kontrolli i saj duhet të jetë i hekurt dhe i padiskutueshëm edhe mbi ekonominë. Sipërmarrësve, reshperëve, tregtarëve e afaristëve, po nuk iu bindën, iu priten kontratat, iu anulohen licencat, iu hiqet buka e gojës. Kështu edhe ata sipërmarrës apo prodhues që mendojnë se kjo sjellje nuk është e moralshme, bien në gjunjë para politikës dhe nuk guxojnë as të ngrenë kokën. Ata që nuk binden hapur, ose blihen me interesa, ose nxirren nga loja, falimentojnë apo diskreditohen publikisht. Kjo vlen edhe për të gjithë kundërshtarët e tyre nga fusha të tjera të jetës.

Kur nuk ecën taktika e shkopot dhe kulaçit, përdoret përzënia e denigrimi i hapur i kundërshtarëve. Një taktikë interesante është izolimi i atyre individëve e grupimeve që mund të bëjnë diçka të mirë, por që e shohin veten si të pazotët të luftojnë kundër tyre. Tirana është kthyer në një tymnajë e kënetë thashethemesh nga më të ndyrat që mund të bëhet, ku nuk ka aspak mbrojtje të jetës private dhe ku gjithçka bëhet sheshit.

Po ashtu, veset e njerëzve janë një çengel ku ata mbahen peng e varur prej parisë. Pusi i llumit njerëzor nuk ka fund dhe gjatë këtij tranzicioni, në shoqërinë shqiptare ka shpërthyer qelbi e njerëzit janë çliruar nga zinxhiri i vlerave morale. Shpërthimi nga zinxhirët dhe nevoja e ngopjes me para, me seks, me pushtet, me hakmarrje, i kanë kthyer njerëzit në përbindsha që e maskojnë keq e aspak, anën e ndyrë njerëzore. Nga ana e vet, paria e di mirë që ajo mund t'i mbajë njerëzit peng për dobësitë e veta; çdo person, çdo familje e çdo grup e shtresë të shoqërisë, një e nga e një e të gjithë bashkë. Duke qenë një vend i vogël, askush nuk mundet të ruajë sekrete e të fshehta prej kujt tjetër. Askush nuk mund me dalë kundër sistemit që e ka nxjerrë dikund dhe kundër strukturës familjare e shoqërore që e lejon të mbijetojë. Përdorimi me efikasitet të jashtëzakonshëm i mendësisë katundare dhe i strukturave shoqërore prej parisë, e ka kthyer shtetin në një katund.

Për arritjen e objektivit të rikthimit të shoqërisë në një kënetë morale, punohet sistematikisht e pa ndërprerje, aqsa

sjellja kriminale ka hyrë në subkoshiencën e njerëzve dhe tashmë shihet si norma e sjelljes së pranuar në shoqëri. Në shtetin shqiptar askush nuk duhet të jetë i pastër e i ndershëm, të gjithë duhet të bëhen vegla të parisë. Gjithnjë e përgjithmonë, ata duhet të kenë e do të kenë frikë prej vetes dhe hijes së vet. Si ka thënë edhe Montaigne, nuk ka një njeri që po të gjykohet për çka ka menduar e për çka ka bërë në jetë, nuk varet të paktën dhjetë here më litar. Paria lufton t'i përdorë këto pika të dobëta të njerëzve, vetëm e vetëm t'u mbyllë gojën dhe t'i kthejë në vegla të vetat. Suksesi i saj do të ishte i paimagjinueshëm diku tjetër. Mbi të gjitha, loja e qëllimtë e parisë shihet qartë te përpjekja e tyre për t'i shtyrë njerëzit të zgjedhin, të mbështesin, ose njerën palë të parisë, ose tjetrën. Lufta është të bindë njerëzit të zgjedhin medoemos njërën palë të parisë mbi palën tjetër. Ndarja duhet të shkojë deri në nivelin e armiqësisimit më të thellë të grupeve të ndryshme në shoqëri e të prerjes së urave me palën tjetër të saj.

Duke e ditur se çka mendojnë njerëzit për ta, paria i shtyn të mendojnë në një nivel tjetër. Njerëzit nuk duhet të zgjedhin palën më të mirë, ata duhet të zgjedhin të keqen më të vogël. Prandaj nuk ka fare rëndësi se cila palë fiton zgjedhjet. Dy palë ka. Kushdo që fiton, do ruajë palën tjetër. E rëndësishme është se gjithnjë fiton sistemi i parisë dhe, përmes rikonfirmimit të sistemit e të kontrollit të saj mbi të, fiton paria vetë.

Më në fund, por jo më e fundit, marka më e dallueshme e parisë së jeniçerëve është përdorimi i strukturave kriminale. Këta janë banda të frikshme mafioze e kamorriste, që nuk ndalen para asgjëje. Të kamufluara, herë si militantë, herë si clackers mitingjesh politike, por të lidhura në kërthizë me parinë, këto struktura mafioze janë duke u përdorur sistematikisht për të mbjellë frikë e terror në mendjen e njerëzve. Njëlloj si vampirët e lugetërit që e duan natën të jetë 24 orë, ashtu edhe paria do që t'i bindë shqiptarët se jeta e tyre duhet të jetë skëterrë. Arsyetimi është se kështu është e gjithë bota, se nuk mundet e nuk ka se si të jetë ndryshe. Ndryshe ata janë

të papranueshëm. Dhe paria e prijatarët e saj e dinë mirë se terri, por edhe nata e vërtetë, fillon e mbaron në mendjen e njerëzve. Aty është edhe burimi i legjitimitetit të saj.

Legjitimimi i sistemit dhe palët e interesuara

Megjithëse paria e ka krijuar bindjen se gjendja në shtetin shqiptar është nën kontrollin e saj të hekurt dhe përshtypja e njerëzve është se ajo është e pakundërshtueshme; prapë i duhet shumë legjitimimi publik i sundimit. Legjitimimi është i shprehur periodikisht nga pjesëtarët, por edhe nga populli me vullnetin e tij të lirë në zgjedhje si dhe nga përfaqësuesit e vendeve të huaja që ia njohin sundimin. Në një mënyrë, ose në një tjetër, pjesëtarët, të huajt dhe populli i sunduar duhet ta shprehin besimin e tyre te paria. Çdo kundërshtim i legjitimitetit të sistemit të saj, është një goditje që paria nuk e harron e nuk e fal, ngado që i vjen.

Por më së shumti e për arsye të kuptueshme, paria e dëshëron dhe e kërkon legjitimimin nga populli. Për këtë arsye, demokracia e vërtetë, vota e fshehtë, është një problem i madh për të. Nuk është puna se nuk di si ta minojë demokracinë e se nuk ia ka arritur ta bëjë këtë. Çdo model i imagjinueshëm zgjedhor që është përdorur ka dështuar. Po për shkak se formalisht shteti shqiptar duhet të duket se është demokraci, paria nuk mund t'i vendosë njerëzit në rresht dhe t'i nisë në kutinë e votimit me hu, si dikur në kohën e “demokracisë popullore”. Ajo ka punuar dhe ka gjetur mënyra për t'i bërë njerëzit ta shprehin besnikërinë e tyre publikisht ndaj parisë, ndaj sistemit të saj thelbësisht jodemokratik, edhe në dhomën e votimit, bash aty ku vota duhej të ishte e fshehtë dhe e drejtpërdrejtë. Kështu, duke e kontrolluar sistemin ekonomik, politik e shoqëror, por mbi të gjitha duke vendosur një hegjemoni të mbështetur me struktura impulsive të propagandës, paria duket sikur e ka arritur qëllimin që njerëzit t'i nënshtrohen me vullnetin e tyre të lirë.

Problemi kyç, megjithatë, janë zgjedhjet, ky moment kritik kur njeriu i thjeshtë e ka fatin e tij në dorë. Çdo votë pro partive të parisë ka peshë, sepse ndihmon në zgjidhjen e problemit të saj. Çdo votë kundër është një problem i madh për parinë. Po ashtu, një problem i madh për të është edhe bojkotimi i zgjedhjeve dhe i sistemit zgjedhor, si një formë refuzimi publik për të qenë pjesëtar, mbështetës, tolerues i krimit të parisë apo një instrument i ndërgjegjshëm i sistemit që mbron interesat e parisë. Nga dy zgjidhjet që kanë qytetarët, për të mos votuar apo për të bojkotuar sistemin, bojkotimi është armiku i saj i vërtetë, armik për vdekje.

Si shprehet besnikëria ndaj sistemit e ndaj parisë?

Më së pari duhet sqaruar si e merr paria mbështetjen nga populli. Pjesëtarët e saj dhe klientët e tyre, e shprehin mbështetjen për këtë sistem kriminal duke u bërë pjesë e tij, duke u konformuar me jovlerat dhe duke u sjellë ekzaktësisht ashtu siç pritet prej tyre, domethënë si mafiozët, kamorristët dhe gangsterët e rrugës, anipse janë me poste e vishen me rroba firmato. Si shpërblim marrin tendera, licenca e, kur është e mundshme, punësohen në shtet. Kur i duhen parisë, të gjithë këto individë e ulin qafën e i shërbejnë asaj me bindje qorre. Të gjithë e bëjnë këtë kompromis me vetëdijë, sepse ndjekin e mbrojnë interesat e veta, ose pse e shohin veten si pjesëtarë të parisë, ose pse ndjekin logjikën e fitimit prej saj. Prandaj sjellja e tyre e ndërgjegjshme, nuk është e falshme, por shoqërisht e dënueshme.

Të gjitha ato që këta individë, përndryshe të shkolluar, thonë në klube e në rrethe të ngushta kundër parisë, kundër njërës e kundër tjetrit pjesëtar të parisë, janë thjesht pallavra për të larë ndërgjegjen. Kur u kërkohet nga shefat, të gjithë këta shërbëtorë të zgjedhur të të gjitha rangjeve, vihen në rresht si ushtarë të bindur. Kur refuzojnë, ose kur hedhin vickla, shefat apo ata që kontrollojnë shefat e tyre, iu kujtojnë

veset e shumta, dashnoret, bizneset, pislëqet, dosjet, poshtërsitë e "nderet" e pandershme e të panumërta që iu kanë bërë. Kështu paria e gjen mënyrën ose t'ua mbyllë gojën, ose t'i fusë edhe një herë në rresht.

Shumë nga këta tipa, VIP të tanishëm, kanë harruar se ka edhe një mënyrë të sjelluri me dinjitet. Për ilustrim të këtyre tipave kam sjellë Lufter Xhuvelin. Megjithatë po sjell edhe rastin e Arben Imamit, sot ministër i Mbrojtjes dhe një kohë edhe shef kabineti në zyrën e kryeministrit Sali Berisha, sepse ky është një rast shumë domethënës. Arben Imami ka qenë dikur një ëndërrimtar e aktor i talentuar, pedagog në Institutin e Arteve, por edhe një njeri me ambicje shumë më të madhe se mendja që kishte. Më vonë, u lidh me Azem Hajdarin dhe Sali Berishën në Partinë Demokratike. Një kohë u riciklua si parlamentar i dështuar me Aleancën Demokratike. Gjatë kundërvënies së tij ndaj Sali Berishës, Saliu përdori të gjithë informacionin që kishte, i kujtoi të ëmën dhe aktivitetin e saj në shërbim të shtetit, përhapi thashëtheme që e ndanë nga gruaja dhe i shkatërroi familjen. Mandej, Arben Imami u njoh si opozitar i rreptë, politikan me dhëmbë të thyer e me trup të copëtuar nga Saliu e nga veglat e tij në vitin 1996, që e rrahën barbarisht në sheshin kryesor të kryeqytetit. Në vitin 1997, Arben Imami u bë drejtues i vetëshpallur i një rebelimi enverist dhe krijoi një strukturë që synonte të vihej në krye të rebelimit, por pa shumë sukses, sepse ata që e drejtonin kishin struktura të tjera. Megjithatë, në shpërbllim të veprimtarisë antiberishiane, Imami u bë ministër, konstitucionalist pa një ditë shkollë për atë punë, drejtues i një OJQ liberale pa ide për liberalizmin dhe në media përflitet se është edhe pronar e aksionist në veprimtari të ndryshme ekonomike. Arben Imami është njeri pa bindje të qarta e koherente politike, pa sjellje konsistente e pa pikë morali politik. Tash gjendet i vënë pa kushte në shërbim të atij që në kushte të tjera, po vetë ka thënë se i ka shkatërruar familjen, shëndetin e jetën. Berisha e ka shpërblyer, duke e bërë shef kabineti, ministër, deputet

dhe anëtar të Këshillit Kombëtar të PD. Njeriu habitet se çka bën Imami në politikë dhe si e takon Sali Berishën. Po ja që modeli Imami i duhet parisë. Prandaj ai mbrohet, promovohet e mbështetet nga oligarkia.

Si ai ka shumë të tjerë që e kanë pasur karrierën tejet të ndërlikuar e me zigzage marramendëse, por Imami është prototipi ilustrativ i këtij grupi që njihen si VIP në Tiranë. Natyrisht, parë nga këndvështrimi i parisë, zgjidhjet e tij kanë qenë racionale. Kështu i del llogaria. Nga këndvështrimi i tij, Imami nuk e ka jetën e keqe. Ai jeton mirë, i dëgjohej fjala dhe takohet shpesh me kryeministrin e rradhës. Si Imami, ashtu edhe pjesëtarët e tjerë të parisë, ndjekin një vijë justifikimi të gjendjes së tyre e të rrëshqitjes në llumin moral. Por në fund të fundit, çdo argument që përdoret s'është asgjë më shumë se justifikim i një sjelljeje amorale, të pandershme, jonjerëzore, në emër të përfitimit për interesa të ngushta materiale në shërbim të parisë.

Nga ana e tyre, të huajt përmes përfaqësuesve të tyre diplomatikë, janë të interesuar kryesisht për stabilitet. Për të huajt shteti shqiptar është në një gjendje katastrofike. E megjithatë ata mendojnë se duhet shmangur gjithnjë më e keqja që mund të ndodhë në atë vend (viti 1997 ka qenë një mësim i madh për të huajt) dhe "më e keqja" shmanget duke e mbajtur kapakun të mbyllur mbi tenxheren që vlon. A fiton krahu i majtë i Gërdecit, apo krahu i djathtë i Gërdecit, për ta nuk ka shumë rëndësi. Shteti shqiptar ka qenë një problem i madh politik në të shkuarën dhe vazhdon të jetë edhe më problem sot, pikërisht kur duket sikur në Tiranë nuk lëviz asgjë. Të huajt e dinë mirë se me kë kanë të bëjnë. Të gjithë këta pjesëtarë të parisë i kanë dosjet e mbushura me gjithfarë xhevahresh. Të gjithë kanë dhënë prova që janë jashtë normës së sjelljes së duhur. Por paria është problem për shqiptarët. Të huajt duket sikur mendojnë që këta duhen duruar për hir të stabilitetit.

Mandej, pse duhet të ndërhyjnë të huajt, kur këta të ashtuquajtur "udhëheqës e liderë", i zgjedh populli i tyre? Me e thë-

në me gjuhën popullore, kur grindet burri me gruan, komshiu që vjen me i nda, shpesh qan më shumë hallin e vet. Po ashtu mësimet e nxjerra nga kriza e vitit 1997, i kanë bindur të huajt se ndoshta duhet t'i lënë të merren me punët e tyre. Ky është një mësim që edhe paria e ka mësuar shumë mirë. Prandaj kur një i huaj flet në favor të palës së tyre, ata e thërrasin në parlament dhe i japin "Urdhëri i Skënderbeut", "Medalje për Shërbime Civile", ose janë gati ta shpallin "Nderi i Kombit", anipse nuk ka kurrgjë shqiptare në atë person. Kur nuk flet mirë, ata nuk e presin fare; herën tjetër e nxjerrin "persona non grata" dhe ai person bëhet objekti i sulmeve mediatike në gazeta "55" apo në "Zëri i Popullit", domethënë mjetet propagandistike të njërës palë a të palës tjetër.

Por në thelbin e gjithë lojës politike të legjitimitit të parisë është qëndrimi i popullit. As të huajt, por as vetë paria nuk mund të vazhdojnë të luajnë të qetë cic - micin në Tiranë, nëse populli e shqiptarët në veçanti, fillojnë e shfaqin shenja të qarta se nuk pajtohen me sundimin e tyre. Deri në këtë pikë, paria ia ka arritur që ta kontrollojë popullin, ta bindë se e vetmja rrugë është sjellja kriminale, domethënë sjellja e bindur ndaj parisë e ndaj rregullave të vendosura prej saj. Kështu, ia kanë arritur ta kriminalizojnë keqas popullin shqiptar. Teknikat e stërholluara të mbajtjes së njerëzve peng për interesa materiale dhe ndërkohë zhveshja e tyre nga çdo vlerë njerëzore, kanë qenë deri diku të suksesshme. Paria e ka mbërritur qëllimin e vet, duke përdorur urrejtjen e mllefin për të shkuarën, neverinë për jetën e tashme, dëshirat për të ruajtur dhe për të marrë pronat, ruajtjen legjitime të pronave të vjedhura apo të ndërhuara në mënyrë të paligjishme.

Mbi të gjitha, sa herë vijnë zgjedhjet, pavarësisht manipulimeve, rrahjeve e kacafytjeve publike, paria nuk ndjehet shumë e sigurtë si do të sillen populli. Prandaj edhe fushata zgjedhore është një përpjekje e kushtueshme financiarisht, por edhe e sofistikutar në nivel të agitacionit e të propagandës për të fituar sigurinë se njerëzit do të sillen ashtu siç pret

paria. Qytetarët duhet të shkojnë, do të shkojnë e do të votojnë, ose për një palë të parisë, ose për palën tjetër. Por në fund të fundit, paria gjithmonë del e fituar, sepse politika shqiptare është dushk për gogla.

Edhe kësaj here, si çdo herë tjetër, populli shqiptar e ka mundësinë të bëjë një zgjidhje. Zgjidhja që do të bëhet, ose do ta legjitimojë, ose do ta minojë sundimin e parisë. Në mungesë të forcave politike që do të mbrojnë interesat e shqiptarëve, më e pakta që shqiptarët mund të bëjnë, do të jetë ta minojnë e ta delegitimojnë sundimin e parisë.

Cilat janë rrugët që mund të ndiqen?

Veçanërisht sot, kur vjen puna te legjitimimi i sundimit të parisë, populli shqiptar ka katër rrugë për të ndjekur.

Njëra rrugë, ajo më e lehta, është legjitimimi i sistemit të parisë. Edhe pse ky sistem duket sikur është demokratik, i bazuar në votën e lirë, përshtypja e vëzhguesit të paanshëm është se shoqëria shqiptare jeton me një frikë të madhe për të nesërmen dhe me një pasiguri të thellë për bukën e gojës. Në shtetin shqiptar, buka e gojës fitohet vetëm e vetëm duke qenë pjesë e një klani të caktuar. Buka fitohet duke hyrë në rresht si pasues i një krahu të parisë sunduese. Prandaj njerëzit shkojnë e votojnë edhe pse e dinë se po ia shkatërrojnë jetën e ardhmërinë vetes e familjeve të tyre. Jo vetëm kaq, po ata po e shkatërrojnë edhe ardhmërinë e gjithë të tjerëve. Duke votuar për “thesin e miellit” që marrin prej partisë, ata e legjitimojnë sistemin dhe i japin parisë të drejtën të sundojë edhe për katër vite të tjera. Në këtë mënyrë, askush nuk ka të drejtë të dalë e të thotë se paria “na bëri këtë e atë”, sepse ata vetë ia kanë dhënë votën. Kur e pati mundësinë, secili e bëri zgjidhjen e vet dhe secili votoi për njërën, ose për tjetrën palë të parisë. Pas votimit, e drejta e tyre për të folur kundër sistemit ndryshon. Kështu paria sundon me votën e popullit dhe fiton legjitimitetin që dëshiron aq shumë.

Rruga tjetër është organizimi i një force politike që të punojë për të gjithë shqiptarët si komb. Pavarësisht tam - tamit mediatik, politika në shtetin shqiptar është një politikë e mbështetur në identitetin etnik, çka manipulohet nga paria. Por, vetë paria ka interesa e jo ndjenja etnike apo kombëtare. Nga ana tjetër, ajo don që gjithsecila nga pakicat të ketë partinë e vet, por që shqiptarët të mos kenë, as përfaqësim, as ndërgjegjësim politik. Në këtë pikë pakicat në shtetin shqiptar janë të organizuara shumë mirë në strukturat e Unionit Vllah, Partisë për të Drejtat e Grekëve, Partia e Maqedonasve, apo edhe Partia e Romëve. Të gjitha këto forca politike të minoriteteve, luajnë në politikë një rol disafish më të madh se vlera reale e tyre. Po për parinë jeniçere të Tiranës, vetëm shqiptarët nuk duhet të kenë një forcë që mendon e që lufton të mbrojë interesat e tyre si komb. Siç shihen gjërat, shqiptarët nuk do të kenë përfaqësim politik si komb, as në këto zgjedhje. Kur të organizohen si shqiptarë, atëherë do të jenë gjërat më ndryshe.

Rruga e tretë është rruga e luftës së hapur me çdo mjet e pa mëshirë kundër këtij sistemi jeniçero - martalloz. Kjo luftë duhet zhvilluar si në nivelin shoqëror, ashtu edhe në atë politik. Terreni nuk është shterp, përkundrazi. Në shtetin shqiptar ka shumë rezistencë ndaj sistemit të parisë. Nga një anë ka shumë forca të majta në të cilat militojnë njerëz të ndershëm dhe që besojnë në një formë të ideologjisë marksiste apo enveriste. Nga ana tjetër ka një rezistencë të dallueshme, veçanërisht në grupimet që po lindin dhe që janë të organizuar në bazë të ideologjisë fetare. Po ashtu ka pasur shenja të rritjes së anarkizmit e të formave të tjera të rezistencës shoqërore të mbështetura në kundërkulturë. Ka edhe grupe e individë që pajtohen vetëm në urrejtjen personale kundër sistemit, por që janë të paqartë në rrugën politike që duhet të ndjekin. Edhe pse duan të kontribuojnë në politikë, nuk e kanë përgatitjen e duhur. Po ashtu ka një rezistencë që shihet qartë në forcimin e strukturave familjare e lokale që po i kundërvihen sundimit

të parisë dhe që, megjithatë, vazhdojnë të mbeten në anë të debatit politik.

Rruga e fundit është ajo e bojkotit. Bojkoti është një armë e fuqishme, e përdorur edhe më parë, por jo sistematikisht, në shtetin shqiptar. Kur njerëzit nuk ia japin votëbesimin sistemit politik, atëherë sistemi shkërmoqet e bëhet hapur diktatorial e tiranik. Me bojkotin, njerëzit e deklarojnë zgjidhjen e tyre dhe ndarjen prej sistemit të parisë. Njerëzit tregojnë se kanë nder e dinjitet, duke refuzuar të bëhen pjesë e krimin.

Frika e bojkotit është e ndjeshme në sjelljen e parisë. Po shihet qartë se atë e ka kapur paniku mos shqiptarët do të bojkotojnë sistemin e tyre. Prandaj në kushtet e sotme, lufta është që të mos lejohet bojkoti i zgjedhjeve, sepse kjo çon në delegitimimin e sistemit. Asaj i duhet vota e popullit. Nuk është njëllëj si të sundosh me dhunë e si të sundosh me votën e popullit. Paria e kërkon shumë legjitimimin e vet. Për të shqiptarët duhen sunduar ashtu si do paria. Por sistemin, pavarësisht deformimeve që ka, njerëzit duhet ta pranojnë me votën e tyre e me vetëdije të plotë.

Bojkoti si rruga e vetme për të luftuar sistemin

Ka zëra që thonë se është koha që shqiptarët ta ndajnë mendjen. Ata duhet të bëjnë një zgjidhje të vështirë, por shumë të dobishme për ta: të vendosin ta bojkotojnë sistemin. Dihet që sistemi i parisë nuk do të ndryshojë, nëse nuk i kundërvihen forca politike me objektiva të qarta. Zgjedhjet nuk do të zgjidhin asgjë. Zgjedhjet vetëm do të legjitimojnë parinë e diskredituar të Tiranës. Cilado parti të fitojë, do t'i ruajë interesat e tjetrës. Ashtu siç e ruajti Fatos Nano një kohë Sali Berishën, ashtu edhe Sali Berisha e ruajti dhe do ta ruajë Fatos Nanon. Siç tregon edhe përvoja e Gërdecit, çmimin e kanë paguar e do ta paguajnë shqiptarët. Nga ana e vet klanet e parisë shahen e rrihen në media, por dihet që ata po sillen në atë mënyrë vetëm për të mbrojtur e fshehur fitimet. Kështu që

njeriu i thjeshtë nuk humbet asgjë, si votoi si nuk votoi, sepse zgjedhjet janë thjeshtë “dushk për gogla”. Pse të votosh për një parti, kur ajo është pjesë e krimit, partnere e palës tjetër e për ta thënë më thjeshtë, kur të dyja palët janë pjesë integrale e parisë së Tiranës?

Si një herë në katër vjet, njerëzit e kanë mundësinë t'i bojkotojnë zgjedhjet dhe frika e parisë është se do të ketë bojkot masiv të zgjedhjeve. Gurë - gurë bëhet mur. Nga shprehjet në shtyp e nga shqetësimi i analistëve të lidhur me segmentet e parisë, ndjehet frika e bojkotimit të zgjedhjeve, si dhe frika e bojkotimit të sistemit. Paria është krejtësisht e vetëdijshme që secila votë që nuk hidhet në mbështetje të njërës, ose të tjetrës palë, është një shigjetë e hedhur në zemër të sistemit kriminal të saj, të sistemit që i shërben dhe i duhet. Duke mos votuar, njerëzit do të tregojnë se nuk pranojnë të jenë pjesë e krimit të parisë së Tiranës. Kjo është frika e madhe e saj.

Makthi i parisë pra, është refuzimi i shqiptarëve për të votuar, frika se mos ndodh bojkotimi masiv i zgjedhjeve që ata i kanë përgatitur me aq kujdes dhe që u duhen aq shumë. Momenti që i druhen më fort, por që kurrë nuk do ta pranojnë mendërisht, është momenti i përshkruar kaq me kujdes nga Josesaramago, kur në qendrat e votimit do të jenë vetëm komisionet e militantëve. Ky është momenti kur gangsterët e partisë do të shkojnë shtëpi më shtëpi, por të gjithë shqiptarët ose do të jenë të sëmurë, ose kanë shkuar me pushime, ose kanë thyer këmbën, ose nuk iu pëlqen kandidati i rradhës, ose mendojnë se koalicioni ka qenë i gabuar, nxjerrin bishta (si bie fjala, nuk kanë letërnjoftime, pasaporta, nuk e kanë emërin në lista, ose e kanë në katër lista, etj.), ose e thonë të vërtetën që politika ka qenë një mashtrim i madh e i paturpshëm, nuk duan ta votojnë këtë pari dhe pikë. Makthi i vërtetë i parisë është se mos mërgimtarët do të shkruajnë dy gisht letër e do t'iu thonë të afërmve të tyre “po votuat, nuk iu nisim më asnjë metalik”. Makthi i parisë së Tiranës e ka emrin bojkot.

Përfundimi

Në përfundim duhet thënë se legjitimitimi i sundimit të parisë së Tiranës përmes zgjedhjeve kuvendore, është një provë e madhe politike që nuk duhet kaluar lehtë. Paria e kërkon legjitimitet me çdo kusht. Ata që janë të ndërgjegjshëm se kjo është gjendja, por nuk mendojnë se vota që hedhin është plumb në zemër të së ardhmes së tyre e të fëmijëve, janë për t'u mëshiruar. Duke gjykuar nga niveli i thellë i krizës së gjithanshme, bojkotimi nëse ndodh, do të jetë një hap i madh përpara drejt riorganizimit të sistemit politik në shtetin shqiptar.

Në mungesë të strukturave politike që të shprehin vullnetin e popullit, bojkotimi do të jetë një vendim i marrë nga shumë individë të vetmuar, por rëndësia e aktit të tyre do të jetë shumë e madhe. Po ashtu duhet thënë se paria ka mësuar ta kthejë dhembjen e vet në fitore, prandaj i ka instrumentet e fuqishme të propagandës. Po bojkoti masiv, si praktikë e sprovuar, është një goditje për vdekje e cilitdo sistemi ekzistues. Në rastin tonë, bojkoti do të ishte një shenjë e qartë se kemi filluar të mendojmë që nuk duhet t'i lëmë më peng familjet dhe jetën tonë në duart e parisë.

FUNDI DALTË HAJR, PËRSËRITJA E TRAGJEDISË KOMBËTARE TE 1997

Po ta lëmë mënjanë llapaqenërinë mediatike dhe kauzën e rrotacionit, turmën lehaqenase të zhurmuesve të parisë nga të dy anët dhe dinakërinë katundare, baltosjen sistematike të gjithkujt e të gjithçkaje që kundërvihet mendësisë së turmës, rrenat e mashtrimet e papërballueshme të parisë që e kanë çuar marrëzinë kolektive në nivele të frikshme, terrorin e kafshatës së gojës, kontrollin e hekurt mbi votat e mbi njerëzit, praninë e pamohueshme të strukturave kriminale, oligarkizimin ekstrem të sistemit politik e të tjera simptoma të sistemit, çdo të gjejmë në fund të psikikës kombëtare?

Në fund të pusit të zi e të qelbëzuar të shpirtit kombëtar do të gjejmë frikën e vitit 1997. Frika që i ngrin të gjithë, është frika nga përplasja e armatosur e vitit 1997, nga mundësia e përsëritjes së saj. Edhe pse pranohet se përplasja është e pashmangshme dhe mundësitë janë të shkojë nga përlëshje lokale të menaxhueshme, në përplasje të pranuar nga palët e parisë, frika e përsëritjes së vitit 1997, i bën të gjithë të ngrijnë si lepuri para gjarpërit. Të gjithë; edhe paria, edhe llapaqenëria, edhe vegjëlja sillen e sillen e në fund të hedhin në tavolinë si një argument të pakundërshtueshëm vitin e mbrapshtë 1997. Është e frikshme sa e fortë është përshtypja që ka lënë viti 1997, në psikikën shqiptare. Por të gjithë e dinë se cila është gjendja. Prandaj është e qartë se ky është argumenti i dëshpërimit dhe i të dëshpëruarve.

Si duhet interpretuar kjo frikë e justifikuar?

Me të vërtetë përplasja e plotë dhe shërrin në nivel shtetëror do të ishte një fenomen i frikshëm. Të gjithë e pamë se çka ndodhi me 21 janar. Nga një anë kishim disa deputetë që mobilizuan mijra të dëshpëruar me hunj, e një kryeministër që e rrahu me shpulla një gjeneral dhe e detyroi të vrasë edhe kur nuk ishte e nevojshme. Në varësi të kalkulimit që do bëjnë, do të vendosin si të sillen. Sepse si “burra trima” që janë e që shiten, duhet t’iu tregojnë mbështetësve se nuk i shesin e se nuk i tradhëtojnë. Më e pakta që do të bëjnë do të jetë të kontestojnë, të organizojnë mitingje, të mbajnë fjalime e protesta dhe të vënë llapaqenërinë mediatike të rrotullojë gurin e mullirit të tyre. Por këta e dinë se si ta gjejnë gjuhën.

E pra, përplasja është thujse e pashmangshme. Kur të vijë puna me vjedhë votën pa para, këta që po paguajnë t’i blejnë, do ta vjedhin pa hezitim. Kur të vijë puna që të dhunojnë vullnetin e njerëzve, këta që kanë vrarë e prerë pa mëshirë, do ta bëjnë pa hezitim. Kur të vijë puna me mbushë kutitë, komisioneri që e di se do të humbë apo fitojë vendin e punës, do ta bëjë sa t’i jepet mundësia. Po e pa njëra palë se i ka mundësitë me fitue 71 vende me pak poshtërsi, do ta bëjë pa hezitim. Po e panë se fitojnë familjet mafioze e bandat kundërshtare, do të gjenden mënyrat me e plasë sherrin. Deputetët që kanë vjedhur e kanë marrë miliona për favore, kandidatët që janë investuar e që janë mbështetur me miliona duhet të justifikojnë humbjen të financuesit e mbështetësit. Ata që ndenjën tetë vjet duke vjedhur, nuk e imagjinojnë veten në opozitë duke shkuar nga një kafene te tjera, pa para, pa mbështetje, pa mbrojtje dhe pa pushtet. Ata që ndenjën tetë vjet në opozitë janë kaq të uritur, sa nuk mund të imagjinojnë edhe katër vjet të tjera.

Por dallimi me vitin 1997, është cilësor. Në vitin 1997 kishim ende struktura që kontrolloheshin mirë nga paria. Ishin kuadrot e mbledhur rreth PS, një repart ushtarak që komandohej lehtë dhe që e kontrolluan me qetësi edhe shpërthi-

min e bandave të tyre që më pas i plasën në burg. Ishte struktura e PD që ende kishte një element besnikërie ndaj partisë, apo edhe kundërshtie ndaj palës tjetër. Në vitin 1997, kishte ende struktura të forta të familjes e të shoqërisë nga mëhalla e deri në nivel të qytetit. Në vitin 1997, njerëzit ende e kishin të fshehur diku frikën e shtetit.

Të huajt duan stabilitet me çdo kusht e me çdo çmim. Në sytë e tyre ne jemi barbarë, të pagdhundur e që nuk dihet se pse jemi në brinjë të Evropës kur duke gjykuar nga sjellja, duhej të ishim në një xhungël diku. Elementi më i dukshëm i përgjegjësisë qytetare është se nuk e ka më kush frikën e shtetit, sepse shteti është tërësisht i korruptuar, i degjeneruar deri në kulm me zyrtarë, oficerë, policë, ministra e me radhë, që sillen si njerëzit e rrugës. Deri edhe të rinjtë nuk njohin shtetin, lëre më fuqinë e vërtetë të shtetit, nuk kanë respekt për të e frikë prej saj, por e dinë se gjithçka zgjidhet duke vepruar kundër ligjit. Tashmë shoqëria është e fragmentarizuar. Familja është e shkatërruar. Vegjëlja urbane e katundarët tanë fisnikë, kanë marrë çka kanë mundë me marrë e kanë vjedhë çka kanë mundë me vjedhë. Partitë politike nuk janë më reparte ushtarake, por truste krimi. Udhëheqësit e partive janë të diskredituar në të gjithë nivelet e pabesueshmërisë për të mbajtur nën kontroll masat e gjëra të të uriturve e të njerëzve që kanë pritë e presin radhën me vjedhë shtetin. Oligarkia ekonomike e ndien se urrejtja popullore do të drejtohet më së pari te ata që ishin si të gjithë, e që tashmë sillen sikur kanë rënë nga qielli. Mbi të gjitha, bota kriminale shumë e strukturuar dhe që ka kaq shumë me humbë nga fitorja apo humbja e palës kundërshtare, nuk do të hezitojë të ndjekë qëllimet e saj.

Ku është arsyeja e pashmangshmërisë?

Mendësia kriminale ka triumfuar dhe është vetëm çështje kohe para se argumenti, cilido argument edhe argumenti se kush i fiton zgjedhjet, do të zgjidhet nga më i shkathëti e më i

shpejti, nga më i forti e nga më i krisuri, nga ai që nuk ka asgjë çka me humbë e nga ai që rrezikon me humbë gjithçka. E ata që kanë shitur votën e tyre për 20 000 lekë, e dinë mirë arsyen pse këta që dinë vetëm të vjedhin, po paguajnë edhe kaq. Po ashtu ata e dimë mirë se ku i ka paratë e pasurinë paria, sa ka e si i shpenzon, se si vjedh e çfarë poshtërsish bën. Se në fund, të gjithë vijnë nga katundi, jetojmë në një katund gjigand, nuk i kemi ikur mendësisë katundare dhe kujtesa e shqiptarëve nuk është shuar krejt. Të gjithë ne e njohim mirë njëri - tjetrin dhe shumë po presin radhën të lajmë hesapet për të gjithë poshtërsitë, pamundësitë, krimet, përbuzjen e pësuar, injorimin, zhgënjimin dhe mbi të gjitha, për dinjitetin e humbur e nderin e vjedhur. Prandaj edhe përplasja është e pae-vitueshme. Nuk dihet se cili do të jetë intensiteti, nuk dihet se ku do të fillojë, nuk dihet sa do të jetë e përhapur, por diçka ka me ndodhë e mund të mos jetë si 1997, por do të jetë gjithnjë më e frikshme, më e pashmangshme, më e egër, më me pasoja.

Sepse nuk dihet se çka bluen ky njeriu i ri i Tranzicionit; ai që ka diplomë e nuk ka marrë edukim e s'ka punë. Ai që ka profesion e nuk ka punë. Emigrant që sjell paratë dhe nuk ka shtëpi e mundësi për jetesë. Pensionistët që nuk paguhen për një jetë punë. Pronarët e ligjshëm që e kanë parë veten të grabitur. Njerëzit që duhet të paguajnë gjithkund e për gjithçka. Dyqanxhiu dhe prodhuesi që e sheh padrejtësinë e taksambledhësve dhe të shtetit. Shoqëria që e din se çfarë poshtërsish janë bërë për të krijuar këtë sistem. Të uriturit që nuk kanë gjë me humbë. Të grabiturit që duan drejtësi. Kriminelët e banditët, mafia dhe trafikantët që mezi presin me mbrritë qëllimin e tyre. A don ma argumente? Lista e minave të tilla në fushën tashmë të minuar të politikës shqiptare, është e gjatë dhe si ka thanë filozofi i shquar, në traditën stoike të mejhaneve në Gjuhadol (e për këtë thënie e meriton medaljen "Nderi i Kombit", sepse në fund ka bërë shumë më tepër se Riçardo Coçiante me Margherita) zotëria i nderuar mitik, Gjergj Mu-llaga, "fundi daltë hajr".

THIRRJA PËR BOJKOTIMIN E ZGJEDHJEVE RIVLERËSIMI I NJË NISME QYTETARE - II

Baza teorike e thirrjes për bojkot

Baza teorike e thirrjes për bojkot është shtjelluar në librin tim “Përrallat e Tranzicionit Shqiptar”. Argumenti që paraqitet në libër është i thjeshtë dhe buron nga teoria e formuluar aty, por mbështetet edhe në teorinë elitariste të Harold Lasswell dhe në punimin e Murray Edelman, “Përdorimet Simbolike të Politikës”. Ky është themeli teorik dhe jo romani i Josep Saramago, siç spekuluan kalemxhinjtë e llapaqenerisë mediatike të Tiranës.

Cili është argumenti? Argumenti është se ka dy lloje realitetesh në të cilat ekziston shoqëria shqiptare. Këto dy realitete janë të papajtueshëm, por bashkëjetojnë si uji i kripur me të emblin në një estuar. Cilat janë dhe si bashkëjetojnë këto realitete?

Argumenti është se bashkëjetesa mundësohet nga shteti dhe nga procesi politik. Ajo që e bën të mundshme pranimin e kësaj gjendjeje si realitet, është politika dhe procesi zgjedhor. Përmes procesit zgjedhor, njerëzit identifikohen me parinë, e pranojnë realitetin që iu imponohet nga shteti dhe paria si të pashmangshëm dhe vazhdojnë të jetojnë në një sistem që i skllavëron pa ndërprerje e pa shpresë.

Njëri realitet është realiteti i parisë. Ky realitet që ajo ka krijuar dhe i shërben, e sheh botën dhe shoqërinë shqiptare duke përdorur metodologjinë marksiste dhe si të vendosur/gjendur në strukturën e kapitalizmit më të egër englesian. Në

këtë realitet, paria e sheh veten si borgjezia dhe të tjerët janë proletariati dhe skllëvërit e saj. Justifikimi ideologjik shkon një hap më larg. Këta janë thjesht shqiptarët “pisa”, një popull “pis” që duhet shfrytëzuar, degjeneruar, zvetënuar, skllavëruar, përdhunuar e marrë nëpër këmbë, sepse kështu vendoset e ndërtohet “kapitalizmi”. Po kjo nuk thuhet, sepse i bie ndesh realitetit në të cilin është shtërngue me jetue pjesa tjetër e shoqërisë.

Realiteti tjetër është realiteti i njerëzve që nuk kanë më as shpirt me jetue. Ky është realiteti i shumicës, i popullit “pis” shqiptar, i atyre që kapen pas pronës së vogël, me gurë e llaç, me tulla e me një dyqan, me një copë tokë, me një apartament, me një ndërtesë, që hanë bukë e djathë, që dalin në klub e shkojnë në plazh dhe që shesin fëmijët e tyre jashtë shtetit për këtë jetë mjerane. Ky është realiteti i atyre emigrantëve që nuk kanë asgjë me tregue për vitet e pafund të poshtërimit, të vuejtjeve e të mundimit, ndoshta një shtëpi, një grusht me euro dhe plagët në shpirt që nuk ua lehtëson askush. Ky është realiteti në të cilin paria kërkon të jetojnë. Dhe procesi i varfërimit moral, material dhe mendor është intensifikuar me shpejtësi.

Po si mund të binden njerëzit të jenë skllëvër? Sepse shqiptarët nuk janë thjesht krah pune, ata janë edhe njerëz e mbi të gjitha, shtetas. Njerëzit mbahen nën kontroll me dhunë e me kafshatën e gojës, veçanërisht me mendësinë e tyre katundare. Ndërsa shtetasit si votues është e vështirë të kontrollohen, sepse ata votojnë dhe vota është burimi kryesor i legjitimitetit të parisë. Pa votën e popullit, fytyra e parisë del ajo që është në të vërtetë. Një bandë kriminale, mafioze, vrastare, oligarkike që ka kryer krimin më të përbindshëm mbi shqiptarët, ua ka humbur shansin historik, i ka skllavëruar përjetë duke u grabitur pasuritë e shtetit, të tyre dhe duke i vënë të punojnë për një copë bukë.

Por parisë i duhet vota e shqiptarëve. Politika dhe procesi zgjedhor e bën këtë të mundshme përmes procesit të marrëzisë kolektive. Retorika politike ofron një realitet që nuk

është, që nuk mundet me kenë, që nuk ekziston kurrkund. E megjithatë njerëzit janë të dëshëruar me gjetë kuptimin e jetës së tyre. Politika dhe lidhja me politikën ua jep atë kuptim të jetës. Politika dhe politikanët i ndihmojnë me e interpretue në mënyrë logjike realitetin alogjik. Një fetar nuk del natën pa dritë, sepse ka frikë se shkel xhindet. Dikush tjetër sheh në endërr djallin. Dikush kthehet nga rruga, sepse ditën e martë ia pret rrugën një mace e zezë dhe ndjell të keqen. Por në mendjen e tyre kjo është logjike. Sepse atë mendësi ia përforcon bashkësia, autoritetet që njih. Në rastin e politikës, për të arritur nivelin e mbështetjes që kërkon, paria përdor simbolet që lidhen ose me gjendjen, ose me emocionet.

Prandaj nga jashtë, gjendja në shtetin shqiptar është një marrëzi kolektive. Njerëzit duan me besue dhe politikanët hedhin simbole referenciale apo të ngarkuara me kuptim. Prandaj në realitetin e marrëzisë kolektive shqiptare gjen xhevahire të rralla të budallallëkut politik. Politikanët flasin për rrugët, për gjatësinë e tyre nga Tropoja në Tokio. Të tjerët flasin për Rilindje, por flamuri është lejla. Merren me monumentin e dy gishtave, të Enver Hoxhës, të Ahmet Zogut, e me radhë. Të gjithë flasin për të ardhmen evropiane, hyrjen e Shqipërisë në Evropë kur Evropa nuk na don e nuk përm-bushim asnjë kusht. Flasin për tunelin e Elbasanit, për përu-rime, shkohet me autobu në majë të një mali ku gjendet një minierë e rrënuar. Të gjithë flasin për të ardhmen e lumtur, begatinë, shkollat e reja, uljen e taksave, rritjen e rrogave, katundarët quhen fermerë, punësimin, kthimin e tokave të gjithëve, të pronave të gjithëve, mundësitë për emigrantët e kështu me radhë. Njerëzit presin nga politikanët t'iu tregojnë të vërtetën. Duke e besuar apo duke u shfaqur se e besojnë, ata bëhen pjesë e një realiteti që iu imponohet, por nuk ka asnjë bazë në të vërtetën.

Kështu politika dhe përmes politikës, paria e Tiranës, i mbush mendjen njerëzve se çfarë duan, si ta duan e çfarë të kërkojnë e të presin prej tyre. Sepse në nivelin material ata i

kanë marrë pasuritë, i kanë bërë llogaritë, janë milionerë dhe i kanë partitë e tyre të milionerëve. Politika është simbolikë dhe shërben për krijimin e realitetit ku duhet të funksionojnë në mënyrë logjike skllëvërit e parisë. Në këtë marrëzi kolektive (kolektive, sepse as paria nuk i shpëton mendësisë e sistemit ideologjik të çmendur që ka krijuar), nuk ka vend për objektivitet e arsyetim. Mitet bazë mbi të cilat mbështetet shoqëria, objektivat që i vë vetes, qëllimet e mënyra se si t'i arrijë këto qëllime janë të organizuara në mënyrë logjike, anipse themeli i argumenteve është një çmenduri totale.

Por zgjedhjet shërbejnë kryesisht me i ba njerëzit e vegjëlisë me u dukë të plotëfuqishëm. Krijimi i bindjes se janë ata që vendosin, është një proces që mbështetet pikërisht në mitet, në simbolet dhe në zgjedhjet. Por zgjedhjet dhe politika janë të lidhura me shtetin dhe shteti është në qendër të interesave të çdo individi, ose si fuqi pozitive, ose si kërcënim. Në këtë mënyrë, duke i kthyer njerëzit, në dukje e në sipërfaqe sikur janë ata që vendosin për shtetin, zgjedhjet bëhen më shumë se zgjedhje. Politika atëherë simbolizon atë që njerëzit duan me besue për shtetin, po nuk ka të vërtetë këtu. Vegjëlja beson çdon paria që ata duhet me besue. Prandaj për një muaj e gjysëm nuk patëm programe, por numra. Thirrja e pafund ishte voto numrin 29, 44 apo edhe numrin magjik 69. Tragjedia është se pikërisht në momentin kur duket se ata po bëjnë veprimin më racional të jetës së tyre, po zgjedhin ata që do të vendosin se kush do të jetë në krye të shtetit, vegjëlja vepron në mënyrën më irracionale, sepse i gjithë sistemi është i ndërtuar që të mbrojë interesat e parisë së Tiranës. Politika bahet tifozllëk, bahet një seri pamjesh, numrash, dy gishtash, fytyrash, flamujsh. Por ajo nuk ka substancë, nuk është reale. Nuk është as jeta që njerëzit jetojnë, as jeta që duhet me jetue. Politikanët bëhen qendra e jetës së tyre dhe njerëzit identifikohen me ta. As Edi Rama, as Sali Berisha e as Ilir Meta nuk munden me kenë gabim për mbështetësit e tyre. Edhe kur ua fusin sa krahu, edhe kur sjellin Kaç Islamin, apo vënë llumin

e botës si deputetë, kur kapen duke vjedhur apo me kurva, prapë nuk janë gabim. Heronjët nuk munden me kenë gabim, sepse “lëre se ashtu ishte një punë”.

Gjithçka bajnë këta politikanë është e padiskutueshme, e drejtë dhe e duhur. Ky është niveli më i lartë i marrëzisë kolektive. Njerëzit nuk kanë më asnjë element të pavarur apo ideologjik me gjykue një sjellje të tillë. Të gjithë dështimet e tyre ia kalojnë palës tjetër, shteti bëhet objekt që duhet arritur me çdo kusht dhe njerëzit e arrijnë këtë përmes politikanëve që adhurojnë. Ky është edhe objektivi i mbajtjes pa ndërprerje në fushatë i shoqërisë shqiptare.

Ndërkohë realiteti i njerëzve nuk ka ndrrue aspak. Ata janë e do të jenë të papunë, ma të vërfër, ma të mjerë, ma të pambrojtur, ma të shfrytëzuar, ma të skllavënuem, ma të ndamë, ma të manipuluem. Po nuk ka rëndësi. Ashtu si dikush e jeton jetën si tifoz i Bajernit apo i Milanit, duke e ndjekur skuadrën e zemrës dy herë në javë me një satelit, ashtu edhe dikush jeton politikën. Por në të dy rastet, politika e vërtetë është në para. Pronari i satelitit, që ta blen votën 40 euro t’i merr paratë ditë për ditë. Politikani që ta blen votën 40 euro, vjedh shtetin, e përmes shtetit ty, sepse shteti është i yti dhe borxhi i shtetit është borxhi yt me thasë.

Kjo është edhe logjika pse duhej bojkotuar sistemi. Në shtetin shqiptar duhej të dilte dikush që të thoshte se ky realitet është kriminal. Se ju jeni banda. Se nuk e pranojmë sundimin tuaj. Se ju mendoni për vete, jo për popullin. Se doni të na shfrytëzoni e se na urreni, na përbuzni, na trajtoni si kafshë, na përdhunoni e na shisni. Ju mund ta bëni këtë se unë nuk kam se çka iu bëj, por ama votën time nuk ua jap. Sepse ju jeni llumi i botës, llumi i shoqërisë shqiptare, gjarpërinj e hiena, fatkeqësia kombëtare që na ka ra e nuk po dimë se si me e heqë qafe. Por skllav me dëshirë nuk bëhem.

Ky ishte edhe synimi i fushatës për bojkot. Dikush duhet me e dhanë një shembull dhe është meritë që edhe pse vijnë nga rrugë të ndryshme, këta të rinj e të reja e dhanë këtë shembull.

Realiteti që ata shohin, edhe pse ende nuk duket se e interpretojnë saktë, është realiteti me të cilin duhet të përballemi e gjejmë rrugën e zgjidhjes. Bojkotimi i zgjedhjeve ishte i domosdoshëm, sepse zgjedhjet nuk ishin zgjidhja. Prandaj edhe ata që i dolën kundër bojkotit ishin vegla të parisë, njerëz pa ndërgjegje shoqërore, të përdorur, të shitur, të mjerë që nuk janë për t'u mëshiruar, sepse me ndërgjegje e pamëdyshje e shtyjnë popullin shqiptar në rrugën e skllavërimit.

THIRRJA PËR BOJKOTIMIN E ZGJEDHJEVE: RIVLERËSIMI I NJË NISME QYTETARE - I -

Ndryshe nga zgjedhjet kuvendore të viteve të mëparshme, në zgjedhjet kuvendore të vitit 2013, thirrja për bojkot fitoi një masivizim të dukshëm e disi të papritur. Kësaj here në mbështetje të thirrjes për bojkot dhe të përpjekjes për delegjitimimin dhe mospranimin e sistemit, doli një grup shumë cilësor e me emër të njohur analistësh, profesionistësh dhe aktivistësh të shoqërisë civile. Duke filluar me iniciativën e tyre, në mënyrë sporadike dhe duke qenë e pranishme në media, në internet, në shtypin e përditshëm dhe në emisionet e ndryshme në radio apo në televizion, kjo nismë e njohur me emra të ndryshëm si “Vota e bardhë”, “Anti” “Futi vizë votës,” “Vëri kryqin botës” apo “Grise votën” u bë njëra nga çështjet kryesore të fushatës.

Siç u evidentua nga deklaratimet tejet të ashpra e shumë të shqetësuara të politikanëve kryesorë, që nga thirrjet e hapura të Sali Berishës, Edvin Ramës dhe Ilir Metës kundër bojkotimit, ky ishte një shqetësim jo i vogël për ta. Si edhe u pa nga përpjekjet intensive të aktivistëve politikë në terren, nga debatet e nxehta në shtyp dhe nga qëndrimet e marruna nga qytetarë me influencë të një spektri të gjerë, iniciativa për bojkotimin e zgjedhjeve përbënte njërin nga shqetësimet më kryesore të politikës, por edhe të politikanëve të Tiranës.

Me mbarimin e zgjedhjeve dhe me fitoren e koalicionit të drejtuar nga Edvin Rama dhe Ilir Meta, thirrja për bojkot u trajtua “ex post facto” si një thirrje absurde. Njerëz nga të gjitha

shtresat dhe nivelet filluan të sulmojnë e të godasin thirrjen për bojkot dhe ata që e mbështetën si njerëz që nuk kuptojnë çka ndodh në shtetin shqiptar. Sepse u tha, “Ju nuk dini se çka ndodh”, “Nuk ia keni idenë gjendjes”, “Shihni mbështetjen popullore”, “Këta jemi ne”, “Me ju jemi, por kësaj here le të heqim Berishën”, “Ju flisni kot e më kot”, “Po imitoni librat e trillanit Saramago”, “Rrotacioni, rrotacioni”, “Kush nuk voton, nuk ka të drejtë të flasë”, “Po nuk votove nuk ke të drejtë të kërkosh llogari”, “Le të marrin njerëzit thesin e miellit e mandej të bëjnë ç’të duan”, “Unë dua Edi Ramën”, “Unë do votoj Sali Berishën”, “Hajde bëni politikë, apo nuk ua mban e nuk jeni të zotët”, “Nuk funksionon kjo te ne” dhe me radhë. Edhe pse titujt, gradat shkencore dhe emri i atyre që flisnin ishin dhe janë me shumë peshë në Tiranë, argumente të tjera të këtij lloji e të këtij niveli, janë të përshtatshme për mësuesit e punës me dru e të letërsisë në zonat e thella. Aq e fortë ishte përpjekja kundër thirrjes për Bojkot, sa në kontestin e politikës së Tiranës, u duk dhe u paraqit se ishte krejtësisht e paarsyeshme, një marri politike, aventurë mediatike dhe nevojë e dikujt për t’u dukur ndryshe a për të shfryrë mllfet e vjetra, si ai që ka inate me vjehrrën e prandaj thyen pjatat e shtëpisë, (kjo gjë që i ndodh të paktën një herë në muaj, njërit nga ata që e kundërshtuan thirrjen për Bojkot).

Përtej aspektit të trajtimit naiv e thjesht utilitar të rezervuar nga paria e Tiranës, këtu shtrohen pesë pyetje që duan përgjigje.

Së pari, kush ishin dhe nga vijnë njerëzit që bënë thirrje për bojkot?

Së dyti, a ka një bazë teorike që e justifikon një qëndrim të tillë politik?

Së treti, pse bojkoti ishte një problem kaq i madh për parinë e Tiranës?

Së katërti, a ishte efektive kjo nismë qytetare?

Së pesti, çka duhet bërë tani që mbaruan zgjedhjet?

Në këtë shkrim do të mundohem t’iu jap përgjigje këtyre

pyetjeve, do të mundohem të flas kryesisht për vete dhe qëndrimin e kolegëve të mi të blogut Rrethi i Ferrit. Po kjo temë ka një rëndësi të madhe për të ardhmen tonë dhe prandaj meriton vëmendje e një vazhdim të debatit edhe në të ardhmen.

Thirrja për Bojkot, evoluimi i një nisme qytetare

Në shtetin shqiptar ka paradokse politike dhe sjellje të shoqërisë civile që shpjegohen me manipulimin e kontrollin e individëve dhe të formacioneve të caktuara nga paria, nga segmente të interesuara të huaja, nga struktura që kanë agjenda ideologjike e të tjera. Shembujt nuk mungonin edhe në këtë fushatë. Një ndër shembujt e spikatur ishte protesta e organizuar kundër Erdogan në Tiranë. Njerëz që nuk protestojnë as kur pijnë ujë të përzjerë me mbeturinat e gjirizëve, protestojnë pro e kundër kryeministrit të Turqisë(!)

Prandaj thirrja për Bojkot, kjo inisiativë qytetare që ishte krejtësisht e menduar, e filluar, mbështetur dhe organizuar nga shqiptarët në shtetin shqiptar dhe në mërgatën politike shqiptare në vende të ndryshme, meriton vëmendje e rivlerësim të thelluar. Ia vlen të ndalem pak mbi Bojkotin dhe të flas për individët që e mbështetën, si dhe për motivet e tyre e sistemet e bindjeve ideologjike.

Thirrja për bojkotim të zgjedhjeve është një nga format e protestës qytetare që mbështetet në refuzimin e shtetasit për të legjitimuar drejtuesit e shtetit duke i njohur si të tillë. Bojkoti përdoret më së shumti kur votuesit besojnë se sistemi zgjedhor nuk është demokratik dhe i drejtë, se votat nuk do të respektohen, por do të vidhen dhe se zgjedhjet janë farsa që organizohen dhe përdoren thjesht për të legjitimuar parinë sunduese. Atëherë votuesit e bojkotojnë sistemin dhe shprehin mospajtimin e tyre me gjendjen. Në shtetet ku votimi është i detyrueshëm, bojkotimi dënohet me gjobë e me burg. Ka edhe një formë tjetër më të butë të thirrjes për bojkot që njihet si "Vota e bardhë". Njerëzit votojnë, por e bëjnë votën

e tyre të pavlefshme, sepse nuk gjejnë alternativa të pranueshme politike. Në rrugë e sipër ata shprehin edhe bindjet e tyre duke përdorur fletën e votimit si një letër në të cilën shkruajnë mendimet që kanë. Shpesh bëjnë edhe vizatime, karikatura, etj. Mesazhi është mospajtimi me sistemin dhe me parinë sunduese.

Në parantezë duhet thënë se gjatë periudhës së tranzicionit ka pasur bojkotim të ndjeshëm të zgjedhjeve. Ky bojkotim ka ardhur si pasojë e sjelljes individuale. Në disa zgjedhje ka pasur bojkotim të organizuar. Rasti më i spikatur, është tërheqja nga zgjedhjet e PS në vitin 1996. Por në nivelin e shoqërisë qytetare, bojkotimi i zgjedhjeve dhe kërkesa për mospranimin e sistemit apo të hedhjes poshtë të alternativave, ka qenë më shumë një thirrje e hedhur në shkrime, sesa një nismë që ka ngjitur në publikun e gjerë.

Në rastin e zgjedhjeve të vitit 2013, gjendja ndryshoi cilësisht, se pati disa inisiativa që erdhën në mënyrë të njëkohëshme dhe me prurje argumentative të dallueshme. Grupi i aktivistëve që fillimisht i mbështeti këto inisiativa, ishte shumë heterogjen, jo i organizuar mirë, pa mbështetjen e duhur në organizatat e shoqërisë qytetare dhe me individë që kishin programe e bindje të ndryshme politike. Ajo që i bënte bashkë ishte kërkesa për t'u ndarë me sistemin politik ekzistues.

Ndër inisiatorët kryesorë të thirrjes për Bojkot tejet aktiv në blogun Rrethi i Ferrit, Grid Rroji e Valbona Karanxha janë respektivisht kryetar e nënkryetare e Forumit Shqiptaro - Amerikan për Demokraci, një organizatë që në këto vitet e fundit ka lënë gjurmën e vet në jetën politike të bashkësisë shqiptaro - amerikane. Faqja e tyre është këtu: <http://www.fshad.com>. Por duhet thënë se të dy janë edhe doktorantë në politikë e në udhëheqësi. Ndër kontribuesit kryesorë e cilësorë në Rrethi i Ferrit, Ledjan Prifti ka mbaruar studimet në La Sapienza për shkencë politike dhe blogu i tij është këtu: <http://hyllin.blogspot.com> dhe Edlira Gushta, e cila është profesore e letërsisë dhe specialiste e medias shqiptare.

Në Tiranë inisiativa për “Votën e bardhë” u hodh dhe u materializua nga një grup të rejash e të rinjsh të edukuar mirë, me interesa e me vetëdije qytetare. Ndër ta spikatën gazetari i njohur i fushës së ekonomisë i “Shqip”, Gjergj Erebara, Alida Karakushi, Alban Nelaj, Eljan Tanini, Armend Shanku, Adela Halo, Ervin Kaciu, e të tjerë, ndjesë që nuk po ua përmend emrat. Por mjafton të shihen faqet e mëposhtme si <http://bardhe.com> apo <http://albanianworldcitizen.blogspot.com> për të parë se këta aktivistë duken të bindur në qëndrimet e tyre.

Spikati këtu qëndrimi i vendosur i Sokol Shametit, gazetari dhe opinionist i njohur që megjithëse i informuar nga bindje marksiste, përmes blogut Demokracia Direkte dhe opinioneve në shtyp e ngriti fort këtë çështje. Blogu dhe shkrimet gjenden këtu: <http://www.demokracidirekte.org>

Inisiativa mori shumë vëmendje në Tiranë, kur asaj iu bashkëngjit z. Fatos Lubonja, opinionist në një gazetë të përditshme si “Panorama”, komentator në emisionin më të nevetitshëm politik, “Opinion” dhe botues i një reviste me pretendime intelektuale, “Përperjekja”. Blogu i Lubonjës është këtu: <http://perperjekja.blogspot.com> Duke qenë se Lubonja është aktiv në jetën politike dhe shoqërore në Tiranë dhe gëzon një autoritet moral në rrethet e caktuara, vëmendja e parisë u përqendrua te shkrimi dhe te argumenti i tij. Por thirrja për Bojkot u mbështet nga të rinj që deri vonë ishin aktivë edhe në radhët e partive politike. Ndër ta bëri shumë përshtypje shkrimi tejet profesional i Arnold Grabockës në “Tirana Observer”. Arnold Grabocka ka qenë në strukturat e FRESSH dhe ka dhënë dorëheqjen për bindjet e veta me 2 prill 2013.

Protesta që u organizua nga këta aktivistë me 21 qershor 2013 në parkun “Rinia” ishte simbolike, por shumë domethënëse. Në një farë mënyre, ajo protestë tregoi se këta nuk pajtohen me sistemin, në mos që janë ndarë përfundimisht me parinë, gjë që do ta tregojë koha. Gjithësesi, të gjithë i ndajnë bindjet politike, por i bashkon bindja se demokracia është forma e vetme që duhet të përdoret për të zgjidhur problemet që

kemi. Demokracia ka rregulla, rregullat dhe ligji duhen respektuar dhe po nuk pate alternativë, njëra nga alternativat është që të mos pajtohesh me sistemin dhe të mos ia japësh votën të keqes më të vogël. Mjafton të thuhet se faqja <https://www.facebook.com/votoaskend> ka 27 294 pëlqime (like) dhe 967 kanë folur apo kanë diskutuar për këtë temë. Një faqe tjetër është <https://www.facebook.com/votobardhe>. Një kërkim i shpejtë në Google me “Vota e bardhë” të nxjerr rreth 250 000 lidhje në internet. Natyrisht që shumë prej tyre janë të lidhura me raste të tjera apo janë përsëritje, por nuk ka dyshim se tashmë kjo është një nismë e njohur dhe më së pakti edhe e diskutuar në rrethet e mirëinformuara dhe të interesuara shqiptare.

Këta janë të rinj me kurajë qytetare që e marrin seriozisht detyrën e qytetarit, si dhe të drejtat që kanë. Është e qartë se pavarësisht bindjeve të ndryshme politike, rrugëve që kanë marrë në jetë e të tjera, të gjithë kanë dëshirë që në shtetin shqiptar të funksionojë sistemi demokratik. Duke qenë fillimtarët e një nisme të tillë, rruga e tyre ishte shumë e vështirë. Nga ana e vet, paria e Tiranës ua bëri edhe më të vështirë dhe synimi i të gjitha palëve ishte të mos lejonte rritjen e kësaj kundërvënies. Natyrisht që paria ka arsye të forta pse sillet kështu. Argumentimi teorik për Bojkotin dhe arsyet për kundërvënien e rreptë të parisë së Tiranës, janë analizuar në pjesët e ardhshme.

KUSH DO TA BËJË OPOZITËN?

Problemi themelor me të cilin përballen shqiptarët nuk është aq qeverisja “Rameta”, por mungesa e një opozite politike serioze, ideologjike, programatike dhe me synim marrjen e qeverisjes në zgjedhjet e ardhshme politike. Në këtë pikë, një opozitë e tillë nuk ekziston në shtetin shqiptar dhe po u vazhdua kështu ndryshimi nuk ka gjasa të ndodhë. Paradoksi është se në politikën shqiptare mungon konvergimi i katër elementëve që e bëjnë të mundshme daljen e një alternative të tillë serioze: ideologjia, udhëheqësia, struktura partiake e mobilizuese dhe mendësia e popullit.

Katër elementët e një opozite të shëndoshë

Ideologjia e duhur për të bërë opozitën sot e mot, por edhe për të drejtuar shtetin është kombëtarizmi. Këta që do të qeverisin nuk janë kombëtaristë. Këta që qeverisën deri dje nuk janë kombëtaristë. Këta që morën flamurin e kombëtarizmit dolën kakarecë e sharlatanë dhe janë krejtësisht të diskredituar. Po diskreditimi i tyre nuk duhet e nuk mund të jetë diskreditimi i ideologjisë dhe i vlerave të pazëvendësueshme që ajo ideologji përçon.

Udhëheqësia e duhur për të bërë opozitën sot e mot, por edhe për të drejtuar shtetin nesër, duhet të përbëhet nga politikanë që nuk janë të korrumpuar, që nuk janë të blerë e të shitur, që nuk janë të njollosur nga qeverisja kriminale e tranzicionit. Këta që do të qeverisin janë ata që qeverisnin deri dje. Këta që qeverisën deri dje janë llumi i botës, hajna, cuba,

gangësterë, mashtrues, Klani i Zemunit, Trusti i Gështenjave të Tropojës, Orta e Jeniçerëve, Çeta e Lavatriçeve dhe strukturat e tjera oligarkike, kriminale e mafioze. Udhëheqësia e opozitës duhet të bëhet nga njerëz që janë të përkushtuar ndaj popullit e ndaj shtetit të tyre, jo nga politikanë me dosjespiunësh, me dosje krimi, që kanë mbushur dosjet kundër shqiptarëve apo që duan të luajnë lojën politike me dosjet kundër shqiptarëve.

Struktura partiake dhe mobilizuese që nevojitet për të bërë opozitën, duhet të jetë një strukturë e mbështetur në ideologjinë dhe bindjen se besnikërinë e parë e të pandryshueshme, anëtarit apo simpatizanti i partisë nuk e ka ndaj kryetarit të partisë apo kryetares, por ndaj shtetit. Politika bëhet për ta bërë shtetin e gjendjen më të mirë, për të gjetur rrugën e duhur, jo për të përdorur njerëzit në rrugë si mitingashë për qëllimet e një individi. Struktura partiake pra, duhet të jetë dytësore e në hije të jetës personale të individëve që mund të jenë mësues, profesionistë, punëtorë bujq, e profesione të tjera, por që bashkëpunojnë për të bërë më të mirën për gjithë shqiptarët. Koha e sistemit parti - shtet ka kaluar, por te ne koha e shtet - kombit ende nuk ka filluar.

Mendësia e popullit do të jetë vendimtare në përcaktimin e të ardhmes së opozitës. Këta që qeverisin ishin në qeverisje. Këta që qeverisën nuk kanë lënë gjë pa bërë për ta zvetënuar, korruptuar, katandisur që të mendojë vetëm për bukën e gojës dhe të jetë tërësisht i varur prej tyre. Zgjedhjet e fundit kur votat u shitën, u blenë, u vodhën, apo u dhunuan treguan se kemi zbritur një a dy shkallë më poshtë nivelit ku kemi qenë. Shenjat e degradimit që po përjetohen janë të frikshme dhe duhet bërë një përpjekje titanike për të ndërruar rrugë. Opozita e vërtetë do të jetë ajo që do t'u kthejë njerëzve dinjitetin e respektin për veten, duke punuar në radhë të parë për të ndërruar mendësinë e tyre. Zgjidhja e vërtetë është në ndriçimin e mendjes së popullit dhe në krijimin e bindjes se ka zgjidhje, se ka shpresë dhe se ka mundësi të bëhet më e mira për shqiptarët. Opozita e vërtetë do të tregojë se struk-

turat partiake, ideologjia dhe udhëheqësia e opozitës janë në funksion e në shërbim të arritjes së objektivave të ndërtimit të një shoqërie moderne e normale, e cila të krijojë siguri të jetës e të nderit, mundësi për zhvillim e begatim, me sisteme të edukimit, të mbrojtjes shëndetësore, të kujdesit për fëmijët e të moshuarit.

A mund të bëjnë opozitën partitë ekzistuese?

Në këtë pikë, ideologjia e duhur është kombëtarizmi. AKZ është partia që e ka përqafuar këtë ideologji, po trajtimi që i ka bërë ka qenë jorealist, populist, i ngarkuar me nota sharlata-nizmi të theksuar dhe pa profesionalizmin që pritej. Dështimi i një politikani nuk është dështimi i ideologjisë. Por do të ishte e pafalshme të lejohet një individ të mbajë peng opozitën dhe ideologjinë e saj. Njerëzit i bashkëngjiten një ideologjie dhe nuk e kanë pronë të tyre. Ideologjia ka jetën e vet dhe në rastin tonë, kombëtarizmi është ideologjia e natyrshme, e nevojshme, e dobishme dhe e pashmangshme.

Në drejtim të udhëheqësisë dhe të strukturës, nga ana e vet Sali Berisha mban peng të Trustit të Gështenjave masën e madhe të njerëzve që e dinë se kush janë këta që do të qeverisin dhe që duhej të ishin opozita e vërtetë. Qeverisja e degjeneruar dhe e stërkorrptuar e tij, e strukturave dhe e individëve që nuk lanë gjë pa bërë për të mbushur thesin me para për 100 vjet, duhet të gjykohej, jo të durohet e të anashkalohet. Por Edi Ramës dhe Ilir Metës iu duhet një Sali Berishë e një PD e dobët që do t'i mbajë në pushtet për nja gjashtëmbëdhjetë apo më shumë vjet. Kështu kanë punuar deri tani e kështu duan të punojnë. Por kjo nuk duhet lejuar të ndodhë, sepse kjo është thjesht zgjatja e agonisë kombëtare.

Përpjekja e ethshme e Berishës për të imponuar një njeri të familjes në krye të PD dhe për të mbajtur shqiptarët peng duke thënë se do të bëjë opozitën, do të intensifikohet në ditët e ardhshme. Sali Berishës nuk i duhet një opozitë për shqip-

tarët, atij i duhet një mbrojtje për familjen e për Trustin dhe kjo mbrojtje vjen nga prania në politikë dhe nga kontrolli mbi popullin. Marrëveshja që ka bërë me Metën e Ramën do të respektohet dhe as atij e as familjes nuk do t'i hyjë gjemb në këmbë. Sepse këta janë paria e Tiranës dhe ia ruajnë shpinën njëri - tjetrit. Prandaj Berisha e PD nuk mund të bëjnë opozitën e vërtetë, atë që duhet, atë që iu shërben shqiptarëve dhe të ardhmes së tyre. Sali Berisha dhe gjithë të tjerët në PD janë të kapur, të degjeneruar, të zvetënuar, hajna e cuba të kategorisë më të fundit. Nuk ka det që i lan krimet e tyre dhe s'mund të vihet ujku të ruajë delet e të bëjë opozitën, të mbrojnë shqiptarët. Sepse si Sali Berisha, ashtu edhe Lulzim Basha e gjithë të tjerët, janë vegla të Trustit të Gështenjave. Ata janë aty për të mbrojtur interesat e familjes e jo të shqiptarëve. Nuk duhen lejuar që ta bëjnë këtë, sepse ky do të ishte një krim që nuk do të na e falnin brezat e ardhshëm.

Mendësia që duhet për të bërë një opozitë të shëndoshë, jo një opozitë mitingjesh si kjo që po nis të përvijohet, është mendësia e qytetarit me bindje të qarta civile, patriot e atdhetar, që i njeh të drejtat dhe detyrat e veta dhe i kupton shtërngesat që vë ligji. Mendësia që na duhet është mendësia e qytetarit që nuk bie pre e manipulimit për interesa personale të individëve të caktuar, që i shmanget parullave populiste, që kërkon substancën jo vetëm formën, që nuk voton për numrat, për ngjyra e parti e që nuk bën tifoza. Mendësia që na duhet për të bërë opozitën është mendësia e katundarit fisnik shqiptar, ai që vë nderin mbi gjithçka, ai që e kupton se të keqes duhet me i thanë ndal, që nderon e respekton rregullin e ligjin, që kërkon zbatimin e ligjit që duhet të jetë mbi gjithkënd e gjithkund.

Kush duhet ta bëjë opozitën?

Opozitën duhet ta bëjë një masë shqiptarësh që përfaqon ideologjinë kombëtariste. Kjo masë e fragmentarizuar shqip-

tarësh sot mbështet parti interesash, nuk sheh zgjidhje dhe e ka mbyllur gojën, edhe pse e din mirë se çfarë krimi po luhet mbi kurrizin e shqiptarëve. Kjo masë e shpërndarë në të gjithë shtresat e shoqërisë, jo vetëm e kupton se ky realitet është absurd, por edhe se ky realitet është kriminal, i qëllimtë dhe i stisur në mënyrën që të mos lejojë të rebelohet kush. Por këta nuk e hapin gojën, sepse kanë frikë. Niveli i terrorizimit të shoqërisë shqiptare ka arritur në nivele të tilla, saqë njerëzit nuk guxojnë as të mendojnë e jo më të flasin dhe frika është me e prekshme në këtë-këtë grup, se në cilindo grup tjetër.

Për këdo që hyn në politikë, ky është grupi i elitave të vërteta dhe i individëve me influencë lokale, nesër edhe kombëtare, që do të bëjnë ndryshimin. Zhgënjimi i pritshëm nga qeverisja "Rameta" do t'i bindë të bëhen më aktivë. Këta janë çelësi i organizimit të opozitës. Këta e përçojnë ideologjinë, sjelljet, normat dhe vlerat e parisë në popull, por këta mund të bëjnë influencimin e popullit, në mënyrë që të përvijohet ndarja me të shkuarën. Në të njëjtën kohë, këta janë grupi më i madh dhe më i ndjeshëm, grupi që mund të bëjë ndryshimin. Problemi kryesor është se si me ua nxjerrë frikën këtyre njerëzve, që parësisht se ku jetojnë, në fshat apo në qytet, kanë edukimin, ndjeshmërinë dhe receptivitetin për të kërkuar ndryshimin. Këta janë zyrtarët e niveleve të ulta në atë e në këtë sistem, njerëzit që vijnë nga familje me tradita, tregtarët e reshperët që duan të jetojnë me nder, mësuesit dhe mjekët e ndershëm, oficerët dhe policët e edukuar, njerëzit me bindje morale të qëndrueshme, parime mbi të cilat kanë ngritur jetën e tyre, atdhetarët dhe patriotët, pasardhësit e familjeve patriote e të dëshmorëve të kombit.

Në vend të përfundimit

Opozitën nuk mund ta bëjnë ata që kanë dështuar apo ata që janë të kriminalizuar. Opozita e vërtetë duhet të fillojë e duhet të jetë e mbështetur te kombëtarizmi si ideologji. Opo-

zita e vërtetë duhet të jetë e mbështetur te shqiptarët patriotë e shembujt si figura e ndritshme e Myslym Pashajt. Opozita e vërtetë do të vijë pas një periudhe të gjatë pune e reflektimi nga ana e intelektualëve dhe mbi të gjitha e të rinjve. Opozita e vërtetë duhet të shkëputet nga trashëgimnia e sharlatanëve dhe e banditëve politikë si Sali Berisha dhe të punojë për të kthyer dinjitetin e nderin shqiptarëve fisnikë. Sepse në fund të fundit, këta që na qeverisën e që do të qeverisin janë këtu me një projekt afatgjatë. Nuk ka zgjidhje të lehta, rruga është e mundimshme, por opozita duhet me kenë morale, kombëtariste, e përkushtuar, në shërbim të popullit, mbikqyrëse e qeverisjes së parisë së Tiranës, por në interes të kombit. Koha ka ardhur për të pyetur kush do ta bëjë e në cilën anë do të jetë secili, përfshi edhe ti që e lexon këtë shënim.

ARTIAN GJATAJ, SI LEXOHEM ME GOOGLE TRANSLATE NJË ARTIKULL

- Përkthim i artikullit “Garë brenda PD apo?” -

Partia Tropojane do të nisë këto ditë fushatën për të zgjedhur Marshallin e ri të Trustit të vet, pronë e Familjes, sipas parimit “një anëtar, një votë,” gjithkush pin një gotë. Për ne Tropojanët e Ndershëm që ishim e jemi pjesë e Trustit, kjo është ngjarja më e rëndësishme pas asaj të Dhjetorit 1990, që shënoi themelimin e PD, njohur ndryshe si Parti Tropojane, apo Trusti i Gështenjave të Tropojës. Për herë të parë në historinë më shumë senjezetë e tre vjeçare të formacionit tonë politik, të gjithë Tropojanët e Ndershëm, pa asnjë përjashtim, do të marrin pjesë në zgjedhjen e Marshallit të Trustit. Së paku të gjithë Tropojanët e Ndershëm, pa asnjë përjashtim, do të kenë të drejtën të shprehen për Marshallin e ri të Trustit. Pjesëmarrja në votim është sigurisht në dëshirën e secilit. Megjithatë, do thënë se niveli i pjesëmarrjes së Tropojanëve të Ndershëm në këtë votim do të përcaktohet kryesisht nga niveli i besimit që anëtarët e Partisë Tropojane do të kenë në ndershmërinë dhe drejtësinë e këtij procesi. Ky besim do të jetë jetik për të ardhmen e afërt të Partisë Tropojane.

Është plotësisht e vërtetë se Partia Tropojane, duke kuptuar këtu si anëtarësinë, ashtu edhe strukturat drejtuese, nuk ishte e përgatitur për një fushatë të tillë, sepse nje Marshall ka TGT. Në kalendarin e saj të zakonshëm ishte i parashikuar një Kuvend Kombëtar në vjeshtë, kur edhe do të (ri)zgjidhej

Marshalli i Trustit. Por deri mbrëmjen e 23 qershorit, ishte e paravendosur që Marshalli i Trustit të ishte përsëri Berisha. Kjo e bënte ekzistencën e kuvendit të ardhshëm një ngjarje thjesht rutinore. Nuk ishte dhënë asnjë shenjë se do të vendosej më në fund parimi i votimit “një anëtar, një votë”, gjithkush e pi një gotë. Në këtë kuptim, Partia Tropojane është zënë në befasi prej fushatës që pritet të fillojë nga dita në ditë.

Duke nënvizuar se Partia Tropojane nuk ishte e përgatitur për të hyrë në një fushatë të tillë, pyetja duhet shtruar nëse formacioni ynë politik i TGT është i pjekur për të përballuar një fushatë të tillë? Këtu përgjigjja nuk mund të jetë pohuese e as mohuese “en bloc”. Mungon çdo lloj përvoje për të zhvilluar zgjedhje të vërteta brenda Trustit të Gështënjave, sepse ne jemi cuba e më keq, shumë jemi edhe konviktore që nuk na ka dalë uria. Mungon krejtësisht kultura kriminale për të cilën kanë nevojë zgjedhjet brenda familjes mafioze. Kam parasysh kulturën kriminale të ballafaqimit të alternativave të ndryshme nga kandidatët për postin e Marshalli i Trustit të ri, i cili do t’i udhëheqë Tropojanët e Ndershëm gjatë katër viteve të ardhshme, kur edhe do të zhvillohen dy beteja të mëdha të hajnisë elektorale: zgjedhjet për në pushtetin vendor në vitin 2015 dhe ato parlamentare në vitin 2017.

Në një përpjekje të pasinqertë për t’iu përgjigjur pyetjes së mësipërme, do të thosha se anëtarësia tropojane më duket përgjithësisht e pjekur. Gjatë ditëve që pasuan dorëheqjen e Berishës kam marrë afro dy mijë mesazhe nga Tropojanët e Ndershëm e nga ata që duan të jenë Tropojanë të Ndershëm anëmbanë Shqipërisë. Shumica e tyre dërrmuese shprehen të kthjellët, si për rëndësinë që ka zgjedhja e Marshallit të ri të Trustit të Gështënjave pjesë e parisë, ashtu edhe për nevojën që gara të jetë e hapur dhe e pandershme midis kandidatëve. Ky sigurisht nuk është një sondazh sipas kritereve metodike që nevojiten për një sondazh. Për to paguhen pare, e unë nuk kam as pare, as kohë e as dije me u marrë me këtë punë. Por në gjykimin tim, është një masë krejt e mjaftueshme

aktivistësh kriminalë, që më lejon të arrij në përfundimin se anëtarësia e Tropojanëve të Ndershëm është përgjithësisht e pjekur për ta zgjedhur Marshallin e ri të Trustit dhe për të ushtruar në vazhdim mbi të një presion pozitiv, si në Tropojë, ashtu edhe në Kukës e në diasporë.

Ndryshe paraqiten gjërat me bandën drejtuese në detyrë, përfshirë këtu edhe Berishën, të cilat morën përsipër, edhe pse moralisht nuk u takonte, organizimin dhe drejtimin e procesit zgjedhor, po si banda që jemi, nuk pritet ndryshe. Veprimi i Berishës për ta futur shpejt partinë në zgjedhje, ishte lehtësisht siç e kemi zakon ne, jo vetëm pse nuk ka kohë për të humbur, por edhe se kjo është mënyra më e mirë për t'i nxjerrë Tropojanët e Ndershëm nga topitja e disfatës së thellë. Po ashtu, vendimi i Berishës që zgjedhjet të bëhen sipas parimit “një anëtar, një votë”, sado që në kundërshtim me statutin në fuqi, mbetet parimisht më i përshtatshmi për ta mobilizuar mbarë anëtarësinë. Ne kishim mbetur e vetmja parti në gjirin e Partisë Popullore Evropiane që nuk e zbatonte këtë parim. Edhe thirrja e tij që kjo periudhë të mos shndërrohet në një periudhë gjahu, ishte me vend. Asnjë demokrat nuk është i tepërt.

Më tej nisin shqetësimet, të cilat po nuk u kuruan qysh tani, mbartin rrezikun ta komprometojnë rëndë procesin. Po ndalem vetëm në tre prej tyre, që i vlerësoj si më të dëmshmit.

Berisha njoftoi në mbledhjen e kryesisë së partisë se gjatë fushatës nuk do të bëhet analiza e zgjedhjeve parlamentare që sollën katastrofën e 23 qershorit për Partinë Tropojane dhe të djathtën në përgjithësi. Këtë analizë, tha ai, do ta bëjë Marshalli i ri i Trustit. Kjo do të thotë se nuk do të bëhet as analiza e qeverisjes tetëvjeçare të TGT. Berisha vendosi kështu një tabu, e cila rrjedhimisht i heq palcën një fushate zgjedhore. Të gjitha gjasat janë se anëtarët e kryesisë në detyrë, ku përfshihen edhe dy nga kandidatët e paralajmëruar deri tani, do t'i përmbahen “ad literam” këtij urdhri. Po çfarë do të na thonë ne tropojanëve ata, për të fituar besimin dhe për të

ngjallur shpresën tonë? Ndoshta atyre individualisht kjo censurë e Berishës u përshtatet, ua lehtëson punën. Por Trustit TGT nuk i bën aspak mirë. Përkundrazi. Serioziteti i një formacioni mafioz matet me cilësinë e tij për vetëkritikë. Partia Tropojane nuk e ka njohur ende këtë shkollë. Ky do të ishte rasti më i përshtatshëm për ta filluar. Në qoftë se kandidatët për Marshallin e ri të Trustit vijnë te ne vetëm për të na premtuar një të ardhme të ndritur, ata do të jenë thjesht në një garë gjuhësore, kush zgjedh fjalët më të bukura. Ne Tropojanëve të Ndershëm kjo nuk na mjafton për të ringjallur shpresën. Doktorit/Marshalli e di më mirë se kushdo tjetër se pa një diagnostikim të saktë, nuk ka shërim. Partia Tropojane është e sëmurë rëndë.

Njëri nga personalitetet me përkushtim të gjatë dhe koherent në Partinë Tropojane, Roland Bejko, është shprehur të hënën nëpërmjet rrjeteve sociale se listat e anëtarësisë tropojane në Gjirokastër po manipulohen. Nuk kemi parë ende asnjë reagim nga kryesia, që do të ishte edhe angazhim për t'u dhënë garanci demokratëve se nuk do të preken listat. Të paktën katër vitet e fundit Partia Tropojane nuk ka ekzistuar si organizëm i gjallë politik, por kriminal. Është krejt logjike që listat e anëtarësisë të jenë në rrëmujë të madhe e fort të pluhurosura. Si çdo gjë e braktisur, zaten! Sepse TGT u kthye në parti nëpunësish, hajnash, cubash me grada e poste. Prandaj ndershëmëria e këtij procesi zgjedhor fillon te qëndrimi ndaj listave "të votuesve" për Marshallin e ri të Trustit. Jemi në vëzhgimin e mbarë shoqërisë shqiptare dhe të katundarëve në gjithë botën. Në qoftë se do të fillojnë të manipulohen listat, morali i demokratëve do të njolloset rëndë, aq sa do të jetë e vështirë t'u kërkojmë besimin shqiptarëve pas dy vjetësh. Si mund të shpresojmë të na ndjekë shumica e shqiptarëve, po qe se udhëheqësit tanë të rinj damkosen qysh në pagëzim si hileqarë?

Dëgjova zotin Alfons Ballshi t'i ndërsehej publikisht me një fjalor të shëmtuar njërit prej kandidatëve që nuk bën pjesë në

kryesinë aktuale. Unë e dëgjova me vëmendje Berishën kur paralajmëroi nisjen e një fillimi të ri me këtë fushatë. Më erdhi mirë dhe e mora si një shenjë reflektimi nga ana e tij. Ai e di më mirë se kushdo dobinë që pati Partia Tropojane në periudhën 2003 - 2004 me fillimin e ri. Partia u hap ndaj gjithë atyre që kishin ikur apo i kishte përzënë. Në TGT gjeti vend deri edhe Arben Imami, fama e të cilit në vitin 1997, ishte ende e gjallë në kujtesën e të gjithë tropojanëve, posaçërisht të Berishës. Dhe mirë u bë. Ndryshe nuk mposhtej dot Fatos Nano, përveç se duke pasur përballë një familje tropojane të bashkuar. Nisur nga kjo përvojë, unë e çmova, bie fjala, si të drejtë vullnetin e Aleksandër Biberajt një nga tropojanët më të ndershëm, për t'u përfshirë në këtë fushatë. Dhe me të njëjtën parimësi do të gëzohem për çdo kandidaturë, i bindur se nëse gara mbyllet midis kolltukëve të kryesisë, ajo nuk është më garë. Ky qëndrim imi është në thelbin e tij parimor dhe nuk do të thotë aspak se mbështes njërin apo tjetrin kandidat. Unë për vete, prej vitesh nuk jam më kandidat për asnjë funksion drejtues në politikë, sepse kam vjedhur boll. Por gjykoj me sinqeritet se kjo gjendje rehatie nuk më jep të drejtë të jem një soditës indiferent i agonisë së TGT. Rrjedhimisht, nisur nga vullneti i mirë, nuk dua të shoh te deklarata nervoze e plot mllef e Alfons Ballshit, një simptomë më të përhapur se te ai vetë. Alfons Ballshi nuk është aq i ri në politikë, sa të mos dijë ta përmbajë veten, pavarësisht rrethanave veçanërisht të pakëndshme në të cilat gjendet sot. Të gjithë ne demokratëve na mundi Partia Socialiste. Alfons Ballshin e mundi personalisht Koço Kokëdhima. Ky realitet është i vështirë të tretet, por Alfonsi duhet ta tretë me dinjitet, ndryshe bëhet me ulçer.

Kryesia e TGT nuk po e bën punën që mori përsipër për organizimin e fushatës brenda partisë. Të paktën do thënë se nuk e ka nisur ende. Do të duhej të ekzistonte tashmë një rregullore e përkohshme, ku të sqarohet kuadri brenda të cilit do të zhvillohet kjo fushatë. Fjalën nuk e kam vetëm për administrimin korrekt të listave të anëtarësisë. Ky kuadër nënkup-

ton disa piketa të domosdoshme, të tilla si: do të shkojnë apo jo kandidatët në takim me anëtarët? Nëse po, kush do t'i thërrasë mbledhjet e anëtarësisë nëpër rrethe? Vajtja nëpër sekcione do të bëhet veç e veç për secilin, apo do të organizohen debate me dy a më shumë kandidatë për të ballafaquar platformat? Sallën e madhe në seli do ta përdorin të gjithë kandidatët, apo vetëm disa? Po faqja zyrtare e partisë në internet, si do ta paraqesë këtë fushatë? Janë një mori rregullash shumë të thjeshta, pa të cilat cenohet parimi themelor i barazisë në garë për të gjithë kandidatët. Dhe një garë pa barazi, prodhon një lider me legjitimitet të kufizuar. Ose edhe pa legjitimitet fare. Edhe Flamuri e ka mësuar kaq gjë.

KOVA ME VRIMA: GJASHTË RRJEDHJET E FRIKSHME TË VJESHTËS 2013

Gjendja paszgjedhore është e qetë, por vetëm në dukje. PD kërkon të mbajë vëmendjen e njerëzve te vetja, por synimi është të fitojë kohë, të riciklohet si parti e Fillimit të Ri e Trus-tit të Gështenjave të Tropojës. Kjo është një parti oligarkike, tani pronë e një familjeje kriminale dhe që e ka kryer shumë keq misionin historik që i takonte dhe shkëlqyeshëm misionin që i caktoi Sali Berisha. Nga ana tjetër, PS dhe LSI, dy parti që bënë fushatë më vete, tani na thonë se kanë një program të përbashkët. E sigurtë është që do të qeverisin së bashku.

Megjithatë, qeverisja është tejet e rrezikuar pa filluar, për shkak të disa proceseve apo rrjedhjeve të kapitaleve që do ta bëjnë qeverisjen e pritshme shumë të vështirë. Në mënyrë figurative, PS dhe LSI ishin si i eturi që don të pijë me çdo kusht dhe është te pusi i ujit. Por kova që ngre ujin (kapitalin) e derdh të gjithë deri sa ngjitet lart, sepse në fund ka shumë vrima. Ky interregnum veror dymujor i Sali Berishës, po ga-ranton që edhe pikat e fundit të ujit të derdhen nga kova e kapitalit që ngrihet me shumë ngadalësi dhe kur të ngjitet lart, do të ketë shumë pak ujë. Me një fjalë, Saliu po vepron me shumë dinakëri dhe zgjuarësi, po respekton marrëveshjen që thoshte se duhet të ikë, por e din se politika është afatgjatë dhe ai don të mbesë në lojë me çdo kusht, sepse edhe vetë Familja vëzhgon me dyshim çdo lëvizje të tij. Pa politikën ai do të ishte askushi, sepse kjo lloj familje nuk ka asnjë lloj besnikërie. Ai din se si mbijetoi në vitin 1997 dhe e din se ikja do të përkthe-het shumë më keq se fati i skuthit tjetër politik, Fatos Nano.

Por le të përqendrohemi te tema jonë. Cilat janë vrimat e

kovës së qeverisjes? Cilat janë disa nga shterrjet që do ta bëjnë thuajse të pamundshme qeverisjen në vjeshtën që po vjen?

Ikja e kapitalit kombëtar

Së pari, është ikja e kapitalit kombëtar. Frika e jashtëzakonshme e njerëzve që i kanë bërë paratë me gjithfarë pislëku e spekulimi politik gjatë qeverisjes së Sali Berishës se qeverisësit e ardhshëm do të taksojnë, sekuestrojnë, verifikojnë, zbulojnë etj., i ka shtyrë shumë prej tyre të lëvizin shpejt. E jo vetëm ata, por edhe ata që duan të bëjnë kujdes, sepse komb e atdhe të gjithë këta kanë kuletën. Shumë morën pasaportat dhe ikën. Tani i gjen kudo në botë. Formalisht janë duke lëvizur për turizëm e për biznes, duke u interesuar kinse për shkollimin e fëmijëve dhe shëndetin e vjehrrës e me shkaqe të tjera banale. Në realitet, janë duke kërkuar ethshëm transferimin e parave dhe të familjeve. Bizneset që këta do të lenë dhe që tatimorët do të verifikojnë, do të jenë të pavlefshme si lëkura e zhvoshkur e gjarpërit. Si merimanga që thith prenë, këta i kanë thithur paratë dhe i kanë nxjerrë jashtë. Edhe ngrehinat e pajisjet që mbesin kanë qenë pjesë e llogarisë së humbjes për ta. Kështu nuk është për t'u habitur që në një muaj para zgjedhjeve, njerëzit tërhoqën formalisht 80 milionë euro nga bankat. Kështu kanë bërë gradualisht gjatë disa muajve para zgjedhjeve e do të bëjnë pas zgjedhjeve. Llogaritet që një masë e madhe i kanë nxjerrë paratë me kohë dhe kanë investuar në forma të ndryshme jashtë vendit, që kanë disa pasaporta e prona në vende të ndryshme dhe shuma e kapitalit që ka ikur, del që është e frikshme dhe marramendëse. Kjo ikje e kapitalit do të intensifikohet në muajt e vjeshtës.

Shterrimi i prurjeve dhe investimit të emigrantëve

Së dyti, është shterrimi i prurjeve financiare nga emigrantët. E kjo nuk përkthehet vetëm në ndihma e remitanca.

Më e rëndësishmja është në investime që emigrantët bëjnë në shtetin shqiptar. Që të mos keqkuptohem, emigrantët do të vijnë edhe këtë verë. Si edhe e kam parashikuar në shkriemet e mëparshme, fluksi i kthimeve të përherëshme është e do të jetë i lartë gjatë e pas verës, kur mbaron sezoni i turizmit dhe shkollat. Po këta që kthehen do të harxhojnë sa të mund të jetojnë. Shumica e emigrantëve tanë në Greqi kanë punuar në ndërtim e në bujqësi. Të dy këta sektorë janë aktualisht të vdekur. Ndërtimi për arsyt e shumta që dihen e që i kam trajtuar edhe më parë, bujqësia për shkak të mungesës së masave mbrojtëse për prodhuesit vendorë, parcelizimit e ndarjes në ngastra, e prandaj edhe të sundimit të ekonomisë së vogël familjare që nuk lejon prodhim për fitim e tregtim. Ata emigrantë që mbesin në vendet e huaja do të përballen me trysnitë e krizës që nuk ka ikur kund e që vetëm do të thellohet. Shtoji këtyre pasigurinë e gjendjes së tregut të pasurive të patundshme që tani do të përballen me pashmangshmërinë e tatimit mbi pronën dhe mbi pronat e dhëna me qera, jo të domosdoshme për jetesën e familjes.

Borxhi i shtetit

Së treti, është borxhi i shtetit. Pavarësisht thashethemeve elektorale se qeverisja do të marrë ndihma të mëdha nga FMN, realiteti është shumë shqetësues.

Së pari, shteti duhet të bëjë pagesat, edhe këto të vonuarat, që shkojnë te 600 milionë dollarë në vit.

Së dyti, mundësia e marrjes borxh është ngushtuar. Pa ekonomi, pa mundësi pagimi, pa garanci, nuk te jep kush para. Por edhe po u morën, nuk kanë për të shkuar te investimet, por do të përdoren për pagesat e buxhetit e për shlyerjen e detyrimeve ndaj shumë kreditorëve. Natyrisht që ka mundësi me luejtë dhe me gjetë zgjidhjen, por zgjidhja do të jetë shumë e vështirë dhe do të vijë me një çmim të kripur në të ardhmen.

Sistemi financiar

Gjendja e krizës në sistemin financiar është evidente. Kreditimi ka rënë përtokë. Bankat e dyta transferojnë jashtë vendit disa qindra milionë euro në vit në formën e pagesave të borxheve ndaj bankave mëmë, fitimit, transaksioneve etj. Si edhe e kam shpjeguar më parë, shoqëria shqiptare është një shoqëri horllëku ku të gjithë janë në borxh deri në fyt. 80 % e shqiptarëve e kanë borxh që nga listat, deri te apartamentet e makinat. Banka e Shqipërisë dhe Guvernatori që e ka mirë edhe me këta që po vijnë, i shërbeu besnikërisht Saliut, duke mbajtur interesin e pandryshuar gjatë fushatës zgjedhore. Tani kjo politikë duhet rishikuar me shpejtësi dhe shplimi i artificialitetit të saj do të bëjë krizën më evidente dhe më të theksuar. Shtoji këtyre faktorëve edhe mungesën e likuiditetit në tregun financiar të brendshëm, sistemin ekonomik që funksionon me “clearing” dhe shkallën e mashtrimit që u luajt me kolateralet e bankave, që po shohin kreditë e këqia të rriten me një shpejtësi marramendëse dhe kjo do të bëhet tepër shqetësuese dhe shumë e qartë në vjeshtë. Mbajtja e lekut si monedhë e fortë shërben shumë dhe zgjidh probleme të mëdha financiare e shoqërore. Shumica e kredive janë në euro, shumica e prurjeve të emigrantëve është në euro e dollarë dhe pagesat e buxhetorëve dhe të punësuarve bëhen në lekë. Po kjo gjendje e sistemit financiar nuk mund të vazhdojë kështu, sepse nuk është e mbështetur në ligjet e ekonomisë.

Korrupsioni dhe kriminalizimi

Problem themelor është nga se vijnë të ardhurat e shtetit. Doganat e TVSH nuk japin aq shumë, sepse importet kanë rënë. Fuqia blerëse ka rënë gjithashtu dhe konsumatori shqiptar është në letargjinë dimërore si ariu. Qeveritarët nuk do të tatojnë veten apo Sali Berishën dhe Familjen. Qeveritarët nuk do të tatojnë kriminelët e bandat që i sollën në fuqi apo

që me marrëveshjen e ditur të rotacionit, i lejuan të fitojnë në “bastionet” e PD. Qeveritarët nuk do të prekin zonat e nxehta të prodhimit të drogës, të krimit, të trafikimit të njerëzve e të kontrabandës, sepse janë vetë në krye të këtyre bizneseve. Nuk do të prekin mbështetësit e miqtë milionerë e multimilionerë që tani janë deputetë. Dyzetë milionerë të koalicionit janë në Kuvend. Barrën e madhe të buxhetit të shtetit, këta duan t’ua hedhin prodhuesve e tregtarëve të vegjël. Por këta i kanë fshehur paratë në “qyp” dhe kështu gjendja është thuarje e pashpresë. Po ashtu vala e të pushuarve nga puna që do të numërojë disa dhjetra mijë, do të kërkojnë menjëherë pagesat.

Shterrimi i kapitalit shoqëror

Problem më kryesor është shterrimi i kapitalit shoqëror. Sali Berisha dhe PD kanë luksin të presin sa të fillojnë dështimi dhe zhgënjimi i njerëzve. Sepse as Edi Rama, as Ilir Meta nuk do ta fusin në burg. Por ata janë të destinuar të dështojnë. Saliu lulëzon mbi pakënaqësinë popullore, tamam si lulet e varreve mbi të vdekurit. Po këtu është në lojë zhgënjimi popullor me mbështetësit e me militantët e PD. Për më shumë, këtu është në lojë edhe zhgënjimi me mbështetësit e PS e të LSI. Rregulli i artë i atyre që ngjiten në pushtet është se për çdo vend pune që mbush, bën nëntë të pakënaqur. Në një vend si shteti shqiptar, ku jetesa sigurohet kryesisht nga korrupsioni në lidhje me punën në shtet, për çdo vend pune që mbush bën 29 vetë të pakënaqur. Këta që kanë vjedhur për 100 vjet, siç vodhën këta që do të qeverisin kur ishin në pushtet, kanë kohë e durim për me pritë që njerëzit të fillojnë të ndihen të pakënaqur dhe të fillojnë ta shesin veten si e keqja më e vogël.

Në vend të përfundimit

Rritja e tatimit, rritja e përgjegjësisë, shplimi i plotë i krizës dhe sqarimi i gjendjes, janë detyrime të mëdha e të menjëher-

shme të qëverisjes. Por paradoksi është se përgjegjësi për këtë gjendje është njeriu që e mban peng qeverinë, sepse ai e kishte në kontroll ekonominë deri dje. Ai e caktoi Guvernerin e Bankës në punë. E kështu me radhë. Dallga që e ngriti varkën e PS dhe të LSI, rrezikon ta përplasë atë në shkëmbin e krizës ekonomike. Sepse ngado që të kthehen, Sali Berisha ka punuar sistematikisht që të lerë një tokë të shkretë, me një pus me kovë me shumë vrima në të cilën duan të pinë kaq shumë njerëz që janë tharë si çimkat tetë vjet në opozitë. Gjithsesi, në fund të fundit, kova do ta ketë një gisht ujë, po kush do ta pijë? Prandaj iu duhet folur njerëzve me realizëm, me vërtetësi dhe duhet bërë ajo që duhet bërë. Por siç duken bathët, ajo që është thënë në Rrethin e Ferrit do të dalë e vërtetë dhe gjendja do të jetë e frikshme për të gjithë njerëzit e dënuar me jetue në atë gjendje e në atë sistem kriminal të sunduar nga kriminelët që duket sikur shtohen për ditë e dalin nga s'e pret, njëlloj si gjarpërinjtë në Ferrin Dantesk.

SHTETI I PARISË APO SHTETI I KOMBIT SHQIPTAR

Në njërin nga shkrimet e tij të fundit, Dr. Artan Fuga ngre problemin e mprehtë të lidhjes së shtetit me kombin ndër shqiptarët. Edhe pse problemi ngrihet në një nivel bisedimor - tavolinor dhe diskutimi nuk e kalon atë nivel, për ata që iu kushtojnë vëmendje shkrimeve dhe argumenteve të tilla, çështja është shumë më e thellë, qendrore në politikën shqiptare, do të thojë. Kjo çështje jo vetëm që do të detyrojë politikanët në shtetin shqiptar të pozicionohen dukshëm e pa ekuivoqe, por do të shtyjë edhe vetë shqiptarët të rivlerësojnë identitetin e tyre dhe lidhjen me shtet - kombin me të gjithë pasojat që do të ketë një rivlerësim i tillë.

Argumenti i Artan Fugës

Argumenti i Artan Fugës është i formuluar në shkrimin "Shteti po bëhet mbiterritorial - askush nuk e vëren!" botuar në gazetën "Standard".^[1] Fuga merr shkas nga një VKM që iu jep shqiptarëve jashtë territorit të shtetit shqiptar të drejtën e qytetarisë në shtetin shqiptar, përveç shqiptarëve të Kosovës dhe që Fuga nuk e përmend, por kryeministri e theksoi, edhe "10 % të popullsisë greke me origjinë shqiptare". Me të drejtë Fuga shpreh habinë që askush nuk po i kushton vëmendje një vendimi të tillë, se për të, ky vendim e transformon shtetin shqiptar nga një shtet territorial në shtet të një lloji tjetër.

Fuga e sheh këtë VKM, që është i kthyeshëm dhe ligjërish mund të hidhet poshtë nga shumica sunduese që doli nga farsa demokratike e zgjedhjeve të 23 qershorit, si dhe implikimet që ka nga tre këndvështrime të ndryshme.

Së pari, e sheh nga të drejtat që kanë qytetarët dhe që shteti e ka detyrë t'ua plotësojë.

Së dyti e sheh nga detyrimet që kanë qytetarët ndaj shtetit.

Së treti, e sheh nga implikimet që do të ketë në politikën e jashtme të shtetit shqiptar.

Duke i pasur shumicën e qytetarëve të vet jashtë territorit, shteti shqiptar do të duhet të marrë përsipër detyrimet që ka ndaj tyre si shtetas dhe kjo do të krijojë probleme të shumta, sipas Fugës, juridike e ndërshtetërore. Kjo do të shtojë barrën e shërbimeve shoqërore, që duhet t'iu ofrohen edhe qytetarëve shqiptarë që jetojnë jo vetëm në Ballkan, por edhe në botë. Fuga e sheh këtë VKM edhe në prizmin e integritit evropian dhe shprehet se nuk është i qartë “nëse kjo e shtyn marrjen e statusit apo e përshpejton (integrimin)”. Mandej me një notë të pamohueshme sarkazme, Fuga vë në dukje se “Nëse, ta zëmë, do të kishim larg qoftë një katastrofë natyrore në ndonjë komunë shqiptare në serbi, Evropa do t'i ndihmonte të dëmtuarit edhe si qytetarë serbë, edhe si qytetarë shqiptarë”.

Duke parë aspektet e tjera të trajtesës, vihet re se për Fugën përbën shqetësim edhe ndryshimi i raporteve të bashkësive fetare dhe raporti midis toskëve e gegëve. E veshur me një gjuhë të kodifikuar, por lehtësisht të kuptueshme për ata që e kanë ndjekur dhe e ndjekin me vëmendje lojën e parisë së Tiranës, Fuga shprehet, “Duhet bërë të gjitha statistikat tani e tutje, sa nga veriu, sa nga jugu, sa burra, sa gra, sa të krishterë, sa myslimanë, sa gegë dhe sa toskë. Institutit të Statistikave do t'i hapen shumë punë. Po a kërkojmë punësim? Ja një front i mirë pune! Edhe statistikat e punësimit biles do të ndryshojnë”.

Megjithatë, pas këtij ekskursioni argumentativ, Fuga tregon se ku fle lepuri me të vërtetë dhe çka e shqetëson atë dhe parinë e Tiranës; “Ndërkaq, në zgjedhjet e ardhshme vota e qytetarëve të Shqipërisë, por që jetojnë denbabaden ta zëmë në Kumanovë, Medvegjë, Shkup, Ulqin etj., do të vendosë se si do të kompozohet Kuvendi i Shqipërisë, kush do të jetë Kryeministri në zgjedhjet e ardhshme etj., etj”. Pra, po ta përkthesh

në shqipen time katundare, kjo don me thanë se ky vendim i ndërron raportet dhe tani, shikoni si do të na sundojnë këta të veriut që nuk janë nga tanët, etj., etj.

Nuk ka rëndësi çka mendon Artan Fuga. Rëndësi ka çka përfaqëson Artan Fuga. Rëndësi ka që po të lexohet me kod, kjo që thotë Fuga është shqetësuese. Në këtë pikë Artan Fuga përfaqëson mendësinë sunduese të parisë së Tiranës që e sheh shtetin shqiptar si një çiflig të vetin në të cilin, me e thanë shkurt e shqip, ata duhet të sundojnë e ne të tjerët të jemi skllëvërit e tyre. Çdo ndryshim në përbërje të shtetit që e rrezikon sundimin e tyre, është problem dhe si çdo problem, duhet adresuar e zgjidhur.

Implikimet imediate politike

Përveç të tjerave, Fuga është i gabuar në një pikë të rëndësishme. Ai mendon se implikimet e pasojat e këtij VKM kanë kaluar pa u vënë re. Në të vërtetë vetë vendimi u mor sepse Sali Berisha don të përdorjë kombëtarizmin. Jo pse Lulzim Basha apo Sokol Olldashi janë nacionalistë, përkundrazi. Por sepse Saliu mendon një hap më larg se të gjithë. Meqë deri diku e hëngri, sepse luajti jo mirë me kartën e nacionalizmit, tani po don t'i shkojë deri në fund lojës e ta shfrytëzojë si duhet. Aq më shumë kur shihet se ka një mbështetje të madhe për kombëtarizmin që ai mendon ta kalërojë deri në zgjedhjet e ardhshme. Shtoji kësaj faktin se Edi Rama flet për "atdhedashuri" domethënë dashuri për shtetin e jo për kombin apo për shtet - kombin. Shtoji këtu sharlatanizmin e atyre që morën flamurin e nacionalizmit në këto zgjedhje dhe që tani bashkë me mbështetësit e tyre gjenden në mes të rrugës. Saliu është dhëlpër e vjetër. Dhe duke qenë se këto dy - tre muaj ai është njëlloj si gaforrja që ka hedhur korracën e vjetër dhe nuk e ka krijuar ende korracën e re, po kërkon të maskohet me kombëtarizmin. Kur të veshë korracën e vet të natyrshme, Saliu do ta shkundë kombëtarizmin si ujku që e kishte lyer

këmbën me miell. Por deri atëherë, çdo patericë që ndihmon mbijetesën e tij, është e dobishme.

Implikimet afatgjata politike

Ballkani po shkon drejt ndërtimit të shteteve kombëtare. Duke qenë se shteti shqiptar deri më tani ka qenë një shtet shumëetnik, ku flitej shqip e ku sundonin të tjerë që nuk besonin në idenë kombëtare shqiptare, ky VKM është i një rëndësie të veçantë. Pavarësisht arsyeve pse e bëri Saliu, kjo don të thotë se jemi një hap përpara deklarimit të shtetit shqiptar si shtet - komb të shqiptarëve. Në mos tjetër, ky VKM do të detyrojë parinë e Tiranës dhe segmentet e saj që do të sundojnë, të tregojnë se në cilën anë janë me të vërtetë; në anën e shqiptarëve apo kundër tyre. Çdo përpjekje për ta shmangur, dobësuar, penguar, modifikuar apo shtrembëruara këtë VKM, do të jetë guri i vërtetë i provës.

Këtë do ta shohim në shumë aspekte. Në përpjekjen e vet për mbijetesë, Sali Berisha ka bërë një lëvizje që me të vërtetë i ka ndërruar kahun lojës, por që nuk i takonte, sepse po ta kishte me zemër, e bënte shumë vite më parë. Sepse në një pikë e ka Fuga gabim. Ai mendon se shteti po bëhet mbiterritorial. Ky koncept nuk ka kuptim. Shteti është dhe mbetet territorial dhe parimisht sovran. Ajo që ndërron me këtë VKM, është pronari i shtetit, kombi që e ka në pronësi. Kjo VKM në një farë mënyre iu njeh shqiptarëve të drejtën të kontrollojnë shtetin e tyre, që kështu paraqitet formalsht si shtet - komb i shqiptarëve. Nëse do të bëhet apo jo, është çështje tjetër, por diku duhet ndryshuar rruga dhe ky është një ndryshim cilësor që nuk duhet nënvlerësuar. Për këtë pajtohem me Fugën dhe ndryshe prej tij, po mendoj se si kaq shumë përpjekje 100 vjeçare me i shmangë shqiptarët nga kontrolli mbi shtetin e tyre, zhbahen thjesht nga dashuria e njerëzve për shtet - kombin e vet.

[1]<http://www.standard.al/shteti-po-behet-mbiterritorial-askush-nuk-e-veren/>

E PAZËVENDËSUESHME IDEOLOGJIA KOMBËTARISTE NË POLITIKËN SHQIPTARE

Shqiptarët gjenden në një udhëkryq me të vërtetë historik. Po udhëkryqi historik nuk e ka të shtruar e të dallueshme rrugën ku duhet të ecim. Kësaj here, për shkak të rrethanave specifike, atë rrugë duhet ta hapim vetë. Duke qenë se kombëtaristët e spikatur shqiptarë gjatë historisë sonë na kanë dhënë vlerat dhe zgjidhjet në nivel parimor, e kemi një strukturë botëkuptimore që do të na orientojë në zgjedhjet që do të bëjmë. Megjithatë, gjendja ku jemi është e veçantë dhe kërkon ta trajtojmë në përshtatje me specifikën e vet.

Prandaj pyetja më e rëndësishme me të cilën përballemi të gjithë bashkë e gjithsecili më vete, sepse jemi në të njëjtin qorrrokak, është cilën rrugë duhet të ndjekim? Fatkeqësisht kemi hyrë në një rreth vicioz në të cilin kemi qenë edhe më përpara, po sjelljet që kemi bërë në rrethana të ngjashme, do të na japin të njëjtat rezultate e përfundime. E mira e kësaj të keqeje të përkohëshme që po përjetojmë është se duke u sjellë në një rreth, nuk jemi asnjëherë shumë larg rrugës së duhur. Me mund e me përpjekje, mund të fillojmë të vihemi në rrugë të mbarë, si të gjithë kombet e popujt e tjerë.

Në mënyrë të pashmangshme pra, debati për të ardhmen është ideologjik, sepse ideologjia apo botëkuptimi të tregon rrugën ku duhet ecur në të ardhmen dhe si të dalësh nga gjendja ku je i ngërthyer. Problemi më i rrezikshëm në këtë pike, është se në debatin e rëndësishëm politik në shtetin shqiptar mungon ideologjia që duhet të japë zgjidhjen e duhur, do të ndihmonte në shërimin e gjendjes e në vënien në rrugën e drej-

të e në shina të forta të historisë së shqiptarëve. Ideologjia e vetme që mbështetet në vullnetin e gjithë shqiptarëve, që iu shërben të gjithë shqiptarëve dhe që është e domosdoshme dhe e pazëvendësueshme, sepse është e rrënjosur në atë që është e veçantë dhe e papërsëritshme në përkatësinë e tyre, është kombëtarizmi. Në këtë sprovë të shkurtër do të kisha dashur të cek e të trajtoj disa nga anët më të rëndësishme të këtij problemi të mprehtë, veçanërisht në shtetin shqiptar.

Kombëtarizmi në përplasjen ideologjike

Shqiptarët janë një nga popujt më kombëtaristë që mund të gjinden në faqe të dheut. Inisiativat e nismat e shumta në nivel qytetar, në emigracion apo në shtetin shqiptar, individuale apo kolektive, kulturore apo politike, të mbështetura në traditën apo në bashkëkohësinë, dëshmojnë për karakterin e theksuar kombëtarist të shqiptarëve. Megjithatë, trysnitë nën të cilat janë gjendur e gjinden shqiptarët, braktisja që iu kanë bërë intelektualët e tyre dhe presionet e fuqishme që vijnë nga sistemi ndërkombëtar, duket se kanë krijuar çarje të thella që vetëm po zgjerohen me kohën që kalon. Ndërsa shqiptarët kërkojnë një shtet - komb normal, paritë e tyre sunduese nuk ndjekin zgjidhje kombëtariste, por kanë përqaftuar e propagandojnë me një intensitet të madh, ideologji që iu shërbejnë interesave të veçanta të grupeve, të shtresave, të klaneve dhe strukturave kriminale. Kjo shihet në katër nivele.

Së pari, në nivelin e politikës dhe të politikanëve, tashmë partitë politike shqiptare janë struktura me udhëheqje të konsoliduar, por pa ideologji të mirëfilltë mbarëshqiptare, shtet - komb formuese që iu shërben të gjithë shqiptarëve. Politikanët drejtues të shqiptarëve në Tiranës, Prishtinë e Shkup kanë përqaftuar ideologji e sisteme vlerash që iu shërbejnë grupeve të veçanta së tyre. Shtresa e politikanëve shqiptarë, parvarësisht kontekstit ku e zhvillojnë aktivitetin, tashmë po përvojohet qartë si oligarkike, kleptokrate, mafioze dhe kriminale.

Tipike për këtë fenomen është paria e Tiranës, por në drejtim të sjelljes ndaj shtetit dhe kombit, nuk bën shumë dallim as paria e Prishtinës apo e Shkupit. Nuk kanë rëndësi fjalët e slloganet që përdorin, rëndësi ka kuptimi që iu japin.

Së dyti, kjo shihet edhe në veprimtarinë e shtresës influente në nivel të shoqërisë që ka përqaftuar ideologji qytetërimore apo që e mbështet sjelljen e vet në bindje fanatike fetare. Duke gjetur terren të favorshëm, edhe për shkak të diskreditimit të parisë, të injorancës së saj të theksuar ideologjike e të mungesës së vlerave të saj politike, aktivistë shoqërorë e struktura të caktuara autoritative në nivel të shoqërisë, janë gjallëruar dhe po mbushin hapësirën e lënë bosh. Por ata po promovojnë me vetëdije ndasi të caktuara shoqërore, që mund të politizohen shpejt e të bëhen shpërthyesë e me efekte shkatërrimtare. Flaka dhe dinamiti duhet të rrinë larg njëra - tjetrës dhe shqiptarëve nuk iu shërbejnë ideologë që fusin fitilat e përçarjes e të vëllavrasjes që po bëhet më e mundshme çdo ditë që kalon. Shkaku kryesor për këtë ecuri është se këto ndasi që po kultivohen me kujdes, mbështeten në ideologji që iu shërbejnë grupimeve të veçanta e jo të gjithë shqiptarëve. Në një farë mënyrë këta veprimtarë e funksionarë strukturash në nivel të shoqërisë e të bashkësisë, po kthehen në forca centrifugale që po i largojnë shqiptarët edhe më shumë nga njëri - tjetri.

Së treti, shtresa influente e parisë dytësore, intelektualët dhe profesionistët, kanë bërë zgjedhje ideologjike që shpesh e influencojnë shoqërinë në drejtimin e gabuar, jo të duhur. Bindjet ideologjike që iu shërbejnë grupimeve të veçanta të tyre, apo që janë të informuara nga ideologji universaliste e bindje që mund të jenë të vyeshme në konteste të tjera, nuk iu shërbejnë të gjithë shqiptarëve. Këta kanë rënë rob të pasurimit, nuk dalin dot nga kornizat e të menduarit në të cilat janë stërvitur dhe më e keqja, po shfaqin një shkallë të habitshme oportunitizmi e rezinjate të frikshme, që i shmang nga përgjegjësia historike dhe i ndan nga populli, pjesë integrale

e të cilit janë dhe shprehës të vullnetit të të cilit duhet të jenë. Të gjithë këta individë shprehen në jetën publike, edhe pse në medium dhe në nivele të ndryshme, kanë sisteme të dallueshme vlerash e bindje ideologjike të ndryshme.

Së katërti, problemi është acaruar jashtëzakonisht shumë për shkak se tashmë edhe masa e madhe e njerëzve që janë edukuar jashtë vendit, nuk flasin gjuhën kombëtariste e me ideologjinë kombëtariste. Të rritur në sisteme në të cilat njerëzit përgatiten për t'iu shërbyer shteteve e kombeve të caktuara, këta flasin me një gjuhë të sofistikuar, por që nuk e shpreh vullnetin e popullit dhe nuk ngjit. Duke kërkuar me transplantue ideologji e sisteme ideologjike që janë të vyeshme në kontekste të tjera, por që nuk iu shërbejnë shqiptarëve, kjo shtresë e edukuar, që përndryshe do të ishte shumë e vyeshme, po izolohet përditë e më shumë. Ç'është edhe më e keqja, kjo shtresë po konformohet dhe po shkrihet në strukturat e parisë së cilës i përket dhe të cilës po i shërben me bindje.

Mungesa e kombëtarizmit ideologjik

Mungesa e kombëtarizmit në debatet e përditshme që bëhen në shtyp e në media, por edhe në politikën e ditës, nuk do të thotë se nuk ka nevojë për një ideologji të tillë apo se nuk ka një ligjërim të qartë kombëtarist. Arsyeja është se edhe pse shqiptarët, politikanët e mendimtarët po merren intensivisht me personat, interesat dhe problematikën immediate paszgjedhore, konflikti ideologjik që ka të bëjë jo vetëm me gjendjen prezente, por mbi të gjitha me të ardhmen afatgjatë, nuk ka shkuar kund. Më shumë se kurrë, sot ndiehet nevoja e ideologjisë dhe e diskutimit ideologjik. Kohëve të fundit, një seri shkrimesh e shqiptimesh në shtypin e përditshëm e vënë në dukje qartësisht debatin ideologjik dhe praninë e përplasjes ideologjike. Dallimi është se në shtypin e në mediat e Tiranës mungon e vetmja ideologji që duhet të jetë e pranishme dhe që është zgjidhja e vërtetë: kombëtarizmi. Për shumë shkaqe,

e ndër më kryesoret janë rrethanat tona specifike, e shkuara jonë historike, përbërja e parisë, mendësia popullore dhe trysnitë e shumta të jashtme, kombëtarizmi duket se ka qenë ideologjia e panevojshme e tranzicionit.

Asgjë nuk mund të jetë më larg së vërtetës. Pavarësisht cektësisë së argumenteve, ekstremizmit, dogmatizmit dhe varfërisë konceptuale, debati që po zhvillohet në çdo nivel të shoqërisë shqiptare është thellësisht ideologjik. Ndeshja ideologjike është e dallueshme në çdo nivel të organizimit shoqëror. Argumentet që përdoren, edhe kur janë të pasistemuar apo të mbështetur në premisë kontradiktore e përjashtuese, janë të hedhur me përsëritje të rregullt, një intensitet që i bën të duken të pakontestueshëm. Por në nivele të ndryshme shoqërore veprojnë ideologji të ndryshme. Megjithatë, për shkak të politizimit të pashmangshëm të ideologjive, që do të kalojnë shkallë - shkallë nga formësimi kulturor në ekstremin tjetër, fanatizmin ideologjik, përplasja ideologjike do të vijë duke u intensifikuar shumë shpejt. Në fakt është e pranishme edhe tani, edhe në këtë fushatë zgjedhore.

Diskreditimi i përpjekjes gjatë zgjedhjeve të fundit për ta përdorur kombëtarizmin si bindje të masave dhe si ideologji, por në funksion të interesave të grupeve të caktuara dhe të individëve të veçantë, nuk është diskreditim i ideologjisë. Në fakt, kjo që ndodhi gjatë zgjedhjeve të kaluara vë në dukje nevojën e jashtëzakonshme që ka shoqëria shqiptare për një ideologji të tillë. Ideologjinë e bartin njerëzit dhe shpeshherë ajo pranohet përmes njerëzve, karizmës apo shembullit të tyre, jo vetëm për shkak të veshmërisë së saj si botëkuptim e si sistem vlerash që iu shërben të gjithëve.

Në vend të përfundimit

Përplasia ideologjike që materializohet në shtetin shqiptar është me rrezikshmëri të lartë, sepse po kthehemi qëllimisht në kaosin totalitar e në ndasitë e manipuluar e të kultivuar

të frikshme të fillimit të shtetformimit. Këto ndasi e papajtueshmëri që mund të politizohen lehtësisht, janë të përcaktuara nga katër faktorë: feja, interesat klasore, dallimet kulturore dhe nga influenca e ideologjive universaliste. Ideologjia e vetme që mungon është kombëtarizmi. Por e vetmja ideologji që iu shërben të gjithë shqiptarëve është kombëtarizmi. Kështu që duhet përqendrohemi edhe një herë në trajtimin e këtij problemi parësor ideologjik, politik dhe kulturor. Dhe prandaj kjo sprovë duhet të ishte edhe si ftesë për një debat që duhet ta zhvillojmë. Sa më shpejt, aq më mirë.

TEORIA E HIJES NË POLITIKËN SHQIPTARE, KUSH DO TA BËJË OPOZITËN?

Shenja më e rrezikshme dhe më e pamohueshme e sundimit të shtetit nga një parti e caktuar, është përpjekja e suksesshme e asaj partie për të krijuar opozitën e vet. Kur sistemi është një oligarki politike e financiare që mbështetet në struktura polimore e kriminale, kjo është edhe më e dallueshme. Kur kësaj përpjekjeje i bashkëngjiten edhe strukturat e shoqërisë civile dhe të medias, atëherë gjendja është e rëndë. Kur shoqëria bie pre e kësaj loje, atëherë gjendja është e pashpresë.

Me e lanë mënjane Rrethin e Ferrit, ndoshta vendin e vetëm ku thuhet e vërteta për politikën e Tiranës, gjendja me të vërtetë duket e pashpresë. Në këtë pikë duket sikur jemi pikërisht në atë fund të lojës kur luan macja me miun. Në këtë moment kritik, partia sunduese dhe eksponentët e saj nën dyshen “Rameta” po kërkon të ndikojë fuqimisht, me vendosmëri, me strategji e objektiva të qarta mbi opozitën. Me shumicë kushtetuese dhe me të paktën njëzetë deputetë nga “kundërshtarët” që kanë bërë, si thuhet në “Sheraton” e “Rogner” “një hale me leka” nga të dy partitë, e që janë të gatshëm t’i shiten blerësit më të parë, gjendja e opozitës është katastrofike. Problemi i tyre nuk është më Sali Berisha, sepse ky tashmë është i fiksuar në ruajtjen e Familjes, edhe pse e din se ku do të shkojnë gjërat, po nuk bashkëpunoi luajalisht me këta që fituan. Aq më shumë që Saliu është pjesë e pazarit që këta bënë dhe megjithëse ia rrasën humbjen shpejt, pa mëdyshje e pak më shumë se pritej çka e la pa frymë, prapë e rren mendja se ia kanë lënë vrimën që mund ta nxjerrë nga gjendja. Problemi i kryesor që kanë, është që në krye të opozitës të dalë

dikush i përdorueshëm, i manipulueshëm, i kontrollueshëm, i varur prej tyre, partner, besnik, pjesëtar i parisë jeniçere - martalloze të Tiranës.

“Teoria e Hijes” në politikën shqiptare formulohet kështu: Le të jetë si të jetë opozita, për sa kohë ata hedhin vickla, bëjnë sherr kot, por janë pjesë e parisë, ne mirë i kemi punët. Hija nuk është shpirti i njeriut, sepse shpirti nuk lëshon hije. Hija nuk është as njeriu që ecën dhe ka një trup, edhe pse hija është e tija. Ajo është në trajta, formë e në përmbajtje, diçka krejt tjetër, sepse i duhet të marrë formën e terrenit, në varësi nga burimi i dritës. Por shpejtësia me të cilën ecën hija, zmadhimi apo tkurrja e saj, varen nga njeriu i vërtetë. Kur hija jote është opozita jote dhe kur je i vetëdijshtëm për këtë, je i fituar. Paria e Tiranës luan me hijet në mur. Asaj i duhet një opozitë që të jetë hija e saj në mur. I duhet një hije si Saliu, që edhe në puschet nuk ua preku asnjë qime, asnjë qime në hundë, të paktën t’i bënte të teshtinin. Sepse në fund të fundit, Saliu është dhe ka qenë i tyre, pjesë e parisë së Tiranës, është në tavë, me lugë në brez, e me një tufë vrasësish rrotull që bëjnë sherre kot, le po t’u prekësh “haletë me leka” që kanë vjedhur këta tetë vjet.

Këtyre iu duhet një opozitë si kjo e Saliut. Një opozitë që të jetë në gjendje të kontrollojë masat e popullit dhe t’iu bëjë magji me premtime idiote e boshe, t’i mbajë varur për plane e projekte që askush më mirë se Luli i Berishës nuk e tha “ai që të ka mundur të mund prapë”. Luli harroi të thonte se si shkuan këto zgjedhjet e fundit në Tiranë e Kavajë dhe se fitoren ia detyronte Ilir Metës dhe xhaxhi Hysni Milloshit dhe sesa para ka vjedhur e për çka mbahet peng. Ky zotni mafiozi kontrabandisti tjetër, Olldashi thotë fitojmë në vitin 2015. Ne jse, me i ra shkurt këta janë dy prestigjiatorë që duan të bëjnë magji, domethënë t’i hedhin hi syve popullit të shkretë që shkon sa nga shiu në breshër, e nga breshëri në shi dhe militantëve “demokratë,” domethënë atyre që ndjekin këso hijesh të hijes. Këta i duhen parisë. Paria e ka listën e gjatë të krimeve të këtyre dy shërbëtorëve të Saliut e të shumë ustallarëve të tjerë. Sa të duan të hyjnë në lojë, kata dalin ‘tymçe’ dhe as hijen nuk e bëjnë dot. Por ne jse.

Ja një histori e shkurtër e hijeve në tranzicion.

Ramiz Alia e donte PD si hije që të mbliidhte kundërshtarët. Saliu dhe të tjerët e përmbushën misionin. Kur deshi t'ia fuste stërkëmbëshin ustait, këta i bënë gjëmën. Dhe e kthyen në hije prapë. Kur deshi të fuste spica, Ilir Meta e rراسi në një komisarariat ku firmosi diçka. Por Saliu është mjeshtër dhe duke e ditur se nuk matet dot me hije, bëri aleanca me të gjithë dhe Gramoz Ruçi në të vetën e Fatos Nano në të vetën, vazhduan lojën e hijes me Saliun. Tani që këta dolën jo thjesht fitimtarë, por dërmëtarë, domethënë që i dhanë dërmën hijes, duhet ta rikrijojnë atë. Sepse kush merret me gjithë këtë “pis millet” që nuk do të durojë vjedhjet e korrupsionin, mashtrimin e krimin, sepse Pjetër Arbnori që ka qenë një plehurinë politike, do të mbahet mend kur tha se “këta nuk janë socialistë, këta janë specialistë”. Natyrisht nuk ishte puna te zhvoshkja e misrit apo shirja në lëmë, por specialist në “rruajtjen e në kruajtjen” e thesarit të shtetit e të pasurisë kombëtare. Dhe këta kanë një uri që një zot e din! Edhe çimkat që rrinë gjashtë vjet pa pirë gjak dhe e derdhin gjakun që pinë duke shkuar në atë vrimën e drurit, dikur pushojnë. Por këta nuk do të pushojnë sa ta mbushin ashtu siç thuhet në “Sheraton”, “halenë me leka”. E nga do të dalin këto leka? Një zot e din, por këta janë të uritur dhe, për dreq, e kanë edhe oreksin e madh.

Nejse, këtyre iu duhet një opozitë hije. Këtyre iu duhet Oll-dashi, sepse si ajo çimka, ka lënë gjurmën e krimit në të gjithë Shqipërinë dhe ngado ta shtrydhësh derdh gjak. Ky nuk fiton e as nuk ka ndërmend të bëjë luftë me njeri, sepse një zot e di çfarë nxjerr thesi i thellë i shokëve. Iu duhet Basha sepse ky i ka të tëra pazaret e bëra me Ilir Metën. Ia kanë matur shumë vetë burrërinë në tavolinë dhe, duke u bazuar te ajo që vetë këta specialistët e “Rametës” kanë thënë, edhe ky e ka thesin e mbushur dhe një zot e di se çfarë nxjerr thesi i shokëve, por edhe shumë thasë të tjerë.

Tani kanë nisur lojën me pasqyra e tallen me shqiptarët e shkretë që e kanë humbur toruan si ajo delja që e sheh se po e presin në fyt. Hedhin shashka e tymçe mediatike që po i konfundojnë e ngatërrojnë njerëzit e shkretë. Ja një shashkë; “nxi-

rrni e hiqni spiunët nga opozita". Po kë të heqësh? PD u mbajt nga Sali Berisha duke përdorur dosjet! Këta na dalin të gjithë spiunë. Teza tjetër është të persekutuarit të dalin më vete! Po kush janë të persekutuarit, more aman! Këta hëngren "rruajtën e kruajtën" thesarin e shtetit për tetë vjet të tjera. Dhe u përdorën si deshi Saliu. Çfarë kredibiliteti kanë? Zero. Teza tjetër është të bëjmë një parti "diversante" me demokratët militantë! Po çfarë militantësh? Militanti ka vlera dhe vdes për ideologjinë e vet. Këta janë për një vend pune e një kafshatë bukë. Një tezë tjetër është që gegët dhe kosovarët duan të kontrollojnë shtetin. Ka edhe teza të tjera hedhur në tregun politik mediatik. Nuk dua të merrem me to tani, por që të gjitha kanë një shpjegim: këtë verë para se të nisim lojën, duhet të kemi edhe hijen gati. Dhe hija duhet të dalë nga paria e Tiranës.

Që të mos më thonë se nuk ka alternativa të tjera, do të kisha thënë se shkrimet e mia dhe të kolegëve si Grid Rroji, Valbona Karanxha, Ledjan Prifti e shumë të tjerëve në blogun Rrethi i Ferrit (shinasi.wordpress.com) të japin zgjidhjen e vërtetë. Por duhet të mësohen njerëzit të lexojnë e jo të shullehen në diell. Ashtu digjet lëkura e nxihesh, por nuk e gjen zgjidhjen. Shkurt e shqip, zgjidhja është kombëtarizmi dhe ndërtimi i shtetit - komb. Këta që e kanë mendjen te dhjamosja e te mbushja e "halesë me leka", kanë trup dhe prandaj duan hije. Kombëtarizmi është një sistem vlerash që del nga shpirti i popullit dhe shpirt nuk ban hije. E keqja ban e kërkon hije, sepse e mira, si drita e diellit, i mbulon njëlloj të tanë dhe e ban hijen të qartë. E mira e shqiptarëve dhe opozita e vërtetë është ajo që do të mbështetet si mbi një shkamb, mbi vlerat e vërteta e shpirtin e popullit shqiptar, sepse deri tani të gjithë këta hajnat e cubat e parisë jeniçere, martalloze dhe bashibozuke, duan t'i bindin shqiptarët që kanë hije, por nuk kanë shpirt e nuk janë njerëz.

ARTIAN GJATAJ - PARTIA E FORTË DHE PARTIA E SPORTEVE TË RËNDA

E vërteta vjen në shumë mënyra, por asnjë formë nuk e nxjerr më lakuriq e nuk dhemb më shumë se sarkazma. E meqë çdo veprim politik, është politik, sepse duhet me e përdredhë pak të vërtetën, sarkazma e parodizimi i politikës janë jo vetëm të mundshme, por edhe të pranueshme. Në mos tjetër, duke e jetuar jetën politikisht dhe duke u bartur pasojat e politikës, qytetari e kupton mirë sarkazmën.

Partia e Fortë

Njëra ndër format më efikase të protestës politike ndër shqiptarët po merr jetë në Kosovë duke u mbështetur pikërisht mbi këtë parim. Duke bërë parodinë e partive politike në Kosovë që janë të drejtuara e të komanduara nga individë me nam luftarak, disa të rinj si Visar Arifi, Ilir Bajri dhe Ylli Rugova, kanë themeluar Partinë e Fortë. Brenda pak ditësh, e përhapur si rrufe, Partia e Fortë ka marrë rreth 7000 likes në Facebook.

Në një emision të drejtuar me cilësi nga Adriatik Kelmendi, Rubikon, <http://www.kohavision.net/video/rubikon/6264/>, kryetari legjendar dhe nënkryetarët, ia arritën të ndërtojnë parodinë e sistemit politik të Kosovës. Kryetari quhet Kryetari Legjendar. Partia e Fortë nuk ka anëtarësi; të gjithë janë

nënkryetarë e nënkryetare dhe të gjithë janë të barabartë. Megjithatë Kryetari Legjendar është pak më i barabartë se të tjerët. Të veshur me pantallona të shkurtëra në mes e poshtë, e me veshje biznesi në mes e përpetë (një gjetje më vete kjo) dhe duke arritur që me seriozitet të bëjnë parodizimin e sjelljes së partive politike në Kosovë, këta të rinj kanë arritur të venë në dukje shumë nga dukuritë që janë kaq të dhembshme për të gjithë ne. Me një vetëdije të lartë politike, ata flasin me gjuhën e politikës, por venë në dukje të gjithë korrupsionin shtetëror, dobësitë e partive politike, sjelljen e papranueshme të kryetarëve të partive që bëjnë vila nga tri milionë euro në mes të Prishtinës, e me radhë. Po kjo ka ngjitur shumë te të rinjtë e Prishtinës, shumica dërmuese të papunë. Në një vend të varfër si Kosova, por ku ka një vetëdije të lartë kombëtare, se tashmë Kosova është vatra e vërtetë e shqiptarizmit, të gjitha shmangiet nga normat bien në sy shpejt. E kështu Kryetari Legjendar dhe nënkryetarët e Partisë së Fortë, vënë në dukje dukuritë negative si minimin e sistemit demokratik, mosrespektimin e shtetit, të interesit kombëtar e me radhë. Çdo çështje politike kthehet në të kundërtën e vet. Në vend të mbrojtjes së të drejtave të grave, këta kanë bërë një komision për mbrojtjen e burrave të moshës së mesme, ku burrat do të kenë të garantuar 30 % të përfaqësimit në Kuvend e të tjera. Simboli i Partisë së Fortë është një shqiponjë dykrenare me muskuj të krijuar me ndihmën e steroidëve në vend të flatrave.

Çka mund të mësohet prej këtij rasti?

Gjetja është e veçantë dhe kërkon vlerësimin e duhur. Nga një anë Partia e Fortë është një shprehje e qartë e nivelit të lartë të vetëdijes politike e qytetare ndër shqiptarët e Kosovës. Duhet nënvizuar se edhe pse përpjekja e tyre është të ruajnë masën dhe të mos e tejkalojnë atë, prapë se prapë, vende vende del dallueshmëria midis fshatit dhe qytetit, midis atyre që bënë luftën dhe atyre që duan të jetojnë jetën e kësh-

tu me radhë. Duke i lënë mënjanë teprimet dhe aluzionet për individë të veçantë, e për të cilat ia vlen të diskutohet, sepse jo gjithherë janë të aplikueshme, ka katër gjëra që të bëjnë t'i kushtosh vëmendje këtij fenomeni.

Së pari, shoqëria civile shqiptare në Kosovë ka një nivel shumë të lartë kombëtarizmi e vetëdijeja politike. Nuk mohohet lufta, por kundërshtohen teprimet që bëhen në emër të saj.

Së dyti, modelet e sjelljes shoqërore që po vijnë nga Prishtina në Tiranë janë shumë më të avancuara, më qytetare, më të përkushtuara dhe shumë më efektive, se sjelljet e OJQ e OJF të Tiranës. Jo vetëm kaq, ato janë edhe vullnetare, çka tregon se shkalla e preokupimit të njerëzve me politikën është e lartë.

Së treti, shoqëria civile shqiptare në Prishtinë gjen mbështetje në popull dhe din si ta kërkojë mbështetjen në popullin shqiptar. Mjafton të shihet si Partia e Fortë po gjen mbështetje te të rinjtë në forumet shoqërore e më gjerë.

Së katërti, pavarësisht parodizimit, vende - vende të tepruar, presioni që shoqëria shqiptare në Prishtinë iu bën politikës dhe politikanëve, është shumë i lartë. Tkurrja e mbështetjes që po përjetohet nga strukturat politike që dolën nga lufta e që po shfaqen si klienteliste e të korrupuara, është shenjë e qartë se ndërsa respekti për luftën do të ruhet, përpjekja e shqiptarëve është të gjejnë normalitetin e munguar të jetesës së përditshme.

Parodia si realitet

Po në Tiranë? Realiteti është se në Tiranë sundon Partia e Sporteve të Rënda. Kuvendi është i mbushur me mundës, bodigardë, peshëngritës, basketbollistë, etj. Sali Berisha vetë, për shembull, është notar i garave të gjata. Edhe pse me këmbë në tokë, ai rrin në ujë mbi dy orë e shtatë minuta. Ndoshta këtë verë nuk arrin me e thye rekordin personal, sepse është në detyrë si kryeministër. Po reagimi i shoqërisë civile në Tiranë

ndaj kësaj që po ndodh përditë, është tejet i vakët dhe i dobët. Fragmentarizimi dhe atomizimi i shoqërisë civile, janë të dukshme dhe paralizuese. Aftësia e aktivistëve apo e intelektualëve për t'u lidhur me popullin shqiptar e për t'u bërë shprehës të ndjenjave të popullit të tyre, është e papërfillshme. Prandaj në Tiranë sundon Partia e Sporteve të Rënda. Po që se dikush vendos të përdorë modelin e Partisë së Fortë në Tiranë, si fillim do të bëja një propozim: në simbolin e partisë nuk duhet të ketë më kokat e një shqiponje dykrenare, por një shtangë dhe në vend të flatrave duhet të ketë të palosura euro e dollarë që dalin nga shtanga. Sugjerimi i dytë do të ishte që sllogani i Partisë së Sporteve të Rënda të ishte "Ne vjedhim ma mirë se ju". Sugjerimet e tjera do t'ia dërgoj Kryetarit Legjendar të Partisë së Sporteve të Rënda, të cilit, edhe pse nuk e kemi zgjedhur ende, paraprkishtë dhe në emër të anëtarësisë së mundshme, i propozoj të nderohet me medaljen "Azem Hajdari".

ARTIAN GJATAJ - LUFTA KUNDËR KOMBËTARIZMIT DHE FATOS LUBONJA

Si edhe është parathënë tash sa kohë në blogun Rrethi i Ferrit, lufta e pa kompromis e parisë së Tiranës është me kombëtarizmin shqiptar. Fitorja e thellë e një pale të parisë, ka nxjerrë nga vrimat e miut edhe disa nga të ashtuquajturit kundërshtarë të parisë, të vetëthirrurit, apo ndryshe, takozvani analistë. Këta që janë me shumicë në Tiranë, tashmë po bëjnë lojën e parisë, por pa u identifikuar haptazi me të. Meqë shumë prej tyre i kam kolegë të vjetër dhe i njoh mirë, ia vlen të ndalem në disa aspekte të sjelljes së tyre.

Së pari, nga një anë taktika që ndjekin është e ndryshme nga paria. Këta duan të hiqen njëherë si të paanshëm e më pas si të përkushtuar për të mbrojtur ideologji e platforma universaliste, liberal - kozmopolitane dhe më evropiane se vetë evropianët. Unë e mbaj mend se ç'hoqëm të gjithë kur Muç Nanaj mori një çmim ndërkombëtar me një ese të gjatë për kalërimin e shqiptarëve drejt Evropës, me fitimet e të cilit pagoi disa darka të mira.

Së dyti, këta janë armiq të zjarhtë të njëres palë. Këta shiten sikur mbrojnë interesa të tjera dhe duket sikur e luftojnë njerën palë më me ngulm se gjithkush tjetër. Berishiada e Andrea Stefanit, Mero Bazes, Muçi Nanajt e të tjerëve dhe Edramajana e Fahri Balliut apo e Hamit Takes, apo Serviliada e pashoqe e Blendi Fevziut dhe e gjithfarë shkarrashkruesi

tjetër të llapaqenërisë mediatike të Tiranës, janë dëshmi e kësaj taktike. Megjithatë, si t'i hiqen petët lakrorit, del se këta e kishin të gjithë mendjen te ajo luga që e mbajnë si zboristët dikur, në brez... Një sjellje që shkurt e shqip nuk përkthehet "ne jemi me ju", por "ne jemi me ata që na paguajnë më shumë".

Ama, në një nivel tjetër këta pontifikojnë, se kanë ustallarë edhe më lart se këta çorapekuqtë e parisë apo si ky Berisha që edhe jelekun antiplumb e vesh me ngjyrë blu. Paria ka interesa për të cilat nuk diskutohet, sepse janë të pranuar dhe të konsideruara jetike nga të gjithë palët, por paria vetë ka ustallarë. Ustallarët duan punë, sepse paria ka kundërshtarë. Në lidhje me vetë parinë në tërësi dhe me interesat e saj të përbashkëta, siç janë, bie fjala interesat oligarkike, ekonomike, kriminale dhe mafioze, këta gjithlogë analistë luftojnë pa mëshirë të gjithë kundërshtarët e saj.

Megjithatë ka një luftë ideologjike që paria e zhvillon kundër të gjithëve. Dhe këta gjithlogët tavolinorë, janë më të flaktit. Si për ilustrim, në këtë pikë objektivi i tyre imediat, në sinkroni, edhe pse në shkallë të ndryshme argumentative, është që të zhvlerësohet kombëtarizmi shqiptar. Rrugët e gjithlogëve analistë janë të ndryshme, por të gjitha të çojnë te kuzhina e kimit të parisë.

Njëri nga këta është gjithlogu i shquar tavolinor, Fatos Lubonja.

Pse paria e lufton kombëtarizmin shqiptar?

Arsyeja është se kombëtarizmi shqiptar paraqet rrezikun kryesor që i kanoset sundimit të tyre. Kombëtarizmi flet për barazi, për drejtësi, për ruajtje të nderit e dinjitetit, për një shtet në shërbim të qytetarëve e të shqiptarëve. Kombëtarizmi flet për ruajtjen e vlerave, të historisë, të trashëgimisë, të identitetit, të territorit historik, të krijimit të një tregu kombëtar. Kombëtarizmi flet për një shtet demokratik, të së drejtës, të pakorruptuar dhe me sistem zgjedhore që me drejtësi e

seriozitet e vënë në jetë vullnetin e popullit. Kombëtarizmi flet për një të ardhme për të gjithë shqiptarët, për një të ardhme shqiptare si komb modern midis të gjithë kombeve të tjera, me struktura e me një udhëheqje në shërbim të popullit.

Por paria e Tiranës dhe këta gjithhollogë analistë, thonë se kombëtarizmi shqiptar është rruga që nuk duhet ndjekur. Në fakt paria e Tiranës e lufton me tërbim e pa asnjë hezitim çdo përpjekje për të përfshirë kombëtarizmin në debatin publik dhe për ta bërë themelin e ideologjisë shtetformuese, siç e kanë të gjithë shtet - kombet e tjera. Arsyeja është e thjeshtë. Një shtet që është i një kombi, nuk mundet me kenë shteti i një partie oligarkike, kriminale, të zvetënuar e të degjeneruar siç është paria e Tiranës që vjen nga skutat më të humbura të skërkave të shtetit shqiptar dhe që synon t'i mbajë shqiptarët si skllevër të saj.

*Lufta e pakushte e parisë së Tiranës
kundër kombëtarizmit shqiptar*

Në arritjen e objektivit të baltosjes së kombëtarizmit shqiptar, nuk lihet gur pa hedhur dhe argument pa u parashtruar. Në këtë blog janë vënë në dukje shumë metoda të parisë që kanë synim thellimin e përçarjeve midis shqiptarëve. Qëllimi i të gjithë palëve të parisë, si i atyre që punojnë për grekët, ashtu edhe i atyre që punojnë për serbët, mbetet i njëjtë dhe i pandryshuar; Jenicerët dhe martallozët duan të ruajnë çifligun e tyre, që është shteti shqiptar. Për të arritur këtë qëllim ata duhet të ndajnë shqiptarët në të gjithë ndasitë e mundshme, sepse të fragmentarizuar, do të sundojnë çifligun më lehtë. Duke mos sulmuar hapur kombëtarizmin, këta sulmojnë shfaqjet e kombëtarizmit dhe bartësit e sjelljeve kombëtariste. Në këtë mënyrë futen pyka, krijohen sherre, ndahen shqiptarët dhe këta sundojnë si duan. Sepse një pakicë e organizuar mirë, e sundon një popull të përçarë keq. Një grusht me luanë ushqehen me kopenë e buajve për gjithë jetën.

Fatos Lubonja - gjithollogu analist

Në këtë front lufte kundër shqiptarëve kontribuojnë shumë vetë. Njëri ndër ta është edhe Fatos Lubonja, një nga antikombëtaristët e shumtë që sillen në Tiranë dhe që nuk lodhen as ta fshehin neverinë që kanë për shqiptarët. Ky wannabe analist, është një gjithollog tavolinash. Grada më e lartë që ka mbërritur ka qenë opinionist personal i Blendi Fevziut. Ka qenë dhe ka mbetur në borderonë e Irfan Hysenbelliut e të Aleksandër Frangajt që e përdorin për të sheqerosur emisionet e gazetën dhe i sigurojnë jetesën, biletat e avionit etj. Le të mos hyj në këto tema, se një zot e di ku ndalemi.

Natyrisht që ky zotëri është pa asnjë shërbim publik shtetëror apo kombëtar që ia vlen për t'u përmendur. E megjithatë, Lubonja, gjithollogu analist që nuk ka as përgatitje konceptuale të mjaftueshme, çka shihet qartë te cektësia argumentative dhe te konfuzioni në mendime, po i shërben kësaj kauze me një intensitet të habitshëm. Është tragjikomike të vësh re se ai shihet si idhull në rrethe të caktuara të parisë së Tiranës dhe shqiptimet e tij merren seriozisht. Dhe kjo thotë më shumë për nivelin e këtij individ, sesa të parisë, sepse dihet se çfarë niveli kanë këta që nuk kanë hapur as librin e shtëpisë, as të tyrin e as të dashnoreve të familjes. Lubonja gjithollogu, që po ia preve fjalën nuk e mban mend ku ishte dhe e nis bisedën nga e para, është pa ndonjë përgatitje profesionale në ndonjë fushë të caktuar, por e ndien veten shumë kompetent. I duket vetja humanist, por nuk ka asnjë koncept të qartë në kokë. I duket vetja me talent politik, por është një snob. I duket vetja kokë e madhe, por të paktën mban syze. Njeriu habitet kur e sheh te "Piazza" me ato pantallonat me katrorë dhe një libër në dorë.

Pse e ndjekin kaq shumë në Tiranë? Arsyeja pse e ndjekin nuk është se ka qenë në burg, por sepse për të jetuar, për të blerë apartamentet që ka e për të mbajtur familjen që ka krijuar, ka marrë flamurin e antikombëtarizmit shqiptar. Një

njeri që pjesërisht jeton me lëmoshat e pushtetit apo me ndihma fondacionesh të huaja, me paratë që ia paguan televizioni më i degjeneruar shqiptar, tv “Klan”, Lubonja, gjithollogu përsiatës, mendon se është qendra e mendimit elitar të kombit. Për këtë edhe i duhet parisë.

Sulmi ndaj UÇK dhe gjithollogu

Në një shkrim, “Nën qiellin evropian” te botuar te “Panorama”, ku botohen përsiatjet e tij të përvajshme, gjithollogu përsiatës dhe joprofesionist, ndërton tre argumente.

Së pari ai akuzon Ramush Haradinajn ish - komandantin e Zonës Operative të Dukagjinit, ish - kryeministrin e Kosovës dhe kryetarin e AAK si kriminel luftime. Duke marrë si të mirëqena akuzat për të cilat edhe u shkarkua ish - prokurorja për krimet në ish - Jugosllavi, duke bërë insinuata për vrasje të dëshmitarëve në Kosovë, që në fakt vdiqën në Gjermani, duke hedhur si të vërtetë zhurmën për vrasjen e qindra serbëve nga ushtarët e UÇK, Lubonja, ky gjithollog që nuk e ka as logjikën elementare të argumentimit mbi prova dhe evidencë të pranuar nga drejtësia, hedh baltë mbi luftën e UÇK, mbi ndjenjat kombëtare të shqiptarëve, mbi rezistencën, mbi sjelljen shembullore e shumë qytetare të shqiptarëve me serbët në Kosovë.

Këto akuza nuk kanë nevojë për asnjë demontim. Por duhet me e nda luftën heroike të UÇK, nga paslufta. Duhet me i nda njerëzit sipas kohës e përvojave që kanë. Kështu me që ky gjithollog merret me Ramush Haradinajn, duhet me thanë se në mendjen time ka disa Ramushë. Ka një Ramush që është patriot e atdhetar, vëllai i Luan Haradinajt, figurë e kombit, dikush që kur 6000 ushtarë ikën në shtetin shqiptar, ndenji me pesëdhjetë vetë dhe e mbajti flamurin në Glllogjan, edhe pse kishte një brigadë serbe përpara. Ka një Ramush që është një nga njerëzit më të korruptuar në Kosovë dhe mjafton të shihen shtëpia që ka ba, paratë që janë marrë nga shteti me korrupsion dhe luksi ku jeton. Ka një Ramush tjetër që don me

çdo kusht me ndenjë në politikë duke bërë të gjithë pazaret e mundshme me këdo që e sjell në pushtet. Historia duhet të merret me të tre këta Ramusha dhe t'i peshojë të gjithë, secilin sipas vlerës që ka pasur në një periudhë të caktuar. Por me hedhë akuza edhe kur janë të provuara si të rreme nga gjykata, nuk flet mirë për këtë gjithollog. Meqë thuhet se Ramushi e ka hedhë në gjyq Lubonjën nuk mendoj se duhet të zgjatem mbi këtë temë. Por do të thoja se këto fenomene janë shumë të njohura në të gjithë shoqëritë dhe kërkojnë analiza të qeta e të balancuara. Ajo që të habit, është pse nuk merret Lubonja me shumë nga njerëzit që pinë kafe rreth tij, kur ulet me një libër kot në vendin e vet? Me çfarë kriminelësh shqiptarë është marrë Lubonja? Përse nuk merret me Aleksandër Frangajn që nuk ka lënë pasuri pa vjedhur? Po me Blendi Fevziun që nuk ka lënë gjë për kushërinjtë, por ua ka rrjepur pasurinë e tokat? Nuk don shumë mend me ditë se pse ndodh kështu.

Në morinë e pseudoargumenteve në lidhje me përdorimin e kombëtarizmit nga politikanë dhe me lehtësinë me të cilën përdoren shqiptarët nga demagogët që në një anë flasin për integrim dhe në anën tjetër flasin për bashkim kombëtar, ky gjithollog hedh gjithfarë shashkash, si përshebull:

“Kjo gjuhë e dyfishtë është shprehje e ideologjisë dominuese të pushtetit që kanë adoptuar politikanët shqiptarë gjatë njëzet viteve të fundit. Kjo ideologji, që e kam quajtur nacional - evropeizëm (si kalim i retorikës së elitës politike shqiptare nga nacional - komunizmi në diskursin nacional - evropeist, që nënkupton instrumentalizimin e integritit evropian) pretendon ta zgjidhë çështjen kombëtare të bashkimit të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Ballkan nëpërmjet integritit evropian, duke përzierë kështu vizionin nacionalist të Shqipërisë së madhe etnike, me vizionin postnacionalist të Bashkimit Evropian të qytetarëve në një lloj Shqipërie të madhe evropiane”.

Në fakt shpjegimi për këtë sjellje të politikanëve dhe të pullit shqiptar, është krejt tjetër. Mjafton edhe një lexim i përciptë i Putnam për logjikën e lojërave në dy nivele, që të bëjë

të qeshësh me çfarë është shkruar këtu. Se ajo që ndodh është krejt tjetër. Shpjegimi për sjelljen e shqiptarëve është ky:

“Njerëzit në shtetin shqiptar në Kosovë janë të zhgënjyer me integrimin. Ata duan të bëjnë shtetin e shqiptarëve. Politikanët që iu shërbejnë të huajve, flasin për integrimin për t’iu pëlqyer atyre dhe përdorin kombëtarizmin për të mobilizuar shqiptarët. Në këtë mënyrë politikanët shqiptarë luajnë një lojë në dy nivele. Por në momentin që do të zgjohen shqiptarët e do ta kuptojnë se integrimi është përrallë, atëherë e vetmja zgjidhje mbetet kombëtarizmi”.

Ky gjithollogu flet edhe për skizofreninë e shqiptarëve etj., por nuk dua të ul veten të merrem me argumente të tilla që dalin nga mendjet e sëmura. Ashtu si nuk dua të merrem me përsiatjen e tij komiko - qesharake në lidhje me argumentin sepse e lejon Evropa këtë. Ku është Evropa? Nuk ka rëndësi, për sa kohë që me një libër të hapur në dorë, gjithollogu rri në “Piazza” e mendon se është “Nën qiellin e Evropës”. Për çfarë Evrope na flet ky gjithollogu ynë? Ndoshta duhet me ia kujtue se Evropa ka kenë një princeshë fenikase që e përdhunoi Zeusi, po nuk ia vlen me humbë kohën me këtë mulli që bluan pa kokrra.

Në vend të përfundimit

E keqja është se si intelektual, domethënë si gjithkush që ka të drejtë me mendue me arsye e me thanë mendimin e vet, Lubonja nuk është pjesë e kombit shqiptar. Sepse agjenda e bindjet e tij personale e vendosin jashtë kombit shqiptar. Kombi ka një histori të vetën ku shumë njerëz bëhen shprehës të shpirtit të tij, si Luan Haradinaj, si Ramush Haradinaj (që është edhe hero, por edhe hajn) dhe shumë vetë si ky Lubonja, janë thjesht kalimtarë apo e shumta bashkëudhëtarë. Sepse kombi është një bashkësi shpirtërore dhe Lubonja, më tipiku i gjithollogëve analistë, nuk ka pjesë në shpirtin e shqiptarëve. Duke parë reagimin e njerëzve për çdo gjë që thotë, ai mendon

se është duke ndryshuar kombin. Në fakt, ashtu sikur shohin gjarpërin, njerëzit bahen grusht rreth njëri - tjetrit, ashtu edhe shqiptarët i ikin Lubonjës, gjithollogut analist. Por ky e ka lëshuar helmin që i shërben parisë së Tiranës, ose më mirë e ka hedhur një gur në pus. Hajde tani të merren njëqind vetë me nxjerrë gurin që ka hedhë në pus ky gjithollogu, takozvani analist...

MBI KONCEPTIN E BËRTHAMËS SË KOMBIT SHQIPTAR

Duke ndjekur me vëmendje shkrimet e kolegëve të Rrethi të Ferrit, ndër të tjerë Grid Rroji, Valbona Karanxha, Artian Gjataj dhe Ledjan Prifti, shihet qartë dhe bindshëm se ka një numër pozicionimesh të guximshme, por njëkohësisht edhe realiste në lidhje me gjendjen e kombëtarizmit shqiptar. Ndër problemet që po diskutohen është edhe ai i qendrës së kombit shqiptar. A kanë kombet bërthamë apo qendër? Si duhet konceptuar ajo? A kanë shqiptarët një bërthamë kombëtare? Ku gjindet ajo? Më së fundi, një pyetje tjetër është a do të ketë influencë politike apo jo? Kambanat bien për ata që duan me dëgjue dhe diskutimet bëhen me ata që dinë, prandaj kjo temë duhet trajtuar me vëmendjen që meriton.

Bërthama e Kombit

Çdo shtet - komb ka një sintezë sigurie e cila e ndihmon me zgjidhë problemet ekzistenciale dhe të identifikimit si komb në rregullin e një shteti të caktuar. Kjo sintezë sigurie ofron edhe sjelljet e pranueshme e të moralshme, praktikat e politikat që duhen ndjekur për të arritur objektivat që kombi dhe shteti i konsideron jetike. Njerëzit që i ndjekin me parësi këto praktika sjelljeje, që besojnë te sinteza e sigurisë kombëtare, që identifikohen me shtet - kombin dhe që punojnë për të mirën e në shërbim të tij, janë bërthama e kombit. Këta janë kombëtaristë. Bërthama e kombit është pikërisht ky grup njerëzish që mund të vijë nga rrugë e nga

përvoja të ndryshme, por që i bën bashkë identiteti i përbashkët dhe lidhja ekzistenciale që kanë me shtet - kombin. Ky grup njerëzish që kërkon të ndërtojë shtet - kombin në bazë të një botëkuptimi të caktuar dhe që janë aktivistë e militantë politikë, janë bërthama e kombit, rreth të cilës do të mblidhen për shumë arsye edhe të tjerët. Kjo po ndodh edhe me ne.

Disa dallime përkufizuese

Kombëtaristët shqiptarë nuk janë të lidhur ekskluzivisht për gjuhën që kanë folur e për gjakun që kanë trashëguar, sa janë të lidhur për bindjet në shërbim të kombit e për lidhjen e tyre me shtetin. Me kenë kombëtarist është me kenë diçka krejt ndryshe prej origjinës thjesht etnike. Pra, mund të flasësh shqip, mund të jesh shtetas shqiptar, mund të kesh origjinat më të pastra që mundet me pasë dikush si shqiptar dhe prapë mund të mos jesh pjesë e kësaj bërthame kombëtare. Zerva ka qenë shqiptar, siç ka qenë Karagjergji apo Ballaban pasha, siç kanë qenë edhe shumë të tjerë që në kohë kanë punuar me ngulm kundër vetë shqiptarëve. Ka shumë shqiptarë që janë bërë të famshëm në shërbim të kombeve, të shteteve e të ideve të huaj, po nuk janë kombëtaristë. Në fakt, ka shumë prej tyre që janë të huaj për kombëtarizmin shqiptar. Sepse kombëtarist e shqiptar është ai që kur i gjykohen veprimet, mund të thuhet pa mëdyshje se i shërbenin shtet - kombit të shqiptarëve. Prandaj Adem Jashari është një hero kombëtar. Prandaj edhe zonja e Hasan Prishtinës, e cila ishte me origjinë hebrije është pjesë integrale e kombit shqiptar.

A ekziston një bërthamë kombëtariste ndër shqiptarët?

Përgjigja e shkurtër është ekziston. Ekziston në Kosovë e Iliridë. Pse? Duke u mbështetur te përkufizimi që ofrova, në Kosovë e Maqedoni ekziston një sintezë sigurie e cila mbështetet fuqimisht te sinteza e sigurisë së një shtet - kombi

shqiptar. Të gjithë partitë politike shqiptare janë me orientim kombëtarist. Në qendër të vëmendjes së mjaft prej tyre, është shtet - kombi dhe politikat që propozojnë e rruga që ndjekin, shpeshhere mund të duken absurde nga jashtë, por janë në kohezion me sintezën e sigurisë kombëtariste shqiptare që e sheh shtet - kombin shqiptar si të paevitueshëm, si të dëshërueshëm e si të pashmangshëm. Ndryshojnë taktikat e zgjidhjes si problem, por në nivelin e diskursit politik, kjo sintezë e sigurisë kombëtariste nuk vihet shumë në diskutim. Aq më shumë kur ekziston një masë e konsiderueshme shqiptarësh që mbështesin platforma të tilla kombëtariste dhe punojnë intensivisht për arritjen e këtyre objektivave. Këta nuk janë në Tiranë, por janë në Kosovë në Iliridë. Prandaj edhe qendra e kombit është Kosova që ka shtet, por ka mbështetje shumë të fortë te shqiptarët e Iliridës. Sepse kombëtarizmi është një ide që përqafohet nga njerëzit, bërthama e kombëtarizmit është atje ku ekziston një masë kritike njerëzish që jetojnë e punojnë për arritjen e objektivave që dalin nga sinteza e sigurisë kombëtariste.

Një paradoks themelor

Paradokset janë të shumta dhe nuk besoj se duhet të analizohen të gjithë këtu. Megjithatë paradoksi kryesor është fakti se shteti shqiptar është një shtet i krijuar për shqiptarët, po që nuk është në shërbim të shqiptarëve. Për arsye historike, të gjithë i dimë e ndoshta me kohë ia vlen t'i diskutojmë, brenda shtetit shqiptar sundon mendësia e parisë që kërkon sundimin e shtetit për interesat e veta si shtresë dhe që e lufton me të gjithë mënyrat kombëtarizmin. Jashtë shtetit shqiptar, ekzistojnë pari sunduese, por ekziston edhe një elitë e zgjedhur, e mbështetur në popull e në struktura të forta politike - shoqërore që janë në shërbim të një sistemi vlerash dhe punojnë për arritjen e qëllimeve politike shtruar nga sinteza kombëtariste e sigurisë së shqiptarëve.

Dilema politike

Ky është paradoksi i vërtetë ekzistencial i shqiptarëve nga ku buron edhe dilema ekzistenciale politike e jona si shqiptarë. Ne jemi një komb, shtetin e të cilit e mbajnë peng një grusht banditësh që nuk kanë asnjë vlerë e që nuk na përkasin si komb, njëlloj si qelbi që duhet shtrydhur nga plaga. Prandaj edhe përplasja që duhet të ndodhë e që është e pashmangshme, sepse dështimi i parisë së Tiranës, Prishtinës e Shkupit është i pashmangshëm, është midis këtyre dy botëkuptimeve të mbështetura në dy sintheza sigurie të papajtueshme njëra me tjetrën. Ose do të shtrydhim qelbin, parinë e Tiranës dhe të kryeqeteteve të tjera dhe të shërohemi e të bëhemi një shtet - komb normal, ose do të vazhdojë ky proces gangrenizimi e qelbëzimi që mban si model pikërisht parinë e Tiranës. Pra, dilema është hiç më pak se historike dhe njerëzit që duan të bëjnë veprimin e duhur, duhet të mendohen mirë; a duan të jenë pjesë e historisë së shqiptarëve apo pjesë e fatkeqësisë së tyre.

MISIONI I PARTISË DEMOKRATIKE

Në dhjetor të vitit 1990, PD ka pasur një mision historik. Misioni historik i PD, ashtu siç e kam pasë menduar unë atëherë dhe si e besoj njëllonj edhe tani, ishte që të ofronte një alternativë të balancuar për të shmangur ekstremet e mundshme me të cilat përballej shoqëria shqiptare në atë kthesë historike. Edhe pse kishte shumë faktorë që ndikonin për keq, nuk duhet me ia mohue meritat për arritjet që mund të kenë në pika të caktuara, as PD, as Sali Berishës. Prapë se prapë, ky ishte një shans historik që nuk duhej humbur, por fatkeqësisht u humb. Rrethi i Ferrit e ka trajtuar gjerësisht këtë temë. Por përpjekja intensive për të ngjallur PD, të dergjurin në koma, është një shkas për reflektim lidhur me misionin e kësaj partie dhe me të ardhmen e saj.

Çfarë misioni kishte PD?

PD duhej të ishte instrumentale për të arritur transformimin e thellë e rrënjësor të shoqërisë në shtetin shqiptar nga sistemi parti - shtet, në një shtet - komb modern. Këtë duhej ta bënte duke përdorur me efikasitet dhe pjekuri burimet njerëzore, natyrore e materiale që kishim në atë pikë e që ishin të konsiderueshme. Ekstremet kryesore me të cilat përballej vendi në atë pikë e nga të cilat duhej të ruhej, ishin shtatë; lufta civile, shkatërrimi ekonomik, zvetënimi i pjesës së shëndoshë të shoqërisë, rrënimi i strukturës shtetërore, fragmentarizimi shoqëror, varfërimi, polarizimi ekstrem dhe

reduktimi i shtetit shqiptar në jofaktor në lidhje me çështjen kombëtare. Lista natyrisht është shumë më e pasur, por të gjitha problemet e tjera lidhen me këto procese, burojnë prej tyre, ose janë të lidhura ngushtë me to.

Si do të ndikonte PD në arritjen e këtyre objektivave?

E vetmja mënyrë përmes së cilës mund të arriheshin këto objektiva strategjike, ishte të punohej për ruajtjen e forcimin e shtetit dhe transformimin gradual të ekonomisë e të shoqërisë. Kjo do të arrihej duke punuar me kujdes me popullin dhe me partitë e tjera që dolën nga PPSH. Arsyeja ishte se këto parti, në radhë të parë PS, kishin përvojë të madhe në drejtimin e shtetit. Në atë udhëkryq kur duhej të bënte shtet - kombin, udhëheqja e PD zgjodhi rrugën me të lehtë duke mos bërë as shtetin, as kombin. Nga një anë ndoqi popullin, nga ana tjetër vendosi të ndiqte modele fantastike, eksperimentale politike dhe ekonomike që nuk ishin vënë kund në jetë. Shteti shqiptar u bë si karroca e Nastradinit.

Ja një shembull. Tre heronjtë e PD, siç u shpreh mëkëmbësi i Sali Berishës, janë Azem Hajdari, Sali Berisha dhe Gramoz Pashko. Ja çfarë bënë këta të tre, të ashtuquajtur heronj të PD! Gramozi solli në PD intelektualët e degjeneruar dhe hodhi teorinë e “çekut të bardhë”, rruga dhe fundi i të cilit dihet tani. Azemi solli rrugaçët e gangsterët, i hyri kontrabandës, vrasjes, dhunimit e krimit dhe dihet edhe fundi i tij. Sali Berisha solli spiunët e veglat e të gjithë regjimeve, i degjeneroi, i zvetënoi e përdoroi njerëzit pa mëshirë dhe tani që kanë nisur si minjtë të braktisin anijen, po e sheh qartë fundin e tij. Udhëheqja e PD e shfrytëzoi pa mëshirë, pa respekt, pa dhembshuri, dashurinë e madhe të popullit për ndryshim, vullnetin e militantëve për të ndjekur një udhëheqje të dobishme dhe i ktheu në mish për topin e Sali Berishës. Sepse në rrugë e sipër, Saliu doli nga fjala dhe nuk ndoqi rrugën e shërbimit kombëtar, por interesin e vet. Kur sheh vetëm interesin tënd, të gjithë të duken të për-

dorueshëm. Duke nuhatur se e vetmja mënyrë ishte të blinte njerëzit, Saliu e ndoqi me konsekuencë këtë rrugë.

Përgjegjësitë e parisë dhe të PD

Nuk është vetëm Sali Berisha përgjegjës për ç'ndodhi me PD dhe me vendin. Lënia në rrugë e shtetit nga shtresa sunduese dhe paria e atëhershme e Tiranës, braktisja e popullit dhe turrja drejt pasurimit të pafre e çoi vendin në katastrofë. E gjithë kjo periudhë njëzetë e dy vjeçare ka qenë një përpjekje për të dalë nga gropa e thellë ku kemi rënë, po nuk kemi mundur të dalim prej aty. Kjo gropa jonë, ky pus ku jemi kapur në çark, e ka emrin tranzicion. Misioni i PD duhej të ishte dalja nga tranzicioni. Edhe me ndihmën e pamohueshme të partive të tjera që dolën nga PPSH, PD ka dështuar në mënyrën më të përplotë në arritjen e këtij objekti strategjik. Në të gjithë fushat ka bërë të kundërtën e asaj që duhej. Lista e zullumeve, të gjitha të qëllimta e të ndërgjegjshme, është e frikshme. Atë e dinë të gjithë dhe nuk do rreshtoj argumentet këtu.

Por PD, kur themi PD tani themi Sali Berisha, është përgjegjëse pikërisht për çuarjen e shtetit shqiptar në ekstremet e mundshme të kriminalizimit, të degjenerimit të shkatërrimit, të zhvlerësimit të idesë së kombit, të fragmentarizimit të shoqërisë dhe në shpërdorimin e pashembullt kund të vuajtjeve, mundit e sakrificave të emigrantëve shqiptarë. Të gjitha ato që duheshin shmangur, ndodhën; lufta civile, shkatërrimi ekonomik, zvetënimi i pjesës së shëndoshë të shoqërisë, rrënimi i strukturës shtetërore, fragmentarizimi shoqëror, varfërimi, polarizimi ekstrem dhe reduktimi i shtetit shqiptar në jofaktor në lidhje me çështjen kombëtare. Edhe më keq, në krye të shtetit janë bashkëfajtorët e PD dhe të Sali Berishës. PD është njëra këmbë e parisë së Tiranës dhe PS - LSI është tjetra.

Se truri është ai që ka qenë dhe i bën këmbët të kërcëjnë si do vetë.

Një fillim i ri?

Duke luajtur farsën e zgjedhjeve brenda në PD, Sali Berisha i dha vetes e mbështetësve të vet të Trustit të Gështenjave kohë të çmueshme me marrë frymë. Në krye të PD u vu një njeri pa shtyllë kurrizore, vegël e Familjes, hetues i UÇK, i akuzuar për vjedhjet masive në Rrugën e Kombit e shumë gjëra të tjera.

Ky është një fillim i ri, por jo për shqiptarët. Ky është një fillim i ri për familjen Berisha, por jo për militantët e njerëzit që besuan te ideali i fillimit të rrugës së PD. Saliu e din se në tre - katër muaj, këta që do të drejtojnë shtetin do të diskreditohen. Nuk do të bien ministra nga këta dhe këta që jetojnë në Tiranë e kanë të gjithë një të shkuar politike. Nuk ka shans që këta të bëjnë qeveri pa 3 - 4 vetë tërësisht të korrumpuar apo edhe sharlatanë të papërsëritshëm. Prandaj ai e mban hekurin në zjarr e çekanin gati. Si të hiqen nga puna këta 60 000 vetë që vodhën me të e për të gjatë këtyre tetë viteve, ku do të shkojnë? Vetëm në rrugë për të protestuar. Kjo i duhet edhe Trustit të Gështenjave. Se aq arra ka thesi, po i mbushe xhepat ti, nuk i mbush dot pala tjetër.

Po ky nuk është një fillim i ri për ata që janë militantë me shpirt. Këta janë një masë e konsiderueshme që tashma nuk dinë më se çka me besue. Këta kanë parë me sytë e tyre si në emër të vjedhjes së shtetit u bënë krime e aleanca që të habitin, u kthyen njerëz si qershitë e atij katundarit që shpiku parimin “e lagu - s’e lagu” edhe pse ishin të lagura e të shkelura nga të gjitha palët. Këta e kanë parë dhe e dinë se Sali Berisha, Lul Basha e të gjithë të tjerët kanë bërë krime pa numër. Këta duhet ose të pranojnë që nuk kanë shpirt, ose të pranojnë që Saliu i ka mashtruar dhe i mashtron.

Kjo nuk është një fillim i ri për kuadrot “besnikë” të PD që nuk lanë gjë pa bërë. Tani të gjithë shohin një mundësi të mbi-jetojnë duke i ikur Sali Berishës e fshesës që po përgatit Lul Basha. Duke synuar të bëjë një parti me kuadro që kanë për-

vojë zyrtare, Berisha po kërkon të bëhet si ai lumi që nis me një rrëke në mal. Por jo që PD - së nuk i vjen e nuk i vjen radha, por siç duken bathët, nuk do të ketë opozitë që të ndryshojë lojën për nja dymbëdhjetë vjet. Kush do ta bëjë opozitën? PD nuk ka as ideologji, as vlera, as moral, as strukturë të konsoliduar, as mundësi që të krijojë diçka të tillë. Në emër të çkaje do të mund të mobilizojë njerëzit Saliu? Halli i tij është që të mos humbë njerëzit.

Misioni i ri?

Tashmë PD është një parti tërësisht e dështuar dhe ka dështuar, siç thotë për diçka, edhe kryetari i saj i vërtetë “në mënyrë të shkëlqyeshme”. Tani PD ka vetëm një mision, ruajtjen e Sali Berishës dhe të interesave të Trustit të Gështenjave të Tropojës. Ky mision johistorik, por i caktuar nga kryetari i saj, i bjen krejtësisht ndesh interesave të shqiptarëve si komb. Në arritjen e këtij misioni, PD do të bëjë gjithçka mundet për të mbajtur peng opozitën. Misioni i saj tashmë është misioni i një partie oligarkike, thellësisht e kriminalizuar, e sunduar nga tropojanët, në fakt nga më të këqinjët e Tropojës, vegël e Trustit të Gështenjave të Tropojës. Misioni i PD është të përdorjë pa mëshirë shqiptarët për të ruajtur interesat e Trustit dhe të Familjes Berisha, sidomos interesat jetike që do të bëhen shpejt shumë të rrezikuara.

Ç’duhet bërë?

PD është një parti e diskredituar, e degjeneruar, e zvetënuar, një bandë politike që ka në krye një bandit politik e kriminel të pashembullt. PD është një strukturë tipike oligarkike, vegël e Trustit të Gështenjave, një makinë e verbër në duart e Sali Berishës. Me një fjalë, PD është si një bostan me të cilin kanë luajtur futboll dhe e kanë lënë të kalbet në mes të fushës. Kur i afroresh PD, të zë lemeria nga ajo që të kalon ndërmend

e nga krimet që janë kryer në emër të saj. PD dhe Sali Berisha janë si rojtarët te dera e Ferrit shqiptar. Këta e ndërtuan Ferrin dhe tani duan ta ruajnë për veten e tyre. PD është e pariparueshme. Me kohë do të tkurret e do të tkurret deri sa të kthehet si partitë që kanë qenë një kohë të gjatë në pushtet në vendet e tjera. Ajo do të jetë një parti nostalgjikësh, të uriturish, njerëzish që për interesa nuk lanë gjë pa bërë, njerëz që “kanë hangër bukën” e Sali Berishës dhe vegla të Trustit të krimit. Prandaj PD duhet të shmanget dhe të kthehet në një forcë e cila është më e shumta e anashkaluar dhe e pazonja të mbajë peng interesat e popullit.

Në vend të përfundimit

Lë të jetë edhe ashtu, ama ne na duhet një opozitë e pastër, një fillim i ri, njerëz të rinj, mendësi e re dhe një mundësi e re për të ndërtuar të ardhmen që na duhet. Dhe e ardhmja e shqiptarëve është pikërisht në atë rrugë që nuk u ndoq e që nuk do të ndiqet as prej këtyre që kanë pushtetin sot, domethënë në ndërtimin e shtet - kombit shqiptar në bazë të një programi kombëtarist që ne e kemi parashtruar këtu e disa herë në Rrethin e Ferrit. Ne që jemi jashtë mund t’u themi atyre që jetojnë në atë Ferr:

- Ka ardhur koha me harrue PD e Sali Berishën e me mbajtë parasysht këta që janë në krye të shtetit. Ka ardhur koha me besue te njerëzit e mirë, se aty janë ata që duhet të thyejnë derën e Ferrit e të kërkojnë një fillim të ri, për veten e tyre, për fëmijët e tyre, për të gjithë shqiptarët e tjerë!

MAJMUNËT NA MBAJNË SKLLEVËR REPLIKË ME KOLORETO CUKALIN

Në një shkrim interesant, “Zoti i majmunëve” që e vendosa edhe në Rrethin e Ferrit, Koloreto Cukali shpreh shqetësimin në lidhje me gjendjen në shtetin shqiptar dhe me kapjen e vendit nga oligarkia e parisë së Tiranës. Shkrimi ka vlera, sepse e shpreh gjendjen ashtu si e vlerëson autori. Përtej kësaj, duhet thënë se shkrimi mundohet të ndërtojë sekuencat që do të çojnë nga kundërvënia ndaj oligarkisë, te zgjidhja e duhur. Si gjithnjë, Cukali gjen një fabul, parabolë, krahasim apo anekdotë të njohur dhe duke e përdorur metaforikisht, ose si krahasim, mundohet të nxjerrë në pah thelbin e çështjes.

Këtë herë ai mundohet të ndriçojë sekuencën dhe urat që mungojnë në rrugën që duhet të nxjerrë shqiptarët nga kriza e thellë ku janë. Po në rrugë e sipër, Cukali e humbet fillin dhe shkrimi që nxjerr me forcë në pah problemin, mbyllet me nota negative, pesimiste e me një thirrje për kundërvënie. Arsyeja pse nuk shkon një hap me tej, është se Cukali nuk sheh se ka njerëz, grupe, ide të shtruara apo sisteme vlerash që e ofrojnë këtë zgjidhje. Pa dashur të ul aspak vlerat e këtij shkrimi, por përkundrazi për ta nxitur Cukalin të shohë pak më larg e më qartë, do të vija në dukje katër problemet e mëposhtme.

Zotnia dhe shteti

“Zoti i majmunëve” është një mesele e bukur, por nuk e kap qartësisht thelbin e dilemës sonë historike. Majmunët rebelohen kundër Zotnisë. Por në rastin tonë, problemi është

se ne na duhet shteti. Mund të rebelohesh kundër një shteti që nuk është i yti, mund të rebelohesh kundër atyre që duan të përdorjnë shtetin, por në thelb të çdo ideologjie e grupi, revolucionar apo kundërshtar, është gjithnjë ideja e një shteti më të mirë. Pra, mbledhja e frutave nga vet majmunët në pemë, është anarki. Detyrimi për të punuar për “plakun” është skllavëri. Në rastin tonë, në botën moderne mund të arrish të lulëzosh e të zhvillosh potencialin tënd, vetëm nëse ke shtet - komb. Shtet - kombi nuk ka pronarë. Shtet - kombi nuk ka zot. Shtet - kombi ka ligj, barazi, mbrojtje për të gjithë, mundësi zhvillimi e shfrytëzim racional e efektiv të burimeve materiale e njerëzore të shoqërisë. Në mos tjetër, në botën e sotme, popujt që nuk kanë shtet - kombe, bien nën zgjedhën e dikujt tjetër. Shtet - kombi është struktura që arrin të zhvillojë më me efektivitet e sukses shoqërinë. Sepse, në mos tjetër, shtet - kombi është struktura më e lartë, sovrane dhe e pazëvendësueshme, njësia bazë që pavarësisht nga madhësia, ka të drejtën ta konsiderojë veten si të barabartë me shtetet e tjera. Në parim të gjithë shtetet janë të barabartë me njëri - tjetrin.

I bën sovraniteti të barabartë.

Pra, metafora e Cukalit duhej të kishte edhe një element tjetër. Ai element do të ishte ky: nëse nuk ke strukturë, atëherë do të vijë një plak tjetër që do të përdorjë, sepse frutoren e kontrollojnë këta. Zgjidhja e majmunëve është që të bëjnë një majmun si plakun e tyre.

Rezistencë dhe delegjitimim

Së dyti, Cukali e ka kapur mirë thelbin e problemit të kundërvënies ndaj regjimit oligarkik të parisë së Tiranës. Për të, edhe pse nuk ka rezistencë të hapur, diku duhet filluar. Sepse dhe këtu jemi në një mendje; sistemet oligarkike kanë një thembër Akili që është legjitimiteti. Nëse njerëzit votojnë, e shfaqin mbështetjen për regjimin, atëherë, askush nuk mundet me thanë se këta njerëz janë të shfrytëzuar, të përdoruar,

të dhunuar, të skllavëruar. Përfundimi në të cilin mbërrin Cukali, është se kjo ndodhi edhe me sistemin e partisë - shtet dhe, megjithëse mund ta kishte zgjeruar e pasuruar argumentin, në fakt e në thelb, ka të drejtë. Diskutimi historik mund të zhvillohet një herë tjetër. Ajo që ka rëndësi është se çka po ndodh tani. Ku është rezistenca? Ku është delegjitimimi? Ku është kundërvënia? Më vjen mirë se Cukali e ka gjetur rrugën te “vota e bardhë” dhe te Bojkoti. Ai e ka kuptuar potencialin e asaj përpjekjeje dhe fisnikërinë e saj. Kjo i bën nder z. Cukali.

Bojkoti dhe e keqja më e vogël

Problemi i tretë që ka z. Cukali është me “votën e bardhë”, inisiativën për Bojkot dhe me kundërvënien e rreptë ndaj parisë së Tiranës dhe e veglave të llapaqenërisë mediatike. Cukali shpreh habinë me kundërvënien e rreptë të parisë së Tiranës ndaj kolegëve të tij të shtypit që propaganduan me ngulm të keqen më të vogël dhe rotacionin. Këtu hyjnë ata që duhej t’ia bënin “qokën” parisë, sepse ashtu llogarisin të fitojnë koromanen e shkretë. Për këta që të paktën e dinë se çka po ndodh, njeriu nuk din as si të ndiejë mëshirë, sepse këta shërbëtorë që bëjnë krim duke u shitur si intelektualë, janë në fundin e fundit të mullarit të llumit. Ndoshta nuk do të japin kurrë llogari e vetë shpresojnë të harrohen, por nuk mundën me harrue mjerimin e ndytësinë e tyre. Këta janë të ndëshkuem me jetue me poshtërsinë e tyre e kaq del e tepron.

Në lidhje me kundërvënien ndaj sistemit, më duhet të sqaroj se e kam mbështetur inisiativën “votë e bardhë”, por ajo ishte një përpjekje e një grupi të rinjsh nga Tirana si Gjergj Erebara, Alida Karakushi, Alban Nelaj, Eljan Tanini e të tjerë. Një përpjekje tjetër u bë nga një grup që njihet Demokracia Direkte ky spikat Sokol Shameti. Fatos Lubonja bëri vetëm një shkrim, por e gjithë paria u muar me të, sepse në fund të fundit edhe ai aty han, është në tavën e parisë së Tiranës, me të e kishin më të lehtë dhe pas atij shkrimi e qepi gojën.

Por ka pasur një grup shumë të konsoliduar ideologjikisht e profesionalisht në të cilin konsideroj Valbona Karanxhën, Grid Rrojin dhe kolegë të tjerë të Rrethi të Ferrit. Me argumente të forta, me qetësi, qartësi e profesionalizëm si dhe me përkushtim qytetar, kolegët e Rrethi të Ferrit kontribuan shumë në qartësimin e çështjes dhe pranuan të paguajnë çmimin e madh. Në politikë, kush mbështet një kauzë që duket e humbur, e paguan çmimin me emrin e me reputacionin e vet. Ne kemi qenë të vetëdijshëm të gjithë, por pas disa diskutimeve vendosëm që në atë llumhane që është shteti shqiptar, çdo përpjekje për të ndezur një shkëndijë, duhej mbështetur e fuqizuar duke bërë gjithçka mundeshim. Dhe çmimin e paguajmë përditë, sepse llapaqenëria mediatike dhe minjtë e gjirizëve blogiste, nuk lënë rast pa na e kujtuar. Por si katundar që jam, më kujtohet një fjalë që ma thoshte një plak në fermë: nuk digjet gja ma lehtë, se bajga e tharë. E gjendja në Tiranë është shumë afër bajgës së tharë. Çdo shkëndijë mundet dhe ia vë zjarrin.

Në Tiranë ndodh një fenomen interesant: Llapaqenëria mediatike merret me llapaqenërinë mediatike dhe politika është diçka tjetër. Por në rastin e Bojkotit, e gjithë struktura punoi me efektivitet që ta zhvlerësonte. Por ata kishin edhe gurin edhe arrën në dorë, numëruan votat e hedhura, mbushën kutitë, hoqën votat kundër bënë çka deshën. E prapë se prapë, edhe nga shqiptarët që ishin në shtetin shqiptar, Bojkoti ishte partia më e madhe. Dhe mbështetësit e “votë e bardhë” ishin partia e pestë. Shqetësimi i parisë është ndierë e ndihet gjithë kohën, sepse ata e kuptojnë që nuk mund të sundojnë duke qenë të deligjitimuar.

Dhe sa për këta vemjet e gjirizëve mediatike e blogiste, vlen të thuhet se ndihmuan të mbytet një inisiativë që në shkretirën e dështimit të partive të mëdha, do të ndihmonte për hyrjen në lojë të djemve e vajzave të reja që do të jenë e vetmja shpresë që ne kemi për t’u bërë një shtet - komb normal. Duke i thyer, paria iu ofron vetëm alternativat e braktisjes së

vendit, ose të kooptimit në radhët e saj. Katër vjet prej tash do të dalin të tjerë, por nuk do të kenë legjitimitet, do të jenë të dobët dhe kjo i intereson parisë. Prandaj edhe këta vemjet që iu kundërvunë Bojkotit e “votë e bardhë” janë instrumentalë e përgjegjës për vrasjen e një shkëndije që mund të ishte bërë një shpresë. Megjithatë, Cukali e ka kuptuar thelbin e asaj inisiative dhe në mos tjetër, kjo mjafton me thanë se kapitali moral që është investuar nuk ka shkuar kot.

Labirinti dhe rrugëgjdhja

Në fund Cukali ngulmon se armiku është oligarkia e parisë së Tiranës, se kjo ishte një inisiativë fisnike, por se nuk ka as plan e as zgjidhje. Mendoj se në të dy drejtimet është gabim. Në këto qindra shkrimet e postuara në Rrethi i Ferrit, të gjithë ne kemi dhënë të qartë, besoj unë, edhe rrugën, edhe vlerat, edhe kredon, edhe zgjidhjen e duhur. Punë tjetër se në këtë pikë duket se nuk do të merremi me politikë. Por po të gjejë kohën z. Cukali e të lexojë me vëmendjen që meritojnë shkrimet e Grid Rrojit, të Valbona Karanxhës dhe të Ledjan Priftit, do të gjejë edhe përgjigjen e shumë prej pyetjeve që ngre.

Në vend të përfundimit

Një shkrim i tillë meriton respekt. Por përpjekja për të nxjerrë vendin nga bataku ku e mban paria e Tiranës, nga sistemi që është oligarkik, kriminal, antishqiptar, i degjeneruar dhe i zvetënuar në të gjithë drejtimet, kërkon shumë njerëz. Njerëzit që merren me lexime si puna ime, janë si dentisti që të thotë se cili dhëmb është me probleme, të ndihmon ta ruash, a po të jetë i prishur ta heqësh, por kur të vijë puna për të nxjerrë dhëmbin e ri, atë duhet ta nxjerrësh vetë. Kjo është edhe tragjedia, sepse nga jeta në katund më kujtohet si dikush e mbillte bostanin, dikush e kultivonte, dikush tjetër e shiste dhe në fund të fundit, ajo që kishte rëndësi, ishte fakti

se fëmijët e hanin të lumtur e gëzimi i tyre ishte shpërblimi që prisnin të gjithë ata që kishin pjesë në atë frut të mundit të tyre. Shpresoj që z. Cukali të lexojë blogun Rrethi i Ferrit dhe jam i sigurtë se do të ndërrojë mendje në lidhje me planin dhe me ideologjinë që duhet në mënyrë që shoqëria shqiptare të gjejë ekuilibrin e duhur në një shtet - komb modern dhe larg kontrollit të këtyre majmunëve që mbajnë njerëzit sklevër.

TË PAKTËN TË BËJNË SHTET, SE SHTETI I KUFIZON EDHE HAJNAT E CUBAT

*- Intervistë për gazetën "Shqiptarja.com",
analizë e programit të PS të prezantuar
nga kryeministri Rama. -*

- Zoti Rama (koincidencë me mbiemrin e kryeministrit!). Zoti Shinasi Rama, besoj ju ka interesuar të hulumtoni programin e PS e qeverisjes së vendit për katër vitet e ardhshme. Çfarë ndjeshish ju la?

- Kaq jemi ne shqiptarët dhe emrat tanë këta janë. Si thotë diku Shekspiri, nuk kanë rëndësi emrat, ka rëndësi njeriu. Si njerëz, me kryeministrin e tanishëm kemi qenë dikur miq, kam pasur shumë respekt për të dhe mbesim me konsideratë si individë, por jemi krejt të ndryshëm e me bindje të kundërta politike.

E mora programin e qeverisë dhe e lexova me shumë vëmendje. Mund të vija në dukje shumë gjëra, por do të ndalem te më kryesoret.

Së pari, ky program është një përpjekje e qartë për të ruajtur fytyrën dhe premtimet e bëra gjatë fushatës. Shihet një përpjekje e qartë për të lëvizur drejt problematikës reale që kërkon masa të tilla të cilat nuk u përmendën në fushatë.

Së dyti do të thoja se është një program shumë ideologjik. Por ideologjia që është bazë e këtij program, është tejet eklektike, sepse aty gjen koncepte që nuk bashkëjetojnë lehtë si tregu dhe solidariteti.

Së treti, do thoja se është një program tejet optimist në premtime dhe njëkohësisht i kursyer në burime. Nga do të dalin paratë? Pra, i porealizueshëm, sepse kjo qeveri nuk do të taksojë milionerët për të sjellë zhvillimin.

Së katërti, programi është një lojë ideologjike e qartë e një mashtrim i hapur me shqiptarët, sepse vazhdohet parada e pamundshme e agjendës së integritimit evropian, nuk adresohen si duhet problemet e vërteta e reale me të cilat përballemi ne.

Së pesti, një program i tillë tregon cektësinë ideologjike të hartuesve dhe të qeveritarëve të ardhshëm. Këta duket se duan pushtet e jo shtet. Për shembull në këtë program nuk përmendet sovraniteti, atributi themelor dhe unik i shtetit.

Emigrantët përmenden një herë, në faqen 56. Po bashkëpunimi ndërshqiptar? E kështu me radhë, problemet sipas meje janë të shumta jo vetëm në nivelin e në mënyrën e konceptimit të gjendjes, por dhe në zbatimin e asaj që premtohet. Sipas mendimit tim, ky program edhe kështu i porealizueshëm, mbetet një mbulojë për agjenda të tjera. Fjalë të kodifikuara si reformim, në shqip përkthehen si heqje nga puna e kundërshtarëve, dhënie rroge e mbështetësve etj. Por nuk ka dyshim që gjendja është tejet e rëndë dhe në program ndiehet vetëdija se do të jetë një qeverisje shumë e vështirë.

- Ju njiheni tashmë si kritik i rreptë, por kush do të ishin sugjerimet tuaja në situatën ku ndodhet Shqipëria, çfarë duhet të bëjë më mirë dhe çfarë duhet të bëjë nga e para qeveria e re?

- Qeveria duhet t'iu thotë shqiptarëve ku gjendemi. Duhet t'iu thotë se edhe këta që janë në qeveri kanë vjedhur, grabitur, uzurpuar, toleruar e zhvatur njëlloj si të tjerët. Duhet t'iu thuhet se integritimi evropian as nuk ka me ndodhë, as nuk na duhet. T'iu thotë se duhet të shtërngojmë rripin dhe të taksojmë me drejtësi e ndershmëri. T'iu thotë se duhet të ndërtojmë shtetin dhe administratën civile që të funksionojnë jashtë influencave partiake. T'iu thotë se duhet të drejtohem me parësi nga bashkëpunimi ndërshqiptar, si mundësi e ndërtimit të tregjeve, të sigurisë, të shfrytëzimit racional të

burimeve dhe të forcimit të vetëdijes politike e të mbështetjes politike. T'iu thotë shqiptarëve se nuk kemi ushtri, se jemi një vend i kriminalizuar, me shoqëri të polarizuar, me një oligarki kriminale që kanë bërë miliarda dhe me shqiptarë që vrasin veten dhe me një gjendje zvetënimi moral që të bën më pasë frikë. Qeveria duhet të nisë një debat të madh shoqëror lidhur me ndasitë, me humbjen e sovranitetit, të territorit, të faljes së burimeve natyrore e të pasurive kombëtare, të shpërdorimit të pasurisë, të shmanges nga rruga e kimit dhe e hajnisë, e trafiqeve dhe e ndërtimeve pa leje.

Shqiptarët duan një qeveri që të thotë të drejtën dhe të mos ketë frikë se nuk do të zgjidhet më në pushtet. Kjo është edhe detyra kryesore e shërbyesit publik. Shihe në sy popullin tënd e thuaji të vërtetën. Po si mund t'ua thuash të vërtetën, kur ua ke blerë votën te qendra e votimit me një zarf me 50 000 lekë të vjetra, me një thes mielli e një bidon vaji?

- A keni vërejtur risi në programin e paraqitur nga Rama dhe kush janë ato?

- Risitë janë në shprehjet e në konceptet e përdorura dhe në adresimin e disa çështjeve që janë tejet shqetësuese. Koncepti i gjeneratës tjetër është interesant. Por nuk duket se këta janë të ndryshëm në mendime nga paraardhësit.

- Ehtë një numër i madh shqiptarësh që i kanë besuar Ramës t'i qeverisë. Ky program, sipas jush i përgjigjet besimit njëmilionësh?

- Qeveria nuk është e mbështetësve, ajo është e gjithë popullit dhe në një shtet kaq të ndarë si shteti shqiptar, qeveria duhet të jetë e të gjithë popullit, ndryshe ke dështuar pa filluar. Tash në lidhje me këtë shifrën "njëmilion" që përmende, në program ka vetëm një shifër të tillë. Ajo nuk është shifra e mbështetësve, por e të papunëve. Rama dhe qeveria e tij ka premtuar 300 000 vende pune të reja. Po ata 700 000 të papunë që nuk do të gjejnë punë gjatë kësaj qeverisje? Çfarë do të bëhet me ta? Po ashtu shihet se në program ka shumë pika në të cilat shteti do të adresojë problemet e grupeve që

mbështetën fort PS dhe LSI, siç është bie fjala, kujdesi për ush-tarakët e liruar.

Besoj se këta nuk do ta ndajnë tortën me legena, por urtë e butë do të gjejnë mënyrat që t'i shpërblejnë mbështetësit si-pas shërbimeve dhe shkallës në hierarki. Do të ketë punësim masiv nga LSI, por liçenca, koncesione, subvencione, partne-ritete, lehtësime nga taksat etj., që do të garantojnë ruajtjen e mbështetjes.

- Nëse nuk do të qëndrojmë vetëm në anën e kritikës, çfarë ju kënaqi më shumë gjatë leximit të faqeve të programit? Besoni ju në nisjen e një ere të re, në qeverisjen shqiptare?

- Jo, jo çfarë risie! Ilir Meta iku dhe erdhi dyfish më i fu-qishëm. Pala tjetër ka mësuar dhe po e kopjon sipas parimit, të gjithë si Ilir Meta, pesë vota për një vend pune. Këta e kanë mendjen me vjedhë njëlloj si të tjerët. Kur e blen votën e po-pullit, e korrupton që në kutinë e votimit, nuk ka asnjë lloj shprese se do të qeverisësh me drejtësi. Njerëzit të shohin në sy dhe në vend të mjekrës tënde shohin mjekrën e Ismail Qe-malit, të Fan Nolit e të Naim Frashërit që i kemi në kartmone-dhat tona. Po nga ana estetike, duket bukur. Shpresa e vetme që ka, është se këta e dinë mirë se çka është shteti. Të mbarë a të mbrapshtë, le të mundohen të vënë ligjin e të bëjnë një shtet. Sepse një shtet, edhe kur është i hajnave dhe i parisë, ka ligje që e shtërngojnë edhe vetë parinë. Këta kanë qenë të gjithë pjesë e shtetit kur kishim shtet, tani të shohim a do të pranojnë shtërngesat që duhet t'ia vënë vetes, për të mirën tonë, por edhe të tyren, se ndryshe nuk i dihet. Në shtetin shqip-tar, asgjë nuk është e sigurtë, as jeta, as pasuria, as nderi, as mendja e kokës. Shteti kombëtar dhe ndërtimi i tij, ky duhet të jetë objektivi kardinal, aftatshkurtër dhe afatgjatë, po që unë nuk e shoh qartë në këtë program, bile nuk e shoh kund.

PARIA I KA DUART ME GJAK, NË POLITIKË MBROJNË INTERESAT E TYRE

- Intervistë dhënë gazetës "Intervista", 28 shtator 2013 -

Prof. Dr. Shinasi Rama është një nga drejtuesit e Lëvizjes Studentore, është bashkëthemelues i PD, por i zhgënjyer nga politika që ndoqi Sali Berisha, u largua për në SHBA, ku sot është profesor i politikës në Universitetin e Nju Jork (NYU).

- Zoti Rama, si do shkojnë zgjedhjet e 23 qershorit?

- Fituan klanet e krimit, fituan ata që kanë shkatërruar kombin e shtetin. Fituan ata që blejnë e degjenerojnë shpirtrat e njerëzve me një grusht lekë. Fituan ato interesa brenda e jashtë, që kanë investuar te këta politikanë në qeveri e në opozitë. Humbësit janë shqiptarët, humbësit janë njerëzit e ndershëm, humbësit janë rinia, të pambrojturit dhe të vuajturit. Humbja më e madhe është shpresa për një të ardhme më të mirë, më të begatë, e më të lumtur për shqiptarët.

- Zoti Rama, ardhja e së majtës në pushtet pas tetë vjetësh, mund të quhet rotacion në politikëbërje, me shpresën se mund të kemi një hop cilësor për një politikë konsensuale midis forcave politike?

- Po çfarë rrotacioni! Janë ndërruar bandat e hajnave dhe të krimit. Iku Trusti i Gështenjave dhe erdhi Çeta e Lavatriçeve. Konsensusi nuk ka munguar. Këta vjedhin bashkë, bizneset i kanë bashkë dhe marrëveshjet i kanë bashkë. Këta bëjnë marrëveshje si të pasurohen e të ruajnë atë që kanë vjedhur. Nuk

duhet të gëzohemi pse bandat merren vesh. Ky konsensus është fatkeqësi.

- *Shikoni vullnet politik te kjo maxhorancë e re që të vendosë një ekuilibër demokratik, kushtetues midis institucioneve dhe pushteteve?*

- Po çfarë vullneti? Këta janë këtu për të mbushur xhepat. Shqiptarët duan një shtet normal, një ekonomi të shëndoshë, edukim, shëndetësi, vlera e struktura efektive. Këta duan të vendosin ekuilibrin që i lejon të vjedhin sa më shumë e me sa më pak zhurmë, rrëmujë e kontrollle. Nuk duan shtet të mirëfilltë, të fortë, efektiv e ligjor.

- *Keni ndjesinë se Rama do të reflektojë ndaj gabimeve që bëri në ndryshimet kushtetuese të 2008, prej të cilave PS vuajti në katërvjeçarin e opozitës së saj?*

- Kushdo që është në pushtet mendon për interesin e tij. Këta janë si shoferi që kur i jep makinës nuk pyet për këmbësorët. Kur bëhet këmbësor, shan shoferët e tjerë. Në këtë rast varet nga marëveshja që ka bërë me z. Meta.

- *Mendoni se varësia e votës nga nevoja për punësim, ishte faktori që favorizoi LSI, PR, PDIU, apo ato ofruan alternativa më bindesë në elektorat?*

- Për çfarë alternativash bëni fjalë? Këta ofruan para në zarf, vendin e punës dhe mbështetje për veprimtari të caktuara të ligjshme e të jashtëligjshme, brenda e jashtë vendit. Këta duhet të jenë në burg. Meqë nuk i fut njeri në burg, këta e bëjnë shtetin shqiptar burg për ne të tjerët. Njerëzit që shitën votat, shitën shpirtin e tyre, nuk janë elektorat, janë fatkeqë që duan të hanë një kafshatë bukë.

- *Kam parasysh këtë varësi të votës për nevojën për punësim, që ishte faktori përcaktues i zgjedhjeve në Greqi për tridhjetë e gjashtë vjet me efekte që administrata shtetërore atje të fryhej në 1. 4 milionë të punësuar në shtet. Ndërsa me reformat shkurtuese, ND dhe PASOK nga 40 - 46 %, që merrnin, arritën në 8 % për PASOK dhe 26 % ND. Mos vallë ky fenomen përsëritet edhe në Shqipëri me partitë tona?*

- Të gjithë këta duan të hanë nga shteti, dikush thërmija e dikush një furrë me para. Në fakt, ky ishte edhe mesazhi i shqiptarëve në këto zgjedhje. Bëni një shtet që të na japë punë, bukë, siguri e nder. Po këta e duan shtetin për vete. Si do t'i fusin në punë të gjithë këta që shpresojnë të gjejnë punë? Grekët kanë shtet, kanë identitet, kanë edhe struktura. I vetmi sektor ku ne mund të punësojmë kaq shumë njerëz, është ekonomia e jashtëligjshme. Nuk ka para, nuk ka ekonomi nuk ka investime, nuk ka drejtësi.

- A e ka imazhin politik PD që të reflektojë nga humbja?

- PD ka qenë një bandë, mbetet dhe është një bandë e drejtuar nga një Barbie Doll në duart e Saliut. Humbën shqiptarët, sepse këta zyrtarët e PD që vodhën sa mundëm, janë majmur e janë bërë rehat për njëqind vjet. PD është një maskë për Trushtin e Gështenjave. I mashtroi militantët, i mashtroi njerëzit që donin një të ardhme më të mirë, i mashtroi të përndjekurit, pronarët legjitimë, rininë, na i humbi njëzetë vjet dhe lufta e saj është që të rrijë në opozitë e në krye të opozitës.

- Çfarë i mungon PD tani që të bëhet alternativë qeverisëse për katërvjeçarin e ardhshëm?

- PD nuk ka shans që të bëhet alternativë për nja dymbëdhjetë vjet. I mungon struktura, vlerat, atdhedashuria, nderi, kontributi, respekti dhe udhëheqja e duhur. PD e ka kryer misionin e saj.

- A mund të bëhet një rimëkëmbje e PD - së, pas një humbjeje të madhe elektorale, me Berishën violinë e parë në opozitë?

- Saliu është politikani më i zoti në shtetin shqiptar. Por ajo që më intereson mua është a do të kenë ndonjë të mirë shqiptarët nga kjo gjë. Nuk besoj. Tani është koha që Saliu të luajë një rol tjetër. Por i ka larë duart me gjak e nuk del dot nga loja, se i duhet të ruajë interesat e Familjes. PD është Sali Berisha dhe Sali Berisha është PD. Koha është për një parti tjetër, për një ideologji kombëtariste e për mënjanimin e tij nga jeta politike. Saliu do të luajë një rol ekuilibruës midis parisë së Tiranës, por shumë pengues për të mirën e shqiptarëve.

- *Ditët e para të Kuvendit të ri, ripamë konfrontimin total shterpë të politikave. Nëse nuk ndryshon ky mentalitet i politikëbërjes, në favor të arritjes së konsensusit e bashkëpunimit, a mund të keni shpresë për një politikëbërje të standarteve evropiane?*

- Evropiane ne kemi çantat, këpucët, orët, vilat dhe makinat. Mendësinë e kemi katundare dhe politikën e bëjmë si katundarë. Ndaj do të vazhdojmë të sillemi si katundarë që nuk duan shtet për të tjerët, po për vete. Evropianët kanë vlera ideologjike. Edhe kur janë të mbaruar, e ruajnë dukjen, sidomos në lidhje me njëri - tjetrin. Ne nuk na ka dalë ende urrejtja për shtetin dhe nuk jemi ngopur duke vjedhur, edhe pse nuk do të marrim asgjë.

- *Pushteti absolut korrupton në mënyrë absolute. A është rrezik real ky edhe për qeverisjen e së majtës?*

- Jo. Sepse shumë nga këta janë tërësisht të korruptuar pa filluar. A ishin këta që drejtuan Tiranën? A ishin këta që Nano i bëri leckë në mbledhjen e KPD? A janë këta të lidhur me krimin, klanin e Zemunit etj., që përmendte dikur Saliu?

- *Edhe pse ditët e para të ushtrimit të pushtetit nga mazhoranca e re, shikojmë që Rama dhe Meta kanë mbajtur qëndrime të kundërta midis tyre; Meta nuk mbështeti vendimin e qeverisë Rama për potretin e Presidentit, për SHQUP, etj. Ju i deshifroni si qëndrime taktike, apo divergjenca politike në marrëdhëniet Rama - Meta?*

- Këta kanë bërë një marrëveshje, do ta respektojnë. Edhe Edi Rama edhe Ilir Meta janë të rrahur me vaj e me uthull. E dinë se duhet të ruajnë veten dhe dallimet. Do të vijë koha që të përplasen, por këto janë thjesht sa për konsum publik.

- *Ardhja e Ilir Metës në koalicion me PS, a shikohet edhe si një tentativë në perspektivë e Metës për t'u bërë lider i gjithë socialistëve, sepse vetë Rama po bën përpjekje të krijojë një klan të tij, duke e zhveshur PS nga e kaluara?*

- Ilir Meta është një figurë politike që do të jetë për shumë kohë në politikën shqiptare. Marrëveshja që ai ka me Ramën

është e përkohëshme. Paqja është pushimi midis dy luftërave. Nëse nuk del në krye të PS, atëherë Meta do ta kthejë PS dhe elektoratin e saj në LSI. Edi Rama ka dy vjet kohë me ndërtue e me konsolidue strukturat, që do ta mbajnë në politikë. PS nuk ka nevojë për të kaluarën, PS ka nevojë për të ardhmen.

- A përbën Ilir Meta personalitetin më të besueshëm që mund të bashkojë e të mishërojë socialistët e vërtetë?

- Kush janë socialistët e vërtetë? Ilir Meta e njeh strukturën, di të punojë në strukturë dhe pa strukturën nuk funksionon. Varet se si do ta shohin brenda PS. Edi Rama ka mbështetje të fuqishme, por shumëçka do të varet nga do të shkojnë dy - tre klanet që u mënjanuan kësaj here e që nuk harrojnë lehtë.

- A është Meta një garanci për një rotacion të shëndoshë?

- Brenda parisë po. Meta do të mbrojë interesat e parisë. Saliun e ka pasur partner dhe tani ka Lul Bashën. Me Ramën ka marrëveshje. Rrotacioni do të bëhet pa problem, edhe pse do të ketë sharje e rrahje në gazeta. Edhe gazetarët e shkretë duhet të fitojnë bukën e të prodhojnë lajme. Kështu që ata do t'i ushqejnë me lajme, kunja, thumba, batuta e ngacmime, por nuk do të ketë sherre serioze.

- Marrja e mundshme e statusit kandidat të Shqipërisë në dhjetor, a përbën një hop cilësor në standartet demokratike që kemi arritur deri tani?

- Po çfarë hopi cilësor! Çfarë do të ndryshojë nga 18 dhjetori më 19 dhjetor? Çfarë mund të ndryshojë në mentalitetin dhe psikologjinë e politikëbërjes shqiptare, pas marrjes së statusit kandidat në BE? Asgjë hiç. Do të mendojnë si të vjedhin në mënyrë më të sofistikuar e që të mos kapen kaq lehtë.

- Ekipin e ri qeverisës të Ramës e shikoni si një prurje e re në politikë, apo përpjekje që të ketë njerëzit e tij, duke e zhveshur PS nga e kaluara?

- Është edhe prurje dhe nuk është zhveshje e PS nga e kaluara, sepse të gjithë këta e kanë një lidhje në kërthizë me PS, përmes PPSH, familjeve, strukturave etj.

- Mendoni se LSI do të jetë protagoniste në qeverisje, apo

thjesht do të jetë në bashkëqeverisje, sikurse u justifikua nga përgjegjësitë e bashkëqeverisjes në PD?

- LSI do të ketë radhën për të qeverisur. Tani është në bashkëqeverisje e në gjetjen e mundësive për të hapur vende pune.

- Sa besueshmëri ofron kjo bashkëqeverisje PS - LSI në luftën kundër korrupsionit, derisa LSI ishte akuzuar nga opozita e PS si pjesë e korrupsionit?

- Politika është interes, varet se në interes të kujt punon. A punon për vete, për parinë apo për popullin shqiptar.

- Disa thonë që Erjon Veliajn atëherë e kishte venë Edi Rama, që t'i merrte PS Nanos, ndaj sot Rama e shpërbleu Veliajn dhe gjithë "MJAFIT"; Spiropali është zv.ministre e Jashtme, ndërsa gjithë bashkëpunëtorët e Nanos janë jashtë PS e qeverisë. Po ju, e keni këtë mendim, domethënë Rama me Veliajn dhe "MJAFIT" bëri komplot kundër Nanos, për t'i rrëmbyer PS?

- Këto gjëra unë nuk i di se jam larg. Por di që në një moment të caktuar, "MJAFIT" dhe Erion Veliaj i ka bërë një shërbim të madh vendit. Se kush përfitoi prej atyre veprimeve, është tjetër gjë. Bashkëpunëtorët e lanë Nanon në baltë, ai që vetëm për shumë kohë, nuk ia hapi njeri telefonin përveç Sali Berishës. Tani, si të ndahet torta e vendeve të punës e koncesioneve, do të shohim se kush do të fillojë të lëvizë.

- Cila është fryma që ushqen konfliktualitetin, si produktin e politikëbërjes në Shqipëri? Përse strategjitë politike pozitive - opozitive mbështeten pikërisht në komfrontimin total e shterp?

- Këta nuk i besojnë njëri - tjetrit, kanë mendësi kriminale dhe e kanë mendjen të vjedhin sa më shumë. Strategjia e përplasjes vjen kryesisht sepse duan të mbajnë turmën e mbështetësve bashkë. Politika në shtetin shqiptar nuk bëhet me vlera apo për vlera, por me interesa e për interesa. Dhe njerëzve iu shitet si tifoza. Dikur shkonin në stadium, tani ulen në kafene e shohin televizorin si shahen e grinden ditën, këta që i vjedhin ditën dhe i vrasin natën. Meqë mendojnë mbrapsht, besojnë se edhe të tjerët sillen mbrapsht dhe kështu grinden për gjithçka.

- Edi Rama si kryeministër, a do të dëftohet si egocentrist në përqendrimin e të gjitha pushteteve, sikurse akuzoi edhe Berishën?

- Ende nuk e kemi parë. Do të ketë kohë të provojë veten.

- *A mundet që Rama të mbajë premtimin se do të japë drejtësi për 21 janarin, derisa bashkëqeveris me Ilir Metën?*

- Ka gjithmonë zgjidhje për gjithçka.

- *Cila do të ishte ajo "drejtësi", që do të jepte drejtësinë katër të vrarëve në 21 janar? Të dënohen vetëm gardistët? Rama a duhet të dënojë tani shkakun e vërtetë, korrupsionin e ish - zv.kryeministrin Meta që i dha motivin demonstratës së 21 janarit?*

- Shkaku i vërtetë është ende i paditur dhe Ilir Meta doli i pafajshëm. Sepse ata që ishin në krye të turmës, nuk ishin më pak të korruptuar se ai që ishte në kryeministri. Dhe këta nuk u nisën drejt zyrave të LSI, por drejt zyrës së Saliut. Kur të na e thonë shkakun, do ta marrim vesh. Por nuk besoj se do ta thonë ndonjë herë shkakun. Ilir Meta ka marrë dyfishin e votave. Të tjerët i numërojnë votat si shuplaka, njëri një million, tjetri 700 mijë, Iliri i numëron si plumba në zemër të armikut. Kështu që do të bëhet drejtësi, me aq sa duhet e sa nuk prish punë.

MIZA NËN KËSULË, PARIA E TIRANËS DHE STRUKTURAT QË MBIJETUAN

Gjatë këtij tranzicioni ka shumë pyetje që nuk kanë marrë përgjigje. Më kryesorja është a ka pasur PPSH dhe strukturat e saj, një plan për periudhën e tranzicionit? Për shqiptarët të cilëve çdo e mirë dhe e keqe iu vjen nga jashtë e asnjëherë nga brenda, duhej të kishte një plan të paramenduar mirë. Viktimizimi është një dukuri rutinë. Lenia e përgjegjësive ndërkombëtarëve dhe historisë është po ashtu një teknikë e njohur për të mbuluar djallëzitë dhe dështimet. Plani që kanë parë në shtyp quhet Katovicë dhe numërohet si platformë e Gorbaçovit paraqitur në mbledhjen sekrete të udheheqësve të kampit lindor. Dalja e Servet Pëllumbit në televizion ka ngritur shumë pluhur. Duke e nxjerrë materialin, z. Pëllumbi akuzoi udhëheqësit e dy palëve, Fatos Nanon dhe Sali Berishën si vegla të sistemit të vjetër dhe zbatues të detyrave të caktuara nga udhëheqja e atëhershme. Tani kanë hyrë në lojë edhe Fatos Klosi e të tjerë. Po ashtu janë shprehur edhe Grid Rroji, më një shkrim që i vë pikat mbi - i -, Ardian Vehbiu që e vë në pikëpyetje qenësinë e një dokumenti të tillë duke u mbështetur në një analizë gjuhësore, e me radhë. Ndër të tjerët edhe Arben Kallamata, edhe unë.

Replikat dhe debati nuk duket se janë shterruese, por edhe nuk duket se do të ndalen lehtë. Problemi shkon në zemër të legjimitetit të parisë që na sundon. Prandaj në vijim, në shkrimin e një gazete, me profesionalizëm të respektuar, një koleg thotë se nuk gjen evidencë që ka pasur një mbledhje të tillë,

apo një plan për të ndryshuar sistemin dhe gjithë këtë e sheh si një teori konspirative të dikujt që kërkon që përgjegjësinë për dështimin e tranzicionit t'ua lerë në derë të huajve dhe ta konsiderojë si shprehje të batakut intelektual shqiptar. Pajtohem me konstatimin e tij se ç'ndodhi gjatë ndërrimit të sistemit e që nuk ka përfunduar, ishte zgjatim i sistemit. Po ashtu thirrja e tij të ruajmë e të punojmë me arkivat, është shumë e vyeshme dhe të shpresojmë se do ruhen ato që kanë mbetur.

Po jo e gjithë e vërteta është në arkiva dhe nuk mund të presim arkivat të merret vesh e vërteta. Plani Katovica dhe teoritë konspirative që kanë qarkulluar me kohë, janë për t'u injoruar, sepse nuk fillon aty baza historike apo e vërteta. Në fakt, duke u marrë me emra vendesh si ky, mbulohet e vërteta dhe pikërisht për këtë venie në spikatje të këtij aspekti, shkrimi i kolegut ka vlerë të madhe. Por në të njëjtën kohë, arkivat janë njerëzit e gjallë. Ata e dinë të vërtetën edhe më mirë se arkivat. Prandaj duke u nisur nga ajo që është ditur e parathënë, duke analizuar këtë që ka ndodhur gjatë tranzicionit, duke rishikuar sjelljen e politikanëve të caktuar, dinamikat e klaneve politike e me radhë, nuk duhen edhe aq shumë arkivat. Arkivat të ndihmojnë të ndërtosh një realitet në të cilin nuk ke jetuar. Një historian bën mirë që të gërmojë në arkiva. Po realiteti në të cilin kemi jetuar e funksionuar të gjithë, si gjatë tranzicionit, por edhe më parë si pjesë e strukturave dhe e shoqërisë shqiptare, është historia e vërtetë. Aq më shumë kur disa prej nesh kemi qenë edhe në dijeni si të planeve, ashtu edhe të njerëzve, të qëllimeve dhe të efektivitetit të strukturave. Nuk besoj se kjo do të gjendet në arkiva. Kur të gjendet nuk do të na hyjë fare në punë, as për të kuptuar se çfarë ka ndodhur me ne.

Prandaj mendoj se komenti që i bie në shenjë problemit është shkrimi i kolegut Grid Rroji, "Paria e Katovicës". Në këtë shkrim, Rroji me të drejtë ve në dukje se pavarësisht nga ka ardhur platforma, këta që dolën në krye të shtetit shqiptar e zbatuan pikë për pikë një platformë që pati këto pasoja dra-

matike e tragjike për shqiptarët. Këtu duhen sqaruar të paktën pesë aspekte të këtij problem. Kushdo që është i interesuar, trajtimin e zgjeruar të tij e gjen në dy librat e mi, “Probleme politike shqiptare” dhe “Përrallat e tranzicionit shqiptar”. Megjithatë ia vlen të vihen në dukje pesë aspektet që përmenda më lart dhe natyrisht të tjerë, kur të krijohet mundësia dhe nevoja. Kjo nuk e shmang nevojën e trajtimit shkencor të problemit, por duke qenë ujqit gjallë, nuk kemi pse e kërkojmë gjurmën e tyre në arkiva. Sepse Mafia, për shembull, nuk ka arkiva. Kjo nuk do të thotë se Mafia nuk ka platformë apo që nuk i ndjek me konsekuencë e me metodë qëllimet e saj.

A ka pasur platformë?

Natyrisht që ka pasur jo një, por disa platforma. Platforma më e njohur/e panjohur për ndryshimin e sistemit dhe gjendjen e stanjacionit në sistemin lindor, është ajo e Andropovit që vdiq shpejt. Ka pasur gjithashtu dokumente, platforma, struktura si nga sovjetikët, ashtu edhe nga të tjerët. Platforma tjetër që ia vlen të përmendet është platforma e NKVD/GPU lidhur me rezistencën në tokat e pushtuara. Apo ajo platformë që nuk ekziston e që thotë se do ta lenë agjenturën e tyre në vendet lindore. Sepse herë pas here, kapen ca tipa që nuk dihet nga dalin, por që punojnë ende për strukturat e tyre. Shkurt, duke nxjerrë mësim nga LIIB, sovjetikët ndërtuan struktura paralele të partisë dhe të shërbimeve në të gjitha nivelet e shoqërisë. Ashtu si ekzistonin listat për të zhdukur njerëzit, ashtu ekzistonin edhe ata që do t'i zhduknin e që do të vazhdonin luftën guerrile. Mesa më kujtohet nga bisedat në kohët e vjetra, te ne ka pasur një platformë të vitit 1953, një tjetër të rishikuar me urgjencë në nentor/dhjetor të vitit 1968, një tjetër të vitit 1976 dhe e rishikuara në vitin 1983. Njerëzit që shkonin në shkollat e instruksionit për oficerë, shkonin edhe në kurse në Pukë apo diku tjetër. Që ka pasur njerëz që i kanë ndjekur këto punë, edhe pse ishim nja tre hapa pas të tjerëve,

ka pasur. Ja për shembull, Sofokli Lazri shkante në Çeki e Bullgari për të nxjerrë mësim. Intelektualët filluan të bëhen të “shquar” dhe të botonin shkrime disidente të “Zëri i Popullit”. Delegacionet e arumunëve shkuan në Rumani për të nxjerrë mësim. Minoritarët e kushërinjtë e tyre shkuan në Greqi. Mërgata filloi të vinte për vizita në Tiranë. Gratë ruse filluan të shkruanin letra. Të huajt po ashtu filluan vinin e të na japin mend. Kontaktet u shtuan në të gjitha nivelet. Këto punë nuk bëheshin pa platformë. A quhet Katovicë, Bërdicë, Drashovicë, Kamenicë, kush po pyet? Kur ecën si gjel deti, lëshon zë si gjel deti, dukesh si gjel deti dhe han gështenja (sepse arrat i kemi prerë e kercunjtë i kemi shitur ne Itali) si gjel deti, je gjel deti. Edhe po ta vunë emrin Parti Demokratike, Parti Socialiste apo Parti Republikane me flatra noliame, je gjel deti. Ai shtet që kishim, ishte shtet që punonte me metodë dhe shumë i sofistikuar. Janë bërë mbledhje të regjistruara që gjenden në arkiva, por ka edhe biseda e takime, mbledhje e sqarime që nuk besoj se gjenden më aq lehtë.

Pse nuk flasin njerëzit?

Po kush të flasë? Këta janë të gjithë të lidhur bashkë me një oshkur të padukshëm. Ndoshta do të duhej ta ilustronja me një histori. Dy punëtorë e urrenin njëri - tjetrin. Pronari iu jep të dyve gabimisht nga një muaj rrogë më tepër. Këta rrihen për gjithçka, por atë rrogën nuk e zë njeri në gojë. Ose me e thanë ndryshe, kur i sheh qentë që zihen për kocka, mendon se të gjithë do të ngordhin. Ata zihen për kocka, por janë vëllezër. Prandaj edhe nuk flasin. Sepse atëherë do të duhej të dilnin e të tregonin pse duhej të ndodhnin këto krime të llahtarshme. Pse duhej të shkatërrohej ekonomia, pasuria kombëtare, vlerat morale, pse duhej të dëboheshin nga vendi një million e gjysëm shqiptarë, pse duhej të duronim erën e këtyre që katranosën tranzicionin. Të gjithë aty janë, të gjitha ia kanë parë dosjen njëri - tjetrit. Të gjithë janë të lidhur me

martesa, me interesa, me edukime, me miqësi, me lidhje të dukshme e të padukshme. Nuk do të flasin. Kush do të flasë? Omerta alla shqiptare katundare sipas parimit “unë nuk flas, por kush kapet e han”. Por kohë pas kohe e tregojnë fytyrën e vërtetë. Njerëzit e shohin atë fytyrë, por nuk duan me e besue. Metoda e gomarit që po e hante ujku funksionon. Gomari e futi kryet në ranë dhe tha “bane Zot andërr!”. Puna e këtyre është si puna e arkivës së Mafias. Vetëm kur të flasin, do ta marrim vesh. Po nuk besoj se do të flasë ndonjëri.

A ka qenë e ditur kjo punë?

Pa dyshim. Kur e kam ditur unë që kam qenë një askushi në atë kohë dhe që e merrja vesh nga shtypi e mediat e huaja, e më shumë nga bisedat me miqtë e shokët, po këta që mbaheshin për dikushi dhe që shkonin e vinin?! Këta e kanë ditur që çke me të. Se atë që nuk duhej në atë ditë e nisën në Greqi për ekspozitë dhe atë që duhej e sollën nga Italia me biletë me emër tjetër. Se në të gjitha palët duhej të ishte në krye një njeri i klaneve kryesore. Se ne shqiptarët punët i bëjmë me dyshe e treshe. Dhe këtë e di mirë, sepse rastisi që të isha në atë lojë. Edhe karrocën dy kuaj duhet ta tërheqin. Pse nuk kanë folur? Nuk kanë folur, sepse kanë qenë duke vjedhur e duke ngrënë mallin e kombit dhe duke u bërë borgjezi. Tani që po hanë kockat e kombit e të shtetit do të grinden dhe do të zihen me njëri - tjetrin. Dhe me kohë ndoshta del dikush dhe ia nxjerr petët lakrorit. Por si zor. Se kanë dalë këta të platformave që nuk kishin asnjë të shkuar apo cen politik, që shpesh ishin tërësisht neutralë në shoqëri dhe na bëjnë ligjin, na japin mend, na drejtojnë nga një katastrofë te tjetra, aq sa na kanë bërë të kemi nostalgji për ata të vjetrit.

A ka qenë lëvizja studentore pjesë e lojës?

Unë kam një interes jo të vogël personal në këtë debat. Nëse besohet se gjithçka u bë me plan e po të mos distancohemi, atëherë edhe unë edhe miqtë e mi paskemi qenë pjesë e

këij plani. Fakti është që Lëvizja ka qenë pjesë e lojës, e planifikuar me kujdes, me njerëz dhe me projekt të detajuar. Po ajo që ndodhi, siç edhe u shprehën në një mbledhje të Ministrisë së Brendshme, aty na kishte qenë një agjent i CIA dhe i Intelligence Service që duhej zhdukur, sepse u prishën punët dhe iu doli loja nga duart. A do të gjendet ndonjeherë procesverbal i asaj mbledhjeje apo i takimeve që pak veta i dinë? Nuk besoj, sepse e di mirë që nuk ka procesverbal. Por dikush që e njoh mirë, më ka thënë verbalisht se çka ndodhi jashtë procesverbalit. Problemi ishte se në atë rremujë ku kishin futur duart të gjitha palët, nuk dihej kush ishte i kujt dhe për kë punonte. Platforma nuk parashihte lenie të pushtetit, sepse siç tha Fatos Klosi, nuk kishte kush ta merrte pushtetin nga klasat e përmbysura dhe kjo dihej. Por Lëvizja Studentore ia arriti të ndërronte rregullat e lojës duke imponuar e kërkuar pluralizmin e vërtetë politik. Pra, do të duhej të luhej loja me rregulla të tjera. Nuk do të ishte futboll, por basketboll. U vendos pluralizmi që shkonte shumë larg atij që dëshironte paria e Tiranës. U mobilizua populli, sepse u bënë demonstrata në sheshin “Skënderbej” e tjerakund. U rrëzua miti i Enver Hoxhës, shtylla e legjitimitetit të parisë dhe të strukturave e me radhë. Dhe sa për këto arrestimet e mërgimet që sillen si deshmi, kur luajnë futboll fëmijët e të rriturit, nuk kanë hall pa ia futur një shkelm njëri - tjetrit. Aq më tepër kur duhet të bindim mbështetësit se e kemi prej vërteti lojën. Prandaj edhe duhet ndarë shapi nga sheqeri. Aty kishte lojtarë të futur, kishte nga të gjithë llojet, por kishte edhe të hyrë me zemër për t’i shërbyer kombit e shtetit. Me njerëzit gjallë që kanë folur e denoncuar këto gjëra që nga dita e parë, arkivat mund të presin.

Arritën atë që deshën?

Po, pa dyshim. Shteti shqiptar është një shtet i shkatërruar. Shqiptarët vishen me “Versaçe”, por punë nuk kanë. Gjysmën e popullsisë e kemi në mërgim. Shtetin e kemi në

borxh deri në fyt. Nomenklatura e vjetër janë bërë rehat edhe për shtatë breza. Shoqëria është moralisht e degjeneruar dhe e zvetënuar. Në krye të të gjithë kësaj katrohure, shkaktare dhe përgjegjëse historike është paria e Tiranës. Kjo është një shtresë oligarkike që sundon shtetin, që kontrollon ekonominë dhe që manipulon vlerat shoqërore përmes sistemit të fuqishëm të propagandës nën kontrollin e saj. Këtë shtresë, një grup të lidhur ngushtë me njëmijë fije të pazgjidhshme dhe të ndërtuar në bazë të parimeve klanore mafioze, së cilës i përkasin të gjithë prijatarët politikë dhe oligarkët e vërtetë të klaneve mafioze - politike, unë e kam quajtur paria e Tiranës dhe e kam bërë objekt të studimeve dhe analizave të mia. Shteti shqiptar është një shtet në një gjendje shumë kritike, në të gjithë drejtimet e mundshme.

Në nivelin politik, nuk janë zgjidhur problemet themelore të identitetit dhe të formimit të shtetit - komb. Shteti nuk ka sovranitet. Territori dhe pasuria kombëtare falen nga politikanët. Shteti drejtohet si kooperativë bujqësore, me metoda enveriste dhe sipas interesave të klaneve. Politikanët vetë janë të zvetënuar dhe të kriminalizuar, pa vlera morale dhe pa kurrfarë ndjenje shërbimi publik. Aty ku duhet të ketë dashuri për kombin e shtetin, ka besnikëri të shpallur e të pakufizuar për tarafin, bandën, katundin e klanin. Aty ku duhet të gjenden e të dallohen manipulatorët e sofistikuar të ligjeve që janë formuluar për të gjithë e në interes të të gjithëve, brohoriten ata që e bëjnë ligjin aty për aty, veç për interesat e tyre dhe e ndërrojnë ligjin sa të kryejnë punën e vet që mund të jetë, as më shumë e as më pak, nevoja e ndërtimit të një pallati në tokën e vjehrrës. Aty ku duhet të ketë shtet, të paktën aq sa për të mbrojtur interesat e parisë, ka një strukturë të pastër mafioze që e mban edhe parinë si peng të saj. Aty ku duhet të ketë sofistifikim intelektual e argumentim ligjor, luhet fall për natë në emisionet televizive. Politikanët të thonë sot, atë që nuk do ta thonë nesër, e që është e kundërta e asaj që kanë thënë dje e që nuk ka asgjë të përbashkët me atë që i thonë vetes së tyre.

Ai që duhej të ishte pari dikund tjetër, në Tiranë shet drogë në qoshe të rrugës, ai që din se si mund të rrihet në qoshe të rrugës bëhet deputet, ministër, kryetar, prijatar i parisë dhe konsiderohet si e ardhmja e kombit.

Në nivelin shoqëror, shoqëria është e thërmuar, e paqartë dhe e zvetënuar. Shteti shqiptar është i sunduar nga një oligarki e pastër politike, një shtet në të cilin hajdutët e thesarit të shtetit dhe të pasurisë kombëtare janë pasanikët më të mëdhenj, por edhe drejtuesit e partive politike. Pushteti dhe fuqia e vërtetë ekonomike është e përqendruar në një grusht familjesh mafioze. Nuk ka ekonomi të mirëfilltë prodhuese. Humbjet njerëzore dhe të kapitalit njerëzor kanë qenë katastrofike. 1.5 milionë shqiptarë kanë lënë vendin, janë hedhur në rrugë me qindra mijëra jetë, janë shpërdoruar mbi 120 miliardë dollarë para të pastra e të papastra që kanë hyrë në shtetin shqiptar. Tranzicioni nuk është mbyllur, por edhe nuk mund të mbyllet, sepse nuk është ndërtuar sistemi që duhet. Ka ardhur koha për reflektime shumë serioze dhe zgjidhjet nuk vijnë nga paria. Vijnë nga masat dhe nga intelektualët që do të dalin nga gjiri i popullit. Shteti shqiptar kërkon zgjidhje, por zgjidhjet nuk mund të vijnë nga paria që e ka sjellë vendin në këtë gjendje.

Në përfundim

Në përfundim, edhe pse pajtohem me kolegun që duhet të presim arkivat kur të hapen, them se Grid Rroji argumenton se me plan e pa plan, këta zbatuan atë platformë që iu interesonte. Menduan për vete e për pjellat e tyre, jo për kombin e shtetin. Në rrugë e sipër ka pasur devijime, ngatërresa, sherre, përplasje e me radhë, por ja, shih kë kemi në krye të shtetit! Nuk ka pasur nevojë të na vijë plani nga jashtë, kur e kemi pasur të zezën brenda vetes. Sepse këta që na mbajtën me bukë e ujë e dhallë duke hapur gropa dimrave nëpër ferma për të ruajtur pushtetin, si mund të ndalen

kur përveç pushtetit kanë edhe mundësinë e pasurimit pa fre? Prandaj le të mos merremi me Katovicën, Bërdicën, Kamenicën, Drashovicën, Reçicën, Nivicën e me rradhë, por të reflektojmë mbi këtë hata që na ka rënë e mbi këta kërma politike që na sundojnë, shfrytëzojnë, shesin, korruptojnë e na degjenerojnë. Këta duhet te ikin, sepse këta e platforma e tyre ishin e janë fatkeqësia jonë.

